

Dr. Agim ZOGAJ

MARRËDHËNIET  
SHQIPTARO - JUGOSLLAVE  
DHE ÇËSHTJAE KOSOVËS  
1945-1948



Prishtinë, 2016



*Përjetësisht, nipit, Aaron Matthew ZOGAJ,  
mbesës, Eva JAKA,  
dhe fëmijëve, Genc, Rina, Bardha!*



MARRËDHËNIET  
SHQIPTARO- JUGOSLLAVE  
DHE ÇËSHTJAE KOSOVËS  
1945-1948

**Redaktor:**

Prof. Dr. Arsim Bajrami  
Akademik, Pajazit Nushi  
Prof. dr. Selim Daci

**Recenzentë:**

Mr. Uran Butka  
Prof. dr. Bujar Dugolli  
Prof. dr. Jahja Drançolli

**Përgatitja grafike dhe ballina:**

Ma. Lejla Ibrahimimi

**Korrektore:**

Vjollca Zogaj

*Shqipëria është Atdheu ynë i përbashkët, është gjaku, shpirti,  
ëndrra, jeta e jonë, bekimi Zotit për çdo zemër shqiptare!*

***Shefkije Paçarizi - Zogaj***

Pasqyra e lëndës

Studimargumentues

Parafjalë

**1. Kapitulli i parë**

Vështrim mbi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave gjatë

LuftësëDytëBotërore 19

**2. Kapitullii dytë**

Vitete pasluftësdhe diplomaciae fshehtë 39

**3. Kapitullii tretë**

Pozita ndërkombëtaree Shqipërisë në vitet1945-1948 55

**4. Kapitullii katërt**

1. Bashkëpunimi nën diktat .. 98

2. Konferenca e Paqes në Paris dhe çështja e Shqipërisë .  
..148

**5. Kapitullii pestë**

Shtypii kohëspërmarrëdhënietshqiptaro-jugosllave, 1945-  
1948 ..212

**6. Përmbyllje . . . 248**

**7. Burimet dhe literatura . 251**



## ***Studim argumentues***

*Prof. Dr. Agim Zogaj që moti merret me studimin e marrëdhënieve shqiptaro – jugosllave. Rezultat i angazhimit sistematik të këtij studiuesi është vepra sintetike e karakterit historiografik e përpiluar në formë dorëshkrimi, që autori e ka emërtuar, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945-1948. Dorëshkrimi, përpos parathënies, fjalës përmbyllëse dhe literaturës, është i mbarështruar në pesë kapituj. Referencat dhe treguesit e tjerë, dëshmojnë për masën e madhe të burimeve politikologjike, historike e sociologjike, që autori ka konsultuar duke u thirrur, natyrisht, në dokumente autentike dhe duke mos lënë anash as përmbajtjen e shtypit të kohës të Tiranës, të Beogradit dhe të Prishtinës në ndriçimin e shtrirjesdhe të karakteritdhe të qëllimeve politike të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të viteve 1945-1948.*

*Duhet theksuar se periudha tri vjeçare e raporteve shqiptaro-jugosllave në kuptimin formal është e shkurtër për një vlerësim të përgjithshëm të këtyre marrëdhënieve studiuese; por pikërisht proceset politike, ushtarake dhe ekonomike të karakterit bilateral përpjesëtimeve të ndryshme si edhe raporti i këtyre marrëdhënieve në arenën ndërkombëtare, sidomos të asaj të Evropës Jug – Lindore, gjatë procesit fillestar të konsolidimit të pozicioneve të reja politike, ekonomike dhe sociale të vendeve pjesëmarrëse në Luftën e Dytë Botërore, kanë rëndësitë jashtëzakonshme për kuptimin zhvillimeve politike të Shqipërisë dhe të Jugosllavisë menjëherë pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore si edhe më pas. Rëndësia e posaçme*

e njohjes së këtyre marrëdhënieve të viteve 1945-1948 qëndron në vetëdijësimin e lexuesve për të mësuar si është kërcënuar pavarësia e shtetit shqiptar, e zhvilluar dhe e përforcuar gjatë tridhjetë gjashtë vjetëve nga shpallja e pavarësisë më 1912 dhe si është mbrojtur mëvetësia e shtetit shqiptar. Lidhur me këtë të kujtojmë fjalët e Liri Belishovës, pjesëmarrëse në Luftën Nacionalçlirimtare dhe e plagosur, udhëheqëse e lartë e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe pas vrasjes së burrit të saj Nako Spiros u përndoq dhe ndaj Lirie Belishovës dhe familjës së saj së bashku me të afërmit e burrit të dytë Maqo Çomonin, është ushtruar me dhjeta vite krim i rëndë, kur ka pohuar "...Byroja Politike vendosi të bënte de facto, "bashkimin" (gëlltitjen) e Shqipërisë me Jugosllavinë, në të gjitha fushat, por shpallja të bëhej kur të ishin konjunkturat ndërkombëtare më të përshatshme". Autori i këtyre rreshtave i ka përjetuar drejtpërdrejtë proceset e këtilla, sepse në proceset e vrullshme politike të asaj kohe i kam kaluar tri vitet e rinisë së paharrueshme dhe për këto procese gjatë zhvillimeve të mëvonshme kam shfletuar literaturë të gjerë. Por, kjo është më pak e rëndësishme.

Studiuesi dhe eksperti i marrëdhënieve shqiptaro – jugosllave/serbe, Prof. Zogaj ka vë vetes dy detyra kryesore, siç ka përmendur drejtpërdrejtë dhe tërthorazi në përmbajtjen e parathënies së kësaj vepre: 1. interpretimin objektiv të fakteve e të dhënave politiko – sociale dhe ekonomike si edhe të raporteve ndërmjet syresh në dritën e synimeve gllabëruese, siç i ka quajtur autori raportet e përgjithshme shqiptaro - jugosllave të tri viteve të para të pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore, dhe 2. Argumentimin e hipotezës bashkëkohore perëndimore, sipas së cilës "Aleanca me Jugosllavinë (në vitet 1945-1948 P. N.) u shndërrua në një bashkësi detyrimi".

Sa i përket detyrës së parë, mbledhja dhe interpretimi objektiv i fakteve dhe i të dhënave historike është baza e qasjes së mirëfilltë të studimeve të secilës çështje të gjitha disiplinave të shkencave sociale e humaniste, si edhe e disiplinave të tjera. Këtë detyrë, Zogaj e ka pasur pikënisje në studimin e kësaj periudhe të raporteve shqiptaro-jugosllave dhe kësaj detyre autori i është përmbajtur. Këtë e

konstatojmë në mbështetje të krahasimeve që u ka bërë studimeve të kësaj teme nga autorë të mëhershëm me materialet burimore, në rend të parë me ato të Arkivit Qendror të Shqipërisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, të Arkivit të KQ të PKJ në Beograd, të Arkivit të Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë në Beograd, të Arkivit të Kosovës dhe të Arkivit të Institutit të Historisë së Prishtinës. Vështruar nga kjo pikëpamje në këtë tudim hasim lëndë të pashfrytëzuar më parë dhe kjo risi e ka begatuar historiografinë e kësaj kohe të marrëdhënieve shumë të ndërlikuara shqiptaro - jugosllave të viteve të para pas përfundimit të Luftës Dytë Botërore deri në shpalljen e Rezolutës së Informbiros në qershor të vitit 1948. Ndërkaq, shfrytëzimi i materialeve arkivore të botuara, të literaturës së gjerë të botuar në gjuhën shqipe, serbishte dhe anglishte, duke përfshirë edhe disa nga botimet e rëndësishme të përkthyer në shqipe, si edhe shfrytëzimi i lëndës së materialeve të botuara në revista shkencore dhe në shtypin e ditës autorit ia ka mundur hedhjen e dritës së re në marrëdhëniet e trajtuara në këtë studim si edhe hapjen e shtigjeve të reja për mundësinë e gjetjes së disa materialeve sekrete të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Por, pavarësisht nga ajo se çfarë mund të gjendet më vonë, nëpër arkiva, mund të thuhet se studiuesi Zogaj e ka verifikuar hipotezën, sipas së cilës aleanca e Shqipërisë me Jugosllavinë e viteve 1945-1948 ka pas përmasë të theksueshme detyrimi të diktuar nga koncepti i përpiluar nga krerët e udhëheqjes së atëherëshme jugosllave, ku janë spikatur krerët udhëheqës të Republikës së Serbisë, dhe të përkrahur nga disa forca udhëheqëse të Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe të organeve shtetërore të Shqipërisë së atyre viteve. Argumentimi të kësaj hipoteze i kanë kontribuar dokumentet burimore dhe ato të shpa-losura në veprat e botuara më herët. Por, kuptohet, kontributi i këtyre burimeve ka qenë i përmassave të ndryshme, ndër të cilat më së paku argumentimi të kësaj hipoteze i kanë kontribuar burimet e shtypit ditor të Beogradit, të gazetës “Borba” në rend të parë, si edhe ato të Shqipërisë, siç ishte

gazeta "Bashkimi". Megjithatë, autori i librit, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945-1948 edhe këtu ka bërë një punë të mirë duke vë në spikamë dallimet dhe ngjashmëritë e përmbajtjeve të tyre dhe duke vë në dijeni lexuesit se sa pak është shkruar për "diplomacinë e fshehtë", për trazirat dhe përplasjet e brendshme të përfaqësuesve të PKSH deri në përcaktimin përfundimtar të PKSH për ndarje nga bashkëpunimi ndërmjet PKSH dhe PKJ, sepse PKSH përkrahu Rezolutën e Informbirosë dhe pikëpamjet e Stalinit për PKJ. Këto dyndje politike, trazira, përplasje dhe ndarje përfundimtare janë reflektuar rëndë në zhvillimin e shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni dhe në Mal të Zi. Prof. Zogaj e ka quajtur studimin e bërë për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështjen e Kosovës, 1945-1948 "Studim sprovë".

Mendoj, se studimi më i ri i prof. Zogaj ka kaluar caqet e "studimit sprovë", sepse është më tepër studim argumentuesi marrëdhënieve të studiuara, sidomos kurmerret në shqyrtim pjesa e bashkëpunimit që ka të bëjë kapitullin e katërt të emërtuar "Bashkëpunimi nën diktat, Konferenca e Paqes në Paris dhe çështja e Shqipërisë". Fjala përmbyllëse e këtij studimi është një sintezë korrekte e përmbajtjes së gjerë të pesë kapitujve të sistematizuar në këtë studim. Parafjala e shtruar në fillim, fjala përmbyllëse edhe literatura e gjerë, si edhe referencat e duhura të vëra në faqet e pesë kapitujve janë të ndërlydhura për-mbajtësisht dhe formojnë një tërësi të vlefshme për historiografinë e politikologjinë shqiptare, si edhe për psikologjinë sociale.

**Prishtinë, 11.11.2011.**

**Akademik, Pajazit Nushi**

## PARAFJALË

Që nga shpallja e shtetit jugosllav më 1918, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave ishin dhe kanë mbetur një ndër temat më me interes për hulumtime jo vetëm në historiografinë shqiptare. Ato, gjatë rrjedhave historike, paraqesin një ndër zhvillimet e rëndësishme, dinamike dhe për shumë çka edhe problematike, gjithnjë të rënduara nga pesha e konflikteve dhe e mosmarrëveshjeve jo vetëm politike ndërmjet dy shteteve, përkatësisht dy popujve por edhe të aspekteve të tjera. His-torikisht, është e ditur se politika shtetërore e Jugosllavisë, përkatësisht më tej e Jugosllavisë mbretërore dhe asajavnojane (1918-1991) kundrejt shtetit shqiptar, përgjithësisht çështjes shqiptare dhe veçmas çështjes së Kosovës, ishte dhe është politikë me pretendime, synime dhe veprime ushtarake, pushtuese, hegjemoniste. Së këtejmi, politikat e të gjitha qeverive jugosllave, duke përfshirë edhe politikën aktuale të recidivave të Jugosllavisë, përkatësisht të Serbisë karshi çështjes shqiptare, ishin, janë politikëe synimeve gl-labëruese, e pretendimeve të vazhdueshme për të pushtuar territore shqiptare. Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, për shkaqe të synimeve pushtuese të Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë gjithnjë ishin karakterizuar me kundërthënie, mosmarrëveshje dhe me konflikte edhe të armatosura. Këto marrëdhënie, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u intensifikuan dhe, në radhë të parë, nën ndikimet ideologjike

morën një ngjyrim tjetër të raporteve të ndërsjella, fqinjësore dhe të bashkëpunimit midis dy partive komuniste, të cilat kanë udhëhequr luftën kundër nazifashizmit. Në dukje të parë, ky bashkëpunim, i udhëhequr nga Partia Komuniste e Shqipërisë-PKSH, dhe Partia Komuniste e Jugosllavisë -PKJ, kryesishtmbi bazate luftës antifashiste, i përshpejtoi marrëdhëniet midis dy shteteve fqinje. Këto marrëdhënie, madje, i tejkaluan kufijtë e luftës antifashiste, edhe pse me kundërshtimin e korpunit politik e ushtarak të nacionalizmës shqiptare, e sidomos me çështjen e pa zgjidhur të Kosovës shpaluan objektivat internacionaliste të fqinjësisë dhe të marrëdhënieve ndërshtetërore të fqinjësisë, siç trumbetohej, me plot hile, pa kufij shtetërorë. Në pretendimin, të cilin objektivishtme iniciativa konkrete e drejtonte PKJ dhe e miraton-tepa hezitim PKSH, pala jugosllave synonte intensifikimine marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit sa më të gjerë midis Shqipërisëdhe Jugosllavisë, madje jugosllavët kishin përgatitur planin për bashkimin e dy shteteve në një federatë të përbashkët. Në ato vite, jugosllavëve u ngutej ta jetësonin, ta bënin realitet idinë për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, fillimisht si Republikë e shtatë jugosllave. Nga distanca e sotme, si dhe analizatdhe krahasimete sotmehistoriko - politikee kemi fare të qartë se si do të dukej raporti i forcave brendanjë federate të tillë, e ideuar dhe e ngritur-sipas konceptit gllabërues jugosllav, përkatësisht të hegjemonizmit serbomadn. Edhe sot, mund të ndeshim referenca të paqëndrueshme e të pa argumentuara nga ndonjë studiues shqiptar se, ndoshta për Kosovën dhe përgjithësisht për projektin e bashkimit kombëtar, plani apo projekti jugosllav gjatë viteve 1945-1948 për federatë midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë do të kishte qenë më me perspektivë.

Nisur nga fakti setema e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka qenë një nga objektivat kryesore të hulumtimeve dhe të studimeve të mia

të deritashme, mendoj se ky libër paraqet një angazhim të drejtpërdrejtë për ndriçimin e vazhdimësisë të marrëdhënieve në fjalë, pra, nga periudha e bashkëpunimit “idilik” shqiptaro-jugosllavderinë prishjen e tyre në vitin 1948. Në këtë kontekst, përveç hulumtimit të lëndëve arkivore, si dhe të literaturës nga provenienca shqiptare, jugosllave dhe botërore, përstudimet e mia lidhur më këtë çështje ishin me interes edhe trajtimet e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllavenga studiuesit tanë të periudhave të mëhershmetë kësaj lënde. Gjithsesi, ka munguar dhe mungon një studim i plotë dhe i dokumentuar i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të viteve 1945-1948. Prandaj, këtë studim, të shtruar në formë libri e shoh, e ndjej si një kontribut nismëtar në rrafshin e studimeve historiografike për marrëdhëniet shqiptare-jugosllave.

Është për të vënë re se, historiografia shqiptare me çështjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1945-1948, merret kryesisht pas vitit 1990. Në këtë frymë duhen veçuar kontributet e disa historianëve shqiptarë, si, bie fjala, Xhelal Xheçovi, Lefter Nasi, Ndreçi Plasari, Arben Puto, Marenglen Verli, Paskal Milo, Luan Malltezi, Muharem Dezhgiu, Uran Butka, Ana Lalaj, Dilaver Sadikaj, Demir Dyrmishi, etj. Nga studiuesit e Kosovës, ndër ata që duhen veçuar për shtruarjen kritike dhe të mbështetur në metodologjinë hulumtuese shkencore të kësaj teme janë: Fehmi Agani, Izber Hoti, Muhamet Shatri etj.

Historiografia komuniste shqiptare i ka idealizuar dhe himnizuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave përgjatë viteve 1945-1948, ndërsa pas prishjes së këtyre marrëdhënieve (1948), këto marrëdhënie midis dy shteteve dhe dy popujve i ka interpretuar duke ia hedhur plotësisht fajin palës jugosllave, e cila, realisht dhe në fakt, kurrë nuk pushoi së zhvilluari politikë tinëzare, gllabëruese ndaj popullit shqiptar, ndaj hapësira vejetike dhe territoreve shqiptare. Të dyja këto

pikëvështrime dhe trajtime, qoftë nga historiografia komuniste shqiptare, qoftë nga ajo jugosllave, janë të njëanshme dhe të politizuara.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në periudhën e Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në vitet 1945-1948, inspiron studiues bashkëkohorë evropianë, si dhe historianë e politologë në SHBA. Veçojmë kontributin e rëndësishëm të studimeve në këtë temë nga studiuesit gjermanë Bernhard Tonnes, Jens Reuter, Fabian Schmidt, Peterl Bartl, më pastaj të çiftit francez, Elizabeth e Jean-Paul Champseix, të Nicolas Martin, Nicholas Bethell, Tomas Schreiber, të britanikëve Reginald Hibbert, Peter Kamp dhe, gjithsesi, njohësit të shkëlqyeshëm të çështjes shqiptare, e në veçanti asaj të Kosovës, Noel Malcolm, Tim Juda dhe James Pettifer. Ndër studiuesit më të spikatur të çështjes shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, me theks të veçant edhe trajtimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllavederi në periudhën e vitit 1945, bën pjesë edhe historiani amerikan Bernd J. Fischer. Studiuesi italian, Antonello Biagini, po ashtu trajton fragmente të temës së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave nga periudha në fjalë. Por, nuk mund të mos themi se, në temën e trajtimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, historiografia perëndimore, deri në shembjen e komunizmit ishte nën ndikimin e historiografisë jugosllave, të arkivave dhe burimeve të kësaj provincie.

Historia e pesëdhjetë viteve të fundit të shekullit XX-të të popullit shqiptar nuk mund të ndriçohet plotësisht pa i hedhur një vështrim kritik, njëerës prej çështjeve mbizotëruese të asaj periudhe: marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave nga viti 1941 e deri në shembjen e sistemit komunist në dy vendet fqinje, Shqipëri dhe Jugosllavi. Është e mundshme që dikush të shtrojë pyetjen, pse pikërisht tani i rikthehemi temës së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të periudhës 1945-1948? Pa hyrë në argumentime të tjera relevante, ato historiko-politike,



akademike e të tjera, mjafton të përkujtojmë se vetë dimensionin aq problematik dhe me shumë kthesa e të papritura që kanë shoqëruar zhvillimet politike të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllavenë periudhën në fjalë, e mbështet arsyeve trajtimit të studimit tonë. Njohja dhe studimi i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1945-1948 ndihmon të kuptohet më me objektivitet, dramabiblike që e ka shoqëruar fatin e Kosovës, përgjithësisht të shqiptarëve nën sundimin jugosllav, pra drejtpërdrejt marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, dje dhe sot.

Kapitulli i ri i çështjes së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave nis që nga akti i themelimit të PKSH, në nëntor të vitit 1941, bashkë me ndërhyrjen jugosllave në zhvillimet politike në Shqipëri, e përkrahur edhe nga Kominterni dhe që kishte krijuar përshtypjen të pala jugosllavesë, PKJ duhej të ndihmonte në themelimin e PKSH. Në të vërtetë, historia politike e marrëdhënieve midis dy shteteve dhe dy partive përkatëse, në vitet 1941-1948 dëshmon se, nuk ishte fjala për ndihmë "miqësore" të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Partinë Komuniste të Shqipërisë, përkundrazi. Rezultatet më të reja të studimeve historike të proveniencës shqiptare dhe asaj perëndimore sjellin fakte se idetë e majta, pararendëse të ideve komuniste, kishin zënë fill në Shqipëri që nga KONARE-ja e Fan Nolit. Një ndikim të madh në krijimin e grupeve komuniste të Korçës dhe të Shkodrës patën grekët, përkatësisht, malazezët, nga të cilët u përkrahën moralisht dhe materialisht. Logjika politike e promovuar në fillim të vitit 1942, se PKJ po ndihmon dhe drejton zhvillimet politike brenda PKSH, hapi shtigje për ndërhyrje edhe më të drejtpërdrejtatë PKJ në zhvillimet e përgjithshme politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Mesi i vitit 1943 dhe gjysma e dytë e vitit 1944 shënojnë kthesë të re të ndërhyrjes së PKJ dhe të përpjekjeve të hapura për nënshtrim të PKSH. Jugosllavët e dinin se komunistët ishin më të organizuar në jug të Shqipërisë, monarkistët në Shqipërinë e Mesme dhe republika-

nët në veri të vendit. Prandaj, emisarët jugosllavë u ngutën që të pengonin bashkimin e qëndresave shqiptare kundër naziste, sepse një pajtim eventual midis komunistëve, në njërën anë, dhe republikanëve e monarksitëve, në anën tjetër, mund t'u hiqte jugosllavëve synimet për ta mbajtur Kosovën nën sundim. Rezistenca shqiptare, që synonte të përforcohej në Konferencën e Mukjes, me hilen jugosllave u shkatërrua dhe kështu forcat politike dhe ushtarake shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore u përçarë aq keq sa që kurrë më nuk u bashkuan. Gjithsesi, edhe me gabimet e udhëheqësve të atëhershëm politikë shqiptarë, PKJ mbante përgjegjësinë kryesore për veprimin përçarës, i cili për shumë vite rëndoi të ardhmen evropiane, perëndimore të Shqipërisë. Plenumi i 2-të i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë-KQ i PKSH, i njohur në historinë shqiptare si Plenumi i Beratit, u krijoi emisarëve jugosllavë mundësi të plota për të thelluar ndërhyrjen e gjithanshme në rrjedhat politike në Shqipëri, duke përcaktuar drejtimit e veprimit politikë dhe të vetë udhëheqjes së PKSH. Çmimi, të cilin Enver Hoxha po e paguante pas Plenumit të Beratit (1944) për ruajtjen e pozitës së vet politikë ishte tepër i madh, jo vetëm për të, por edhe për zhvillimet në shoqërinë shqiptare. Si pasojë, e politikës grabitqare të Jugosllavisë, përkatësisht drejtpërdrejt të Serbisë, Kosova u lanë harresë, kurse portat e ndërhyrjes jugosllave në politikën shqiptare ishin hapur hape krah. Në fillim të vitit 1945, ndërkohë që çarjet ideologjike midis Perëndimit dhe Lindjes po bëheshin publike, udhëheqja e PKSH, gjithnjë nën presionin diplomatik të jugosllavëve filloi haptazi ta përhapte dhe ta përkrahte idenë, planin për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Aso kohe, nën shtërngatat e presioneve të fuqishme që, udhëheqjes shqiptare i vinin si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi, udhëheqja e PKSH nuk e kuptonte se po futej thellë dhe më thellë në kurthet e jugosllavëve, përkatësisht, drejtpërdrejt dhe pamëshirshëm nën

orbitën e kontrollit, jo vetëm ideologjik të perandorisë komuniste në krye BRSS-në.

Qeveria Provizore e udhëhequr nga Enver Hoxha, në fillim të vitit 1945, duhej t'i kryente dy detyra: të konsolidonte pushtetin dhe të njihej ndërkombëtarisht. Dihet se, edhe gjatë viteve 1945-1947, rezistenca politike dhe e armatosur e forcave politike e ushtarake humbëse, properëndimore e demokratike në Shqipëri, ishte ende e fuqishme. Transformimi i raporteve politike e sociale në Shqipëri nuk po zhvillohej pa vështirësi, prandaj PKSH në këtë plan ishte po aq rigorozë, e ashpërnë luftimine alternativave tjera demokratike, perëndimore politike sa edhe partitë si motra në kampin komunist. Ndjekja e kundërshtarëve politikë, deri në dënimin dhe ekzekutimin me vdekje, kishte filluar edhe para se të krijoheshin bazat kushtetuese për të institucionalizuar veprimet e tilla. Në punët e brendshme, regjimi komunist në Shqipëri e filloi kursin e rreptë politik të luftës së klasave, duke filluar edhe me gjyqet publike të bashkëpunëtorëve dhe të "armiqve të popullit". Ndërkohë, qeverinë e Enver Hoxhës nuk e njihte asnjë nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Ndaj kërkesës së Enver Hoxhës për ta njohur ndërkombëtarisht qeverinë shqiptare, kërkesë kjo e dërguar më 5 janar 1945 kancelarivetë SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe BRSS, u reaguua me ngurtësi. Dukej qartë se Fuqitë e Mëdha kishin vendosur që Shqipërinë ta linin pa mbështetjen e tyre, ndërsa vërejtjet e qeverisë amerikane dhe asaj britanike se gjendja në Shqipëri ende nuk ishte e qartë dhe se qeveria shqiptare nuk ishte legjitimuar përmes zgjedhjeve të lira, nuk mund të ishte argument i qëndrueshëm. Kjo ngase, edhe në shtetet tjera të bllokut socialist, konkretisht në shtetin fqinj, Jugosllavi, ishte një gjendje e tillë, por reagimet e Fuqive Perëndimore nuk ishin aq të rrepta si në rastin e Shqipërisë. Për këtë arsye, historiografia bashkëkohore perëndimore, me të drejtë hedh hipotezën se, aleanca e Shqipërisë me Jugosllavinë u shndërrua në një

bashkësitë detyrimit. Së fundi, në fillimet e vitit 1945, ishte e qartë se Shqipëria, gjithsesi edhe me gabimet e veta, nën parashenjat e Luftës së Ftohtë nuk kishte çfarë të priste nga udhëheqësit perëndimorë. Mirëpo, qeveria shqiptare në marrëdhëniet e jashtme i keqësoi punët dhe pozicionet e veta edhe më tepër me prishjen dhe mosmarrëveshjet që i nxiti, gjithsesi, edhe nën ndikimin e thellë jugosllav. Veçmas, në vitin 1945 dhe në vijim, Shqipëria i kishte përkeqësuar marrëdhëniet diplomatike me SHBA dhe Britaninë e Madhe. Në fillim të vitit 1946, Shqipëria ra në varësi të plotë të Jugosllavisë. Jugosllavia, madje, për shkak të mosnjohjes ndërkombe-tare të qeverisë shqiptare, i përfaqësonte dhe i mbronte interesat e Shqipërisë si të ishte ajo një provincë e saj territoriale. Siç shihet nga dokumentet arkivore të kohës, kontakte te Shqipërisë me shtetet komuniste dhe të tjera bëheshin përmes Jugosllavisë dhe të diploma të vetë saj. Kompetencat e Jugosllavisë, në këtë plan, ishin të jashtëzakonshme dhe kjo dëshmonte se Shqipëria nga dita në ditë po bëhej gjithnjë e më e varur nga fqinja e saj. Lidhjet e Shqipërisë me Jugosllavinë u thelluan edhe më shumë në korrik të vitit 1946, kur midis dy vendeve u nënshkrua Traktati i Miqësisë dhe i Bashkëpunimit dhe Ndihmës së Ndërsjellë. Ky Traktat i Miqësisë, Jugosllavisë i dha po atë lloj kontrolli mbi ekonominë e Shqipërisë, siç ia dhanë, traktatet e po asaj natyre Bashkimit Sovjetik, kontrollin mbi ekonominë e vendeve socialiste të Evropës Juglindore. Megjithatë, ndër udhëheqësit më të lartë të Byrosë Politike të KQ të PKSHkishte të tillë që nuk entuziazmoheshin me ndërhyrjet jugosllave në Shqipëri dhe aq më parë me shpejtësinë e realizimit të planit jugosllav për krijimin e federatës midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Sipas burimeve arkivore del se ndër kundërshtarët e parë të vijës së bashkimit me Jugosllavinë ishin Sejfullah Malëshova, Mehmet Shehu, e më pase dhe Nako Spiru, i cili pikërisht për shkak të kundërshtimeve të tij të hapura, nën presionin e

bashkëpunëtorëve të tij politikë, u detyrua të bënte vetëvrasje. Plenumi i 5-të i KQ të PKSH, i mbajtur në shkurt të vitit 1946, ku u kritikua vija politike e cilësuar si oportuniste e Sejfullah Malëshovës, nxiti proceset e zbatimit të politikës së bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë.

Në vitin 1947, KQ i PKJ, i pakënaqur me shpejtësinë e realizimit të bashkimit të proklamuar ndërmjet dy shteteve në një federatë, paditi zyrtarisht KQ të PKSH për krijimin e një vij etë dytë kundër jugosllave në Shqipëri, padi kjo e cila u vu për diskutim në Plenumin e 8-të të KQ të PKSH. Ky Plenumi, i cili i zhvilloi punimet me ndërprerje, prej 26 shkurtit deri më 8 mars të vitit 1948, në nëntor të të njëjtit vit, disa vite më vonë, konkretisht në Kongresin e Parë të KQ të PKSH personalisht nga Enver Hoxha do të cilësohej si një nga njollat më të zeza të PKSH. Enver Hoxha kishte parasysh se, aleancën me Jugosllavinë në Plenumin e 8-të të KQ të PKSH-së, e kishte vlerësuar “një nga fitoret më të mëdha”. Meqenëse të çarat politike midis PKJ dhe PK të BRSS ishin paraqitur që në pranverë të vitit 1947, ndërkohë që, në kontekst të planeve për federatë me Shqipërinë, udhëheqja jugosllave po bëhej gjithnjë e më e shqetësuar. Prandaj, nuk ishte rastësi pse në mars të vitit 1948, PKJ, nëpërmjet Savo Zllatiqit, emisar jugosllav në Shqipëri, i kishte propozuar Enver Hoxhës të riaktualizonte çështjen e Kosovës. Plani i fshehtë jugosllav, i hartuar nën diktatin e Titos dhe bashkëpunëtorëve të tij serbë ishte vonuar, sepse disa ditë pasi ishte hartuar Rezolucioni i Plenumit të 8-të të KQ të PKSH, udhëheqja komuniste shqiptare u informua për letrën e 27 marsit 1948 të KQ të PK të BRSS, dhe, nga ai çast udhëheqja e PKSH u gjet në udhëkryq. Në qershor të vitit 1948, Enver Hoxha dhe udhëheqja e PKSH përfundimisht mori anën e Stalinit. Prishja midis BRSS dhe Jugosllavisë ishte diçka e jashtëzakonshme, e papritur, që sipas studiuesve të kësaj fushe e shpëtoi Enver Hoxhën, i cili që udhëheqësi i parë i vendeve të Evropës Juglindore që me

guxim i fryu trumbetës kundër titizmit jugosllav. Pozitat dhe autoriteti i Enver Hoxhës si udhëheqës i PKSH-së dhe i shtetit shqiptar u rikthyen në Kongresin e I-rë të KQ të PKSH, mbajtur në nëntor të vitit 1948. Kështu, Shqipëria kaloi nga varësia jugosllave në varësinë e re sovjetike, gjë që realisht, në planine rrezikimit të integritetit dhe sovranitetit territorial të Shqipërisë dukej se ishte me më pak rreziqe. Siç del nga zhvillimet e atëhershme ndërkombëtare, i vetmi ngushëllim i aleancës së re të shtetit shqiptar me Stalinin ishte ruajtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Shqipërisë. Asgjë më tepër, sepse në planin ndërkombëtar, Shqipëria vazhdonte të mbetej e izoluar, e armiqësuar, jo vetëm nga aspekti ideologjik me botën perëndimore, me thellimin e vazhdueshëm të diktaturës komuniste, me varfëri sociale të masave të gjëra popullore dhe me një të ardhme të turbullt që më tepër i ngjante vetmisë së madhe në arenën, asokohe, shumë të turbullt ndërkombëtare. Ndërkohë, çështja e Kosovës, edhe për shkak të pafuqisë së ndikimit të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare vazhdonte të mbetej e mbyllur, e harruar, e lënë nën enigmat e marrë-veshjeve të fshehta, gjatë Luftës së Dytë Botërore e më vonë, drejtpërdrejt nën ashpërsinë e jehonës dhe të pasojave të Luftës së Ftohtë.

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë 1945-1948 dhe më pas, kishin ndikuar edhe në ngjarjet dramatike nëpër të cilat kaloi populli i Kosovës, i cili edhe pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kishte në nën risundimin jugosllav. Natyrisht, me gjithë ato rrethana shumë të rënduara dhe tejet të vështira politike, sociale, të sigurisë, përgjithësisht kombëtare, populli i Kosovës, i mbështetur nga shteti shqiptar nuk pushoi së luftuari deri në luftën çlirimtare heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për t'u çliruar nga robëria serbe dhe për ta shpallur shtetin e pavarur të Kosovës që, siç do të dëshmojë historia e zhvillimeve të ardhshme, është

edhe një hap përpara drejt bashkimit kombëtar, zgjidhjes së vetme dhe të drejtë për popullin shqiptar.

Në këtë libër kam bërë përpjekje studimore për të ndriçuar dhe shpjeguar marrëdhëniet shumë komplekse shqiptaro-jugosllave dhe çështjen e Kosovës, kryesisht gjatë viteve 1945-1948, duke u mbështetur në burimet arkivore, literaturë të kohës, si dhe mbi një interpretim objektiv dhe komparativ të historiografisë bashkëkohore.

*Autori*

*Prizren, prill 2012*





## Kapitulli i parë

# HISTORIKUI MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO - JUGOSLLAVE GJATËLUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Mbledhja e grupeve komuniste shqiptare për themelimin e PKSH u mbajt më 8-14 nëntor 1941, në Tiranë. Në këtë mbledhje, e cila shënoi një hap të ri e vendimtar dhe një kthesë të madhe të lëvizjes komuniste e nacionalçlirimtare në Shqipëri, u mor vendim për shkrirjen e grupeve komuniste dhe krijimin e një partie të vetme -PKSH.

Rreth çështjes së themelimit të PKSH, në historiografinë jugosllave dhe atë perëndimore janë paraqitur pikëpamje dhe interpretime të ndryshme, kryesisht lidhur me rolin e komunistëve jugosllavë në formimin e PKSH. Historiografia jugosllave, duke i mbetur besnike dhe shërbyese preten-dimeve të hegjemonizmit serbomadh, nuk pushoi së propaganduari spekulimin politik se PKJ ishte themeluese e PKSH. Emisarët e PKJ në Shqipëri, Miladin Popoviç dhe Dushan Mugosha, patën një rol të rëndësishëm në formimin e PKSH, por nuk mund të thuhet se ata themeluan Partinë Komuniste Shqiptare. Përcaktuese ishin zhvillimet politike në Shqipëri dhe më gjerë. Gjithsesi, për këtë çështje ka pasur dhe vazhdon të ketë mendime të ndryshme kundër thënësë, jo vetëm në historiografinë shqiptare, por edhe në atë të huaj. Hibbert shkruan:“PKJ u interesua për të nxitur një-

farë veprimtarie komuniste në Shqipëri, në verën e vitit 1939. Miladin Popoviçi, një malazez (në atë kohë Kosova ishte e grupuar me Malin e Zi në strukturën e brendshme të PKJ), u dërgua të binte në kontakt me grupin komunist të Shkodrës, më i afërti me Maline Zi, me synimin që të hetonte se çfarë hapash mund të merreshin për të formuar një parti komuniste në Shqipëri. Mund të supozohet se PKJ kishte si motiv vështirësitë që kishin pasur për të ngritur në këmbë një lëvizje ndër popullsinë shqiptare në Kosovë. Nëse mund të krijohet në Shqipëri një parti bijë, ose ndoshta një parti motër më e re, mund të bëhet më e lehtë që me ndihmën e një partie të tillë të hidhet fara e komunizmit në Kosovë. Misioni i Popoviçit nuk pati sukses..."<sup>1</sup> Georges Castellan, profesor i Unionit të Parisit, duke folur rreth formimit të PKSH, shkruante: "Kongresi që shënon themelimin e Partisë Komuniste shqiptare u mbajt nga 8-14 nëntor 1941, dhe ishte krejtësisht modest: ai bashkoi pesëmbëdhjetë militantë të tre grupeve ekzistuese dhe caktoi një Komitet Qendror prej shtatë anëtarësh, me në krye Enver Hoxhën. Komiteti kishte për detyrë të përcaktonte programin: referim i plotë i marksizëm-leninizmit dhe përkrahje e vijës së Kominternës për bashkimin e forcave kundër fashizmit. Në mbledhje morën pjesë edhe dy anëtarë të Partisë Komuniste Jugosllave, aq sa një polemikë do të zhvillohej më vonë midis V. Dedijerit, i cili e paraqiti themelimin e Partisë Komuniste shqiptare si krijesë të drejtpërdrejtë të jugosllavëve, dhe Enver Hoxhës, i cili e quajti iniciativën e tij të pavarur".<sup>2</sup> Elisabeth Barker, midis të tjerash, shkruan: "SOE, fillimisht, nuk kishte informuar se në mbledhjen e mbajtur në Tiranë, nën mbikëqyrjen, iniciativën dhe nxitjen e dy përfaqësuesve të partizanëve jugosllavë, Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës, nënëntor të vitit 1941, u themelua Partia Komuniste shqiptare dhe

1 Reginald Hibbert, Fitorja e hidhur, Tiranë, 1993, f. 35.

2 Georges Castellan, Historia e Ballkanit, Tiranë, 1996, f. 478.

zgjodhi Komitetin Qendror, në të cilin hyri edhe mësuesi i ri, Enver Hoxha".<sup>3</sup>

Duke analizuar pikërisht këtë moment, studiuesi gjerman Jens Reuter, konstatoi se: "Të dy misionarët e PKJ (Miladin Popoviçi e Dushan Mugosha) kanë pasur rolin kryesor në themelimin e PKSH, më 8 nëntor 1941".<sup>4</sup>

Faktet historike dëshmojnë se në përgatitjet për mbledhjen e përbashkët dhe gjatë konsultimeve që i paraprinë mbledhjes themeluese të PKSH, ishin të pranishëm edhe dy përfaqësuesit e PKJ, Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha.

"Nëmbledhjen themeluese të PKSH kishin marrë pjesë Miladin Popoviçi dhe Dushan Mugosha. Përpyqje te para të krijimit të marrëdhënieve të barabarta e miqësore midis komunistëve jugosllavë dhe atyre shqiptarë, datojnë edhe më herët. Konkretisht, me iniciativëne Kominternës që t'u jepej ndihmë komunistëve shqiptarë në formimin e PKSH, qysh në shtator të vitit 1939, Tito sekretar i përgjithshëm i PKJ, nëpërmjet Miladin

Popoviçit e kishte porositur Komitetin Krahinortë PKJ të vinte kontakte me komunistët shqiptarë".<sup>5</sup> Duke iu referuar Reginald Hibbertit, mund të thuhet se: "Për një periudhë pas kësaj nuk ndodhi asgjë, sepse Miladin Popoviçi, i cili duhej ta kryente këtë mision, u kap nga italianët, afër Mitrovicës, dhe kështu doli jashtë veprimit. Në shtator, në Shqipëri u dërgua një emisar tjetër nga PKJ, anëtar i Komitetit Qendror të PKJ, Dushan Mugosha. Edhe njëherë Grupi i Shkodrës u bë pikësynimi i parë. Ai mori kontakte edhe me Grupin e Korçës, por me sa duket ata ia prenë me sëpatë të madhe... Kur ai u kthye në Jugosllavi, Grupi i Korçës e mendoi edhe një herë punën dhe hyri përsëri në lidhje me të. Në tetor,

3 Elisabeth Barker, Britanska politika na Balkanu u Drugom Svetskom Ratu, Zagreb, 1978, f. 171.

4 Jens Reuter, Die Albanen in Jugoslawien, München, 1982, f. 35.

5 Ali Hadri, Stvaranje KP Albanije, Prilozi za istoriju socijalizma, 3, Institut za izucavanje radnickog pokreta, Beograd, 1966, f. 242.

ai u kthye në Shqipëri dhe u bashkua me komunistët shqiptarë për të çliruar Miladin Popoviçin nga internimi. Ky është varianti që japin jugosllavët për këtë ngjarje. Versioni shqiptar e paraqet lirin e Popoviçit si meritë vetëm të shqiptarëve dhe nuk e përmend Mugoshën”.<sup>6</sup> Pikëpamjet e historiografisë jugosllave, përkatësisht asaj serbe, të cilat pa kurrfarë kriteri e me hile ia atribuojnë PKJ dhe komunistëve jugosllavë rolin e themeluesit të PKSH, dalin nga pretendimet historike megalomane të politikës serbomadhe. Pretendimet autorëve jugosllavë, si të atyre nga historiografia jugosllave, ashtu edhe të politikanëve dhe pjesëmarrësve serbë në Luftën Dytë Botërore, mbështeten në spekulimet shkencore e politike, si dhe në programet historikisht të dështuara të ideologjisë serbomadhe. Në fillim të viteve të shtatëdhjeta, ndaj pretendimeve megalomane të Tempos, të Dedijerit etj., reagoi historiani Ali Hadri, duke pohuar se: “...hidhet poshtë mendimi i Svetozar Vukmanoviç-Tempos (dhe jo vetëm i tij) që e ngriti punën e delegatëve të PKJ në relacion me PKSH në një megalomani dhe që nuk mbështetet në të vërtetën historike e nuk përkon me botëkuptimin mbi kushtet historike dhe faktorët, që ndikojnë në formimin e lëvizjes dhe të partisë komuniste”.<sup>7</sup> Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, edhe në periudhën Luftës së Dytë Botërore, nuk janë zhvilluar pa acarime dhe pa tensione të shumëfishta të ndërhyrjeve brutale, imponimeve ideologjike dhe skemave të tjera, jo vetëm politike. PKJ, qysh nga filltet e bashkëpunimit ndërpartiak, është pozicionuar vazhdimisht në raportme çështjens hqiptare, pra, edhe ndaj PKSH, me ngarkesa paternaliste dhe me pasione serbomëdha. PKSH, e cila është rirreshtuar në bllokun e partiv ekomuniste të bllokut të aleancës antifashiste të Internacionales Komuniste, në raport me marrëdhëniet e

---

6 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 36.

7 Ali Hadri, Një vështrim kritik mbi memoaret e S.V. Tempos, “Përparimi”, Nr. 7, 1971, f. 593.

ndërsjella me PKJ dhe përgjithësisht me LNÇ të Jugosllavisë, është paraqiturmbi bazat e skemave të tejkaluara ideologjike të dogmatizmit dhe të ortodoksisë marksiste-leniniste Fakti që. PKSH, në raportme PKJ, ka hyrë jo si parti komunist es hqiptare, por si Parti Komuniste e Shqipërisë, e ka përkufizuar roline vet në kohë dhe në hapësirë, i ka vënë pa të drejtë kornizat e veprimit shpirtëror e territorial, jashtë të cilave, PKJ ia ka kontestuar legjitimitetin e veprimit dhe propagandimit të ideve, jo vetëm komuniste, por edhe të atyre çlirimtare, e në veçanti kombëtare. Mirëpo, realiteti historik asnjëherë nuk iu nënshtrorhet skemave ideologjike, pra as të udhëheqësve komunistë shqiptarë, sipas të cilëve, PKSH ishte konsekuent-enë ide dhe veprimtë platformës internacionaliste, ndërkohë që ajo iu nënshtrua plotësisht politikave të PKJ, madje, edhe në tregtimin e çështjes sonë kombëtare. Duke evokuar me ironi sekuencat e marrëdhënieve midis PKJ e PKSH, Tempo flet edhe për bashkëpunimin me Lëvizjen Nacional çlirimtare të Shqipërisë, i cili, sipas tij, ishte "...i gjithanshëm, i sinqertë e i dobishëm...parezerva dhe shoqëror"<sup>8</sup>. Ndërkohë, Enver Hoxha, duke pretenduar të shpaloste të vërtetën e vonuar për marrëdhëniet dhe bashkëpuniminë ndërsjellë me jugosllavët, prame PKJ, midis të tjerash konstatonte: "Të gjithë njerëzit që i dërgonte Titoja dhe udhëheqja e Partisë Komuniste e Jugosllavisë te ne, gjoja për të na ndihmuar dhe për të shkëmbyer eksperiencë, vinin me plane të parapërgatitura, me "direktiva" që na i diktoninndhene duhej t'i zbatonim, vinin si "ustallarë" të revolucionit dhe të Luftës Nacionalçlirimtare...

Megalomania dhe arroganca e tyre nuk kishte kufi, duke filluar që nga Bllazho Jovanoviç, Vukmanoviç Tempo, Dushan Mugosha, Velimir Stojniç, Nijaz Dizdareviç dhe deri tek ata që erdhën pas çlirimit, Josip Gjergja, Savo Zlatiç, Sergej Krajger, gjenerali Kupreshane të tjerë"<sup>9</sup>.

8 Svetozar V. Tempo, Borba za Balkan, Lubjanë, 1981, f. 148.

9 Enver Hoxha, Titistët, Tiranë, 1982, f. 14.

Duke e trajtuar çështjen e ndërhyrjes brutale të udhëheqjes së PKJ në punët e brendshme të PKSH, dhe gjithsesi edhe në rrethanat e ndryshme mbi karakterine themelimit të PKSH, shkruesit e historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë, më 1971, vlerësonin: “Me kërkesën e KQ të PKJ, një numër kuadrosh të PKSHu dërguan për të organizuar partinë dhe luftën kundër pushtuesve fashistë në Kosovë e në Rrafshin e Dukagjinit. Organizata e PKSH e qarkut të Dibrës jepte ndihmë të madhe për organizimin e luftës çlirimtare në qytetet e Dibrës, Gostivarit, Tetovës, Kërçovës dhe në rrethet e tyre. Për të mbajtur lidhje midis dy partive, në Shqipëri qëndroi Miladin Popoviçi, komunist internacionalist jugosllav, të cilin komunistët shqiptarë e patën liruar në vjeshtë të vitit 1941, nga një kamp përqendrimi fashist në Peqin. Në marrëdhëniet ndërmjet PKSH dhe PKJ, ai ka përkrahur gjithnjë qëndrimin internacionalist të KQ të PKSH”.<sup>10</sup>

Qasjet diametralisht të ndryshme, rreth themelimit të PKSH dhe ndihmës jugosllave në formimin e saj, mund të klasifikohen në tre grupe:

1. Pikëpamjet sipas të cilave PK e Shqipërisë u krijua nga PK e Jugosllavisë, gjegjësisht nga përfaqësuesit e saj, prandaj ishte filiale e PKJ.
2. Pikëpamjet që shënojnë një stërmadhim të rolit të PKJ dhe të përfaqësuesve të saj në krijimin e PK të Shqipërisë dhe që, objektivisht, ndonëse jo në formë eksplikativo-terminologjike, u afrohen pikëpamjeve të para.
3. Pikëpamjet mbi pavarësinë dhe mëvetësinë e PK të Shqipërisë, si në formim, ashtu edhe në zhvillimin dhe funksionimin e saj, me ç’rast kontaktet me PKJ dhe me përfaqësuesit e saj cilësoheshin si “ndihmë e rëndësishme”.<sup>11</sup>

Pikëpamjet jugosllave, të cilat e mbiçmojnë rolin e ndi-

<sup>10</sup> Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1971, f. 177.

<sup>11</sup> Shih për këtë: Fehmi Agani, Partitë dhe grupet politike në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, Disertacioni i doktoratës në dorëshkrim, mbrojtur në Universitetin e Prishtinës më 1973, f. 202.

hmës së PKJ, nuk kanë mbështetje dokumentare dhe argumente bindëse. Pikëpamjet jugosllave, ndër të cilat duhen veçuar ato të V. Dedijerit në librin “Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1939-1949”, mandej pikëpamjet e Svetozar Vukmanoviç-Tempos të paraqitura në formë të kujtimeve, por edhe ato të autorëve të tjerë serbë, synojnë kryesisht të shtrembërojnë trajtimin kushteve dhe të rrethanave shoqërore, historike e politike në Shqipëri, të cilat ishin faktorë vendimtarë për themelimin e PKSH. Duke bërë fjalë për qëndrimin e tij të parë në Shqipëri, Tempo shkruante me një pretenciozitet të theksuar, të njëanshëm e tendencioz, duke falsifikuar faktet historike: “Posa kishte përfunduar Konferenca e Parë e Partisë, në të u zgjodh Komiteti Qendror. Ky ishte një suksesi madh i njerëzve tanë udhëheqës, Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës. Ata qëndruan një kohë në Shqipëri dhe arritën që prej grupeve marksiste të ndryshme mes veti, të krijojnë Partinë e bashkuar...”<sup>12</sup>

Në historikun e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, në veçanti të marrëdhënieve të ndërsjella të bashkëpunimit mes PKSH dhe PKJ gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kosova është njëra prej temave më me rëndësi rreth së cilës në vazhdimësi kishte mosmarrëveshje, lojëra të shumëfishta diplomatike, të cilat u reflektuan për të keq në dëm të popullit shqiptar të Kosovës. PKSH dhe PKJ i qaseshin çështjes së Kosovës nga këndvështrime të ndryshme, por edhe të njëjta, ndonëse ka pasur momente që mund të quhen si imponim i pikëpamjeve të PKJ ndaj PKSH. Rrjedhat historike diktuan që PKSH dhe PKJ u morën me Kosovën edhe nga fakti se të dy partitë ishin parti të më të mëdha të kohës dhe bartëse të luftës së armatosur antifashiste e për çlirim nacional. Pikërisht, në çështjen e Kosovës dhe mbi fatin e rëndë të popullit të saj zhvilloheshin dramet më të rënda ndërmjet PKSH dhe PKJ. Ky dramaticitet u reflektua në fërkime e tensione politike të marrëdhënieve

12 Svetozar V. Tempo, vep. e cit., f. 334.

mes dy partive dhe dy lëvizjeve nacional çlirimtare. Lidhur me këtë, Hibbert konstatonte: “Kosova mbeti një zonë problematike për PKJ dhe PKJ vazhdoi të kishte nevojën e bashkëpunimit të PKSH në përpjekjet për trajtimin e saj. Nga ana e saj, PKSH vijoi të ishte e interesuar për bashkëpunim, sepse kjo ishte e vetmja rrugë e mundshme për të fituar merita dhe për të treguar, nëpërmjet punës organizuese aktive, se popullsia shqiptare e Kosovës e meritonte vetvendosjen. Enver Hoxhae kishte në anëne vet Miladin Popoviçin dhe fusha fillestare e përgjegjesisë së Miladinit kishte qenë zona e Kosmetit. Siç duket, Miladini ka qenë i një pikëpamjeje me Enver Hoxhën, se rezistenca në Kosovë duhej të drejtohej nga Shqipëria dhe jo nga Jugosllavia/Serbia”.<sup>13</sup> Dihet se komunistët jugosllavë, të udhëhequr nga PKJ dhe Tito, pretendonin të ndikonin në rrjedhat e Luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe në Kosovë. Në fillim, Lëvizja Nacionalçlirimtare në Kosovë nuk kishte kurrfarë lidhjeje dhe bashkëpunimi me forcat antifashiste të aleancës perëndimore. Edhe ky ishte një faktor i favorshëm për krijimin e kushteve që PKJ, pa ndonjë pengesë, pa kundërshtim, së pakutë PKSH, të paraqitej në skenën politike e luftarake me pretendimin e pakontestuar se popullin e Kosovës do ta përfshinte në luftën anti-fashiste duke e pasur në radhët e veta, pra të PKJ. Në atë kohë, marrëdhëniet midis komunistëve shqiptarë dhe atyre jugosllavë ishin kryesisht të mira, ndërsa udhëheqja e komunistëve jugosllavë premtonte zgjidhje të drejtë për Kosovën. Prandaj, edhe PKSH ishte ndër faktorët më me ndikim që shqiptarë te Kosovës’ia jepnin besimin dhe pajtimin PKJ në luftën e tyre antifashiste dhe nacional çlirimtare. “Mirëpo, ky lëshim nuk ishte absolut, sepse, qysh në atë kohë, shumë kundërnazifashistë shqiptarë kishin shprehur mosbesim të madh ndaj thirrjes që PKJ u bënte shqiptarëve në luftë kundër

---

13 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 51.



pushtuesve nazifashistë”.<sup>14</sup> Se nuk do të jetë ashtu, se qëndrimi i komunistëve jugosllavë ndaj çështjes së Kosovës nuk do të jetë pa hile dhe nuk do të ketë ndryshime esenciale nga platforma e hegjemonizmit serb, kjo u pa nga qëndrimet e instruktorëve të KQ të PKJ, të dërguar me mision të caktuar politik e ushtarak në Shqipëri. Kështu, Miladin Popoviçi, në letrën dërguar Svetozar V. Tempos, më 15 dhjetor 1941, veç të tjerash shkruante: “Shokët nga Maqedonia kërkojnë njëfarë ndihme aktive nga viset e Shqipërisë, mirëpo kuptohet, duke zbatuar në mënyrë rigorozë vijën e IK, përkatësisht vendimet që PK të mbetet në kufijtë e vjetër. Kështu veprime edhe më herët dhe në këtë veprime kemi përfillur në Kosovë e Metohi”.<sup>15</sup> PKJ, duke përdorur politikën e dinakërisë jugosllave, u premtonte shqiptarëve në Kosovë dhe përgjithësisht në Jugosllavisë, në rastse do të hidheshin në luftën antifashiste, do t’u garantohej e drejta e vetvendosjes deri në shkëputje.

PKJ i kushtonte kujdes të veçantë angazhimit të shqiptarëve në Luftën Nacionalçlirimtare edhe për arsye të tjera. Ndër arsyet kryesore pse PKJ ngutej që të ndihmonte, por edhe të kontrollonte PKSH, dhe përmes saj edhe LANÇ në Shqipëri, ishte se me këtë mbikëqyrje jugosllavët siguronin të luftonin, nëpërmjet vetë politikës së komunistëve shqiptarë, programin dhe idealet e lëvizjes nacionaliste e antikomuniste për programin e bashkimit kombëtar nën emblemën e Shqipërisë etnike. PKJ e kishte qartëse nëpërmjet të PKSH dhe LANÇ të Shqipërisë do t’i bënte më pak të fuqishme aspiratat dhe veprimet e popullit të Kosovës për bashkim me shtetin amë. Përveç kësaj, duke i angazhuar shqiptarët në lëvizjen antifashiste, do t’i largonte edhe për një kohë, veçmas shqiptarët e Jugosllavisë, nga synimet historike për

---

14 Izber Hoti, Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f. 37.

15 AQ i PKJ, Fondi Miladin Popoviç, Letër dërguar Tempos, më 15.12.1941.

çlirim nga robëria jugosllave dhe nga bashkimime shtetin amë.

Nisur nga këto qëndrime, por para së gjithash nga synimi historik që të çlirohej nga zgjedha serbe, populli i Kosovës ishte ngritur me pushkë në dorë kundër nazizmit dhe luftonte, duke u mbetur besnik idealeve për çlirim nacional. Por, shumë shpejt, gjatë LANÇ ishte e qartë se deklarimet partiake të Titos dhe përgjithësisht të PKJ për realizimin e të drejtës së parimit të vetvendosjes për popullin e Kosovës ishin të mbështjella me paragjykime dhe me mashtrime. Në të vërtetë, edhe vetë korrespondenca që ishte zhvilluar mes Titos, Miladin Popoviçit, Tempos, Ivan Milutinoviçit dhe udhëheqësve të tjerë jugosllavë, në vitet e luftës, dëshmon për përgatitjen e një tradhtie e mashtrimi të madh ndaj popullit të Kosovës, qysh nga ditët e para të fillimit të luftës kundër nazizmit.

Më 29 korrik 1943, Komiteti Qendrori PK të Shqipërisë, përmes delegatit të vet, i ishte drejtuar KQ të PKJ në lidhje me çështjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Miladin Popoviçi, nëpërmjet një letre dërguar Ivan Milutinoviçit, anëtarit të Byrosë Politike të KQ të PKJ, i cili ato ditë gjendej në Mal të Zi (1943), ia transmetonte qëndrimet dhe pikëpamjet e KQ të PKSH lidhur me statusin e ardhshëm të Kosovës. Në këtë letër, e cila mban datën 29 korrik të vitit 1943, Miladin Popoviçi, në mes të tjerash, shkruante: “Më parë kemi diskutuar (me Svetozar Vukmanoviç Tempon -A.Z.) për shumë çështje, prej të cilave disa janë përfshirë në letër. Kemi diskutuar edhe përçështjen e Kosovës. Mirëpo, kjo çështje ka kërkuar zgjidhjen e Titos. Ka kërkuar qëndrim të caktuar. Shumë çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën në Shqipëri, gjithashtu. Qysh kur Dushani ishte te Tito (në fund të verës 1942 -A.Z.) i kam shtruar një varg çështjesh, aty edhe çështjen e Kosovës dhe kam kërkuar qysh atëherëse si të zgjidhet”<sup>16</sup>. Në emër të KQ të PKJ, KQ të PKSH iu përgjigj Ivan Milutinoviçi, i cili paraq-

16 Radoshin Rajoviç, Autonomija Kosova, f. 219-220.

iste pikëpamjet e PKJ dhe të Titos, ku përsëritej qëndrimi i njohurse çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë duhej të shtyhej për kohën pasi të mbaronte lufta: “Përsëri po ju theksoj se nuk bën të lejoni që ju të merrni qëndrim ashtu siç ka marrë borgjezia reaksionare shqiptare, në të vërtetë, që kjo pjesë që tani t’i bashkohet Shqipërisë, por se përmes rrugës së luftës dhe atë të përbashkët duhet t’i çlirojmë ato vise nga okupatori dhe ngatë gjithëtradhtarëte vendit, kurse më vonë popujt do të përcaktohen çfarë duan dhe ku dëshirojnë”.<sup>17</sup> I pakënaqur me këtë përgjigje, KQ i PKSHPërsëri e aktualizoi këtë çështje, përmes një delegacioni të udhëhequr nga Vasil Shanto, anëtar i KQ të PKSHP, i cili bisedoi me Ivan Milutinoviçin. Duke parë presionin dhe këmbëngulësinë e KQ të PKSHP, që në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës të hiqeshin dilemat dhe të merrej qëndrimi caktuar, Tito në një letër dërguar KQ të PKSHP, më 2 dhjetor 1943, i jepte përgjigje të prerë dhe ultimative: “Në lidhje me letrën e Miladinit, si dhe me bisedën e delegatëve tuaj me shokun Milutinoviç, e ndjej të nevojshme t’ju përgjigjem në pyetjen tuaj për pozitën e Kosovës dhe Metohisë. Të shtrosh sot çështjen e bashkimit, kjo vërtet do të thotë të derdhë shujë në mullirin e reaksionarëve të ndryshëm, pra edhe të vetë okupatorit. Shoku Milo (Miladin Popoviç - A.Z.) nuk ka të drejtë kur thotë se Partia jonë do të duhejta ndryshojë qëndrimin në lidhje me çështjen e Kosovës Metohisë dhe kur Kosovën e Metohinë i krahason me Istrën”.<sup>18</sup>

Në të njëjtën letër, Tito fliste përsëri edhe për të drejtën e shqiptarëve të Kosovës për vetvendosje, por këtë mundësi e kushtëzonte me përfundimin e luftës dhe me teorinë jugosllave për jokompaktësinë territoriale, përkatësisht për orientimet e ndryshme të shtresave të popullatës në Kosovë: “Kjo do të thotë se shqiptarët në Kosovë dhe Metohi kanë të drejtë

17 Po aty, f. 220.

18 Arkivi i KQ të LKJ, Fondi i KQ të PKJ, nr. 1943, f. 378

që të përcaktohen ku të shkojnë dhe si dëshirojnë. Por, në lidhje me këtë, në pajtim me qëndrimet tona teorike kështu shikojmë: shqiptarët në Kosovë e Metohija në të përbërë nga disa shtresime, të cilat nuk kanë synime të njëjta, ndaj edhe as nuk mund të shkojnë në të njëjtën rrugë”.<sup>19</sup> Tito, duke bërë të qartëse PKSHE dhe UNÇ e Shqipërisë nuk do të mund të ishin të pranishme në Kosovë, as ushtarakisht e as politikisht, sqaronte pozicionin dhe qëndrimin e PKJ ndaj të drejtës së vetvendosjes të popullit shqiptar, që shprehimisht do të thoshte se ky parim nuk do të mund të vlente e të respektohej për popullin e Kosovës. Që këto qëndrime të PKJ ishin të paramenduara mirë, flete dhe konstatimi i Titos, paraqitur në letrën dërguar Tempos, më 6 dhjetor 1943, pra katër ditë pasi i kishte dhënë përgjigje KQ të PKSHE. Në këtë letër, Tito, theksonte: “Parulla për bashkimin e Kosovës dhe të Metohisë sot Shqipërisë, të cilën e propozon Miladini, si dhe qëndrimi për komandën e Shtabit Suprem Shqiptar mbi Metohinë, në të vërtetë, do t’u shkonin në favor të gjithë armiqve të Luftës Nacional çlirimtare në Jugosllavi dhe të gjitha klikave fashiste e reaksionare”.<sup>20</sup>

Fakti se përfaqësuesit e popullit shqiptar, përkatësisht udhëheqësit e LANÇ të Kosovës nuk u thirrën në Mbledhjen e Dytë të KAÇKJ, më 29-30 nëntor 1943, në vitet e luftës, por edhe më vonë, kishte lënë përshtypje të ndryshme kundërtënëse. Sipas disa pikëpamjeve, mos prania e përfaqësuesve të Kosovës në Mbledhjen e Dytë të KAÇKJ nënkuptonte se PKJ ishte e vendosur që për çështjen e Kosovës të vendoste vetë populli i saj, kuptohet, pasi të përfundonte lufta. Mirëpo, kishte edhe pikëpamje, sipas të cilave, te popullata e Kosovës ishte krijuar një frikë, një shqetësim e një pasiguri për të ardhmen e Kosovës, pikërisht nga mos deklarimi i Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ lidhur me statusin e Kosovës. Vetë konkluzi-

---

<sup>19</sup> Po aty, f. 378.

<sup>20</sup> Josip Broz Tito, Sabrana djela, vëll. 18, f. 250-251.

oni i Mbledhjes së Dytë të KAÇKJ, se nuk pranohej copëtimi i Jugosllavisë, ishte mesazh i mjaftueshëm për të kuptuar se çështja e Kosovës nuk do të zgjidhej drejt, se nuk do të respektohej e drejta e garantuar edhe nga Karta e Atlantikut për të drejtën e vetvendosjes së secilit popull që merrte pjesë në aleancën antifashiste, pra edhe e popullit shqiptar në Kosovë. Për një shqetësim të tillë bënte me dije edhe Mitar Bakiç, komisar partizani Korparmatës II të UNÇJ të KQ të PKJ, i cili, në raportin e datës 31 dhjetor 1943, vlerësonte: “1. Po ndihet një pakënaqësi te paria, përse Mbledhja e KAÇKJ dhe deklarata nuk e ka përmendur popullin shqiptar në Jugosllavi; 2. Përse Titoja, si kryetar, në deklaratë dhe në proklamatë nuk ka dhënë një qëndrim të qartë ndaj shqiptarëve; 3. Përse KQ i Partisë nuk po u drejtohet shqiptarëve. Komiteti Krahinor kërkon që në njëfarë mënyre të përmenden shqiptarët”.

Shkelja brutale e vendimeve të Konferencës së Bujanit dhe injorimi i vullnetit legjitime sovran të popullit të Kosovës nuk ndikoi në prishjen apo në keqësimin marrëdhënies në mes të PKSH dhe të PKJ. PKSH, edhe pse kishte pasur përfaqësuesit në Konferencën e Bujanit, nuk ishte ndier përgjegjëse që të kundërshtonte imponimin e qëndrimeve jo të drejta të PKJ. “Për këtë konferencë, ku denoncohej veprimtaria armiqësore e udhëheqjes jugosllave kundrejt Shqipërisë, Enver Hoxha nuk foli asnjëherë as gjatë luftës, as pas luftës, as në Kongresin I të PKSH, as në ndonjë takim a kongres tjetër”<sup>21</sup>. Përkundrazi, në vend që PKJ të kritikohet për shkeljen e vullnetit të popullit të Kosovës, prijësi i saj Tito madhërohej, përshëndetej dhe falënderohej. Kjo shihet edhe nga telegrami përshëndetës që në Kongresin e Parë Antifashist të Rinisë Popullore të Shqipërisë, më 16 korrik 1944, iu dërgua marshallit të Jugosllavisë, Josip Broz Tito. Në këtë telegram, pjesëmarrësit e kongresit falënderonin Titon për: “...luftën e

---

21 Dr. Muhamet Shatri, Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë, 1997, f. 156. 23 Zbornik, VII/3, dok. nr. 103, f. 307.

tij për bashkimin, për vëllazërimin e popujve të Ballkanit, si dhe për sendërtimin e idesë së madhe të Konfederatës Ballkanike”.

Orientimi i palëkunduri PKSHP që të jetë forca kryesore, madje edhe e vetme, që do ta merrte pushtetin në Shqipëri, si në luftimin e nazizmit, ashtu edhe në drejtimin e Lëvizjes Antifashiste Nacionalçlirimtare, bëri që PKSHP dhe prijësit e saj të jenë të pranueshëm për PKJ, e cila, nëpërmjet PKSHP, dëshironte të realizonte synimet e politikës së vet. Prandaj, nuk kishte dyshim në përkrahjen e kursit të tillë të PKSHP nga ana e PKJ. Mirëpo, pengesë në këtë bashkëpunim paraqisnin forcat nacionaliste dhe forcat kundër komuniste në Shqipëri, Kosovë dhe viset e tjera shqiptare në Maqedoni, të cilat, po ashtu, ishin ngritur dhe ishin deklaruar kundër nazizmit. Konferenca e Pezës, e mbajtur më 16 shtator 1942, shënonte një hap të rëndësishëm drejt formimit të një fronti të përbashkët antifashist, por njëkohësisht dëshmonte edhe për ndërhyrjen e hapur të PKJ në punët e PKSHP dhe të Lëvizjes Nacional çlirimtare të Shqipërisë. “Qysh në mbledhjen e delegatëve komunistë, e cila u zhvillua pak ditë para Konferencës së Pezës, Miladin Popoviçi propozoi që Konferenca e Pezës të mos kishte të drejtë të formonte KPNC, sepse, sipas tij, ky këshill duhej të dilte nga lufta. Por, meqenëse kjo tezë u kundërshtua nga të gjithë të pranishmit, emisari jugosllav propozoi që Këshilli i Përgjithshëm të mos kishte të drejtë të drejtonte luftën gjersa të krijohet Shtabi i Përgjithshëm, i cili do të dilte nga lufta e do të mbante lidhje me çetat partizane dhe vullnetare. Me këtë propozim synohej që çetat vullnetare nacionaliste, nëpërmjet komisarëve politikë, të lidheshin me PKSHP, e jo me KP”.<sup>22</sup> Sipas dëshmive të Koço Tashkos, pjesëmarrësit e Konferencës së Pezës nuk e pranuan “... këtë propozim, se po t’u pranoheshin nacionalistëve, ata do të kujtonin menjëherë që s’e kishim me sinqeritete dëshmë t’i

<sup>22</sup> Muhamet Shatri, vep. e cit., f. 100

kishim si kuaj me kapistallin në dorën tonë”.<sup>23</sup> Siç shihet nga dokumentacioni i Konferencës së Pezës, Miladin Popoviçi ishte këmbëngulës në kundërshtimin e idesë për të krijuar një front të gjerë antifashist të përbërë nga të gjitha forcat patriotike.

Udhëheqësit nacionalistë ishin angazhuar që të krijonin frontin e përgjithshëm në luftë kundër fashizmit, me anën e të cilit do të bëhej realizimi i idealeve të Shqipërisë etnike, si dhe pretendonin që ky front të drejtohej nga Këshilli i Përgjithshëm Nacional çlirimtar. Enver Hoxha, duke respektuar sugjerimet që vinin nga emisarët jugosllavë, në radhë të parë nga Miladin Popoviçi, ishte kundër idesë që këtë front lufte ta drejtonte KPNC, por vetëm PKSH. “Me sa duket, në Pezë dhe më pas, puna ishte se Enver Hoxha ishte tepër i shqetësuar që të siguronte rolin drejtues të PKSH në rezistencën shqiptare, sesa të tërhiqte në një shkallë sa më të gjerë ndjenjat nacionaliste kundër pushtuesit. Nga kjo kohë, ai do ta kishte idenë për të marrë pushtetin në fund të luftës.. Në Pezë, ai nisi rrugën drejt pushtetit nga një bazë relativisht e ngushtë: dukej qartë që ai parapëlqente më mirë këtë, sesa ta ndante pushtetin me të tjerët”<sup>24</sup>. Në këtë frymë, nuk ishin pa domethënie kundërshtime te Koço Tashkos ndaj Miladin Popoviçit, lidhur me përfshirjen e popullit të Kosovës nën drejtimin PKJ. Edhe në këto bisedime, Miladin Popoviçi kishte mbrojtur vazhdimisht mendimin se Kominterni kishte vendosur që çështja e Kosovës të zgjidhej në kuadër të PKJ.

Involvimi i theksuar dhe i drejtpërdrejtë i PKJ në zhvillimin e ngjarjeve brenda lëvizjes antifashiste e nacional çlirimtare në Shqipëri në Kosovë u shpreh edhe në Konferencën e Parë të Vendit të PKSH, e cila u mbajt në mars të vitit

---

23 Politika antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i Beratit, f. 196. 26 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 40.

24 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 40.

1943. Ndikimi i PKJ në PKSHP dhe përgjithësisht në LANÇ të Shqipërisë, në fillim të vitit 1943, u zgjerua edhe më tej në çështjen e organizimit të lëvizjes dhe të përhapjes së saj në masat popullore. Tani e tutje, thuhet gjithçka filloi t'i nënshtruhej konceptit organizativ, sipas Titos. Pasojat e ndërhyrjes së misionarëve jugosllavë në krijimin e platformës për Konferencën e Pezës dhe qëndrimi jokritik i prijësve të PKSHP në raport me PKJ, ishin të drejtpërdrejta dhe hapnin shtigje për ndërhyrje edhe më frontale e tinëzare të jugosllavëve. Komunistët jugosllavë nuk mund të pajtoheshin me faktin se në Pezë, në kuadër të forcave dhe grupimeve politike shqiptare, u inkuadruan edhe patriotë dhe forca të tjera demokratike, atdhetare, të cilat u angazhuan në platformën e luftës kundër fashizmit. Një ecuri e tillë dhe një koekzistencë paqedashëse e të gjitha forcave politike në Shqipëri nuk u konvenonte emisarëve jugosllavë. Prandaj, sipas tyre dhe urdhreve që vinin nga PKJ duhej sa më parë të prishej koekzistenca e demokratëve dhe e komunistëve në Shqipëri. Kështu, nëpërmjet Svetozar Vukmanoviç-Tempos, Tito u përkujdes që në Shqipëri t'u dërgonte direktiva të reja Dushan Mugoshës e Miladin Popoviçit dhe të thirrej një konferencë e re e PKSHP. Qëllimi ishte i dukshëm: për t'i përçarë nacionalistët dhe komunistët. Kështu, "...me direktivën e Titos, u mbajt Konferenca e Parë e Vendite PKSHP në Labinot (17-22 mars 1943), në një fshat afër Elbasanit. Tito, në emër të Kominternës dhe nëpërmjet Blazho Jovanoviçit, u dha direktiva të reja komunistëve shqiptarë se në ç'mënyrë të distancoheshin nga nacionalistët dhe të krijonin një forcë unike sipas modelit sovjetik. Në këtë konferencë, ideologjia nuk luante asnjë rol primar. Të rëndësishme ishin çështjet organizative".<sup>25</sup> Në këtë direktivë të Titos ishte apostrofuar edhe çështja e organizimit dhe e bashkimit të aradheve dhe të grupeve në një ushtritë organizuar, e cila, përveç luftës kundër armi-

25 Bernhard Tönnies, Sonderfall Albanien, vep. e cit., f. 451. 28 Po aty, f. 451.



kut, do të përpiquej të organizonte edhe pushtetin popullor. Sipas udhëzimeve të Titos, në këtë konferencë të PKSHP u formuan shtabe ushtarake dhe komitete të tjera partizane, të cilat morën përsipër çështjen e pushtetit komunist dhe afirmimin e ideologjisë. “Vendimi më i rëndësishëm në këtë konferencë ishte që në bazë të njërive vullnetare partizane të krijohej një ushtri nacionalçlirimtare, e cila do të ishte një fuqi e rëndësishme kundër okupatorit dhe garanci e sigurt për çlirimin e vendit. Ushtria Nacionalçlirimtare u definua si sektori më i rëndësishëm i punës për të gjithë pjesëmarrësit e Partisë. Përveç punës së rekrutimit të fshatarëve, edhe puna me femrat dhe të rinjtë u konsiderua me rëndësi”.<sup>26</sup> Konferenca e Labinotit ka rëndësi dhe domethënie edhe për një moment, i cili i shteme peshë të veçantë në zhvillimin e LANÇ në Shqipëri. Në fakt, misionarët jugosllavë, të cilët arritën të ndikonin fuqishëm në krijimin e platformës së Konferencës së Parë të Vendit të PKSHP, ia arritën qëllimit që përfundimisht ta hidhnin Ballin Kombëtar në terrenin kundërshtar, që luftën ideologjike e politike ndërmjet PKSHP dhe Ballit Kombëtar ta acararin dhe ta vinin në një vazhdimësi të përçarjeve e të mosmarrëveshjeve. “Ndërhyrja jugosllave ishte aq e fuqishme dhe e pakontrolluar, sa që në Konferencën e Parë të Vendit zgjedhjene KQ të Byrosë Politike, të sekretarit të përgjithshëm të PKSHP-Enver Hoxhës, të strukturës organizative të organeve më të larta të partisë, si dhe përbërjen e tyre, e vendosën emisarët jugosllavë, Miladin Popović dhe Dushan Mugosha. Ky fakt u konfirmua nga drejtuesit e PKSHP, në Plenumin e Beratit”.<sup>27</sup> Duke analizuar pikat qendrore të platformës politike të Konferencës së Labinotit dhe vendimet e saj, Reginald Hibbert konstatonte se: “...shumë shpejt, pas Konferencës I të Vendit të PKSHP, në mars, mar-

---

26 Po aty, f. 451.

27 Dr. Muhamet Shatri, vep. e cit., f. 103. 30 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 47-48. 31 Po aty, f. 47-48

rëdhëniet ndërmjet PKSH dhe PKJ morën një kthesë të re me ardhjen në Labinot të Svetozar Vukmanoviç-Tempos, i dërguari kryesori PKJ dhe i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Jugosllave për Maqedoninë. Diskutimet me Tempon e përqendruan vëmendjen në çështjen e Kosovës dhe të zonave kufitare të Maqedonisë, veçanërisht të Dibrës, ku popullsia ishte kryesisht shqiptare. Qysh nga viti 1942, Tempoja kishte pasur si detyrë të përpiquej të rriste rezistencën kundër italianëve dhe gjermanëve ndër maqedonasit dhe shqiptarët në Kosovë-Metohi, në Maqedoni dhe në zonat kufitare ndërmjet Maqedonisë jugosllave e Shqipërisë, Greqisë dhe Bullgarisë... Tempoja i jep vetes meritën se i ka dhënë udhëheqjes së PKSH shtysën për të formuar brigada e më pas divizione të rregullta. Nuk ka dyshim se Tempoja ka pasur ndikim, por me sa duket ai merrte shumë gjëra për vete. Vendimi për të ngritur një ushtri me brigada e më pas me divizione, tashmë, ishte marrë në Konferencën e I të Vëndit të PKSH, në mars 1943, para se të dilte në skenë Tempoja. Tempo kishte thënë se udhëheqja komuniste shqiptare po i zvarriste këmbët lidhur me mobilizimin dhe zhvillimin e luftës, sepse ishte tepër e zënë me përpjekjet për të arritur marrëveshje me Ballin Kombëtar. Sipas Tempos, kursi i drejtë do të ishte rruga jugosllave".<sup>28</sup> Natyrisht, duke preferuar rrugën jugosllave edhe për LANÇ të Shqipërisë dhe për vetë PKSH, Tempo donte të tërhiqte PKSH dhe Lëvizjen Nacionalçlirimtare Shqiptare pas qerres jugosllave. "Me siguri, ai nuk ishte i interesuar për asgjë që do të inkurajonte nacionalistët dhe aspiratat e tyre lidhur me Kosovën. Kjo u bë plotësisht e qartë gjatë vizitës së tij, në fillim të gushtit, ku ai luajti rol për hedhjen poshtë të marrëveshjes së Mukjes me Ballin Kombëtar nga LNC".<sup>29</sup>

Pikëpamjet, udhëzimet dhe vlerësime e Tempos kapnin

<sup>28</sup> Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 47-48.

<sup>29</sup> Po aty, f. 47-48

edhe çështjen e diferencimit të masave popullore, qëndrimin kundrejt Ballit Kombëtar, si dhe çështjen e marrjes së pushtetit. Edhe lidhur me këto çështje, Tempo kishte vlerësimenegative kundrejt vijës së PKS. Duke folur për çështjen e polarizimit dhe konfrontimit të forcave politike dhe të formacioneve ushtarake në luftë kundër okupatorit, Tempo ishte kritik dhe i pakompromis: “Pasoja e këtij mos aktiviteti tuaj janë esenciale: nuk është bërë polarizimi i forcave në ato që bëjnë luftë kundër okupatorit dhe në ato, të cilat ende qëndrojnë mënjane. Pa polarizim të ashpër nuk ka as fitore kundrejt forcave të rendit të vjetër... Ju, nga sa kam mundur të vlerësoj, ndodheni në fillim të këtij procesi”.<sup>30</sup> Edhe në rastet e tjera, Tempo kishte akuzuar udhëheqës të LANÇ të Shqipërisë, por ato cilësime, udhëheqja e komunistëve shqiptarë i kishte marrë si fyerje dhe “aspak komuniste”. Lidhur me këtë qëndrim të Tempos, Enver Hoxha, në një letër drejtuar udhëheqësve të KQ në Tiranë, më 4 tetor 1943, shkruante: “Kjo letër është shumë fyese për ne dhe Tempua shkruan në një mënyrë aspak komuniste, duke na akuzuar si sabotatorë, se ne nuk kemi çuar ushtritë tona të shuajmë reaksionin në Maqedoni dhe Tempua të vendosë pushtetin. Ai paturpshëm akuzon Haxhi Lleshin dhe shokët e tjerë se punojnë tamam si shovinistë serbë dhe shqiptarë”.<sup>31</sup>

Lidhur me takimin me Tempon dhe akuzat që ai i bënte LANÇ të Shqipërisë dhe jo vetëm Haxhi Lleshit, ky i fundit, në kujtime të tij midis të tjerash shkruante: “Tempoja vinte për herë të parë në Dibër të Madhe. Më thanë se kur kishte ardhur që shprehur: - Këtu, në Dibër, t’u krijuaka përshtypja se ndodhesh në Shqipëri dhe jo në territorin e Jugosllavisë -...”

Më duhet të them se prania e Tempos në zonat ku vepronin forcat tona na krijonte herë pas herë telashe dhe situata të

---

30 Svetozar V. Tempo, vep. e cit., f. 365-367.

31 Po aty, f. 457.

vështira".<sup>32</sup> Por, Tempon e pengonte gjithçka shqiptare. Prandaj, nuk kishte hezituar ta pyeste Haxhi Lleshin: "Në qytet pashë të valojë vetëm flamuri shqiptar. Mos edhe kjo vjen nga druajtja?".<sup>33</sup> Këto ishin arsytet që Tempoja të ndiheji pakënaqur me përparimin LANÇ të Shqipërisë. Për këtë arsye, sipas Haxhi Lleshit: "...duket se arsytet kryesore qenë mosnjohja e situatës dhe kryesorja, frika e Tempos nga ndjenjat patriotike të shqiptarëve të Maqedonisë. Kjo frikë që lidhej me synimet e PKJ për të ruajtur të pandryshuar kufirin e 1913-ës, bënte që Tempos të mos i pëlqente forcimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare Shqiptare".<sup>34</sup> Pavarësisht prej pretendimeve jugosllave për të përdorur Luftën Nacional çlirimtare të popullit shqiptar për gllabërimin e tokave shqiptare, të cilat ishin qëllimet e tyre historike, forcat kombëtare të popullit shqiptar, si në radhët e PKSH, të Ballit Kombëtar dhe të të gjitha forcave të tjera politiko-ushtarake, ishin të vendosura përbashkë pa kushte në luftë për çlirimin e vendit. Në këtë synim historik, i cili më vonë, gjatë vazhdimit të LANÇ në Shqipëri, do të pësonte deformime për ardhmërinë e kombit, Kuvendi mbarë kombëtar i Mukjes ishte sprovë me dimension kombëtar historik për realizimin e këtij qëllimi. "Platforma politike e Kuvendi të Mukjes buronte pikërisht nga Rezoluta e Konferencës së Parë Nacionalçlirimtare të mbajtur në Pezë, ku u konfirmua karakteri kombëtar dhe pluralist me strategjinë e luftës për Shqipërinë e lirë, të pandashme, të pavarur dhe demokratike".<sup>35</sup> Synimi ishte të realizohej një front i madh demokratik. Për këtë vijë politike të Konferencës së Pezës, e cila do të rikonfirmohej në Kuvendin e Mukjes, dëshmonin edhe kujtimet e dr. Ymer Dishnicës, pjesëmarrës në Konferencën e Pezës dhe Kuvendin e Mukjes: "Kam ndenjur në

32 Haxhi Lleshi, Vite, njerëz, ngjarje, Tiranë, 1996, f. 216.

33 Haxhi Lleshi, po aty, f. 218

34 Po aty, f. 221.

35 Klement Shalari, (Mos)Marrëveshja e Mukjes kullon ende gjak, Tiranë, 1996, f. 10.

Pezë. Direktiva ishte të realizohej një front i madh demokratik për të luftuar, jo vetëm me penë, por edhe me pushkë. Kishim organizuar njësitë guerile, kish filluar lufta. Në Pezë erdhën njerëz nga Durrësi, Shkodra e Dibra, nacionalistë oficerë madhorë: Bazi i Canës, Mustafa Gjinishi, etj., gjithsej 28 vetë. Një e katërta ishim komunistë, të tjerë patriotë pa parti, anëtarë të Kongresit të Lushnjës etj. Platforma ishte shumë e bukur dhe shumë e thjeshtë: do të luftojmë me të gjitha forcat për të goditur Italinë fashiste, që nga njësitë e thjeshtë gueril dhe lufta me çeta”.<sup>36</sup> Marrëveshja dhe mosmarrëveshja e Mukjes, në të cilën ndodhi ndërhyrja më flagrante e misionarëve jugosllavë, në historinë kombëtare mbetet si shansi madhi bashkimit të forcave politike shqiptare, porë dhe si fatalitet me dimension kombëtar. Edhe sot mbeten për studim çështje që kanë të bëjnë me platformën politike të Kuvendit të Mukjes dhe, mbi të gjitha, mbetet për t’u dhënë përgjigje në pyetjen: Në ç’masë misionarët jugosllavë arritën që raportet kombëtare brenda politikës shqiptare t’i ngatërronin me raportet ideologjike dhe prishjen e Marrëveshjes së Mukjes ta impononin pikërisht për hesapet e veta, konkretisht për ta lënë Kosovën dhe LNC në Kosovë nën sundimin e PKJ dhe të Serbisë? Dhe, me këtë rast, nuk duhen harruar as synimet dhe qëndrimet e misionarëve jugosllavë në Shqipëri: “Partisë Komuniste Jugosllave i interesonte një kundërvënie pa kompromis midis dy forcave politike, që Balli Kombëtar të hidhej artificialisht në krahun e pushtuesit, që në LANÇ të sundonte vetëm PKS e dirigjuar nga PKJ, sepse kështu, sipas planeve serbomëdha, në Shqipëri mund të vendosej përfundimisht sundimi i tyre, sepse kështu, jo vetëm Kosovën, por edhe tërë Shqipërinë do të mund ta përfshinin në projektet e tyre ogurzeza antishqiptare për ta bërë atë republikën e shtatë të Jugosllavisë Federative”.<sup>37</sup>

---

36 Alternativa, Tiranë, 23.3.1992, f. 7. (krahaso [cfr.]): Uran Butka, Mukja, shans i bashkimit, peng i tradhëtisë, Tiranë, 2007.

37 Klement Shalari, vep. e cit., f. 6.

Historiografia e sotme shqiptare, me të drejtë e ka shtruar pyetjen: Si do të ishte fati i Marrëveshjes së Mukjes sikur të mos kishte ndodhur aq shpejtë në mënyrë ultimative intervenimi politik i emisarëve jugosllavë dhe sikur të mos e kishin kontestuar dhe kundërshtuar kategorikisht Marrëveshjen e 1 dhe 2 gushtit midis forcave politike mbarëshqiptare? Pikërisht, nga momenti i ndërhyrjes aq të hapur, tinëzare dhe qëllimkeqe të jugosllavëve nisi një situatë krejtësisht re dhe përfundimisht fatale për perspektivat e realizimit të kësaj marrëveshjeje. Në fakt, emisarët jugosllavë, sapo kuptuan vendimet e Konferencës së Mukjes, u ngutën që ta kundërshtonin dhe shumë shpejt i detyruan edhe udhëheqësitë PKSH që, falë servilizmit të tyre ndaj emisarëve jugosllavë dhe përgjithësisht ndaj urdhrave që vinin nga PKJ e nga Tito, të kundërshtonin marrëveshjen e arritur. Fragmentet e caktuara të kundërshtimeve të rrepta të Marrëveshjes së Mukjes, nga ana e Enver Hoxhës me bashkëpunëtorë janë aq të prera, intolerante e me paragjykime, sa që mund të shtrohet pyetja: A ishte, pikërisht, ai me bashkëpunëtorë që kishin dhënë pajtimin paraprak që përfaqësuesit e tyre, Ymer Dishnica e Mustafa Gjinishi, t'i mbronin qëndrimet e deklaruara politike të PKSH në bisedimet e Mukjes? Pas intervenimit të emisarëve jugosllavë dhe nënshtrimit të Enver Hoxhës direktivave të PKJ, marrëveshja, përkatësisht mosmarrëveshja e Mukjes, ishte prishur në mënyrë të njëanshme. Nga dokumentet del qartë se, rolin vendimtar në prishjen e Marrëveshjes e pati PKJ. “Ajo nuk mund të lejonte që PKSH, të cilën konsideronte se e kishte krijuar vetë, të bënte pazarllëk me nacionalizmin shqiptar të tipit irredentist. Ky përfundim shprehej edhe nga parashtrimi që i bënte Vladimir Dedijer Marrëveshjes së Mukjes, të cilën e paraqiste si shembull të devijimit shqiptaromadh”.<sup>38</sup>

Mbështetur në ndërhyrje të emisarëve jugosllavë në ngjar-

38 Dr. Muhamet Shatri, vep. e cit., f. 106-107.

jet gjatë LANÇ të Shqipërisë dhe në zhvillimet e brendshme të PKSH, qoftë në krijimin e politikës së përgjithshme të PKSH, qoftë në praninë e tyre madje edhe në nivele të udhëheqjes së PKSH, që nuk mbeti pa pasoja për rrjedhat e përgjithshme në Shqipëri dhe në viset e tjera ku banojnë shqiptarët, vështirë se mund të flitet për një veprim dhe orientim krejtësisht të pavarur të PKSH. Ndërhyrjet e PKJ ndaj PKSH dhe LANÇ në Shqipëri patën reflektime, si në marrëdhëniet e brendshmenë PKSH, ashtu edhe në jetën e përgjithshme shoqërore e politikenë Shqipëri. Pretendime te emisarëve jugosllavë nuk mbetën vetëm në sferën e ndërhyrjes së papranueshme në punët e brendshme të PKSH. Ata, duke u trimëruar me ndërhyrjet e vazhdueshme dhe të papenguara nga vetë kreu i udhëheqjes së PKSH, arritën ta nënshtronin në të gjitha planet PKSH dhe udhëheqjen e LANÇ në Shqipëri. “PKJ, pra, është direkt e implikuar e edhe shkaktari kryesor i dy përçarjeve më të mëdha politike në Shqipëri gjatë viteve të Luftës së Dytë, me ndikim në zhvillimin politik, jo vetëm të këtyre viteve, por edhe të viteve të pas luftës, në përçarjen e madhe në vetë PK të Shqipërisë”.<sup>39</sup>

Plenumi i 2-të i PKSH, i mbajtur në Berat më 23-27 nëntor 1944, në historikun e PKSH cilësohet si një njollë e zezë dhe si një përpjekje e emisarëve jugosllavë për nënshtrim të plotë të udhëheqjes së PKSH, me në krye Enver Hoxhën. Angazhimi i emisarëve jugosllavë për nënshtrim të udhëheqjes së PKSH dhe për marrjen definitive të çështjeve të brendshme shqiptare në duar të veta, pra nën komandën e PKJ dhe të Titos, duhet analizuar në prizmin e synimeve hegjemoniste të udhëheqjes së PKJ, në konstelacionin e raporteve të gjithëmbarshme politike, ushtarake e gjeostrategjike në rajon. Koha e ardhjes së Misionit ushtarak dhe politik jugosllav, me në krye Velimir Stojniçin, në gjysmën e dytë të vitit 1944, ishte kohë kur shihej përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe në

39 Fehmi Agani, Demokracia, kombi, vetvendosja, Pejë, 1994, f. 53.

Jugosllavi e Shqipëri shiheshin edhe fituesit. Pretendime të udhëheqjes jugosllave për dominim në një zonë edhe më të gjerë sesa ishte Jugosllavia, të shprehura enkas në fjalën e Stojniçit, në Plenumin e Beratit, në pohimine tij se Titoja është personalitet jo vetëm i Ballkanit, por edhe i Evropës Juglindore, manifestoheshin më qartë dhe me më shumë agresivitet. Shqipëria ishte një ndër zonat e para të këtyre pretendimeve. “Që të arrihej dominimi mbi Shqipërinë, duhej të nënshtrohej plotësisht PK e Shqipërisë”.<sup>40</sup>

Goditja dhe nënshttrimi i PKSH, në radhë të parë, i udhëheqjes së saj me në krye Enver Hoxhën, ishte qëllim prioritar. Goditja dhe kritika që i bëhej vijës së deri atëhershme të PKSH nënkuptonte kritikë të udhëheqjes dhe të politikës së Enver Hoxhës. PKSH dhe personalisht Enver Hoxha kritikoheshin nga Titoja dhe nga PKJ për politikë të gabuar, oportuniste, të paqëndrueshme e sektare. Stojniç dhe Dizdareviç kishin ardhur që, nëpërmjet kritikës së pamëshirshme drejtuar vijës së PKSH dhe politikës së udhëheqësit të saj, të zhvleftësonin çdo të arritur të PKSH në mobilizimine masave shqiptare për pjesëmarrjenë LANÇ të Shqipërisë. Kritika synonte të siguronte pa pengesë imponimin e modelit jugosllav, si të vetmen alternativë të Luftës Nacionalçlirimtare edhe në hapësirën mbarëshqiptare. “PKSH dhe Hoxha akuzoheshin se kishin qenë tepër “oportunistë” përçështjet që lidheshin me Jugosllavinë (Kosovën, Dibrën, nacionalizmin shqiptar, përgjithësisht) dhe disa operacione ushtarake, të cilat do t’i kishin ndihmuar partizanët jugosllavë në kurrriztë shqiptarëve dhe se kishin qenë tepër “sektarë” në trajtimin e opozitës brenda Shqipërisë... Natyrisht, pikësynimi i vërtetë i kritikave të Stojniçit ishte Enver Hoxha. Duhej që Hoxha të qethej sa t’i zvogëloheshin përmasat, kështu që Shqipëria të bëhej një pasuese e bindur e Jugosllavisë”.<sup>41</sup>

40 Fehmi Agani, vep. e cit., f. 66.

41 Reginald Hibbert, vep. e cit., f. 332.



Për të krijuar rrethana, në të cilat më lehtë do të rrëzohej vija e Enver Hoxhës dhe me të edhe ai vetë, sipas Stojniçit, më parë duhej realizuar largimi i mbrojtësve të Enver Hoxhës nga udhëheqja politike. Prandaj, "...kurkuarteri u zhvendos nga Odriçani në Berat, në mes të tetorit, Koçi Xoxe dhe Nako Spiro sajuan që ta largonin nga Byroja Politike Ramadan Çitakun (i cili mbështeste Hoxhën) dhe Liri Gegën dhe t'i zëvendësonin me Sejfulla Malëshovën dhe Pandi Kriston... Enver Hoxha e pa veten me katër anëtarë në Byronë Politike, që ishin të kënaqur t'i nënshtroheshin influencës së Stojniçit".<sup>42</sup> Enver Hoxha shpjegonte se, pikërisht, Sejfulla Malëshova, Nako Spirue Koçi Xoxe ishin realizatorët kryesorë të të gjitha veprimeve që ndodhën brenda PKSHP në prag të mbajtjes së Plenumit të 2-të të KQ të PKSHP dhe personalitetet kryesore në qërimin e hesapeve brenda radhëve të udhëheqjes së PKSHP, gjatë dhe pas Plenumit të Beratit. Në përgatitje të Plenumit të 2-të të KQ të PKSHP, derisa zhvillohej prapaskena e Beratit dhe me përkrahjen e Malëshovës, Xoxes, Spirut e të tjerëve, Stojniçi ia arriti të krijonte situatë dhe rrethana në favor të pretendimeve jugosllave. Sipas Enver Hoxhës, pikëpamje këto, të cilat pas hapjes së arkivave perëndimore dhe atyre shqiptare, në lidhje me Plenumine Beratit, janë mjaft të diskutueshme: "...çdo gjë që bënte ose thoshte 'Veloja' ishte e drejtë, pse këtë e thoshte Titoja, e thoshte PKJ dhe kush e kundërshtonte ishte armik dhe duhej luftuar. Për arsye e motive nga më të ndryshmet, qysh në këtë fazë të parë të veprimtarisë së tij agjenturiste, Stojniçi arriti të bënte për vete një numër shokësh kryesorë të udhëheqjes sonë".<sup>43</sup>

Stojniçi ishte i vendosur, prandaj, para fillimit të Plenumit të 2-të të KQ të PKSHP, i paralajmëronte Enver Hoxhës masa ndëshkuese nëse, eventualisht, nuk përmirësohej dhe nuk e ndërronte rrugën e deri atëhershme. Kjo ishte një ndërhyrje

42 Po aty, f. 333-334.

43 Enver Hoxha, Titistët, f. 144.

tepër e padenjë e një përfaqësuesi të një partie tjetër të jasht-komuniste ndaj PKSHE dhe udhëheqësit të saj. Nga ana tjetër, vështirë të gjendet ndonjë rast më karakteristik i një nënshtrimitë pashembullt dhe jodinjitoz të një partie komuniste nga një parti tjetër. Kjo përulje, ky nënshtrim, mbeten të pakuptim të dhe me pasoja të rënda, pavarësisht historikut të ndërhyrjeve të vazhdueshme të Jugosllavisë në çështjet e brendshmetë shtetit shqiptar. Është e qartëse format e ndërhyrjes së PKJ ndaj PKSHE dhe çështjes shqiptare manifestonin edhe pasionin e pashtershëm të politikës jugosllave për dominim dhe për ndërhyrje në raport me faktorin mbarëshqiptar. Në këtë kontekst, Fehmi Agani shtronte pyetjen: “Por, pse pranuan marrëdhënie të këtilla, pse u nënshtruan komunistët shqiptarë? Shqipëria ishte e vogël, e pazhvilluar, momente të shumta hendikeponin pozitën e saj. Por, në fund të vitit 1944 e më 1945, komunistët shqiptarë ishin fitimtarë të një lufte të madhe nacionalçlirimtare, s’kishin pse të ndiheshin inferiorë ndaj askujt, pra as ndaj jugosllavëve. Megjithatë, qëndrimi i tyre ishte kapitulant”.<sup>44</sup>

Pas Plenumit të 2-të të KQ të PKSHE, lufta për pushtet ishte bërë edhe më e rreptë dhe më e pakompromis. Thellimi i vijës terroriste të PKSHE, vartësia dhe nënshtrimi i plotë i udhëheqjes komuniste nga PKJ, projektimi dhe realizimi i shumë vrasjeve të panumërta, jo vetëm të nacionalistëve, kundërshtarëve politikë, por edhe të shokëve të tyre, në prag të çlirimit të Shqipërisë, shënuan hapat e parë në jetën shtetërore politike të Shqipërisë drejt totalitarizmit lindor.<sup>45</sup> Nuk është e rastësishme pse PKSHE, pas Plenumit të Beratit, edhe më pamëshirshëm goditi nacionalizmin shqiptar, i cili angazhohej për një Shqipëri të bashkuar e demokratike. Nacionalistë të shquar, si brenda Frontit Nacional çlirimtar, ashtu edhe nacionalistët demokratë, të cilët vepronin në Bal-

44 Fehmi Agani, vep. e cit., f. 75.

45 Uran Butka, Ringjallja, Tiranë, 1995, f. 37.

lin Kombëtar dhe Legalitet, u ndoqën, u vranë, u burgosën, u internuan dhe shumë të tjerë u detyruan të lëshonin atdheun. Nacionalistët shqiptarë, të cilët ishin me orientim properëndimor, u trajtuan si “armiç” nga ana e PKS, të cilët me çdo kusht duheshin izoluar politikisht e ndonjëri prej tyre edhe duhej zhdukur. E tërë kjo veprimtari bëhej që të triumfoje komunizmi shqiptari orientimit sllavo-komunist, platformën e të cilit e kishin krijuar PKJ dhe PKS. Qëndrimi i tillë i PKS ndaj intelektualëve atdhetarë, ndaj pjesës më avangarde, demokratike e properëndimore të kombit, shënonte thellimin e frymës terroriste. Është mëse e kuptueshme përse emisarë të PKJ futën në Shqipëri frymëterroriste në udhëheqjen PKS dhe në udhëheqjen Luftës Nacionalçlirimtare.<sup>46</sup> Kështu veprime edhe për eliminimin e kundërshtarëve politikë, të cilët, si nga radhët e PKS, ashtu edhe nga radhët e forcave të tjera politike, kundërshtonin vijën terroriste dhe angazhoheshin për një vijë liberale e demokratike të ndërtimit të shoqërisë shqiptare.

Në Plenumin e 2-të të KQ të PKS, një prej çështjeve kryesore ishte: “Në ç’ rrugë do të ecte Shqipëria pas luftës?” Sipas planit të Stojniçit dihej se, Enver Hoxha duhej të angazhohej më së tepërmi për orientimin projugosllav, që Shqipërinë ta ofronte, jo vetëm ideologjikisht, por edhe sa më ngushtë me Jugosllavinë. Bazën e këtij orientimi e kishte paralajmëruar Enver Hoxha, i cili, në punimet e këtij plenumi, ishte shprehur për “ndihmën e pakursyere të çmueshme, për eksperimentin e madhe” që PKJ i kishte dhënë PKS. Sipas Enver Hoxhës, PKJ i ofronte perspektiva të reja PKS. “Populli ynë e di sa e shtrenjtë e jetike është për popullin tonë aleanca dhe vëllazërimi me Jugosllavinë. A mund të rrojë i lirë dhe të ndërtojë jetën e tij populli ynë pa Jugosllavinë Federative Popullore. Jo, kjo është e pamundur”.<sup>47</sup> Ky besimi verbër ide-

---

46 Po aty, f.46.

47 Po aty, f.530.

ologjik, mbi bazat e internacionalizmit proletar, do ta mbante Enver Hoxhën symbyllazi në orientimin projugosllav deri në prishjen definitive me Titon, në vitin 1948, ndërsa çështjen e Kosovës do ta linte në harresë. Orientimi i politikës shqiptare të viteve të pasluftës për bashkim me Jugosllavinë është një prej rrjedhëve më fatkeqe që buroi nga vendimet e Plenumit të 2-të të KQ të PKSH. Ky orientim kaq i skajshëm, jo vetëm ideologjik, por edhe i dëmshëm në aspektin kombëtar, pati pasoja të rënda në planin e mos njohjes së qeverisë shqiptare nga ana e Fuqive të Mëdha. Qysh më 4 janar 1945, qeveria e përkohshme e Enver Hoxhës u ishte drejtuar për njohje qeverive të SHBA, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik. Kundërshtimet, sidomos amerikane dhe ato britanike, qenë recidive, ndonëse jo edhe aq të drejta. Ministri britanik i Punëve të Jashtme, Eden, në lidhje me pranimin e qeverisë së Hoxhës, më 14 mars 1945, deklaroi se kjo çështje nuk do të vinte në konsideratë, meqenëse çështja e Shqipërisë ishte e pazgjidhur. Sekretari amerikan i Shtetit, Stetinius, nëpërmjet shtypit lajmëroi se do të dërgonte në Shqipëri përfaqësuesin-diplomatik, i cili do të shqyrtonte situatën.<sup>48</sup>

---

48 Bernard Tönnies, *Sonderfall Albanien*, vep e cit., f. 481.

## Kapitulli i dytë

### VITETE PASLUFTËS DHE DIPLOMACIA E FSHEHTË

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore shënoi fundin e një prej kapitujve më të errët të historisë së re të kontinentit. Më 7 maj 1945, në Reims, u nënshkrua akti i dorëzimit të Gjermanisë nga feldmarshali Jodl, në emër të Vehrmasit, dhe nga gjeneral-lejtnant Bedell Smith, në emër të forcave amerikane e britanike. Ky akt, simbolikisht, paralajmëroi një agim të ri në kontinentin e shkatërruar të dërrmuar tmerrësisht nga humbjet e luftës më të gjatë dhe më shkatërrimtare në historinë moderne. Megjithatë, shpresat e miliona njerëzve të dalë nga lufta e madhe, shumë shpejt, filluan të zbehen për shkak se mosmarrëveshjet dhe divergjencat në radhët e aleatëve fitimtarë të luftës e kishin vënë para sfidave të reja aleancën e kohës së luftës. Në fakt, grindja midis aleatëve kishte filluar qysh në mbarim të luftës. Lufta përfundoi me një vakuum gjeopolitik. "Ekuilibri i forcës ishte prishur dhe një trakt i gjithanshëm paqeje mbeti i papërcaktuar. Tani bota ishte ndarë në dy kampe ideologjike. Periudha e pasluftës do të kthehej në një luftë të zgjaturë të dhimbshme...".<sup>49</sup> Ndarja e botës pasluftës nuk kishte filluar në Jaltë, sepse edhe gjatë luftës kishte pasur fërkime të ndryshme midis Moskës dhe aleatëve Perëndimorë. Realisht, në Konferencën e Jaltë spri-

---

49 Henri Kissinger, *Diplomacia*, Tiranë 1999, f. 422.

oritete te Bashkimit Sovjetik dhe ato të SHBA e të Britanisë së Madhe, të cilat ishin shtruar për bisedime të fshehta, ishin të ndryshme.<sup>50</sup> Aleanca e luftës po dobësohej deri në prishje. Kjo edhe për faktin se, kjo aleancë, e cila ishte mbajtur kryesisht për shkak të rrezikut të përbashkët nga fashizmi, pas përfundimit të luftës, ishte bërë jo e preferueshme dhe jo me interese rëndësi të njëjtë për të gjitha palët. Ndërkohë edhe qëllimet e aleatëve, në muajt dhe vitet e para të pasluftës, ishin në masë të caktuar kontradiktore. Sferat e interesit, si instrumenti ruajtjes së ekuilibrit të brishtë në marrëdhënie te atëhershme ndërkombëtare, kishin zënë rrënjë qysh në vitete fundit të Luftës së Dytë Botërore. Burrështetas të shteteve të boshtit antifashist kishin pranuar hapur se kishin bërë marrëveshje dhe ruanin dokumente ndërkombëtare lidhur me sferat e interesit. Në botimin e vitit 1963 të Enciklopedisë Britanike shkruhej: “Pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik krijoi sferën e interesit, si fakt politik, në territoret e vendeve në Evropën Lindore dhe në Ballkan, përveç në Greqi. Ndarjes politike të Ballkanit, në sferat e ndikimit dhe në kuptimin politik, iu vunë themelet me marrëveshje të arritura në mes Anglisë dhe Bashkimit Sovjetik, në vitin 1944...”.<sup>51</sup> Marrëveshje për ndarjen e sferave të interesit janë bërë edhe midis Rozveltit, Stalinit dhe Çerçillit. Gjatë bisedimeve rreth ndarjes të sferave të interesit, Stalini vazhdimisht kishte këmbëngulur në argumentet se në kufijtë perëndimorë të Bashkimit Sovjetik duhet të kishte shtetemike, në mënyrë që të evitohet ndonjë agresion ndaj shtetit sovjetik. Përmes këtyre bisedimeve dhe kërkesave ultimative, Stalini kishte arritur që të zgjeronte dukshëm ndikimin rus në Evropën Lindore dhe në një pjesë të Ballkanit. Moska zyrtare, në vitet e para të pasluftës, vite këto që paralajmëruan stuhi të reja, e shtroi influencën e saj politike dhe ushtarake në ato

---

50 Gabriel Partos, Bota që erdhi prej të ftohtit, Tiranë 1994, f. 15.

51 Enciklopedia Britanica, vëll. 21, f. 210-211.

shtete, kryesisht në bazë të marrëveshjeve për ndarjen e sferave të interesit, të cilat diplomatikisht interpretoheshin si aspekte të internacionalizimit. Derisa: “Çërçilli kërkonte të parandalonte sundimin e Evropës Lindore nga Bashkimi Sovjetik, Stalini donte të shpërblehejme monedhë territoriale për fitoren ushtarake sovjetike...”.<sup>52</sup> Sfera e influencës në Evropën Juglindore ishte një prej pikave kyçe të bisedimeve dhe interesime vetë Stalinit. Në fakt, Stalini ishte i interesuar që të restauronte atë që ai e quante kufi të vjetër të perandorisë cariste dhe që në marrëveshjet e fshehta, të vitit 1939, ia kishte marrë Hitlerit. “Objektivi i Stalinit ishte vënia e Evropës Lindore nën kontrollin sovjetik. Për Perëndimin hëpërhë nuk ishte e qartë nëse Stalini ishte i vendosur të impononte edhe në këtë rajon regjime komuniste apo do të pranonte shtete relativisht të pavarura, por me qeveri mike kundrejt Bashkimit Sovjetik. Stalini ishte agresiv dhe imperialist ndaj Evropës Lindore”.<sup>53</sup> Mirëpo, dokumentet historike të diplomacisë së kësaj periudhe të krijojnë përshtypjen se, në atë fazë të viteve të para të pasluftës, Perëndimi nuk kishte bërë më përpjekje që t’i përgjigjej energjikisht dhe vendosmërisht influencës sovjetike në Evropën Lindore në atë masë dhe në atë mënyrë siç u ishte imponuar sistemi sovjetik shteteve të rajonit. Në këtë kontekst duhet parë edhe rënia e Shqipërisë në zonën e influencës sovjetike, edhe pse, madje edhe ndër historianët bashkëkohorë ka pasur mendime se Shqipëria kishte mbetur nën influencën jugosllave. Në të vërtetë, sovjetikët, përmes jugosllavëve, kishin siguruar dominimin e influencës së tyre në Shqipëri dhe kjo mund të kuptohej edhe nga vetë reagimi i rreptëdhe dramatik i Stalinit në çastin kur kishte kuptuar se Tito vërtetë synonte ta gëlltiste Shqipërinë në variantin e politikës hegjemoniste. Ndërsa, demokracia e modelit perëndimor, në muajte parë

---

52 Shih: Henri Kissinger, vep. e cit., f. 424

53 Gabriel Partos, vep. e cit., f. 20.

së pasluftës, nënkuptonte vendosjen e kapitalizmit. Kjo gjë ishte e papranueshme për Stalinin, i cili sipas doktrinës së tij ideologjike, kapitalizmin e barazonte dhe e identifikonte me fashizmin dhe nga të dy ndjente rrezik të barabartë e të njëjtë për shtetin sovjetik dhe ambiciet pansllaviste. Në këtë kohë, Stalini, si komunist besonte që komunizmi doemos do t'ia zinte vendin kapitalizmit dhe në këtë drejtim çdo bashkekzistencë e të dy sistemeve nuk mund të ishte e përherëshme. Në këtë kohë, qëndrimi i Stalinit ishte sa mbrojtës po aq edhe agresiv nga frika e hegjemonisë së SHBA, pasuria dhe fuqia e të cilave dukej sheshazi që u rrit tejmasë. Nga ana tjetër, kur politika e konfrontimit midis Uashingtonit dhe Moskës po bëhej gjithnjë e më transparente, edhe SHBA ishin të shqetësuara nga rreziku i një epërsie ndërkombëtare sovjetike.<sup>54</sup> Në këtë periudhë, pra, në vitet 1945, 1946, 1947, SHBA ishin në gjendjet' u ofronin evropianëve planet e tyre politiko-ekonomike dhe ishin mjaft të fuqishme për të dominuar në rrafshin ndërkombëtar. Duhet pasur parasysh se treguesit relevantë, sidomos ekonomikë dhe ushtarakë, në vitete para të pasluftës, flisnin se ato vite do të ishin në një kuptim të gjerë epokë e sundimit të amerikanëve, natyrisht, nëse SHBA nuk do të respektonin deklarinimin e mëhershëm, menjëherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, të tërheqjes së tyre në politikën izolacioniste (e izolimit). Shihej qartë se, SHBA dolën nga Lufta e Dytë Botërore si shteti më i fuqishëm në të gjitha drejtimet, ndërkohë që Anglia dhe Franca dolën krejtësisht të shkatërruara. Fakti që, për SHBA më nuk kishte kufi ushtarakë dhe politikë, kjo u pa qartë në verën e vitit 1945, kur SHBA zotëronin bombën atomike. Kërcënimin me bombë atomike, Stalini e neutralizoi përmes iniciativës së menjëhershme që edhe ekspertët sovjetikë të fillonin punën në prodhimin e bombës bërthamore, gjë e cila

---

54 Shih: Eric Hobsbawm, Epoka e ekstremeve, I rrëmbyeri shekull i njëzetë 1914-1991.



rezultoime sukses. Nga ana tjetër, ideja e Stalinit në atë kohë ishte që në Evropën Juglindore të kishte sundimtarë të sigurt. Politika e aleancës kundër Bashkimit Sovjeti kishte përpunuar dhe ekzekutohej nga politika e jashtme amerikane. Mirëpo, objektivisht, në rrethana të tilla nuk kishte rrezik real për luftë botërore. Bisedimet midis Uashingtonit, Londrës dhe Moskës për të ardhmen e botës, e në veçanti të Evropës Qendrore dhe Ballkanit, nuk ishin të lehta. Ato përshtokoheshin me një diplomaci të ashpër, me shumë sfida dhe fshehtësi, jo vetëm diplomatike. Njëkohësisht, kjo ishte periudha kur ende preferohej për zbatim politika e deklaruar nga SHBA se, ajo do të tërhiqej vullnetarisht nga Evropa pas mbarimit të luftës. Ndërkohë që Bashkimi Sovjetik kishte shtyrë kufirin e tij shtetëror 600 kilometra në perëndim, derinë Elbë, nga ana tjetër pritej të vihej në zbatim tërheqja e parashikuar e forcave amerikane. Në këtë periudhë, pra, në fillim të mbarimit të luftës dhe paralajmërimit të paqes së brishtë, Rozvelti, i cili sipas historianëve amerikanë nuk shquhej për sens dhe intuitë të veçantë diplomatikë politike jashtme, ende shpresonte se bashkëpunimime Rusinë do të vazhdonte edhe pas luftës. Ai influencohej nga një ndjenjë jorealiste se Stalini do të bashkëpunonte pa hile me të. Në opinionin e atëhershëm amerikan dhe në vetë qarqet më të larta të diplomacisë amerikane mbizotëronte bindja se Rusia e pas luftës do të ishte një aleate e natyrshme e SHBA për të formësuar një imazh të ri, paqësor dhe vëllazëror midis popujve të botës. Ndaj nuk ishte e rastësishme që në opinionin publik amerikan, në fund të luftës dhe fillimin e paqes së luhatur, kritikant ndaj Rusisë dhe regjimit të Stalinit nuk priteshin me simpati, përkundrazi.<sup>55</sup> Nuk ishte e rastit pse Rozvelti, në tërë etapat e bashkëpunimit me Stalinin, përkundër Çërçillit, nuk kishte ndonjë emocion mosbesim-indaj Stalinit. Në pikëpamjet e tij politike, Rozvelti shkante

55 Shih: Walter Laqueur, Evropa në kohën tonë, Tiranë, 1996, f. 90.

aq larg sa që mbronte qëndrimin se Stalini nuk kishte aspirata hegjemoniste, por kishte dyshime dhe mosbesim ndaj politikës britanike, ideolog i së cilës ishte Uinston Çërçilli. Ky lloj i mosbesimit politik ndaj aleatit të deridjeshëm të luftës shkonte aq larg, saqë kryetari amerikan në konceptet-politike të Çërçillit përpiquej të gjente konceptet e vjetra dhe reaksionare të interesave të mëhershme tradicionale të britanikëve. Ç'është e vërteta, pa mbështetjen dhe përkrahjen pa rezerva të amerikanëve, britanikët nuk mund të rezistonin gjatë dhe me sukses ndaj pretendimeve të reja territoriale dhe hegjemoniste të Bashkimit Sovjetik për pjesët e Evropës Lindore, më vonë edhe në Ballkan. Çërçilli, i cili ishte dëshmuar si strateg lufte dhe me përvojë edhe në fushën e diplomacisë, në ditët e para të pasluftës, kishte dëshmuar instinkt të veçantë në të kuptuarit me kohë të rrezikut të avancimit të Ruisë në Evropë, për ç'ka politika amerikane dhe e majta evropiane, në ato kthesa të historisë së pasluftës, ishin gati të përgjumura.<sup>56</sup> Për njohësit e mirë të rrethanave të atëhershme politike ishte e qartë se problemi po shtrohej në atë se sa do të shtrihej ekspansioni i Bashkimit Sovjetik dhe me sa lehtësi do të realizohej procesi i përpirjes së fqinjëve të tij të afërt. Stalini, qysh nga dita e parë e përfundimit të Luftës ë Dytë Botërore, në mënyrë transparente po dëshmonte një animozitet dhe mosbesim të madh ndaj udhëheqësve perëndimorë, pavarësisht nga dëshmimi i ndjenjës së simpatisë dhe të miqësisë nga ana e Rozveltit dhe Çërçillit. Ky qëndrim arrogant i Stalinit, në fakt, paralajmëronte seleanca e luftësdo të prishej brenda pak muajsh. Nuk do të kalonin shumë muaj të historisë së pasluftës dhe Konferenca e Postdamit dhe e Jaltës do të viheshin në thumb të kritikës. Në veçanti, sulme të rrepta do të drejtoheshin kundër Rozveltit. Akuza ishte e gatshme: "Udhëheqësve perëndimorë ua kishte hedhur Moska, se nuk kishin qenë në gjendje të

---

<sup>56</sup> Po aty, f. 90-91.

parashikonin se pas luftës Moska do të kthehej kundër Perëndimit”.<sup>57</sup> Mirëpo, duhet pasur parasysh se, në atë kohë, përderisa nuk u dha informacion i plotë për vendimet e konferencave të sipërpërmendura, në Perëndim ishin të paktë ata që politikën e Stalinite shikonin me dyshim dhe vështrim kritik. Madje edhe vetë Çerçilli, në fjalimin e tij mbajtur në Jaltë më 4-11 shkurt 1945, kishte deklaruar: “Ne e konsiderojmë jetën e marshallit Stalinsi shumë të çmuar për shpresat dhe gjithë zemrat tona”. Disa javë më vonë, në një fjalim të mbajtur në Dhomën e Komuna vetë parlamentit britanik, lideri i atëhershëm britanik kishte thënë: “Unë nuk njoh qeveri tjetër që u përmbahet më mirë detyrimeve të saj sesa qeveria sovjetike”.<sup>58</sup> Çerçilli i shihte bisedimet si një mënyrë për të lidhur forcën me diplomacinë. Ndonëse asnjëherë nuk ishte konkret në deklaratat e tij publike, ai shtronte me forcë se kishte parasysh një lloj ultimatumi diplomatik të demokracive perëndimore. Çerçilli donte të ngushtonte zonën e influencës sovjetike, por ishte i gatshëm të bashkëjetonte me pushtetin sovjetik brenda kufijve të reduktuar. Përkundrazi, udhëheqësit amerikanë nuk donin t’i ngushtonin, por t’i shkatërronin sferat e kundërshtarit të tyre. Ata parapëlqenin të prisnin përmbysjen e komunizmit sado larg të ishte, të siguronin një zgjedhje uillsoniane të problemittërenditbotëror.<sup>59</sup> Harry Truman, i cili zëvendësoi Rozveltin në postin e presidentit të SHBA, kishte një instinkt më të zhvilluar në të kuptuarit e hileve diplomatike të Stalinit, prandaj, qysh në kontaktet e para me diplomatët sovjetikë ishte më realist sesa paraardhësi i tij.

Truman, i pakënaqur nga takimi i parë i tij me ministrin e jashtëm sovjetik, Molotovin, me shqetësim ishte shprehur: “Ne duhet të jemi të ashpër me rusët, ata nuk dinë të sillen,

---

57 Po aty, f. 95

58 Po aty, f. 93.

59 Shih: H. Kissinger, Diplomacia... f. 467.

ata janë si arinj dhe ne duhet t'u mësojmë atyre si të sillen".<sup>60</sup> Padyshim, ky ishte një vlerësim publik mjaft karakteristik për politikën e atëhershme amerikane, i cili, në fakt, zbulonte ndeshjen me realitetin dhe paralajmëronte stuhi të reja në raportet diplomatike midis Uashingtonit dhe Moskës. Tensionet politike midis SHBA dhe Bashkimit Sovjetik kishin filluar të bëheshin realitet. Këto tensione nuk ishin shkaktuar nga ndonjë keqkuptim për ndonjë çështje konkrete politike, por reflektonin brendinë e kundërshtimeve dhe të mospajtimeve esenciale, e në radhë të parë, rreth sferave të interesit dhe kufijve, të cilat ishin përcaktuar në rrafshine interesave gjeo-strategjike. Politikanët perëndimorë nuk e merrnin shumë seriozisht faktin se Bashkimi i atëhershëm Sovjetik nuk ishte vetëm një shtet i madh, por kishte edhe një ideologji dhe sistem tjetër shoqëror që ndryshonin në thelb nga ato të Perëndimit. Ndryshonin fundamentalisht edhe sistemet e vlerave. Bashkimi Sovjetik kishte ndërmarrë iniciativa të mëdha diplomatiko-ideologjike për sovjetizimin e shteteve të vogla që i kishte nën influencë, duke u angazhuar në të gjitha mënyrat për ngadhënjimin e komunizmit në tërë kontinentin. Kishin pasur të drejtë të gjithë ata historianë dhe politikanë të kohës që, në vorbullën e trazuar të këtyre marrëdhënieve Perëndim-Lindje, shihnin fillimin e historisë së Luftës së Ftohtë. Përndryshe, lufta nuk po rihapej vetëm për ndarjen e sferave të influencës. Konkretisht, Moska e atëhershme zyrtare po sforconte fushatën ideologjike që, përmes komunizmit, si doktrinë politike e ideologjike të ripërtërinte luftën kundër "imperializmit perëndimor". Stalini, qysh në fillim të viteve 1945-1946, preokupohej lidhur me kërkesën e perëndimorëve që në vendet, të cilat fituan luftën ndaj nazizmit të vendoseshin qeveri demokratike, shumë partiake, sepse kjo nënkuptonte qëllimet për rrethimin kapitalist të

---

60 Shih: Richard J. Walton, Henri Wallance, Harry Truman and the Cold War, New York, Viking Press, 1976, f. 6.

Bashkimit Sovjetik. “Prapa të gjitha këtyre dyshimeve, keqkuptimeve dhe mosbesimit të plotë midis aleatëve të deridjeshëm të luftës kundër nazizmit, në esencë, fshiheshin konflikte të mëdha interesash për influencë dhe dominim në rendine ri botëror. Kornizate dy blloqeve antagonistë po krijoheshin me shpejtësinë të gjitha kuptimete Luftës së Ftohtë. Njerëzit në Perëndim, jo vetëm politikanët, nga dita në ditë-filluantë ndjenin shqetësim real për këtë ndasi në blloqe ideologjike dhe frika e tyre nga rreziku sovjetik sa vinte e bëhejmë dramatike. Papritmas, Perëndimi u ndie i zhgënjyer dhe ky zgjim tronditës bëri pluhur e hi shumë iluzione të kohës së luftës: ekzistonte një prirje për ta dramatizuar shumë konfliktin dhe për t’u atribuar Stalinit dhe udhëheqësve të tjerë komunistë, jo vetëm një dinakëri djallëzore dhe gjithë të këqijat e tjera, por edhe ambicie të pangopura e të pakufizuara territoriale”.<sup>61</sup> Kjo frikë nga sovjetizimi, ky shqetësim nga komunizmi dhe dëshpërimi i thellë nga udhëheqja sovjetike, deri dje aleate lufte, bëri që Perëndimi, i cili me aq lehtësi e kishte injoruar për vite të tëra komunizmin si ideologji, t’i rikthehej mësimin elementar për njohjen dhe vlerësimin realist të doktrinës së komunizmit, si botëkuptim mbi shoqërinë, historinë, botën dhe marrëdhëniet shoqërore mes njerëzve, shteteve dhe popujve. Megjithatë, ndonjë diplomat amerikan, siç ishte George Kennan, i cili, në vitete para të pasluftës, punonte në ambasadën amerikane në Moskë, e kishte kuptuar esencën e strategjisë të diplomacisë sovjetike që falë Stalinit dinak, si dhe të një varg bashkëpunëtorësh me përvojë të madhe diplomatike, në ato vite, kishte epërsi ndaj diplomacisë së përgjumur Perëndimore. Kryesisht, përmes të famshmit “Telegrami Gjatë”, (dërguar nga Moska në Uashington, në vitin 1946), Kennan kishte bërë presionte burrështetësit dhe diplomatët amerikanë që të nxiste një ripozicionim të ri të diplomacisë amerikane karshi ekspansionit komunist

61 Walter Lakqueur,, vep. e cit., f. 100.

me ngjyrim sovjetik. Esenca e kërkesës së George Kennan ishte që diplomacia amerikane të përpunonte një strategji të re ndaj ekspansionizmit sovjetik, strategji diplomatike kjo, e cila më vonë do të ndërtohet mbi të ashtuquajturën “teori e frenimit”.<sup>62</sup> Megjithatë, Perëndimit, e në radhë të parë, SHBA u mungonte forca për të kundërshtuar vendosmërisht politikën agresive të sovjetizimit dhe komunizimit të shteteve të reja përreth Bashkimit Sovjetik. Në tërë këtë situatë të re të diplomacisë botërore të pasluftës, qëndrimi i Perëndimit ishte pa strategji, inert, i vonuar dhe para së gjithash mbrojtës. Edhe në këtë periudhë, kur Lufta e Ftohtëpor merrte përndezjetë fuqishme, kur agresiviteti sovjeti kishte në rritje sipër dhe kërcënues, diplomacia amerikane, jo vetëm që nuk i merrte në shqyrtim vërejtjet dhe sugjerimet kritike të Çërcillit dhe të Kennanit, por tregonte interesim më të sinqertë për vazhdimin e partneritetit të Uashingtonit me Moskën dhe nuk preferonte forcimin marrëdhënies anglo-amerikane. Ishte ende viti 1946, kur diplomacia amerikane sinqerisht besonte në gjetjen e marrëveshjeve të reja me Bashkimin Sovjetik, përmes bisedimeve politike të drejtpërdrejta të nivelit më të lartë zyrtar ndërshtetëror.<sup>63</sup> Nga arkivat historike amerikane dihet se, kur delegacioni amerikan kishte arritur në Konferencën e Potsdamit (17 korrik-2 gusht 1945), diplomacia amerikane ende u përmbahej pikëpamjevetë kohës së luftës. Kështu, në dokumentin e Departamentit të Shtetit, që ndryshe shërbente si orientim për delegacionin amerikan, ndër të tjera, theksohej se krijimi i zonave të interesave do të ishte kërcënimi më i madh për paqen botërore: “...Objektivi ynë kryesor duhet të jetë mënjanimi i shkaqeve që i bëjnë kombet të ndjejnë nevojën e sferave të tilla për të ndërtuar sigurinë e tyre, në vend që të ndihmojnë një vend të forcohet

---

62 Shih: Gabriel Partos, vep. e cit., f. 27.

63 Shih: H. Kissinger, vep. e cit., f. 430.

kundër tjetrit".<sup>64</sup> Rezultati praktik i Konferencës së Potsdamit ishte nisma e procesit të ri diplomatik që paralajmëroi ndarjen definitive të Evropës në dy sfera influence. Ky proces thuajse u legjitimua në mbledhjen e parë të ministrave të jashtëm, që u mbajt në Londër, në shtator dhe fillim të tetorit 1945. Sovjetikët, as në këtë takim të nivelit të lartë diplomatik, nuk u treguan më kooperativë, ndërsa iluzioni amerikan se ndoshta me kërcënimin e bombës atomike do t'i frikësonin sovjetët u tregu ai pabazë. Përkundrazi, sovjetikët, përmes diplomatit Molotov, i cili i kishte mbetur besnik Stalinit në udhëzimet për diskutimet e çështjeve diplomatike, edhe në takimin e Londrës, bënë të qartë se nuk heqin dorë nga diplomacia kërcënuese. Nga kujtimet e Sekretarit amerikan të Shtetit, James Byrnes, del se: "... Ne kishim përballë një Rusi të re, krejtësisht të ndryshme nga Rusia që jemi marrë një vit më parë. Sa kohë që ata kishin nevojë për ne në luftë dhe ne u jepnim atyre furnizime kishim marrëdhënie të kënaqshme, por tani që lufta kishte mbaruar, ata po mbanin një qëndrim armiqësor dhe një qëndrim të pambrojtshëm për çështjet politike territoriale".<sup>65</sup> Megjithatë, moment vendimtar, përka-tësisht, kthesënë diplomacinë paqësore ndërkombëtare të pasluftës ishte Konferenca e Jaltës (4-11 shkurt 1945), në të cilën u vendos që vendet balltiketë gllabëroheshin dhe të bëheshin pjesë integrale e Bashkimit të atëhershëm Sovjetik. Fjalët e Stalinit dhe premtimet dhënë Rozveltit dhe Çërçillit do të lejonte zgjedhje të lira në Poloninë Hungari mbetën vetëm fraza diplomatike që u zbehën qysh në ditët e para pas përfundimit të takimit në Jaltë. "Rozveltika të drejtë të mendjese sakrifikimi i Polonisë e Hungarisë është i pranueshëm,

---

64 State Department briefing book, British Plans for a Western European Bloc, July 4, 1945, in U.S. Departments of State, Foreign Relations of the United States: The Conference of Berlin (The Potsdam Conference) 1945 Washington D. C.: U. S. Government Printing Office), vëll. I, f. 262-263.

65 Shih: The United States, Great Britain, and the Cold War, 1944-1947, Columbia University Press. 1977. p. 81.

nëse duhet të paguajë haraçin për arritjene paqesbotërore".<sup>66</sup> Paqja e arritur në Jaltë do të ishtenjë paqe e brishtë, shumë e paqëndrueshme, në radhë të parë, ndërmjet vetë shteteve që bënë ndarjene re të botës. Ndërsa, sa i përket Shqipërisë, si do të shohim në vijim, ajo u sakrifikua në favor të aspiratave sovjetike për sfera të reja të influencës së dominimit strategjik. Madje, çështja shqiptare u la qëllimisht në sferën e Lindjes pa u përmendur me asnjë fjalë në Konferencën e Jaltës. Në fakt, Jalta: "... Në vend që të çojë në një paqe të qëndrueshme, lë të lira të gjitha egërsitë e realizmit sovjetik. Në realitet, jo vetëm sovjetizimi i gati gjithë Evropës Juglindore, por edhe grushti i shtetit të Pragës, edhe situata koreane, situata indokineze, fitorja e Mao Tse-Tungut, muri i Berlinit, situata në Kubë, implikimi i manovrës komuniste në dramën e diskriminimit racial në Shtetet e Bashkuara, etj., embrionin e kanë në marrëveshjen e 11 shkurtit 1945. Në Jaltë, komunizmi ndërkombëtar kuptoi lehtësinë e Perëndimit dhe që atëherë nuk do të lodhej së bëri padrejtësira".<sup>67</sup> Jalta kishte përgatitur, qëllimisht ose jo, ndarjen e re, në radhë të parë të Evropës në dy blloqe. Gjashtë dhjetë ditë më vonë, pikërisht para se të vdiste, Rozvelli do t'i kuptonte gabimet e tij në dyluftimin e pabarabartë politik me Stalinin në Jaltë, do të ndërgjegjësohej për mospërfilljen e sugjerimeve të Çerçillit inteligjent e të vetmuar, por ai pendim ishte tepër i vonuar. Madje, të pafuqishme dhe krejtësisht të pa efektshme ishin edhe fjalët e hidhërimit në letrën që Rozvelli i dërgoi Stalinin, më 1 prill 1945. Rozvelli, gjithsesi i shqetësuar me zhvillimet ndërkombëtare pas Jaltës dhe ofensivën e sovjetikë vepër komunizimit e shteteve, të cilat i kishte përcaktuar si zona influence dhe interesi strategjik, një orë para se të ndahej nga kjo jetë, për herë të fundit i drejtohej me një telegram Çerçillit, duke i sugjeruar për ngushëllim: "Të mini-

---

66 Artur Conte, Jalta dhe ndarja e botës, Tiranë, 1994, f. 217.

67 Po aty, f. 218.



mizojmë sa më shumë të jetë e mundur problemin sovjetik. Megjithatë, duhet të mbetemi të fortë”.<sup>68</sup>

Lufta diplomatike do të vazhdonte edhe me ardhjen e Trumanit për president të ri të SHBA. Në mars të vitit 1947, u bë publike doktrina e ashtuquajtur “Truman”, kurse tre muaj më vonë doli edhe iniciativa e Planit Marshall, e cila, me kalimin e kohës, u bë simboli një shembulli të suksesshëm të rimëkëmbjes së marrëdhënieve politike dhe ekonomike të Perëndimit, por edhe të frenimit të sovjetizimit dhe komunizimit. Natyrisht, Bashkimi Sovjetik duke qenë i shqetësuar se, përmes këtij plani, Marshalli (George Marshall, sekretar i shtetit të SHBA) do të rriste influencën e Perëndimit mbi shtetet e Evropës Lindore, të cilat ishin nën ndikimin sovjetik, e kishte kundërshtuar këtë plan. Në atë kohë, shtetet që ishin nën ndikimin e politikës sovjetike dhe jugosllave, ndër to edhe Shqipëria, e kishin kundërshtuar Planin Marshall.

Në Konferencën e Jaltës, Shqipëria nuk u përmendas në diskutime e as në paragrafët e tekstit integral të marrëveshjes, që njëherit ishte edhe dokumenti përfundimtar i konferencës së trifuqive. Në kreun VIII, IX, X dhe XI të dokumentit përfundimtar të Konferencës së Jaltës, të titulluar “Evropa Juglindore”, bëhej fjalë për marrëdhëniet dhe pozitën e re gjeostrategjike të Jugosllavisë, Bullgarisë, Greqisë, Rumanisë, Italisë e Austrisë, ndërsa Shqipëria nuk figuronte as gjeografikisht. Shteti shqiptar dhe qeveria e re e dalë nga Lufta Antifashiste e Nacionalçlirimtare ishte lënë në harresë jo rastësisht, sepse kjo nuk ishte hera e parë në historinë e shtetit shqiptar që në konferenca ndërkombëtare të lihej qëllimisht në harresë, të izolohej ndërkombëtarisht e të mbetej në mëshirën e aspiratave të fqinjëve apo të fuqive të mëdha që nuk i takonin bllokut Perëndimor. Pra, Shqipëria edhe në Jaltë po lihej si zonë interesi në orbitën fillimisht jugosllave dhe më pas atë sovjetike, pavarësisht se populli shqiptar

---

68 Po aty, f. 220.

ishte i vetmi ndër popujt e rajonit ballkanik të Evropës Juglindore që e kishte çliruar vendin nga nazifashizmi pa ndihmën ushtarake të fuqive të bllokut antifashist, madje, pavarësisht traditës properëndimore të shtetit shqiptar, veçmas në kohën e Zogut. Nga analiza e arkivave historike del se nuk qëndronte konstatimi se vetëm Polonia dhe Rumania ishin sakrifikuar për paqene brishtë të tri Fuqive të Mëdha. Rrjedhimisht, nuk mund të qëndronte supozimise Shqipëria po mbetej pengje Lindjes vetëm për arsye në krye të shtetit të ri kishte ardhur një qeveri komuniste. Pra, lënia e Shqipërisë në kthetrat e jugosllavëve, përkatësisht të bllokut të Lindjes, nuk mund të justifikohet kurrsesi me instalimin e një shtatmadhorie komuniste në kryetë Shqipërisë së re, siç kishin interpretuar historianët dhe politikanët e ndryshëm ndër-kombëtarë, por edhe shqiptarë.<sup>69</sup> Në këtë kontekst, pra, të lënies së Shqipërisë në orbitën e Lindjes e jo të Perëndimit, fjala ishte për marrëveshjet e fshehta ndërmjet Rozveltit, Çerçillit dhe Stalinit, e jo siç thuhej e shkruhej se kjo po ndodhte për arsye të ardhjes në pushtet të një qeverie komuniste. Në Komunikatën e 11 shkurtit 1945, në ditën e përfundimit të Konferencës së Jaltës, ndër të tjera, në kreun e pestë të Deklaratës mbi Evropën e çliruar, shkruhej: “Një nga parimet e Kartës së Atlantikut është që të gjithë popujt kanë të drejtën të zgjedhin formën e qeverisë, nën të cilën mendojnë të jetojnë dhe që të drejtat sovrane të autonomisë, nga të cilat u zhveshën me forcë prej vendeve agresore, duhet t’u kthehen...Vendosjen e qeverive provizore, në të cilat do të përfaqësohen gjerësisht të gjithë elementët demokratë të popullsisë nëpërmjet zgjedhjeve të lira, duhet sa më shpejt të formojnë qeveri që i përgjigjen vullnetit të popullit...”.<sup>70</sup> Analizuar nga ky pikëvështrim del se i ashtuquajtimi Treshii Fuqive të Mëdha Aleate, në rastin e Shqipërisë, nuk i

69 Shih: Artur Conte, vep. e cit., f. 217.

70 Artur Conte, vep. e cit., f. 197-198.

kishte përfillur deklaratimet e veta të bëra publike, pra, që të respektonte të drejtën e popujve që vetë dhe pa imponime të zgjidhnin formën e qeverisjes, nën të cilën mendonin të jetonin. Mbi qeveritarët shqiptarë ishte bërë përjashtim i kobshëm dhe hakmarrës në ndëshkimin ndërkombëtar, përmes presioneve të gjithfarshme, kryesisht në vitet 1945, 1946 dhe 1947. Kjo vetëm për faktin, sepse siç thuhej në atë kohë në qarqet diplomatike europaerëndimore, në Shqipëri erdhi në pushtet një qeveri komuniste. Natyrisht, nga kjo distancë historike, kur në hapësirën ndërkombëtare, dhe jo vetëm të botës shqiptare, kemi një realitet të ri të rendit të ri botëror, është e vështirë dhe ndoshta edhe e pakuptimtë të pretendosh që të shkruash një histori hipotetike. Prandaj, askush nuk do të mund të thoshte me saktësi se ç'do të ndodhte nëse marrëdhëniet e Shqipërisë me Perëndimin pas luftës do të kishin marrë të mbarën. A thua vërtet Shqipëria po mbetej, po rirreshtohet karshi bllokut ideologjik të Lindjes me dëshirën vet dhe vullnetin e popullit të saj, pavarësisht përcaktimit të pathyeshëm të qeverisë së parë komuniste të Shqipërisë që të mos pranonte ultimatumin Perëndimor, e në radhë të parë atë anglo-amerikan, si dhe që të mos lejonte zgjedhjet e lira shumë partiake në vend, pra, që të vendoste regjimin totalitar komunist? Padyshim, me këtë orientim të politikës së jashtme nuk pajtohej pjesa dërmuese e popullit shqiptar, pavarësisht gjithë propagandës agresive të PKSH dhe kokëfortësisë së pashembullt të udhëheqjes së saj, me në krye Enver Hoxhën. Udhëheqja e re shqiptare e ballafaquar midis shpresës për përkrahje ndërkombëtare, ideale vepër Shqipërinë e re të pavarur, por jo demokratike e shumë partiake, ruajtjes me çdo kusht të pavarësisë nga kërcënimet greke dhe dinakëria jugosllave, e më vonë edhe ajo sovjetike, si dhe nga ana tjetër e bllokadave, izolimit ndërkombëtar që nga ditët e para të pasluftës, përkatësisht izolimi nga bota Perëndimore, u gjet në pozitë më të vështirë dhe më të papër-

shtatshme se qeveritë tjera po ashtu komuniste të vendeve fqinje. Qeveria e re e dalë nga lufta dhe nga zgjedhjet një partiake jopluraliste e gjeti veten me pavarësitë rivendosur në kufijtë e paraluftës, në kufijtë e Shqipërisë së ndarë e të copëtuar, ndërkohë që, duke mënjanuar politikisht opozitën demokratike properëndimore në vend, madje edhe duke shkelur të drejtat themelore të njeriut, me shpejtësitë rrufeshme imponoi vullnetin e saj diktatorial para popullit. Në rrethana të tilla, çështja e hapur e Kosovës as që shtrohej në rend dite për qeverinë komuniste të Shqipërisë. Sipas vendimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, Jugosllavisë së re iu pranuan kufijtë e Jugosllavisë mbretërore, të krijuara më 1918, kështu që u legalizua ndërkombëtarisht mbetja e Kosovës së pushuar në kufijtë e shtetit jugosllav. “Qeveria shqiptare e Enver Hoxhës, duke bashkëpunuar në të gjitha fushat e jetës me qeverinë jugosllave, shprehu besimin e saj se çështja e Kosovës do të zgjidhej në përputhje me parimin e vetvendosjes dhe do të realizohej më vonë, se atëherë nuk ishte momenti për t’u zgjidhur kjo çështje. Prandaj, ajo nuk e ngriti asnjëherë këtë çështje për zgjidhjenë forumet e saj, si edhe në forumet ndërkombëtare”.<sup>71</sup> Nga ana tjetër, po ashpërsohej kundërshtimi i vendosuri Perëndimit për të njohur qeverinë komuniste të Enver Hoxhës, ndërkohë që udhëheqja re po e thellonte kursin e luftës ideologjike dhe diplomatike kundër qeverive perëndimore, në radhë të parë të SHBA dhe Britanisë së Madhe. Me kopjimin e sistemit politik, ushtarak, ekonomik dhe ideologjik jugosllav, Shqipëria nuk mund të ishte përjashtim në zhvillimet e brendshme të shtetit të ri socialist. Pra, në emër të një ideologjie totalitare, në shoqërinë shqiptare po vendosej një shtet dhe sistem totalitar, ndërsa dhuna dalëngadalë po bëhej ligj që diktonte prishjen e ekulibrit brendakombëtar. Për opozitën politike, gjatëluftës, në fund të saj dhe në ditët e para të çlirimit, po vinin dhe po

71 Demir Dyrmishi, Studime historike, 1-2, 1998, Tiranë, f. 106.

paralajmëroheshin ditë ankthi dhe përndjekjesh. Shqipëria komuniste po fillonte luftëne re politike brendakombëtare me përmasa tepër tragjike. Por, paradokset nuk ishin vetëm me ngjyrim shqiptar, sepse në vitet e para të pasluftës, kur Evropa e mbërthyer me idealine ndërtimit të një jetë të re, të lirë dhe të denjë, në një kuptim po bëhej ideal i qytetërimit të ri, kishte shembuj kur edhe intelektualë evropianë në zë<sup>72</sup> filluantë shihnin me një kureshtje, shpresë dhe besim mashtrues qytetërimin e ri të Lindjes. Megjithatë, diktatura e re me ngjyrim komunist po zinte rrënjë në shtetin shqiptar, i cili sapo kishte dalë i shkatërruar nga lufta. “Në punët e brendshme, regjimi i ri shumë shpejt nisi një formë të rreptë të luftës së klasave, duke filluar nga gjyqet publike të bashkëpunëtorëve dhe të “armiqve të popullit”, si dhe dënimet me vdekje duke i internuar familjet në kampe pune dhe duke shpronësuar pasuritë, më tej vijoi me eliminimin nëpërmjet taksave penale për këdo që mund të vështrohej si kapitalist dhe kështu, në gusht 1945, arritinë një reformë rrënjësore për tokën që e shfarosi gjithë klasën e vjetër të pronarëve të tokave”.<sup>73</sup> Nuk do të kalonte shumë kohë, veçmas pas shuarjes brutale e të përgjakshme të kundërshtimeve të hapura të grupeve dhe personaliteteve opozitare, intelektuale dhe me shpirt demokratik, dhe, po bëhej përditë e më e qartë se në realitetin e ri të Shqipërisë së pasluftës nuk ishte fjala vetëm për një parti, pra PKSH, por se ajo në të njëjtën kohë ishte një ankth i ngjitur në pushtet. Politika e asaj partie nuk ishte një politikë shoqërore: ishte vargëzim i zgjedhjeve dhe vendimeve të gabuara, ishte një inkuizicion i ri”.<sup>74</sup>

Jeta e shoqërisë shqiptare dalëngadalë po përshkohej nga kultura e urrejtjes dhe e hakmarrjes, ndërsa hapi nga: “Dësh-

72 Paul Eluard, Rene Clair, Irene Cure, Yves Montand, etj.

73 Reginald Hibbert, Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, Tiranë, 1993, f. 356-357

74 Amik Kasoruh, Një ankth gjysmëshekullor, Shqipëria e Enver Hoxhës, Tiranë, 1996, f. 22.

mor në tradhtar kishte qenë shumë i shkurtër dhe nuk kush-toi që të vdekurit nuk mund të kenë të drejtë”.<sup>75</sup> Nako Spiro, më 7 shkurt 1945, përmes gazetës “Bashkimi” përkujtonte dhe njëkohësisht kërcënonte: “Shqipnija mbarë kërkojti gjyqin dhe dënimin e Mithat Frashërit, Abaz Kupit dhe shokëve të tyre. Ata qi shpresojnë të përfitojshin nga gjëndja e këtyre kriminelave jashta Atdheut për të kurdisë, vratë tjera në shpinë të popullit tonë, le të marrin mirë shënim për këtë”.<sup>76</sup> Mesazhi i Nako Spiros ishte i qartë. Në të njëjtin artikull citoheshin edhe fjalët e Koçi Xoxes, thënë më 4 shkurt 1945, në mitingun e mbajtur në Tiranë: “Vdekje dhemallkimkriminelëve të luftës dhe tradhtarëve të Atdheut”.<sup>77</sup> Ndërsa, idealet edhe të vetë FANÇ për bashkimin e ëndërruar të popullit shqiptar dhe krijimin e një shoqërie të re të lirë dhe demokratike përditë e më tepër po veniteshin. Ishte e qartë se shoqëria dhe shteti shqiptar i pasluftës po ballafaqoheshin me sfida dhe kundërthënie të jashtëzakonshme, ndoshta për shumëkënd edhe të papritura. Por në radhë të parë, mosmarrëveshjet dhe konfliktet, jo vetëm politike brenda përbrenda faktorit politik shqiptar, po paralajmëronin largimin dhe shkëputjen gjithnjë e më dramatike nga ideale te luftës dhe të lirisë.

Në ditët e paratë çlirimit, në planin politik po ravijëzoheshi preferencat kryesisht për Jugosllavinë titiste, e cila me dinakëri të përpiktë sllave i fshihte synimet grabitqare të serbëve, jo vetëm ndaj Kosovës, por edhe ndaj shtetit shqiptar në tërësi. Portat e gllabërimit të Shqipërisë tanimë ishin hapur tërësisht, ndaj synimet sllave për daljen në ujërat e Detit Mesdhe, e pse jo edhe përmes portës së Durrësit, në vitet e para të pasluftës, dukeshin krejt të afërta dhe të realizueshme. Populli shqiptari zënë në befasi, i mashtruar në shpresat e veta

---

75 Po aty, vep. e cit., f. 34.

76 Nako Spiro, Artikuj dhe fjalime, Tiranë, 1945, f. 95-96.

77 Po aty.

dhe i braktisur në fatine vet, tanimë nuk kishte as alternativë. Disa autorë shqiptarë (shih: Amik Kasarohu, vep. e cit.) janë të mendimit se shkaqet kryesore që çuan në prishjen përfundimtare ndërmjet blloqeve dhe grupacioneve politike, në fund të luftës dhe në muajt e parë të çlirimit, ishin: çështja e Kosovës dhe qëndrimi ndaj aleatëve. Megjithatë, duhet shtuar se ndër çështjet thelbësore të prishjes së ekuilibrit midisforcave politike brenda shqiptare ishin mospajtime te thella dhe të pakapërcyeshme që kishin të bënin me trajtën e së ardhmes politike të shtetit shqiptar. Pra, ishin shtruar tri trajta të papajtueshme rreth rregullimit të ri kushtetues-juridik të Shqipërisë së pasluftës: "...Një republikë komuniste ishte synimi i PKSH, një shtet demokratik i lidhur me Perëndimin parashihej në programin e Ballit Kombëtar, një monarki me në krye familjen mbretërore të ishmbretit Zog parashihej nga Legaliteti".<sup>78</sup>

Militantizmi komunist ishte shprehur dhe në ditët e para të Shqipërisë së dalënga lufta. Nako Spiru, udhëheqës komunisti dealist, i cili më vonë edhe vetë do të binte viktimë e iluzioneve ideologjike dhe e luftës së klasave, në janar të vitit 1945, në gazetën komuniste "Bashkimi", me tone kërcënuese, paralajmëronte: "Me kriminelët e luftës duhet të dënohet, duhet të shembet, duhet të çduket nga rrënjët e gjithë politika e bashkëpunimit me okupatorin, e gjithë politika dhe e gjithë propaganda kundër lëvizjes nacional-çlirimtare, kundër krijimit të një Shqipërie të re demokratike, të një Shqipërie të popullit. Me kriminelët e luftës duhet të varroset, për mos me u ngjallë ma kurrë, në asnjë formë, edhe rruga e tradhtisë".<sup>79</sup> Ndërsa, në fjalën tij mbajtur në Tiranë në mitingun e 28 janarit 1945, Spiru ishte edhe më decidiv, duke kërkuar para mijëra tiranasve: "...Na kërkojmë dënimin e kriminelëve të luftës. Ata qi përpiqen qi të shtrembërohet ky problem dhe të

78 Po aty, vep. e cit., f. 36.

79 Nako Spiru, Artikuj dhe fjalime, Tiranë, 1945, f. 83.

humbin gjurmat e përgjegjësve politik, e bajnë tamam për të kundërtën”.<sup>80</sup> Lame Kodra (Sejfulla Malëshova), në mars 1945, shkruante:” Sot gjithë populli shqiptar po mëson se ata që kanë ulëritursi çakenjper Kosovë e Çamëri, kanë qenë lidhure kanë bashkë punuar ngushtë me xhelatë te shqiptarëve të Kosovës e të Çamërisë”.<sup>81</sup> Paralajmërimet e këtilla për qërim hesapeshme ata që me armë apo jo, gjatë viteve të luftës, kishin qenë kundërshtarë politikë, po instaloheshin edhe institucionalisht në emër të pastërtisë ideologjike të luftës së klasave. Nuk vonoi dhe të parët që u pushkatuan, madje në ato ditë kur po përfundonte lufta, ishin disa dhjetëra intelektualë të Tiranës. “Dhjetëra qytetarë u pushkatuan në breg të lumit: midis tyre ishin edhe dy shokë fëmijërie të Hoxhës, vëllezërit Kokalari, librashitës, fajtorë, sepse gjatë luftës kishin mbajtur anën e Ballit Kombëtar. Dy vjet më vonë do të dënohej edhe motra e tyre Musine, shkrimtare e talentuar”.<sup>82</sup> Pikërisht, në këtë vit të parë të pasluftës, situata e përgjithshme edhe në planin e sigurisë po paraqitej e turbullt dhe e paqartë. Në këto rrethana kishte zënë fillë dhe qëndresa e kundërshtarëve të regjimit, e cila manifestohej kryesisht mbi bazat e lëvizjes antikomuniste. Paradoksi i politikës shqiptare qëndronte në faktin se i njëjti popull, kryesisht krahinave veriore të Shqipërisë, i cili më parë kishte përkrahur partizanët, tani po u jepte përkrahje, bukë dhe strehim prijësve të lëvizjes antikomuniste. Zhvillimet e tilla, për shumëkënd kundërthënëse, të papritura e plot ankth, paralajmëronin zhgënjime të thella afatgjate, në vend të qetësisë brenda kombëtare, prosperitetit, zhvillimit ekonomik-shoqëror, konsolidimit dhe forcimit të shtetit shqiptar përbrenda kombit, si dhe në raportme faktorët ndërkombëtarë.

Fillet e rezistencës antikomuniste në Shqipëri datojnë

---

80 Po aty, f. 91.

81 Lame Kodra, Artikuj dhe ligjërata 1939-1945, Tiranë, 1945, f. 81.

82 Amik Kasaruho, vep. e cit., f. 44.



qysh nga takimi i 152 përfaqësuesve të Maleve të Shkodrës, mbajtur më 13 maj 1944 në kinemanë “Rozafa” të Shkodrës, në të cilini shte krijuar Lidhja e Shkodrës. Programi i Lidhjes së Shkodrës kundërshtonte drejtpërdrejt bashkëpunimin shqiptaro-jugosllav, të mbështetur nga viti 1941 mbi bazat komuniste. Në fillim të vitit 1945, shpërtheu kryengritja e armatosur e Malësisë së Madhe, e para lëvizje antikomuniste në të gjitha vendet e Lindjes. Por, ajo u shtyp me gjak. Qëndresa e organizatave ilegale antikomuniste ndaj alternativës së zhvillimit dhe rendit të ri komunist në Shqipëri kulmoi me kryengritjen Postribës, në vitin 1946, e cila po ashtu u shua me gjak nga forcat e ushtrisë dhe të policisë.<sup>83</sup> Mirëpo, opozita politike e pushtetit të ri komunist ishte krijuar edhe në vetë radhët e Kuvendit të Parë Popullor. Në Kuvendin Popullor, grupi i deputetëve demokratë kundërshtonte zbatimin e politikës antidemokrate të brendshme dhe asaj të jashtme të qeverisë. Kjo opozitë politike instruktohej edhe nga misionet anglo-amerikane që kishin për qëllim njohjen e opozitës në Shqipëri. Në një dëshmi të Sulo Klosit, anëtar i Organizatës Ilegale Nacional demokratike, deponuar pranë organeve gjyqësore, konfirmohej: “Anglo-amerikanët na kanë udhëzuar të bënim aksionekundër pushtetit popullor, si në pikëpamje politike, ashtu edhe në pikëpamje ekonomike, me qëllim që të provokohej zbarkimi”.<sup>84</sup> Përgjithësisht, mund të konstatohet se, në vitet e para të pasluftës, opozita politike e intelektuale kundërshtoi, jo vetëm vendosjen e sistemit njëpartiak, pra, diktaturën e PKSH, por barabar kishte ngritur zërin e protestës edhe për politikëne jashtme të shtetit shqiptar e orientuar nga Lindja e jo nga Perëndimi, më konkretisht e varur drejtpërdrejt nga jugosllavët dhe sovjetikët. “Ajo kundërshtonte orientimin e politikës së jashtme

83 Shih: Uran Butka, Ringjallja, Tiranë, 1995, f. 116-128, Lufta civile në Shqipëri 1943-1945, Tiranë, 2008, f. 200-277.

84 Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Fondi: Dosjet gjyqësore, viti 1947, dos. 2224/1., fl. 12.

të PKSH nga Bashkimi Sovjetik, qëndrimin tolerant të saj ndaj vendeve perëndimore, në radhë të parë ndaj Anglisë dhe Amerikës, dhe shprehte mendimin se ndaj tyre duhej ndjekur një politikë më e moderuar dhe të hiqej dorë nga qëndrimi papajtueshëm".<sup>85</sup> Mirëpo, shpartallimi i përgjakshëm i forcave antikomuniste nga ana e regjimit, në shtator të vitit 1946, u bëri me dije udhëheqësve të opozitës se regjimi komunist nuk do të pranonte kurrfarë koncesionesh përsa i përket rregullimit të brendshëm sistemor, se do të ndërmerre masa të rrepta dhune ndaj çdo përpjekjeje që synonte rrëzimin e pushtetit popullor të vendosur në Shqipëri. Ndjekjet, gjyqet dhe dënimet me vdekje të pjesëtarëve të opozitës politike nuk kishin të ndalur, ndërsa ishin shuar të gjitha iluzionetse qeveria komuniste mund të rrëzohej përmes veprimit politik. Prijësit politikë dhe intelektualë të opozitës ende i mbanin shpresat te Perëndimi duke menduar se anglo-amerikanët nuk do të lejonin që Shqipëria të mbetej nën ndikimin politik dhe gjeostrategjik të bllokut të Lindjes. Mirëpo, Perëndimi nuk kishte plane për të ndërhyrë ushtarakisht në Shqipëri, sepse ndarja e sferave të interesit midis Fuqive Aleate të dala pas Luftës së Dytë Botërore i kishte përcaktuar kornizat dhe kufijtë e shtrirjes së ndikimit të influencës për Fuqitë e Mëdha, siç ishin: SHBA, Anglia e Rusia. Perëndimi vetëm nxiste krijimin e reagimit politik në Shqipëri dhe i premtonte opozitës politike shqiptare përkrahje, por ajo përkrahje ishte jashtëzakonisht e kufizuar në të gjitha planet. Pra, edhe në vitet e para të pasluftës, Shqipëria, me gjithë thyerjet e mëdha politike dhe të tjera në shoqërinë shqiptare, vazhdonte të mbetej në pozicionin gjeostrategjik dhe atë të diplomacisë ndërkombëtare, në varësi të interesave të Fuqive të Mëdha në rajon, duke u shndërruar për shumë vite në një prej qendrave më neuralgjike të Luftës së Ftohtë midis Perëndimit dhe Lindjes.

---

85 Demir Dyrnishi, Veprimtaria ilegale e Organizatës Nacionaldemokratike, Studime historike, Tiranë, 1997, f. 76.

## Kapitulli i tretë

### POZITA NDËRKOMBËTAREE SHQIPËRISË NË VITET 1945-1948

Në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, madje qysh në ditët e paratë përfundimit të luftës, pozita ndërkombëtare e Shqipërisë, në vend që të ishte e vendosur mbi bazat e njohjes dhe bashkëpunimit ndërshtetëror, u gjend para sfidave gati të papërballueshme. Në këtë periudhë, arsyet kryesore të krijimit të pozitës së pafavorshme dhe të pamperspektivë në planin ndërkombëtar të Shqipërisë ishin: 1. Ndërhyrja hegjemoniste jugosllave, e cila ishte krejtësisht dhe drejtpërdrejt me qëllime të caktuara kundër interesit të shtetit shqiptar, 2. Qeveria e re shqiptare, e dalë nga Mbledhja e Dytë e Kuvendit Antifashist në Berat (22 tetor 1944) në prag të çlirimit të Shqipërisë, ishte deklaruar edhe publikisht për mos kooperim me aleatët perëndimorë, ndërkohë që bashkëpunonte ngushtë me përfaqësuesit e misionëve jugosllave dhe ruse të vendosura në Shqipëri. Diplomacia e re shqiptare pasluftës, në masë të caktuar, ishte vënë në pozitat e hapura kundërshtuese me atë anglo-amerikane dhe përgjithësisht perëndimore. Nuk ishte për t'u habitur pse vendimet e Kongresit të Përmetit,<sup>86</sup> të cilat përmes Koço Tashkos iu dërguan Departamentit të Shtetit dhe mërgatës shqiptare në SHBA, nuk u pritën mirë nga qarqet diplomatike të aleatëve, në radhë të parë të Anglisë dhe SHBA. Një qëndrim

---

86 Historia e Popullit Shqiptar II, Prishtinë, 1969, f. 774-778.

kundërshtues dhe refuzuesi diplomacive perëndimore ndaj vendimeve të Kongresit të Përmetit, e më pas edhe vendimeve të Kuvendit të Dytë Antifashist Nacional çlirimtar të Shqipërisë, mbajtur në Berat (nëntor 1944), nuk ishte i papritur, pasi Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar në Shqipëri formoi një qeveri komuniste, të cilën qeveritë e SHBA dhe Anglisë nuk do ta pranonin për vite me radhë. Konkretisht, anglezët, në prag të përfundimit të luftës, përmes gjeneralit Uilson, ishin deklaruar lidhur me çështjen shqiptare se përkrahnin një marrëveshje midis forcave politike e ushtarake në Shqipëri, e cila do të eliminonte përçarjet e reja brenda shqiptare.<sup>87</sup> Gatishmërinë dhe disponimin e qeverive perëndimore për të bashkëpunuar ngushtë me udhëheqjen e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar dhe forcat tjera ushtarake e politike në Shqipëri, i bënte publike edhe mikja e madhe shqiptare, anglezja Edit Durham. Në një letër dërguar Fan S. Nolit, në qershor të vitit 1944, ajo theksonte: “Nëse shqiptarët do të mund t’ua parashtronjë aleatëve Frontin e Bashkuar dhe të deklarojnë haptazi dëshirat e tyre, Shqipëria mund të ngrihet sërish si feniksi prej zjarrit dhe të zërë vend në radhën e kombeve”.<sup>88</sup> Madje, duke shprehur bindjen se Mali i Zi, Bosnja, Maqedonia Perëndimore, Dalmacia e Kroacia nuk do t’i nënshtroheshin diktaturës së Beogradit, Edit Durham shkruante: “Nëse formohet një grup i tillë i shteteve federative (në Jugosllavi), është e arsyeshme që edhe shqiptarë të Kosovës të fitojnë të drejtën të vendosin vetë”.<sup>89</sup>

Amerikanët, me praninë e tyre ushtarake e politikenë Evropënë fund të Luftës së Dytë Botërore, gjithashtu e kishin ngritur nivelin e interesimit të tyre për zhvillimet e ardhshme në Shqipëri, veçanërisht, në gjysmën e dytë të vitit 1944, kur dihej epilogo i luftës antifashiste. Diplomati amerikan

---

87 Gabriel Partos, Bota që erdhi prej të ftohtit, Tiranë 1994, f. 15.

88 Enciklopedia Britanica, vëll. 21, f. 210-211.

89 Shih: Henri Kissinger, vep. e cit., f. 424.

Markham, në raportine tij, përgatitur në korrik të vitit 1944, për gjendjen në Shqipëri, pasi theksonte se popullshqiptar ishte i ndarë në pesë grupe politike e ushtarake (partizanët, ballistët, malësorët (mendohet për zogistët), kosovarët dhe qeveria), kërkonte nga qeveria e Uashingtonit që të përcaktohej në qëndrimin e vet për të përkrahur partizanët ose mbretin Zog.<sup>90</sup> Në këtë raport, diplomati amerikan, i cili dëshmohejsi njohës i mirëi rrethanave në Evropën Juglindore, pra edhe i çështjes shqiptare, vlerësonte se LNÇ udhëhiqej nga komunistët, të cilët “ishin të frymëzuar nga Rusia” dhe e konsideronin veten si miq të afërt me Titon. Ai sugjeronte se partizanët shqiptarë duhet të paraqiteshin si miq të aleatëve, si patriotë dhe si mbrojtës të harmonisë së Ballkanit.<sup>91</sup> Nisur nga këto informacione, Departamenti i Shtetit të SHBA kishte përgatitur instruksione, të cilat, përmes Sektorit për marrëdhënie me Evropën Juglindore, duhej t’i paraqiteshin LNÇ në Shqipëri. Shprehimisht thuhej: “Duhet të kemi parasysh se SHBA kanë interesat e veta në Shqipëri, se përderisana nuk pajtohem në përgjithësi me planet britanike, nuk duhet të ndjekim udhëheqjen britanike, pasi ajo na ul pozitën dhe prestigjin tonë të shqiptarët”.<sup>92</sup>

Planet anglo-amerikane për zbarkim të trupave ushtarake në Shqipëri, në verën e vitit 1944, Enver Hoxha dhe Shtabi i Përgjithshëm i LNÇ i kishin kundërshtuar me këtë arsytim: “Asnjë ushtri e huaj, qoftë dhe aleate, nuk do të lejohet në vendin tonë të bëjë si t’i dojë qejfi”.<sup>93</sup> Megjithatë, komandat angleze kishin zbarkuar në zonën e Sarandës, ndërsa më 29 shtator 1944 nga Bari i raportohej Forin Ofisitse: “Zhvillimi i mëtejshëm i operacionit varet nga një numër faktorësh, të cilët tani nuk mund të vlerësohen. Por, në qoftë se çdo gjë

90 Gabriel Partos, vep. e cit., f. 20.

91 Shih: Eric Hobsbawn, Epoka e ekstremeve, I rrëmbyeri shekull i njëzetë 1914-1991

92 Shih: Walter Laqueur, Evropa në kohën tonë, Tiranë, 1996, f. 90.

93 Po aty, f. 90-91.

do të shkojë mirë, ne mund të jeminë gjendjetë mbajmë një bazëtë përhershme në tokën shqiptare, ashtu si edhe në Korfuz”.<sup>94</sup> Pak ditë më pas, Enver Hoxha kishte njoftuar kolonelin amerikan C. A. Palmerin që të tërhiqeshin forcat angleze, përndryshe do të shpërthente luftë në mes të partizanëve dhe anglezëve.<sup>95</sup> Ndërkohë, Enver Hoxha iu kishte dorëzuar misioneve të huaja kërkesën drejtuar qeverive të tyre për njohjen e qeverisë së re të Shqipërisë. Në letrën e ambasadorit britanik në Moskë, Arçibald Klark Ker, dërguar më 30 tetor 1944 Molotovit, diplomati britanik, mes të tjerash e njoftonte Molotovin, përkatësisht qeverinë sovjetike: “Në këtë situatë të turbullt në Shqipëri, ajo (qeveria britanike - A.Z.) nuk ka ndërmend të njohë “Qeverinë e përkohshme” të krijuar nga Fronti Nacional çlirimtar i Shqipërisë”. Ker, pasi shpresonte se qeveria sovjetike do të ishte dakord me këtë vendim, njëherit e njoftonte Molotovin se në këtë drejtim qeveria anglezedo ta njoftonte edhe qeverinë SHBA”.<sup>96</sup>

Në rrethanat e këtilla, kur diplomacisë perëndimore po i rrëshqiste çështja shqiptare, duke u bërë kështu fushë e privilegjuar e prapa skenave jugosllave dhe më pas edhe të atyre ruse, zyrtarët e Departamentit të Shtetit kërkuan nga Komanda e ushtrisë amerikane, me selinë Kazertë të Italisë, që ngjarjet në Shqipëritë përcilleshin më për së afërmi dhe me një vrojtim më analiste efektiv. Kordell Hilli, sekretari atëhershëm shtetëror amerikan, në njoftimin e tij personal, pasi theksonte se diplomacia amerikane nuk ishte e interesuar për konfrontime në radhët e organizatave politike e ushtarake që vepronin në Shqipëri, në mënyrë të veçantë bënte me dije se rreziku i konfrontimit eventual, madje edhe i luftës civile mund të evitohejme ndërhyrjene forcave anglo-amerikane, pra menjëherë pas largimit të ushtrisë gjermane

---

94 Po aty, f. 95.

95 Po aty, f. 93.

96 Shih: H. Kissinger, Diplomacia... f. 467.

nga territori shqiptar.<sup>97</sup> Qëndrimi refuzuesi PKSHE ndaj aleatëve perëndimorë, në radhë të parë ndaj Anglisë dhe SHBA, në prag të çlirimit të Shqipërisë, bëhej edhe më transparent në një raport të përgatitur nga KQ i PKSHE, i siguruar në shtator të vitit 1944 nga Sektori për Marrëdhënie me Evropën pranë Departamentit të Shtetit. Në një pjesë të këtij raporti thuhej se PKSHE paraqiste të vetmen fuqi të motivuar të LNÇ, të armatës dhe të luftës për çlirim, se KQ i PK të PKSHE do ta drejtonte vështrimin nga Moska dhe politika sovjetike dhe sidomos ndaj Lëvizjes çlirimtare të Jugosllavisë, të cilat “nuk e kërcënojnë pavarësinë kombëtare të Shqipërisë”.<sup>98</sup> Në këtë analizë, gjithashtu, KQ i PKSHE kritikonte rreptë qëndrimin e diplomacive anglo-amerikane, të cilat pretendonin që të ndërhyenin në punët e brendshme të politikës shqiptare. Në raport theksohej decidivisht se duhej ndaluar çdo mundësi e përzjerjes së Misionit ushtarak Anglez në punët e brendshme të LNÇ. Duke parë këto qëndrime qartësisht antiperëndimore, në vjeshtën e vitit 1944, diplomacia amerikane dhe ajo angleze kishin intensifikuar angazhimin e tyre kritik ndaj çështjes shqiptare, duke u shprehur se nuk pajtoheshin me mendimin e udhëheqësve të PKSHE, se LNÇ duhej të udhëhiqte shtetin shqiptar dhe aq më pak ishin të bindur se PKSHE do të ishte e mirëpritur nga mbarë populli shqiptar. Sektori për Marrëdhënie me Evropën pranë Departamentit Amerikan, pasi nënvizonte se pranë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH gjendeshin misionet ushtarake të Bashkimit Sovjetik dhe misioni ushtarak jugosllav, deklaroi se diplomacia amerikane nuk do të anonte kah njohja zyrtare e qeverisë së përkohshme demokratike të Shqipërisë, duke e arsyetuar qëndrimin e tyre me një varg argumentesh. Në raport veçoheshin të dhënat e shërbimeve amerikane të zbulimit, sipastë

97 Shih: Richard J. Walton, Henri Wallance, Harry Truman and the Cold War, New York, Viking Press, 1976, f. 6.

98 NA-USA. 875.01/9-2544. Analizë e KQ të PK të Shqipërisë në Sektorin e marrëdhënieve Evropiane të Stejt-Departamentit, 25 shtator 1944.

cilave vlerësohej se Fronti Nacional çlirimtar në thelb ishte organizatë komuniste, se njoftimet provonin se udhëheqja e tij ishte anti-britanike, anti-amerikane dhe pro-sovjetike. Shërbimet e zbulimit amerikan kishin parasysh deklaratat dhe direktivat e ndryshme të Enver Hoxhës dhënë gjatë luftës, ku mes të tjerash shprehimisht thuhej: “Me sjellje te misionit anglez, këtu ndër neve, ata mundohen me ngjallë e me forcue lëvizjen reaksionare kundër lëvizjes sonë...këta nuk duhen të përzihen në punë te brendshme, nuk duhet në asnjë mënyrë të merren si arbitër ndërmjet nesh dhe reaksionit”.<sup>99</sup> Në vazhdim të direktivës, të nënshkruar nga Enver Hoxha, sugjerohej që “duhet sytë t’i kemi drejt Moskës dhe çdo gjë ta shohim në prizminë luftës që bën Bashkimi Sovjetik...”.<sup>100</sup> Në raport, pasi vlerësohej se, përderisa FNÇ ishte prosovjetike, konstatohej se edhe sikur të përkrahej njohja, nuk do të ekzistonte asnjë lloj sigurimi për të përmirësuar pozitat e FNÇ pa ndihmën e demokracive perëndimore. Prandaj, në raportin e sekretarit për Marrëdhënie me Evropën pranë Departamentit amerikan, të hartuar në fillim të muajit shtator 1944, thuhej se nëse SHBA nuk ndërmerrenin veprime për ta mbrojtur FNÇ, Rusia mund të ndërhynte dhe të aktivizohej. Në këtë kuptim, Sektori për Marrëdhënie me Evropën, në bazë të analizave të përpunuara nga njohës të mirë amerikanë të çështjes shqiptare, i kishte propozuar Stejt-De-partamentit tri mundësi:

1. FNÇ të njëhej si qeveri e përkohshme e territoreve të çliruara të Shqipërisë.
2. FNÇ të njëhej si autoritet i përkohshëm në zonat që ishin nën ndikim dhe kontrollin e tij për një kohë të caktuar.
3. FNÇ të njëhej si qeverie përkohshme për tërë Shqipëri-

---

<sup>99</sup> Direktivë e KQ të PKSH Komiteteve Qarkore të PKSH, AQSH, f. 14.

<sup>100</sup> Po aty.



në.<sup>101</sup>

Në të njëjtën kohë, pra, në fillim të nëntorit të vitit 1944, ambasadori anglez në Uashingtonin formonte Departamentin e Shtetit se: “Qeveria angleze propozon që të mos njihet qeveria e përkohshme që ka formuar Fronti Nacionalçlirimtar”, duke shtuar se: “Ambasada e Anglisë porositi qeverinë e Uashingtonit që edhe ajo të mbajë të njëjtin qëndrim në lidhje me çështjen shqiptare.<sup>102</sup> Qarqet diplomatike anglo-amerikane, qysh gjatë viteve 1943-1944, e kishin paraparë që ngritja eventuale dhe forcimi i LNÇ do të shkaktonte çrregullime dhe përçarje të reja në zhvillimet politike brenda shqiptare dhe si rezultat i atyre luftërave politike mund të ndodhte që në plan të parë të luftës antifashiste të vinte ndonjë parti, e cila do të ishte më e afërt me Rusinë se sa me Anglinë.<sup>103</sup>

Pas fitores kundër nazifashizmit dhe çlirimit të plotë të Shqipërisë, qeveria e përkohshme me në krye Enver Hoxhën, e dalë nga zjarri i luftës, ndër çështjet më të rëndësishme në ditët e para të Shqipërisë së lirë kishte çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare nga ana e aleatëve. Kështu, qysh më 4 janar të vitit 1945, qeveria e përkohshme i ishte drejtuar qeverive të SHBA, Anglisë dhe të Bashkimit Sovjetik, që ta njihnin qeverinë demokratike të Shqipërisë dhe të vendosin marrëdhënie diplomatike me të. Në mes të tjerash, në notën diplomatiketë qeverisë së Shqipërisë, pasi theksohej besnikëriandaj aleancës së madhe anglo-sovjeto-amerikane, shfaqej “vullneti i popullit shqiptar që qeveria demokratike e Shqipërisë të njihet në radhë të parë nga ana e aleatëve të mëdhenj anglo-sovjeto-amerikanë dhe të vendosen marrëdhënie

---

101 NA-USA. 875.01/2814. Raport i dt. 5 tetor 1944.

102 NA-USA. 875.01/11-344. Informatë e Ambasadës së Anglisë në Uashington drejtuar Stejt-Departamentit, 11 janar 1944.

103 Shih, Masar Kodra, Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane 1918-1945, Shkup, 1997, f. 199.

diplomatike në mes të qeverisë Suaj dhe qeverisë sonë".<sup>104</sup> Ndërkohë, para arritjes së çfarëdo përgjigjeje lidhur me notën e qeverisë së Shqipërisë, Misioni ushtarak Britanik, në shkurtmars të vitit 1945, ishte zgjeruar dukshëm në Shqipëri, ndërsa si udhëheqës i tij ishte caktuar gjenerali D.E.R. Hoxhson. Më vonë, edhe amerikanët dërguan në Shqipëri një mision civil të kryesuar nga Xheikobs, për të cilin Enver Hoxha thoshte se kishte ardhur me ndihmën e Herri Fulcit.<sup>105</sup> Sipas kujtimeve të Enver Hoxhës, Hoxhsoni ishte ankuar këtij të fundit se në Shqipëri kishte vetëm një parti, kurse Enver Hoxha i ishte përgjigjur gjeneralit anglez se: "ne nuk kemi nevojë të na ndihmojnë nga jashtë".<sup>106</sup> Kjo sjellje krejtësisht jokooperative e udhëheqësit të atëhershëm të qeverisë së Shqipërisë bëhej pikërisht në kohërat dhe ditët, kur ai vazhdimish tu lutej qeverive perëndimore që ta njihnin qeverinë e tij. Diplomacitë e qeverive të SHBA dhe të Anglisë nuk ndërmoren kurrfarë veprimi që mund të linte të shpresoje se përgjigja lidhur me njohjen eventuale të qeverisë demokratike të Shqipërisë do të mund të ishte pozitive. Koha kalonte dhe në këtë drejtim nuk kishte ndonjë përgjigje diplomatike zyrtare, por jepej të nënkuptohej se qeveritë perëndimore nuk nguteshin dhe ishte e qartëse bënin kombinime e plane të ndryshme. Duke pasur parasysh deklaratimet dhe veprimet jo rrallë kundër-produktive të udhëheqjes së PKSH në raport me aleatët perëndimorë, nuk ishte për t'u befusuar se diplomacitë e qeverive perëndimore e analizonin çështjen shqiptare edhe nga prizmi i rirreshtimeve të reja, jo vetëm mbi bazat e krijimit të rendit të ri botëror, por edhe mbi bazat e orientimeve ideologjike të qeverive që dolën nga lufta dhe kërkonin njohje. Për qeverinë e Enver Hoxhës, e cila, qysh gjatë vitit të fundit të luftës, kishte paralajmëruar një luftë të

---

104 Enver Hoxha, *Vepra 3*, Tiranë, 1969, f. 4-5.

105 Enver Hoxha, *Rreziku anglo-amerikan*, Tiranë, 1982, f. 344-345.

106 Po aty, f. 349.

ftohtë ideologjike të pashpallur ndaj aleatëve anglo-amerikanë, ishte e papriture dhëna se, pikërisht, qeveritë anglo-amerikane nuk ishin të entuziazmuara për ardhjen në frontë qeverisë komuniste të Enver Hoxhës dhe se llogarisnin e shpresonin se ajo qeveri e dalë nga Mbledhja e Beratit në një të afërme jo të largët ndoshta edhe do të përmysej.<sup>107</sup> Në këtë situatë, krejtësisht të pafavorshme për qeverinë demokratike të Shqipërisë, diplomacia perëndimore, në radhë të parë SHBA dhe Anglia, ishin rezervuar në kthimin e menjëhershëm të përgjigjes në adresë të Tiranës zyrtare, duke e lënë çështjen shqiptare “në dosjen e vet të papërfunduar”, duke mos e njohur qeverinë shqiptare të zgjedhur në Berat (22 tetor 1944).<sup>108</sup> Kjo mund të kuptohej edhe nga raporti i Departamentit të Shtetit, hartuar në maj të vitit 1945, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverisë së Shqipërisë që një komision financiar-ushtarak shqiptar të vizitonte SHBA. Përgjigja e qeveritarëve amerikanë dërguar Tiranës zyrtare ishte e drejtpërdrejt dhe e prerë: “Nuk e shohim të arsyeshme që përfaqësues ushtarakë shqiptarë të vizitojnë SHBA...derisa të mos arrihet marrëveshja ndërmjet fuqive (shteteve) kryesore të koalicionit rreth çështjes shqiptare”.<sup>109</sup> Pra, edhe pse qeveria amerikane kishte konfirmuar se ndjente konsideratë ndaj Shqipërisë, të cilën e konsideronte si viktimë të agresionit, ajo mbante qëndrimin se “derisatë mosarrihet marrëveshja ndërmjet fuqive kryesore të koalicionit rreth “çështjes shqiptare” nuk do të njihet zyrtarisht qeveria shqiptare”.<sup>110</sup> Përkundër luftës së ftohtë diplomatike midis qeverive anglo-amerikane dhe asaj shqiptare, kjo e fundit ende e panjohur de jure nga asnjë qeveri e Fuqive të Mëdha, zyrtarët e diplomacisë amerikane vazhdonin të përcillnin me kujdes të madh

107 Shih: Masar Kodra, vep. e cit., f. 203.

108 Po aty, f. 204.

109 NA-USA. 875.01/12-2044. Udhëzim i Stejt-Departamentit dërguar Komandës së forcave ushtarake amerikane me seli në Kazertë të Italisë, 15 janar 1945.

110 Po aty.

zhvillimet e ndërlikuara rreth çështjes shqiptare. Në prill të vitit 1945, një zyrtar amerikan kishte vizituar Shqipërinë dhe me këtë rast kishte përgatitur një raport të gjerë me përshtypjete tij nga kjo vizitë. Raporti, i cili përmbante vlerësimete tij lidhur me gjendjen në Shqipërinë lëmin e fushës ekonomike-shoqërore e politike, i ishte dërguar për analizë Zyrës strategjike pranë Stejt-Departamentit. Në maj të vitit 1945, edhe grupi amerikan që gjendej në Shqipëri kishte përgatitur një raport, lidhur me situatën ekonomike-shoqërore e politike, dhe me atë rast kishte potencuar se: “Popullsia e Korçës...pas çlirimit përcillte me interesim të madh përpjekjet e qeverisë së Tiranës për të vendosur marrëdhënie me SHBA, Anglinë dhe BRSS”.<sup>111</sup> Pasi potencojë ndjenja pro-amerikane e banorëve të Korçës, autorët kishin nënvizuar se qeveria shqiptare po bënte çdo gjë për të minimizuar influencën anglo-amerikane dhe për të afirmuar ndikimin rus dhe atë jugosllav.<sup>112</sup> Në këtë kontekst, lidhur me notën diplomatike të Tiranës, ministri i Punëve të Jashtme të SHBA, do të dërgonte për vëzhgim një diplomat amerikan. Më 8 majtë vitit 1945, në Shqipëri erdhi një komision jozyrtar i kryesuar nga Joseph Jacobs. Vizita e këtij delegacioni të lartë amerikan kishte për qëllim njohjen e rrethanave konkrete në Shqipëri, parase qeveria amerikane të shqyrtonte kërkesën e autoriteteve shqiptare për njohje. Gjatë qëndrimit në Tiranë, diplomatin amerikan e kishte pranuar edhe Enver Hoxha, i cili në kujtimet e veta shkruante: “Që në fillim më foli për arsyet e ardhjes së misionit dhe të zgjatjes së kohës së njohjes së qeverisë demokratike të Shqipërisë... Shpjegimet që më bëtë rreth misionit tuaj dhe shtytjes së njohjes së qeverisë sonë, zoti Xheikobs, na duken jobindëse. Formula juaj se “njohja duhet të

---

111 NA-USA. 875.01/10-744 (II). Raport i grupit amerikan në Shqipëri dërguar Zyrës së shërbimit strategjik dhe degës së punëve kërkimore të Stejt-Departamentit, Tiranë, 6 maj 1945.

112 Po aty.

vijë mbas sqarimit të gjendjes në Shqipëri” është absurde”.<sup>113</sup> Enver Hoxha kishte mbetur këmbëngulës në qëndrimin se njohja duhej të ishte rezultat i luftës që populli shqiptar kishte zhvilluar kundër nazifashistëve e jo të pranoheshin kushtëzimet lidhur merregullimin kushtetues-juridik dhe sistemin politik e ideologjik të shtetit të ri shqiptar.<sup>114</sup> Pas shqyrtimit të raportit të këtij komisioni jozyrtar, qeveria amerikane, përmes përfaqësuesit të saj në Tiranë, i kishte dorëzuar Enver Hoxhës notën diplomatike lidhur me çështjen e njohjes së qeverisë së tij. Qeveria amerikane decidivisht kërkonte: “Siguri që zgjedhjet ardhshme për Asamblenë Kombëtare të mbaheshin në baza të vërteta dhe të lira, me vota të fshehta dhe pa kërcënime...që korrespondentëve të huaj t’u lejohej hyrja në Shqipëri për të përcjellë dhe raportuar lirisht zgjedhjet dhe punën e Asamblesë Kushtetuese. Qeveria e SHBA dëshironte gjithashtu që autoritet shqiptare të miratonin mbajtjen në fuqi të traktateve dhe marrëveshjeve që ishin nënshkruar midis SHBA dhe Shqipërisë deri më 7 prill 1939”.<sup>115</sup> Enver Hoxha, duke interpretuar pikërisht detajin e bisedës me diplomatin Joseph Jacobs, rreth çështjes së rishikimit të marrëveshjeve politike e ekonomike shqiptaro-amerikane që nga koha e Zogut, në kujtimet e tij shkruante se diplomati amerikan i ishte drejtuar me fjalët: “Në dokumentet që keni publikuar thuhet se do të rishikoni të gjitha marrëveshjet politike, ekonomike e ushtarake që ka pasur mbreti Zog me shtetet e tjera dhe do t’i prishni të gjitha. A nënkuptoni me këtë edhe ato me qeverinë amerikane?”.<sup>116</sup> Enver Hoxha shkruante se përgjigja e tij e shkurtër dhe e padiskutueshme ishte “po”. Qeveria shqiptare, pa u hamendur dhe pa i shqyrtuar pasojat e veprimeve të tilla të gabuara diplomatike, i kishte shpallur publikisht të

113 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 354.

114 Po aty.

115 Shih: Masar Kodra, vep. e cit., f. 212.

116 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 358.

papranueshme kushtet e qeverisë amerikane për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis dyshteteve, duke i kualifikuar si ndërhyrje imperialiste të shtetit amerikan dhe cenim të integritetit sovranitetit territorial dhe kushtetues-juridik të Shqipërisë. Përpjekjet përvendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis SHBA dhe Shqipërisë mbeten të ngrira. Disa autorë shqiptarë mosnjohjen e qeverisë shqiptare e ndërlihdnin ekskluzivisht meqëndrimin e vendosur për të mos pranuar nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, pra edhe me SHBA, nga frika se do të cenohej sovraniteti i Shqipërisë.<sup>117</sup> Rrjedhimisht, sipas një vlerësimi të tillë, do të mund të konsiderohej që edhe njohja e qeverisë shqiptare nga ajo jugosllave, e më pas edhe ajo sovjetike, cenonte integritetin territorial të Shqipërisë. Përkundrazi, ato njohje ndër-shtetërore e ndërqeveritare u bënë me një eufori nga ana e qeverisë së Enver Hoxhës. Pavarësisht fërkimeve ideologjike midis qeverisë së Tiranës dhe asaj amerikane e angleze, njohja e qeverisë shqiptare ishte dashur të realizohej edhe nga prizmi i detyrimit moral i SHBA dhe Anglisë, si anëtare të Koalicionit Antifashist. Për një njohje të tillë, të dyja këto qeveri perëndimore i obligonte edhe deklarata e vitit 1942, me të cilën ato ishin angazhuar se do të respektonin integritetin dhe sovranitetin e shtetit shqiptar, pavarësisht qeverisjes dhe rregullimit të ri shtetëror të dalë nga lufta.

Mosnjohja e qeverisë shqiptare nga ana e qeverive perëndimore, në radhë të parë nga ato amerikane e angleze, kishte brengosur edhe komunitetin shqiptar që jetonte përtej Atlantikut, i cili nuk mund të qëndronte i paangazhuar politikisht e kombëtarisht. Në këtë drejtim, duhet veçuar angazhimi i Fan S. Nolit, i cili, në vitet e para të stuhishme të pasluftës, dëshmoi përkujdesje të jashtëzakonshme përnjohjen e qeverisë shqiptare nga ana e SHBA, si dhe përpjekjen për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shqipërisë dhe

117 Shih: Masar Kodra, vep. e cit., f. 212.

Uashingtonit. Në telegramin dërguar presidentit Ruzvelt, në emër të Sinodit të kishës Ortodokse shqiptare të Amerikës, në shkurt të vitit 1945, Fan S. Noli i bënte thirrje kryetarit amerikan që: “Së pari, të njihni zyrtarisht qeverinëshqiptare të Tiranës

...Së dyti, të lejoni t’u dërgohen ilaçe, veshmbathje dhe ushqime popullit shqiptar që po vuan nga uria, nga mungesa e barnave dhe nga sëmundjet për pesë vjet, qysh të Premtene Zezë 1939. Së treti, të hapen marrëdhëniet postar edhe telegrafike, kështu që shqiptarët e Shteteve të Bashkuara të dërgojnë të hollapër të ndihmuartë afërmit dhe miqtë e tyre”.<sup>118</sup> Noli, më 3 mars 1945, u dërgoi një telegram kryetarëve të SHBA, Anglisë dhe BRSS, ku kërkonte që Shqipëria të ftohej si pjesëmarrëse e barabartë në Konferencën e San Franciskos, më 25 prill 1944.<sup>119</sup>

Në lidhje me kërkesën e qeverisë shqiptare për njohje reciproke dhe rivendos jetë marrëdhënieve diplomatike me SHBA, Anglinë dhe BRSS, së pari u prononcua ministri i Punëve të Jashtme të Anglisë, Iden, i cili, para anëtarëve të parlamentit anglez, kishte theksuar: “Gjendja në Shqipëri nuk është krejtësishte qartë në mënyrë që të arsyetohet njohja e administratës së tillë si qeveri”.<sup>120</sup> Derisa përfaqësuesi i ministrisë së Punëve të Jashtme të SHBA kishte deklaruar se së shpejti do të dërgonte në Shqipërinjë përfaqësues për të rishikuar situatën në vend dhe për t’u njoftuar me qëndrimin e zyrtarëve shqiptarë, BRSS në notën diplomatike, dërguar në prill të vitit 1945 në adresë të qeverisë së Shqipërisë, shprehte gatishmërinë që në Shqipëri të dërgonte një mision ushtaraksovjetik.<sup>121</sup> Në pjesën e parë të vitit 1945, në

---

118 Cituar sipas Behar Shtylla, Fan Noli, siç e kam njohur, Tiranë, 1997, f. 130. 119 Po aty, f. 131.

120 Arkivi diplomatik i Sekretariatit të punëve të Jashtme të Jugosllavisë (në tekstin e mëtejshëm: ADSPJ), Shqipëria (në tekstin e më-tutjeshëm: A), 1945, nr. 8, Fondi, nr. 245, “Pozita e jashtme e Shqipërisë”.

121 Bogumilj Hrabak, Medjunarodni položaj Alabanije 1945-1947 i Jugoslavi-

Shqipëri erdhën përfaqësuesit diplomatikë e ata të misioneve ushtarake të Anglisë (21 mars), SHBA (maj) dhe të BRSS (qershor). Misionin ushtarak anglez, të përbërë nga 38 oficerë, nënoficerë dhe ushtarë, e udhëhiqte gjenerali Hoxhson. Sipas raporteve të misionarëve jugosllavë, oficerëve anglezë gjatë qëndrimit në Shqipëri u interesonte çështja e Kosovës, me qëllim që të shkaktonin mosmarrëveshje deri edhe përleshje në mes të Shqipërisë se re dhe Jugosllavisë së re.<sup>122</sup> Përfaqësuesi i ish-RFPJ në Tiranë, Velimir Stojniçi, në një raport dërguar Beogradit në qershor të vitit 1945, mes të tjerash, shkruante: “Gjenerali Hoxhson çuditej pse qeveria shqiptare deri më sot nuk ka dhënë kurrfarë deklarate mbi qëndrimin e saj ndaj Kosovës dhe Metohisë...Gjithashtu (Hoxhson-A.Z) u ka deklaruar se Kosova dhe Metohia kanë një rëndësi më të madhe për Shqipërinë se sa Epiri Verior. Në të gjitha paraqitje te tij shihet se anglezët në Shqipëri përpiqen që ndër masa të zgjojnë çështjen e Kosovës dhe të Metohisë dhe që masat këtë çështje ta shtrojnë si kërkesë dhenë këtë mënyrë të lëkundet miqësia dhe marrëdhëniet në mes të Jugosllavisë dhe Shqipërisë”<sup>123</sup>.

Në prag të mbajtjes së Konferencës së San-Franciskos (që i zhvilloi punimet më 25 prill-26 qershor 1945), Enver Hoxha iu drejtua përsëri kryeministrit Çerçill, marshallit Stalin dhe kryetarit Ruzvelt me kërkesën që Shqipërisë t’i mundësohej pjesëmarrja në këtë konferencë, e cila aprovoi Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Enver Hoxha, në këtë kërkesë rikujtontefaktin se: “Ndër shtetet që kanë luftuar krah për krah me shtetet aleate për të mposhtur Gjermaninë hitleriane, Shqipëria zë një vend të rëndësishëm për hir të luftës së pareshtur që ka bërë kundër armikut të përbashkët dhe për hir të sukseseve që kanë kurorëzuar përpjekjet dhe

ja, Istraživanje nr. 13, f. 250, Novi Sad, 1990.

122 Vladimir Dedijer, Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1945-1948, Beograd, 1949, f. 134.

123 ASHSPJ, A. 1945, nr. 8, fondi 2, nr. 2455 (V.Stojniçi).



sakrificat e saja të panumërta".<sup>124</sup> Këshilltari politik i SHBA në Kazertë, përmes Misionit amerikan, i ishte përgjigjur Enver Hoxhës: "... Konferenca e San-Franciskos (A.Z) do të trajtojë vetëm problemet e organizimit ndërkombëtar dhe se në asnjë rast nuk do të kryejë funksionin ose do të ketë karaktertë konferencës paqësoreku do të vihen në rend dite çështjet territoriale, çështja e pakicave, dëmshpërblimet ose çështje tjera".<sup>125</sup> Megjithatë, ai i shpreh kryeministrit shqiptar konsiderata për sakrificat e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore: "Kryetari dhe i tërë populli i SHBA e di fare mirë se në ç'mënyrë të pathyeshme patriotët shqiptarë me sukses i arritën synimet e veta kundër agresionit armiqësor...dhe se qeveria e SHBA sinqerisht shpreson se Shqipëria shpejt do të zërë vendin, i cili i takon në bashkësinë e kombeve".<sup>126</sup> Enver Hoxha, i bindur se një përgjigje e tillë nuk kishte ndonjë prapaskenë diplomatike, i kishte dërguar një notë kryetarit të Konferencës në San-Francisko, duke i uruar punë të mbarë dhe sukses punime vetë kësaj konference ndërkombëtare. Derinë muajin prilltë vitit 1945, qeveria shqiptare nuk kishte pasur ndonjë marrëdhënie të veçantë dhe të rëndësishme me strukturat e diplomacisë ndërkombëtare, përveç një note diplomatike, e dërguar nga ana e Enver Hoxhës në adresë të Trumanit, Stalinit dhe Çerçillit, me të cilën kryeministri komunist shqiptar në emër të qeverisë që drejtonte kërkonte dorëzimin e kriminelëve shqiptarë të luftës, të cilët kishin emigruar në Itali dhe për vendqëndrimin e të cilëve aleatët perëndimorë kishin informacione.

Më 11 prill 1945, qeveria shqiptare ishte në marrëveshje veprimi të përbashkët me organizatën e quajtur "Military Liaison"(ML), e krijuar nga aleatët perëndimorë për të ndihmuar vendet e Ballkanit. Kjo organizatë, e cila parashihej që

---

124 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 18.

125 Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 251.

126 Po aty.

të vepronte dy muajnë Shqipëri, derisa të mos funksiononte UNRRA, sipas Enver Hoxhës, për t'i dhënë ndihmë popullit shqiptar kishte vënë dy kushte: "...të sillen 1500-1700 oficerë specialistë' për ta shpërndarë' dhe të ngriheshin qendra të ML në të gjitha portet tona".<sup>127</sup> UNRRA, (UNITED NATIONS REIEF AND REHA-BILITATION ADMINISTRATIONS), Administratë e OKB për Ndihmë e Rimëkëmbje, e krijuar më 9 nëntor 1943 në Uashington, ishte organizatë, me të cilën shtetet antifashiste projektuan bashkëpunimin e tyre për rimëkëmbjen ekonomike të vendeve të dëmtuara nga shkatërrimet, gjatë Luftës së Dytë Botërore. Qeveria e Shqipërisë, në janar të vitit 1945, kishte marrë vendim për të ftuar zyrtarisht UNRRA në Shqipëri, misioni i së cilës për Shqipërinë ishte ngritur që në gusht të vitit 1944, me kryetar të saj të parë amerikanin Dudley Haskel.<sup>128</sup> Qysh gjatë luftës, projektet e UNRRApër të ndihmuar Shqipërinë e sapo çliruar u ishin bërë të njohura udhëheqësve të PKSH, ndërsa vetë qeveria shqiptare komunikimin me UNRRA dhe ndihmat që do të vinin nga ajo i shihte edhe si një mjet dhe mënyrë të favorshme për daljen e saj të efektshme në arenën ndërkom-bëtare. Nga ana tjetër, Enver Hoxha, i cili, dy herë radhazi në ditët e para të janarit 1945, kishte kundërshtuar që shpërndarja e ndihmave të ML të bëhej nga ushtarakët e saj,<sup>129</sup> megjithatë ishte i predispozuar që UNRRA, si organizatë civile, të shpërndante ndihma në Shqipëri. Enver Hoxha e konsideronte UNRRA si një organizatë të dyshimtë dhe e cilësonte atë si "organizatë anglo-amerikane që ka për qëllim të ndihmojë shtetet që janë të shkatërruara nga fashizmi".<sup>130</sup> Mirëpo, Enver Hoxha, i cili në ato kohë ishte nën ndikimin e thellë të jugosllavëve dhe të rusëve, duke u nisur nga shembulli dhe

127 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 352.

128 AQSH, Fondi 890, viti 1945, dos. 2, fl. 11, janar 1945.

129 Shih, W. Bland, I. Price, A TANGLEB WEB, A History of Anglo-American Relations with Albania 1912-1955, London, 1986, p. 115.

130 AQSH, Fondi 890, viti 1945, dos. 2, fl. 11.

udhëzimet e Titos, kishte propozuar që ndihmat e UNRRA të pranoheshin, por me kusht që ato të shpërndaheshin nga vetë qeveria shqiptare, ç'ka realisht paralajmëronte faktin se UNRRA do të ishte gjatë gjithë qëndrimit në Shqipëri e mbikëqyrur dhe e dyshimtë. Më 24 mars të vitit 1945, Enver Hoxha i drejtohej me shkrim zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të UNRRA, F. Hendrickson, dhe theksonte se e pranonte propozimin që përfaqësuesit e organizatës UNRRA të vinin për bisedime në Tiranë.<sup>131</sup> Ndërkohë, drejtori i përgjithshëm i UNRRA, Herbert Lihman, kishte autorizuar personalisht F. Hendricksonin që të hynte në bisedime me palën shqiptare për të gjetur mënyrat më të përshtatshme për dhënien e ndihmave të drejtpërdrejta.<sup>132</sup> Marrëveshja e hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze saktësonte mjaft çështje të rëndësishme dhe, në mes të tjerash, decidivisht parashihte: "Qeveritë amerikane e angleze theksojnë se do të kujdesen që sa më shpejt të jetë e mundur ta zëvendësojnë Lidhjen Ushtarake Shqiptare (ML) për Shqipërinë me UNRRA dhe Lidhja Ushtarake Shqiptare do të tërhiqet sapo UNRRA të jetë në gjendje të kryejë misionin e vet. Kjo periudhë nuk duhet t'i kapërcejë afërsisht 2 muaj".<sup>133</sup> Më 2 maj 1945, mbërritinë Tiranë misioni i UNRRA i kryesuar nga koloneli Oakley Hill, të cilin e kishte pranuar pas një pritjeje dyjavëshe Enver Hoxha. Në këtë takim, Enver Hoxha kishte kundërshtuar lejimin e personelit të ML që të qëndronte për t'i ndihmuar UNRRA, shpërndarjen e ndihmave në Shqipëri nga personeli i UNRRA dhe nuk pranoi që të firmoste marrëveshjen si Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare<sup>134</sup>. Madje, Enver Hoxha i kishte thënë kolonelit Hillse: "gjithë personeli i ML duhet të largohet".<sup>135</sup> Këtë qën-

131 AQSH, Fondi 890, viti 1945, dos. 107, fl. 25.

132 AQSH, Fondi 890, viti 1945, dos. 107, fl. 26.

133 AQSH, Fondi 89, viti 1945, dos. 7, fl. 5.

134 W. Bland, I. Price, vep. e cit., f. 122.

135 Shih: Enver Hoxha, vep. e cit., f. 354.

drim, Enver Hoxha, e kishte mbajture dhe gjatë takimit me J. E. Jacobs, shefine misionit civil amerikan në Shqipëri.<sup>136</sup> Natyrisht, qëndrimi i rreptë dhe mospërfillës i Enver Hoxhës kishte indinjuar diplomatët anglo-amerikanë. Ivor Pink, diplomat i atëhershëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Britanisë, ishte shprehur: “Më duket e padiskutueshme që një turmë brigandësh komunistë shqiptarë, të cilëve u ofrojmë ndihma falas pa paguar një grosh, të kenë paturpësitë thonë se do ta pranojnë ndihmën tonë sipas kushteve të tyre”.<sup>137</sup> Megjithatë, marrëveshja me UNRRA u nënshkrua më 1 gusht të vitit 1945, nga Enver Hoxha, kryeministër, dhe Dayrell R. Oakley Hill, kryetari misionit të UNRRA.<sup>138</sup> Marrëveshja nuk kishte precizuar se me cilën datë përfundonte, por shënontese ajo do të mbetej në fuqi dhe gjashtë muaj pas lajmërimit me shkrim për ndërprerjen e saj nga njëra ose të dyja palët nënshkruese. Misioni i UNRRA u vendos në Tiranë më 7 gusht të vitit 1945, kurse furnizimet e para mbërritën në fund të muajit gusht. Deri në fund të nëntorit, UNRRA në Shqipëri kishte sjellë mijëra tonë furnizime, kurse më 1 dhjetor të po këtij viti, Komisioni Ndërministror u njoh me programin për ndihmë Shqipërisë që parashihte, përveç 5000 dollarë që ishin për shpenzimet e transportit, edhe 25.000.000 dollarë amerikanë. Meqenëse Komisioni Ndërministror kishte dhënë vërejtje, duke e cilësuar të vogël programin shqiptar, në janar të vitit 1946, qeveria shqiptare u njoh me shtesën prej 3,5 milionë dollarë që iu bë fondit për financimin e programit shqiptar. Mosmarrëveshjet e para të autoriteteve të UNRRA me ato shqiptare u paraqitën në janar të vitit 1946, kur në një takim me anëtarët e Komisionit Ndër ministror për furnizimet nga UNRRA, anglezi Hill kishte kritikuar rreptë qeverinë shqiptare. Kritika e tij konsistonte në shkrimet nihiliste të

---

136 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 354-357. .

137 W. Bland, I. Price, vep. e cit., f. 122

138 AQSH, Fondi 890, viti 1945, dos. 132, fl. 3.

gazetës “Bashkimi”, lidhur me mosrealizimin e planit të furnizimeve nga UNRRA për Shqipërinë gjatë gjashtë muajve të fundit të vitit 1945.<sup>139</sup> Në të njëjtën periudhë, gazeta “Bashkimi” vlerësonte lart “ndihmat e mëdha” jugosllave e sovjetike dhe ky mbivlerësim bëhej në një kohë kur, tregtarët jugosllavë po e zbraznin Shqipërinë nga rezervate pasluftës. Megjithatë, Oakley Hill në një takim që zhvilloi me Enver Hoxhën, në janar të vitit 1946, i kishte dhënë kryeministrit shqiptar disa propozime të vlefshme, prej të cilave qeveria shqiptare mund të përfitonte edhe më tepër ndihma. Këto propozime ishin edhe më domethënëse, sepse i hapnin rrugë të reja shtetit shqiptar për t’u lidhur me Perëndimin. Mirëpo, UNRRA shihej nga vetë qeveria shqiptare me sy dyshimi. Këtë syrvejm të qeverisë shqiptare e ndjenin edhe vetë drejtuesit e UNRRA, prandaj edhe nuk mungonin reagimet e tyre të hapura. Kështu P.C. Floud, njëri nga ish-kryetarët e misionit të UNRRA në Shqipëri, shkruante: “Në sytë e qeverisë shqiptare, nuk mund të kishte pasur asnjë britanik apo amerikan, historia e të cilit nuk vihej në pikëpyetje”.<sup>140</sup> Në vitin 1946, ndodhi pakësimi i fondit të UNRRA për Shqipërinë në masën 6,4%. Ky pakësim i ndjeshëm i fondit nuk përjashtohet të ishte bërë edhe me motive politike, ngaqë marrëdhëniet e qeverisë shqiptare me qeveritë amerikane dhe angleze ishin të këqija dhe çuan në largimin e misioneve të tyre nga Shqipëria. Madje, në muajt nëntor-dhjetor të vitit 1946, edhe marrëdhëniet midis Misionit të UNRRA në Shqipëri dhe qeverisë shqiptare ishin ftohur, sepse qeveria e Tiranës kërkonte largimin e dy specialistëve të UNRRA, duke i akuzuar se ata ishin përfshirë në procesin e kënetës së Maliqit. Si shkas i këtyre acarimeve dhe mosmarrëveshjeve, UNRRA i ndërpreu ndihmat për Shqipërinë, për një muaj

---

139 AQSH, Fondi 164, viti 1946, dos. 54, fl. 14.

140 W. Bland, I. Price, vep. e cit., f. 125.

rresht.<sup>141</sup> Më 18 qershor të vitit 1947, Misioni i UNRRA i bëri të ditur Enver Hoxhës se, më 30 qershor, do ta ndërpriste veprimtarinë e tij në Shqipëri dhe se një hap i tillë nuk kishte prapavijë politike, por mbështetej në vendimet e Këshillit të UNRRA dhe në marrëveshjene firmosur më 1 gusht të vitit 1945. Në janar të vitit 1947, Misioni i UNRRA në Tiranë kishte njoftuar Komisionin Ndërministror se disa artikuj mund t'u dorëzoheshin shteteve marrëse pasi të ishin larguar misionet, meqenëse këta artikuj duheshin blerë në SHBA, Kanada, Britani të Madhe e Itali, vende këto, metë cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike. UNRRA i propozonte qeverisë shqiptare që të autorizonte qeverinë jugosllave për të hyrë në bisedime në emër të Shqipërisë rreth këtyre transakcioneve me shtetetet përmendura. Ky veprim i drejtuesve të UNRRA u bë duke pasur parasysh marrëdhëniet e ngushta të bashkëpunimit ndërshtetëror midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. UNRRA, ndërkaq, garantonte pagesën e mallrave të prapambetura. Qeveria shqiptare e kishte miratuar këtë propozim pa asnjë kundërshtim dhe më 24 shkurt të vitit 1947, edhe qeveria jugosllave shprehu pajtueshmërinë e saj.<sup>142</sup> Qeveria jugosllave nuk shihte asgjë të keqe në këtë ndërmjetësim. Përkundrazi, tërheqjen e ndihmave të vonuara për të plotësuar programin shqiptar ajo e shihte si çështje tregtie dhe mundësi për të fituar. Mirëpo, në korrik të vitit 1947, i ngarkuari jugosllav për tërheqjen e ndihmave (dr. Bozho Boroviç) për Shqipërinë nga Trieshta nuk kishte pranuar të nënshkruante marrjen e tyre në dorëzim, sepse ato ishin ngarkuar me një anije jojugosllave. UNRRA kishte reaguar menjëherë në adresë të qeverisë shqiptare, duke i bërë të ditur se nuk kishte vepruar drejt kur ishte marrë vesh me qeverinë jugosllave që ndihmat të barteshin, transportoheshin për në Shqipëri vetëm me anije jugosllave dhe se këtë për-

---

141 W. Bland, I. Price, vep. e cit., f. 128.

142 "Bashkimi", 25 janar 1947, f. 7.

vendim UNRRA nuk kishte pasur dijeni. Përgjithësisht, programi i ndihmave nga UNRRA për Shqipërinë, pas largimit të misionit nga Tirana, hyri në fazën e tij të fundit, kurse mosmarrëveshjet midis qeverisë shqiptare dhe Misionit të UNRRA ishin në thellim e sipër. Duhet thënë se, furnizimet e UNRRA në vitet të para të vështira të pasluftës ishin jashtëzakonisht të vlefshme për shtetin shqiptar dhe i kishin dhënë një shtytje rimëkëmbjes ekonomike e sociale të shoqërisë shqiptare në vitet 1945-1947.

Kryeministrin shqiptar e mbante shpresa se kërkesat e tij drejtuar diplomacive perëndimore, në radhë të parë aleatëve anglo-amerikanë, do të hasnin në përkrahje dhe miratim rreth njohjes së qeverisë shqiptare. Mirëpo, shtrëngata diplomatike sa vinte e bëhej më e papërballueshme. Enver Hoxha dhe qeveria e tij, me të drejtë, ndiheshin të shqetësuar për mosnjohjen ndërkombëtare të qeverisë së përkohshme dhe për këtë izolim institucional e të organizuar ndërkombëtar. Nga ana tjetër, në pranverën e vitit 1945, vazhdimisht, në formë presioni dhe të një lufte propagandistike, përsëriteshin thashethemet se Britania e Madhe po përgatiste kthimin mbretit Zog. Me këtë propagandë të perëndimorëve, që kishin për qëllim krijimin e një situatë konfuze rreth Shqipërisë, ishte i shqetësuar edhe Tito, i cili Shqipërinë e shihte si pjesë të konfederatës së ardhshme ballkanike dhe njëherit provincë jugosllave. Tito, duke përcjellë me vëmendje zhvillimet kundërtënëse rreth njohjes apo mosnjohjes së qeverisë shqiptare, kishte vendosur të njihte qeverinë e Tiranës. Kështu, Jugosllavia ishte shteti i parë që e njohu Shqipërinë. Tito e theu akullin më 29 prill të vitit 1945. "Borba" beogradase kishte njoftuar se: "Qeveria jugosllave ka vendosur të njohë qeverinë e Hoxhës, si dhe t'i vendosë marrëdhëniet diplomatike".<sup>143</sup> Politika e jashtme e Shqipërisë, në periudhën e viteve 1945-1948, ishte e determinuar në masë të kon-

143 Bernard Tonnes, vep. e cit., f. 482.

sideruar nga ndikimet e ndërhyrjeve, thujtse të barabartatë jugosllavëve dhe të sovjetikëve. Disa historianë shqiptarë mendojnë: "Beogradi ka qenë i autorizuar nga Moska që të kryente edhe rolin e kujdestarit ndaj Shqipërisë, duke i njohur edhe disa përparësi në këtë vend. Por, duke i dhënë këtë status, Bashkimi Sovjetik nuk i kishte dhënë liri të plotë veprimi Jugosllavisë".<sup>144</sup>

Studiues të shumtë me të drejtë konstatojnë se pozita e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, në vitet 1945-1948, nuk mund të ketë pasqyrë të qartë nëse nuk merren në shqyrtim edhe relacionet e diplomacisë sovjetike karshi çështjes shqiptare, përkatësisht relacionet e diplomacisë sovjetike me ato të diplomacisë shqiptare në vitet e përmendura. Në këtë kontekst, duhet përkujtuar se interesi sovjetik për Shqipërinë kishte qenë historikisht më i hershëm dhe gjithnjë në funksion të njohjes së zonës periferike të kontaktit me perandoritë ose Fuqitë e Mëdha që e kontrollonin hapësirën shqiptare. Megjithatë, në kornizat e politikës ruso-sovjetike në Ballkan, deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria ishte në periferi të diplomacisë së Kremlinit. Moska kishte vendosur të dërgonte në Shqipëri një përfaqësues të Misionit Ushtarak në çastin kur në Evropën Juglindore, pra edhe në shtetin shqiptar, po zhvilloheshin operacionet e fundit ushtarake, luftarake dhe kur ishte e qartë se ardhja e komunistëve shqiptarë në krye të shtetit ishte e paevitueshme. Kështu, në gusht të vitit 1944, pranë Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare ishte vendosur majori Ivanov, (i kontrolluar nga drejtorja e zbulimit të Ushtrisë Sovjetike), për të cilin, Enver Hoxha në kujtimet e tij shkruante se nuk ishte i aftë dhe nuk e kuptonte situatën në Shqipëri. Historiografia shqiptare, por edhe vetë Enver Hoxha, në disa raste kanë mbajtur qëndrimin, sipas të cilit sovjetikët nuk treguan

---

144 Paskal Milo, Bashkimi Sovjetik dhe politika e jashtme e Shqipërisë në vitet 1944-1946, Studime historike I-IV, Tiranë, 1997, f. 43.



ndonjë interesim të veçantë për zhvillimet në Shqipëri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, mirëpo zhvillimet gjatë vitevetë parapas luftës dëshmuar se nuk qëndronte një konstatimi tillë politik. Ç'është e vërteta, në arkivat ruse të Ministrisë së Punëve të Jashtme, por edhe në ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, nuk ka shumë dokumente e burime të karakterit diplomatik për të dëshmuar shkallën dhe gjerësinë e këtyre marrëdhënieve diplomatike midis Tiranës dhe Moskës. Megjithatë, në ato pak dokumente, shënime dhe analiza për nevojat e brendshme të diplomacisë sovjetike, shihet qartë se “ndihej ndrojtja dhe mosbesimi ndaj qeverisë shqiptare, si dhe kujdesi për të ecur me një hap me anglezët dhe me amerikanët për njohjen e saj”. Qasjet e diplomacisë sovjetike ndaj çështjes shqiptare mund të vlerësoheshin të kujdesshme, të matura dhe gjithnjë duke pasur parasysh aktivitetin e misioneve perëndimore, që në ato vite vepronin në Shqipëri. Marrëdhëniet e udhëheqjes së PKSH me përfaqësuesit e Misionit Ushtarak Sovjetik cilësoheshin nga diplomati amerikan në Tiranë, Xheikobs, të kishin mbetur enigmë, madje edhe pas bisedimeve me Enver Hoxhën: “Një nga enigmat e situatës është qëndrimi i BRSS, i cili nuk e ka deklaruar politikën e tij që nga deklarata e Molotovit, në dhjetor të vitit 1942”.<sup>145</sup> Ndërkohë, pas hapjes së Misionit Diplomatik sovjetik në Tiranë, në dhjetortë vitit 1945, u shtua interesimi sovjetik për zhvillimet në Shqipëri, si dhe u hapën portat e ndikimit më të drejtpërdrejtë të diplomacisë së Kremlinit ndaj politikës shqiptare. Në vitin 1946, Moska ishte përgatitur mirë për të fituar hapësirë të re në fushën e marrëdhënieve diplomatike me shtetin shqiptar. Orientimet programore të politikës sovjetike karshi çështjes shqiptare ishin përpiluar në formë të 12 pikave në një dokument të titulluar “Detyrat dhe synimet e Misionit Diplomatik të BRSS në Shqipëri”. Në të njëjtën periudhë, edhe Ministria e Pu-

145 Shih: Po aty, f. 48.

nëve të Jashtme e BRSS, nën drejtimin e Molotovit, kishte hartuar një dokument në formë projektme titull: "Porosi Ambasadorit të BRSS në Shqipëri".<sup>146</sup> Në porosinë që Moskë i dërgonte në Tiranë të dërguarit të jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i BRSS në Shqipëri, D.S.Çuvahinit, pasi theksohej se qeveria amerikane dhe ajo angleze po shfaqnin interesim për të vendosur marrëdhënie diplomatike me qeverinë shqiptare, nënvizohej: "Kohët e fundit, në qarqet qeveritare shqiptare janë shfaqur ndjenja anti jugosllave dhe nga shtypi shqiptar janë injoruar materialet sovjetike. Këto veprime mendohet se janë bërë në ndikimin e qartë të SHBA dhe Britanisë së Madhe ndaj qeverisë shqiptare".<sup>147</sup> Një ndër pikat e rëndësishme të veprimit të misionit sovjetik në Tiranë ishte shqyrtimi i kërkesës shqiptare për bashkëpunim ekonomik me BRSS. Në lidhje me këtë, ambasadori Çuvahin porositej se forcimi i ndikimit në Shqipëri mund të realizohej, para së gjithash, përmes linjës ekonomike, që nënkuptonte se duhej shqyrtuar mundësia e bashkëpunimit ekonomik midis BRSS dhe Shqipërisë në formën e marrëveshjes ekonomike sovjeto-shqiptare. Në udhëzimet drejtuar Çuvahinit thuhej se: "Kjo marrëveshje do të parashikonte krijimin e shoqërive të përbashkëta shqiptaro-sovjetike për përpunimin e mineraleve të kromit, nxjerrjen e naftës, shfrytëzimin e linjave ajrore, përdorimin e porteve shqiptare etj".<sup>148</sup> Ambasadorit rus në Tiranë i vinin porosi nga Moskë, lidhur me qëndrimin që duhej të mbante Misioni Sovjetik në marrëdhëniet diplomatike me Enver Hoxhën. Dihej se, Enver Hoxha, në disa raste, në vitin 1945, kishte shtruar kërkesën për vizitën e tij në Moskë nga ana e udhëheqjes së lartë sovjetike. Ishte e kuptueshme pse Enver Hoxha dëshironte që të takonte personalisht Stalinin, për të cilin qysh atëherë shprehej se kishte

---

146 Po aty, f. 49.

147 Po aty.

148 Po aty.

një admirim të lartë si udhëheqës komunist. Gjithashtu, kuptohet se Enver Hoxha synonte që takimin eventual me Stalinin ta shfrytëzonte, ta kapitalizonte edhe me qëllim që, duke e forcuar pozitën e vet pranë tij, eventualisht t'i largohej kontrollit dhe mbikëqyrjes së Titos. Mirëpo, sovjetikët, duke qenë të bindur se Enver Hoxha nuk kishte adresa të tjera për të kërkuar mbështetje, vlerësonin që ta shtynin edhe për një kohë vizitën e tij në Moskë. Sigurisht, sovjetikët nuk kishin ndonjë arsye për të nxituar që të takonin Enver Hoxhën, edhe për faktin se, që nga Lufta e Dytë Botërore, veçmas në përfundim të saj, në masë të caktuar ai kontrollohej nga jugosllavët, ndërsa me anglo-amerikanët ishte gjithnjë e më larg, që do të thoshte se nuk paraqitej ndonjë rrezik real i cenimit të sferave të interesit sovjetik në Shqipëri. Prandaj, sa herë që Enver Hoxha interesohej te Misioni Sovjetik në Tiranë për fatin e kërkesës së takimit të tij me Stalinin, përgjigja ishte gjithnjë diplomatike, që nënkuptonte se vizita shtyhej deri në vlerësimin e momentit më të përshtatshëm diplomatik. Dihet se vizita e parë e Enver Hoxhës në Moskë u realizua në vitin 1947, pasi marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, fshehurazi, kishin marrë drejtimin e rrugës së përkeqësimit, përplasjeve dhe mosmarrë-veshjeve deri në prishje. Mirëpo, ndër detyrat e rëndësishme që i jepeshin Misionit Sovjetik në Tiranë, në vitet e para pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ishte edhe hulumtimi dhe vlerësimi i zhvillimeve në fushën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Kjo tregon te qartë orientimin e diplomacisë sovjetike rreth zhvillimeve në këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor. Konkretisht, pavarësisht se Moska u kishte dhënë dorë të lirë jugosllavëve që të vepronin në Shqipëri, pra, edhe mbi bazat e interesave sovjetike, megjithatë ata nuk dëshironin që këto marrëdhënie të zhvilloheshin pa mbikëqyrje nga Kremli. Dy çështjet kryesore që dominon në interesimin sovjetik në këtë plan dhe që nga Misioni Sovjetik në Tiranë kërkonin sqarime për Kremli-

nin ishin: 1) Kërkohej sqarim i hollësishëm për mendimin e Enver Hoxhës në bisedimet me palën jugosllave gjatë vizitës së tij, në korrik të vitit 1946, përkatësisht qëndrimin e tij rreth propozimeve sovjetike për hartimin e planeve të përbashkëta të mbrojtjes dhe çështjeve tjera, dhe 2) Kërkohej sqarim rreth qëndrimit të qeverisë shqiptare për çështje të bashkëpunimit ekonomik dhe krijimit të federatës me Jugosllavinë. Në rast të interesimit të palës shqiptare rreth mendimeve të misionit sovjetik për çështjete biseduara me jugosllavët, Misionit i sugjerohej që rreth këtyre çështjeve, palës shqiptare t'i jepej përgjigje pozitive. Misioni Sovjetik, po kështu, autorizohet që të mbledhte shënime dhe materiale të karakterit historik dhe etnografik edhe për çështjen e Kosovës. Kështu, më 17 dhjetor të vitit 1945, ambasadori sovjetik në ish-Jugosllavi, I. Sadçikov, kishte dërguar në Moskë një informacion me karakter historik, ekonomik, social dhe demografik për Kosovën.<sup>149</sup> Mirëpo, Ministria e Punëve të Jashtme të BRSS i kishte dhënë detyrë Misionit Sovjetik në Tiranë që vazhdimisht dhe mundësisht me të gjitha detajet kryesore të përcillte orientimet, interesimet dhe veprimet e përfaqësues vetë misioneve angleze dhe amerikane në Tiranë, në lidhje me bashkëpunimin e tyre me qeverinë shqiptare. Nga ana tjetër, edhe drejtuesit e misionit anglez dhe amerikan shprehnin shqetësim për veprimtarinë e Misionit Sovjetik, përkatësisht të ambasadorit Çuvahin, i cili me shpejtësi kishte krijuar një pozicion të privilegjuar prej diplomati të qeveria shqiptare. Sidomos, Çuvahin kishte vendosur marrëdhënie shumë të afërta dhe të drejtpërdrejta me Enver Hoxhën, Koçi Xoxendhe Nako Spiron, të cilët para Çuvahinit rrëfenin në mënyrë transparente të gjitha zhvillimet e brendshme shtetërore dhe partiake të Shqipërisë. "Rrëfeshin të gjitha sekretete shtetit, të gjitha intimitete të udhëheqjes komuniste shqiptare, grindjet dhe ankesat që kishin drejtuesit e qeverisë midis tyre, pro-

---

149 Po aty, f. 51

jektet për emërimet ose për zgjedhjet e njerëzve në nivelet më të larta të Partisë Komuniste, të qeverisë dhe të ushtrisë”.<sup>150</sup> Kuptohet, Çuvahini i premtonte udhëheqjes shqiptare se shteti i ri shqiptar do ta kishte përkrahjen e BRSS në tryezën e diplomacisë ndërkombëtare, në veçanti rreth çështjes së njohjes së qeverisë shqiptare dhe pranimin të Shqipërisë në OKB. Mirëpo, zhvillimet ndërkombëtare, krejtësisht të pafavorshme për çështjen shqiptare, drejtpërdrejt për njohjen e qeverisë dhe pranimin e Shqipërisë në OKB, në vitete trazuara të Luftës së Ftohtë, dëshmuuan të kundërtën, që do të thotë se, aleanca e pashpallur shqiptaro-sovjetike, por edhe shqiptaro-jugosllave, nuk i krijoi kurrfarë favore Shqipërisë. Përkundrazi, shteti shqiptar u përball me sfida të jashtëzakonshme në planin ndërkombëtar, duke qenë kështu, në jo pak raste, viktimë e përplasjeve të Fuqive të Mëdha, por në radhë të parë e synime vegrabitqare të jugosllavëve edhe BRSS ndaj hapësirave shqiptare. Një prej ngjarjeve kthesë që shënuan dramaticitetin të jashtëzakonshëm të pozitës së përkeqësuar të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe që i forcoi pozitat e kontrollit sovjetik dhe jugosllav mbi Shqipërinë, ishte incidenti në kanalën e Korfuzit, i ndodhur më 22 tetor të vitit 1946.

Preokupimet kryesore të Shqipërisë në fushën e diplomacisë së jashtme, në vjeshtë të vitit 1945, ishin njohja ndërkombëtare e qeverisë shqiptare nga Fuqitë e Mëdha dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet tjera të Evropës, njohja e të drejtës për Shqipërinë që të merrte pjesë në të gjitha konferencat e takimet ndërkombëtare, në të cilat merreshin vendime të rëndësishme për rajonin, vendosja e marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike e kulturore me vendet perëndimore etj. Të gjitha këto aspekte të politikës së jashtme shqiptare kishin domethënie fundamentale për forcimin e pavarësisë së brishtë të shtetit shqiptar në ato vite,

---

<sup>150</sup> Po aty, f. 54.

ndërkohë që pretendimet territoriale të Greqisë ndaj Shqipërisë dhe nxitja e incidenteve në kufirin shqiptaro-greksh kaktonin me arsye brengosje të mëdha tek qeveritarët shqiptarë. Në këtë periudhë, në fund të vitit 1945, jugosllavët kishin shënuar depërtime të reja në realizimin e strategjisë së tyre për ndërhyrje të papenguar në të gjitha zhvillimet e brendshme shtetërore, qeveritare e partiake të Shqipërisë. Shqipëria dalëngadalë, por sigurt, po shndërrohej në një provincë jugosllave pa ndonjë kundërshtim të veçantë të pushtet mbajtësve shqiptarë. Në këtë kuptim, edhe ndërhyrjet e Misionit Jugosllav ishin gjithnjë e më imponuese, gjë për të cilën dokumentojnë edhe dokumentet e arkivave jugosllave. "Të gjitha lidhjet me botën (të Shqipërisë-A.Z) janë vendosur ekskluzivisht përmes Beogradit. Ndonjëherë, diplomacia jugosllave i ka iniciuar ato me vetiniciativë".<sup>151</sup> Jugosllavët, përmes kanaleve diplomatike, në bisedimet me diplomatët rumunë dhe bullgarë, me vet iniciativë, e kishin shtruar çështjen e njohjes së qeverisë shqiptare, mirëpo udhëheqësit shqiptarë i kishin dhënë përgjigje Velimir Stojnićit, se: "Bullgaria dhe Rumania nuk kanë ndonjë status të favorshëm në shtetet perëndimore, kështu që në vend të dobisë me këtë njohje më tepër mund të ketë pasoja".<sup>152</sup> Qeveria shqiptare kishte kërkuar nga jugosllavët që të angazhoheshin për njohje të shtetit shqiptar nga Polonia dhe Çekosllovakia, për ç'ka diplomacia jugosllave kishte iniciuar bisedimet. Jugosllavët kishin ndërmarrë aktivitete për të mbrojtur dhe përfaqësuar interesat e Shqipërisë edhe në vjeshtën e vitit 1945, kur Franca ende nuk e kishte njohur qeverinë shqiptare. Në këtë kohë, udhëheqësi i lartë shtetëror i Shqipërisë, Tuk Jakova, në cilësinë e shefit të delegacionit sindikalist shqiptar, kishte kërkuar nga ambasadori jugosllav në Paris,

---

151 Bogumilj Hrabak, *Medjunarodni položaj Albanije 1945-1947 i Jugoslavija, "Istraživanja"* nr.13, f. 258, Novi Sad, 1990.

152 Po aty, f. 259.

Marko Ristiç, që ambasada jugosllave: “Të mundësonte repatriimin e disa shtetasve shqiptarë, të cilët jetonin në Francë dhe që nuk mund të merrnin dokumentet e identifikimit për atdhe dhe që në tërësi ambasada jugosllave në Paris të merrte përfaqësimin e interesave shqiptare në Francë”.<sup>153</sup> Shqipëria, në gusht të vitit 1945, përmes Hysni Kapos, udhëheqësit të përfaqësisë shqiptare në Beograd, kishte kërkuar që përmes Beogradit të iniciohte marrëdhëniet diplomatike me Bullgarinë, kurse për vendosjen e marrëdhënieve tregtare midis Shqipërisë dhe Rumanisë, kishte ndërhyrë ndihmësi i shefit të ministrit të Punëve të Jashtmetë Jugosllavisë, V. Velebit.<sup>154</sup> Po kështu, Kryqi i Kuq Shqiptar, në vitet e para të pasluftës, mbante lidhje me Kryqin e Kuq të Zvicrës përmes Kryqit të Kuq Jugosllav. Në dhjetor të vitit 1945, në Tiranë ishte rritur prezenca e faktorit ndërkombëtar në formë të misioneve civile dhe ushtarake ose të misioneve të specializuara, siç ishte ajo e UNRRA, por ende nuk kishte përfaqësi ndërkombëtare me karakter diplomatik. Në fillim të janarit të vitit 1946, përmes përfaqësisë jugosllave në Uashington u përsërit kërkesa shqiptare për praninë të Shqipërisë në OKB. Ndërsa, në fund të të njëjtit muaj, Misioni Britanik në Tiranë i dërgoi një notë proteste qeverisë shqiptare për shkak të persekutimeve të qytetarëve mbi bazat fetare. Lidhur me vërejtjet e Misionit Anglez, që në të vërtetë ishin qëndrime të politikës zyrtare të Forin Ofisit britanik, më 25 janar të vitit 1946, shefi i këtij misioni, gjenerali Hoxhson, kishte zhvilluar një bisedë me kryeministrin Enver Hoxha me plot tone kritike në adresë të qeverisë shqiptare.<sup>155</sup> Ishte e qartë se marrëdhëniet e ndërlikuara dhe bashkëpunimi gjithnjë e më i dyshimtë midis qeverisë shqiptare dhe misioneve angleze e amerikane po nxiste ndërlikime të reja në planin e relacioneve ndërkombëtare.

---

153 ASHMPJ, A 1946/I, Fond. nr 3534, Paris 21.X.1945, Fondi, nr.1483/VII.

154 ASHMPJ, A 1945, nr. 32, Fondi nr. 3767 (Stojniçi 30.VIII 1945), Fondi nr. 2 890.

155 “Bashkimi”, 4. I 1946, 1; “Politika”, 5. I.1946, 3

bëtare midis shtetit shqiptar dhe shteteve perëndimore, konkretisht SHBA dhe Britanisë së Madhe. Shtypi shqiptar kishte botuar vështrime e komente me përmbajtje jo edhe aq të matura në adresë të misioneve angleze dhe amerikane, lidhur me kompetencat e tyre në Shqipëri, duke u pohuar: “Nëse Shqipëria, në vitin 1939, ishte e nënshtruar nga fashizmi italian, ajo kurrsesi nuk mund të konsiderohet si satelit vullnetar, ndërkohë që, në OKB po pranohen edhe ata që me vonesë i kanë shpallur luftë Gjermanisë, kurse po harrohet fakti se Shqipëria ishte viktima e parë e agresionit fashist”.<sup>156</sup> Nako Spiru, njëri prej udhëheqësve të lartë shtetërorë të atëhershëm, kishte mbajtur një fjalim të rreptë drejtuar shteteve perëndimore, në radhë të parë SHBA dhe Britanisë së Madhe dhe me këtë rast kishte riafirmuar orientimet programore të politikës së jashtme shqiptare pro bllokut të Lindjes, konkretisht për thellim të miqësisë me sovjetikët dhe jugosllavët. Lidhur me këtë, Josip Gjergja, shefi përfaqësisë jugosllave në Tiranë, në raportin dërguar Beogradit, mes të tjerash, shënonte: “Kjo është hera e parë që për çdo gjë flitet hapur dhe në mënyrë të qartë, në veçanti për drejtimit e politikës së përgjithshme të Shqipërisë, si dhe për politikën e jashtme edhe orientimin e saj ndaj Rusisë Sovjetike dhe Jugosllavisë”.<sup>157</sup> Nako Spiru, duke ritheksuar qëndrimin ndaj BRSS dhe Jugosllavisë, mes të tjerash, kishte deklaruar: “Kurrsesi nuk është e mundur që të flasim për luftën heroike të popullit shqiptar për pavarësi e që në të njëjtën kohë të mos e kemi parasysh ndihmën e madhe materiale dhe morale, të cilën na ka dhënë dhe po na jep Jugosllavia e marshallit Tito”.<sup>158</sup> Gazeta beogradase “Politika”, në numrin e 15 shkurtit, në një vështrim të gjatë në frymën e politikës zyrtare të Jugosllavisë, deklaroi për përkrahje të qëndrimeve

---

156 “Politika”, 31.I.1946.

157 ASHMPJ, A 1946/I, nr. 11, Fondi nr. 1181, Gjergja 2.II.1946, Fondi nr. 23.

158 Po aty.



të Shqipërisë kundër bllokut, aleancës anglo-amerikane, të cilën e kritikonte përqëndrimet e ngurta ndajkërkesës së Shqipërisë për njohjen e qeverisë saj të dalë nga lufta. Artikullshkruesi, duke kritikuar shtetet perëndimore, vlerëson se për të njëjtat qëllime: “po përkrahen qarqet reaksionare të Greqisë, të cilat, duke kërkuar ndarjen e Shqipërisë, po përgatisin aventurën ushtarake kundër Shqipërisë së vogël... Armiqtë e Shqipërisë së re po i bashkojnë të gjithaforcat, me qëllim që opozitën ta sjellin në pushtet edhe me çmim të luftës civile, ku do të ndërhynte Greqia”.<sup>159</sup> Diplomacisë jugosllave dhe asaj sovjetike i shkonte përshtat keqësimi dramatik i marrëdhënieve politike të Shqipërisë me shtetet perëndimore, ndaj, kursin e rreptë e të pamatur dhe në masë të caktuar edhe përçarës të politikës së jashtme shqiptare, Beogradi dhe Moskë, jo vetëm që e përkrahnin, por në mënyra të ndryshme vazhdimisht e ndërsonin. Kjo për faktin se keqësimi sa më i thellë, deri në ndarje, i marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet perëndimore, në radhë të parë me SHBA dhe Britaninë e Madhe, shtetin shqiptarë linte gjithnjë e më të izoluar në arenën e diplomacisë ndërkombëtare. Ndërsa në anën tjetër, portate ndërhyrjes sovjetike dhe jugosllave në Shqipëri ishin gjithnjë e më të hapura për udhëheqësit e Beogradit dhe ata të Moskës. Diplomacia jugosllave, përmes përfaqësuesit të saj diplomatik në Tiranë, Josip Gjergjës, shqipfolës nga Zara e Kroacisë, i cili ishte emëruar në vend të Velimir Stojniçit, më 26 tetortë vitit 1945, me disiplinë i përcillte të gjitha zhvillimet politike në Shqipëri dhe e informonte Ministrinë e Punëve të Jashtmenë Beograd. Sipas raporteve të tij, dërguar qendrës në Beograd, konfirmohet se Enver Hoxha, në fund të shkurtit të vitit 1946, e kishte pranuar për takim pune shefin e Misionit Amerikan në Tiranë, Xhekopsin, për t’i komunikuar përgjigjen verbale lidhur me notën diplomatike të Stejt-Departamentit. Përgjigja e En-

159 “Politika”, 15.II.1946, 4.

ver Hoxhës konsistonte në kërkesën që Tirana ishte e gatshme të pranonte një marrëveshje të përgjithshme me SHBA për të mundësuar njohjen e qeverisë shqiptare nga Uashingtoni zyrtar, mirëpo Shqipëria nuk mund të pranonte marrëveshjet e paraluftës midis dy shteteve si kusht për njohje. Diplomacia jugosllave, duke qenë në rrjedha të të gjitha zhvillimeve që kishin të bënin me politikën e jashtme të Shqipërisë dhe fatin e kërkesës shqiptare për njohje nga shtetet perëndimore dhe pranim në OKB, në fund të muajit mars të vitit 1946, ndërmoi veprime dhe aktivitete konkrete diplomatike për të matur gatishmërinë e qeverisë amerikane rreth çështjes së pranimin të Shqipërisë në OKB dhe përgjigjeve të Enver Hoxhës në notën diplomatike amerikane për njohje ndër-shtetërore. Më 25 mars 1946, përfaqësuesi diplomatik jugosllav në Uashington, S. Makiedo, në bisedën me zyrtarët e Stejt-Departamentit rreth pranimin eventual të Shqipërisë në OKB, kishte hetuar qartë pakënaqësinë e autoriteteve amerikane pse, pikërisht, jugosllavët kishin shtruar këtë çështje. Zyrtarët amerikanë i kishin bërë me dije diplomatit jugosllav se qeveria amerikane ndiente një pakënaqësi të thellë në përgjigjet e Enver Hoxhës dhe me atë rast ishin thirrur edhe në kumtesën e agjencisë sovjetike të lajmeve, TASS, e cila shkruante se marrëdhëniet me perëndimin kohëve të fundit ishin acaruar edhe për arsye të qëndrimit të qeverisë shqiptare ndaj misioneve të huaja, të cilët në mënyrë jo të zakonshme ishin larguar nga Tirana.<sup>160</sup> Në të njëjtin raport, dërguar MPJ të Jugosllavisë nga Uashingtoni, diplomati Makie do nuk linte pa nënvizuar një prej vërejtjeve kryesore të zyrtarëve të Stejt-Departamentit, sipas të cilëve udhëheqja shqiptare në asnjë rast nuk kishte kërkuar që të dërgonte në Uashington misionin e vet politik, për ç'ka amerikanët kishin treguar gatishmëri që ta pranonin dhe të zhvillonin dialog

---

160 ASHMPJ, A 1946, Fondi nr. 3394, S. Makiedo 25.III.1946, Fondi nr. 363.

miqësor diplomatik.<sup>161</sup> Në mars të vitit 1946, numri i diplomatëve të jashtëm në Tiranë ishte simbolik: përfaqësuesi jugosllav dhe ai sovjetik, një përgjegjës i zyrës bullgare dhe diplomatët francezë, ndërsa flitej se do të arrinte edhe përfaqësuesi diplomatik i Britanisë së Madhe, i cili, megjithatë, nuk erdhi asnjëherë në kryeqytetin shqiptar. Diplomati francez (Piko), me të arritur në Tiranë, kishte vërejtur se pozita e jugosllavëve në Shqipëri dukej se ishte e privilegjuar, prandaj në një takim me Josip Gjergjëne kishte pyetur atë se a ishte e vërtetë që po zhvilloheshin bisedimet për federatën jugosllavo-shqiptare. Natyrisht, diplomati jugosllav i kishte dhënë përgjigje të nivelit diplomatik, duke thënë se marrëdhëniet intensive midis dy shteteve nuk nënkuptonin se ato shtete do të krijonin federatë.<sup>162</sup> Ndërkohë, në këtë periudhë, diplomacia jugosllave, përmes përfaqësuesit të saj diplomatikë Bukuresht, Gruloviçit, me vet iniciativë angazhohej për vendosjen e marrëdhënieve shqiptaro-rumune. Mirëpo, ambiciet e diplomacisë jugosllave i kalonin kufijtë e interesimit shqiptar, duke u marrë edhe me sferate interesimit të politikës së jashtme të Shqipërisë. Ishte e qartë se: “Jugosllavia këtë e bënte, jo vetëm për të forcuar pozitën ndërkombëtare të Jugosllavisë, por që të dëshmohej si koordinatore e lidhjeve diplomatike midis shteteve ballkanike”.<sup>163</sup> Udhëheqjes jugosllave i shkante për shtat ndërlikimi gjithnjë e më i hapur i pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë dhe sidomos konfrontimi i udhëheqjes shqiptare me zyrtarët amerikanë dhe anglezë. Kjo ndodhte edhe për shkak se udhëheqja shqiptare e pasluftës, në rrethanat e një lloj bojkoti të heshtur të qeverisë shqiptare nga ana e anglo-amerikanëve, ishte e detyruar që përkrahjen ndërkombëtare ta kërkonte përmes Beogradit, i cili historikisht kishte qenë burim i shumë fatkeqësive

---

161 Po aty.

162 ASHMPJ, A 1946/I, nr. 10, Fondi nr. 3245, Gjergja 19.III.1946, nr. 143.

163 Bogumilj Hrabak, vep. e cit., f. 269.

shqiptare. Duke parë se çështja e pranimit dhe njohjes ndërkombëtare të qeverisë shqiptare nuk po përparonte, por po shënonte sfida dhe rëniet e reja, qeveria jugosllave i kishte ofruar Shqipërisë që të merrte përsipër përkujdesjen e mbështetjes dhe të mbrojtjes së interesave shqiptare në shtetet ku Shqipëria nuk kishte përfaqësi të veta të jashtme. Qeveria shqiptare e kishte pranuar një ofertë të tillë jugosllave pa diskutim duke i shprehur mirënjohje, duke mos kuptuar se prapa iniciativave të tilla të autoriteteve jugosllave, në thelb, fshiheshin qëllimet gllabëruese ndaj shtetit shqiptar. Gjatë muajit prill të vitit 1946, qeverinë shqiptare e njohën Çekosllovakia dhe Polonia. Për këtë njohje ndërshtetërore nuk ishte njoftuar fillimisht qeveria e Tiranës, por drejtpërdrejt përfaqësuesit diplomatikë jugosllavë, të vendosur në Pragë dhe Varshavë. Kështu, "Kryetari i qeverisë së Pragës, dr Firlinger, më 26 prill, e kishte njoftuar ambasadorin jugosllav, Çernej, se qeveria ka për qëllim të dërgojë në Tiranë përfaqësuesin e saj diplomatik. Qeveria polake, më 28 prill, e kishte lajmëruar ambasadorin jugosllav, Lumoviçin, se edhe për një kohë nuk do të ishte në gjendje të dërgonte në Tiranë përfaqësuesin e vet diplomatik, për arsye të mungesës së kuadrove, ndërsa ardhja e përfaqësuesit diplomatik shqiptar ishte e mirëseardhur..."<sup>164</sup>. Diplomacia jugosllave ishte konsultuar nga qeveria shqiptare edhe rreth përgjigjes lidhur me incidentin e ndodhur në kanalën e Korfuzit, më 15 maj të vitit 1946, kur një bateri detare shqiptare kishte hedhur 12 projekte mbi anije britanike "Orion" dhe "Sjuperb". I pyetur rreth përgjigjes së mundshme të qeverisë shqiptare, përfaqësuesi diplomatik jugosllav në Tiranë, Josip Gjergja, e kishte këshilluar palën shqiptare që "pas disa ditësh të shpjegohej se si ka ardhur deri te hapja e zjarrit... ndërsa nota diplomatike do të duhej të kishte intonacione të tilla që të

---

164 Po aty, f. 274.

linte të kuptohej edhe si falje publike".<sup>165</sup> Ndërhyrjet jugosllave në politikën e jashtme shqiptare kishin ardhur në shprehje edhe në periudhën, kur qeveria shqiptare bënte përpjekje që përmes përfaqësuesve të komunitetit shqiptar në SHBA, në radhë të parë, përmes Fan S. Nolit, të shënonte ndonjë hap përparimi në njohjen e shtetit shqiptar nga ana e SHBA. Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë fillimisht i kishte sugjeruar qeverisë shqiptare që, në vend se të kërkonte ndonjë ndërmjetësues për bisedime me zyrtarët amerikanë dhe personalitetet autoritative të mërgatës shqiptare përtej Atlantikut, të bënte përpjekje që t'i vazhdonte bisedimet me misionin amerikan në Shqipëri. Më pas, konkretisht më 30 maj të vitit 1946, diplomacia jugosllave kishte bërë edhe një hap më tej duke i dhënë urdhër diplomatit të saj në Uashington, S. Makiedo, që të bisedonte drejtpërdrejt në Stejt-Departament, lidhur me pozitën e ndërlikuar dhe gjithnjë e më të paqartë ndërkombëtare të Shqipërisë. Diplomati jugosllav, në bisedimet me zyrtarin e lartë të Stejt-Departamentit, Donald Rasel, i kishte bërë kërkesë qeverisë amerikane që interesat e Shqipërisë në SHBA t'i mbronte Jugosllavia dhe që qytetarët shqiptarë në SHBA të mund të lëviznin me pasaporta dhe viza jugosllave, të cilat do t'i merrnin në përfaqësinë amerikane në Beograd.<sup>166</sup> Pala shqiptare i kishte bërë kërkesë zyrtare Jugosllavisë që t'i përfaqësonte dhe t'i mbronte interesat e Shqipërisë edhe në rastin e Greqisë, pasi Athina zyrtar e deklarohet se midis Greqisë dhe Shqipërisë ishte gjendje lufte. Kërkesa shqiptare drejtuar autoriteteve jugosllave, në të njëjtën kohë, kishte të bënte edhe me shqetësimet lidhur me qëndrimin publik të SHBA, të cilat e përkrahnin qeverinë greke në pretendimet e saj territoriale ndaj Shqipërisë, konkretisht për pjesën e Shqipërisë jugore. Qeveria greke me propagandën e lansuar në qarqet diplomatike se gjoja Shq-

---

165 Po aty, f. 275.

166 ASHMPJ, A 1946, I, nr. 11/IV.

ipëria nuk konsiderohet si palë luftuese e aleatëve, por aleate e fuqive të qendrës, i kishte sjellë dëme të mëdha Tiranës zyrtare në arenën ndërkombëtare. Nuk ishte aspake rastit dhe e papritur pse qeverit arët grekë e kishin hedhurposhtë kërkesën jugosllave për përfaqësim të interesave të Shqipërisë pranë shtetit grek. Qeveria greke ishte e njoftuar për marrëveshjen e nënshkruar, më 9 korriktë vitit 1946, midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë për bashkëpunim dhe ndihmë reciproke, prandaj këtë marrëveshje shihte edhe si një arsyemë shumë që Jugosllavia të mos mund të përfaqësonte dhe mbronte interesat e Tiranës në Greqi. Ndërkohë, me sugjerimin e përfaqësuesit jugosllav në Tiranë, Josip Gjergjës, qeveria shqiptare, në një notë dërguar më 3 qershor 1946 Konferencës Ministrave të Punëve të Jashtme në Paris, për herë të parë, e kishte hapur çështjen e pakicës shqiptare në Çamëri. Në vitin 1946, qeveria shqiptare kishte dërguar notë diplomatike edhe në adresë të qeverisë së Turqisë dhe të Egjiptit për të pranuar që Jugosllavia t'i përfaqësonte dhe mbronte interesat e shtetit shqiptar. Derisa qeveria turke kishte dhënë përgjigje pozitive, ajo e Egjiptit, më 4 korrik, kishte deklaruar se kundërshtonte përfaqësimin jugosllav të interesave të Shqipërisë në Egjipt.

Në prag të fillimit të punimeve të Konferencës së Paqes në Paris, në verë të vitit 1946, ishin intensifikuar konsultimet e qeveritarëve shqiptarë, konkretisht të Enver Hoxhës me përfaqësuesin diplomatik jugosllav në Tiranë, i cili paraprakisht i kishte sugjeruar kryeministrit shqiptar që veçmas ndaj SHBA të mbante qëndrim më diplomatik dhe më të përmbajtur.<sup>167</sup> Pikërisht, në këtë kohë, Josip Gjergja u kishte propozuar autoriteteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë të shqyrtonin mundësinë që në përbërje të ambasadës jugosllave në Uashington të pranohej një veprimtar shqiptar nga mërgata shqiptare në SHBA, i cili do të punonte

167 ASHMPJ, A 1946/I, nr. 11/VI, Dos. nr. 9078, Gjergja 30.VII.1946.

me këtë mërgatë. Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë ishte përgjigjur pozitivisht, duke sugjeruar që: “ai duhet të jetë njeri, të cilin vetë qeveria shqiptare do ta caktonte si përfaqësues të ligjshëm”.<sup>168</sup> Ndërkohë, më 1 gusht të vitit 1946, Stejt-Departamenti kishte informuar ambasadën jugosllave në Uashington se Jugosllavisë i lejohej t’i kryentepunët për qytetarët shqiptarë në SHBA, por në atë nivel, në të cilin i ka kompetencat edhe Misioni Amerikan në Tiranë. Veçmas, në këtë periudhë, ndikimi i politikës jugosllave mbi politikën e jashtme të Shqipërisë kishte shënuar dimensione të reja që nënkuptonin humbjen gradualetë pavarësisë së shtetit shqiptarë dhe në politikën e jashtme, duke iu nënshtruar skemave, direktivave dhe mbikëqyrjes së diplomacisë jugosllave që realizoheshin përmes Josip Gjergjës. Gjergja, në disa raste, e këshillonte udhëheqjen shqiptare që të ishte gjithnjë e matur në marrëdhëniet me SHBA dhe të mos ndërmernte veprime diplomatike pa konsultë me jugosllavët: “Kur janë në pyetje SHBA, Gjergja lutej që vendimet të mos merreshin me nxitim, por të zhvilloheshin konsultime me jugosllavët. Në të vërtetë, kah fundi i korrikut të vitit 1946, ishin zbuluar disa spiunë, të cilët ishin të lidhur me Misionin Amerikan, kurse disa (mendohet në udhëheqjen shqiptare - A.Z), ishin të prirur që çështja menjëherë të bëhej publike dhe të ndërmerreshin konsekuenca”.<sup>169</sup> Udhëheqësit shqiptarë personalisht e njoftonin përfaqësuesin diplomatik jugosllav në Tiranë për bisedimet dhe kontaktet me diplomatët e jashtëm. Kështu, Enver Hoxha, në vjeshtë të vitit 1946, pas bisedës që kishte zhvilluar me përfaqësuesit e Misionit Amerikan, Xhekobs dhe Handerson, e kishte njoftuar diplomatin jugosllave dhe lidhur me propozimin e Handersonit që Shqipëria të inicionte çështjen e Kosovës si dëmshpërblim për territoret jugore

168 ASHMPJ, A 1946/I, nr.11/VI, Sekr. Nr. 11387, Gjergja 21.IX.1946, Sekr. nr. 526 dhe përgjigja e V. Krula 25.IX.1946

169 Po aty, Sekr. nr. 9220 ( Kosanoviçi nga Uashingtoni 1.VIII.1946, Sekr. nr. 980) dhe Sekr. nr. 100775 (Gjergja 10.IX.1946).

të shtetit shqiptar, të cilat Greqiai kërkonte me parullën për Verio-Epirin.

Në vjeshtën e vitit 1946, kur gjendja e brendshme në Shqipëri sa vinte e bëhejmë e rëndë, veçmas në raport në rrjedhat ndërkombëtare, nëtë cilat ishin shfaqur hapur të çarat e para mbi politikën e blloqeve Perëndim-Lindje dhe kur Lufta e Ftohtë ideologjike paralajmëronte ashpërsime të reja midis Uashingtonit dhe Moskës, shtetin shqiptar e tronditi edhe një ngjarje e kobshme. Më 22 tetor 1946, ndodhi incidenti në Kanalin e Korfuzitku nga shpërthimi i minave nën ujore mbetën të vrarë një oficer e 43 marinarë anglezë, kurse 3 oficerë e 39 marinarë të tjerë u plagosën. Pastrimi i minave ishte aksion ndërkombëtar i ndërmarrë në vitin 1945, ndërsasipas Këshillit Qendror për pastrimin e minave nga Deti Mesdhe, zona e 17-të përfshinte pjesën më të madhe të ujërave territoriale të Shqipërisë. Kanali i Korfuzit cilësohej si zona numër 18, për të cilën ekzistonte marrëveshja që ta pastronte Greqia. Pesë muaj para se të ndodhte incidenti në Kanalin e Korfuzit, pikërisht në këtë zonë, kishte ndodhur incidenti i 15 majit të vitit 1946. Atë ditë, artileria bregdetare shqiptare kishte hapur zjarr kundër dyluft anijeve britanike, të cilat kishin hyrë pa paralajmërim në ujërat tokësore të Shqipërisë. Pesë ditë më pas, në notën diplomatike të datës 21 maj 1946, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke i shprehur keqardhje qeverisë britanike, deklaronte se anijet britanike kishin hyrë në ujërat tokësore shqiptare pa paralajmërim. Qeveritarët shqiptarë njëherit kishin nënvizuar se Shqipëria nuk kishte asgjë kundër lundrimit të lirë në Kanalin e Korfuzit afër bregdetit shqiptar, por kishin kërkuar që, me qëllim të mënjanimit të incidenteve të ngjashme, të kishte paralajmërim në adresë të qeverisë shqiptare.<sup>170</sup> Qeveria britanike, në përgjigjen drejtuar Tiranës zyrtare, pasi shprehte mospajtim me arsyetimet e dhëna në notën diplo-

170 Notë e qeverisë së RPSH-së, 21 maj 1946.



matike shqiptare, mbronte qëndrimin se, duke u mbështetur në ligjin ndërkombëtar për lundrimtë lirë në ngushticat e kanalet ndryshme në botë, nuk pranonte asnjë kusht për kalimin e anijeve të saj në ngushticën e Korfuzit.<sup>171</sup> Kur varësia e qeverisë shqiptare dhe përgjithësisht e Shqipërisë po bëhej gjithnjë më e madhe ndaj Jugosllavisë, kur regjimi komunist në Tiranë i trajtonte si armiqtësore përpjekjet e misioneve amerikane dhe britanike për të krijuar në jetën shqiptare themelet e sistemit demokratik perëndimor, në mesditën e 22 tetorit 1946, destroyerët anglezë “Saumarez” dhe “Volage”, duke lundruar nëpër Kanalin e Korfuzit drejt veriut, u ndeshën në mina meçrst dhe ndodhi tragjedia. Incidenti në Kanalin e Korfuzit që kishte pasoja vdekje prurëse për marinarët dhe oficerët britanikë ndezi edhe më fuqishëm tensionet në marrëdhëniet edhe ashtu të acaruar shqiptaro-britanike. Në shtypin zyrtar dhe atë të pavarur britanik, ato ditë, ishin shtuar kërkesat që: “Ndaj Shqipërisë të ndërmerren masa urgjente drastike me të gjitha mjetet luftarake, të cilat i disponon Britania e Madhe, sepse është fajtorë për incidentin në Kanalin e Korfuzit, ndaj edhe duhet të dënohet”.<sup>172</sup> Për disponibilitetin luftarak të britanikëve ndaj shtetit shqiptar dëshmonte edhe deklarata e një diplomati të lartë britanik të kohës, i cili ishte shprehur: “Shqipëria duhej gëlltitur me tri kafshatë”.<sup>173</sup> Në lidhje me incidentin e Kanalit të Korfuzit, në dosjen e Forin Ofisit, nr. 371/58493-XC të vitit 1946, jepeshin detaje që mbështeteshin në të dhënat e burimeve ushtarake britanike. Dy shpërthimet e para kishin ndodhur në orën 14:45, kurse shpërthimi i tretë kishte ndodhur në orën 16:31, kur destroyeri “Volage” kishte hasurnë një minë. Në dokumentet e Forin Ofisit theksohej gjithashtu se: “Nuk ka

171 L. Gardiner, *The eagle spreads his claws*. Edinburgh and London, 1966, p. 68.

172 Daut Dauti-Haqif Mulliqi, *Më 12 nëntor 1946, Britania ushtarakisht sulmoi Shqipërinë, “Zëri”, Prishtinë, 1992.*

173 Po aty.

informataqë aleatëta po armiqtë kanë vënë ndonjëherë mina në kanal in e pastruar...".<sup>174</sup>

Qeveria shqiptare, shtatë ditë pas incidentit të përgjakshëm në Kanal in e Korfuzit, i dërgoi një telegram proteste Sekretarit të Përgjithshëm të OKB, në të cilën qeveria britanike akuzohej për shkeljen e ujërave tokësore dhe kërkohesh nga ana e OKB të ndërhynte që të mos përsëriteshin më provokacionet britanike. Qeveria shqiptare njëkohësisht kishte kërkuar që Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës të Kombeve të Bashkuara ta shtronte këtë çështje përpara Asamblesë, e cila në atë kohë ndodhej në sesion. Kërkesa shqiptare nuk ishte përfillur, ajo nuk ishte vënë në rendin e ditës së Asamblesë ose të Këshillit të Sigurimit dhe nuk ishte marrë ndonjë masë rreth saj. Në përgjigjen e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB thuhet: "Qeveria shqiptare u njoftua se kërkesa që kishte bërë ajo u ishte shpërndarë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB".<sup>175</sup> Asambleja e OKB, në vend se të shtronte në rend dite kërkesën e qeverisë shqiptare, e cila notën e saj diplomatike e kishte parashtruar në bazë të artikullit 35 të Kartës së OKB, në rend dite vuri kërkesën e qeverisë britanike lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit, të parashtruar më 16 janar të vitit 1947.<sup>176</sup> Ndaj akuzës britanike kishte reaguar edhe Enver Hoxha në mesazhin festiv me rastin e Vitit të Ri të vitit 1947: "Qeveria angleze e akuzon qeverinë shqiptare se gjoja kjo ka vënë mina në Kanal in e Korfuzit, dhe, këtë e bën për t'i krijuar vendit tonë pengesa në të drejtat e tij në lëmin ndërkombëtar, për t'i kërkuar dëmshpërblime e të tjera gjëra të tilla. Qeveria britanike kanosetse do ta çojë çështjen e incidentit të Kanalit të Korfuzit në Këshillin e Sigurimit. Qeveria shqiptare, çështjen e shkeljes së sovranitetit të Shqipërisë për tri herë rresht nga ana e anijeve britan-

---

174 Po aty.

175 Hysni Kapo, Vepra të zgjedhura, vëll. I, f. 358, Tiranë, 1980.

176 Po aty.

ike e ka çuar më parë se qeveria angleze në Këshillin e Sigurimit dhe kërkojmë që të shqyrtohet sa më parë kërkesa jonë. Ne jemi gati të shkojmë në Këshillin e Sigurimit pse kemi shumë gjëra për të thënë dhe për t'i treguar botës".<sup>177</sup> Derisa po zhvilloheshin debate të rrepta në fushën e diplomacisë midis qeverisë shqiptare dhe asaj britanike, më 12 e 13 nëntor 1946, 30 anije britanike kishin hyrë, pa asnjë paralajmërim, në ujërat tokësore të shtetit shqiptar me motivacion se do të çminonin tërë hapësirën e Kanalit të Korfuzit. Kësaj radhe, qeveria britanike, përmes një note, të dërguar më 10 nëntor 1946, e njoftonte qeverinë shqiptare se më 12 nëntor 1946 Kanali i Korfuzit do të spastrohej nga minat. Sipas notës britanike, ky spastrim bëhej me një vendim unanim të marrë më 1 nëntor nga Komiteti Qendror për Spastrimin e Minave.<sup>96</sup> Lidhur me këto incidente janë shkëmbyer një varg notash diplomatike midis qeverisë shqiptare dhe asaj britanike, natyrisht, secila palë duke dhënë argumentet dhe kundërshtimet e veta. Në këtë operacion hulumtimi, marinaret britanikë arritën të gjenin edhe 22 mina, dy prej të cilaveu dërguan për kontrolldetaj në Maltë. Nga kontrollimi përfundimtari minave dhe rezultatet kuptohejse minat ishin të prodhimit gjerman të tipit GY dhe se në Kanalin e Korfuzit nuk ishin vënë më herët se dy muaj para se të zbuloheshin e nxirreshin. Qeveria shqiptare mbante qëndrimin se: "Rrjedhim logjik i një përdorimi të këtillë të rregullave ndërkombëtare nga ana e qeverisë britanike janë provokacionet brutale të 12 dhetë 13 nëntorit kundër Shqipërisë".<sup>178</sup> Hysni Kapo, në fjalën e tij në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB, mbajtur më 19 shkurt 1947, pasi kishte konstatuar se qeveria britanike as që kishte denjuar t'i merrte në konsideratë të drejtat e Shqipërisë, akuzoi edhe Komitetin Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave që nuk i

---

177 "Bashkimi", 1 janar 1947.

178 Hysni Kapo, vep. e cit., f. 365.

kishte dërguar paraprakisht asnjë njoftim qeverisë shqiptare në lidhje me vendimet e marra e as për ekzistencën e këtij organizmi ndërkombëtar.<sup>179</sup> Më 14 nëntor 1946, sipas deklaramentit të Hysni Kapos, Komiteti Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave kishte publikuar përgënjeshttrimin, në të cilin thuhej: “Në lidhje me lajmet e botuara në shtyp kohët e fundit mbi veprimete spastrimit që anijet britanike kanë kryer në ujërat territoriale të Shqipërisë, në pjesën veriore të kanalit të Korfuzit, Komiteti Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave deklaronte spastrimi nuk është kryerme urdhrin e tij dhe nuk ka pasur pëlqim të tij”.<sup>180</sup> Një kopje të përgjigjes ndaj notës diplomatike britanike lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit, qeveria shqiptare ia kishte dërguar Beogradit zyrtar për t’u analizuar nga ekspertët jugosllavë të së drejtës ndërkombëtare dhe për të përgatitur mbrojtjen shqiptare. E përditshmja britanike “Times”, më 13 janar, kishte hedhur një vështrim të gjatë lidhur me situatën gjithnjë e më të tendosur midis Tiranës dhe Londrës dhe kishte konfirmuar lajmin se për incidentin e përmendur akuzohej edhe Jugosllavia, për pjesëmarrje në vendosjen e minave në Kanaline Korfuzit.<sup>181</sup> Në momentin kur dyshimet për përzierjen eventuale jugosllave, në lidhje me këtë incident, ishin bërë publike edhe në suazat e diplomacisë ndërkombëtare, Ministria e Jashtme e Jugosllavisë kishte ndërmarrë aktivitete të reja konkrete diplomatike, ndër të cilat kërkoheshin që kjo diplomaci të formulonte detajisht çështjen e incidenteve greke në 96 Organizëm ndërkombëtar i krijuar pas Luftës së Dytë Botërore, i cili kishte për detyrë të organizonte e të bashkërendonte operacionet për kërkimin dhe spastrimin e minave të mbetura në ujëra detare nga koha e luftës. kufirin shqiptar, me ç’ka synohej të zbutej padia ndërkombëtare

---

179 Hysni Kapo, vep. e cit., f. 367.

180 Po aty.

181 Shih: Bogumilj Hrabak, vep. e cit., f. 293.

kundër Beogradit zyrtar. Në këtë kuptim, më 17 janar 1946, përfaqësuesit diplomatikë jugosllavë në Tiranë dërguan në adresë të Beogradit një material në lidhje me provokimet greke. Atasheu jugosllav në Tiranë, Petroviç, i kishte propozuar Shtabit të Përgjithshëm Shqiptar që minambledhësit jugosllavë të bënin kontrollimin e zonës 17/1 dhe 17/2, mirëpo edhe pse shtabi shqiptar ishte pajtuar me propozimin jugosllav, Këshilli i Ministrave e kishte hedhur poshtë këtë kërkesë me motivacionin se: “Fushate minuara edhe në situatën e tillë do të ishin mbrojtje e mirë për bregdetin shqiptar”.<sup>182</sup> Jugosllavët më parë kishin përgatitur ekspeditën e ekspertëve për nxjerrjen e minave, mirëpo zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë gjendeshin para dilemës së hapur: të zhvillohej ky operacion në ujërat territoriale shqiptare me apo pa dijeninë e Komitetit Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave. Këshilli i Sigurimit, me kërkesën e ambasadorit britanik në OKB, më 18 janar 1947, e kishte vënë në rend dite çështjen e incidentit të Kanalit të Korfuzit, duke vënë kështu përballë argumentet dhe akuzat reciproke të qeverisë britanike dhe asaj shqiptare. Pikëpamjet e qeverisë shqiptarenë mbledhjen e Këshillit të Sigurimit i mbronte Hysni Kapo, atëherë përfaqësues diplomatik i Shqipërisë në Beograd, i cili njëkohësisht udhëhiqte edhe delegacionin e qeverisë shqiptare në Komisionin anketues të Këshillit të Sigurimit të OKB, në lidhje me incidentet greke në kufirin shqiptar. Sipas burimeve të proveniencës jugosllave, Hysni Kapo nuk kishte arritur në Nju Jork për të marrë pjesë në debatin e paralajmëruar për incidentin e Kanalit të Korfuzit. Prandaj, Andrej Gromiko, ministër i jashtëm i ish-BRSS, në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB kishte kërkuar që të shtyhej shtruarja e çështjes në rend dite të Këshillit të Sigurimit, derisa të arrinte delegati shqiptar. Në mbledhjen e KS të OKB, mbajtur më 19 shkurt 1946, ku ishte shtruar si pikë e

---

182 Po aty.

veçantë çështja e padisë britanike në lidhje me incidentin e përmendur, Hysni Kapo në një referatme mbi 40 faqe kishte paraqitur mbrojtjen shqiptare ndaj akuzave britanike, duke hedhur para tryezës së diplomacisë ndërkombëtare argumentete qeverisë shqiptare për të provuar se Shqipëria nuk mund të fajësohej për incidentin e Kanalit të Korfuzit. Hysni Kapo, fillimisht, kishte këmbëngulur se hyrja e luftanijeve britanike në ujërat territoriale shqiptare pa paralajmërim dhe në formacione lufte “nuk lë asnjë dyshim se të gjitha këto përbëjnë një provokacion dhe një cenim të sovranitetit të shtetit shqiptar...Ngjarja e 22 tetorit rrëzon pohimin e thjeshtë të qeverisë britanike se luftanijet angleze, duke hyrë në ujërat shqiptare nuk kishin qëllim armiqësor ose provokacioni. Ngjarja e 22 tetorit, me të gjitha aspektet e saj, tregon se nuk ndodhemi përpara një kalimi pa të keq sikundër pretendon qeveria britanike, por përpara një dhunimi të sovranitetit të shtetit shqiptar mbi ujërat territoriale”.<sup>183</sup> Diplomati shqiptar, në fjalimin e tij, kishte përmendur edhe faktin se qeveria shqiptare nuk kishte qenë e lajmëruar paraprakisht nga Komiteti Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave, duke kritikuar këto rast qëndrimin injorues të këtij organizmi ndërkombëtar ndaj qeverisë shqiptare, aq më parë kur në njënjofitim të qeverisë britanike, ndër arsytet e mosthirrjes së shtetit shqiptar në Komitetin Ndërkombëtar Qendror për Spastrimin e Minave, veçohej fakti se Shqipëria nuk kishte forca minambledhëse.<sup>184</sup> Kapo, pasi kishte theksuar se qeveria britanike duhej më parë të provonte saktësinë e akuzave të saj kundër Shqipërisë, më pas kishte insistuar në Konventën e Hagës dhe ishte përpjekur të paraqitej bindës në konstatimin se: “Qeveria shqiptare nuk i ka vënë minat, nuk ka ditur kush i ka vënë ato, ...dhe as që është përgjegjëse për sigurimin e lundrimit në ujërat e saj territoriale ose në

---

183 Po aty, f. 362-363.

184 Po aty, f. 367.

ngushticë".<sup>185</sup> Në paraqitjen e tij, diplomati shqiptar në mënyrë të tërthortë e mbronte edhe Jugosllavinë nga akuzat e hapura që, ato ditë, ishin bërë publike për bashkëfajësi, lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit. "Paranisjes nga Beogradi (për në Nju-Jork -A.Z) së bashku me ndihmësin e ministrit të jashtëm, V. Velebitin, e kishte përgatitur fjalën e tij lidhur me pranimin detyrimeve shqiptare të vendosura në Këshillin e Sigurimit".<sup>186</sup> Autorët shqiptarë mbronin qëndrimin se fjala e Hysni Kapos në Këshillin e Sigurimit ishte përgatitur sipas udhëzimeve të posaçme të Enver Hoxhës dhe ishte miratuar nga ky i fundit.<sup>187</sup> Rreth: "Përpilimit të kundër akuzës është mbajtur këshillim në Beograd (14 tetor 1948), ku morën pjesë prof. M. Bartosh, eksperti Ceroviç, Vohoçi, Tuk Jakova dhe Stila. Paraprakisht, rreth kësaj çështjeje, Vohoçi kishte punuar në përfaqësitë çekoslllovaqe në Tiranë dhe Beograd."<sup>188</sup> Madje, për tekstin e përmbajtjes së fjalës të Hysni Kapos në seancën plenare të Asamblesë së Këshillit të Sigurimit ishte njoftuar edhe Andre Gromiko, ministër i jashtëm sovjetik. Ndërsa, për ndërhyrjet e drejtpërdrejta jugosllave në zhvillimet e përmendura diplomatike, rreth incidentit të Kanalit të Korfuzit, dëshmonin angazhimet intensive që i kishte ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë përmes zyrtarëve të vet, të cilët, madje, ishin kujdesur që: "duhet të sigurohen ekspertë të përshtatshëm për anëtarësim në Gjyqin e Hagës dhe për mbrojtje, sepse pritej që akuza do t'i përcillej Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës".<sup>189</sup> Më 25 mars 1947, Këshilli i Sigurimit të OKB, pasnjë debati të nxehtë, kishte nxjerrë përfundime se fusha e minuar afër bregut të detit shqiptar nuk ka mundur të vendosej pa dijeninë e auto-

---

185 Po aty, f. 369.

186 Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 295.

187 Shih: Ndreçi Plasari, Rreth incidentit të Kanalit të Korfuzit, Studime historike 3-4, Tiranë, 1994, f. 124.

188 Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 308.

189 Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 296.

riteteve shqiptare, prandaj rekomandonte që qeveria shqiptare dhe ajo britanike të zgjidhnin kontestin, duke i paguar Britanisë së Madhe dëmshpërblimet përkatëse. Për këtë rezolutë votuan 7 pro ndër anëtarët e Këshillit të Sigurimit, mirëpo vota kundër e ambasadorit të Bashkimit Sovjetik bëri që kjo rezolutë të hidhej poshtë. Këshilli i Sigurimit, në bazë të kërkesës britanike, ishte detyruar që, në një debat tjetër, të mbajturnë prill të vitit 1947, rreth incidentit të kanalit të Korfuzit, të merrte vendim për ta dërguar çështjen për gjykim në Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës.<sup>190</sup> Përgatitjet për shtruarjen në rend dite të Gjykatës së Hagës të çështjes së incidentit të Kanalit të Korfuzit kishin filluar në shkurt të vitit 1948, kurse seanca e parë i nisi punimet më 9 nëntor të po të njëjtit vit. Shqipëria, edhe rreth kësaj çështje të rëndë dhe delikate për udhëheqjen e saj shtetërore të papërvojë në këto duele dhe fërkime ndërkombëtare, i zhvillonte konsultimet e ngushta dhe transparente me udhëheqjen jugosllave. Për përfaqësues të vet në seancën e përmendur gjyqësore kishte emëruar diplomatën Kahreman Ylli, i cili ishte udhëheqës i përfaqësuesit diplomatik në Paris. Mirëpo, zyrtarët e Ministrisë së Jashtme Jugosllave ishin të mendimit se përfaqësuesit dhe ekspertët që do të mbronin çështjen shqiptare në këtë seancë gjyqësore në Gjykatën e Hagës, fillimisht duheshin kërkuar në Çekoslovaki. Ambasadori jugosllav në Pragë kishte zhvilluar bisedime për këtë çështje me ministrin e atëhershëm të punëve të jashtme të Çekoslovakisë, i cili kishte propozuar pedagogun e Universitetit të Pragës, Jan Kramarzh. Ambasadori jugosllav e kishte hedhur poshtë këtë propozim me motivacionin se profesori i përmendur nuk kishte praktikë në proceset gjyqësore ndërkombëtare dhe se mund të binte nën ndikimin e britanikëve. Çështja e caktimit të gjykatësit dhe avokatit, në procesin gjyqësor të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, kishte qenë aktuale dhe

190 Ndreçi Plasari, vep. e cit., f. 125.



temë e diskutueshme edhe për një kohë në qarqet e Ministrisë së Jashtme Jugosllave, sepse Tirana zyrtare ua kishte lënë autoriteteve të Beogradit në kompetencë këtë përkujdesje.<sup>191</sup> Në këtë drejtim, një angazhim të veçantë kishte pasur ambasadori jugosllav në Pragë, Çernej, i cili personalisht kishte biseduar me kandidatët për gjykatës në Gjykatën e Hagës, rreth akuzës britanike. Kështu, mbi këtë bazë të marrë veshjeve reciproke ndërshtetërore, në maj të vitit 1949, pala shqiptare, duke iu përgjigjur pyetjeve të Gjykatës së Hagës në lidhje me lëndën që shqyrtohej në gjyq, paraprakisht kishte zhvilluar konsultime me autoritetet jugosllave të Ministrisë së Jashtme. “Menjëherë, lidhur me këtë lëndë, në ministrinë beogradase kishin mbajtur takim Tuk Jakova (përgjegjës i përfaqësisë diplomatike të Shqipërisë në Beograd -A.Z.) dhe ndihmës ministri i Jashtëm jugosllav, Alesh Bebler, kurse mendimin e vet për këtë çështje e paraqitën edhe diplomatët Leo Mates dhe J. Vilfan”.<sup>192</sup> Ndërkohë, çështja e procedurës së mëtutjeshme të vënies së çështjes së incidentit të Kanalit të Korfuzit në Gjykatëne Hagëskishte vazhduar të preokuponte edhe diplomatët në OKB. Ambasadori polak ishte i mendimit se çështja e akuzës britanike karshi qeverisë shqiptare duhej të vihej në votim në Këshilline Sigurimit, kurse Andre Gromiko mbronte qëndrimin se ishte më mirë që çështja të shtrohej në Gjykatën e Hagës, për faktin se çfarëdo vendimi që do të merrej nga ajo gjykatë nuk do të kishte elemente politike, për ç’ka ishin të mendimit edhe ekspertët jugosllavë.<sup>193</sup> Ndërkohë, pranë Këshillit të Sigurimit ishte dëgjuar referimii përfaqësuesit grek, i cili, në lidhje me incidentin e Kanalit të Korfuzit, kishte akuzuar Jugosllavinë, duke theksuar se: “Pas gjermanëve nuk kanë mbetur mina të mëdha as në Greqi e as në Shqipëri, mirëpo

---

191 Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 295.

192 Po aty, f. 303.

193 Po aty.

ekzistojnë të dhëna se minat e tilla janë ngarkuar në Tivar dhe në Dubrovnik, e më pas janë bartur në Sarandë".<sup>194</sup> Senanca e parë gjyqësore, lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit, filloi më 6 nëntor të vitit 1948, kurse vendimin përfundimtar gjyqi e dha më 9 prill të vitit 1949. Kjo procedurë gjyqësore, së bashku me shqyrtimin e çështjes së dëmshpërblimit, ishte ndër procedurat më të zgjatura, por edhe më të ndërlikuara që deri atëherë ishin debatuar e shtruar në Gjykatën e Hagës. Trupi gjykues përbëhej prej 16 anëtarësh, ndër të cilët kishte juristë të njohur nga Brazili, Kili, Belgjika, Franca, San Salvadori (kryetar i gjyqit), SHBA, Kina, Britania e Madhe, Meksika, Norvegjia, Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia, Kanadaja, Polonia dhe një nga Çeko-slovakia, i caktuar nga pala shqiptare si gjyqtar ad-hoc. Shqipërinë, në këtë lëndë gjyqësore, e mbroinin francezi Pierre Cot, jurist i zoti dhe mik i Shqipërisë, si dhe avokati tjetër francez Joe Nordman, kurse përfaqësues i qeverisë shqiptare ishte Kahreman Ylli, i cili, në pranverë të vitit 1949, ishte zëvendësuar nga Behar Shtylla, diplomati njohur shqiptar. Çështjet thelbësore në këtë procedurë të ndërlikuar gjyqësore shtroheshin mbi bazënse a ishte Shqipëria përgjegjëse për shpërthimin e minave dhe për dëmet që rrodhën nga këto shpërthime në Kanalin e Korfuzit, a duhej të paguante shteti shqiptar dëmshpërblime për këtë, a kishte shkelur Britania e Madhe ligjin ndërkombëtar dhe sovranitetin e Shqipërisë, fillimisht më 22 tetor, kur anijet britanike u ndeshën në mina dhe më 12 e 13 nëntor 1946, kur anijet britanike kryen në ujërat tokësore shqiptare operacionin "Retail". Në dhjetor të vitit 1948, Gjykata e Hagës kishte krijuar një Komitet Ekspertësh të Marinës me tre oficerë të lartë, një suedez, një norvegjez, një holandez, me qëllim që ata, pasi të kishin bërë hetime, të përcaktonin përgjegjësinë. Ata kishin shkuar për të bërë hetime në Sarandë dhe qytetin Shibenik të Kroacisë, dhe, në shkurt

---

194 Po aty.

të vitit 1949, ia parashtruan qëndrimet e tyre në tri rapor te Gjykatës së Hagës. Vendimi i Gjykatës së Hagës, i shpallur më 9 prill të vitit 1949, me 11 vota pro dhe me 5 kundër, e cilësoi Shqipërinë përgjegjëse për shpërthimin e minave që ndodhi më 22 tetor të vitit 1946 në ujërat e saj tokësore, si dhe për dëmet në njerëz që u shkaktuan nga incidenti. Si rrjedhojë e vendimit të tillë, Shqipëria detyrohej që t'i paguante dëmshpërblimet qeverisë britanike.<sup>195</sup> Me këtë vendim, edhe pse i tërë trupi gjykues kishte bindjen se minat nuk i kishin vënë shqiptarët, sepse në fakt as që kishin mina të tilla, Shqipëria bëhej përgjegjëse për faktin se duhej të tregohej më e vëmendshme ndaj asaj se çfarë po ndodhte në ujërat e saj, pra duhej të kishte diktuar edhe vendosjen e minave dhe të kishte lajmëruar për këtë në bazë të detyrimeve që dilnin nga ligji ndërkombëtar.<sup>196</sup> Po kështu, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës kishte marrë qëndrim, sipas të cilit Britania e Madhe, më 22 tetor, nuk e kishte shkelur sovranitetin e shtetit shqiptar, kur shpërthyen minat, ndërsa me veprimete datës 12 e 13 nëntor 1946 anijet britanike kishin shkelur sovranitetin e Shqipërisë, sepse kishin kryer një operacion spastrimi të minave pa marrë lejen e qeverisë shqiptare.

Me këto vendime, Gjykata e Hagës nuk ia doli që të nxirrte përfundime të qëndrueshme dhe të sakta, me të cilat do të zbulonte të vërtetën për vendosjen e minave në Kanalin e Korfuzit. Pasi ishte krijuar një përshtypje se Shqipëria nuk i kishte vendosur minat, filloi të përhapej supozimise, ose ato kishin mbetur që nga koha e luftës, ose ishin vendosur nga Greqia, Britania e Madhe dhe nga Jugosllavia. Ndërkaq, dihej se Kanali i Korfuzit ishte pastruar mirë dhe pasi ishte kontrolluar disa herë me kalime të veçanta të anijeve, lundrimi në të ishte shpallur i lirë dhe i sigurt. Më 12 korrik të vitit 1947,

195 Pro votuan Belgjika, Brazili, Britania e Madhe, Kanadaja, Kili, Kina, San Salvadori, Franca, Meksika, Norvegjia dhe SHBA, kurse kundër ishin Çekosllovakia, Egjipti, Polonia, Bashkimi Sovjetik dhe Jugosllavia.

196 Studime Historike, vep. e cit., f. 124.

dy ditë para se të nisej për në Moskë, Enver Hoxha, para deputetëve të Parlamentit Shqiptar, kishte deklaruar se minat fare lehtë mund t'i kenë vënë vaporët britanikë.<sup>197</sup> Por fare lehtë mund të shtrohej pyetja: Kush do të kryente një vepër të tillë monstruoze, një krim kundër vetvetes, kundër ushtarakëve të vet? Edhe Greqia ishte përjashtuar nga mundësia që t'i kishte vënë minat në Kanaline Korfuzit, sepse ajo nuk zotëronte më mina të tipit GY. Për këtë arsye, dyshimi drejtohej nga Jugosllavia, për të cilën kishte shumë supozime lidhur me vendosjen e minave. Në vitin 1947, qeveria britanike, duke hulumtuar rastin, kishte ardhur deri te të dhënat e grumbulluara nga dëshmitarë okularë që provonin se "Dy anije minavënëse jugosllave "Mljet" e "Meljine" kishin ngarkuar mina në portin e Shibenikut, më 16 tetor 1946, kurse të nesërmen ishin nisur drejt jugut. Më 17 tetor, i kishin parë të linin portin e Mandalinës, të qëndronin një copë herë në Kotor për t'u rifurnizuar dhe të merrnin drejtimin nga ujërat shqiptare, për kryerjen e një "detyre të rëndësishme". Pastaj i kishin parë këto anije të ktheheshin më 26 tetor në bazën e Mandalines".<sup>198</sup> Pala britanike i mbështeste mbarështrimet e veta, duke u bazuar në dëshminë e komandantit të një luftanije jugosllavete quajtur Kovaçiç, i cili kishte dezertuar në tetor të vitit 1947 nga Marina Jugosllave. Ekspertët e Gjyqit të Hagës, më pas kishin shkuar në Shibenik, Mandalina dhe Kotorr të Malit të Zi për të vërtetuar saktësinë e dëshmimeve të Kovaçiçit, por nuk kishin hasur në gjurmë konkrete. Kjo ishte arsyeja që Gjyqi i Hagës nuk i vlerësoi të plota e krejtësisht të sakta të dhënat e britanikëve dhe ato të dëshmitarit Kovaçiç. Gjithashtu, "pafajësisë" së jugosllavëve i dhanë dorë edhe qëndrimet e ndërhyrjet e avokatëve të Shqipërisë, të agjentit e të dëshmitarëve shqiptarë, të cilët këmbëngulnin se jugosllavët s'kishin gisht në vënien e minave në Kanaline Korfuzit

<sup>197</sup> "Bashkimi", 13 korrik 1947.

<sup>198</sup> L. Gardiner, vep. e cit., f. 184-188.

(!) dhe për të treguar se edhe Shqipëria s'kishte gisht fare në këtë çështje.<sup>199</sup> Pra, të dhëna te britanikëve mbetën në suazat e supozimeve. Ndërsa, insistimi i avokatit britanik Soskice se minat mund të ishin vënë nga vetë jugosllavët pa dijeninë e shqiptarëve, me qëllim që ta fusnin qeverinë e Tiranës në grindje edhe më të rrepta me anglo-amerikanët dhe kështu të përgatiste terrenin për aneksimin e Shqipërisë, për Gjqin e Hagës kishin mbetur në rrafshin e argumenteve pa mbulesë, të karakterit të presioneve diplomatike. Ndaj nuk ishte e rasti që mbrojtësit britanikë, në paraqitjen e tyre të fundit në seancën gjyqësore për incidentin e Kanalit të Korfuzit, duke mos u bindur as me argumente te mbrojtësve shqiptarë, kishin mbrojtur qëndrimin se: "Qeveria e Tiranës e ka shtyrë Jugosllavinë të vendosë minat për të, si alternativë kjo e përpjekjeve të përbashkëta midis dy vendeve".<sup>200</sup> Pala jugosllave "nuk inkriminohej para gjyqit meqë konsiderohej se vendosja e minave ishte bërë me kërkesën e palës shqiptare dhe me qëllimin e saj".<sup>201</sup> Lidhur me vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, 36 vjet më pas, Enver Hoxha do të shkruante: "Gjykata doli me konkluzionin e paargumentuar se Britania, më 12 e 13 nëntor, kishte shkelur sovranitetin e Shqipërisë, ndërsa më 22 tetor, jo". U duk haptazi se Shqipëria duhej quajtur patjetër fajtores, sepse ky ishte urdhri e dëshira e "më të madhit".<sup>202</sup>

Analizuar nga distanca e sotme historike, edhe pse Gjyqi i Hagës në hulumtimin e kësaj lënde gjyqësore nuk kishte arritur të përcaktonte se kush i kishte vënë minat në Kanalin e Korfuzit, mund të hidhen disa supozime rreth kësaj ngjarjeje, pasojat e së cilës më së rëndi i ndjeu pikërisht Shqipëria. Në vitet e para të pasluftës, e veçmas në vjeshtën e vitit 1946, në radhë të parë, duhet pasur parasysh relacioni shumë i afërt i marrëdhënieve diplomatike e shtetërore midis Shqipërisë

199 Studime Historike, vep. e cit., f. 128.

200 L. Gardiner, vep. e cit., f. 220.

201 "Zëri", vep. e cit.

202 Enver Hoxha, Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë, Tiranë, 1982, f. 406.

dhe Jugosllavisë, marrëdhënie këto, të cilat në shumë fusha, pra edhe në atë të sigurisë e të mbrojtjes dhe të sferës diplomatike, ishin të ndërvarura, kurse vetë pozita e Shqipërisë ishte nënshtruese. Jugosllavët, veçanërisht pas nënshkrimit të Konventës për bashkëpunim ekonomik me Shqipërinë, kishin krijuar rrethana të reja për ndikim dhe ndërhyrje në të gjitha lëmenjtë e zhvillimeve dhe në strukturat e shtetit shqiptar. Ndaj, nuk ishte e rastësishme pse jugosllavët me të gjitha format, në mënyrë të organizuar dhe të paramenduar, ndërhynin, sidomos në ato çështje ku mund të ndikohej në keqësimin edhe më dramatik të marrëdhënieve atë kohë gjithnjë e më të ftohta midis shtetit shqiptar dhe vendeve perëndimore, në radhë të parë me angloamerikanët. Sa për ilustrim të rasteve të kontrollimit dhe mbikëqyrjes së zhvillimeve dhe veprimeve politike të strukturave shtetërore e partiake të Shqipërisë nga ana e jugosllavëve, mund të marrim si shembull radiogramin e Aleksandër Rankoviçit, atë kohë ministër i Brendshëm i Jugosllavisë, drejtuar homologut të tij Koçi Xoxe, më 10 shtator 1946, një muaj para se të ndodhte incidenti i kanalit të Korfuzit. Rankoviçi i drejtohej Koçi Xoxes në lidhje me korrespondentin e një gazete britanike, i cili kishte shprehur dëshirën që të vizitonte Shqipërinë.

Ministri i Brendshëm i Jugosllavisë dhe bashkëpunëtori më i afërt i atëhershëm i Titos, Aleksander Rankoviç, gjithsesi, duke ndjerë kompetencë absolute që t'i jepte urdhra e direktiva ministrisë shqiptare, i ishte drejtuar ministrit të Brendshëm shqiptar, Koçi Xoxe, me këtë radiogram ultimativ: "Mbasi ky person merret në radhë të parë me punët informative do të ishte mirë që në këtë situatë të mos i jepni lejen e hyrjes për në Shqipëri, në rast se do ta kërkonte".<sup>203</sup> Përmbajtjet e radiogrameve që kishin qarkulluar në relacionin Tiranë-Beograd dhe anasjelltas, nga data 23 deri më 28 tetor, të nënshkruara nga Rankoviçi dhe Xoxe, dëshmonin

203 AMB.D. 1623/9.

qartë për interesimin e veçantë të jugosllavëve lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit, ndërsa përmbajtja e këtij komunikimi midis dy ministrave të Punëve të Brendshme ofronte argumente të mjaftueshme për të kuptuar pse jugosllavët ishin aq energjikë dhe këmbëngulës për të përcjellë çdo detaj të qëndrimeve të diplomacisë shqiptare rreth incidentit. Nga përmbajtjet e udhëzimeve, porosive dhe urdhrave të Rankoviçit drejtuar Xoxës, lidhur me mënyrën e trajtimit të incidentit dhe përgjigjet që duhej t'i jepte qeveria shqiptare para opinionit ndërkombëtar, në radhë të parë para qeverisë britanike, dilte qartë arroganca e jugosllavëve edhe përzierja flagrante në çështjete brendshme të politikës shqiptare. Natyrisht, përmbajtjet e radiogrameve dëshmonin se jugosllavët ishin jashtëzakonisht të interesuar për zhvillimet që do të pasonin pas incidentit të Kanalit të Korfuzit. Sigurisht, qëllimi jugosllav ishte që qeveria shqiptare të armiqësohej edhe më keq me anglo-amerikanët dhe kështu ta detyronin udhëheqjen shtetërore dhe partiake shqiptare që të drejtohej për bashkëpunim dhe ndihmëve të kah qeveria jugosllave. Koçi Xoxe, në radiogramin e parë drejtuar A. Rankoviçit, lidhur me incidentin e kanalit të Korfuzit, më datë 23 tetor 1946, vetëm një ditë pas shpërthimit të minave, e njoftonte: "Në pasditene datës 22 të këtij muaji u panë katër vapore anglezë të udhëtonin për në Korfuz gjatë bregdetit të Sarandës. Njëri prej tyre takoi në një minë (në të vërtetë u ndeshën në mina dy luftanije - A. Z) dhe u ndez në flakë. Tjetri zbarkoi me barkë ushtarëtrreth vaporet të djegur..."<sup>204</sup> Ndërlidhësi i Koçi Xoxes, Shpend Draga, punonjës në Legatën Shqiptare në Beograd, në komunikimin me Rankoviçin, më 25 tetor të të njëjtit vit, në radiogramin dërguar Koçi Xoxes, pasi e njoftonte se personalisht ia kishte dorëzuar Rankoviçit radiogramin, i bënte të ditur ministrit të brendshëm shqiptar se, Rankoviçi i kishte thënë: "Junuk i keni thirrur ata në vend

---

204 Po aty

intuaj. Mirë ka menduar Koçi. Duhet me të vërtetë të dyja protestat ku të theksohet se ato kanë qenë mina të vjetra, se ky është provokacion”.<sup>205</sup> Të nesërmen, më 26 tetor, në adresë të Koçi Xoxes ishte dërguar me shenjën tepër urgjent nga Legata Shqiptare në Beograd, radiogrami, i cili përmbante mendimet e A. Rankoviçit për çështjene incidentit të Kanalit të Korfuzit. Rankoviçi, fillimisht, kërkonte të njoftohet nëse qeveria shqiptare i kishte bërë protestat në lidhje me incidentin, dhe, më tej udhëzonte të mos qëlloheshin vaporët britanikë, vetëm të shënoheshin mirë të gjitha lëvizjet e tyre dhe mënyrat e provokimeve. Për sa u përket provokimeve greke në kufirin shqiptar, Rankoviç udhëzonte: “... si gjithnjë, kur të cenonë tokën, qëlloni”.<sup>206</sup> “Ju nuk i keni thirrur vaporët anglezë në ujërat tuaja? Mirë e kanë pësuar”.<sup>207</sup> Më 27 tetor 1946, me një radiogram tjetër, Koçi Xoxe i ishte drejtuar A. Rankoviçit, të cilin e njoftonte: “Protestën, në lidhje me luft anijet britanike, mendojmë që t’ia drejtojmë Këshillit të Sigurimit ose drejtpërdrejt qeverisë britanike ose dota lëmë në heshtje, këtë dota bëjmë në rast se e shohim që anglezët nuk do t’i vënë rëndësi”.<sup>208</sup> Xoxe njëherit e njoftonte Rankoviçin se ai do të gjendej në Beograd më 5 nëntor. Komunikimi intensiv midis Koçi Xoxes dhe Rankoviçit kishte vazhduar edhe më 28 tetor 1946, kur Shpend Draga ia dërgonte Koçi Xoxes radiogramin me udhëzimet e Titos e të Rankoviçit për incidentin në Kanalin Korfuzit. Në këtë radiogram shkruhej: “Rankoviçi tha tamam ashtu si mendoni ju, domethënë, në qoftë se drejtohen për të hyrë në portintonë, dakord, të qëllohen, por në qoftëse kanë drejtime të tjera, pa iu drejtuar portit tonë, të mos qëllohen dhe është mirë të heshtet”.<sup>209</sup> Në radiogram përshkruhej reagimi i Rankoviçit

205 Po aty.

206 Po aty,

207 Po aty,

208 Po aty,

209 Po aty,



pasi kishte lexuar notën e qeverisë britanike dërguar qeverisë shqiptare, biseda telefonike me Titon, të cilin e kishte njoh-tuar për notën e qeverisë britanike, si dhe citohej Rankoviç të kishte thënë se, Tito kishte deklaruar: “Nuk kanë të drejtë. Qeveria shqiptare të bëjë protestën, ku të theksojë se masat e spastrimit të minave do të përgatiten për t’i bërë vetë qeveria shqiptare”.<sup>210</sup> Analiza koncize e përmbajtjes së këtyre radiogrameve, të cilat, për gjashtë ditë me radhë pas shpërthimit të minave në Kanalin e Korfuzit, qarkulluan në mes të Koçi Xoxes dhe Aleksandër Rankoviçit, flisnin qartë se jugosllavët ishin jashtëzakonisht të preokupuar për incidentin dhe se e kishin vënë në gjendje gatishmërie tërë aparatit e Ministrisë së Jashtme, madje, me këtë çështje merrej drejtpërdrejtë dhe vetë Tito. Interesimi dhe shqetësimi i jugosllavëve, sigurisht, se nuk kishte të bënte me mbrojtjen e qeverisë shqiptare nga vërsuljet diplomatiketë anglo-amerikanëve në Këshillin e Sigurimit, por edhe përkërcënimet me sulm të armatosur nga ana e trupave britanike, sidomos më 12 e 13 nëntor 1946. Gjithsesi, jugosllavët çmonin se ndërlikueshmëria e situatës mund të shkonte në dëm edhe të jugosllavëve nëse zbuloheshin e vërteta dhe në rast se, eventualisht, cenohej integriteti territoriali Shqipërisë, të cilën në atovite e konsideronin gati si provincat tjera të ish-Jugosllavisë. Dyshimet se jugosllavët kishin gisht në vendosjen e minave në Kanalin e Korfuzit nuk ishin të pabaza, veçmas kur analizohej i tërë shqetësimi i tyre për zhvillimin e situatës që u reflektua pas incidentit. Siç shihet nga përmbajtja e radiogrameve, ata e përcillnin nga çastinë çast situatën me shumë shqetësim dhe nga Beogradit jepnin udhëzime e urdhra për veprimete caktuar të diplomacisë shqiptare. Gjatë debateve të shumta në Gjyqin e Hagës, në pyetjet se përse jugosllavët kishin mundur t’i vendosin minat, britanikët kishin përmendur zemërimin e Titos ndaj britanikëve me rastin e kundërshtimit të këtyre të fundit

---

210 Po aty,

që Jugosllavia ta merrte Trieshtën. Një analizë më e mbështetur dhe më e thellë argumenton më tepër tezën, sipas të cilës jugosllavë te kishin ndërmarrë këtë veprim për të përshpejtuar planet e tyre për gllabëritjen e Shqipërisë përmes bashkimit të shtetit shqiptar me Jugosllavinë, përkatësisht, krijimit të republikës së shtatë. Gjithashtu, është sinjifikative e dhëna për komunikimin ekskluziv që ishte zhvilluar, lidhur me incidentin e Kanalit të Korfuzit, nëpërmjet Koçi Xoxes dhe Aleksandër Rankoviçit, të cilët në atë kohë mbanin postet e ministrave të Punëve të Brendshme në qeveritë e shteteve të tyre. Ky fakt është domethënës, duke pasur parasysh edhe rolin që, në vitet e para, kishte luajtur Koçi Xoxe në marrëdhëniet dhe komunikimin shqiptaro-jugosllav. Së fundi, Xoxe personalisht për Rankoviçin dhe Titon ishte shumë më i besueshëm se vetë Enver Hoxha. Në lidhje me këtë incident, Enver Hoxha prononcohej fare pak publikisht, jo vetëm në vitin 1946 kur ndodhi shpërthimi i minave, por edhe në vitet më pas, sidomos në fjalimet, kujtimet dhe veprat e tij të karakterit memo aristik. Historiografia më e re shqiptare, në trajtesat për këtë incident dhe ndërhyrjen transparente jugosllave, kryesisht, mbron qëndrimin se: "Minat i kanë vënë jugosllavët me dijeninë e pëlqimit të Enver Hoxhës. Për këtë kanë pasur dijeni, përveç E. Hoxhës, një numër fare-fare i vogël ndër udhëheqësit... Nuk i ka shtyrë qeveria e Tiranës jugosllavët të vinin minat, por jugosllavët i kanë vënë ato me iniciativën e tyre dhe me dijeninë e me pëlqimit, jo të gjithë qeverisë shqiptare, por të Enver Hoxhësme 4-5 udhëheqës të tjerë kryesorë të Partisë Komuniste e të qeverisë".<sup>211</sup> Siç shihet, ky autor nuk e lë të hapur mundësinë për të supozuar se jugosllavët i kishin vendosur minat vetëm në marrëveshje me Koçi Xoxen, tek i cili mbështetnin besimin e plotë për realizimin e politikës së tyre ndaj shtetit shqiptar, pra, pa dijeninë e Enver Hoxhës. Në këtë supozim na shtyn deri diku

211 Studime Historike, vep. e cit., f. 129

e vërteta se Enver Hoxha, siç theksuam më lart, në fjalimet, referatet dhe veprat e veta shumë rrallë fliste apo shkruan-  
tepër incidentin e Kanalit të Korfuzit. Kjo, deri në atë masë sa  
na shtyn të parashtrojmë pyetjen: “A thua Enver Hoxha, që  
sipas dokumenteve të arkivave perëndimore ishte në dijeni  
për vendosjen e minave në Kanalin e Korfuzit dhe qëllimisht  
e kishte heshtur dhe fshehur incidentin tragjik të 22 tetorit të  
vitit 1946?”. Dhe, edhe në rastet kur e kishte përmendur inci-  
dentin në Kanalin e Korfuzit, Enver Hoxha, pra, kur i kishte  
akuzuar anglo-amerikanët për vendosjen e minave, këtë e  
kishte bërë pa ndonjë argument të mbështetur në fakte, duke  
fokusuar çështjen në radhë të parë në akuzat apriori ndaj  
amerikanëve dhe britanikëve, duke i cilësuar ata si “imperi-  
alistë”.

Enver Hoxha, në raportin në Kongresin e I të PKSH, nën-  
tor 1948, në lidhje me incidentin sipër përmendur, kishte  
pohuar: “Minat fare lehtë mund t’i kenë vënë vaporet britan-  
ikë ose shërbëtorë te tyre të Athinës...”

Provokacionet në Kanalin e Korfuzit, imperialistët anglo-  
amerikanë u përpoqën t’i përdornin si pretekst për zbarkim,  
po objektivi i tyre dështoi dhe u demaskuan nga qeveria jonë  
dhe nga përfaqësuesit sovjetikë në Këshillin e Sigurimit”.<sup>212</sup>  
Shumë vite më vonë, ai do t’i rikthehej vetëm fragmentarisht  
çështjes së incidentit të Kanalit të Korfuzit, duke shkruar:  
“Mundet që minat të ishin vendosur që gjatë luftës nga gjër-  
manët, por s’përrjashtohet probabiliteti që këto të ishin vënë  
nga vetë anglezët për të krijuar konflikt. Bosët e Admiralisht  
Britanik mund t’i kenë drejtuar anijet për atje, duke pasur-  
parasysh edhe faktin që ato ishin rrangula. Natyrisht, mari-  
narët që ishin në to, nuk mund të dinin se po lundronin drejt  
vdekjes”.<sup>213</sup> Incidentin e Kanalit të Korfuzit, Enver Hoxha e  
kishte përmendur edhe në bisedimet e para me Stalinin në

---

212 Enver Hoxha, Vepra, vëll. 4, f. 112-113.

213 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 402.

Moskë, më 14 korrik, duke i thënë: “Incidenti i Kanalitë Korfuzitu krijua kokë e këmbë nga anglezët për të provokuar vendin tonë dhe për të gjetur pretextin e ndërhyrjes ushtarake në qytetin Sarandës. Ne nuk kemi pas vendosur kurrë mina në detin Jon. Ato që shpërthyen, ose kishin qenë vendosur nga gjermanët që në kohën e luftës, ose qenë vënë qëllimisht më vonë prej anglezëve që t’i shpërthenin në kohën kurdisa anije të tyre të ndodheshin në ujërat tona territoriale, në drejtim të Sarandës”.<sup>214</sup> Enver Hoxha e ka ditur të vërtetën për incidentin e Kanalit të Korfuzit, por shtrohet pyetja: Pse atëherë atë nuk e shpaloj në periudhën pas prishjes së marrëdhënieve me jugosllavët? Me hezitimin eventualisht të qëllimtë që të fshihej e vërteta për incidentin e Kanalit të Korfuzit, Enver Hoxha, edhe shumë vite pas prishjes me jugosllavët, i mbronte ata nga përgjegjësia për vendosjen e minave në ujërat tokësore shqiptare, sepse donte të mbronte edhe veten, nga që minat ishin vendosur me pëlqimin e tij. Dihet se, jugosllavët me manovrimet diplomatike gjatë kohës së mbajtjes së seancës gjyqësore në Hagë, veçmas duke hedhur poshtë përpjekjet britanike që në këtë incident të implikonin edhe Jugosllavinë dhe me kualifikimin e këtyre përpjekjeve “si një manovër politike e ndyrë”<sup>215</sup>, në fakt, ata të gjithë fajin për incidentin ia kishin lënë Shqipërisë.

Politika e jashtme e qeverisë shqiptare, edhe në vitin 1947, në masë të madhe determinohej nga zhvillimet e vështira të politikës së përgjithshme ndërkombëtare që në atë periudhë imponohej në Ballkanë më gjerë. Këtë politikë, në raport me çështjen shqiptare, e karakterizonin kryesisht dy momente. Së pari, pretendimet e shteteve fqinje, në radhë të parë të Jugosllavisë dhe të Greqisë, që secila në mënyrën e vet pretendonte të kontrollonte situatën në Shqipëri, e përmes asaj edhe të impononte politikën e vet të ndërhyrjes në çështjet e brend-

---

214 Enver Hoxha, *Me Stalinin*, Tiranë, 1979, f. 66-67.

215 L. Gardiner, *vep. e cit.*, f. 220.

shme të shoqërisë shqiptare. Së dyti, reflektimet e luftës së ftohtë ideologjike në mes blloqeve Perëndim e Lindje, e cila, në ato vite, kishte përfituar elemente të reja të acarimit. Ky acarim, jo vetëm ideologjik, por edhe ushtarak, midis Perëndimit dhe Lindjes, në rastin e Shqipërisë reflektohej me pretendimet e hapura gjeostrategjike të superfuqive të atëherëshme botërore. Ndaj, nuk ishte çështja vetëm te orientimi ideologjik, komunist, prolindor i qeverisë shqiptare, por në radhë të parë lufta diplomatike e Fuqive të Mëdha zhvillohej për të siguruar praninë ushtarake në detin dhe portat detare shqiptare. Kuptohet se, Jugosllavia ishte më e pranishmja në këtë plan, ndaj edhe interesimi i saj për zhvillimet në Shqipëri dhe rreth saj ishin shumë më të drejtpërdrejta dhe më transparente. Shqipëria, në këtë kohë, në analiza të shumta të perëndimorëve cilësohej si një provincë jugosllave, politikën e së cilës e drejtonte Beogradi përmes ndërhyrjeve në punët shtetërore, partiake dhe ato të politikës së jashtme. Ndërkohë, në pranverën e vitit 1947, konkretisht në muajt prill dhe maj, në bazë të depeshave të përfaqësisë diplomatike jugosllave dërguar nga Tirana në adresë të Ministrisë së Jashtme Jugosllave, për herë të parë vlerësohej se politika e jashtme shqiptare po ndërtohej e zhvillohej plotësisht mbi linjën e politikës së BRSS dhe Jugosllavisë.<sup>216</sup> Raporti informativi përfaqësisë jugosllave në Tiranë, dërguar në prill të vitit 1947 Ministrisë së Jashtme Jugosllave në lidhje me politikën e jashtme shqiptare, vinte në theks tri segmente kryesore. Së pari, veçonte ardhjen e ministrit fuqiplotë bullgar në Shqipëri, pastaj kthimin e përfaqësuesit francez në Paris, si dhe veçonte ofertën italiane që të vendoseshin marrëdhëniet diplomatike në mes të Shqipërisë dhe Italisë. Në raport thuhej se, pasi përfaqësuesi i mëparshëm bullgar në Tiranë, në kohën e kthimit në Sofje, ishte burgosur, përfaqësuesi i ri diplomatik i Bullgarisë në takimin e parë me Enver Hoxhën që kishte zgjatur diku

216 ASHMPJ, A 1947/II, nr. I, Sekr. br. 48090.

afro gjashtë minuta nuk kishte hapur asnjë çështje me rëndësi të veçantë për marrëdhëniet ndërshtetërore. Mirëpo, raporti apostrofonte të dhënën se diplomati bullgar, në takimin me përfaqësuesit diplomatik jugosllav në Tiranë, hapur ishte angazhuar për konfederatën ballkanike.<sup>217</sup> Ndërsa, në lidhje me kthimin në Shqipëri të përfaqësuesit diplomatik francez, Gij Menant, në raportin e sipërpërmendur theksohej se në takimin që kishte pasur me Enver Hoxhën, ai i kishte përcjellë interesimet e qeverisë franceze që Shqipërisë t'i ofrohej ndihmë e konsideruar ekonomike, madje duket reguar gatishmëri që t'i ripërtërinin me shtetin shqiptar të gjitha marrëveshjet e paraluftës mbi bazat jokapitaliste. Diplomati francez në takimin me Enver Hoxhën kishte përsëritur se ndihma franceze përfshinte edhe lëminë e kulturës, duke kërkuar nga kryeministri shqiptar që të rikthehej lënda e gjuhës frënge nëpër shkollat shqiptare. Gjithashtu, kishte propozuar edhe hapjen e një librarie franceze. Propozime të diplomatit francez nuk ishin pranuar. Në një takim rasti me përfaqësinë jugosllave në Tiranë, diplomati francez kishte deklaruar se në takimin me Enver Hoxhën dhe funksionarët tjerë shqiptarë ishte pritur ftohtë dhe me rezervë. Pikërisht, në këtë periudhë, Enver Hoxha ishte i mendimit se aktiviteti i theksuar francez ishte i inspiruar nga ana e Britanisë së Madhe dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose nga të dy shtetet bashkërisht. Koçi Xoxe besnikërisht i kishte lajmëruar miqtë jugosllavë: “Për faqësia franceze po shërbehet me të njëjtin rrjet informativ, të cilin e kishin përdorur edhe amerikanët dhe kishte zhvilluar aktivitetin që të përfitonte edhe elementet e reja të antiregjimit”.<sup>218</sup> Përsa i përket ofertës italiane për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Romës dhe Tiranës, qeveria shqiptare nuk ishte treguar e gatshme që për momentin të jepte përgjigje pozitive për këtë ofertë diplomatike.

217 ASHMPJ, A 1947/II, nr. 50/III, Sekr. nr. 46781.

218 ASHMPJ, A 1947/II, Sekr. nr. 46718.

Madje, Enver Hoxha, në një takim rasti, i kishte thënë një zyrtari të lartë të përfaqësisë diplomatike jugosllave se shqiptarët e dinë se Italia nuk ka hequr dorë nga pretendimet e saja ekspansioniste ndaj Shqipërisë.<sup>219</sup> Në korrik të vitit 1947, qeveria shqiptare kishte refuzuar ftesën britanike dhe franceze për të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare për Planin Marshall, ku parashihej që në ndihmën e madhe ekonomike nga SHBA të përfshiheje dhe Shqipëria. Përgjigja e qeveritarëve shqiptarë në lidhje me këtë ftesë ishte e paluhatur dhe mbështetej në qëndrimin jugosllav, sipas të cilit: “Kushtet për realizimin e këtij plani nënkuptonin edhe përzierjen në punët e brendshme të anëtarëve që e pranojnë këtë plan”.<sup>220</sup> Në vjeshtën e vitit 1947, çështjet parësore në politikën e jashtme shqiptare kishin të bënin me zgjidhjen e çështjes greke në forumet ndërkombëtare dhe zhvillimet në Greqi, reflektimet për pozitën e Shqipërisë në lidhje me incidentin e Kanalit të Korfuzit, si dhe ratifikimin e marrëveshjes paqësore me Italinë, ndërkohë që incidentet në kufirin shqiptaro-grek nuk kishin të ndalur. Përsa i përket nënshkrimit të marrëveshjes paqësore me Italinë, duhet përmendur se përfaqësuesi shqiptar këtë nënshkrim e bëri në cilësi të vëzhguesit, pasi paraprakisht e kishte marrë pajtimin nga ambasadori sovjetik në Paris.<sup>221</sup> Në muajt e fundit të vitit 1947, qeveria shqiptare, nën ndikimin e ndërhyrjeve jugosllave në politikën e brendshme dhe të jashtme të saj, ndodhej para një ftohjeje të veçantë diplomatike në marrëdhënietme shtetet perëndimore dhe nuk ishte vështirë të supozohej se shtetin shqiptar, në atë fundvit dhe në fillim të vitit 1948, po e prishte një izolim dhe bllokadë jo vetëm diplomatike në planin ndërkombëtar, karshi shteteve perëndimore. Mirëpo, në këtë periudhë, për herë të parë paraqitet një tendencë re në poli-

219 Po aty.

220 ASHMPJ, A 1947/II, nr. 90/I, Sekr. nr. 412503.

221 ASHMPJ, A 1947/II, nr. 11/IV, Sekr. nr. 41908, Komrshrli për situatën e politikës së jashtme të Shqipërisë gjatë vitit 1947.

tikën e jashtme të Shqipërisë në raport me Jugosllavinë, që u reflektua në acarimin e marrëdhënieve ekonomike midis dy shteteve. Provenienca jugosllave mbronte qëndrimin se, në fundvitin e 1946, në kreun shtetëror e partiak të shtetit shqiptar po formësoheshin dy konceptione politike të politikës së jashtme: “Mbështetja në Jugosllavinë (Koçi Xoxe) dhe mbështetja drejtpërdrejt në BRSS (Nako Spiru). Deri në vizitën e tij në Moskë, Enver Hoxha konsiderohej si përfaqësues i linjës jugosllave. Duke parë shtetin e madh dhe duke marrë premtime për ndihmë dukshëm më të madhe sesa që mund t’i ofronte Jugosllavia, veçmas në planin politik ndërkombëtar, Hoxha iu mbështet linjës sovjetike”.<sup>222</sup> Nga kjo periudhë filluan të bëhen gjithnjë e më transparente mosmarrëveshjet dhe të çarat në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

## Kapitulli i katërt

---

<sup>222</sup> Bogumil Hrabak, vep. e cit., f. 306.



## BASHKËPUNIMINËN DIKTAT

Plenumii 2-tëi KQ të PKSH, mbajtur prej 23-27 nëntor të vitit 1944, hapi portat e bashkëpunimit nën diktat midis PKSH dhe PKJ, rrjedhimisht PKSH gjendejnë pozitë të varshmerisë nga jugosllavët. Vërtet, ishte një kohë tjetër nga ajo e viteve të para të Luftës së Dytë Botërore që kishte përfshirë edhe Shqipërinë, kohë kur PKSH, veçanërisht pas prishjes së Konferencës së Mukjes po binte nga gabimi në gabim, nga dështimi në përçarje. “Që të arrihej ky nënshtrim, PKSH duhej të përçahej. Fara e përçarjes ishte mbjellë një vit më parë me grindjet që kishte ngritur në udhëheqësin partiakë S. V. Tempo dhe me favorizimin që i bënte Koçi Xoxes. Por, me Stojniçin filloi përçarja e drejtpërdrejtë e PKSH, ndërhyrja më brutale në zhvillimin politik të Shqipërisë me pasoja të rënda e tragjike për Shqipërinë, si dhe për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllavo”.<sup>223</sup> Dokumentet e kohës dëshmojnë se ndërhyrja e PKJ në veprimtarinë e PKSH dhe përgjithësisht në drejtim të Lëvizjes Antifashiste Shqiptare, si dhe nënshtrimi deri në përulje i PKSH ndaj PKJ, ishin rast i veçantë në raportete atëhershme midis lëvizjeve antifashiste dhe partive komuniste në Evropën Juglindore. Prandaj, në shqyrtimin kritik të marrëdhënieve politike shqiptaro-jugosllave për periudhën në fjalë, në radhë të parë, duhet të kemi parasysh ngarkesat dhe divergjencat e mëdha, të cilat i karakterizuan këto marrëdhënie në prag të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Kjo ndërhyrje e një partie ndaj tjetrës, dhe ky nënshtrim i një partie ndaj një partie tjetër, nuk ndodhi vetëm pse PKJ vazhdimisht kishte synim ndërhyrjen deri në nënshtrim të PKSH. Përkundrazi, aspiratat e ndërhyrjes së pashembullt të PKJ ndaj PKSH duhen kërkuar qysh nga kohërat dhe vitet e traditës së ndërhyrjeve serbe e jugosllave në punët e brendshme të Shqipërisë. “Qysh prej pavarësimit të saj janë të thel-

223 Fehmi Agani, Demokracia, kombi, vetvendosja, Pejë, 1994, f. 66.

la rrënjët e hegjemonizmit serbo-jugosllav ndaj Shqipërisë e zonave shqiptare". Vërtet, në fund të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, komunistët shqiptarë ishin fitimtarë të luftës për çlirim nga nazifashizmi dhe nuk kishin pse të ndiheshin inferiorë as ndaj jugosllavëve, mirëpo historia tregonse ata nuk vepruansipas logjikës historike. Ka autorë, të cilët, ndër faktorë të varësisë së PKSHP në raport me PKJ, edhe në fillim të vitit 1945, radhisin edhe "... komponentin psiko-social të "elitës" shqiptare, veçanërisht të asaj politike, mungesën e vetëbesimit që e karakterizonte këtë shtresë që nga mëvetësia e Shqipërisë".<sup>224</sup> Sido që të jetë, nga fundi i luftës dhe fillimi i vitit 1945, raportet politike shqiptaro-jugosllave i karakterizonte ofensiva permanente diplomatike e udhëheqjes jugosllave për të thelluar kursin e bashkëpunimit mbi programin dhe platformën pushtuese jugosllave. Pala shqiptare, konkretisht PKSHP dhe udhëheqja e saj, e aprovonin atë rrugë të bashkëpunimit pa hezitim dhe pa ndonjë qëndrim apo vërejtje kritike. Nuk ishte e rastësishme pse marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në fillim të vitit 1945, po rrëshqisnin në drejtim të varësisë së plotë të palës shqiptare nga ajo jugosllave dhe se në këtë kuptim mund të supozohej se Shqipëria ishte nën sferën e interesit jugosllav. Kjo vërteton konstatimin se PKJ, me ndërhyrjen në veprimtarinë e PKSHP, po vazhdonte traditën e ndërhyrjeve jugosllave në çështjet e brendshme shqiptare. Por, "mandati" jugosllav për t'u kujdesur ndaj zhvillimeve në Shqipërinë e re socialiste ishte siguruar edhe nga zhvillimet diplomatike ndërkombëtare të kohës në gjirin e kampit socialist. Konkretisht, "Bashkimi Sovjetik gjatë luftës nuk është marrë me Shqipërinë, duke ia lënë kujdesin për të Jugosllavisë, përkatësisht PKJ, përmes Kominternës, qysh nga viti 1939. Vetëm para përfundimit të luftës, BRSS filloi përmes PKJ të interesohej për Shqipërinë dhe për përbërjen kuadrore të PK të Shqipërisë... Në situ-

---

224 Po aty, f. 75.

atën e pasluftës raportet ndryshuan, sepse përmes Jugosllavisë dhe Shqipërisë, BRSS del në të ashtuquajturat detra të nxehta...”<sup>225</sup>

Pavarësisht nga ky rol kominternist që i ishte ndarë PKJ për të bashkëpunuar ngushtë me PKSHP, në lidhje me këtë problematikë duhen veçuar edhe disa faktorë kyç që determinuan marrëdhëniet politike shqiptaro-jugosllave për periudhën në fjalë. Ndër këta faktorë vlerësojmë, mungesën e nivelit të mjaftueshëm të pavarësimit të PKSHP si parti komuniste në raport me lëvizjet komuniste të kohës, pastaj faktin se marrëdhëniet ndërmjet PKSHP dhe PKJ gjatë luftës ishin thelluar në shumë dimensione, por edhe nivelin e caktuar të indoktrinimit me bolshevizmin proletar të udhëheqjessë PKSHP, e cila i besonte verbërisht atij bashkëpunimi. Nga ana tjetër, janë edhe dy segmente që kanë ndikuar në përcaktimin jokritik të PKSHP për bashkëpunim me PKJ edhe pas përfundimit të luftës. Në radhë të parë është tradita e diskutimeve dhe e spekulimeve për krijimin e Federatës Ballkanike, ide e cila datonte qysh para Luftës së Dytë Botërore, si dhe planet për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Përsa i përket projektit të Federatës Ballkanike, i cili ishte aktualizuar edhe pas përfundimit të luftës, dihej se: “... Udhëheqja e PKJ ka pritur rolin prijës të Jugosllavisë në Konfederatën Ballkanike, sepse ajo ishte vendi më i madh ballkanik dhe në luftë subjekti më i fortë i luftës nacionalçlirimtare kundër fashizmit... Jugosllavia, në vitin 1945, padyshim ishte në orbitën e ndikimit sovjetik, por nga burimet gjithashtu del se udhëheqja e saj është përpjekur që në Shqipëri të forconte ndikimin e saj dhe të pamundësonte ndikimin sovjetik”<sup>226</sup>. Studiuesi dhe njohësi gjerman i çështjes shqiptare, Bernhard Tonnes, mendonte: “...Për PKJ, Shqipëria, në vitin 1941, kishte të njëjtën rëndësi si për anglezët: që të krijoheshin kushte që në prapavijë të ital-

225 Branko Petranović, *Balkanska Federacija 1943-1948*, Beograd, 1991, f. 138.

226 Po aty, f. 136.

ianëve dhe gjermanëve të krijohej një farë kryengritjeje për t'i shqetësuar okupatorët. Në këtë kohë, Tito mendonte se duhej të bënte çmos që një ditë Shqipëria të futej në konfederatë apo federatë ballkanike bashkë me Bullgarinë dhe me ca shtete tjera sllave të Ballkanit".<sup>227</sup> Gjithashtu, ai mendonte: "...Pas luftës ishin të qarta përpjekjet e Titos që Shqipërinë ta fuste në Federatën Ballkanike. Për një mision të tillë tashmë nuk ishin të përshtatshëm Dushan Mugosha dhe Miladin Popoviçi, kështu që në Shqipëri si emisar special u dërgua Velimir Stojniçi, i cili mbante lidhje të drejtpërdrejta midis dy partive. Stojniçit i shkoi për dore që me ndihmën dhe rekomandimin e Tempos të fitonte simpatinë e Koçi Xoxes, i cili po i forconte pozitativisht Shqipëri, dhe, qysh në janartë vitit 1945, ia doli që të arrinte postin e zëvendëskryeministrit, pastaj ministrit të Punëve të Brendshme, presidentit të Komisionit të Kontrollit dhe shefit të Sigurimit".<sup>228</sup> Pikërisht, në rivalitetin sovjetiko-jugosllav për dominim ndaj PKSH dhe në përgjithësi për të siguruar pozitën superiore ndaj shtetit shqiptar duhet kërkuar edhe një nga shkaqet kryesore që determinuan bashkëpunimin e njëanshëm shqiptaro-jugosllav dhe që për më pak se tre vjet pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore çuan edhe deri te prishja definitive e marrëdhënieve partiake e shtetërore. Prandaj, mund të konstatohet se, pikërisht, ky rivalitet i dy partive komuniste më të mëdha e më me ndikim në orbitën e shteteve të atëhershme socialiste kishte determinuar varshmërinë deri në dramaticitet të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Në këtë kontekst, vlerësojmë se nuk qëndrojnë kualifikimet se prishjen e PKSH me PKJ dhe rirreshtimin e udhëheqjes së PKSH kah PK e BRSS e ka bërë Enver Hoxha vetëm për shkaqe karrieriste. Realisht, po të mos ndodhte konflikti i Stalin-Tito, vështirë se do të mund të ndryshonte kursi politik i udhëheqjes së PKSH në raport me

---

227 Bernhard Tonnes, *Sonderfal Albanien*, Minhen, 1980, f. 435.

228 Po aty, f. 485.

Jugosllavinë, pra PKJ. Kjo do të thotë se merita për prishjen e marrëdhënieve të PKSH me PKJ dhe rreshtimi kah bashkëpunimi me BRSS nuk i takon Enver Hoxhës, por rrethana konkrete historike të vitit 1948 që reflektuan konfliktin ndërshtetëror midis Jugosllavisë dhe Bashkimit Sovjetik. Gjithashtu, mund të supozohet se për orientimin e PKSH në thellimin e bashkëpunimit deri në varësi ndaj PKJ nuk është thelbësor vetëm diskutimi dhe presioni i PKSH që pas luftës Kosovë t'i bashkohej Shqipërisë. "Shikuar burimisht, qëllimi jugosllav përdorëzimin e Kosovës dhe Metohisë Shqipërisë, 1943-1948, nuk është shënuar në asnjë dokument partiak po shtetëror, por kjo nuk do të thotë se nuk ka ekzistuar... Padyshim se presioni i Shqipërisë për dorëzimin e Kosovës dhe Metohisë ka qenë i pandërprerë, në vitet 1943-1948, edhe pse publikisht ai nuk është nxjerrë, kryesisht në formën e aneksimit të Kosovës në përbërje të Shqipërisë".<sup>229</sup> Bashkëpunimi shqiptaro-jugosllav, në vitet 1945-1948, në pamje të jashtme zhvillohej pa vështirësi të theksuara dhe me orientim të qartë që Shqipëria të bëhej Republikë e shtatë e Jugosllavisë. Mbi teorinë e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë spekulohet edhe me planin për bashkimin e mundshëm të Kosovës me Shqipërinë, por siç sugjeronin dhe proklamonin jugosllavët vetëm me kushtin që Shqipëria të bashkohej me shtetin jugosllav. Milovan Gjlasi, duke sqaruar se ekzistonin plane dhe projekte për federatën e përbashkët midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, pranonte: "Në të vërtetë, ne mendonim se marrëdhëniet me Shqipërinë do të zhvilloheshin në atë drejtim që të dy vendet do të bashkoheshin... Në atë kohë hapej një perspektivë e re e marrëdhënieve të reja mes Shqipërisë dhe vendit tonë... Përndryshe, nga fundi i luftës, ne me shokët shqiptarë kishim ardhur në përfundim se duhej të bashkoheshim, edhe pse nuk e kishim detajizuar çështjen se nën çfarë kushtesh do të realizohej ai bashkim, respektivisht se

<sup>229</sup> Branko Pribiqeviç, vep. e cit., f. 137.

çfarë statusi do të ketë Shqipëria në Jugosllavinë e bashkuar. E pra, atëherë qëndronim në atë se Kosova duhet t'i takojë Shqipërisë nëse bashkohemi, ndërkaq nëse nuk bashkohemi, atëherë tërë çështja bie në ujë".<sup>230</sup> Në këtë periudhë kishte një varg problemesh të natyrës bilaterale dhe ndërshtetërore midis dy vendeve fqinje. Kosova nuk shfaqejsi problemi kryesor që i rëndonte ato marrëdhënie, por edhe kundërthëniet rreth çështjes së Kosovës me kohë do të bëheshin një nga pikërrëndesat e diskutimeve shqiptaro-jugosllave, e sidomos pas vizitës së kreut të PKSH, Enver Hoxhës, në Jugosllavi, në verën e vitit 1946. Stojniçi, i cili deri në çlirimin e Shqipërisë kryente rolin e instruktorit, "...kishte marrë pjesë rregullisht në cilësi të komunikimit partiak në mbledhjet e Byrosë së KQ të PKSH, kurse në muajin nëntor të vitit 1944, edhe në mbledhjene Plenumit të KQ të PKSH. Gjatë qëndrimit në Tiranë, lidhjet e Stojniçit me udhëheqësin e Shqipërisë u reflektovan në lidhjet e herë pas hershme me Koçi Xoxen, sekretarin organizativ të PKSH, sepse mbledhjet e rregulltatë Byrosë nuk ishin mbajtur".<sup>231</sup> Roli partiak i Velimir Stojniçit mori fund me vendosjen e marrëdhënieve midis dy komiteteve qendrore. Vija e dytë e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, në vitet 1945-1948, realizohej përmes Misionit Ushtarak jugosllav pranë Shtabit Suprem të Shqipërisë, i cili, në janar të vitit 1946, u shtua edhe me pesë oficerë të lartë të UJ që kishin për detyrë të punonin përngritjen e ushtrisë shqiptare, pranimin e armatimit nga Jugosllavia dhe "...bashkëpunimin me pjesën komanduese të divizioneve shqiptare në Jugosllavi, deri në tetor të vitit 1945".<sup>232</sup> Në Shqipëri, gjatë kohës së qëndrimit të dy divizioneve shqiptare, për rolin e të cilave historiografia jugosllave konstaton se ndër të tjera kishin për detyrë të qetësonin situatën në Kosovë, vepronin strukturat

---

230 Agim Zogaj, Fuqia e ideve, Prishtinë, 1993, f. 25-26.

231 Branko Petranoviç, vep. e cit., f. 141.

232 Po aty.

torët ushtarakë jugosllavë.

Vija e tretë e marrëdhënieve dhe lidhjeve shqiptaro-jugosllave, në vitet 1945-1948, realizohej përmes kanaleve diplomatike, në radhë të parë me vendosjen e Velimir Stojniçit në detyrën e përfaqësuesit të parë të Qeverisë së Përkohshme të RFJ pranë qeverisë shqiptare". Më 12 janar 1945, Gjilasi kishte lajmëruar Velimir Stojniçin se KQ i PKSHP mund të vendoste lidhje të drejtpërdrejta me KQ të PKJ, kështu që: "dikush nga "ju" të vijë "këtu" një herë në javë ose çdo dhjetë ditë".<sup>233</sup>

Kjo ndihmë dhe ky bashkëpunim realizohej mbi bazën e dy marrëveshjeve të nënshkruara midis palës shqiptare dhe asaj jugosllave, më 20 shkurt të vitit 1945.<sup>234</sup> "Sipas marrëveshjes së parë, e cila ka pasur formën e aleancës ushtarake për luftë të përbashkët kundër forcave gjermane dhe që kishte vlerë edhe për periudhën e pasluftës, pjesëmarrja e ekspertëve ushtarakë jugosllavë ishte cilësuar nga pala greke si pengesë e pretendimeve territoriale greke ndaj pjesës jugore të Shqipërisë. Mirëpo, këto marrëveshje, të nënshkruara më 20 shkurt 1945, ishin pasojë e bashkëpunimit të afërt politik dhe ushtarak të forcave ushtarake me rastin e shuarjes së kryengritjes në Kosovë dhe Metohi, në fund të vitit 1944 dhe fillim të vitit 1945".<sup>235</sup> Në të vërtetë, dy marrëveshjet shqiptaro-jugosllave të 20 shkurtit të vitit 1945 nuk ishin bërë publike deri pas vdekjes së Titos. Këto dokumente janë gjetur në arkivin e Qendrës Memoriale "Josip Broz Tito" në Beograd dhe nuk kanë signaturë arkivale.<sup>14</sup> Megjithatë, është me rëndësi fakti se qeveria jugosllave u tregua e gatshme që për mes atyre dy marrëveshjeve të garantonte dhe të mbronte integritetin dhe sovranitetin territorial të Shqipërisë në rast të kërcënimeve nga pala greke, si dhe që Jugosllavia të për-

233 Branko Pribiçević, vep. e cit., f. 142.

234 Josip Smoljaka, Partizanski dnevnik, Beograd, 1972, f. 262.

235 Gjorgje Borozan, Velika Albanija, porijeklo, ideje, praksa, Beograd, 1995, f. 513. 14 Po aty.

faqësonte interesat e shtetit dhe qeverisë shqiptare në arenën ndërkombëtare deri në njohjen e kësaj të fundit. Këto ishin elemente të mjaftueshme për të bindur palën greke që të hiqte dorë edhe nga projekti për ndarjen e Shqipërisë midis Greqisë dhe Jugosllavisë, plane këto të viteve të para Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore të aktivizuara edhe pas vitit 1945. Dokumenti i 20 shkurtit 1945 i nënshkruar midis palës shqiptare dhe asaj jugosllave përmbante tetë nene. Në nenin e parë të Marrëveshjes për lidhjen, bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë ishte rregulluar pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta ushtarake mes Ushtrisë Çlirimtare të Jugosllavisë kundër pushtuesve gjermanë të dy divizioneve të Ushtrisë Çlirimtare të Shqipërisë, të cilat gjendeshin në luftime kundër forcave gjermane në territorine Jugosllavisë. Neni i dytë i kësaj marrëveshjeje kishte të bënte me detyrimet e të dy palëve nënshkruese se nuk do të bënin kurrfarë marrëveshjeje për armëpushim ose për paqe me Gjermaninë, pa marrëveshjeje të përbashkët. Në nenin tre të marrëveshjes theksohej tekstualisht se nuk do të vepronin me shtetet e treta në lidhje ose aleanca, të cilat do të mund të ishin kundër interesave të secilës nga dy palët nënshkruese të marrëveshjes, si dhe parashihej që në rast të sulmit të njëres nga palët nënshkruese, pala tjetër të vihej në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të palës së sulmuar. Në nenin katër parashihej që të dyja palët nënshkruese, gjatë mbetjes në fuqi të marrëveshjes, të angazhoheshin që të zhvillonin bashkëpunimin sa më të ngushtë në fushën e kulturës dhe të ekonomisë të popujt e tyre. Në nenin pesë theksohej rëndësia e kësaj marrëveshjeje dhe e kësaj aleance ndërshtetërore. Në nenin gjashtë parashihej që të dyja palët nënshkruese të angazhoheshin për respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në shtetet e veta. Neni shtatë parashihte që marrëveshja të nënshkruhej për kohë të pacaktuar, ndërsa do të zhvlehtësohej një vit pasi njëra nga palët nënshkruese të hiqte dorë nga nënshkrimi.



Marrëveshjen e 20 shkurtit të vitit 1945, me sugjerimin që ajo të ratifikohet sa më parë në Tiranë, e kishin nënshkruar nga pala jugosllave, Tito, kryetar i NKOJ, dhe përfaqësuesi i Punëve të Jashtme të NKOJ, Josip Smoljaka, kurse nga pala shqiptare nënshkruet ishin nënkryetari i Këshillit të Ministrave, Myslim Peza, ministri i Punëve të Jashtme, dr. Omer Nishani, ministri i Ekonomisë, dr. Medar Shtylla, dhe ministri i Politikës Sociale, Bedri Spahiu.<sup>236</sup>

Kjo marrëveshje, si dhe marrëveshja e mëhershme për bashkëpunimin ekonomik midis dy shteteve, ishin bazë e mirë për thellimin dhe intensifikimin marrëdhënies midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Madje, historiografia e proveniensës jugosllave vlerëson: "Largimi i delegacionit shqiptar nga Beogradi, më 23 shkurt 1945, pas nënshkrimit të marrëveshjes shënonte krijimin e kushteve të mëtejshme për futjen e Shqipërisë në federatën e ardhshme. Në të vërtetë, në pritje që Federata Ballkanike të bëhej realitet politik, çështja e Kosovës dhe e Metohisë, e cila edhe gjatë luftës ishte në qendër të vëmendjes të marrëdhënies partiake e politike shqiptaro-jugosllave, mbeti anash edhe përkundër përpjekjeve britanike që, me hapjen e temës së tillë dhe të ndihmuar edhe me intervencionizmin grek kah jugu i Shqipërisë, të rrëzonin parakushtet e ndërtuara për Federatën Ballkanike dhe atë jugosllave".<sup>237</sup> Të trimëruar me përparimin e planit jugosllav për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë në një federatë të përbashkët, si dhe në atë ballkanike, udhëheqësit shtetërorë e partiakë të Jugosllavisë edhe me kërkesë dhe sugjerime të përfaqësuesve të tyre diplomatikë e ushtarakë në Tiranë, kishin shtruar kërkesa dhe plane të reja që në fakt nënkuptonin shpejtimin procesit të varshmërisë totale të Shqipërisë nga Jugosllavia. Për këtë qëllim, ishte vendosur që sa më parë të emërohet atashu ushtarak jugosllav

---

236 Po aty.

237 Po aty, f. 515.

në Tiranë, atasheu për ekonomi, tregti dhe kulturë dhe bashkëpunim kulturor, si dhe të caktoheshin personat zyrtarë për rregullimine kalimit kufitar. Edhe çështjet e bashkëpunimit kulturor dhe sportiv ishin në plan të parë. Ishte planifikuar që nga Shqipëria, në mungesë të shkollave të mesme dhe të fakulteteve, të shkonin në Jugosllavi për mësim dhe studime të rinjtë shqiptarë. Ishte paraparë edhe dhënia e bursave dhe kredive për nxënësit dhe studentët shqiptarë që do të studionin në Jugosllavi. “Më 9 mars 1945, qeveria jugosllave i kishte dërguar qeverisë shqiptare kërkesën që në Kosovë të dërgonte kuadro profesionist për tri gjimnaze, në të cilat mësimi do të zhvillohej në gjuhën shqipe. Ishte planifikuar që të hapej gjimnazinë gjuhën shqipe në Prishtinë, Prizren, Pejë, si dhe një gjimnaz i ulët në Gjakovë”.<sup>238</sup> Me njohjen e qeverisë shqiptare nga ana e qeverisë jugosllave, më 28 prill 1945, si dhe me heqjen e Misionit Ushtarak jugosllav, qeveria e Republikës Demokratike Federative të Jugosllavisë caktoi disa instruktorë pranë ushtrisë shqiptare për këmbësori, inxhinieri, artileri, marinë, aviacion dhe shkollat ushtarake. Përveç këtij personeli dhe instruktorëve për punë me rini, në vitin 1945, në Shqipëri, gjithnjë në kuadër të projekteve për ndihmë të përkohshme, kishin ardhur edhe një numër i caktuar artistësh, mjekësh, gjeometrash, arsimitarësh të gjuhës serbe e ruse, juristë dhe persona tjerë të nevojshëm jugosllavë.

Kryesia e Këshillit të Ministrave të Jugosllavisë Demokratike Federative, më 10 korrik 1945, i kishte dhënë për detyrë ministrisë së Punëve të Jashtme që, për rregullimin e kalimit ndërkuftar në kufirin shqiptaro-jugosllav, të formonte delegacionin për bisedime, i cili përbëhej nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Financave. Ndërkaq, përshkak të vështirësive

---

238 Arkivi i Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Fondi 1, Shqipëria 1945, Raporti i datës 9 mars 1945.

në bashkëpunimin me Misionin Britanik dhe atë amerikan dhe planeve për bashkëpunim me disa shtete ballkanike, qeverias hqiptare, në gusht të vitit 1945, i ishte drejtuar qeverisë jugosllave me lutjen që ajo të merrte rolin ndërmjetësues në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Bullgarinë dhe me Rumaninë. Mirëpo, përfaqësuesit diplomatikë të Jugosllavisë në Shqipëri i përcillnin me interesimzhvillimet politikenë Shqipërinë e pasluftës, e sidomos ato që po shfaqeshin në përgatitje të zgjedhjeve për parlamentin shqiptar. Në një raport të datës 28.10.1945 të përfaqësuesit të ambasadës jugosllave në Shqipëri konfirmohej: "...Britanikët, përmes Suad Asllanit, po përpiqentë imponojnë procesin e diferencimit përbrenda frontit".<sup>239</sup> Në këtë raport vlerësohej se në fushatën zgjedhore dymujore, rol të veçantë në krijimin e situatës së paqartë politike dhe nxitjen e mos unitetit në radhë te Frontit Demokratik kishte luajtur "...orientimi probritanik i të ashtuquajturës "Lidhja Shqiptare", të cilën e udhëhiqte kleri katolik dhe të ashtuquajturit nacionalistë te pavarursi: Muharrem Bajraktari, Gjon Mark Gjoni, Hysni Dema, Fiqri Dina etj.".<sup>240</sup> Duke i përcjellë me interesim zhvillimet politike në Shqipëri, ambasadori jugosllav në Tiranë, Josip Gjergja, i cili e kishte zëvendësuar Velimir Stojniçin, në raportin e datës 24 tetor 1945, ndër të tjera kishte apostrofuar interesimin e shtuar të personelit të përfaqësisë britanike në Shqipëri për të aktivizuar çështjen e Kosovës. Josip Gjergja raportonte se dr. Omer Nishani, anëtar i udhëheqjes më të lartë të Shqipërisë, në lidhje me Kosovën kishte deklaruar: "Kosova tani është më mirë se kurrë më parë, sepse nga të dy anët e kufirit shqiptarët janë të kënaqur".<sup>241</sup> Ndërkaq, në raportin e datës 26 tetor 1945, Josip Gjergja, gjithnjë për temën e Kosovës,

239 Arkivi i Sekretariatit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, F-1, Raporti i Velimir Stojniçit për situatën politike në Shqipëri, nr. 179 të datës 28 tetor 1945, f. I/111.

240 Po aty.

241 Arkivi i KQ të LKJ-së, IX-8-V/218/1946.

shkruante: “Është e padiskutueshme se edhe udhëheqësit më vizionarë këtu (mendohet në Shqipëri -A.Z) vuajnë në masë të caktuar nga sëmundja shqiptaromadhe, përkatësisht nga bindja se duhet t’u jepet Kosmeti... Është interesant se edhe vetë E. Hoxha shumë vështirë jepte deklarata në këtë kontekst, ndonëse ato ndonjëherë do të ishin të domosdoshme, duke marrë parasysh implikime të caktuara të reaksionit lidhur me këtë çështje”.<sup>242</sup> Diplomati jugosllav shprehte brengosje edhe për pikëpamjet e Sejfulla Malëshovës dhe të dr. Omer Nishanit, të cilët në planin e politikës së jashtme angazhoheshin që Shqipëria të kultivonte marrëdhënie të mira diplomatike edhe me vendet perëndimore. “Duke analizuar gjendjen politike në Shqipëri pas fitores së Frontit Demokratik, në zgjedhjet 2 dhjetorit 1945 për parlamentin shqiptar, Gjergja, në raportin e 6 dhjetorit, theksonte se politika e qeverisë së E. Hoxhës dhe e udhëheqjes së Frontit Demokratik karakterizohej me kompromise dhe se qëndrimet e Sejfulla Malëshovës dhe të dr. Omer Nishanit për lëshimet ndaj fuqive perëndimore dhe hapjen ndaj Italisë e bënë pozitën e Shqipërisë edhe më tej të paqartë”.<sup>243</sup> Vërejtjet e palës jugosllave në adresë të udhëheqësve shqiptarë për lëvizjet e tilla të politikës së jashtme shqiptare, në vitin 1945, po bëheshin gjithnjë e më transparente, sepse vlerësohej se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe ato të Shqipërisë me vendet tjera ballkanike po viheshin në plan të dytë. Udhëheqja jugosllave nuk pajtohej që të toleronte kurrfarë politike të jashtë me të pavarur të qeverisë shqiptare. Në këtë kontekst, pala jugosllave frikësohej se mos edhe me presionin e jashtëm të qeveria shqiptare, çështja e Kosovës do të ringrihej në tavolinën e bisedimeve diplomatike. Mirëpo, “I bindur se pa ndihmën jugosllave do të duhej t’ubënte lëshime kërkesave greke dhe

---

242 Arkivi i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, F-I, Shqipëria, 1945, Dos. nr. 363, raporti i datës 6.XII.1945.

243 Po aty.

atyre anglo-amerikane, të cilat e vinin në diskutim çështjen e statusit politik dhe territorial të Shqipërisë, E. Hoxha me vetëdije e kishte shtyrë çështjen e Kosovës, edhe përkundër bindjes së tij se Shqipëria e zmadhuar është ëndrra e tij e porealizuar”.<sup>244</sup> Sidoqoftë, Enver Hoxha, angazhimin e qeverisë jugosllave për intensifikim të marrëdhënieve, njëherit dhe për ndërhyrje sa më të plotë në zhvillimet e përgjithshme në Shqipëri, në masë të theksuar e ndjente dhe e përjetonte si një lloj presioni të madh politik e moral, në radhë të parë ndaj udhëheqjessë PKSH, qeverisë shqiptare dhe personalisht ndaj tij. Enver Hoxhanë kujtime të tij, të publikuara tri vjet para vdekjes, më 1982, duke u kthyer në retrospektivë të marrëdhënieve shqiptaro-jugoslla vetë vitit 1945, ndër të tjera shkruante: “...nga ana e tyre e gjithë kjo “mirësi”, “ndihmë”, “përkrahje”, në thelb, ishte vetëm një bluf, një hile e madhe, një çark i maskuar me dafina e me degë ulliri, por që nën gjithë këtë fshihte dhëmbët e hekurt të armiqve të betuar të partisë e të lirisë së atdheut tonë”.<sup>245</sup> Sipas Enver Hoxhës: “Konkretisht, tamam në kohën kur ata publikonin me bujë njohjen e qeverisë sonë, të pavarësisë së Shqipërisë dhe të njësisë së saj të pacenueshme territoriale, në fshehtësi, në bisedat e rangjeve më të larta të udhëheqjes shtetërore e të partisë thurnin planet për aneksimin e Shqipërisë e kthimin e saj në një republikë të shtatë të Jugosllavisë! Qysh në fillim të vitit 1945, një ndër bashkëpunëtorët më të afërt të Titos, Moshe Pijade, kërkoi që kancelaria e re e Republikës Federative të Jugosllavisë në Beograd të mos kishte 6, por 7 kabinete! Kabineti i 7-të i përkiste, sipas titoistëve, “Republikës Jugosllave të Shqipërisë”.<sup>246</sup> Çështjen e planeve jugosllave për ta shndërruar Shqipërinë në republikë të shtatë jugosllave e konfirmonte në botimet veta edhe autobiografi i Titos,

---

244 Dr. Gjorgje Barazan, vep. e cit., f. 257.

245 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 210.

246 Po aty, f. 211.

Vladimir Dedier, i cili shkruante: “Moshe Pijade, përkrahës i madh i Federatës së Jugosllavisë e të Shqipërisë, propozonte që në planet për ndërtesën e re të federatës në Beogradin e ri të përfshihet menjëherë ndërtimi i 7 kabineteve: 6 për republikat jugosllave dhe një për Shqipërinë. Pra, “Tash ishte puna që aneksimi i Shqipërisë të mos ngjallte debate e telashe në arenën ndërkombëtare, të mos quhej kurrsesi nga të tjerësi një aneksim manu militari, si pasojë e luftës etj. Ky aneksim, sipas tyre duhej të bëhej në kushte të paqes dhe të mbante vulën e “vullnetit” të ligjshëm të shtetit shqiptar e të qeverisë së tij të ligjshme”<sup>247</sup>.

Në këtë periudhë, pra, fundi i vitit 1945, në Byronë Politike të KQ të PKSH ekzistonin dy qëndrime e qasje divergjente rreth zhvillimit të Shqipërisë në periudhën e socializmit. “Qëndrimi i parë, bartësi të cilit shte Sejfulla Malëshova, përkraheje dhe nga Enver Hoxha dhe Ymer Dishnica. Sipas mendimit të Sejfulla Malëshovës, reaksionit që kishte pësuar disfatë duhej t’i jepej përsëri mundësia që, në kushtete ndryshuara e me armë të reja, të sprovonte forcat e veta kundër revolucionit popullor... Në fushën e politikës së jashtme, sipas mendimit të Sejfulla Malëshovës, Shqipëria nuk duhej të bënte dallim midis marrëdhënieve me Jugosllavinë, me BRSS dhe me vendet e tjera socialiste dhe marrëdhënieve me vendet kapitaliste. Bartësit e këtij qëndrimi ishin edhe kundër asaj që të realizohej ndërtimi socialisti vendit, në bazë të përvojave jugosllave dhe sovjetike”<sup>248</sup>. Panajot Plaku, ishministër pa portofol në qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, i cili, në vitin 1957, ilegalisht kaloi nga Shqipëria në Jugosllavi, në kujtime të tij shpaloste se shumica e anëtarëve të Byrosë Politike dhe në qeverinë e përkohshme ishin kundër qëndrimeve dhe pikëpamjeve të këtilla. “... Në periudhën e viteve 1945-1946, Sejfulla Malëshova dhe Ymer Dishnica, nën

---

247 Po aty, f. 212.

248 Panajot Plaku, Dhuna ndaj revolucionit në Shqipëri, Prishtinë, 1985, f. 64.

mbrojtjen e Enver Hoxhës, luanin rol të madh dhe tejet negativ në jetën politike të brendshme të Shqipërisë”.<sup>249</sup> Plaku pranonte se me iniciativën e Koçi Xoxes dhe të një pjese të Byrosë Politike, Sejfulla Malëshova dhe Ymer Dishnica u dënuan me përjashtim nga Byroja Politike dhe nga KQ i PK të Shqipërisë, në gjysmën e parë të vitit 1946. Rryma e dytë, sipas Panajot Plakut cilësohejsi “...rryma, e cila përpiquej të konsolidonte sa më parë pushtetin popullor, të ndërtonte dhe të perfeksiononte ekonominë me masa të jashtëzakonshme, duke marrë si shembull pozitiv para së gjithash praktikën në Jugosllavinë fqinje...”. Bartës kryesori këtij orientimi politik ishte Koçi Xoxe, kurse qëndrimet e tij i përkrahte shumica në Byronë Politike edhe tërë KQ i PK të Shqipërisë.<sup>250</sup> Ekzistimi i dy vijave politike brenda përbrenda Byrosë Politike të KQ të PKSH, qysh në fillim të vitit 1945, kishte acaruar luftën e brendshme të fraksioneve në udhëheqjen më të lartë të KQ të PKSH. Kjo situatë i krijonte mundësi edhe më të mëdha PKJ që të ndërhynte pa pengesa në punët e brendshme të shtetit shqiptar. Në këtë periudhë, qeveria provizore e udhëhequr nga Enver Hoxha përballej para sfidave të rënda, sepse në të njëjtën kohë duhej të kryente dy detyra: “... Duhej të konsolidonte pushtetin dhe të njihej ndërkombëtarisht”.<sup>251</sup> “Pas përfundimit të luftës, Shqipëriara në varësi të Jugosllavisë në të gjitha fushate jetës politike, ekonomike e ushtarake. Pozita e Hoxhës, si sekretar i përgjithshëm, në një periudhë të caktuar, ishte shumë kontestuese. Njësoj si Stalini edhe jugosllavët duhet të kenë parë në të “një borgjeztë vogël me prirje nacionaliste”.<sup>252</sup> Për këtë shkak Hoxhës iu shoqërua Koçi Xoxe, si sekretar i KQ për çështje organizative. Xoxe vlente si njeri i besueshëm i udhëheqjes partiake jugosllave

249 Po aty, f. 65.

250 Po aty.

251 Peter Bartel, *Albanien VomMittelalter bis zur Gegenwart* Verbog, Fridrih Pustel, Regensburg, 1995, f. 222.

252 Po aty.

dhe ashiqare duhej ta kontrollonte sekretarin e përgjithshëm. Ai kishte për detyrë të shkruante ligjet dhe dekretet e udhëheqjes shtetërore shqiptare në emër të KQ. Xoxe mundohej t'i bënte ballë tendencave properëndimore, për të cilat akuzohej Enver Hoxha, Sejfullah Malëshova, Ymer Dishnica dhe komunistë të tjerë shqiptarë".<sup>253</sup> Veprimtaria projugosllave dhe kundër interesave të shtetit shqiptar e Koçi Xoxes mund të kuptohet edhe nga këmbimi i radiogrameve që ai i kishte realizuar në vitet 1945-1946 me Aleksandër Rankoviçin, ish-ministër i Punëve të Brendshme të qeverisë jugosllave. Për të dëshmuar nënshtrimin e palës shqiptare karshi asaj jugosllave janë karakteristike përmbajtje të radiogrameve që Koçi Xoxe i dërgonte Aleksandër Rankoviçit, në lidhje me incidentin e Kanalit të Korfuzit. Në radiogramin e datës 27 tetor 1946, Koçi Xoxe, lidhur me incidentin, ndër të tjera i raportonte Aleksandër Rankoviçit: "... Shoku ynë në Beograd na shkruanse kishte folur me ju, ju i kishit thënë që të mos qëlloni mbi anijet britanike. Për këtë jemi dakord, por në rast se anijet britanike i drejtohen portit tonë pa na lajmëruar ne kemi dhënë urdhër që të qëllojnë".<sup>254</sup> Në radiogramin që ia kishte bërë Koçi Xoxes nga Legata Shqiptare në Beograd, Shpend Dega e informonte për udhëzimet e Titos dhe të Rankoviçit për incidentin e Kanalit të Korfuzit, duke shkruar: "Tito tha: Nuk kanë të drejtë. Qeveria shqiptare të bëjë protestën, ku do të theksojë se masat e pastrimit të minave do të përgatitet për t'i bërë vetë qeveria shqiptare".<sup>255</sup>

Në pikën dy të Konkluzioneve të Byrosë Politike të KQ të PKSH, ndër të tjera formulohej konstatimi politik: "Të influencuar nga kjo tendencë oportuniste nuk e kemi orientuar sa duhet popullin drejt një vëllazërimi të shëndoshë me Jugosllavinë, që është një konditë e domosdoshme për ekzistencën

---

253 Po aty, f. 224

254 Arkivi i Ministrisë së Brendshme. D.1623/9.

255 Po aty.



e një Shqipërie demokratike popullore. Kjo ka lejuar borgjezinëtonë që të shpresojë dhe të përpiqet të orientojë marrëdhëniet tona ekonomike drejt Perëndimit dhe në radhë të parë me Italinë”.<sup>256</sup> Etapën e re të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore, Enver Hoxha në kujtime te tij e përshkruante si periudhë mjaft delikate, e cila shënonte njëherit edhe kalimin në një fazë të re të marrëdhënieve midis dy partive komuniste dhe dy shteteve të sapoçliruara nga nazifashizmi. “...Vazhdonim të ruanim për partinë jugosllave dhe udhëheqjen kryesore të saj mendim të mirë, deri diku euforik, sado që për 4 vjet s’patëm mundësi t’i njihnim nga afër e konkretisht...Ishim, pra, të gatshëm e të predispozuar për t’i zhvilluar për t’i forcuar sa më shumë marrëdhëniet miqësore me PKJ e me popujt e Jugosllavisë...”<sup>257</sup> Duke i hedhur njëvështrim marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në vitin 1946, Enver Hoxha vërente: “Dukej sikur shumë nga qëndrimet e tyre të mëparshme po ndryshonin, sikur ecej drejt një përmirësimi të atmosferës së rëndë e kritike të së kaluarës, sikur, bile, prej tyre po rishikoheshin edhe disa nga qëndrimet e padrejta të së kaluarës”.<sup>258</sup> Mirëpo, në të njëjtën kohë edhe përfaqësuesit jugosllavë shprehnin brengosje me paraqitjen e vijave të tjera politike brendapërbrenda Byrosë Politike të KQ të PKSH, të cilat nuk ndjenin eufori me orientimin projugosllav, por kërkonin orientim edhe kah Perëndimi. “... Në udhëheqjen shqiptare ishte aktive vija e Sejfulla Malëshovës, i cili kishte kërkuar orientimin kah Italia... Është konsideruar si “truri” i partisë dhe ka përhapur ndikim të rëndësishëm doktrinar, veçmas duke u angazhuar për mbështetjen e Shqipërisë në Perëndimin, duke manifestuar orientimin e politikës së jashtme të kundërt me fraksionin pro-jugosllavnë KQ të PKSH.Politika,

256 Arkivi i Ministrisë së Brendshme, Tiranë, D.1623/9.

257 Enver Hoxha, Titistët, Tiranë, 1982, f. 204.

258 Po aty, f. 205.

të cilëne ka formuluar Malëshova, ishte drejtpërdrejt në kundërshtim me politikën jugosllave".<sup>259</sup> Jugosllavët, në fund të vitit 1945 dhe fillim të vitit 1946, ishin gjithnjë e më të shqetësuar për të çarat që po manifestoheshin përbrenda Byrosë Politike të KQ të PKSH, pra, sa i përket orientimit për thellimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe orientimit tjetër që në këtë bashkëpunim dhe afrim kah Jugosllavia të ketë masë, kritere dhe kujdes. "Një orientim i tillë politik i Shqipërisë, në vitin 1945, kishte hasur në kritikën e diplomacisë jugosllave, e cila vlerësonte se Shqipëria në vend të orientimit kah Perëndimi duhej të kthehej me vendosmëri dhe pa mëdyshje kah Lindja, d.m.th. kah Jugosllavia, Ballkani demokratik dhe Bashkimi Sovjetik. Shqiptarët ishin lëshuar në spekulime te paprincipëta dhe të rrezikshme me Perëndimin, me parullën "... të gjitha për pranimin ndërkombëtar të pavarësisë sonë".<sup>260</sup> Në sektorin e diplomacisë së punëve të jashtme të RFJ, në lidhje me kursin e politikës së jashtme të Shqipërisë, ndër të tjera konstatohej: "...Udhëheqja e këtu shme jo drejte ka vlerësuar forcën e vërtetë dhe situatën përbrenda Frontit Demokratik të mbledhur rreth BRSS. Kjo vlen për sektorin e Ballkanit dhe veçmas për Jugosllavinë... Kulmi i këtij orientimi është manifestuar në orientimin e caktuar të shtypit, në inteligjencën etj. që të iket nga Ballkani dhe të injorohet realiteti ballkanik dhe të shkohet kah Perëndimi, në Perëndimin e kulturuar, çlirimtar dhe miqësor".<sup>261</sup> Përfaqësuesit diplomatikë të RFJ në Tiranë, në raportet e tyre nënvizonin: "Asnjë frazë, as deklaratat e përkohshme nuk ishin në gjendje të fshihnin orientimin e vërtetë të shumicës, madje edhe të udhëheqësve, ministrave dhe në punës vetë lartë që në Perëndim të kërkohet garancia për pavarësinë shqiptare...".<sup>262</sup> Vlerësimet e diplomacisë jugosllave për

259 Branko Petranoviç, vep. e cit., f. 150.

260 Po aty.

261 Po aty, f. 152.

262 Po aty.

kthesat e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, në vitet 1945-1946, ishin: “Mund të thuhet se, në ata muaj, Shqipërinë, në radhë të parë, e ka mbajtur presioni i madh moralopolitik i Jugosllavisë dhe i tërë bllokut demokratik...”.<sup>263</sup> Pavarësisht nga këto lëvizje politike, me të cilat udhëheqja e PKSH po përpiquej, qysh në vitet e para të pasluftës, të mbronte dhe ndërtonte identitetin shtetëror shqiptar, pavarësisht presioneve dhe përzjerjes së hapur në punët të shtetit shqiptar nga ana e PKJ, udhëheqja komuniste shqiptare e trasonte rrugën e thellimit të bashkëpunimit me PKJ dhe Republikën-Federative Popullore të Jugosllavisë. Pozita e rëndë në të cilën gjendej PKSH menjëherë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore mund të ilustron edhe me këtë fakt: “Plot tri herë në katër vjet ndryshuan urdhrat në lidhje me gjuhën e huaj që duhej dhënë nëpër shkolla: frëngjisht në periudhën 1945-1946, serbokroatisht më 1946-1948 dhe në fund rusisht, duke filluar nga viti 1948. Gjuhët e tjera u përjashtuan, sepse u përkisnin shteteve borgjeze. U mbyllën shkollat private dhe ato fetare. Nga programet u hoqën: greqishtja e vjetër, latinishtja, filozofia, edukata morale dhe mësimi i fesë”.<sup>264</sup> Ndërkohë, gjithnjë nën trysninë e madhe të PKJ dhe shkallës së lartë të indoktrinimit projugosllav të një bërthame të udhëheqjes së PKSH, të cilën e përfaqësonte Koçi Xoxe, vazhdonin të thelloheshin marrëdhëniet me jugosllavët. “Tito mbetej gjithnjë i parinë shkallëzimin e garan të vetëvijës së re, por kishin filluar lidhjet edhe me qeveritë tjera komuniste... Enver Hoxha donte që njerëzit të mendonin se, mes të mëdhenjve të Lindjes, ai ishte i barabartë mes të barabartëve”<sup>265</sup>. “Zëri i Popullit”, gjatë muajit janar, kishte shkruar me epitetet më të veçanta për rolin e Titos në Luftën e Dytë Botërore, duke madhëruar rolin e tij, në sajë të të cilit janë arritur fitoret e

---

263 Po aty.

264 Amik Kasoruh, vep. e cit., f. 58.

265 Po aty, f. 61.

revolucionit popullor, jo vetëm në Jugosllavi dhe në Shqipëri, por edhe në gjithë Ballkanin".<sup>266</sup> Më 5 shkurt 1945, Vasil Komoni, udhëheqës i lartë ushtarak i Shqipërisë, kishte arritur për vizitë në Beograd dhe, pikërisht, në të njëjtën datë, Radio Beogradi kishte filluar emetimin e emisionit në gjuhën shqipe. Më 13 prill, kishte ardhur për vizitë në Tiranë Zharko Broz, i biri i Titos, kurse më 25 maj në Tiranë u zhvillua takimi ndërmjet Enver Hoxhës dhe Milovan Gjilasit. Lidhur me këtë takim, Milovan Gjilasi evokonte: "Te Enver Hoxha isha vetëm njëherë. Ai më la përshtypje të një njeriu jashtëzakonisht inteligjent, por disi të përmbajtur... Në atë kohë pala shqiptare u ankua për sjelljet e një përfaqësuesi tonë jugosllav në Shqipëri (fjala ishte për Velimir Stojniçin -A.Z)... Kjo nuk do të thotë se nuk kemi biseduar asgjë edhe për çështjen e Kosovës, por megjithatë qëndrimet ishin të prera për këtë çështje".<sup>267</sup> Enver Hoxha, në fjalimin e tij të mbajtur në Kongresin II të Rinisë Antifashiste të Shqipërisë, duke folur për rolin e Titos në Luftën e Dytë Botërore, kishte deklaruar: "Merreni me mend shokë të mi çfarë do të ndodhte këtu në Ballkan... sikur të mos ishin popujt e guximshëm të Jugosllavisë me në krye njeriun e madh, marshallin Josip Broz Tito...".<sup>268</sup> Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave u intensifikuan me ardhjen në Tiranë të Velimir Stojniçit, ministër fuqiplotë i RPF të Jugosllavisë në Shqipëri, më 1 qershor 1945, dhe me vizitën e delegacionit të grave antifashiste të Shqipërisë në Beograd, më 19 qershor. Në të njëjtën ditë Haxhi Lleshi, Shefqet Peçi dhe Tahir Kadareja u dekoruan nga qeveria jugosllave. Më 6 shtator 1945, Enver Hoxha, në emër të tij personal, dekoroi anëtarë të misioneve ushtarake të Jugosllavisë dhe të Bashkimit Sovjetik, ndërkohë që më 29 shtator, nën ndikimin e presioneve jugosllave dhe me pajtimin e qeverisë shqiptare

266 Idriz Lamaj, Marrëdhëniet partiake shtetërore Shqipëri-Jugosllavi, Nju Jork, 1977, f. 9.

267 Agim Zogaj, vep. e cit., f. 27.

268 Dokumenti nr. 109834, Arkivi i KQ të LKJ-së, Beograd.

tare, Misioni Ushtarak Amerikan e lëshoi Tiranën. Velimir Stojniçi, me rastin e dekorimit të tij nga Këshilli Antifashist shqiptar, kishte premtuar: "Këto dekorata përforcojnë miqësinë e vendeve tona dhe dijeni se popujt e Jugosllavisë do të bëjnë ç'është e mundur për sigurimin e independencës nacionale shqiptare".<sup>269</sup> Në të njëjtin muaj u mbajt kongresi i intelektualëve, me qëllim të rikonstruktimit të shkollave, teatrove dhe filmit nën patronazhin jugosllav.<sup>270</sup> Muaji tetor, në planin e intensifikimit të bashkëpunimit Shqipëri-Jugosllavi, u karakterizua me ardhjen në Shqipëri (1 tetor) të një numri mjekësh, dentistësh dhe infermierësh jugosllavë, të cilët i kishte dërguar Ministria e Shëndetësisë Jugosllave dhe me fillimin e veprimtarisë së Shoqërisë Shqipëri-Jugosllavi, e cila drejtohej nga kosovari Ramadan Çitaku, një nga bashkëpunëtorët më të afërt të Enver Hoxhës. Më 30 tetor 1945, në Tiranë, me detyrë të ambasadorit të RPF të Jugosllavisë, erdhi Josip Gjergja, diplomat jugosllav me prejardhje shqiptare. Pas njohjes jo të plotë ndërkombëtare të qeverisë shqiptare, pra në fund të vitit 1945 dhe në fillim të vitit 1946, Shqipëria ishte orientuar për marrëdhënie sa më të afërta me Jugosllavinë dhe BRSS, duke u larguar kështu nga kursi i politikës së jashtme diplomatike edhe me shtetete Perëndimit. Me këtë orientim të politikës së jashtme, shteti shqiptar dhe udhëheqja e PKSH përfundimisht kishin mbetur në orbitën lindore dhe po i hapnin rrugë izolimit të gjatë nga rrjedhat e shoqërive perëndimore. Megjithatë, përfaqësuesit e PKJ nuk mjaftoheshin me këtë nivel të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, por të shtyrë nga politika e diktatit mbi palën shqiptare dhe në radhë të parë në udhëheqjen e PKSH, në fillim të vitit 1946, po i shprehnin pakënaqësitë e tyre ndaj udhëheqësve shqiptarë: "Shqiptarëve u bëhej vërejtje se në mënyrë të pamjaftueshme e çmonin ndihmën ekonomike të

269 "Bashkimi", 6 shtator 1945.

270 "Politika", Beograd, 15-16 shtator 1945.

Jugosllavisë, ndërsa nga ana tjetër nuk i kryenin obligimet e tyre ndaj Jugosllavisë. Udhëheqjes partiake shqiptare iu përshkrua si gabime dhe fakti pse shtypi shqiptar, veçmas gazeta "Bashkimi", organ i Frontit Demokratik të Shqipërisë, nuk shkruante mjaft për Jugosllavinë, apo pse ndaj ngjarjeve sillej si vëzhgues neutral. Ndër dobësitë radhitej edhe fakti i mosbotimit të fjalimeve të Titos në tërësi dhe moskommentimi i fjalimeve të tij".<sup>271</sup> Kritikën jugosllave ndaj palës shqiptare shkonin edhe deri aty sa udhëheqja partiak edhe ajo shtetërore e Shqipërisë kritikohej madje edhe për mosinformim të mjaftueshëm të saj për rrethanat në Jugosllavi. Historiani dhe njohësi i mirë i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, Branko Pribiçević, në trajtimin e kësaj çështjeje, vlerësonte: "Prej këtyre keqkuptimeve dhe pakënaqësive të fshehura, megjithatë fshihej divergjenca e thellë e shprehur në pakënaqësinë e Enver Hoxhës në lidhje me statusin e Kosovës, i cili nuk u zgjidh në favor të Shqipërisë ashtu si ishte pritur, si dhe pakënaqësia personale e tij ndaj Velimir Stojnićit, i cili sipas Hoxhës, e favorizonte Koçi Xoxen në llogari të tij".<sup>272</sup> Dyshimet e jugosllavëve ndaj palës shqiptare në lidhje me mungesën e një përcaktimi edhe më të fuqishëm të udhëheqjes shqiptare ndaj modelit jugosllav shkonin deri aty sa pala jugosllave paraqitej e habitur pse udhëheqja e PKSH nuk e pranonte më me entuziazëm ndihmën ekonomike, politike, ushtarake e kulturore të jugosllavëve. Ata kishin ngritur shqetësime edhe lidhur me atë pse udhëheqja shqiptare nuk mbështetej edhe më tepër në përvojat e modelit jugosllav të ndërtimit të socializmit, veçmas, pse nuk kërkonte me vet iniciativë mbështetje më të madhe të Jugosllavisë. Edhe në fund të vitit 1945, diplomacia jugosllave, përmes përfaqësuesve të saj në Tiranë, shprehte pakënaqësi për orientimin e tillë të qeverisë shqiptare, duke konstatuar:

271 Branko Pribiçević, *Balkanska federacija*, Beograd, 1990, f. 149.

272 Po aty.

“...Shqipëria, në vend të orientimit kah Perëndimi, duhet-vendosmërisht dhe pa dilema të orientohet kah Lindja, Jugosllavia, Ballkani demokratik dhe BRSS. Shqiptarët janë lëshuar në spekulimet e rrezikshme dhe joprincipiele të Perëndimit me parullën, çdo gjë për pranimin ndërkombëtar të vendit tonë”.<sup>273</sup> Në këtë periudhë, në prag të fillimit të vitit 1946, në udhëheqjen e PKSH po kristalizoheshin dy linja: linjës së parë i printe Enver Hoxha që ishte për një afrim mundësisht sa më të kujdesshëm dhe të matur kah Jugosllavia, ndërsa, linjës së dytë i printe Koçi Xoxe që angazhohej për shpejtimin e thellimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në të gjitha fushat, duke përfshirë këtu edhe unifikimine monedhës dhe të ushtrive. Enver Hoxha, të cilit edhe pas Plenumit të Beratit ende i rrezikohej vendi udhëheqës në PKSH, ndjehej i kërcënuar për pozitën e tij, prandaj ndihmën jugosllave e kuptonte edhe si presion ndaj tij. Pikërisht, në lidhje me këto presione dhe përpjekjen që në një masë të caktuar të lirohej prej tyre, Enver Hoxha sugjeronte: “... Shqipëria t’i realizojë lidhjet me frontin demokratik përmes Bullgarisë në vend të Jugosllavisë. Mirëpo Moska, deri në fund të vitit 1947, e orientonte për bashkëpunim me Beogradin”.<sup>274</sup> Enver Hoxha, në kujtimet e tij për këto zhvillime, shkruante: “Shpërthyen grindjet, acarimi në Byronë tonë Politike. Kuptohet, këto grindje nuk shpërthenin përgjëra të vogla, përkundrazi, për probleme të mëdha që dilnin para vendit, partisë, pushtetit në të gjitha fushat. Kështu, po hynim në etapën e re historike pa një vijë të përcaktuar qartë e saktë”.<sup>275</sup> Presionet dhe kërcënimet politike të jugosllavëve ndaj kreut udhëheqës të PKSH, Enver Hoxhës, po bëheshin gjithnjë e më sistematike dhe ato më në fund, në fillim të vitit 1946, dhanë frytet e

273 Arkivi diplomatik i Sekretariatit për Punë të Jashtme të Jugosllavisë, Shqipëria, 1946/I, nr. 28.

274 Arkivi Diplomatik i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Shqipëria, 1945, nr. 2.

275 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 224.

para konkrete, duke e detyruar vetë Enver Hoxhën që sadopak ta lëvizte kursin e politikës së brendshme partiakenë Byronë Politike të KQ të PKSH. Lufta politike e fraksioneve po paralajmërohej, ndërsa viktima e saj e parë, gjithnjë nën trysinë jugosllave dhe të grupit pro-jugoslav përbrenda Byrosë Politike të KQ të PKSH, u bë Sejfulla Malëshova, një nga udhëheqësit liberalë të PKSH në atovite. “Përqëndrime dhe veprime të tilla antimarksiste e armiqësore që Sejfullai i kishte pa fund, ne vendosëm ta dënonim me të drejtë në Plenumine 5-të të KQ të PKSH në shkurt 1946... tash ishte edhe “dikush” tjetër i interesuar për këtë dënim. Ky “dikush”, në radhë të parë, ishin jugosllavët”.<sup>276</sup> Motivet e këtij modifikimi të kujdesshëm të kursit politik përbrenda Byrosë Politike të PKSH nga ana e Enver Hoxhës ishin të determinuara në radhë të parë nga presionet jugosllave, por që vinin edhe nga grupi me orientim jugosllav, i cili vepronte për brenda Byrosë. Në të njëjtën kohë, ky modifikim i kursit politik vinte edhe nga vendosmëria e Enver Hoxhës që të mos lëshonte postin e sekretarit të përgjithshëm të KQ të PKSH. Mbi të gjitha ishte me rëndësi jugosllavët kishin arritur efektet e paratë presionit ndaj udhëheqjes së PKSH, që ajo tani e tutje të orientohej pa dilema për bashkëpunim sa më të drejtpërdrejtë me Jugosllavinë dhe të hiqej përfundimisht nga rendi i ditës orientimi për bashkëpunim me Perëndimin. Kthesa e madhe në këtë kuptim, e cila Jugosllavisë do t’ia hapte portatë ndërhyrjes dhe ndikimit të gjithanshëm në Shqipëri, pra edhe në veprimtarinë e brendshme të Byrosë Politike të KQ të PKSH, tanimë ishin hapur frontalisht. Plenumit të 5-të të KQ të PKSHi kishin paraprirë debatet e zjarra dhe polemizuese në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH që kishte filluar më 6 dhjetor dhe që kishte mbaruar më 11 dhjetor të vitit 1945. Në dhjetor 1945, Byroja Politike e KQ të PKSH kishte kritikuar rreptë “veprimtarinë oportuniste” të Sejfulla

<sup>276</sup> Enver Hoxha, vep. e cit., f. 234.



Malëshovës, anëtar i së njëjtës Byro. “...Konkluzionet, në të cilat erdhi Byroja, më 11 dhjetor 1945, kërkonin patjetër thirrje ne Plenumit të Komitetit Qendror për të marrë në shqyrtim vijën, për të përcaktuar drejt qëndrime te mëtejshme dhe njëkohësisht për t’i dhënë fund dhe zgjidhje të drejtë situatës së krijuar në Byronë e KQ të Partisë ku dominonin pikëpamjetë kundërta në çështjen e vijës”.<sup>277</sup> Në raportin politik mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PKSH, më 21 shkurt 1946, Enver Hoxha konstatonte: “... Natyrisht, të influencuar nga kjo tendencë oportuniste, nuk e kemi orientuar popullin tonë sa duhet drejt vëllazërimit të shëndoshë me Jugosllavinë që është një kusht i domosdoshëm për ekzistencën vendit tonë... Në popull duhet të ngjallim dashurinë dhe vëllazërimin për Jugosllavinë, që u lind në këtë luftë. Jugosllavia ka qenë përkrahësja më e madhe dhe e drejtpërdrejtë në Luftën Nacional-çlirimtare, ajo do të vazhdojë të jetë një nga ndihmëset më të mëdha të popullit tonë dhe të pushtetit. Duhet të luftojmë me mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që kërkojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë...Të dy vendet tona duhet të jenë para rojë në Ballkan për të forcuar bllokun e madh të demokracisë përparimtare dhe të bëhen mbështetje e gjallë për Bashkimin Sovjetik në këtë anë”.<sup>278</sup> Në këtë raport, fragmentet e të cilit nuk janë botuar në vëllimin 3-të të veprave të Enver Hoxhës (1969), ai, pasi përcakton rolin e Shqipërisë në ruajtjen dhe sigurimin e interesave ruse në Ballkan, kritikon mospërkushtimin e PKSH që të realizojë marrëveshjet bilaterale me Jugosllavinë: “Por këto marrëdhënie ekonomike, sipas mendimit tonë, nuk janë konkretizuar siç duhet, përkundrazi ato janë të shthurura. Ne nuk u kemi vënë kujdesin e duhur. Me Jugosllavinë ne duhet të kemi marrëdhënie ekonomike më të vendosura, më konkrete

277 Enver Hoxha, Vepra 3, Tiranë, 1969, f. 262.

278 AQSH.F.14/AP,dos. 1, v. 1946.

dhe më të ngushta, dhe, pa i konkretizuar këto marrëdhënie do të jetë gabim dhe marrëzi të kërkojmë tregje jashtë si, në Itali, Çekoslovakia e gjetkë”.<sup>279</sup> Pikërisht, në këtë pikë, pranë orientimin e politikës së jashtme shqiptare, sipas Sejfulla-Malëshovës edhe kah Perëndimi, Enver Hoxha e kritikonte atë se ka qenë “... kurdoherë partizani një politike të butë dhe oportuniste kundrejt anglo-amerikanëve dhe e nënvleftëson-te më tepër se kushdo tjetër rrezikun e reaksionit të jashtëm. Ai kujtonte se duke u bërë koncesione anglo-amerikanëve do të shpejtohej njohja e qeverisë dhe do të normalizohej situata jonë ndërkombëtare”.<sup>280</sup> Enver Hoxha, i cili në raportin e tij politik mbajtur në Plenumin e 5-të të KQ të PKSH paralajmëronte thellimin e kursit të fortë politik pro-jugosllav në fushën e politikës së jashtme, vlerësonte: “Forcimi i marrëdhënieve ekonomike e kulturore me Jugosllavinë janë aq të rëndësishme sa edhe koordinimi i politikës së jashtme dhe i mbrojtjes nga armiqtë e përbashkët. Kjo çështje është në rend të ditës dhe pret vetëm një zgjidhje të drejtë nga ana jonë”.<sup>281</sup> Por, Plenumi i 5-të i KQ të PKSH njëherit, përveç thellimit të kursit pro-jugosllav, kishte sjellë vendime edhe për një vetëdijesim më të madh përballë “rrezikut imperialist” të vendeve perëndimore. Lidhur me këtë, nëkonkluzionet dhe-vendimete Plenumit të 5-të të KQ të PKSH kërkohej: “Populli ynë duhet të kuptojë mirë se ç’rrezik janë për vendin tonë imperialistët e huaj. Për këtë arsye, partia duhet të zhvillojë urrejtjen kundër tyre”. Vendimet dhe debati i zhvilluar në Plenumine 5-të të KQ të PKSH kishin qenë temë bisede edhe në takimin e zhvilluar midis Nesti Kerenxhit, anëtar i KQ të PKSH, dhe Aleksandër Rankoviçit, zëvendësministër i Punëve të Brendshme, më 29 mars 1946. Në radiogramin dërguar nga Beogradi në adresë të Koçi Xoxes, zëvendësi i tij,

---

279 Po aty.

280 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 265.

281 AQSH.F.14/AP,dos. 1, v. 1946.

Nesti Kerenxhi informonte: “U takova me gjeneral Rankoviçin. Fola mbi çdo gjë me të, sepse këtu akoma nuk kanë kaluar gjithë ndryshimet që kanë të bëjnë me Ministrinë e Brendshme. Më foli për Plenumin e Pestë dhe për konkluzionet. Mendimi tyre është se në autokritikë është shkuar më larg se sa duhet, se ka qenë më e fortë, më e rreptë se sa duhej. Me gojë do të flasim më gjerë kur të vijë atje. Markoja (A. Rankoviçi -A.Z.) më porositi që të bëja këtë telegram, sidomos në lidhje me ruajtjen e dokumentit të konkluzioneve. Ky dokument duhet të mbetet vetëm në duart e Komitetit Qendror”.<sup>282</sup> Pra, Nesti Kerenxhi paralajmëronte aktivitete të shumta dhe intensifikim të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në të gjitha fushat, si atë diplomatike, ekonomike, kulturore, arsimore e deri te ato ushtarake. Udhëheqja shqiptare në të gjitha këto aktivitete dhe veprimtari po dëshmonte konsekuencë në rrugën e forcimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe imponohej me qëndrimin tashmë pa dilema për mbështetjen e vendosur në shtetin sllav fqinj. Në planin diplomatik, Jugosllavia kishte ofruar edhe mbështetje dhe garancise do të mbronte interesat e shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare.

Përcaktimi i udhëheqjes shtetërore shqiptare që Jugosllavisë t’i jepej mandati i mbrojtjes së interesave të saj ishte transparent dhe pa ekoiuvoke. Në lidhje me këtë, Enver Hoxha në fjalimin e tij, në Plenumin e KQ të PKSH, mbajtur nga 25-27 prill 1946, pikërisht rreth mbrojtjes së interesave të Shqipërisë në fushën e diplomacisë ndërkombëtare, kishte veçuar: “Jugosllavët na kanë propozuar që, kudo ku ata kanë përfaqësi diplomatike, të kemi edhe ne një përfaqësues tonin pranë atyre përfaqësive për t’i ndihmuar në kërkesat tona e për të bërë punën tonë. Ne e kemi pranuar këtë propozim të jugosllavëve. Ata presin emrat e elementëve tanë dhe ne duhet të përgjigjemi sa më parë. Në vende të tilla si Amerika duhet

282 AQSH. F. 14/AP, dos. 10, v.1946.

të dërgojmë elementë të zotë”.<sup>283</sup> Pra, ndërhyrjet jugosllave në zhvillimet e brendshme shtetërore dhe partiake në Shqipëri, në të gjitha sferat e jetës politike, sa vinin e bëheshin më të drejtpërdrejta dhe reflektonin edhe gatishmërinë e palës shqiptare që, në formë të servilizimit, t’i lejonin palës jugosllave ndërhyrje të tilla. Në këtë kuptim, mund të marrim si ilustrim diskutimet në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, mbajtur më 3 maj 1946, ku ishte shqyrtuar përmbajtja e telegramit, të cilin e kishte dërguar nga Beogradi Nako Spiru. Enver Hoxha, duke referuar para anëtarëve të Byrosë Politike, kishte bërë të ditur se sipas konfirmimit të Nako Spirus: “Jugosllavët janë të mendimit që ne ta shtyjmë kongresin (Kongresi i PKSH ishte vendosur në Plenumin e 5-të të KQ (shkurt 1946) të mbahej më 25 maj 1946 -A.Z.). Arsyet, thonë ata, janë: çështja e situatës, sidomos që jemi para Konferencës së Parisit (është fjala për Konferencën e Paqes që u hap në Paris, në korrik 1946 - A.Z.), të shohim si do të vejë. E dyta, duhen bërë përgatitje për kongresin, të përgatiten tezat, rezolucionet, programi dhe statuti i Partisë dhe gjithë punët e tjera. Edhe Nakoja është i këtij mendimi që Kongresi të shtyhet... Traktatet me amerikanët, jugosllavët thonë se ata vetë i kanë pranuar dhe se mund t’i pranojmë edhe ne ato traktate që kanë karakter ndërkombëtar. Ata (jugosllavët-A.Z) kërkojnë vetëm që të lihet mënjanë (marrëveshja) që Amerika të jetë shtet i favorizuar... (Midis qeverisë zogiste dhe qeverisë amerikane që nënshkruar një marrëveshje për t’u njohur SHBA të drejtë ne kombit më të favorizuar). Jugosllavët nuk janë në dispozicion të blejnë sendet tona me çmimet e tregut të tyre, si u intereson atyre.”<sup>284</sup> Siç shihet, pala jugosllave i shfrytëzonte marrëdhëniet e pabarabarta shqiptaro-jugosllave për të përcaktuar edhe detyra në fushën politikës së brendshme, ndërkombëtar edhe në atë ekonomike. Nëse PKJ ka mundur t’u deklarojë dhe t’u

---

283 AQSH. F. 14/AP, dos. 2, v. 1946.

284 AQSH. F. 14/AP, dos. 7, v. 1946.

preferojë udhëheqësve të PKSH se kur mund të mbahet ose jo Kongresi i parë i PKSH, atëherë del se, statusi i PKSH paraqitej si i barabartë me statusin e partive komuniste të republikave tjera jugosllave, që nënkupton varshmërinë e plotë të PKSH nga PKJ. Edhe në pikën rreth mospranimit të marrëveshjes me SHBA, që ato të kenë statusin e shtetit të favorizuar, udhëheqja jugosllave lëshonte direktiva qëllimkëqija ndaj shtetit shqiptar për ta lënë sa më larg orbitën e shteteve perëndimore dhe për ta detyruar Shqipërinë që të krijonte aleanca, duke kërkuar mbështetje vetëm të Jugosllavia dhe BRSS. Sa u përket marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, historiografia jugosllave ka shkruar vazhdimisht për ndihmat e mëdha ekonomike, të cilat Jugosllavia ia ka dhënë Shqipërisë deri në vitin 1948. Mirëpo, siç del nga referimi i Enver Hoxhës, në mbledhje në Byrosë Politike, pala jugosllave nuk dëshironte që të krijonte marrëveshje ekonomike-financiare me shtetin shqiptar me çmimet e tregut ndërkombëtar, por me çmimet që atyre ju konvenonin.

Marrëdhëniet ekonomiko-tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, të cilat u intensifikuan në fillim të vitit 1946, ishin zhvilluar mbi bazat e pabarabarta edhe nga fakti se zhvillimi ekonomik në Shqipëri ishte dukshëm nën atë jugosllav, edhe pse Jugosllavia e pasluftës po përballlej me vështirësi të mëdha ekonomike. “Në sajë të kësaj, Jugosllavia ka mundur të eksploronte Shqipërinë, sikur t’i merrte për bazë çmimet botërore, ashtu si ishte rasti i tregtisë sovjetike me vendet juglindore. Në vend të kësaj, tregtia ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë është zhvilluar mbi atë bazë, sipas së cilës Shqipëria ia ka shitur mallrat e saj Jugosllavisë sipas çmimeve, të cilat kanë ekzistuar në tregun vendas shqiptar, kurse të mirat materiale të Jugosllavisë janë eksportuar sipas çmimeve jugosllave... E gjithë kjo e ka pamundësuar Jugosllavinë që të nxjerr superprofit, i cili buron nga ndryshimi në

nivelin e zhvillimit ekonomik të dy vendeve”.<sup>285</sup> Shqipëria, sipas autorëve jugosllavë, duke i krijuar shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave, me kërkesë të shtetit shqiptar, “... pasasë gjithash ka punuar në zhvillimin e forcave prodhuese në Shqipëri. Është krijuar shoqëria për ngritjen e hekurudhave në Shqipëri...Përmes shoqërive të përziera në Shqipëri është ndërtuar rruga Durrës-Peqin, e gjatë 43 kilometra, janë bërë përgatitjet për ndërtimin e hekurudhës Durrës-Tiranë... Të gjitha këto, Jugosllavia i ka bërë për dy vjet. Gjatë ekzistencës së shoqërive të përziera, për tre vjet me radhë, Jugosllavia nuk ka marrë pjesën e vet të profitit, por e ka investuar në ndërmarrje. Jugosllavia ka shkuar edhe më larg, edhe pse në vitet e pasluftës edhe vetë ishte në pozitë të vështirë ekonomike, i ka dhënë Shqipërisë kredit në vlerë prej 2 miliardë lekë (afro 40 milion dollarë)”.<sup>286</sup> Arkivat jugosllave konfirmojnë për ndihmë teknike të Jugosllavisë për Shqipërinë, kështu që në Shqipëri, gjatë viteve 1945-1948, janë dërguar 597 ekspertë jugosllavë, kurse në vitin 1946 Shqipërisë i janë dërguar 20.000 tonë misërdhe grurë që të zbutet uria. Në tetor të vitit 1946, kur Shqipërinë e përfshinë vërshimet, në Jugosllavi ishin mbledhur 57 milion dinarë ndihmë. Pala jugosllave vazhdimisht kishte potencuar: “Me vendosjene marrëdhënieve të tilla synohet që të eliminoheshin marrëdhëniet, të cilat padrejtësisht ishin vendosur në periudha të kaluara dhe që sollën konfliktet dhe mosmarrëveshjet. Me zgjidhjen e këtyre çështjeve filluan të ndërtohen marrëdhëniet e tilla, të cilat do të ishin bazë për ofrimin më të fuqishëm, jo vetëm midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, por edhe midis të gjitha vendeve socialiste”.<sup>287</sup> Mirëpo: “Me ndihmën ekonomike për Shqipërinë, Jugosllavia synonte një rrugë protektorati në Shqipëri, e cila shumë pak ndryshonte nga politika fashiste e

285 Vladimir Dedijer, Novi prilozhi za autobiografiju Josipa Broza Tita, Zagreb, 1980, f. 425.

286 Po aty, f. 447.

287 Miodrag Milić, Današnja Albanija, Beograd, 1982, f. 9.

Italisë para luftës. Përveç nxjerrjes së naftës dhe xeheve tjera, Jugosllavia nxitoi që të ndërtonte rrugë dhe një hekurudhë. Hekurudha filloi të ndërtohej deri në Durrës, në mënyrë që më vonë të lidhte pjesë të Serbisë jugore me Durrësin. Madje, të gjitha shoqëritë e përbashkëta shqiptaro-jugosllave i nënshtroheshin këtij qëllimi. Në vitin 1947, u nënshkruan mbi 27 marrëveshje të tilla, qëllimi i të cilave ishte që të përgatitej terreni për futjen e Shqipërisë në Federatën Jugosllave”.<sup>288</sup> Megjithatë, përfaqësuesit diplomatikë të Jugosllavisë në Shqipëri nuk mjaftoheshin me përcaktueshmërinë verbale të udhëheqjes së PKSH dhe në ndonjë rast kur ata përmendin edhe orientimin për bashkëpunim edhe me shtetet perëndimore, nuk ngurronin të reagonin me shqetësim. Në këtë kuptim, janë karakteristike vlerësimet kritike në adresë të udhëheqjes së PKSH të Josip Gjergjës, i cili në një raport të muajit qershor të vitit 1946 dërguar nga Tirana në Beograd, ndër të tjera sqaronte: “... Në vend të orientimit të vendosur jo dymendësh kah Lindja, kah Jugosllavia, Ballkani demokratik dhe BRSS, çka do të ishte logjike dhe konsekuencë e nevojshme në realizimin e parimeve, disa burrështetas të Shqipërisë kanë sjellë shikimet e tyre më te përkah Perëndimi... E para, udhëheqësit, shtypi dhe organizatat shumë pak ose aspak nuk kanë ndërmarrë që ta njohin dhe ta solidarizojnë popullin me Jugosllavinë ... Fjalimet e udhëheqësve të Jugosllavisë, sukcesi dhe ndërtimi i saj i brendshëm dhe politika e saj e jashtme, që e gjitha mund të ishte një udhërrëfyes i mirë për Shqipërinë, kësaj në shtyp i është kushtuar një vend pa rëndësi ... Dhe, kur në mbarim të vitit 1945, Anglia njohu Shqipërinë, shtypi dhe manifestuesit ranë në delirium të pashpjegueshëm. Ndaj Amerikës është mbajtur i njëjti qëndrim”.<sup>289</sup> Diplomati jugosllav, Josip Gjergja, në ra-

---

288 Bernhard Tonnes, vep. e cit., f. 487.

289 Arkivi Diplomatik i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme e Jugosllavisë, Shqipëria, 1946, nr.7.

portin e tij, disa ditë parase Enver Hoxha të nisej për vizitën e tij të parë në Jugosllavi, shqetësohej edhe me faktet pse: "... Vetëm në muajin shkurt të vitit 1946, janë përzënë agjentët italianë dhe fashistë nga Shqipëria... se vetëm në muajin shkurt është përzënë misioni italian... pse studentët priten haptazi mundësinë e shkollimit në Itali, tregtarët mundësinë e tregtimit dhe të fitimeve me Italinë, por... edhe pse Qeveria Shqiptare ka qenë madje e gatshme që të pranojë kushtet e qeverisë amerikane për njohjen dhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike".<sup>290</sup> Ambasadori jugosllav, me prejardhje arbëreshe, në raportin e tij pranonte se pikërisht pala jugosllave ishte ajo që kishte bërë trysni ndaj qeverisë shqiptare për të mos pranuar kushtet amerikane për njohjen e qeverisë shqiptare të dalë nga Lufta e Dytë Botërore dhe për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis SHBA dhe Shqipërisë: "Me influencën nga jashtë, në momentin e parë, u arrit t'i ndryshohej mendja qeverisë nga pranimi i kushteve amerikane, në mes të cilave figuron edhe obligimi i trajtimit, njohjes së Amerikës si kombi më i privilegjuar".<sup>291</sup> Udhëheqja e PKSH, në veçanti grupi i vijës politike projugosllave me në krye Koçi Xoxen: "... Shikonte me besim aleancën ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve jugosllavë... Megjithatë, sekretari i përgjithshëm dhe shokë të tjerë të Komitetit Qendror i shikonin me shqetësim ndërhyrjet e përfaqësuesve jugosllavë në punët e brendshme të partisë e të shtetit shqiptar. Por ende nuk dyshonin se këto ndërhyrje bëheshin me udhëzim dhe me pëlqim të KQ të PKJ".<sup>292</sup> Në dokumentet e historisë së PKSH, në lidhje me ndërhyrjet jugosllave, konstatohet: "Duke kundërshtuar të gjitha rastet kur diplomatët dhe ushtarakët jugosllavë në Shqipëri përziheshin në çështjet e brendshme shtetërore të Partisë, ata përpiqeshin të zh-

---

290 Po aty.

291 Po aty.

292 Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1968, f. 241.



dukej çdo keqkuptim e çdo pengesë në marrëdhëniet midis dy shteteve dhe dy partive".<sup>293</sup> Në të vërtetë, për periudhën e viteve 1945-1946, gjatë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, si në fushën diplomatike, atë ekonomike, ushtarake dhe kulturore, pala shqiptare nuk kishte paraqitur kundërshtime, përkundrazi aprovimi i të gjitha iniciativave jugosllave që çonin në ndërhyrje te thella dhe të gjithanshme në jetën politike e shtetërore të shtetit shqiptar ishin aprovuar hapur dhe pa vërejtje nga udhëheqja e PKSH. E cekim PKSH, sepse në vitet e pasluftës PKSH si parti në pushtet, ishte parti-shtet dhe udhëhiqte të gjitha çështjet me interes shtetëror, qeveritar dhe nacional. Veprimi i tillë i PKSH, në fakt, nuk kishte kurrfarë ndryshimi nga partitë e tjera komuniste të shteteve të Evropës Juglindore.<sup>294</sup> Në prill të vitit 1946, gazeta "Bashkimi" me eufori të pazakontë shkruante: "Mirëpo, mbi të gjitha, populli ynë i është mirënjohës Jugosllavisë së re dhe udhëheqësit të saj, Marshallit të madh Tito, për mbrojtjen e të drejtave tona elementare para OKB. Populli ynë kurrë nuk ka dyshuar në sinqeritetin e miqësisë të popujvetë Jugosllavisë... Populli ynë do t'i ruajë si sytë e ballit dhe edhe më tepër do të forcojë miqësinë me popujte Jugosllavisë, sepse e di se kjo miqësi paraqet faktor të rëndësishëm jo vetëm për paqen në Ballkan dhe në Evropë, por do të jetë edhe garanci e shëndoshë për pavarësinë Shqiptare".<sup>295</sup>

Në vitin 1946, bashkëpunimi intensiv i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave ishte shënuar edhe në fushën e sigurisë dhetë punëve të brendshme midis dy shteteve. Lidhur me këtë bashkëpunim, i cili mund të kualifikohet edhe si ndërhyrje brutale e Jugosllavisë në çështje te sigurisë së brendshme dhe të sistemit të sigurisë e fshehtësisë shtetërore të Shqipërisë, janë me interes referimet në komunikimin përmes

---

293 Po aty.

294 Po aty.

295 "Bashkimi", 5 prill, 1946.

radiogrameve midis Koçi Xoxes, ministër i brendshëm i Shqipërisë dhe Aleksandër Rankoviçit, ministëri brendshëm i Jugosllavisë. Aleksandër Rankoviçi, në radiogramin e datës 24 janar 1946 dërguar Koçi Xoxes, duke njoftuar për saktësimin format ashagjente, konfirmonte: “Sipas njoftimeve që kemi, ishadjutanti i mbretit, kolonel Muharrem Bajraktari, ka bashkuar disa krerë të fiseve me ndihmën e oficerëve anglezë, të cilët nuk janë zyrtarisht në Shqipërinë e Veriut dhe drejtojnë një punë kundër qeverisë... Disa ish bajraktarë të fiseve shqiptare bisedojnë midis njerëzve të tyre për një kryengritje me armë në pranverë në Shqipërinë e Veriut... Fiqri Dine dhe Hysni Dema kanë në dispozicion një shumë mjaft të madhe të hollash dhe po vazhdojnë që të armatosin malësorët e tij. Na lajmëroni se a janë të vërteta njoftimet e mësipërme”.<sup>296</sup> Koçi Xoxe, ndërkohë, në radiogramin e datës 12 prill, e informonte Rankoviçin për lëvizjet në planin sigurisë: “Porsa kemi arrestuar një dezertor të ushtrisë sonë që kalonte kufirin duke ardhur nga Greqia... Interesant është se ai deklaroi të ketë lidhje me informatorë në territorin jugosllav. Në fshatin Odrec (Jugosllavi) ai ka lidhje me vëllezërit Myslim e Shyqyri edhe me një farë Mevludin...”.<sup>297</sup> Në radiogramet e datave 5, 12 dhe 15 maj 1946, dërguar Rankoviçit, Koçi Xoxe kërkonte mendimin e tij konkret lidhur me mënyrën e organizimit të shërbimit të sigurimit sekret shqiptar, duke iu drejtuar me fjalët: “... Ju lutem të më përgjigjeni si mendoni ju të rregullohet kjo çështje, sepse ne kemi problemin e buxhetit të Ministri së sonë të Brendshme”.<sup>298</sup> Shkallën e ndërhyrjes së ministrit të brendshëm jugosllav në çështjet e sigurisë së shtetit shqiptar e dëshmon mjaft bindshëm edhe radiogrami datës 10 shtator 1946, të cilin Rankoviçi ia kishte dërguar homologut të tij shqiptar, në lidhje me korrespon-

---

296 Arkivi i Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë, D.1623/9.

297 Po aty.

298 Po aty.

dentin e një gazete britanike: “Majori Sajers, korrespondenti një gazete angleze, dëshiron që të vijë tash në Shqipëri. Mbase ky person merret në radhë të parë me punët informative, do të ishte mirë që në këtë situatë të mos i jepni lejen e hyrjes për në Shqipëri, në rastse do ta kërkonte”<sup>299</sup>. Koçi Xoxe, një ditë pas incidentit në Kanalin e Korfuzit e informonte Aleksandër Rankoviçin për ngjarjen, për të cilën Shqipëria pësoi aq shumë në planin ndërkombëtar. Në radiogramin e datës 26 tetor 1946 dërguar Koçi Xoxes nga Shpend Dega, ndërlihdhës i tij në Legatën Shqiptare në Beograd, Xoxes i transmetoheshin qëndrimet e Rankoviçit: “... Përsa u përket provokimeve në kufirin grek, si gjithnjë, kur të cënojnë tokën, qëlloni. Pastaj i erdhi gjaku në fytyrë prej urrejtjes e tha: “Ju nuk i keni thirrur vaporët anglezë në ujërat tuaja? Mirë e kanë pësuar”.<sup>300</sup> Rankoviçi, edhe më 19 janar të vitit 1948, kur jugosllavët qëllimisht frikësonin palën shqiptare gjoja për përgatitjen e Greqisë që të sulmonte Shqipërinë, nuk e shihetë udhës që për këtë të informonte së pari Enver Hoxhën, por drejtpërdrejt e njoftonte Koçi Xoxen, duke i shkruar: “Në Qeverinë e Greqisë po zhvillohen bisedime për të sulmuar Shqipërinë. Meqenëse kohëve të fundit po zhvillohet fushatë e madhe, veçmas kundër jush, nuk përjashtohet mundësia që kjo bandë me përkrahjen edhe të amerikanëve të mendojë edhe në provokime të hapura. Në kufirin tuaj duhet të përcillen lëvizjet e ushtrisë monarko-fashiste”.<sup>301</sup> Në radiogramin e Koçi Xoxes dërguar Aleksandër Rankoviçit, më 15 maj 1948, në lidhje me çështjen agjenturore në rrethet e Kosovës, veç të tjerash, pala shqiptare pajtohej që Sigurimi Jugosllav (UDB) në bashkëpunim edhe me Sigurimin Shqiptar të organizonte ndjekjen dhe kapjen e Luan Gashit dhe Jup Binakut, që vepronin në bazat ilegale politikenë Kosovë: “Se si e kërkonti

---

299 Po aty.

300 Po aty.

301 AQSH.F.14/AP,dos. 2, v.1948.

ju gjendjen në Kosovë, ne nuk dimë. Ne jemi dakord që ata të mos i lëmë të dalin me një proklamatë. Për Luan Gashin ose Jakup Binakun, si ilegalë që janë, mundet të organizojmë kapjen. Kjo nuk rrezikon vazhdimin e përpunimit. Tashti njoftohemi nga Kukësi se shokët tuaj në Prizren qysh të premtën kanë arrestuar dy anëtarë të organizatës dhe mendojmë që brenda dy ditëve të bëhet realizimi”<sup>302</sup>. Qëndrimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të shtetit shqiptar dhe personalisht Koçi Xoxes, si ministëri brendshëm në qeverinë e parë socialiste të Shqipërisë, kundrejt qytetarëve të Kosovës, ilustron edhe me deklaratën e Zoi Themelkos, dhënë më 6 prill të vitit 1949: “Mbas çlirimit të Shqipërisë janë lejuar organet e UDB që të nxisin spiunazhin në Shkodër me qëllim që gjoja këta të zbulonin armiqtë e popullit jugosllav, t’i arrestonin vetë dhe të bënin si të donin me këta njerëz. Kështu që në atë kohë OZN (sot UDB) kishte dërguar për këtë majorin e OZN, Niko Piper. Ky arrestoi një numër njerëz pa pyetur aspak organet tona dhe i shoqëronte për në Jugosllavi. Nga këta njerëz që arrestoheshin, shumë prej tyre vriteshin rrugës, duke i maskuar. Ka ndodhur që të jenë vlarë edhe në tokën shqiptare. Për të gjitha këto veprime ka dijeni fare mirë Koçi Xoxe...”<sup>303</sup>.

Vizita e Enver Hoxhës në Jugosllavi, prej 23 qershori deri më 2 korrik të vitit 1946, dhe takimi me Titon shënoi shtytje të re të thellimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe të varësisë edhe më të madhe të Shqipërisë nga Jugosllavia. Ajo vizitë ishte zhvilluar në rrethana mjaft të ndërlikuara për shtetin shqiptar dhe përgjithësisht për qeverinë shqiptare të udhëhequr nga Enver Hoxha. Në veçanti, kjo vizitë shënonte një sprovë të rëndë dhe tejet të ndërlikuar në radhë të parë për Enver Hoxhën. Së pari, duhet përmendur fakti se udhëtimi i Enver Hoxhës në Jugosllavi vinte pas qërimit të hesape-

302 Arkivi i Ministrisë së Brendshme, D.1623/6.

303 Po aty.

ve politike në radhët e udhëheqjes më të lartë të PKSH, që si konsekuencë kishte largimin e Sejfulla Malëshovës nga Byroja Politike e KQ të PKSH. Së dyti, Enver Hoxha, i cili edhe pse angazhohej për thellimin e marrëdhënieve me Jugosllavinë, megjithatë tani ndodhej edhe një hap më afër kapitullimit para grupit me përcaktimin e thellë për krijimin e federatës me Jugosllavinë që vepronte brenda Byrosë Politike të KQ të PKSH i udhëhequr nga agjenti jugosllav, Koçi Xoxe, të cilin jugosllavët e përkrahnin me të madhe në kursin e tij politik. Së treti, udhëheqja më e lartë e PKSH dhe personalisht vetë Enver Hoxha, tani më ishin pajtuar me shpallje lufte politike shteteve perëndimore, në radhët të parë SHBA dhe Anglisë, me çka përfundimisht Shqipëria po kalonte në kampin Lindor të shteteve komuniste. Së katërti, udhëheqja e PKSH, në mes të vitit 1946, i ishte dorëzuar krejtësisht kursit dhe ndikimit jugosllav dhe jugosllavët i kishin dyert e hapura për “gllabërimin” e Shqipërisë dhe për realizimin e synimit që ta bënte shtetin shqiptar njësi të re të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, përkatësisht të realizohej ideja për Konfederatën Ballkanike, në të cilën Jugosllavia do të kishte rolin udhëheqës. Ideja për Konfederatën Ballkanike, në fakt, kishte qenë projekt jugosllav që datonte qysh nga periudha e Luftës së Dytë Botërore dhe ithtarët e saj llogarisnin se Shqipëria do të ishte anëtaree asaj federate. Në lidhje me këtë, Eduard Kardeli, anëtar i Politbyrosë të KQ të PKJ, në raportin e KQ të PK të Sllovenisë, 1 tetor 1944, konstatonte: “Me fqinjët tanë është ndryshe. Shqiptarët po mbahen shkëlqyeshëm dhe duan federatë me ne. Kjo dëshirë te ata është e formuluar shumë qartë...”<sup>304</sup> Së pesti, qeveria shqiptare dhe udhëheqja e PKSH ishin pajtuar se çështja e Kosovës duhet të “mbyllet” përkohësisht në sirtarët e tavolinave diplomatike, duke u lënë për kohëra të tjera, sepse vlerësohej se në

---

304 Izvori za istoriju SKJ, Zbornik dokumenata centralnih organa KPJ, NOR i revolucija 1941-1945, lib. 20, Beograd, 1987, f. 171.

vitet e para të pasluftës Kosova më tepër mund të ishte mollë shërrë e shkas për ngatërresa me jugosllavët, sesa çështje që mund të zgjidhej në favor të së drejtës historike dhe etnike të popullit shqiptar në të dyja anët e kufirit. Shikuar realisht, madje edhe inicimi dhe përdorimi i temës së Kosovës nga britanikët, për atë kohë më tepër duhej kuptuar si çështje strategjike, sesa plan dhe strategji e Perëndimit për t'ia bashkuar Shqipërisë trojet etnike të ndara. Ky supozim del edhe nga fakti se Perëndimi në ato vite, po të dëshironte vërtet të ndihmonte shtetin shqiptar do ta përkrahte njohjen e qeverisë shqiptare, pavarësisht se çfarë formacioni politik-ideologjik e udhëhiqte Shqipërinë. Kjo sepse edhe disa shtete të tjera ballkanike, në të cilat ishin vendosur qeveritë komuniste, Perëndimi për dallim nga qeveria e Enver Hoxhës, ato i kishte njohur. Në rrethana të tilla, aspak të volitshme për shtetin shqiptar dhe përgjithësisht për udhëheqjen e PKSH, Enver Hoxha ishte ftuar për vizitë në Jugosllavi. Enver Hoxha në kujtimet e tij për këtë takim shkruante: "Në adresën time mbërriti një radiogram urgjent. E dërgonte Hysni Kapo, të cilin në atë kohë e kishim ambasador në Jugosllavi. E kishte thirrur "Markoja" (Rankoviçi vazhdonte të mbante pseudonimin e luftës) dhe i kishte komunikuar se këtë radhë prisnin urgjentisht në Beograd Enver Hoxhën! Tani pritej vetëm fjala ime nëse isha apo jo dakord të shkoja "sa më parë" në Beograd, ku do të më prisnin me "madhështi".<sup>305</sup> Në radiogramin e datës 19.6.1946, të cilin Hysni Kapo e dërgonte nga Beogradi, shkruhej: "Markoja më tha se është mirë që Enveri të vijë sa më parë, mundësisht të dielën. Pritet vetëm mendimi juaj. Për ardhjen tuaj do të vënë në dispozicion aeroplan po të jetë nevoja. Mendojnë t'ju bëjnë një pritje madhështore".<sup>306</sup> Në fakt, udhëheqja e PKSH edhe më parë i kishte dërguar udhëheqjes së PKJ dhe personalisht Titos kërkesë që një del-

---

305 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 246.

306 Po aty.

egacion i shtetit shqiptar i kryesuar madje nga vetë Enver Hoxha të vizitonte Jugosllavinë. Mirëpo, deri në qershor të vitit 1946, pala jugosllave nuk kishte treguar interesim për të ftuar për vizitë udhëheqësit më të lartë të PKSH, përfshirë këtu personalisht Enver Hoxhën. Ndërkohë që në Jugosllavi kishin udhëtuar delegacione të rinisë shqiptare, por edhe ekspertë të ekonomisë, industrisë dhe udhëheqës politikë të rangut të Byrosë Politike të PKSH, si Nako Spiru, Koçi Xoxe, Liri Gega etj. Lidhur me takimin zyrtar Hoxha-Tito, të mbajtur në Beograd më 26 qershor 1946, nuk ka shënime, të cilat deri më sot, qoftë nga pala shqiptare ose ajo jugosllave, janë bërë transparente. Përmbajtja e takimit më tepër ka mbetur në sferat e spekulimeve dhe komentimeve të pa argumentuara. Në këtë kuptim, jo me objektivitet dhe argumente të plota, historiografia mund t'u referohet edhe kujtimeve të Enver Hoxhës, të paraqitura në publikime të tij të mëvonshme. Nga këto shënime del se ndër temat e biseduara ka qenë projekti për të ashtuquajturën "Federatë Ballkanike" dhe tema për çështjen e Kosovës dhe bashkimin e saj me Shqipërinë. Enver Hoxha shkruante se gjatë bisedës, pikërisht për temën e Kosovës dhe të "Federatës Ballkanike", Tito i kishte thënë: "... Ne, nga ana jonë do të dalim në kohën e duhur edhe me propozime konkrete e do të shohim të gjitha rrugët e mundshme, por zemra na e do të ndërtojme federatën. Shembulli dhe përvoja e Jugosllavisë së re Federative do të shërbejë shumë në këtë drejtim. Por le ta lëmë për sot këtë problem. Unë e zura në gojë më tepër meqë ra fjala për të ardhmë Kosovës. Brenda "Federatës Ballkanike", çështja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë do të ishte shumë më e lehtë".<sup>307</sup>

Edhe historiografia jugosllave shkruan se tema e Kosovës ishte shtruar në takimin midis Enver Hoxhës dhe Titos, por pa dhënë detaje dhe të dhëna dokumentare për përmbajtjen e bisedimeve. "Shikuar burimisht, qëllimi jugosllav për

---

307 Po aty, f. 261.

dorëzimin e Kosovës dhe Metohisë Shqipërisë, 1943-1948, nuk është shënuar në asnjë dokument partiak apo shtetëror të cilin e kemi shikuar, por kjo nuk do të thotë se kjo çështje nuk ka ekzistuar. Bisedime të ndryshme individuale ndërmjet përfaqësuesve udhëheqës partiakë e shtetërorë ka pasur si në forumet e brendshme, ashtu edhe në bisedimet ndërshtetërore, por nuk ka marrëveshje ndërshtetërore ose akt ndërshtetëror, i cili në këtë kuptim do të hiqte çështjen nga rendi i ditës”.<sup>308</sup> Megjithatë, Enver Hoxha, pas prishjes me jugosllavët, përpigj të argumentonte se: “Plani i fshehtë i Titos ishte që, jo Kosova të lidhej me Shqipërinë, por Shqipëria të lidhej me Kosovën dhe, tok me të, të gllabërohej në Jugosllavinë titiste”.<sup>309</sup> Më 26 qershor 1946, ai u dekorua me Urdhrin e Heroit të Popullit të Jugosllavisë. Gjatë fjalimit falënderues, Enver Hoxha kishte ripërsëritur: “...Në çastet më të vështira vendi ynë ka gjetur mbështetjen më të madhe të Jugosllavia dhe populli ynë ka pasur në popujt e Jugosllavisë së re miqtë dhe aleatët më besnikë”.<sup>310</sup> Agjencia telegrafike jugosllave “Tanjug”, më 26 maj, kishte reaguar ndaj shkrimit të gazetës bullgare “Izgreila”, e cila shkruante se vizita e delegacionit shtetëror të Shqipërisë në Jugosllavi, i udhëhequr nga Enver Hoxha, menjëherë i dha shtytje të reja thellimit të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave në të gjitha nivelet. Jugosllavët, patjetër që duhej të ishin më të kënaqurit nga kjo vizitë dhe nga thellimi i këtij bashkëpunimi. Kjo në radhë të parë për faktin se me marrëveshjet bilaterale ekonomike ndërshtetërore që u nënshkruan gjatë dhe pas vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi, siguruan supremacion të theksuar në drejtim të ndikimit të plotë të politikës jugosllave në zhvillimet brendshme në Shqipëri. Me këtë vizitë, e cila aprovohej edhe nga BRSS, qeveria dhe përgjithësisht politika

---

308 Branko Petranović, vep. e cit., f. 136.

309 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 263.

310 “Bashkimi”, Tiranë, 28 qershor 1946.



e jashtme jugosllave kishte siguruar realizimin pa pengesa të kursit të ri të politikës së jashtme shqiptare për modelin dhe konceptin jugosllav të ndërtimit të shtetit. Nga ana tjetër, tanimë ishin eliminuar pengesat dhe fraksionet e brendshme partiake dhe shtetërore shqiptare që synonin ngadalësimin e afrimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, siç ishte rasti i Sejfulla Malëshovës e më vonë edhe Naku Spirus, rishikimin kritik të bashkëpunimit të njëanshëm dhe jo të barabartë ndërshtetëror midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Me këtë vizitë po forcohej pozita udhëheqëse e Enver Hoxhës, edhe pse në dëm të interesave të shtetit shqiptar, por gjithashtu po forcohej edhe pozita kyçe politike e Koçi Xoxes, të cilin, megjithatë Enver Hoxha nuk e kishte marrë në përbërjetë delegacionit gjatë vizitës në Jugosllavi. Nexhmije Hoxha, në kujtimet e saj për vizitën e parë të Enver Hoxhës në Jugosllavi, shkruante: “Pas mbarimit të kësaj vizite dhe nga ato që bënin jugosllavët në drejtim të “unifikimit” ekonomik, mund të themi, edhe ushtarak, Enveri u kthye me përshtypjen më të përforcuar se diçka po ndodhte, diçka më e madhe, sidomos në fushën politike. Jugosllavët po bëheshin gjithnjë e më arrogantë ndaj nesh. Nga agjentë të jugosllavëve dhe të Koçi Xoxes flitej haptas parulla: “Rruga për në Moskë kalon nga Beogradi”.<sup>311</sup> Efektet kryesore të kësaj vizite ishin reflektuar në marrëveshjet ekonomike e tregtare midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Si rezultati parë i vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi ishte nënshkrimi i marrëveshjes mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për krijimin e shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave, nënshkruar më 1 korrik 1946. Në artikullin e parë të marrëveshjes thuhej se të dy shtetet kanë vendosur të organizojnë shoqëri mikste shqiptaro-jugosllave me aksione si më poshtë: “Shoqëria për ndërtimin dhe eksplotimin e hekurudhave, Shoqëria për nxjerrjen dhe fabrikimin e naf-tës, Shoqëria për zbulimin e minierave, për eksplotimin dhe

311 Nexhmije Hoxha, Jeta ime me Enver Hoxhën, Tiranë, 1989, f. 195.

përdorimin e metaleve, Shoqëria për elektrifikimin, Shoqëria për lundrimin detar, Shoqëria tregtare për importim dhe eksportim dhe Banka shqiptaro-jugosllave”.<sup>312</sup> Sipas artikullit të dytë të marrëveshjes, parashihej që Jugosllavia të jepte ndihmë teknike për disa degë të industrisë ushqimoree tekstile, kurse në fushën e bujqësisë parashihej të dërgoheshin ekspertë nga Jugosllavia në Shqipëri. Sipas artikullit të katërt të marrëveshjes parashihej që shoqëritë miks të shqiptaro-jugosllave të organizoheshin sipas principit të paritetit, duke u organizuar kështu për një periudhë prej 30 vjetësh.<sup>313</sup> Marrëveshjen, që mban datën 1 korrik 1946, e kishin nënshkruar në Beograd në emër të Republikës së Shqipërisë Nako Spiru, kurse në emër të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë Nikola Petroviç. Më 9 korrik 1946 në Tiranë, me autorizimin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë dhe me autorizimin e Presidiumit të Asamblesë Kombëtare të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë u nënshkrua Traktati i Miqësisë dhe i Ndihmës reciproke në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Në artikullin e dytë të marrëveshjes veçohej: “Të dyja palët kontraktuese do të marrin së bashku të gjitha masat që do të jenë të nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe integritetin e vendeve të tyre, për të ndalur në të ardhmen çdo përsëritje të agresionit të njëllojtë me atë të Gjermanisë hitleriane dhe të Italisë fashiste të Musolinit”.<sup>314</sup> Artikulli i tretë parashihte: “Në qoftë se njëra nga të dy palët e larta kontraktuese ata kohet prej kujt do tjetër fuqie me qëllim që të cenojë pavarësinë e saj, të robërojë ose t’i shkëputë ndonjë pjesë të tokave të saj, pala tjetër lart kontraktuese do t’i japë menjëherë ndihmën ushtarake si dhe çdo ndihmë tjetër, sipas mjeteve që disponon”.<sup>315</sup> Duke analizuar këtë paragraf të

312 AQSH.D. 174/7.

313 Po aty.

314 “Službeni list FNRJ”, br. 60, VII Beograd, 1946.

315 Po aty.

Traktatit shqiptaro-jugosllav del se, pala jugosllave me mjaft dinakëri kishte parapërgatitur terrenin që në rast të ndonjë atakimi të sovranitetit të shtetit shqiptar, jugosllavët ushtarakisht të ndërhyjnë në emër të obligimeve që dilnin nga pika tre e Traktatit të datës 9 korrik 1946, në fakt, për t'u vendosur edhe me forca ushtarake në Shqipëri. Në vitet 1947 dhe 1948, nuk është e çuditshme pse jugosllavët trumbetonin se Greqia po përgatiste sulm ndaj Shqipërisë dhe në lidhje me këtë kërkonin që, pikërisht, në emër të traktatit në fjalë të dërgonin në Korçë dy divizione ushtarake. Në lidhje me qëllimet dhe prapaskenat jugosllave, edhe më e qëllimshme ishte përmbajtja e artikullit numër katër e kësaj marrëveshjeje, në të cilin saktësohej: "Të dy palët kontraktuese detyrohen të mos hyjnë asnjëra prej tyre në ndonjë aleancë, as të bëjnë pjesë në ndonjë koalicion që drejtohet kundër palës tjetër të lart kontraktuese".<sup>316</sup> Me këto formulime pala jugosllave po e izolonte Shqipërinë për bashkëpunim dhe aleanca tjera ndërshtetërore me vendet fqinje, si dhe siguronte në masë të caktuar një mandat të vetin që të kishte kontroll dhe mbikëqyrje ndaj zhvillimeve në Shqipëri. Kjo formë e bashkëpunimit-shqiptaro-jugosllav, Shqipërinë e vinte në pozitë jo të barabartë me Jugosllavinë dhe kësaj të fundit i mundësohej suveraniteti në raportet ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Traktati parashihej të ishte i vlefshëm për njëzet vjet nga data e nënshkrimit të tij. Me këtë traktat: "Ishte mëse e qartë se Jugosllavia po bënte hapa të fortë hegjemonist në Ballkan dhe se kjo po tregohej sheshazi në rastin e Shqipërisë. U bënë përpjekje që të hollat shqiptare, lekët, të shndërroheshin në dinarë. Po ashtu, çmimet për mallrat e ndryshmeqenë të njëjta për të dy shtetet dhe malli u përcaktua në të dy drejtimet njësoj. Planet ekonomike u koordinuan nga një komisioni përbashkët, i cili e përjashtoi pothuajse plotësisht

---

316 Po aty.

ndikimin e qeverisë shqiptare”.<sup>317</sup> Gazeta “Bashkimi” në kryeartikullin e datës 14 korrik 1946, për Traktatin e Miqësisë në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, me eufori konstatonte: “Traktati hap rrugën për prosperitetin tonë, për rindërtimin në të gjitha fushat. Vendi ynë ka nevojë për bashkëpunim me miqtë sinqertë dhe besnikë, si Jugosllavia e marshallit Tito, ka nevojë për miq që nuk kanë qëllime grabitqare dhe shfrytëzimi...Populli shqiptare përshëndeti traktatin me manifestime të jashtëzakonshme. Duke thirrur “Tiranë-Beograd”, ai shikon me plot bindje në këtë traktat faktorin historik të sigurisë për të ardhmen e tij”.<sup>318</sup> Në lidhje me nënshkrimin e traktatit, Enver Hoxha kishte deklaruar: “...Në popujt e Jugosllavisë dhe në personine shquartë kryetarit të qeverisë, marshallit Josip Broz Tito, neve shohim miqtë e afërt dhe të sinqertë, të cilët pa u kursyer kanë ndihmuar popullin tonë që të arrijë fitoren e sotme dhe të cilët në një masë gjithnjë më të madhe na japin këtë ndihmë për mbrojtjen e lirisë, të pavarësisë dhe sovranitetit të vendit tonë, për përparimin e Shqipërisë. Populli ynë si një gjë të shenjtë do ta shikojë miqësinë që popujt Tuaj ushqejnë ndaj nesh, sepse ajo është baza e fortë e përparimit të vendit tonë, e mbrojtjes së paqes në Ballkan dhe në botë, si dhe për forcimin e demokracisë, për të cilën popujt tonë kanë derdhur lumenj gjaku”.<sup>319</sup> Po kështu, Enver Hoxha, duke iu referuar marrëdhënieve ekonomike me Jugosllavinë, në vitin 1946, në kujtimet e tij të vitit 1982, shkruante e sqaronte: “Më pas, veçanërisht, pas vizitës sime në Beograd, në qershor 1946, marrëdhëniet e ekonomike filluan të zhvilloheshin më ‘intensivisht’, por ky zhvillim konsistonte në bisedime, në projekte e në deklarata në kartë, në premtime pa fund, po, hëpërhë, asgjë në trastë”.<sup>320</sup>

317 Bernhrad Tonnes, vep. e cit., f. 437.

318 “Bashkimi”, 14 korrik 1946.

319 Vladimir Dedijer, Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare 1939-1948, Beograd, 1949, f. 154.

320 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 276.

Ndërsa në ekspozenë e ministrit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Stanoje Simić, paraqitur më 20 korrik para deputetëve të Kuvendit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë me rastine ratifikimit të Traktatit e Miqësisë në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, vlerësohej: "... Është prekëse të shohësh në çdo hap atë dashuri dhe respekt, të cilën e ndjejnë masat e gjëra të popullit shqiptar për marshallin Tito dhe Jugosllavinë e re. Atje Jugosllavia ndjehet si ndër mysafirë të afërmitë gjakut".<sup>321</sup> Më 6 gusht 1946, të dyja shtetet e aprovuan Ligjin mbi Traktatin e Miqësisë dhe të Ndhmës reciprokenë mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, lidhur në Tiranë më 9 korrik 1946. Enver Hoxha, dukshëm i entuziazmuar për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror shqiptaro-jugosllav, më 8 gusht 1946, deklaronte: "Trakti i miqësisë dhe ndihmës reciproke me Jugosllavinë e marshallit Tito, asht ma i randesishmi dhe ma i natyrshmi nga të gjitha aktet që qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ndërmerr në fushën ndërkombëtare... Në këto momente solemne ne e ndiejm veten të lumtun dhe ma te fortë se kurr, sepse gjindemi në rrugë të drejtë..., sepse kemi miq të fortë dhe besnikë, sepse në popujt fqij dhe vllazën të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë kemi aleatët më të sinqertë dhe ma të fortë të cilët deri në fund janë solidar me çashtjen tonë të drejtë, siç jemi edhe na deri në fund solidar me të tyne".<sup>322</sup> Traktati (Konventa Ekonomike) në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për koordinimin e planeve, për bashkimin doganor dhe barazimine monedhave, nënshkruar në Beograd më 27 nëntor 1946, shënonte edhe një hap në thellimin e më tutjeshëm dhe të papenguar të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në fushën e ekonomisë dhe në radhë të parë të integritimit të ekonomisë shqiptare në modelin dhe strukturën e ekonomisë jugosllave. Ky traktat shënonte veprim konkret të

321 "Borba", 21.VII 1946.

322 Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 154.

nxitur nga dëshira për të zgjeruar bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke në veprën e rindërtimit të dy vendeve fqinje. Qëllimi kryesor i Traktatit (Konventës Ekonomike) në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për koordinimin e planeve dilte nga artikulli i parë i tij, ku saktësohej: “Të dyja palët e larta kontraktuese angazhohen të koordinojnë planet e të dy vendeve mbi një bazë të përbashkët. Për realizimin e këtij qëllimi do të krijohen organe koordinimi”.<sup>323</sup> Në artikullin e dytë parashihej: “Brenda një afati prej tre muajsh që nga data e nënshkrimit të këtij traktati, qeveria e Republikës të Shqipërisëdo ta bëjë vlerëne njësisë së monedhës së saj të barabartë me atë të dinarit jugosllav... Derisa të bëhet reforma monetare, e parashikuar në paragrafin 1 të artikullit 2 të këtij traktati, qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë do të vendosë në vendin e saj si stemin e çmimeve me çmimet që vlejné në vendin (territorin) e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë”.<sup>324</sup> Ndërsa, në artikullin tre të kontratës, decidivisht parashikohej: “Qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë angazhohen të zhdukin, në një afat prej një muaji nga data e nënshkrimit të këtij traktati, kufirin doganor dhe doganat në mes të dy vendeve, duke krijuar kështu një territor unik”.<sup>325</sup> Traktati, të cilin e kishin nënshkruar në emër të Shqipërisë Nako Spiru, kurse në emër të Jugosllavisë Boris Kidriçi, parashihej të ishte i vlefshëm për tridhjetë vjet nga data e nënshkrimit. Në komunikatën e përbashkët për nënshkrimin e Marrëveshjes (Konventës) Ekonomike në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ndër të tjera, ritheksohej: “... Me këtë konventë (marrëveshje) RFD e Jugosllavisë merr barrënpër t’i ofruar një përkrahje të gjerë dhe një ndihmë të konsiderueshme në fushën e mjeteve të prodhimit dhe të tjera RP të

---

323 Službeni list FNRJ, nr. 106, 31.XII.1946.

324 Po aty.

325 Po aty.

Shqipërisë me qëllim të ngritjes ekonomike të kësaj më të shpejtë dhe më efikase”.<sup>326</sup> I njëjti tekst i komunikatës për shtyp ishte publikuar, në të njëjtën datë, edhe në gazetën “Bashkimi”, në Tiranë. Qeveria jugosllave i kishte kushtuar publicitet të madh nënshkrimit të Traktatit, duke konsideruar se me këtë marrëveshje Jugosllavia ishte edhe një hap më afër në realizimin e qëllimeve politike, ekonomike dhe ushtarake ndaj Shqipërisë, e cila, e izoluar ndërkombëtarisht, po i hidhej në prehër shtetit jugosllav. Blagoje Neshkoviç, kryetar i qeverisë së Serbisë, në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullortë Jugosllavisë, lidhur me ratifikimin e Traktatit në fjalë, kishte theksuar: “... Për ne, serbët, kjo marrëveshje ka domethënie të veçantë... Në këtë marrëveshje ne e shohim veprën e madhe historike, të cilën e kanë synuar që moti popujt tanë dhe e cila është realizuar me luftën e madhe nën udhëheqjen e PKJ, nën udhëheqjen e birit më të dashur të popullit tonë shokut Tito... Kjo marrëveshje nuk është e drejtuar kundër askujt, por mbron vendin tonë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë prej atyre të cilët kanë tendencë imperialiste. Me një fjalë kjo marrëveshje është kontribut i madh për forcimin e paqes në Ballkan dhe në Evropë...”.<sup>327</sup> Ndërsa, Boris Kidriçi, ministëri Industrisë dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të qeverisë jugosllave, në të njëjtën mbledhje kishte deklaruar: “Me këtë marrëveshje, Jugosllavia po merr mbi vete detyrime të mëdha serioze ndaj Shqipërisë”.<sup>328</sup> Milovan Gjilasi, ministër në qeverinë jugosllave, kishte thënë: “Bashkimi doganor ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë në të vërtetë do të thotë forcim i pavarësisë së Shqipërisë, forcim i barazisë së saj me Jugosllavinë dhe me vendet tjera”.<sup>329</sup> Gjilas, atëherë njeriu numër dy i PKJ, kishte paralajmëruar dhe premtuar: “Popujt e Jugosllavisë dhe populli shqiptar nuk duan të jetoj-

326 “Borba”, 11.XII.1946.

327 Dokumenti o spolnoj politici SFRJ, 1946, II, Beograd, 1985, f. 358.

328 Po aty, f. 360

329 Po aty, f. 363.

në me recetën e askujt, e kuptohet, as me recetën britanike, pavarësisht se a e pranojnë qarqet përgjegjëse amerikane dhe britanike pavarësinë dhe qeverinë shqiptare”.<sup>330</sup>

Në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RFJ, për Traktatin shqiptaro-jugosllav të datës 27 nëntor 1946, kryetari i Presidiumit, dr. Ivan Ribar, kishte potencuar: “Kjo marrëveshje është një nga ato dokumente, të cilat shpien kah paqja, përparimi dhe mirëqenia e popullit të Jugosllavisë dhe popullit të Shqipërisë, si dhe të gjithë popujve në Ballkan”.<sup>331</sup>

Me gjithë proklamatat e qeveritarëve jugosllavë, realisht nuk mund të bëhej fjalë për marrëdhënie të barabarta shqiptaro-jugosllave, as në fushën e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare. Fjala ishte për dy sisteme të njëjtë, për ekonomi socialiste të qendrorizuar dhe burokratike, sistem e njëpartiak edhe udhëheqës autoritarë, siç ishin Enver Hoxha dhe Tito. Megjithatë, dallimet në këto marrëdhënie ishin evidente. Kjo qartësohej nga faktet se, Jugosllavia në të gjitha aspektet ishte më superiore se Shqipëria, si në planin e shtrirjes territoriale, numrit të popullatës, planin ekonomik dhe zhvillimor, dhe veçanërisht Jugosllavia imponohej me pozicionin e favorizuar në arenën diplomatike ndërkombëtare. Në lidhje me elementin e fundit, pra të pozitës ndërkombëtare, në rrethanat (gjatë) e Luftës së Ftohtë, Shqipëria ishte në pozitë jashtëzakonisht të pavolitshme dhe për shumë shkaqe ishte e detyruar që ta pranonte ofertën jugosllave për bashkëpunim dhe përkrahje. Pra, një pavarësi e tillë e Shqipërisë ishte në fakt pavarësi e kufizuar, sepse të krijonte marrëdhënie të barabarta me Jugosllavinë ishte një iluzion i madh për udhëheqjen e shtetit shqiptar. Qeveria jugosllave dhe udhëheqja e PKJ duke i ditur të gjitha këto rrethana, si dhe duke hetuar pozicionin e pavolitshëm të Shqipërisë së sapodalë nga lufta, imponoheshin me rolin e padronit, të “shpëtim-

---

330 Po aty.

331 Po aty, f. 364.



tarit", edhe pse në diplomacinë elokumente jugosllave nuk he-toheshin qëllimet hegjemoniste dhe gllabëruese. Ndërkohë, Tito, duke projektuar rolin e Jugosllavisë si fuqi numër një politike, ekonomike e ushtarake në Ballkan, kishte vlerësuar se, së pari duhej të varësonte Shqipërinë në të gjitha fushat dhe pastaj, duke e trajtuara të si një provincë jugosllave, do të forconte pozicionet për t'i futur nën ndikim edhe shtetet e tjera socialiste ballkanike. Ideja e tij për Konfederatën Ballkanike, ndonëse e kontestuar nga Stalini, edhe pas vitit 1945, po mbijetonte në planet jugosllave. Edhe historiografia jugosllave është detyruar të pranojë se: "Në opinionin jugosllav ka ardhur deri te pranimi "parregullive" të caktuara edhe në marrëdhëniet e Jugosllavisë më të madhe kundrejt Shqipërisë më të vogël. Por vetëm për aq sa ishte e mjaftueshme që të bëhet dallimi ndërmjet "megjithatë" eksploatimit të paskrupullt të Jugosllavisë nga ana e BRSS", për dallim të "disa hapave dhe potezave të gabueshëm të Jugosllavisë kundrejt Shqipërisë si shprehje e mungesës së përvojave dhe njohurive".<sup>332</sup> Disa historianë jugosllavë shkruajnë se traktatets hqiptaro-jugosllave të viteve 1946-1947: "Nuk ishin të mbështetura në principin e reciprocitetit dhe nuk kanë paraparë detyrime analoge të Shqipërisë në raport me Jugosllavinë".<sup>333</sup> Gjatë vitit 1946, të dy vendet kishin nënshkruar 21 marrëveshje dhe 6 të tjeranë vitin 1947. Ndërkaq, krijimi i shoqërive shqiptaro-jugosllave nuk mund të kishte tjetër karakter nga ato jugosllavo-sovjetike, të cilat, në literaturën jugosllave janë interpretuar dhe definuar si eksploatim i pakursyer ekonomik i vendeve të dobëta nga vendet e fuqishme të industrializuara. Pra, një krahasim i tillë i marrëdhënieve jugosllavo-sovjetike duhet të vlenë edhe për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave në fushën e bashkëpun-

---

332 Miodrag Marović, Balkanski džoker-Albanija i albanci, Tivar, 1995, f. 447.

333 Dr. Smilja Avramov, Savezi u politici Narodne Socijalističke Republike Albanije, Marksistička misao, Beograd, nr. 3, 1985.

imit ekonomiko-tregtar, gjithnjë në kontekst të shoqërivetë përziera shqiptaro-jugosllave. Milentije Popović, njëri nga teorikët shtetërorë jugosllavë dhe udhëheqës i lartë partiak, kishte konstatuar: “Në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë pa dyshim se ka pasur edhe aso formash dhe dukurish, të cilat nuk ishin socialiste, veçmas në fillim, siç ishte fjala me shoqëritë e përziera (shqiptaro-jugosllave A.Z.). Kjo ishte e kuptueshme kur dihet se ishte fjala për kalimin nga një gjendjen gjendje tjetër kualitative... Është me interes teorik që të bëhet kritikë e atyre marrëdhënieve”.<sup>334</sup> Gjithsesi: “Politika e unifikimit në sferën e ekonomisë dy sistemeve dhe rregullimeve shoqërore, në të vërtetë nënkuptonte për shpejtimin jugosllav në krijimin e federatës, me bindjen se për këtë ka ardhur koha dhe janë pjekur kushtet... Unioni doganor me Shqipërinë u arrit në kohën kur Jugosllavia përgatitej të kalonte në ekonominë e dirigjuar planifikuese, si dhe, në anën tjetër, realizohej, pas takimit të Enver-Hoxhës dhe Titos në Beograd, si dhe sinjalit të Molotovit dhënë Hoxhës në Paris, që Shqipëria të mbështetet në Jugosllavinë në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe politik”.<sup>115</sup> Bashkëpunimin ndërshtetëror midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, përvitet 1945-1946, dhe realizimin e objektivave në këtë fushë e përcillte me kujdes PKSH, e cila në lidhje me këtë çështje kishte debatuar në një Plenum të veçantë të KQ të PKSH, i mbajtur nga 18 deri më 20 dhjetor 1946. Në rend dite ishte shtruar rëndësia politike dhe ekonomike e Konventës në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Me këtë plenum partiak synohej që të jepej një vlerësim për të arriturat në lëmin e bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në fushën e marrëdhënieve ekonomike dhe të nxitej shtytje e re thellimit dhe përparimit të këtyre marrëdhënieve ndërshtetërore, që në PKSH shiheshin me interes të jashtëzakonshëm për zhvilli-

---

334 Milentije Popović, O ekonomskim odnosima izmedju socijalističkih zemalja, Komunist, Beograd, 3, 1949.

min e vendit. Vetë faktise çështjen e thellimit të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në fushën e ekonomisë e trajtonte me aq interes PKSH, tregonte se bashkëpunimi politik midis dy vendeve duhej të realizohej mbi bazat e bashkëpunimit sa më të përafërtekonomik. Ndërkaq, lihej anash faktise, në rrethanat e tilla të pasluftës nuk mund të kishte bashkëpunim mbi bazat e barabarësisë dhetë interesavetë njëjta. Në referatin e tij paraqitur në Plenumin e KQ të PKSH, më 18 dhjetor, ishte sqaruar: “Nënshkrimi i këtij akordi tregoi se vendi ynë hyn në një fazë të re historike. Kjo për Partinë tonë nuk është një gjë e papritur. Këtë Partia e jonë e dinte. Udhëheqja e Partisë duhet të jetë e qartë për këtë rol, si nga ana politike dhe ekonomike, për ta zbatuar mirë këtë akord”.<sup>335</sup> Por, në vijim, Enver Hoxha, i nxitur nga floskulat dhe ndikimet ideologjike, në frymën e bashkëpunimit internacionalist me jugosllavët, kishte apostrofuar “segmente” të caktuara të çështjeve që i takonin fushës politike: “...Gjatë zhvillimit të marrëdhënieve në mes Partisë sonë dhe asaj jugosllave këto u bën marrëdhënie midis partish motra. Si Jugosllavia, si ne, kishim si dritë BS, d.m.th. të dy partitë e orientuan dhe nuk gabuan vijën e tyre drejt BS... Pra, në Jugosllavie në Shqipëriparti të komuniste erdhën në fuqi dhe në mes të këtyre dy popujve lindi një bashkim jo vetëm ideologjik, një bashkim që u mbrojt me gjakun e popujve tanë”.<sup>336</sup> Sekretari i përgjithshëm i KQ të PKSH kishte sqaruar: “Akordi përmbledh në princip koordinimin e planeve tona ekonomike, heqjen e taksave doganore dhe kufijve doganorë, parifikimin e monedhës sonë me monedhën jugosllave. Këto janë të lidhura ngushtë, në mënyrë që ekonomia jonë të shkojë paralelisht me pushtetin tonë politik”.<sup>337</sup> Në referatin e tij, Enver Hoxha, duke analizuar keqtrajtimet që mund t’i bëheshin Traktatit të

---

335 AQSH, F. 14/ AP, dos. 4, v. 1946.

336 Po aty.

337 Po aty.

Miqësisë dhe Bashkëpunimit Ekonomik midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, kishte apostrofuar edhe çështjene Kosovës: “Disa anëtarë të Partisë sonë pyesin se mos kërkojë populli ç’bëhet me Kosovën. Nërast se një anëtar partie e ka të qartë vijën, ai e ka të qartë dhe çështjen e Kosovës. Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me një Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan”.<sup>338</sup> Ai më tej kishte pyetur: “A është në interesin tonë të kërkojmë Kosovën”?<sup>339</sup> Dhe ishte përgjigjur shkurt e qartë: “Kjo nuk është progresiste. Pra, në këtë situatë, duhet të bëjmë ç’është e mundur që kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët”.<sup>340</sup> Në temën e Kosovës, Enver Hoxha vlerësonte: “Kur ne të arrijmë në socializëm... ahere në njësituatë të tillë Kosova do të bashkohet me Republikën Socialiste të Shqipërisë”.<sup>341</sup> Pastaj, Enver Hoxha paralajmëronte veprime: “Kjo është vija, këtë na e mëson marksizmi. Ne këtë do ta shpjegojmë. Ata që nuk e kuptojnë këtë, ne e kemi për detyrë t’i luftojmë”.<sup>342</sup> Dhe, ndonëse dihej se çfarë ishte gjendja e popullit shqiptarë shtypur në Kosovë dhenë viset tjera shqiptare të Jugosllavisë, Enver-Hoxha pa ndonjë brengosje deklaronte pa asnjë argument: “Populli i Kosovës i ka të gjitha liritë. Ai ka marrë tokën. Ai ka shkolla. Ne jemi miqtë më të mirë (me jugosllavët)”.<sup>343</sup>

Nako Spiru, në vitin 1946 dhe deri në vetëvrasje, ministëri Ekonomisë dhe kryetar i Komisionit të Planit, i cili qëndroi disa muaj në Beograd në vitin 1946 për përgatitjen e akteve të bashkëpunimit ekonomik midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në fjalinë e parë të raportit të tij në Plenumin e Jashtëzakonshëm të KQ të PKSH, kishte konfirmuar: “Më 27 u afirmua

---

338 Po aty.

339 Po aty.

340 Po aty.

341 Po aty.

342 Po aty.

343 Po aty.

akordi për koordinimin e planit, parafikimin e monedhës dhe zhdukje në kufijve”.<sup>344</sup> Pasi konstatonte se Jugosllavia “... merr përsipër të na ndihmojë me fabrika, me mallra tregu, ashtu bën edhe me krahinat e saj...sepsene kemi një bashkim ekonomik”<sup>345</sup>. Ai, duke folur për planin e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë, kishte paralajmëruar: “Ne mendojmë për hartimin e planit bashkë me Jugosllavinë”<sup>346</sup>. Diskutimet në plenum shprehnin qartë pozitën inferiore të palës shqiptare në raport me marrëdhëniet ekonomike dhe politike me palën jugosllave. Kështu, udhëheqja shqiptare, e ballafaquar me kushtet e rënda ekonomike, preokupimin kryesorë kishte sigurimin e bukës për shtetasit e vet. Ndaj, nuk ishin të papritura cilësimet dhe vlerësimet gjatë plenumit, siç theksoi në diskutimin e tij Niko Opari: “Unë mund të them se gjendja jonë ekonomike ka bërë që populli të preokupohet për bukën. Kur nga akordi vjen buka, kjo i pëlqen atij, është i inkurajuar dhe thotë: tani i siguroam punët, rroftë Jugosllavia”.<sup>347</sup> Kishte pasur mendime, ndërkaq se, siç shprehej Spiro Pano: “Kjo mund të shkaktojë që, duke menduar se çdo gjë do të vijë nga Jugosllavia, ne vetë të mos punojmë...”.<sup>348</sup> Enver Hoxha kishte bërë thirrje: “Ne të dimë ta popularizojmë mirë Jugosllavinë, shtypi duhet të flasë për të dhe për këtë akord”.<sup>349</sup>

Udhëheqja e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 29 dhjetor 1946, në opinion doli me rezolutë të veçantë të Plenumit të Jashtëzakonshëm të KQ të PKSH, ku konstatohej: “Me nënshkrimin e kësaj konvente, vendi ynë hyn në një fazë të re historike... Konventa Ekonomike me Jugosllavinë është pasoja logjike e Traktatit të Aleancës dhe Ndhmës Reciproke, është

---

344 Po aty.

345 Po aty.

346 Po aty.

347 Po aty.

348 Po aty.

349 Po aty.

njehap që forcon marrëdhëniet vëllazërore midis dy popujve... Konventa Ekonomike plotëson ndihmën e madhe që popujt e Jugosllavisë i japin popullit shqiptar për ta forcuar pushtetin tij, për ta siguruar të ardhmen e tij dhe për të qenë një forcë përparimtare në Ballkan".<sup>350</sup> Nga rezoluta dilnin edhe detyra konkrete për PKSH, që ishte forca e vetme politike në Shqipëri: "Partia duhet të kuptojë rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë me Jugosllavinë, rëndësinë e zbatimit të këtij akordi dhe të kuptojë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej tij, roline organizimit dhe të drejtimit, rolin e lidhjes me masat".<sup>351</sup> Byroja politike e KQ të PKSH, çështjen e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit ekonomik me Jugosllavinë e shtroi edhe në mbledhjen e 29 majit 1947, për të precizuar aspekte të caktuara në operacionalizimin e realizimit të marrëveshjeve ekonomiko-tregtare. Në mbledhje ishte vendosur që në Beograd të shkonin Nako Spiru dhe Gogo Nushi. Si rezultat i bisedimeve dhe i harmonizimit të qëndrimeve në Beograd midis përfaqësuesve të qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave, më 12 qershor 1947, ishte arritur marrëveshja për kredinë prej 2 miliardë dinarësh caktuar nga Jugosllavia për Shqipërinë. Marrëveshja synonte ngritjen e ekonomisë shqiptare. Në nenin tre precizohej: "Shuma e kredisë së sipërpërmendur do të paguhet në sende tregtie, material dhe shkëmbime të nevojshme për investimet dhe punimet që kanë të bëjnë me përtëritjen dhe rimëkëmbjen ekonomike të Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe në sende tregtie të konsumit të madh".<sup>352</sup> Marrëveshjen e kishin nënshkruar në emër të Republikës Popullore të Shqipërisë Nako Spiru, kurse në emër të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë Boris Kidriç. Në frymën e zbatimit të traktateve të nënshkruara, në vitet 1945-1946, ishte paraparë

---

350 Po aty.

351 Po aty.

352 Bashkimi", 17 korrik 1947.

që në buxhetin e vitit 1947, Shqipërisë t'i akordohej një kredi prej 2 miliardë dinarësh jugosllavë, me qëllim të ngritjes së ekonomisë dhe industrisë së shtetit shqiptar. Kjo kredi, Shqipërisë iu akordua më 12 qershor 1947, "... kurse nuk asht parapa aspak se kurdhe nën ç'kondita kjo kredi do të kthehet, por asht lënë që kjo të përcaktohet ma vonë. Kjo kredi, e cila ka pasë për t'u paguar me mallra, material dhe nevoja për investime në punë te nevojshme në lidhje me rindërtimin e vendit, si edhe në mallra të konsumit të gjanë, ka shërbyesi bazë për përpilimin dhe vendosjen e planit ekonomik shqiptar për 9 muaj të vitit 1947, dhe për buxhetin shtetëror të Shqipërisë, në të cilin ajo ka përfaqësuar 56% të të gjitha të ardhurave buxhetore".<sup>353</sup> Në mbledhjen e Kuvendit Popullor të RP të Shqipërisë, të mbajtur më 17 korrik 1947, ndihmës ministri i Financave, Abdyl Këllezi, ndër të tjera, kishte vlerësuar lart këtë vendim të qeverisë jugosllave për dhënien e kredisë: "... Popujt vllazën të Jugosllavisë na ndihmojnë sot pa kurrfar interesi, me të vetmin qëllim që të ngritet ekonomia jonë, që t'i sigurohet popullit tonë një jetë ma e mirë, sepse rruga e popujve tonë asht rruga e lavdishme drejt socializmit... 2 miliardë lekë don me thanë mall për 2 miliard, i cili ka fillue qysh tashti të arrijë në vendin tonë. Këtu nuk asht fjala për ndihmë abstrakte, por për ndihmë reale dhe serioze. Nuk bahet fjalë vetëm mbi artikujt, të cilët janë të domosdoshëm për plotësimin e nevojave të popullit tonë, por edhe mbi landët e para për industrinë, minierat, artizanatet dhe qendroret. Këta 2 miliard lekë përfaqësojnë një ndihmë te madhe për buxhetin tonë".<sup>354</sup> Një ndër njohësit e mirë të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, Vladimir Dedijer shkruante: "Disa përgjegjës shtetërorë shqiptarë kanë tentuar që të fshehin para popullit shqiptar faktin mbi dhënien e kredisë prej 2 miliardë dinarësh nga ana e RFPJ. Në mbled-

353 Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 108.

354 Po aty.

hjene Komisionit Koordinues përfaqësuesi shqiptar, Kiço Ngjela, ka kërkuar në emër të qeverisë shqiptare që në buxhetine vitit 1947të mos shënoheshintë ardhurat prej 2 miliardë dinarësh si ndihmëe RFPJ, por të paraqiteshin si të ardhura të shtetit shqiptar, duke mos vënë burimin e tyre. Ud-hëheqësit shqiptarë, fshehjen e ndihmës nga RFPJ, e arsyetonin me faktin se nuk do të ishte mirë që para botës se jashtme të tregohej sa i madh ishte angazhimi i RFPJ në RP të Shqipërisë, si dhe nuk do të ishte e urtë që t'i tregohej popullit shqiptar se pjesa më e madhe e buxhetit përbëhej nga ndihma jugosllave".<sup>355</sup> Sipas historiografisë jugosllave mendohet se këtë pikëpamje e ka përfaqësuar dhe e ka mbrojtur veçmas Naku Spiro dhe se vetëm me intervenimin e diplomacisë jugosllave, pala shqiptare ka pranuar që ndihma prej 2 miliard dinarësh jugosllavë e akorduar Shqipërisë të bëhej publike. Në lidhje me kredinë prej 2 miliardë dinarësh akorduar Shqipërisë, Enver Hoxha, në kujtimet e tij shkruante: "Na akorduan një kredit prej 2 miliardë dinarësh, por ç'realizuan nga ky kredit i shumë reklamuar prej tyre? Thuajse asgjë të saktë. Në bazë të këtij krediti, veç disa mallrave për konsum, do të na jepeshin e na u dhanë edhe 3-4 "fabrika", një për sapunin, një për prodhim litari, një fabrikë sheqeri e më duket se edhe një mulli bloje. Çfarë ishin këto dhe sa kushtonin? Çmimet i caktuan "ekspertët" jugosllavë".<sup>356</sup> Në këtë frymë vlerësonin kredinë jugosllave për shtetin shqiptar edhe dokumentet e PPSH: "Për zbatimin e marrëveshjes ekonomike, qeveria jugosllave kishte premtuar se, për vitin 1947, do t'i jepte Shqipërisë një kredi prej 2 miliardë lekësh. Kredia u plotësua më pak se 50%. Edhe ato mallra të dhëna me kredi nga Jugosllavia ishin llogaritur me çmime dy deri katërfish më të larta nga çmimet ndërkombëtare. E gjithë e ashtuquajtura ndihmë jugosllave përmblidhej në katër fabrika të vogla, krejt të

---

355 Po aty.

356 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 295.



vjetërsuara e të amortizuara prej kohësh. Dhe veç kësaj, kredia u përdor si mjet për të bërë presion mbi partinë e qeverinë dhe për të ngjallur mosbesim tek ato, gjoja si të paafta për ta drejtuar zhvillimin me plan të ekonomisë. Kjo e vështirësoi shumë plotësimin e planit për vitin 1947, i cili ishte hartuar duke u mbështetur edhe në ndihmën jugosllave. Qeveria jugosllave nuk i dha Shqipërisë as kredinë e premtuar për vitin 1948".<sup>357</sup> Burimet historiketë proveniencës jugosllave dëshmojnë se: "...kredinë prej 2 miliardësh, qeveria e RP të Shqipërisë e ka shfrytëzuar vetëm 1,600.000 dinarë, për arsye se të gjitha nevojatë saj në material për investime dhe konsumine gjerë me qëllim të kryerjes së planit për vitin 1947 nuk kanë qenë më të mëdha, sipas kërkesës që qeveria shqiptare ka paraqitur në prillin e vitit 1947 qeverisë së RFPJ... Gjatë vitit 1947 dhe në fillim të vitit 1948, kredia prej 2 miliardë dinarësh është shfrytëzuar 1.432,968.000 me dërgesa në mall Shqipërisë, përveç një shume minimale që iu është paguar dikastereve dhe ndërmarrjeve jugosllave për shërbimet e tyre ndaj Shqipërisë. Deri më 31 dhjetor 1947, kredia është shfrytëzuar me 1.356,811.698,48 ose 83%, gjë që do të thotë se, në fund të vitit 1947, ka arritur ose ka qenë në rrugë për Shqipëri mall me këtë vlerë".<sup>358</sup> Kredia jugosllave kishte mundësuar barazimine të dalave dhe të ardhurave në buxhetin shtetëror të shtetit shqiptar për vitin 1947. Kjo ndihmë ishte shprehur më së shumti në përparimin dhe ngritjen e industrisë shqiptare. "Përveç dërgimit të instalacioneve për fabrikat, ndihma e Jugosllavisë ka konsistuar edhe në përpilimin e projekteve dhe të planeve, si dhe në drejtimin e kuadrove speciale për montim dhe vënien në lëvizjetë këtyre fabrikave dhe në drejtimin teknik në punën e tyre".<sup>359</sup> Literatura jugosllave përmend disa fabrika, të cilat janë ndërtuar me ndihmën e kredisë prej 2 miliardë dinarësh, siç

---

357 Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1968, f. 242.

358 Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 182.

359 Po aty, f. 183.

janë: fabrika e sheqerit, fabrika e marmelatës, fabrika e sardeleve etj. Pastaj përmendet montimi i shtypshkronjës së re në Tiranë nga pala jugosllave, montimi i Qendrorit automatik të telefonisë në Tiranë dhe ndërtimi i hekurudhës Durrës-Peqin, e gjatë 43 kilometra. Ndihma jugosllave ka konsistuar edhe në angazhimin për realizimin e planit në fushën e bujqësisë, furnizimit me drithë, sheqer, marmelatë, peshk të konservuar. “Përveç kredisë prej 2 miliardë dinarësh, marrëdhëniet ekonomike në mes RFPJ dhe RP të Shqipërisë, në vitin 1947, janë bazuar dhe në shkëmbimin e mallit sipas marrëveshjes tregtare. Edhe në këtë trakt është shprehur, si dhe në të gjitha traktet ekonomike në mes të dy vendeve, qëllimi dhe dëshira e Jugosllavisë se re që të ndihmojë zhvillimin më të shpejtë të RP të Shqipërisë dhe ngritjen e standardit jetësor të masave shqiptare. Sipas këtij traktati, është dashur që RFPJ të dërgojë mall për 327 milion, kurse Shqipëria për 186... Obligimet e saj Shqipëria i ka plotësuar dobët”.<sup>360</sup> Mirëpo, në mungesë të aparatit të vet për tregti të jashtme, Shqipëria është detyruar që mallrat e saj t’i shesë përmes ndërmarrjeve eksportuese jugosllave, të cilat, sipas direktivave të Ministrisë së Tregtisë së Shqipërisë, kanë kryer shitjen e prodhimeve shqiptare jashtë vendit dhe të gjitha vlerat e realizuara në devizat e huaja ia kanë lënë Shqipërisë në dispozicion”. Në këtë periudhë, me marrëveshje ekonomiko-tregtare midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishte bërë unifikimi i çmimeve për prodhimin e industrisë dhe të minierave, si dhe ish-in caktuar edhe çmimet unike për grumbullimin e prodhimeve bujqësore. Enver Hoxha, në ekspozenë e tij lidhur me propozimin e planit për vitin 1948, para deputetëve të Kuvendit Popullor kishte komunikuar: “Ka hyrë në fuqi struktura e re e çmimeve dhe është aplikuar sistemi i çmimeve unike, i cili përfaqëson një bazë të rëndësishme për rregullimin e jetës së popullit tonë”.<sup>361</sup> Historiografia jugosllave, në bazë të vlerësime-

---

360 Po aty.

361 Po aty, f. 203.

ve politike të kohës, kishte konkluduar se Nako Spiru ishte personi kyç i politikës shqiptare, i cili: "...nuk ka pas kuptim për këto sakrificat dhe nuk kanë treguar vullnet që tu ndihmojnë popujve të Jugosllavisë dhe të ju lehtësoj në luftën... Flamurtari kësaj vije, e cila nga njëra anë ka shkuar në shtyrjen e zbatimit të këtyre masave dhe nga ana tjetër ka dashur që kjo shtyrje të justifikohet gjoja me mosdërgesat e mallit nga ana e RFPJ, ka qenë Nako Spiru, i cili e bëri për vete edhe Enver Hoxhën".<sup>362</sup> Madje, nga pala jugosllave vlerësohej se: "...qeveria e RP të Shqipërisë, me anë të Nako Spiros, me rastin e hartimit të projektplanit pesë vjeçar, nuk ka bërë llogari mbi traktatin e akordimit të planeve ekonomike, por ka parashtruar principin e autarkisë, i cili objektivisht ka dashur të thotë frenimin e zhvillimit të shpejtë të ekonomisë shqiptare".<sup>363</sup>

Në fillim të vitit 1947, KQ i PKSH, i entuziazmuar në vitet e para të pasluftës për marrëdhëniet me Jugosllavinë, u kishte dhënë direktivë organeve shtetërore që të fillonin hartimin e një plani dyvjeçar (1948-1949) për zhvillimin ekonomik. Udhëheqja e PKJ, e cila vazhdimisht i fshihte qëllimet e vërteta gllabëruese ndaj Shqipërisë, kishte këmbëngulur që edhe Shqipëria të hartonte një plan perspektiv pesëvjeçar ekonomik. Dhe jovetëm kaq, por ajo i rekomandoi qeverisë së RPSH edhe orientimin për këtë plan, duke e parë Shqipërinë si një republikë jugosllave. Sipas këtij orientimi, ekonomia e RPSH nuk duhej të zhvillohej në mënyrë të pavarur, por të shkrihej në ekonominë e Jugosllavisë. Shqipëria nuk duhej të krijonte e të zhvillonte industrinë e vet kombëtare, por të mjaftohej vetëm me prodhimin e lëndëve të para bujqësore e minerale, të cilat do të përpunoheshin në Jugosllavi. Në shkëmbim të tyre, Shqipëria do të merrte nga Jugosllavia mallrat e nevojshme industriale. Plani dhe strategjia jugosllave për bashkëpunimin ekonomik me Shq-

---

362 Po aty

363 Po aty, f. 206.

ipërinë synonte nënshtrimin dhe shfrytëzimin e plotë të pa-surive natyrore dhe të ekonomisë shqiptare përgjithësisht. Por, edhe më tepër. Pala jugosllave kishte për qëllim që me këto kushte të bashkëpunimit të pabarabartë dhe me dilemë ta vinte Shqipërinë në pozitë vasale ekonomike nga Jugosllavia, duke e detyruar që t'ia jepte lëndën e parë sipas kriterëve jugosllave. Përkundër kësaj, publicisti jugosllav, Boris Ziherl, në mbledhjen e datës 9 korrik 1947, me rastin e akademisë solemne për njëvjetorin e Traktatit të Miqësisë dhe të Ndhimës Reciproke në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, sqaronte: “Bashkëpunimi ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë nuk di për kërcënime, presione dhe korruptime, ai është i bazuar në pranimin dhe respektimin e plotë të shteteve sovraane, të drejtate të dy vendeve, ai nuk është “bashkëpunim” imperialist, i cili nisët në të drejtëne më të fortit, që në të vërtetëi ndan popujt...”<sup>364</sup> Për kredinë jugosllave prej 2 miliardë dinarësh, që Jugosllavia ia kishte dhënë Shqipërisë, ka shkruar edhe Panajot Plaku, ish udhëheqësi lartë shqiptar, i ikur në Jugosllavi: “...Në vitin 1947, me propozim të Boris Kidriçit, Kuvendi Popullor i Jugosllavisë i dha RP të Shqipërisë kredinë një lartësi prej dy miliardë dinarësh pa kamatë dhe pa afat të caktuar të kthimit. Sipas fjalëve të Kidriçit, kjo kredi me kushte aq të volitshme iu dha Shqipërisë edhe me qëllim që të kompensohen humbjet e saj, të cilat si vend më pak i zhvilluar do të mund t'i kishte në marrëdhëniet ekonomike me Jugosllavinë si vend më të zhvilluar. Këtë propozim dhe arsyetim e aprovoi unanimisht Kuvendi Popullor i Jugosllavisë, megjithëse marrëdhëniet ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë nu kishin të tipit të vjetër për nga forma, përmbajtja dhe esenca, sepse shkëmbimi reciprok i mallrave nuk bëhej në bazë të “çmimeve botërore”, por në bazë të shpenzimeve reale të prodhimit”<sup>365</sup> Nënshkrimi i

364 Tanjug, buletini “Lajmet nga vendi”, 10.VII.1947.

365 Panajot Plaku, vep. e cit., f. 68.

traktateve shqiptaro-jugosllave për bashkëpunim ekonomik dhe ndihmë reciproke ndërshtetërore kishte qenë temë analizash dhe debatesh edhe në qarqet e diplomacisë ndërkombëtare dhe të shtypit perëndimor. Veçmas, këto diskutime ishin ngritur pas vizitës që Enver Hoxha i bëri Jugosllavisë. Shtypi dhe qarqet e caktuara diplomatike ndërkombëtar edhe ato perëndimore komentonin për nënshkrimin e një plani të fshehtë midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ndonëse edhe sot e asaj dite nuk ka dokument arkivor që dëshmon për një marrëveshje të fshehtë midis Enver Hoxhës dhe Titos. Në bisedimet midis Enver Hoxhës dhe Titos kishte marrë pjesë vetëm Josip Gjergja, i cili shumë vite më vonë, në lidhje me takimin, kishte shënuar: "... Në ditën e parë të qëndrimit të delegacionit në Beogradu zhvillua takimi Tito-Hoxha, në të cilin kam marrë pjesë vetëm unë, si përfaqësues në Tiranë dhe si përkthyes. Pjesa e parë e bisedës kishte të bënte me përmbylljen e marrëveshjes për mbrojtjen. Tito i dha Hoxhës tekstin e projektit, për të cilin Hoxha ishte shumë i gëzuar, sepse projekti kishte paraparë aksionin e përbashkët mbrojtës në rast të sulmit ndaj pavarësisë, integritetit dhe sigurisë së Shqipërisë nga cilado anë, gjë që në atë kohë për Shqipërinë ishte me rëndësi të veçantë, për shkak të gjendjes në kufijtë e saj. Enver Hoxha tha se në Shqipëri ishin plotësisht të vetëdijshëm se federata ndërmjet dy vendeve tona, përkatësisht hyrja e Shqipërisë në federatën jugosllave ishte çështje natyrore dhe çështje e ardhmërisë së drejtpërdrejtë, sepse këtë e kërkonte interesi i dyanshëm i tanishëm dhe ai i ardhshëm. Në këtë drejtim, lëvizja do të ishte shumë më e qartë sikur të ishin në gjendje të kishin një pamje më të qartë për atë sesi do të ishte fati i shqiptarëve të Kosovës në atë federatë, përkatësisht pozita e tyre.

Tito, lidhur me këtë, tha se Federata Jugosllave është e ndërtuar mbi bazat e parimeve të caktuara, meqë parimi etnik në masë më të mundshme është i respektuar. Në këtë

kontekst, ai shprehu bindjen se për vetë pozitën e shqiptarëve të Kosovës, duhet shqyrtuar dhe rregulluar në frymën e parimit të tillë dhe të rrethanave tjera ekonomike dhe historike. Enver Hoxha shprehu pajtimin dhe kënaqësinë e plotë me mendimine shokut Tito”.<sup>366</sup> Shtypi perëndimor, veçmas ai italian, i cili me hyrjen eventuale të Shqipërisë në Federatën Jugosllave shihte rrezikimin e interesave të saj në Shqipëri, komentonte se po pritej bashkimi i dy shteteve socialiste, gjë që menjëherë do të sillte likuidimin politik të pavarësisë së Shqipërisë, dhe se gjatë takimit Tito kinse i kishte premtuar Enver Hoxhës ndihmë materiale në luftën kundër organizatave aktive antikomuniste në Shqipërinë Veriore. Shtypi italian, në parashikimet për efektet e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, parashihte se Jugosllavia me këto marrëveshje dhe traktate së shpejti do ta gëlltiste Shqipërinë. Diplomacia britanike, komentonte se nënshkrimi i Traktatit në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë për koordinimin e planeve, për bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave, paraqet hapin e parë konkret në krijimin “Federatës Ballkanike të shteteve sllave”, të përbërë nga Jugosllavia, Bullgaria dhe Shqipëria. Shtypi britanik shkruante se rëndësia strategjike e Shqipërisë ishte e vogël, kur kjo e fundit ishte nën sundimin italian, mirëpo në rrethanat e reja të pas Luftës së Dytë Botërore edhe të fillimit të Luftës së Ftohtë, rëndësia gjeostrategjike e Shqipërisë është shumë më e madhe, sepse Jugosllavia ka hyrë në sferën e interesit të Moskës dhe me këtë është hapur rruga për në Mesdhe.

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në periudhën e viteve 1945-1948, kishin përfshirë edhe fushën e kulturës, arsimit dhe shkencës dhe, në këtë kuptim, ato po e përcillnin shkallën e intensitetit të marrëdhënieve diplomatike dhe veçmas të atyre ekonomike midis dy shteteve. Interesi jugosllav ishte i qartë dhe reflektohej në pretendimin që edhe në fushën e

<sup>366</sup> Dokumenti 22 sednice CK SKJ, Beograd, 1981.

kulturës, arsimit dhe përgjithësisht të arteve të zhvillonte një ndikim sa më të gjerë në Shqipërinë e pasluftës. Ky synim realizohej edhe nën atmosferën e euforisë së bashkëpunimit sa më të gjerë, por të pakontrolluar dhe, gjithsesi, të pabarabartë midis dy vendeve fqinje, të cilat tani i lidhte në radhë të parë ideologjia, por edhe sistemet politike, shoqërore dhe ekonomike. Udhëheqja e PKSH, duke qenë krejtësisht transparente në marrëdhëniet me Jugosllavinë edhe në fushën e bashkëpunimit kulturor dhe arsimor, dëshmonte interesim të njëanshëm, që nënkuptonte “importimin” e vlerave kulturor edhe arsimore jugosllave. Prandaj, ky bashkëpunim edhe në këtë sferë, qysh nga ditët e para, ishte i pabarabartë dhe zhvillohej nën ndikimin e jugosllavëve. Euforia e këtyre marrëdhënieve dhe e këtij bashkëpunimi, përkatësisht e ndërhyrjes jugosllave edhe me “kulturën” e popujve sllavë, kishte arritur deri aty sa, në fillim të vitit 1946, në disa shkolla shqipe në qytetet të Shqipërisë, gjuha serbokroate të mësohej si lëndë e obliguar. Kjo ndodhi në kohën kur, politika e PKSH, e ndikuar nga antiperëndimizmi, kishte arritur që lëndët e gjuhëve perëndimore t’i hiqte nga përmbajtjet e programeve në të gjitha nivelet e shkollës shqipe, me motivacion se ato janë gjuhë të “shteteve armiqësore, imperialiste”. Një veprimtari të rëndësishme në sferën e integritimeve kulturore dhe arsimore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në periudhën e viteve 1945-1948, e kishin zhvilluar pikërisht dy shoqatat mikse: “Shoqëria Shqipëri-Jugosllavi” në Tiranë, dhe “Shoqëria Jugosllavi-Shqipëri” në Beograd. Këto shoqëri, që sipas statusit të tyre kishin mision të ndërlidhjes kulturore dhe arsimore midis dy shteteve, edhe pse të karakterit formal, kishin arritur që të nxisnin bashkëpunim intensiv, por gjithnjë të pabarabartë në këtë sferë. Shoqatat e sipërpërmendura, gjithnjë në frymën e vendimeve të dy partive komuniste të dy vendeve fqinje, synonin dhe kishin për detyrë që të intensifikonin bashkëpunimin dhe afrimin midis dy popu-

jve në frymën e sistemeve të njëjta politike, të ideologjive komuniste dhe të rrugës së përbashkët të ndërtimit të socializmit. Në këtë kuptim, me qëndrime, projekte dhe plane konkrete imponohej Shoqata “Jugosllavi-Shqipëri”, e cila drejtohej nga politikanë dhe intelektualë eminentë jugosllavë. Çdo gjë në këtë plan, pra edhe në eliminimin e objektivave që dilnin nga planet dhe orientimet e të dy shoqatave mikse, ishte në frymën e bashkëpunimit ndërshtetëror dhe ndër partiak midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, duke e veçuar pretendimin e hapur jugosllav që të ndërhynte në zhvillimet në Shqipëri edhe në fushën e kulturës, arsimit dhe përgjithësisht jetës intelektuale e artistike. Në mars të vitit 1948, aktiviteti i Shoqatës “Shqipëri-Jugosllavi” ishte intensifikuar, pasi Hysni Kapo kishte emëruar Ramadan Çitakun në detyrën e kryetarit të shoqatës. Një nga mësuesit e atëherëshëm jugosllav, Drago Koshmarlj, duke evokuar kujtimet e veta për qëndrimin e tij me detyrë mësuesi të gjuhës serbo-kroate në Shqipëri në fund të vitit 1945, shpaloste detyrat që dilnin nga kumtesa e KQ të PK të Sllovenisë, ku tekstualisht thuhej: “Duhesh të udhëtosh për në Shqipëri. Qeveria e atjeshme na ka lutur t’i dërgojmë disa profesorë, të cilët do të ligjërojnë gjuhën serbo-kroate në shkollat e tyre të mesme. Secila republikë do të dërgojë disa profesorë. Sllovenia duhet t’i dërgojë tre dhe ndërta të kemi zgjedhur edhe ty... Në të vërtetë, në disa gjimnaze në Shqipëri, ku kishin mbetur profesorë të gjuhës italiane, të cilëti kishte dërguar Italia fashiste, kishin filluar të bojkotonin lëndën e gjuhës italiane dhe që gjithnjë e më e këmbëngulje të kërkonin që në vend të asaj gjuhe, të mësonin gjuhën serbokroate”.<sup>367</sup> Të gjashtë profesorët e parë jugosllavë që kishin arritur në fund të vitit 1945 në Tiranë, fillimisht i kishte pranuar në takim përfaqësuesi diplomatik jugosllav në Shqipëri, Josip Gjergja, e më pas edhe udhëheqësit më të lartë në Ministrinë e Arsimit shqip-

<sup>367</sup> Drago Koshmarlj, “Najteže albanske godine”, “Duga” nr. 52, 20 mars 1982.



tar, duke i njoftuar me planin për sistemimin e tyre nëpër shkollat, në të cilat parashihej të ligjëronin lëndën e gjuhës serbo-kroate. "Vërtet isha shumë kënaqur, sepse të gjithë nxënësit ishin shumë të vullnetshëm të mësonin gjuhën... Unë bëja çdo gjë që t'u mësoja sa më mirë gjuhën serbokroate, si dhe që lënda të ishte sa më tërheqës edhe interesante... Gjithashtu, në të gjitha raportet ndaj meje shihej dhe ndjehejse njerëzite thjeshtë nga jugu i Shqipërisë e çmonin Jugosllavinë".<sup>368</sup> Sistemi arsimori Shqipërisë së pasluftës ishte reformuar me ligjin e aprovuar për arsim, më 17 gusht 1946, në mbledhjen e qeverisë shqiptare. Arsytimin për ligjin e ri të arsimit dhe projektin e reformës së re të arsimit e kishte paraqitur ministri i atëhershëm i arsimit, Sejfulla Malëshova. "Sipas atij ligji, sistemi arsimit ishte vendosur në bazë të modelit jugosllav dhe përfshinte: a) arsimimin parashkollor, b) arsimimin e përgjithshëm në kohëzgjatje prej 11 vjetësh, c) arsimimin profesional, d) shkollimin e lartë dhe e) arsimimin për të rritur".<sup>369</sup> Në bazë të këtij ligji, i cili parashihte shkollimin e obliguar për fëmijët nga mosha shtatë vjeç, "në periudhën e viteve 1945-1946, ishin të përfshirë në procesin e arsimor: në çerdhe 2.336 fëmijë, në shkollat fillore 77.240 nxënës, në shkollat e mesme 5.774, ndërsa në shkollat e larta 2.115 nxënës. Me këtë numër kanë punuar 2.381 arsimtarë".<sup>370</sup> Ndikimi jugosllav në përmbajtjen e programeve shkollore shqipe ishte evident. Në lëndën e Historisë së Partisë, e cila u aplikua në programet e reja të shkollës socialiste, me epitete të larta madhërohej roli i PKJ dhe i Titos në Luftë ne Dytë Botërore, veçmas në fitoren e komunizmit në Shqipëri. Në këtë lëndë veçohet bashkëpunimi midis PKSH dhe PKJ e me këtë përgjithës ishte dhe bashkëpunimi shqiptaro-jugosllav, qysh nga viti 1941. Në programet skol-

---

368 Po aty.

369 Po aty.

370 Fehmi Pipa, "Një shekull shkollë shqipe", Tiranë, 1962, f. 264.

lore ishte i pranishëm ndikimi i modelit jugosllav dhe shkalla e lartë e indoktrinimit të rinisë shkollore me orientimin dhe ndikimin jugosllav. “Të gjitha tekstet shkollore, në atë kohë, ishin për gatitur duke u mbështetur në tekstet jugosllave, veçmas në tekstete letërsisë jugosllave. Këngët partizane dhe Tito kishin vend të merituar”.<sup>371</sup> Nga fundi i vitit 1946, Ministria e Arsimit të Republikës së Shqipërisë kishte kërkuar nga Instituti Shkencor në Tiranë që të hartohej një fjalor serbokroatisht-shqip. Hartimit të këtij fjalori iu qasën filologët më të njohur shqiptarë të kohës, si Aleksandër Xhuvani, Kostaç Cipo, Eqrem Çabej etj., të cilët në bashkëpunim me profesorin jugosllav, Vojislav S. Dançetoviç, punuan intensivisht dhe hartuan fjalorin, i cili, në kujdestë Institutit Shkencortë Tiranës, u botua më 1947. Në të njëjtin vit, Këshilli për Shkencë dhe Kulturë i qeverisë jugosllave kishte autorizuar pedagogun jugosllav, drejtues i Seminarit Shqiptar në Universitetin e Beogradit, prof. Henrik Bariçin, që të hartonte fjalorin e madh të gjuhës serbokroatisht-shqip. Vëllimi i parë dhe i vetëmi këtij fjalori është botuar në vitin 1950, në edicionin botues të Akademisë Jugosllave në Zagreb. Mirëpo, bashkëpunimi intensiv shqiptaro-jugosllavnë fushën e kulturës dhe arsimit, në vitet e 1945-1948, kishte nxitur edhe fluks të caktuar të studentëve shqiptarë, të cilët kishin ardhur në Jugosllavi për studime. Prej gjithsej 477 studentëve shqiptarë, të cilët studionin jashtë atdheut, 208 i ndiqnin studimet e larta në Jugosllavi. Një numër i konsideruar i nxënësve dhe studentëve shqiptarë kishin studiuar në shkollat e ndryshme profesionale ushtarake. Ndërkohë, në viset kufitare me Maqedoninë, ku jetonte minoriteti maqedonas, ishte lejuar që të zhvillohej shkollimi në gjuhën maqedonase. Për këtë qëllim, në vitin 1945, kishin ardhur në Shqipëri mësues maqedonas. “Nga Jugosllavia (Maqedonia) erdhën dhjetë nxënës me tekste të domosdoshme dhe deri në vitin 1947

<sup>371</sup> Revista “Shejzat”, Romë, 1962, vj. VII, nr. 7-8, f. 264-265.

ishin hapur dhjetë shkolla".<sup>372</sup> Në këtë periudhë (1946-1948), në Shqipëri ishin botuar një varg librash e tekstesh të literaturës jugosllave, kryesisht prozë dhe poezi, të cilat kishin motive të luftës së përbashkët shqiptaro-jugosllave gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Pra synohej një shkallë caktuar e indoktrinimit të rinisë shqiptare me frymën e jugosllavenizmit. Në këtë frymë ishte përkthyer në gjuhën shqip-poezia e poetit malazez, Radovan Zogoviçit, "Kënga përbiografinë e shokut Tito", pastaj ishin përshtaturnë gjuhën shqipe fragmente nga ditari i shkrimtarit kroat, Vladimir Nazorit, me titull "Me partizanët", si dhe "Poezia proletarë vetë vdekur" nga shkrimtari serb Branko Çopiç. Në shkolla këndohej në origjinal, pra në gjuhën serbe.

Më 9 korrik 1947, Shqipëria dhe Jugosllavia kishin nënshkruar në Tiranë Konventën mbi bashkëpunimin kulturor midis dy shteteve, e cila synonte të intensifikonte bashkëpunimin shqiptaro-jugosllav në fushën e arsimit dhe kulturës në përgjithësi. Konventën e kishin nënshkruar në emër të qeverisë shqiptare, dr. Manol Konomi, ministër i Drejtësisë dhe zëvendësministër i Arsimit dhe Matjan Stilinoviç nga pala jugosllave, president i Komitetit të Shkollave dhe të Shkencës të RFJ. Konventa, në artikullin tre, parashihte: "Shtetet kontraktuese janë të lira të themelojnë institute kulturore mbi territorin e shtetit tjetër kontraktues".<sup>373</sup> Parashihej që konventa të vlente së paku për pesë vjet. Gjithashtu, ishte caktuar një komision miks prej 12 anëtarëve, i ndarë nga dy grupe prej gjashtë vetash, të cilët vepronin njëri në Tiranë e tjetri në Beograd, me qëllim që të përcillnin realizimin në jetë të Konventës Kulturore. Në këtë kuptim, synohej që të rritej bashkëpunimi në planin njohjes së vlerave reciproke kulturore, historike dhe përgjithësisht shpirtërore midis dy vendeve. Për këtë qëllim, ishte krijuar edhe Komisioni

372 Budimovski D.K., "Makedoncite vo Albanija", Skoplje, 1983, f. 95-99.

373 "Bashkimi", 11 korrik 1947, Tiranë.

shqiptaro-jugosllav në fushën e kulturës. Në vjeshtë të vitit 1947, ishte nënshkruar edhe marrëveshja për heqjen e vizave ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë që krijonte hapësira të reja për lëvizjen më të shpejtë të drejtuesve të fushave të kulturës dhe arsimit nga të dy vendet. Në këtë kuptim, në vitin 1947, në Shqipëri kishin arritur një numër i konsiderueshëm i profesorëve të gjuhës serbokroate, si dhe këshilltarë për çështje të caktuara nga fusha e kulturës, arsimit dhe sportit. Të gjithë ata vinin me ftesë të qeverisë shqiptare. “Shokët shqiptarë kanë kërkuar që të krijohet bashkëpunimi edhe në fushën kulturore. Nga Jugosllavia u dërgua artisti i shquar serb Bozha Nikoliç për të organizuar teatrin e parë shqiptar. Me gjithë mosinteresimin e plotë të disa anëtarëve të KQ të PKSH për këtë ngjarje me rëndësi në jetën kulturore të Shqipërisë, me gjithë moskuptimin dhe pengesat e ndryshme që shkaktonte Sejfulla Malëshova, si ministër i Kulturës, shoku Nikoliç e kryente detyrën me sukses dhe u ndihmonte artistëve të rinj shqiptarë që teatri i tyre nacional të fillonte punën”.<sup>374</sup> Regjisori jugosllav, Bozha Nikoliç, i cili në Tiranë kishte qëndruar plot shtatë muaj, duke punuar me artistë shqiptarë, në kujtimet e tij për atë bashkëpunim profesional, rrëfente: “E kuptoja se ata dëshironin të kënaqnin pjesën kryesore dhe më të rëndësishme të jetës kulturore në Shqipëri – themelimin e teatrit të përhershëm dhe profesionist dhe përmes kësaj të ndërtohej individualiteti nacional, të inspiroheshin shkrimtarët vendas që të ndërtonin gjuhën letrar edhe që dalëngadalë të merrnin mbi vete kultivimin e degëve tjera artistike dhe së fundi të ishte shkollë popullore për masat e gjëra popullore dhe të jetës kulturore përgjithësisht”.<sup>375</sup> Përkundër intensifikimit të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në fushën e kulturës, arsimit dhe të shtypit, autoritetet diplomatike jugosllave në Tiranë, por edhe vetë profesorët

374 Vladimir Dedijer, vep. e cit.

375 “Jedinstvo”, Prishtinë, 23.3.1985.

e ardhur nga Beogradi, kërkonin një ndikim edhe më të madh të Jugosllavisë në fushat e përmendura. Sipas tyre: "Të gjithëve ne që punonim në Shqipëri na befaso i për të keq fakti pse në shtypin shqiptar botoheshin informata fragmentare për zhvillimet në Jugosllavi ose kishte raste kur nuk kishte fare informata. Normalisht, për shkak të marrëdhënieve shumë intensive reciproke mund të pritej që çështja të jetë në të kundërtën. Por, nuk ishte ashtu".<sup>376</sup> Pas nënshkrimit të Konventës Kulturore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në vjeshtë të vitit 1947, u nxitën iniciativa konkrete në planin e kulturës, filmit, teatrit, literaturës, botimeve etj. Si rezultat konkret i këtyre angazhimeve, në Tiranë në vitin 1947, u hap libraria jugosllave, e vendosur në një nga pjesët më të bukura të kryeqytetit shqiptar. Në ceremoninë e hapjes së librarisë kishin marrë pjesë shumë punëtorë politikë, të kulturës dhe artit të dy shteteve fqinje, ndërsa për rëndësinë e hapjes së librarisë dhe përgjithësisht bashkëpunimin ndërkulturor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë kishte folur Hysni Kapo, ndihmës ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Shoqata për Bashkëpunimin Kulturor në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në vitin 1946-1947, kishte zhvilluar një varg aktivitete të rëndësishme në Tiranë dhe qytetet tjera më të mëdha të Shqipërisë. Këto aktivitete ishin reflektuar në mbajtjen e konferencave të rëndësishme tematike, shfaqje dokumentaresh, shkëmbim delegacionesh mes dy shteteve fqinje, kurse në muajin mars 1947, merastin e manifestimit Java e Rinisë Botërore në Tiranë, u organizua një konferencë tematike mbi rininë e Jugosllavisë. Më 25 maj 1947, ishte festuar përvjetori i ditëlindjes së marshallit Tito, ku organizatorët kishin mbajtur edhe një konferencë mbi biografinë e Titos. Shoqata përkatëse kishte mbajtur manifestime të ndryshme, kryesisht tematike dhe me karakter festiv, edhe me rastine kthimit të Brigadës katër herë sulmuese "Qemal Stafa", që

<sup>376</sup> Drago Koshmrlj, vep. e cit.

punoi në Hekurudhën “Shamac-Sarajevo” në Jugosllavi, pastajmë 20 tetor 1947 me rastine çlirimit të Beogradit. Duke mos u mjaftuar me këto aktivitete, gjatë vitit 1947, ajo kishte ndërmarrë iniciativa për ardhjen në Shqipëri të grupeve të ndryshme folkloristike dhe përgjithësisht të shoqërive kulturoro-artistike jugosllave, si dhe kishte organizuar edhe vizita nëpër qendrat e ndryshme të Jugosllavisë të grupeve të punëtorëve dhe ushtarëve të dalluar. Më 10 tetor 1947, në bashkëpunim me Shoqërinë Kulturore Maqedoni-Shqipëri, në Manastir ishte dërguar një delegacion për të asistuar në Festivalin Kombëtar të Maqedonisë. Delegacioni përbëhej nga kompleksi artistik i pionierëve të Tiranës. Më 15 korrik, në Tiranë ishte organizuar një mbrëmje letrare, ku ishin recituar pjesë të zgjedhura nga shkrimtarët e Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë. Ndërsa, më 31 gusht, ishte organizuar një mbrëmje letraro-muzikore, ku ishin kënduar këngë popullore e partizane jugosllave dhe shqiptare. Anëtarët e Seksionit të Letërsisë, me atë rast, kishin recituar pjesë të zgjedhura nga poezia jugosllave. Shoqata kishte zhvilluar edhe aktivitete të tjera të shumta me qëllim të afirmimit të Jugosllavisë në shoqërinë shqiptare, duke hapur kështu shumë ekspozita si: ajo për Luftën Nacionalçlirimtare në Jugosllavi, Piktorët në luftë, Aksioni i rinisë Shamac-Sarajevë, Vuk Karaxhiçinetj. Radio Tirana kishte mbajtur emisionin special “Të njohim Jugosllavinë e re”, si dhe ishin ligjëruar mësimet për gjuhën serbo-kroate dy herë në javë. Pranë Shoqatës për Bashkëpunimin Kulturor në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, gjatë vitit 1947, kanë funksionuar 12 kurse të gjuhës serbo-kroate me gjithsej 200 kursistë. Kurse përmësimin e gjuhës serbo-kroate ishin ngritur edhe pranë: Bankës së Shtetit, Shoqërisë Import-Eksport, Këshillit të Përgjithshëm Sindikal, Redaksisë “Bashkimi”, Kryeministrisë, Ministrisë së Jashtme, Ministrisë së Arsimit, Kryqit të Kuq, Sekretariatit të Rinisë etj. Grupe për mësimin e gjuhës serbo-kroate

ishin ngritur edhe pranë të gjitha prefektura vetë atëher-shme të Shqipërisë me nga 10-20 veta, ndërsa kursistët më të mirë ishin dërguar për specializim të gjuhës në Jugosllavi. Shoqëria e sipër përmendur ka mbajtur rregullisht lidhje me shoqëritë e ngjashme të republikave federative të Jugosllavisë me qendra te tyre në Beograd, Zagreb, Cetinje dhe Shkup. Shoqëria kishte nxjerrësi botim të vetin periodik revistën e saj "Shqipëri-Jugosllavi".<sup>377</sup>Siç shihet, në planin e bashkëpunimit kulturor me Kosovën, Shoqëria për Bashkëpunimin Kulturor mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë nuk ka zhvilluar kurrfarë veprimtarie.

---

<sup>377</sup> "Bashkimi", 7 janar 1948, Tiranë.

## KONFERENCA E PAQESNË PARIS

### DHE ÇËSHTJA E SHQIPËRISË

Dimensioni i marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, në periudhën 1945-1948, plotësohet edhe me përkrahjen jugosllave dhënë Shqipërisë në Konferencën e Paqes mbajtur në Paris, në vitin 1946. Historiografia jugosllave, lidhur me këtë konferencë dhe "mbrojtjen" jugosllave që iu bë çështjes shqiptare, është përplot glorifikime. Pavarësisht se Jugosllavia ishte vënë në përkrahjen e realizimit të interesave të shtetit shqiptar, megjithatë kjo mbrojtje në fakt bëhej, jo vetëm për interesat shqiptare, por edhe për interesat e Jugosllavisë. Kjo përfaktin se, Jugosllavia mbante qëndrim absolutisht paternalist kundrejt Shqipërisë dhe mbrojtjes së interesave të saj në Konferencën e Paqes në Paris. Nga ana tjetër, shikuar nga prizmi i së drejtës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe ndërshtetërore, rasti i "mbrojtjes" së interesave të shtetit shqiptar nga ana e Jugosllavisë në Konferencën e Paqes në Paris, paraqet një nga shembujt më konkretë të varësisë së një shteti nga një shtet tjetër. Për të mos thënë se pozicioni juridik i shtetit shqiptar, në Konferencën e Paqes në Paris ishte thuajse i njëjtë me cilën do anëtare të Federatës Jugosllave. Në fakt, siç del edhe nga dokumentet historike, lufta diplomatike që zhvilloi Jugosllavianë Konferencën e Parisit për thirrjen edhe të përfaqësuesve të qeverisë shqiptare ishte luftë për mbrojtjen e një shteti, të cilin Jugosllavia e përgatiste të bëhej republikë e saj. Para sofrës së diplomacisë ndërkombëtare ishte edhe një rast i volitshëm për jugosllavët që, krahas përkrahjes së çështjes shqiptare, t'i forconin pozitat para qeverisë shqiptare si të vetmit aleatë të shtetit shqiptar. Historiografia shqiptare e periudhës së komunizmit nuk i jep publicitet kësaj konference, pra as paraqitjes së përfaqësuesve jugosllavë në konferencë në mbrojtje të çështjes shqiptare. Konferenca e



Paqes në Paris, e cila i kishte filluar punimet më 29 korrik 1946 dhe që kishte zgjatur gjithsej 81 ditë, nuk pasqyrohet as në dokumentet e ndryshëm të PKSH. Enver Hoxha kalimthi u referohet punimeve të konferencës në fjalë në librin e tij të kujtimeve: “Aty nga mesi i gushtit 1946, ndërsa në Paris kishte filluar punimet Konferenca e Paqes, ne dhe gjithë opinioni publik ndërkombëtar dëgjuam për denoncimin e fortë që i bëri Mosha Pijade, në një nga seancat e konferencës, propozimit të Caldarisit (në atë kohë kryeministëri Greqisë dhe përfaqësues i saj në Konferencën e Paqes në Paris - A. Z) për një marrëveshje të fshehtë greko-jugosllave për copëtimin e Shqipërisë. Pak ditë pasi kishte folur Pijade, unë shkova vetë në Paris, për të kryesuar delegacionin tonë në këtë konferencë dhe qysh në takimin e parë e falënderova Pijaden për qëndrimin e tij dhe të qeverisë jugosllave kundrejt propozimit tëndyrë të Caldarisit. Isha bashkë me Molotovin në momentin kur takova Pijaden dhe këtij iu bë shumë qejfi për fjalët e mia, ca më tepër që po ia thosha në sy të Molotovit... Por atëherë nuk dija se, tamam ky “mbrojtës” i pjesës jugore të Shqipërisë, vuante nga ëndrra për ta gllabëruar Shqipërinë... Shkurt, “mbrojtësit” jugosllavë nuk mbronin Shqipërinë si shtet të lirë e sovran, por mbronin ato troje, që në planete tyre të fshehta, përbënin gubernën jugore të “shtetit të madh” shumëkombëshe shumëpopujsh jugosllavë të ëndërruar prej shekujsh”.<sup>378</sup> Në të vërtetë, në javën e fundit të korrikut 1946, shtypi shqiptar kishte ngritur shqetësimet për të drejtën e Shqipërisë që të thirrej dhe të merrte pjesë në Konferencën e Paqes në Paris. Këtë aktivitet të shtypit e përkrahnin edhe organizmat tjerë politikë në Shqipëri, të cilat kërkonin nga organizatat si motra ndërkombëtare që të përkrahnin kërkesën që edhe Shqipëria të ishte pjesëmarrëse në tubimin e Parisit. Më 31 korrik 1946, gazeta “Bashkimi” kishte botuar Rezolutën e Parlamentit Shqiptar drejtuar Kryesisë së Konferencës së

<sup>378</sup> Enver Hoxha, vep. e cit., f. 214.

Paqes në Paris ku kërkohet që të pranohej kërkesa e qeverisë shqiptare për pjesëmarrje në konferencë. Më 30 korrik 1946, Enver Hoxha i kishte dërguar një letër kryetarit të Konferencës së Paqes në Paris, ku i bënte thirrje që edhe Shqipëria të përfaqësohej në punimet e konferencës. Qeveria shqiptare, madje, i kishte caktuar edhe përfaqësuesit, të cilët do të merreshin pjesë: Hysni Kapo, i cili konsiderohejse do të ishte kryetari përkohshëm i delegacionit shqiptar, Manol Konomi, ministër i Drejtësisë, Ylli Kahremani, përfaqësues diplomatik i Republikës së Shqipërisë në Paris, Pëllumb Dishnica, deputet, Behar Shtylla, diplomat, Dimitër Popa, Aleks Buda, Petraq Peja, Sami Antoni dhe Misto Treska. Parashihej që, nëse zhvillimi i ngjarjeve kërkonte qasje tjetër, atëherë varësisht nga situata, delegacionin do ta kryesonin Nako Spiru ose Koçi Xoxe.<sup>379</sup> Ndërkohë, qeveria shqiptare kishte marrë vendim që, për shkak të rëndësisë që kishte shtruarja e çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, delegacionin ta kryesonte Enver Hoxha, e jo Hysni Kapo, i caktuar më parë për të kryesuar provizorisht delegacionin. Enver Hoxha, në mbledhjen e Kuvendit Popullor, mbajtur më 17 gusht 1946, në të cilën ishte miratuar përbërja e delegacionit shqiptar dhe e kryesuesit të saj, ndër të tjera kishte thënë: “Qeveria, duke marrë parasysh rëndësinë e çështjes, vendosi që të shkojë unë atje dhe të marrë kryesinë e delegacionit për të shfaqur pikëpamjet e qeverisë shqiptare. Duke kërkuar leje për mungesën që do të bëjë në punimet e Kuvendit, jusiguroj se shokët dhe unë do të paraqesim si duhet pikëpamjen e Shqipërisë...”<sup>380</sup> Nexhmije Hoxha, në librin e kujtimeve “Jeta ime me Enver Hoxhën”, ofron detaje të rejanë lidhje me shkuarjen në Konferencën e Paqes në Paris të Enver Hoxhës: “Si përfaqësues të vendit tonë në këtë konferencë, në fillim, ishin caktuar

---

379 Arkivi Shtetëror i Sekretariatit të Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, A 1946/1, nr. 11/VI, Sekr. nr. 9091, Gjergja 31.VII.1946, Sekr. nr. 487.

380 Enver Hoxha, Vepra 3, Tiranë, 1969, f. 420.

të tjerë udhëheqës të Shqipërisë së re Popullore. Në krye të delegacionit tonë ishte Hysni Kapo, i cili kishte qenë edhe në Konferencën e San Franciskos. Enveri nuk e kishte fare në plan të shkonte vetë në Paris... Siç mora vesh më vonë, nga ato që më tregonte Enveri, në Konferencë, grekët do të kundërshtonin njohjen e Shqipërisë si anëtare të koalicionit antifashist, madje edhe se ata do ta akuzonin Shqipërinë si pjesëmarrëse bashkë me ushtrinë fashiste italiane, në sulmin e kësaj të fundit kundër Greqisë”.<sup>381</sup> Nexhmije Hoxha, sulmet greke kundër Shqipërisë i konsideronte si motiv dhe shkakun kryesor pse Enver Hoxha kishte shkuar në Konferencën e Paqes në Paris: “Prandaj shokët e delegacionit tonë kërkuan që të vinte në Konferencë urgjent vetë Enver Hoxha. Më 17 gusht, Enveri njoftoi Kuvendin Popullor që Qeveria e RPSH e kishte ngarkuar atë si kryetar të delegacionit dhe i siguroi ata se do të paraqitnin si duhej pikëpamjen e qëndrimin e Shqipërisë...Pjesëmarrja në këtë Konferencë e vetë Enverit, si kryeministër i Shqipërisë u bë e domosdoshme veçanërisht pas denoncimit të bujshëm që i bëri aty delegati jugosllav, Mosha Pijade, propozimit të ulët të Caldirisit (atëherë kryeministër dhe kryetari delegacionit grek - A.Z.) për një marrëveshje të fshehtë greko-jugosllave për copëtimin e Shqipërisë”.<sup>382</sup> Ndërkaq, pjesëmarrësit e Konferencës së Paqes në Paris kishin humbur plot katër seanca diskutimesh të zjarrta pro dhe kundër pjesëmarrjes së delegacionit shqiptar në punimet e konferencës. Delegacioni jugosllav, qysh nga fillimi i seancës së parë të punimeve plenare, kishte këmbëngulur në të drejtën e pjesëmarrjes së përfaqësuesve të qeverisë shqiptare në konferencë. Këtë çështje e kishte ngritur Mosha Pijade dhe jo, siç shkruan Eduard Kadeli në një pjesë të dokumenteve historike të proveniencës jugosllave: “Në mbledhjen e parë, e cila kishte shqyrtuar të drejtën e

---

381 Nexhmije Hoxha, Jeta ime me Enver Hoxhën, Tiranë, 1998, f. 189.

382 Po aty.

pjesëmarrjes së Shqipërisë, më 9 gusht 1946, delegati jugosllav Mosha Pijade, në bazë të nenit tre të rregullores së punës, kishte propozuar që Shqipëria të thirret në konferencë...”.<sup>383</sup> Mosha Pijade kishte thënë: “E marr fjalën për të propozuar që në Konferencën e Paqes të thirret edhe Republika Popullore e Shqipërisë...

Shqipëria, nga të gjitha vendet ballkanike, është e para që u bë viktimë e imperializmit italian... Që të mbronte dhe kthente lirinë e vet dhe pavarësinë, populli shqiptar ka zhvilluar plot gjashtë vite luftë të rëndë dhe heroike kundër okupatorit fashist... Delegacioni jugosllavsheh se nuk mund të arsyetohet mosthirrja e Shqipërisë në konferencë, si shtet anëtare e barabartë me ne të tjerët. A është Shqipëria shtet armiqësor që në konferencë të thirret vetëm për t’u marrë në pyetje apo është vend aleat që meriton mburrje dhe falënderim prej të gjitha vendeve demokratike?” Diplomati jugosllav kishte propozuar që konferenca plenare të aprovonte vendimin në të cilin thuhej: “Konferenca plenare vendosi që Republika Popullore e Shqipërisë të thirret në Konferencën e Paqes në Paris që të marrë pjesë me të drejtë të votës këshilluese, në konferencën plenare dhe në komisionet, të cilat do të debatohen për projektin e marrëveshjes me Italinë”.<sup>384</sup> Diskutimet në lidhje me propozimin e Mosha Pijades kanë vazhduar edhe në seancën plenare të pasdites së 9 gushtit. Udhëheqësi i delegacionit francez, Zhorzh Bido, kishte propozuar që, përveç Shqipërisë, në konferencë të ftoheshin edhe: Egjipti, Meksiko dhe Kuba, të cilat, ashtu sikurse edhe Shqipëria, kishin paraqitur kërkesat me shkrim para Kryesisë së punës së konferencës. Ndërkohë, gjatë diskutimeve të pasdites, në foltore kishte dalë delegati grek, Konstatin Caldaris, i cili kishte sulmuar Shqipërinë me kualifikimin tendencioz: “Shqipëria nuk ka marrë pjesë në luftë kundër shteteve ev-

---

383 Vladimir Dedijer, Konferenca e Parisit, Beograd, 1947, f. 151.

384 Moša Pijade, Izabrani govori i članci, 1941-1947, Beograd, 1948, f. 411-413.

ropiane, por ka marrë pjesë në luftë kundër shteteve aleate, kundër Greqisë dhe se 14 batalione shqiptare kanë luftuar së bashku me Italinë kundër Greqisë...".<sup>385</sup> Sulmet dhe shpifjet greke në adresë të qeverisë shqiptare dhe përgjithësisht të popullit shqiptar kishin vazhduar në të njëjtën mbledhje me akuzat që i kishte paraqitur Filip Dragumis, nënsekretar shtetëror në Ministrinë e Jashtme të Greqisë. Dragumis, i cili është themelues i teorisë, sipas të cilës "Shqipëria kurrë nuk e ka humbur lirinë e vet pas agresionit italian të vitit 1939", para foltores kishte shtuar se: "Greqia është në gjendje lufte me Shqipërinë qysh nga data 28 tetortë vitit 1940".<sup>386</sup> Ndaj akuzave të delegatëve grekë ishte përgjigjur ministri i Punëve të Jashtme të Ukrainës (që atë kohë ishte republikë sovjetike - A.Z), duke mbështetur me atë rast deklaratën e ministrit britanik të Punëve të Jashtme, Antoni Iden, ku thuhej se: Qeveria e Britanisë së Madhe ndien simpati të madhe ndaj popullit të Shqipërisë, e cila ka qenë viktimja e parë e Italisë fashiste... Ai kishte lexuar edhe deklaratën e ish-ministrit të Punëve të Jashtme të SHBA, Kordeli Hill, më 10 dhjetor 1942, ku shprehej qëndrimi i qeverisë amerikane për respektimin e kontributit të popullit shqiptar për çështjen e përbashkët. Delegati amerikan Xh. Beris kishte propozuar që çështja e shteteve të ftuara t'i dërgohet Komisionit të Përgjithshëm të Konferencës. Në mbledhjen e tretë plenare të Konferencës së Paqes në Paris u hapën sërish diskutimet për pjesëmarrjen ose jo të Shqipërisë në konferencë. Në foltores dolidelegati polak, Zhimovski, i cili përkrahu propozimin që Shqipëria të thirret në konferencë. Ai, duke kritikuar heshtjen "oportuniste" të diplomatit Herbert Evat, mbrojtësi "popujve të vegjël", kishte pyetur: "Pse sot, kur është fjala për një popull të vogël, nuk e dëgjojmë zërin e mbrojtësit të popujve të

---

385 Vladimir Dedijer, Konferenca e Parisit, f. 152.

386 Po aty.

vegjël? Pse nuk po e dëgjojmë zërin e z. Evat?"<sup>387</sup> Thirrjen e Shqipërisë dhe praninë e përfaqësuesve të saj në konferencë e kishte përkrahur edhe Andrej Vishinski, shef i delegacionit sovjetik, kështu që edhe sekretari amerikan i shtetit për Punë të Jashtme ishte detyruar të pranonte rezolutën kompromise të Çekosllovakisë, të propozuar nga përfaqësuesi i saj Jozef Korbel, ambasadorçek në Beograd, me të cilën Konferencës për Paqe në Parisi bëhej thirrje të pranonte propozimin që të ftoheshin përfaqësuesit e Shqipërisë, Egjiptit, Kubës dhe Meksikos.<sup>388</sup> Delegati grek, Caldiris, sërish kishte marrë fjalën, duke kontestuar të drejtën e Shqipërisë që të ftohej në konferencë. Pas tij, fjalën e kishte marrë Mosha Pijade, i cili kishte thënë: "Jugosllavia e re, duke i respektuar të drejtat e të gjithë popujve në liritë nacionale, e ka ndërprerë politikën imperialiste të regjimit të vjetër. Luftërat e shumta midis nesh dhe popullit shqiptar, ne i kemi zëvendësuar me miqësitë fortë dhe bashkëpunim vëllazëror në luftën e përbashkët çlirimtare të popujve tonë... Mirëpo, në Greqi fatkeqësisht nuk është i njëjti rast".<sup>389</sup> Gjatë diskutimit të tij, Mosha Pijade, për befasinë e të pranishmëve, kishte bërë publike deklaratën e delegatit grek dhënë më 2 gusht 1946 në takimin e përbashkët në mestë diplomatit amerikan Berns dhe delegatit jugosllav, Pijade. Sipas Mosha Pijades: "Caldirisi kishte paraqitur ofertën që Jugosllavia dhe Greqia ta ndajnë Shqipërinë. Madje edhe sot përfaqësues zyrtarë grekë na paraqesin propozime për ndarjen e Shqipërisë ndërmjet Jugosllavisë dhe Greqisë. Madje, do të them se z. Caldiris ishte ai, i cili, paradisa ditësh, na dha këtë propozim. Ai këtë e quan "politikë praktike", mirëpo ne politikën e tillë nuk e duam. Ne jemi të çliruar nga të gjitha tendencat imperialiste. Ne dëshirojmë që Shqipëria të jetë e lirë dhe e pavarur. Me Traktatin për Bashkëpunim, të

---

387 Politika, 11.VII.1946.

388 Po aty.

389 Moša Pijade, Izabrani govori i članci, 1941-1947, Beograd, 1948, f. 414-416.

cilin e kemi realizuarne dhe Shqipëria, garantojmë integritet reciprok, sovranitet dhe pavarësitë dy vendeve tona...Ideja përndarjen e Shqipërisë, ideja që Shqipëria të hiqet nga harta gjeografike si shtet i pavarur, gjendet në qëndrimin, të cilin dje delegacioni grek e mori kundër rezolutës, të cilën ne e propozuam. Ajo ide gjendet në bazën e të gjitha pretendimeve të qeverisë së Athinës në dëm të Shqipërisë”.<sup>390</sup> Caldiris, të njëjtën ditë, i kishte shkruar një letër Kryesisë së Konferencës ku deklaronte se, pohime te diplomatit jugosllav nuk ishin të vërteta dhe se nuk ka pasur kurrfarë propozime për ndarjen e Shqipërisë. Mosha Pijade, më 15 gusht 1946, i kishte dërguar një letër Kryesisë së Konferencës së Paqes në Paris, ku konfirmonte se Caldiris në bisedë me delegatët jugosllavë, Bebler dhe Vilfan, kishte dhënë propozimin për ndarjen e Shqipërisë. Caldiris, ndërkaq, deklaronte se nga delegatët e përmendur jugosllavë ka kërkuar që Jugosllavia të mos jetë opozitë lidhur me kërkesa te Greqisë ndaj Epirit Verior. Enver Hoxha, në lidhje me mbrojtjen jugosllave shumë vite më vonë, shkruante: “... Konform planit të fshehtë për aneksimin e krejt Shqipërisë, njerëzit e Titos s’kishin pse të mos dilnin në “mbrojtje” të pjesës jugore që synohej nga Caldaris. Ata besonin se punët do të ecnin në favor të tyre dhe, në një rast të tillë, përse të lejonin që e vluara e ëndërruar, Shqipëria, të cenohej edhe nga greku, kur mund ta gëzonin të gjithë vetë”.<sup>391</sup> Nexhmije Hoxha, duke komentuar polemikat midis Pijades dhe Caldirisit rreth çështjes së Shqipërisë dhe reagimin e Enver Hoxhës, shkruante: “Enveri këtë denoncime quajti një ndihmë dhe mbrojtje internacionaliste. Por, atëherë, as ai dhe askush nga shqiptarët nuk e dinin se kur udhëheqja jugosllave qysh më 1945 kishte filluar ndërtimin e një pallati të madh pranë lumit Sava, për zyrat qendrore të Republikave të Federatës ishte pikërisht ky, Mosha Pijade, që

---

390 Po aty.

391 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 214.

kishte propozuar të “rezervoheshin” aty disa kabinete edhe për republikën e 7-të, me të cilën ata nënkuptonin Republikën Popullore të Shqipërisë. Pra, udhëheqja jugosllave, në kuadrin e planit të fshehtë për aneksimin e krenjt Shqipërisë, s’kishte pse të mos kundërshtonte synimet e Caldirisit”.<sup>392</sup>

Enver Hoxha, në rrethana shumë të ndërlikuara ndërkom-bëtarisht për Shqipërinë dhe përgjithësisht për çështjen shqiptare, më 19 gusht 1946, u nis nga Tirana për në Paris për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes, e cila po i zhvillonte punimet në atmosferë mjaft të tensionuar diplomatike. Me të kishte udhëtuar edhe ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme, Vasil Komoni.<sup>393</sup> Në fjalimin e mbajtur në seancën plenare të Konferencës së Paqes në Paris, më 21 gusht 1946, Enver Hoxha, pasi kishte kritikuar qëndrimin e diplomacisë evropiane për të mos ftuar qeverinë shqiptare si pjesëtare të konferencës, kishte konstatuar: “... Ajo e kish fituar me luftë të drejtën të marrë pjesë në këtë konferencë, me titull dhe me të drejta të njëjta me ato të njëzete një kombeve fitimtare. Populli i vogël shqiptar, i vetëm dhe pa mbrojtje, ka qenë viktima e parë e agresionit italian... Fill të vetëm, përpara një armiku të pamëshirshëm, ne e kemi mbajtur ballin lart në furtunë, ne i shpallëm armikut luftë të ashpër dhe të paprerë”.<sup>394</sup> Duke iu referuar spekulimeve të shefit të delegacionit grek, Caldiris, në lidhje me Shqipërinë dhe pjesëmarrjen e popullit shqiptar në Luftën e Dytë Botërore kishte përkujtuar të pranishmit në konferencë: “Me qëllim që të shtrembërojnë historinë dhe të mohojnë faktet... bëhen gjithë këto përpjekje për të mos i trajtuar në mënyrë të barabartë ata që trimërisht kanë luftuar për kauzën e përbashkët. Në këtë konferencë të lartë është folur shpeshherë për mbrojtjen e interesave të popujve të vegjël, por në fakt, përsa i përket popullit tonë,

---

392 Po aty, f. 191.

393 “Politika”, 20.VIII.1946, 1.

394 “Bashkimi”, nr. 540, 22 shtator 1946.



është vepruar krejt praptazi... Populli shqiptar e ndjen veten të ofenduar që është vënë në të njëjtën radhë me Austrinë, me atë Austri që nuk ka shtënë asnjë pushkë kundër gjermanëve...".<sup>395</sup> Duke iu përgjigjur drejtpërdrejt akuzave të Caldirisit, Enver Hoxha kishte deklaruar: "Z. Caldiris përpigjet të provojë se Shqipëria nuk është një vend aleat, se Shqipëria ka atakuar Greqinë dhe se kjo është në gjendje lufte me të. Nga ana tjetër, z. Caldiris rivendikon Shqipërinë e jugut duke pretenduar se kjo është një tokë greke dhe se i takon asaj me të drejtë".<sup>396</sup> Kryeministri shqiptar mëtej në fjalimin e tij, cili nga shtypi ndërkombëtar i kohës ishte cilësuar si i zjarrtë, kishte zbërthyer pretendimet shoviniste greke: "Por, objektivi i vërtetë i gjithë këtyre thënieve të delegatit grek është që t'i merren Shqipërisë dy krahina: Korça dhe Gjirokastra, që kanë qenë gjithmonë nga qendrat më të zjarrta të patriotizmit shqiptar..."<sup>397</sup>. Edhe në deklaratën e dhënë për shtypnë Paris, më 16 shtator 1946, Enver Hoxha kishte përsëritur pakënaqësinë e delegacionit shqiptar, lidhur me akuzat që pala greke kishte bërë në adresë të Shqipërisë, si dhe oportunitetin e disa delegacioneve perëndimore, pjesëmarrëse në konferencë, lidhur me akuzat dhe pretendimet greke: "Unë deklaroj solemnisht se, as Konferenca e Parisit, as Konferenca e të Katërtëve, as çdo konferencë tjetër qoftë, nuk mund të marrin në shqyrtim kufijtë e vendit tonë, brenda të cilëve nuk ka asnjë pëllëmbë tokë të huaj. Kufijtë tanë janë të padiskutueshëm dhe askush nuk do të guxojë t'i prekë... Nga ana tjetër, protestoj kundër vendimit të marrë në seancën plenare të Konferencës së Parisit. Populli shqiptar nuk ka dërguar delegacionin e tij në Paris për të dhënë llogari, por për tu kërkuar llogari atyre që e kanë dëmtuar aq tepër dhe që ai i ka luftuar me ashpërsi deri në fund".<sup>398</sup>

395 Po aty.

396 Po aty.

397 Po aty.

398 "Bashkimi", 19 shtator 1946.

Në depeshën dërguar qeverisë shqiptare nga Parisi, më 10 tetor 1946, Enver Hoxha paralajmëronte se do të kthehej në Shqipëri, sepse në marrëveshje me delegacionin jugosllav dhe atë sovjetik kishte vendosur që të tërhiqej nga qëllimi që në seancën plenare të parashtronte protestë kundër pretendimeve territoriale të Greqisë. Më 15 tetor, Enver Hoxha kishte njoftuar

qeverinë shqiptare se, çështja shqiptare po përparonte mirë dhe se kërkesat greke nuk kishin marrë përkrahje. Paraprakisht, Enver Hoxha, në një darkë të përbashkëtpune me diplomatët rusë, Molotovin dhe Vishinksin, kishte marrë premtime se çështja shqiptare do të lëvizte përpara. Burimet-diplomatike jugosllave kishin marrë njoftimin se Enver Hoxha gjatë qëndrimit të tij në Paris, me gjithë mbikëqyrjen dhe kontrollin jugosllav dhe sovjetik, kishte paraqitur interesime konkrete për takime edhe me diplomatë të vendeve perëndimore. Dihet se diplomati francez, Zh. Bidoa, nuk e kishte pranuar për dhjetë ditë me radhë, ndërkohë që me delegatët anglo-amerikanë as që kishte arritur të kishte ndonjë takim. Diplomatat jugosllavë kishin konstatuar se Enver Hoxha, edhe gjatë qëndrimit në Paris, kishte mbajtur shpresë se do të kishte mbështetjen e Francës, për të cilën ishte i bindur se do ta përkrahte që të përmirësonte marrëdhëniet e ftohura me anglo-amerikanët.<sup>399</sup> Diplomacia jugosllave e kishte vlerësuar si të dobishme mosgatishmërinë e segmenteve të caktuara të diplomacisë ndërkombëtare, në radhëtë parë të asaj anglo-amerikane, për të bërë bashkëbisedime me përfaqësuesit shqiptarë dhe personalisht me Enver Hoxhën. Diplomacia jugosllave e kishte të qartë se izolimi ndërkombëtar i Shqipërisë nga shtetet perëndimore, i manifestuar edhe në nivel të Konferencës së Paqes në Paris, e detyronte politikën e jashtme shqiptare që përfundimisht të orientohet

---

399 Arkivi Shtetëror i Sekretariatit të Punëve të Jashtme, A 1946/1, nr. 11/VI, Sekr. nr. 10074, 100776, 11287

vetëm kah Jugosllavia dhe BRSS, që të mund t'i realizonte dhe mbronte interesat e shtetit shqiptar. "Enver Hoxha në Konferencëne Parisit krijoi përshtypjen reale për marrëdhëniet ndërmjet shteteve të bllokut lindor. Ai e pa se çka do të thotë BRSS si superfuqi, mirëpo e hetoi po ashtu se midis BRSS dhe Shqipërisë është Jugosllavia, përmes të cilës lindja komunikonte me Shqipërinë".<sup>400</sup> Kuptohet, posa e kuptuan pozicionin e dobësuar të EnverHoxhës në përmasat e diplomacisë ndërkombëtare, në veçanti mospranimin e tij nga diplomacia perëndimore, diplomacia jugosllave u hodh në ofensivën diplomatike dhe të presioneve të reja kundër Enver Hoxhës. "Si e hetoi këtë në bisedë me Hoxhën, Gjergja e potencoi çështjen e konventës kulturore, në mënyrë që të thelloheshin marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Hoxha i kishte bërë të ditur Gjergjës se më 29 shtator, në plenumin e Frontit Demokratik, do të bënte spastrime të kuadrove, në sajë të përvojave të fituara. Këtë është dashur ta bënte edhe në saj të faktit se autoriteti dhe prestigjii Jugosllavisë në vend (Shqipëri -A.Z) ishte rritur, mirëpo në organet udhëheqëse ende kishte njerëz të rezervuar ndaj Beogradit".<sup>401</sup> Më 17 shtator1946, Enver Hoxha me tu kthyer nga Parisi në atdhe, i trimëruar me përkrahjen jugosllave dhe atë sovjetike, në aeroportin e Tiranës kishte përsëritur qëndrimin e qeverisë shqiptare, pra, edhe të delegacionit shqiptar në konferencë, për mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë: "Bota e dëgjoi, por është mirë që ta dëgjojë edhe një herë se, as Konferenca e Paqes e Parisit, as Konferenca e katër ministrave të Punëve të Jashtme dhe as ndonjë konferencë tjetër qoftë, nuk janë kompetentë të diskutojnë kufijtë tanë... Pretendimet aq të poshtra edhe qesharake të qeveritarëve të Athinës do të dështojnë me turp... Britmate Caldirisit as na trembin, as na

---

400 Po aty.

401 B. Hrabak, vep. e cit.

alarmojnë...”.<sup>402</sup> Konkluzionet e diplomacisë shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris i kishte formuluar Hysni Kapo, anëtar i delegacionit shqiptar, në letrën drejtuar më 17 tetor 1946 nga Parisi në adresë të Ministrisë të Punëve të Jashtme në Tiranë, ku thuhet: “Si përfundim i punës së zhvilluar gjatë konferencës, me mbështetjen e madhe të delegacioneve mike, Konferenca e Parisit pati për ne këto rezultate politike dhe materiale të favorshme:a) Çështja e Shqipërisë së Jugut nuk u shtrua për diskutim në konferencë dhe, sipas mendimit të miqve tanë, ajo quhet e mbyllur, megjithëse qeveria greke nuk do të qëndrojë pa e shtruar përsëri;b) Çështja e ishullit të Sazanit,u vendos se është e drejtë që i takon Shqipërisë;c) Shqipëria përfiton nga restitucionet që duhet t’i kthehen prej shtetit italian; d) Të gjitha pasuritë italiane në Shqipëri i lihen shtetit në formë reparacionesh... Nuk patëm sukses në këto raste: a) Shqipëria nuk u pranua si shtet asocië në aplikimin e traktatit; b) Nuk u njoh integriteti territorial i Shqipërisë;c) Nuk aplikohet artikulli 38 për Shqipërinë, i cili flet për kriminelët e luftës; d) Nuk u përfundua çështja e rezervës së arit,e cila mbeti të diskutohet në Këshillin e Ministrave të Punëve të Jashtme; e) Nuk u përfundua çështja e materialit ushtarak të marrë prej Italisë në Shqipëri mbas okupacionit të 7 prillit 1939; f) Nuk na u caktua shuma e reparacioneve që duhet të marrim nga Italia, çështja do të shtrohet në Këshillin e Ministrave të Punëve të Jashtme”.<sup>403</sup>

EnverHoxha në fjalimin e tij në Konferencën e Paqes në Paris nuk e ngriti çështjen e Kosovës, kurse atë të Çamërisë e kishte përmendur vetëm në kontekst të kundërpërgjigjes ndaj përfaqësuesve grekë, të cilët shtruan çështjen e rishikimit të kufijve të Shqipërisë së Jugut,duke marrë si shkak “politikën shkombëtarizuese” që gjoja zbatonte qeveria shqiptare kundër minoritetit grek në Shqipëri.

402 “Bashkimi”, nr. 536, 18 shtator 1946.

403 Hysni Kapo, vep. e cit., f. 335.

Ramiz Alia lidhur me këtë, shumë vite pas tërheqjes së tij nga politika sqaron: Në Konferencën e Paqes në Paris (1946) delegacioni shqiptar nuk ka shtruar as çështjen e Kosovës dhe as të Çamërisë".<sup>404</sup> Pala jugosllave kritikonte inteligjencën shqiptare, e cila, sipas vëzhguesve diplomatikë jugosllavë në Tiranë "...anon të largohet, të ikë" nga Ballkani, që të injorohet realiteti ballkanik dhe të shkohet në Perëndim në perëndimin e kulturuar, solidar dhe miqësor... Nga ajo rrugë e "verbër" në "hunner", sipas vlerësimeve diplomatike, Shqipërinë objektivist e kishte shpëtuar fuqia e Jugosllavisë dhe përkrahja e saj".<sup>405</sup> Historiografia jugosllave pranonte se: "... Në ata muaj, Shqipërinë, në rend të parë, e ka mbajtur presioni i madh moralopolitiki Jugosllavisë dhe i mbarë bllokut demokratik, gjë që i kishte lidhur duart reaksionit që të mos ndërmerre përpjekje më agresive, sepse nuk e dintese si ishte raporti i forcave".<sup>406</sup> Në fakt, ka të ngjarë që në këtë periudhë edhe vetë Enver Hoxha, ndonëse dukshëm i idealizuar me përkrahjen dhe ndihmën jugosllave, ndihmën jugosllave ta ketë kuptuar dhe përjetuar edhe si presion jugosllav. Shumë vite më vonë, edhe pse mjaft kundërtënë, Enver Hoxha shkruante: "... Tamam në kohën kur ata publikonin me bujë njohjen e qeverisë sonë, të pavarësisë së Shqipërisë dhe të njësisë së saj të pacenueshme territoriale, në fshehtësi, në bisedat e rangeve të larta të udhëheqjes shtetërore e të partisë, thurnin planet për aneksimin e Shqipërisë dhe kthimin e saj në një republikë të shtatë të Jugosllavisë!"<sup>407</sup> Ishte e vërtetë se presioni i udhëheqjes jugosllave me Titon në krye, edhe drejtpërdrejt, edhe me anën e emisarëve të saj, sidomos në përmjet Velimi Stojniçit dhe Savo Zlatiçit, ishte i madh dhe i vazhdueshëm. Plenumi i 5-të i KQ të PKSH, mbajtur në shkurt të vitit 1946, shënon kthesën rrënjësore në kursin e ri të politikës së jashtë-

404 "Zëri", Prishtinë, 30 tetor 2001.

405 Branko Pribiqeviç, vep. e cit., f. 152.

406 Po aty.

407 Enver Hoxha, vep. e cit., f. 211.

me shqiptare ndaj bashkimit me Jugosllavinë. Presione të shumëfishta jugosllave po bënin efektet e tyre, dhe në këtë kuptim brenda radhëve të Byrosës KQ të PKSH dhe të vetë Komitetit Qendror po hapeshin fronti i luftës së brendshme politike fraksioniste. Kjo luftë politike, e cila do të merrte edhe koka njerëzish, ishte zhvilluar mbi dy konceptet e kundërta politike për thellimin e bashkëpunimit dhe nënshtrimit ndaj jugosllavëve dhe kursi tjetër që ishte për ruajtjen e pavarësisë politike të PKSH dhe të shtetit shqiptar në ndër-timin e shoqërisë së re. Gjenera e ndërhyrjeve jugosllave në veprimtarinë e PKSH dhe përgjithësisht në zhvillimet politike e ushtarake në Shqipëri, gjatë dhe pa smbarimit të Luftës së Dytë Botërore, duhet kërkuar qysh në mesin e vitit 1943 dhe në veçanti në gjysmëne dytë të vitit 1944. Në këtë kuptim: "PKJ është direkt e implikuar e edhe shkaktari kryesor i dy përçarjeve më të mëdha politike në Shqipëri gjatë viteve të Luftës së Dytë, me ndikim të madh në zhvillimin politik, jo vetëm të këtyre viteve, por edhe të pasluftës, në përçarjen midis PKSH dhe Balli tKombëtar dhe në përçarjen e madhe në vetë PK të Shqipërisë".<sup>408</sup> Ardhja e Velimir Stojniçit në Shqipëri dhe, më pas, e misionarit tjetër të PKJ, Savo Zlatiç, shënuan fazë të re në përpjekjet jugosllave për të nënshtruar udhëheqjen politike të PKSH, për të imponuar "modelin" dhe "përvojën" jugosllave në ndërtimin bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Ishte ajo kohë, kur Tito dhe PKJ po nxitonin të siguronin pozitën dominuese në përcaktimin e sferave të interesit në rajonin e Evropës Juglindore. Jugosllavët vlerësonin se me nënshtrimin e PKSH dhe e nxitjen e luftës politike dhe ushtarake përbrenda faktorit politik e ushtarak shqiptar, më lehtë e hiqnin nga rendi i ditës edhe çështjen e pazgjydhur të Kosovës dhe të shqiptarëve përgjithësisht në trojet e tyre etnike të mbetura në krijesën e federatës së re jugosllave. Prandaj, diplomacia jugosllave, përmes emisarëve

408 Fehmi Agani, Demokracia, kombi, vetvendosja, Pejë, 1944, f. 53.

të saj në Shqipëri, ngutej që sa më parë t'i bënte të qartë udhëheqjes shqiptare edhe çështjen e paprekshmërisë së kufijve të Jugosllavisë mbretërore. Kjo ndërhyrje e pashembullt e një partie ko-muniste fqinje ndaj një partie tjetër po ashtu komuniste dhe përgjithësisht ndaj zhvillimeve të brendshme të një shteti të pavarur bëri që, menjëherë pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, në frymën e ndërhyrjeve jugosllave edhe gjatë luftës, të hapeshin fronte të reja të luftësideologjike e politikë përbrenda protagonistëve kryesorë të forcave politike shqiptare. Me këtë lloj ndërhyrje të pashembullt të PKJ në zhvillimet e brendshme në PKSH, siç dokumentoi edhe Plenumi i 2-të i KQ të PKSH mbajtur në Berat, u instalua modeli i diferencimit mbi bazat ideologjike. Pra, në Shqipëri, në vitin 1945, po vendosej një atmosferë e patolerueshme politike, atmosferë, e cila legjitimoi fillimin e ndjekjeve dhe likuidimeve e fizike të kundërshtarëve politikë. Ai që nuk ishte me PKSH dhe programin e saj, pra, ai që nuk e përkrahte bashkëpunimin me Jugosllavinë deri në varësi të plotë, ai që mendonte politikisht ndryshe nga partia në pushtet, ai konsiderohej, jo vetëm armik politik, po edhe tradhtar i kombit dhe si i tillë duhej likuiduar. Në këtë atmosferë politike, të cilën e imponuan në radhë të parë jugosllavët, por me gabimet dhe nënshtrimin e prijësve të PKSH, forcat nacionaliste, demokratike dhe properëndimore shqiptare, jo vetëm në Shqipëri, pësuan më së keqi. Kosova ndërkaq në vitet e para të pasluftës po lihej në harresë e në vetmi për t'u vërsulur mbi të të papenguara forcat ushtarake jugosllave.

Plenumi i 5-të i KQ të PKSH, mbajtur më 21 shkurt 1946, paralajmëroi vijën e re politike të PKSH dhe të shtetit shqiptar që shpinte në drejtim të afrimit sa më të ngushtë me Jugosllavinë. Me këtë plenum, ku përfundimisht u mund vija demokratike që u munduan ta zbatonin Sejfulla Malëshova, Ymer Dishnica, Spiro Moisiu, Gjergj Kokoshi, Shefqet Beja, Riza Dani, Enver Sazani, Cen Elezi, Dom Luigj Pici e shumë

të tjerë, u inaugurua diktatura njëpartiake në Shqipëri dhe fillimi pa ekuivoqe i politikës së bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Tani më nuk ishte çështje vetëm e presioneve dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme jugosllave, por edhe e përcaktimit të vullnetshëm politik dhe shtetëror të udhëheqjes së PKSH dhe të qeverisë shqiptare. Enver Hoxha, në fjalimin e tij në Plenumin e 5-të të KQ të PKSH, paralajmëronte këtë kurs të ri politik: "...Të influencuar nga kjo tendencë oportuniste (e Sejfulla Malëshovës - A.Z.), nuk e kemi orientuar popullin tonë sa duhet drejt vëllazërimit e bashkimit të shëndoshë me Jugosllavinë që është një konditë e domosdoshme për ekzistencën e vendit tonë. Kjo, nga ana tjetër edhe shumë lëshime të tjera, i kanë dhënë shpresa dhe kanë inkurajuar borgjezinë reaksionare të përpiqet të orientojë marrëdhëniet tona ekonomikedrejt Perëndimit, në radhëtë parë drejtItalisë..."<sup>409</sup>

Enver Hoxha, i nxitur nga kritikrat e rrepta të emisarëve jugosllavë, shfrytëzonte rastin që t'i drejtohej me këtë mesazh popullit shqiptar: "... Për Jugosllavinë duhet të ngjallim në popull dashurinë dhe vëllazërimin që u lind në këtë luftë. Jugosllavia ka qenë përkrahësja e madhe dhe direkte në Luftën Nacionalçlirimtare. Ajo do të vazhdojë të jetë një nga ndihmëset më të mëdha të popullit tonë dhe të pushtetit. Duhet të luftojmë me mish e me shpirt tendencat shoviniste të atyre shqiptarëve që kërkojnë të ngjallin mërinë e vjetër kundër popujve të Jugosllavisë..."<sup>410</sup> Enver Hoxha e projektonte rolin e Shqipërisë ngjashëm me atë të Jugosllavisë në ndërtimin e raporteve midis shteteve komuniste, duke shtruar detyra edhe në planin e mbështetjes së BRSS: "...Të dy vendet tona duhet të jenë pararojë në Ballkan për të forcuar bllokun e madh të demokracisë përparimtare dhe të bëhenmbështetje gjallë për Bashkimin Sovjetik në këtë anë... Me Jugosllavinë

409 AQSH. F. 14, dos.1, v. 1946.

410 Po aty.



dhe Bullgarinë, ne duhet të kemi një vijë, si brenda, ashtu edhe jashtë... Ne duhet, gjithashtu, në çështjen e mbrojtjes nga armiqtë e jashtëm, si dhe ata të brendshëm, të arrijmë të kemi një pikëpamje të përbashkët, sepse armiqtë i kemi të përbashkët dhe të njëjtë. Një vijë e tillë politike... krijon mundësi për të realizuar një bashkim më të fuqishëm dhe më të përsosur, i cili do të jetë një bllok i fort për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik dhe të revolucionit".<sup>411</sup> Duke kritikuar orientimin e Sejfula Malëshovës që Shqipëria, në planin e marrëdhënieve tregtare me jashtë, të orientohet kah bashkëpunimi me shtetet perëndimore dhe në radhë të parë me Italinë, Enver Hoxha parashtronte udhëzime të reja në drejtim të bashkëpunimit me Jugo-sllavinë: "Me Jugosllavinë, ne duhet të kemi marrëdhënie ekonomike më të vendosura, më konkrete dhe më të ngushta dhe pa i konkretizuar këto marrëdhënie do të jetë gabim dhe marrëzi të kërkojmë treg je jashtë, si në Itali, Çekoslovakia e gjetkë... Forcimi i marrëdhënieve ekonomike e kulturore me Jugosllavinë janë aq të rëndësishme sa edhe koordinimi i politikës së jashtme dhe i mbrojtjes nga armiqtë e përbashkët. Kjo çështje është në rendin e ditës dhe pret vetëm një zgjidhje të drejtë nga ana jonë".<sup>412</sup> Në këtë frymë, në konkluzionet dhe vendimet e Plenumit të 5-të të KQ të PKSH ishte përcaktuar: "Të dërgohen jashtë, në Bashkimin Sovjetik dhe në Jugosllavi, në kurse specializimi dhe në universitete, kuadrot që premtojnë më tepër... Populli ynë duhet të kuptojë se ç'rrezik janë për vendin tonë imperialistët e huaj. Për këtë arsye partia duhet të zhvillojë urrejtjen kundër tyre. Nuk mund të jenë në radhë të partisë sonë ata që nuk e kuptojnë dhe nuk mobilizohen kundër këtij rreziku... Politika jonë duhet të orientohet nga Bashkimi Sovjetik. Populli ynë duhet ta kuptojë se Bashkimi Sovjeti kështë garancia më e madhe e

---

411 Po aty.

412 Po aty.

independencës dhe e pushtetit tonë popullor...”.<sup>413</sup> Një ndër konkluzionet e Plenumit të 5-të të KQ të PKSH ishte marrja e vendimit që, Kongresi i I i PKSH të thirret më 25 maj 1946. Mirëpo, shumë shpejt, me sugjerimin e udhëheqësve të PKJ, konkretisht të Titos, Kongresii I i PKSH ishte shtyrë për më vonë. Për këtë dëshmon telegrami i Nako Spiros, dërguar nga Beogradi, udhëheqjes së KQ të PKSH: “Jugosllavët janë të mendimit që ne ta shtyjme kongresin. Arsyet, thonë ata, janë: çështja e situatës, sidomos që jemi para Konferencës së Parisit, të shohim si do të vejë”.<sup>414</sup> Plenumi i jashtëzakonshëm i KQ të PKSH, mbajtur prej 18-20 dhjetor 1946, shënoi thellimin e kursit të politikës së jashtme shqiptare drejt ofrimit dhe bashkëpunimit sa më të ngushtë me Jugosllavinë. Ky plenum, i cili u mbajt pas Konferencës së Paqes në Paris, debatoi për rëndësinë politike dhe ekonomike të Konventës Ekonomike në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Duke mbajtur referatin kryesor në plenum, Enver Hoxha flet edhe për rolin e Kominternës në lidhje me detyrat e PKJ rreth zhvillimeve në Shqipëri dhe ndikimin e saj në PKSH: “Këto që ishin direktivat e pavdekshme të Kominternit, Partia jonë i bëri të sajat, ashtu si Partia Jugosllave... Partia shkoi në një binar me Partinë Jugosllave dhe populli shqiptar pa që në fillim te populli jugosllav atë popull që rroku armët dhe luftoi. Gjatë zhvillimit të marrëdhënieve në mes Partisë sonë dhe asaj jugosllave, këto u bënë marrëdhënie midis partish motra. Si Jugosllavia, si ne, kishim si dritë BS, d.m.th. të dyja partitë e orientuan dhe nuk gabuan vijën e tyre drejt BS”. Sekretari i përgjithshëm i PKSH kishte shpaluar një prej qëllimeve kryesore të programit të PKSH, marrjen e pushtetit: “Partia jonë e mori pushtetin. Kjo është gjëja kryesore, që pushteti politik është në duart e Partisë sonë”.<sup>415</sup> I gjetur nën trys-

---

413 PPSH, Dokumente kryesore I, Tiranë, 1960, f. 276.

414 AQSH. F. 14/AP, dosja 7, v. 1946

415 AQSH. F. 14/AP, dos.4, v. 1946.

ninë jugosllave, por edhe për t'u imponuar me orientimin proforcimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, Enver Hoxha gjatë referatit të para-shtruar në Plenumin e 5-të i ekspozoi pikëpamjet e veta edhe në lidhje me Kosovën. Paraqitj e tij rreth çështjes së Kosovës ishte në frymën e marrëveshjeve bilaterale me udhëheqësit jugosllavë, marrëveshje kjo e konfirmuar në bisedimet me rastin e vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi, në qershor-korrik 1946. Rreth kësaj teme ai ishte i prerë dhe nuk linte hapësirë për diskutim apo dialog: "Disa anëtarë partie që duan të filozofojnë thonë se mos kërkojë popullit ç'bëhet me Kosovën. Në rast se një anëtar partie e ka të qartë vijën, ai e ka të qartë edhe çështjen e Kosovës. Jugosllavia demokratike është më e avancuar, më e përparuar se ne. Interesi ynë është që ajo të jetë e fortë, se me një Jugosllavi të fortë do të ketë demokraci në Ballkan. A është në interesintonë të kërkojmë Kosovën? Kjo nuk është progresiste".<sup>416</sup> Enver Hoxha theksonte: "Pra, në këtë situatë, përkundrazi, duhet të bëjmë ç'është e mundur që kosovarët të vëllazërohen me jugosllavët... Kur ne të arrijmë në socializëm, që do të thotë kur atje dhe këtu mbeturinat e kapitalizmit të kenë ngrënë dru, ahëre, në një situatë të tillë, Kosova do të bashkohet me Republikën Socialiste të Shqipërisë, atëherë Kosova do të bashkohet. Kjo është vija, këtë na e mëson marksizmi... Populli i Kosovës i ka të gjitha liritë".<sup>417</sup> Nako Spiru, në Plenumin e 5-të të KQ të PKSH, duke ekspozuar planin e zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik me Jugosllavinë, që kanë një bashkim ekonomik, kishte paralajmëruar hartimin e planit ekonomik në bashkëpunim me ekspertët jugosllavë: "Ne mendojmë për hartimin e planit bashkë me Jugosllavinë".<sup>418</sup> Ndërkaq, folësi Niko Opari, në diskutimin e tij në plenum, pasi kishte veçuar gjendjen e rëndë ekonomike-sociale të sh-

---

416 Po aty.

417 Po aty.

418 Po aty.

tresave të gjëra popullore, kishte vlerësuar: "... Gjendja jonë ekonomike ka bërë që populli të preokupohet për bukën. Kur nga akordi vjen buka, kjo i pëlqen atij, është i inkurajuar dhe thotë: tani siguruam punët, rroftë Jugosllavia...".<sup>419</sup> Në Rezolucionin e Plenumit të Jashtëzakonshëm të KQ të PKSH, mbajtur prej 18-20 dhjetor 1946, vlerësohej se duheshin zbatuar detyrat që dilnin nga Konventa Ekonomike e nënshkruar në Beograd, më 27 nëntor 1946, në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë.

Në të njëjtin muaj, pra, dhjetor 1946, Enver Hoxha i shkruante një letër Titos në lidhje me ushtrinë dhe çështjet ushtarake. Enver Hoxha i drejtohej Titos me kërkesën që të merrte nga ai këshilla lidhur me disa probleme, veçanërisht me ushtrinë shqiptare dhe veprimet e planet që planifikoheshin për vitin 1947. Komandanti i forcave të armatosura shqiptare i bënte të ditur Titos se Ushtria Kombëtare Shqiptare: "...Ka një forcë komplekse prej 4.415 vetash (sic.-A.Z.), duke përfshirë prej kësaj shume forcat e policisë. Kjo shumë përbëhet prej 2.927 oficerësh, 5.321 nënoficerësh, 34.937 ushtarësh, si dhe 800 nxënësish ushtarakë. Në shumën e lartpërmendur përfshihet edhe Divizioni I Mbrojtës i Popullit, i cili ka një efekti vprej 8.710 vetash. Me këtë Divizion të Mbrojtjes, forca efektive e ushtrisë operative është 35.305 veta. Nga kjo forcë kemi 27.611 si trupë, përbërja e së cilës është organizuar dhe çrregullt... Efektivi i vitit 1947 do të ketë 2.000 veta më pak se ai i vitit 1946".<sup>420</sup> Kjo linte të kuptohej se Ushtria Kombëtare e Shqipërisë, kompleksivisht, me gjithë Divizionin e Mbrojtjes së Popullit, në shkurt të vitit 1947, do të kishte një forcë prej 42.000 vetash me gjithë oficerë dhe nënoficerë, duke mos marrë parasysh në atë numër forcat e policisë. Por, Enver Hoxha, në letrën dërguar Titos ngrinte shqetësimin e mbajtjes së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare. Duke qenë

---

419 Po aty.

420 AQSH. F. 14/AP, dos. 5, v. 1946.

i vetëdijshëm për vështirësitë ekonomike dhe buxhetore për mbajtjen e efektivit prej 42.000 ushtarësh, Enver Hoxha i drejtohej Titos me kërkesën për ndihmë: “Për këtë problem të rëndësishëm të ushtrisë sonë ne jemi të bindur se ju, shoku Marshall, do të mendoni dhe të kujdeseni njësoj si edhe për ushtrinë tuaj dhe e dimë fare mirë se një zgjidhjee kësaj çështjengaanee juajdo të jetëajomë e drejta, pse bëhet në interesin e përbashkët të popujve tanë vëllezër... vendimet dhe këshillatuaaja për këtë problemtë ushtrisësonë na shërbejnë si drejtim dhe orientimi punës sonë me ushtrinë”.<sup>421</sup> Në përgjigjen e datës 9 janar 1947, Tito e njoftonte Enver Hoxhën se për të gjitha çështjet ka biseduar me shefin e Shtabit të Ushtrisë Kombëtare, Mehmet Shehun, dhe se ai “për të gjitha të tjerat do t’ju informojë me hollësi...”.<sup>422</sup> Çështja e strukturimit të brendshëm të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare ishte aktuale dhe temë diskutimi, në fillim të vitit 1947, edhe në nivelet më të larta të Ushtrisë Kombëtare të Shqipërisë. Në strukturat më të larta të ushtrisë shqiptare paraqiteshin dy koncepte rreth zhvillimit të saj. Në lidhje me këto dy prirje të ndryshme të zhvillimit dhe perspektivës së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare dëshmonte edhe përmbajtja e letrës që, më 25 prill 1947, Pëllumb Dishnica, shef i Seksionit të Agjitpropit të Drejtorisë Politike ia dërgonte Enver Hoxhës. Ishte e qartë se në këtë periudhë kishte mosmarrëveshje konceptuale dhe strategjike rreth zhvillimit të ushtrisë ndërmjet Shtatmadhorisë dhe Drejtorisë Politike të Ushtrisë Shqiptare. Mehmet Shehu mbronte vijën e ruajtjes së pavarësisë së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, kurse Enver Hoxha angazhohej për konceptin e bashkimit të ushtrisë shqiptare me atë jugosllave. Pëllumb Dishnica, duke e njoftuar Enver Hoxhën me përmbajtjen e bisedës me Mehmet Shehun, shkruante: “... Në lidhje me zhvillimin e armëve të ndryshme si xhenioja,

---

421 Po aty.

422 AQU, F.Shtatmadhoria, dos. 82, v 1947.

ndërlidhja, aviacioni, tanket, marina, që ngrihet në tezat e paraqitura, mua më duket se nuk mund të mendojmë pavarësisht nga ushtria jugosllave, ashtusi nuk mund të mendojmë për një plan veprimi në rast lufte, qoftë për mbrojtjen e bregdetit, qoftë për mbrojtjen e kufijve tanë të jugut, pavarësisht nga ushtria jugosllave...Në përfundim del çështja që ne në zhvillimin e ushtrisë sonë duhet të kemi parasysh që të shkojmë paralel, në të njëjtën rrugë, ku shkon Ushtria Jugosllave dhe se zhvillimi i ushtrisë sonë nuk mund të shtrohet i ndarë nga zhvillimi i Ushtrisë Jugosllave".<sup>423</sup> Nënkolonel Dishnica, i cili ishte ithtar i bashkimit të dy ushtrive, me ç'rast do të humbte identitetin e vet Ushtria Kombëtare Shqiptare, konfirmonte: "... Që kur u bë organizimi i Drejtorisë Politike dhe i gjithë Partisë në ushtri, u mor për bazë organizimi në Ushtrinë Jugosllave. Gjithashtu, që nga ajo kohë e deri më sot, Drejtoria Politike, në të gjitha punët e saja... për programet dhe metodat e punës, është bazuar në instruksionet dhenë udhëzimet që ka nxjerrë Drejtoria Politike e Ushtrisë Jugosllave. Për këtë ka marrë aprovimin nga Komiteti Qendror dhe për shumë prej tyre, edhe nga ju vetë personalisht".<sup>424</sup> Ai më pas i përkujtonte Enver Hoxhës: "...As nga ju personalisht, as nga Komiteti Qendror nuk na është bërë ndonjë vërejtje në këtë drejtim".<sup>425</sup> Ai, gjithashtu, e përforconte pozicionin probashkimit me ushtrinë jugosllave duke iu referuar qëndrimeve të KQ të PKSH, në lidhje me bashkëpunimin me Jugosllavinë, duke konkluduar: "Nëqoftëse e kam kuptuar mirë vijën e Komitetit Qendror, më duket se thotë që të jemi sa më afër dhe të lidhemi sa më ngushtë me Jugosllavinë në të gjitha fushat".<sup>426</sup> Prandaj, ai i propozonte Enver Hoxhës që: "Në zhvillimin e ushtrisë sonë, veçanërisht në zhvillimin e armëve të aviacionit e të marinës, ne nuk mund të mendojmë pavarë-

423 Po aty.

424 Po aty.

425 Po aty.

426 Po aty.

sisht, por në lidhje të ngushtë me ushtrinë Jugosllave; Shtatmadhoria, ashtu si Drejtoria Politike, të bazohet më shumë më tepër sesa është bazuar deri më tani në organizimin, programimin, rregulloret etj. të Ushtrisë Jugosllave... ”.<sup>427</sup>

Pra, qeveria jugosllave dhe udhëheqja e PKJ, pasi siguruan dominimin e tyre në marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me Shqipërinë, më tej kishte synuar bashkimin e dy ushtrive. Ky ishte hapi tjetër që do të shpinte kah futja e Shqipërisë në Federatën Jugosllave. Armata Shqiptare, qysh nga viti 1945, ndërtohej dhe zhvillohej mbi modelin jugosllav, prandaj, jugosllavët vlerësonin se kishte ardhur çasti që ajo të shkrihej krejtësisht dhe pa pengesa në gjirin e ushtrisë jugosllave. Dihet se një ndër ata që kundërshtuan unifikimin e të dy ushtrive, sipas diktatit dhe modelit jugosllav, ishte shefi i shtabit të Ushtrisë Shqiptare, Mehmet Shehu. Ai kishte kundërshtuar përcaktimin për shkrirjen e dy ushtrive dhe insistonte në ruajtjen e identitetit të Ushtrisë Shqiptare. “Pikërisht për prirjen e zhvillimit të Ushtrisë Shqiptare në mënyrë të pavarur nga Ushtria Jugosllave, Mehmet Shehu, në fund të vitit 1947, u shkarkua nga detyra e shefit të Shtatmadhorisë dhe u përjashtua nga KQ i PK në Plenumin e 8-të në shkurtmars 1948. Vetëm pas prishjes me jugosllavët, në Plenumin e 11-të të KQ e në Kongresin I të PK, kur E. Hoxha, për qëllimet që dihen, ngriti flamurin kundër titizmit, duke e rehabilituar N. Spiron e M. Shehun me shokë, formuloi, midis tjerash, edhe padinë kundër Drejtorisë Politike dhe përkatësisht kundër P. Dishnicës për marrjene përvojës jugosllave në zhvillimin e Ushtrisë Shqiptare.”<sup>428</sup>

Me gjithë përparimin e konsiderueshëm të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, thajse në të gjitha fushat e jetës ekonomike, diplomatike, kulturore, arsimore, ushtarake, e deri te ato në sferën e shëndetësisë, udhëheqja jugosllave e shtyrë

---

427 Po aty.

428 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, (Dokumente) Tiranë, 1996, f. 90.

nga agresiviteti i logjikës së dominimit të plotë, nuk ishte e kënaqur dhe shfaqte brengosje për shkallën dhe shpejtësinë e realizimit të marrëveshjeve ndërshtetërore. Kështu, nuk vonoi dhe në fund të qershorit të vitit 1947, Savo Zlatiç, emisar jugosllav në Shqipëri, i cili kishte arritur që të merrte pjesë edhe në seanca të mbyllura të Byrosë Politike të KQ të PKSH, në një bisedë me Enver Hoxhën kishte ngritur shqetësimet për moszbatimin efikas të marrëveshjeve shqiptaro-jugosllave. Paraprakisht: “Në qershor të po atij viti, Tito, përmes një letre, akuzoi ashpër partinë shqiptare dhe fajësoi Enver Hoxhën përnxitje të prirjeve armiqësore ndaj Jugosllavisë dhe për orientim anti-jugosllav të politikës shqiptare”<sup>429</sup>. Enver Hoxha, në kujtimet e veta lidhur me këto zhvillime, që paralajmëronin luftën e madhe politike midis udhëheqjes së PKSH dhe të PKJ, shkruante: “Goditjen e re, që njihet në histori si akuza e parë e Titos kundër Partisë sonë, udhëheqja jugosllave e drejtojnë fundtë qershorit 1947, nëpërmjet të dërguarit të saj kryesor në Shqipëri, famëkeqit Savo Zlatiç”.<sup>430</sup> Emisari jugosllav kritikonte KQ të PKSH për gjoja ekzistencën brenda tij të dy vijave të kundërta në platformën e bashkëpunimit me Jugosllavinë. Në lidhje me këto akuza, të cilat pala jugosllave ende po i paralajmëronte vetëm në formë të bisedave gojore me udhëheqësit shqiptarë, Enver Hoxha kishte takuar me Savo Zlatiçin, më 4 dhe 6 korrik 1947. Në bisedimet me Enver Hoxhën, emisari jugosllav kishte insistuar në konstatimin se në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave po kristalizohehin dy rryma. Enver Hoxha, gjatë bisedimeve, i ishte drejtuar Savo Zlatiçit me fjalët: “Domethënë, del se te ne qenka një vijë “projugosllave” dhe një “antijugosllave”! Enver Hoxha, duke raportuar në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, në korrik 1947, emisarit jugosllav i kishte thënë: “... Në rast se këto gabime kanë degjeneruar në shtrem-

429 Georges Herman Hodos, “Koha Ditore”, Prishtinë, 20 tetor 2001.

430 Enver Hoxha, Titistët, f. 304.



bërim vije, detyra jonë është të japim alarmin dhe t'i themi kësaj ndal dhe në qoftë se këto janë gabime të rënda, të marrim masa të rënda. Çështja është t'i sqarojmë në frymën më të drejtë komuniste... Mund të ketë çdo gjë tjetër, dhe ka, por jo një vijë të dytë".<sup>431</sup> Gjithnjë sipas shënimeve të Enver Hoxhës, del se Savo Zlatiç ishte këmbëngulës në padinë jugosllave ndaj udhëheqjes shtetërore e partiake të Shqipërisë në lidhje me ngadalësimin e procesit të realizimit të marrëveshjeve, gjë që, sipas emisarit jugosllav, kishte mundësuar krijimin e vijës së dytë përbrenda PKSH, e cila synonte bllokimin e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Prandaj, nga biseda midis Enver Hoxhës dhe Savo Zlatiçit kishte dalë konkluzioni i këtyre detyrave konkrete:

- Luftë kundëravashllëkut.
- Të drejtohet në mënyrë operative.
- Sqarimesa më tepër kuadrove, mundtë sqarohen edhe në çështje më konkrete.
- Bashkëpunim sa më të ngushtë në mes jugosllavëve dhe shqiptarëve në zbatimin e vendimeve të KQ tona"<sup>432</sup>

Ishte e qartë se padia jugosllave kundër PKSH, e paraqitur nga Savo Zlatiçi, shënonte presion shtesë për zbatimin e shpejtuar të Konventës Ekonomike dhe të protokolleve përkatëse jugosllavo-shqiptare, të nënshkruaramë 27 nëntor 1946, që thënë ndryshe ishin një konkretizim i vijës së dy partive komuniste për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Fillimisht, Enver Hoxha tregojë i përmbajtur në pranimin e akuzës jugosllave për një vijë të dytë anti-jugosllave përbrenda radhëve të Byrosë Politike të PKSH. Mirëpo, presioni jugosllavi ngritur qëllimisht mbi udhëheqjen e PKSH me akuzën e vazhdueshme dhe shumë agresive për

---

431 AQSH, Fondi 14/AP, dos. 3, v. 1946.

432 AQSH, F.14/AP, dos. 3, v. 1947.

ekzistencën e një vije të dytë në udhëheqjen e PKSH, përse u përket marrëdhënieve me Jugosllavinë, nuk pushoi dhe, nga fundi i nëntorit të vitit 1947, dha rezultatet konkrete në tërheqjen e udhëheqjes së PKSH dhe në pranimin pa të drejtë të një vije tjetër brenda radhëve të saj. Kjo i mundësoi PKJ që përbrenda udhëheqjes më të lartë të PKSH të instalonte logjikën e fraksioneve dhe përçarjeve të mëdha. Dominimi jugosllav mbi udhëheqjen e PKSH sa po vinte e po bëhej më i pambrojtur, deri në nivelin e nënshtrimit të PKSH ndaj PKJ dhe direktivave të saj për zhvillimet në Shqipëri.

Sidoqoftë, vizita e Enver Hoxhës në BRSS dhe takimet me Stalinin ngritën shqetësime plotësuese të pala jugosllave për perspektivat e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe, në radhë të parë, për zbatimin e marrëveshjeve ekonomike dhe të tjera. Udhëheqja jugosllave kishte arsye të shqetësohej me këtë vizitë edhe për faktin se kështu po krijoheshin hapësira të reja për ndërhyrjen sovjetike në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Kjo linte të nënkuptohej se udhëheqja sovjetike, konkretisht Stalini, mund të ushtronte kontrollin e vet në këtomarrëdhënie në rast se vlerësonte se pala jugosllave rrezikonte interesat sovjetike në rajon, konkretisht në Shqipëri. Por, nga viti 1944, kishin kaluar plot tre vjet dhe shumëçka kishte ndryshuar në raportet brenda shteteve socialiste, konkretisht, në përcaktimin e sferave të reja të interesit gjeostrategjik edhe në Evropën Juglindore. Në këtë kuptim, BRSS, në mesin e vitit 1947, për shkak të ndërhyrjeve gjithnjë e më të hapura të jugosllavëve në zhvillimet e shtetit shqiptar i shihte të rrezikuara interesat e saj gjeostrategjike në Shqipëri. "Deri atë kohë Bashkimi Sovjetik nuk kishte treguar thujt fare interes për problemin shqiptar. Këtë vend ai u kishte lënë jugosllavëve. Indiferenca fillestare mospërfillëse e Stalinit mund të ketë qenë vërtet e sigurtë. Në këtë mënyrë, Stalini përpiqej të acaronte luftën për pushtet midis Xoxes dhe Enver Hoxhës. Marrëdhëniet midis dy vendeve u ten-

dosën edhe më shumë në prill të vitit 1947, kur u nis për në Beograd një delegacion ekonomik shqiptar nën udhëheqjen e Nako Spiros, i cili duhej të kërkonte shtimin e ndihmave dhe përfundimin e një marrëveshjeje të re tregtare”.<sup>433</sup> Prandaj, ftesa e Stalinit drejtuar Enver Hoxhës që të takoheshin në Moskë, ishte e mirëpritur për të dy burrështetasit. Në këtë mënyrë, Enver Hoxhës i jepej rasti që së paku përkohësisht të çlirohej nga presionet dhe ndërhyrjet e vazhdueshme jugosllave, kurse Stalini, i cili disa herë më parë e kishte refuzuar kërkesën e Enver Hoxhës për t’u takuar, në korrikun e vitit 1947, gjatë bisedimeve me Enver Hoxhën indirekt i bëri me dije udhëheqjes jugosllave se megjithatë ekzistonte kufiri i ndërhyrjeve jugosllave në Shqipëri. Stalini, përmes këtij takimi linte të kuptohej, si te Beogradi zyrtar, ashtu edhe te udhëheqja shqiptare, se në lojën diplomatike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisëka vend edhe për BRSS.

Në takimin Tito-Stalin, mbajtur më 9 qershor në Moskë, ky i fundit e kishte pyetur udhëheqësin e PKJ se a e njihje Enver Hoxhën. Tito i ishte përgjigjur: “... Nuk e kam parë Enver Hoxhën, është njeri i ri, por gjatë luftës është bërë i popullarizuar... Përgjithësisht njerëzit në udhëheqjen e Partisë shqiptare janë të rinj. Sa dimë ne, nuk ka probleme të theksuara ndërmjet tyre... Ata kanë kërkuar të vijnë këtu, por nuk duan ta lëshojnë Enverin vetëm, por me të dëshiron të vijë edhe Koçi Xoxe, si një kontroll. Ne vazhdimisht e shtyjmë ardhjen e tyre”.<sup>434</sup> Stalini e kishte pyetur Titon se a do të duhej t’i pranonte udhëheqësit shqiptarë në Moskë, duke sugjeruar qëllimisht dhe plot me dinakëri se më mirë do të ishte që udhëheqja sovjetike t’i ndihmonte përmes jugosllavëve. Megjithatë, Stalini kishte konkluduar gjatë takimit se diçka nuk është në rregull në Polit byronë Shqiptare. Aleksandër

---

433 Georges Herman Hodos, “Koha Ditore”, 20 tetor 2001.

434 Vladimir Dedijer, Novi prilozhi za autobiografiju Josipa Broza Tita, 1, Rijeka, 1980, f. 418.

Rankoviçi, duke u inkuadruar në bisedën për çështjen e zhvillimeve përbrenda PKSH, kishte thënë se: “Nuk ka probleme të mëdha, pos asaj që shokët nga Polit byroja Shqiptare nuk e mendojnë Enver Hoxhën aktualisht mjaft të zotin, prandaj gjithnjë kërkojnë që së bashku me të të shkojë edhe Koçi Xoxe, si anëtar më i vjetër i Partisë. Në plenumin e prillit e kanë diskutuar çështjen e linjës, në veçanti lidhur me raportet me Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik dhe kanë konstatuar disa gabime dhe, si bartës të këtyre gabimeve, kanë përjashtuar nga polit byroja Sejfulla Malëshovën. Prej atëherë udhëheqja është më kompakte”.<sup>435</sup> Tito kishte thënë: “Ne ato çështje mund t’i zgjidhim së bashku me ata”.<sup>436</sup> Stalini, që në takimet e para me udhëheqjen jugosllave, dëshmonte një interesim më të theksuar përzhvillimet në Shqipëri dhe sidomos për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. “Shihej se ishte i informuar ndoshta edhe më mirë se udhëheqja jonë, edhe përkundër fqinjësisë sonë dhe lidhjeve më të mira me Shqipërinë. Ai interesohej detajisht për personalitetet dhe zhvillimet politike në udhëheqjen shqiptare”.<sup>437</sup> Takimin e udhëheqjes sovjetike dhe asaj jugosllave, në qershor të vitit 1946, dhe ngritjen e çështjes së Shqipërisë nga ana e Stalinit, Gjilasi e shpjegonte me vlerësimin: “Ajo bisedë për Shqipërinë nuk ishte aspak e rastësishme, kurse unë mendoj se në mendjen e Stalinit që atëherë formësohej ideja për nënshtrimin e Jugosllavisë: pikërisht Shqipëria dhe mosmarrëveshje te jugosllavëve me sovjetët do t’i shërbejnë Stalinit, në fillim të vitit 1948, si shkasi më i mirë për sulm ndaj Jugosllavisë... Afrimi i Shqipërisë me Jugosllavinë ishte kurth i Stalinit”.<sup>438</sup> Zhvillimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, udhëheqja sovjetike e përcillte me qëndrim kritik. Nuk kishte pasur takim sovjetiko-jugosllav, qysh nga viti 1945-1948, në të cilin nuk

435 Po aty, f. 418.

436 Po aty.

437 Milovan Gjillas, Vlast i pobuna, Beograd, 1991, f. 90.

438 Po aty, f. 91.

ishite shtruar edhe çështja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe e zhvillimeve brenda PKSH. Nga fundi i vitit 1947, kishte mbërritur de pesha, në të cilën Stalini kërkonte që Milovan Gjlasi ose dikush nga udhëheqja më e lartë jugosllave të udhëtonte në BRSS për të diskutuar qëndrimin e dy qeverive ndaj Shqipërisë. Me të arritur në Moskë, më 10 janar 1948, Stalini kishte pranuar delegacionin jugosllav, të cilit i printe Milovan Gjlasi. Pasi u kishte përkujtuar fillimisht vetvrasjen e Nako Spirus, Stalini papritmas kishte deklaruar: “Nenuk kemikurrfarëinteresashtëveçantanëShqipëri. Ne pajtohemi që Jugosllavia ta gëlltisë Shqipërinë!”<sup>439</sup> Gjlasi kishte reaguar duke thënë: “Nuk është fjalapërgëlltitje, por përbashkim”. Kurse Molotov kishte reaguar me cinizëm të zakonit rus: “Pikërisht kjo është gëlltitje!”<sup>440</sup> Stalini kishte përsëritur: “Po, po gëlltitje! Por ne me këtë pajtohemi: ju duhet ta gëlltisni sa më parë Shqipërinë”.<sup>441</sup> Pastaj, diskutimi ishte shtruar rreth personalitetit të Enver Hoxhës, për të cilin, siç evokon Milovan Gjlasi, Stalini kishte dhënë të njëjtin vlerësim: “Ai është mikroborgjez, i afërt me nacionalizmin. Po, edhe ne ashtu mendojmë. Si duket Xoxe atje është njeriu më i fortë”. Vlerësimet dhe pikëpamjet e Stalinit për udhëheqjen e PKSH kishin hapur dilema të Gjilasi, i cili pranonte: “E para, kishte të bënte me atë se diçka nuk është në rregull me politikën jugosllavë ndaj Shqipërisë, kurse e dyta kishte të bënte me mendimin e Bashkimit Sovjetik bashkoi shtetet baltike duke i gëlltitur vërejtja e Molotovit drejtpërdrejt sugjeronte këtë”.<sup>442</sup>

Gjatë qëndrimit të tij të parë në BRSS, nga 12-26 korrik 1947, Enver Hoxha dhe anëtarët tjerë të delegacionit shqiptar kishin zhvilluar takime edhe me Stalinin. Nga libri i kujtimeve të Enver Hoxhës del se në takimin e parë kryesisht janë diskutuar zhvillimet në rajon dhe pozicionimi i Shqipërisë

439 Po aty, f/ 128.

440 Po aty.

441 Po aty.

442 Milovan Gjlasi, Razgovori sa Staljinom, Beograd, 1990, f. 94.

ndaj tyre. Duke folur për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, Stalini, pasi e kishte pyetur Enver Hoxhën se a ishte i kënaqur populli shqiptar nga marrëdhëniet me Jugosllavinë, kishte thënë: “Është një gjë shumë e mirë që ju keni Jugosllavinë mike në kufi, se Shqipëria është një vend i vogël dhe si i tillë ka nevojë edhe për një mbështetje të fortë nga miqtë e saj”.<sup>443</sup> Ndërkaq, sipas shënimeve stenografike nga mbledhja e Polit byrosë të KQ të PKSH, në të cilën Enver Hoxha kishte referuar për përmbajtjen e bisedimeve, dëshmon se temë qendrore ishte ndihma ekonomike e BRSS për Shqipërinë. Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike kishte deklaruar: “... Biseduam me Stalinin dhe u vendos që të na jepet një kredi 8 milionëshe dhe të paguajnë 4.000.000 brenda dhjetë vjetëve. Do të dërgojmë 73 nxënës në shkollat ushtarake të B.S. dhe do të na dërgojnë afro 20 instruktorë... Veç këtyre, u firmos një marrëveshje ekonomike. Kredia që na jepet është 6.000.000 dollarë: dy fabrika tekstili, një fabrikë lëkurash, një fabrikë sheqeri, 200 traktorë etj. Kredia do të paguhet brenda shtatë vjetëve, duke filluar pas vitit të katërt. Kredia do të paguhet në bakër, naftë, bitum, lëkura ose devize. Çmimet do të jenë ndërkombëtare. Kamata do të jetë 3%”.<sup>444</sup> Në bisedën me Enver Hoxhën, Stalini kishte shpjeguar arsyet pse ndihma sovjetike duhej të shkonte në Shqipëri përmes Jugosllavisë: “Ne nuk mund t’ju ndihmojmë dot drejtpërdrejt. Ndihamat tona ne do t’ju japim nëpërmjet Jugosllavisë, sepse po t’ju japim drejtpërdrejt dhe po të marrin vesh për këtë anglo-amerikanët, atëherë ata do të përpiqen të bëjnë pengesa. Po ndihamat do të vijnë nëpërmjet Jugosllavisë”.<sup>445</sup>

Enver Hoxha ishte kthyer më i qetë nga vizita në BRSS dhe takimet që kishte pasur me udhëheqjen sovjetike, sepse kësaj radhe ai kishte arritur që të krijonte afërsi politike me

---

443 Enver Hoxha, Me Stalinin (Kujtime) ,Tiranë, 1979, f. 70.

444 “Zëri”, Prishtinë, 23 tetor 2001.

445 AQSH, F. 14/ AP, dos I, v. 1947.

Stalinin që në ato vitet e stuhishme, gjithsesi, së paku dhe drejtpërdrejtë, Enver Hoxhës i garantonte mbrojtje nga kritikat dhe vërsuljet e vazhdueshme jugosllave. Nga ana tjetër, Tito po bëhej gjithnjë e më nervoz dhe kërkonte që Koçi Xoxe të ishte më aktiv në realizimin e planeve për realizimin e marrëveshjeve të nënshkruara ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që shënonin edhe një hap kah bashkimi i dy shteteve. Tito, po ashtu, ndjehej i shqetësuar për rolin gjithnjë e më aktiv të Stalinin në lidhje me zhvillimet në Shqipëri dhe përpjekjet e shtuara për t'i kontrolluar, sa të ishte e mundur, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Koçi Xoxe, i cili kishte pasur rolin kryesor në eliminimin e vijës së moderuar partiake me në krye Sejfulla Malëshovën, e parandiente se po vinteçastii tij përveprim. Enver Hoxha, ndonëse edhe vetë me orientim pro jugosllav, e hetonte trimërimin e Koçi Xoxes dhe dalja hapur e jugosllavëve në anën e Xoxes, Hoxhës i krijoi më në fund bindjen se Titoja e kishte nisur betejën vendimtare për të shtënë nën kontroll të plotë udhëheqjen e PKSH. Megjithatë, në udhëheqjen e PKSH ende po përviroheshin dy fraksione, njëri që synonte ruajtjen, po aq sa ishte e mundur, të pavarësisë në raport me jugosllavët, të cilit i printe Enver Hoxha, dhe tjetri që kërkonte shpejtimin e bashkimit të dy shteteve, të cilit i printe Koçi Xoxe. I gjetur në pozitë skajshmërisht të pafavorshme, për arsye të krijimit të lidhjeve të drejtpërdrejta të Enver Hoxhës me Stalinin, Tito u detyrua të kalojë në ofensivë politike duke i shpeshtuar presionet mbi udhëheqjen e PKSH dhe kështu i bëri padi të reja drejtpërdrejt Enver Hoxhës për vonesa të qëllimshme në realizimin e marrëveshjeve të nënshkruara midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Tito e parandiente se po i rrezikohesh privilegji i kontrollit mbi Shqipërinë. Prandaj, në nëntor të vitit 1947, Tito e bëri padinë e dytë brenda vitit kundër udhëheqjes së PKSH, duke hedhur tërë fajësinë mbi palën shqiptare për mos zbatimin e marrëveshjeve ndërshtetërore.

Vërejtjet e Titos ndaj KQ të PKSH dhe personalisht ndaj Enver Hoxhës, këtij të fundit, ia kishte transmetuar gojarisht Savo Zlatiçi, në bisedën më 6, 7, 8 dhe deri më 18 nëntor 1947. Në bisedime herëpashërë kishte marrë pjesë edhe Koçi Xoxe, i cili i kishte përkthyer bisedimet. Nga shënimet e datës 8 nëntor 1947, prej bisedës me Savo Zlatiçin, të përpunuara nga Enver Hoxha, del se kritikën jugosllave konsistonin në një varg pikash rreth çështjeve të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të atyre viteve. Zlatiç kishte konstatuar me atë rast se ato marrëdhënie sipas jugosllavëve: "...Nuk janë të qarta në vend që të jenë të ngushta. Konstatohet një rënie e dobët në lidhjet tona, sidomos në ekonomi... Duhet të themi se njerëzit shqiptarë nuk përftojnë dhe nuk e marrin ndihmën e jugosllavëve dhe ka njerëz që kanë frikë nga ky bashkëpunim. Kemi përshtypjen që, në vend të përpjekjeve të përbashkëta për të kapërcyer pengesën, të disa shokë shqiptarë ka një qëndrim jokonstruktiv".<sup>446</sup> Zlatiç kishte kritikuar edhe nivelin e dobët të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav në lëmin e kulturës, duke cilësuar: "Ne s'jemi të kënaqur me këto marrëdhënie, të cilat janë shumë të këqija dhe ne ngremë pyetje se armiku këtë do dhe ai është i kënaqur".<sup>447</sup> Zlatiç, duke shtruar çështjen e fajtorit dhe përgjegjësit për mosrealizimin e marrëveshjeve ndërshtetërore, akuzat i kishte drejtuar te udhëheqja shqiptare, pra drejtpërdrejt te Enver Hoxha, i cili sipas padisë së dytë jugosllave bëhej edhe më përgjegjës për këto lëshime dhe dështime: "Ne këto duhet t'i kërkojmë në politikën që bën qeveria shqiptare dhe organet e saj karshi Jugosllavisë. Një politikë e tillë veçanërisht ka ardhur në sektorin ekonomik, ku orientimi komplet është në kundërshtim plotësisht diametral me bazën e vijës që është përcaktuar në mes dy vendeve".<sup>448</sup> Akuzat e Zlatiçit shkonin edhe deri në

---

446 AQSH, F. 14/ AP, dos. 3, v. 1947.

447 Po aty.

448 Po aty.



konkludimin se te kuadro të caktuara shqiptare ka edhe disponim dhe qëndrim antijugosllav: “Në Shqipëri ekziston një vijë, një qëndrim, një orientim që nuk është i pajtueshëm me atë që është vendosur në plenumin e gjerë të dhjetorit (1946). Ekziston një orientim, i cili shikon ndarje në atë që e shikon qeveria jugosllave dhe populli jugosllav karshi Shqipërisë. Nuk është çudi që ky qëndrim u reflektohet aktivistëve shqiptarë nga njerëz me pozita mjaft të rëndësishme dhe këta, në bazë të kësaj, shpesh herë në punën e përditshme mbajnë një qëndrim antijugosllav”.<sup>449</sup> Pasi kishte shfaqur dyshimet se për të gjitha këto vonesa të qëllimta nga pala shqiptare në realizimin e marrëveshjeve ndërshtetërore mund të qëndronte në prapaskenë edhe “politika e ndonjë organi të qeverisë që ashpëron, kërcënon marrëdhëniet tona”,<sup>450</sup> Zlatiç shtrinte dyshime te tij në radhët të parë tek Nako Spiru, të cilin e akuzonte për “... një rol të çuditshëm që lot...”. “Ne na duket se, shoku Nako Spiru dëshiron në këtë gjë orientimin anti jugosllav dhe është mbrojtës i këtij orientimi. Ai, Fadil Paçrami, e të tjerë, sigurisht sipas mendimit tonë, kanë luajtur një rol të dukshëm në dobësimin e marrëdhënieve në mes nesh”.<sup>451</sup> Kështu, emisari jugosllav po paralajmëronte se Nako Spiru ishte në shënjestër të kritikave jugosllave, mirëpo nuk do të vononte, dhe, shefi i planifikimit do të akuzohej rëndë edhe nga udhëheqja e Byrosë Politike e KQ të PKSH si bartës dhe realizatori vijës antijugosllave. Emisari jugosllav në Shqipëri, Savo Zlatiç, e kishte kushtëzuar vazhdimin e bashkëpunimit të mëtejshëm midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë me kushtin e rishikimit të dobësive, gabimeve dhe bllokadave nga ana e Byrosë Politike të KQ të PKSH ndaj marrëveshjeve ekonomike, tregtare dhe të tjera me Jugosllavinë dhe marrjen e masave të menjëhershme ndaj atyre kuadrove shqiptare që

---

449 Po aty.

450 Po aty.

451 Po aty.

ishin përgjegjës për krijimin e vijës antijugosllave: “Konstatohet pamundësia e vazhdimet të punës në bazat e tanishme, veçanërisht në disa qëndrime të disa organeve shqiptare... duhet punuar për një rishikim të ri të përgjithshëm të të gjitha akordeve tona ekonomike”.<sup>452</sup>

Udhëheqja më e lartë e PKSHT ishte përballur me një fushatë të re jugosllave. Gjithsesi e shtrënguar, por edhe e frikësuar nga kritikrat e rreptatë PKJ, ajo, dhe, në radhë të parë, Enver Hoxha po kërkonin rrugët e shtegdaljes me sa më pak pasoja si në raportet ndërshtetërore, por edhe për ruajtjen e pozicioneve politike në hierarkinë partiake dhe shtetërore. Sulmi jugosllav thuhet se ishte frontal dhe parimisht nuk e përjashtonte askënd nga përgjegjësia dhe konsekuencat e mundshme. Enver Hoxha, edhe pse gjatë vizitës në BRSS, tre muaj më parë, e kishte krijuar mundësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me Stalinin, pra edhe favoret e mundshme që mund t'i siguronin ajo lidhje dhe bashkëpunim, ende nuk kishte marrë guximin që t'i kundërvihet sulmit jugosllav. Prandaj, vetëm dhjetë ditë pas bisedimeve me Savo Zlatiçin, Enver Hoxha kishte thirrur mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSHT, e cila në fakt çoi në vetë-vrasjen e Nako Spirus. Pika e vetme e rendit të ditës të mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSHT, mbajtur më 1 nëntor 1947, ishte marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Enver Hoxha, në fjalën e hapjes, pa ndonjë shpjegim të veçantë, kishte lexuar tekstin e bisedimeve me Savo Zlatiçin. Koçi Xoxe në ndërhyrjen e parë të shkurtër kishte thënë: “...Duhet të bëhet një rishikim i gjithë marrëdhënieve tona. KQ Jugosllav do të kërkojë që ta sqarojë këtë çështje”.<sup>453</sup> Enver Hoxha, pasi kishte pranuar se vija e PKSHT çoi në rezultatet diametralisht të kundërta në marrëdhëniet me Jugosllavinë, më pas me vetë kritikë të pashembullt kishte konstatuar: “Qëndrimi ynë tregon qëndrimin antiju-

---

452 Po aty.

453 AQSH, F.14/AP,dos. 33, v. 1947.

gosllav dhe këtë duhet ta shikojmë se mos ka gisht armiku...".<sup>454</sup> Koçi Xoxe, në paraqitjen e tij të dytë, kishte akuzuar drejtpërdrejtë Nako Spirun, si përgjegjës për vijën e dytë brenda PKSH ndaj Jugosllavisë: "Duhet shikuar se cilat janë shkaqet që mbërritëm në këtë gjendje dhe pse Nakoja i ka dhënë këtë frymë".<sup>455</sup> Kristo Themelko, që në historinë politike të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave njihet si bashkëmendimtar i Koçi Xoxes, kishte vlerësuar: "Shumë herë është biseduar këtu dhe është shfaqur mosbesim ndaj Jugosllavisë në lidhje me furnizimet përhekurdhën. Nga këto gjëra ka mbërritur puna që ne të kemi pasur një urrejtje për jugosllavët që gjenden këtu... Nuk përjashtohet që në këto çështje të jetë gishti i armikut. Ne kemi heshtur kur teknikët shqiptarë kanë folur kundër Jugosllavisë... Orientimi ka qenë kundër teknikëve jugosllavë, si të pavlefshëm. Duke folur shumë për Bashkimin Sovjetik dhe teknikët sovjetikë, kemi krijuar një përbuzje karshi Jugosllavisë dhe jugosllavëve dhe jemi shkëputur prej tyre, këtu ka qenë dhe qëllimi i armikut".<sup>456</sup> Kristo Themelko kishte akuzuar edhe Mehmet Shehun për inaktivitet në zbatimin e marrëveshjeve shqiptaro-jugosllave në fushën e integritimeve të ushtrisë: "Ne kemi insistuar që edhe në anën ushtarake të dy shtatmadhoritë të veprojnë sikurse në sektorin politik të ushtrisë. Këtëj kuptohet se nuk ka pasur frymë të shëndoshë, derisa Mehmeti nuk ka pasur kontakt fare me jugosllavët që janë këtu dhe i shikon me përbuzje".<sup>457</sup> Nako Spiru, i gjetur përballë akuzave të rënda që i bënte Kristo Themelko, kishte kundërshtuar duke kërkuar t'i jepej afat që të përgatiste mbrojtjen e tij. Enver Hoxha i kishte lejuar Nako Spirun që të mos fliste në mbledhjen datës 18 nëntor dhe të përgatitej për seancën tjetër të thirrur më 19 nëntor 1947. Mirëpo, me të filluar mbledhja e Byrosë Politike të KQ

454 Po aty.

455 Po aty.

456 Po aty.

457 Po aty.

të PKSH, më 19 nëntor, Nako Spiru sërish kishte kërkuar që atij t'i lejoheshin 4-5 ditë për t'u përgatitur, sepse, siç kishte thënë ishte i papërgatitur. Ishte e qartë se Nako Spiru po kërkonte shpëtim nga situata shumë e rëndëpër të. Duke i ditur korrespondencat e tij me emisarin sovjetik në Shqipëri, Çuvajski, është e mundur që Spiru të jetë përpjekur të sigurojë mbështetjen e sovjetikëve në lidhje me akuzat jugosllave dhe ato në Byronë Politiketë KQ të PKSH. Anëtarë te Byrosë Politike nuk kishin pranuar që mbledhja të shtyhej sërish, por kishin kërkuar që Nako Spiru të paraqiste pikë-pamjete tij lidhur me akuzat që i rëndonin. Për ngadalësimin veçmas të marrëveshjes shqiptaro-jugosllave për ekonominë, Pandi Kristo kishte akuzuar Nako Spirun: "Nakoja di të flasë, por nuk do të flasë dhe, kështu, ai ka një qëllim".<sup>458</sup> Koçi Xoxe, madje, kishte kërkuar që: "të mos i jepet asnjë afat... Nakoja u trembet gabimeve... Nakoja do të fshehë të vërtetën".<sup>459</sup> Kështu, Nako Spiru refuzoi të flasë në mbledhjen e 19 nëntorit. Byroja bëri përjashtim dhe i dha afat Nako Spiritut edhe 24 orë të tjera. Të nesërmen, Nako Spiru kishte shkuar paradite te Enver Hoxha dhe sërish kishte kërkuar që t'i lejohej përgatitja për mbrojtje edhe për 4-5 ditë, për ç'ka Enver Hoxha kishte refuzuar. Të njëjtën ditë, pra 20 nëntor 1947, pak minuta para orës 20.00, kur ishte caktuar të fillonte vazhdimi i mbledhjes së ndërprerë, Nako Spiru ishte vetëvrapur.

Që pala jugosllave përzihej në punët e brendshme të shtetit shqiptar, por që edhe vetë udhëheqës të caktuar të PKSH kërkonin mendimin dhe gjykimine jugosllavëve për shumë çështje të rëndësishme, dëshmon edhe telegrami, të cilin Savo Zlatiç ia kishte dërguar Aleksandër Rankoviçit, në lidhje me rastin e vetëvrasjes së Nako Spiritut dhe pjesëmarrjen e udhëheqësve shqiptarë në varrimin e tij, më 21 tetor 1947: "Nako Spiru është vra duke lozur me revole. KQ i

---

458 Po aty.

459 Po aty.

Shqipërisëpyet a duhet të lajmërohet kjo si vrasje apo si rast fatkeq. Nga kjo varet edhe organizimi i funeralit. Unë kam propozuar që kjo të shpallet si rast fatkeq. Ata, megjithatë, mendojnë se plenumi i KQ dhe disa anëtarë të KQ duhet të lajmërohen për situatën. Dërgojeni mendimin tuaj gjatë kësaj nate. Nëse pajtoheni që kjo të trajtohet plotësisht si rast fatkeq me funeral përkatës, më lajmëroni menjëherë me telefon nëpërmes legatës. Shqiptarët presin që brenda natës t'ju komunikoni mendimin tuaj".<sup>460</sup> Savo Zlatiç kishte kërkuar që jugosllavët, drejtpërdrejt përmes Rankoviçit, të lajmërojnë se a duhet të merrte pjesë në ceremoninë e varrimit të Nako Spirus personalisht Enver Hoxha apo jo, sepse këtë përgjigje e prisnin udhëheqësi tshqiptarë.

Jugosllavët, të entuziazmuar për gatishmërinë e udhëheqjes të PKSH që të pranonte pa kundërshtime presionet, ultimatimet dhe paditë që vinin në adresë të udhëheqjes shqiptare nga PKJ, i kishin dhënë udhëzime të reja emisarit të tyre në Shqipëri, Savo Zlatiç, në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Qëllimi kryesor i jugosllavëve, në fund të vitit 1947 dhe në prag të vitit 1948, nuk ishte vetëm shtyrja përpara e proceseve që shpinin në bashkimin e dy shteteve. Më 5 dhjetor 1947, në bisedën e Savo Zlatiçit me Enver Hoxhën, ata, pra jugosllavët me në krye Titon dhe Rankoviçin, kishin ndërmarrë ofensivën e re diplomatike përmes të cilës parashtronin kërkesa të shtuara dhe ultimative. Ishte kjo periudha kur udhëheqja e PKSH, pra edhe Enver Hoxha, po i nënshtrohej plotësisht diktatit jugosllav. Në të njëjtën kohë, ai ishte nën presione të fuqishme edhe nga opozita politike e cila ishte krijuar në Byronë Politike, e të cilësi printe, si në Parti, në organet e Punëve të Brendshme, ashtu edhe në politikën e jashtme, Koçi Xoxe. Nga tezat politike të paraqitura nga Savo Zlatiç në bisedë me Enver Hoxhën, më 5 dhjetor 1947, shihej: "Tok do të mbrojmë Frontin e Jugut, bashkë-

<sup>460</sup> Branko Petranoviç, vep. e cit., f. 167.

punimi ynë ushtarak duhet të shtrohet në këtë vijë... Ndihma jugosllave do të jetë më e madhe, por ne mendojmë që do t'ia arrijmë qëllimit, kur të bëjmë një bashkime konomik... Sido bëjmë mëtej, do bëjmë një shtet, etj. Në këto baza praktikisht federata (dotë ngrihet) në radhë të parë nëse ktorët ekonomikë".<sup>461</sup> Byroja Politike e KQ të PKSH, më 7 dhjetor 1947, kishte hedhur në shqyrtim te zate parashtruara nga Savo Zlatiç gjatë bisedës me Enver Hoxhën, në temën e aspektit aktual dhe të perspektivës së marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Enver Hoxha, duke informuar udhëheqjen më të lartë të PKSH për bisedimet me Savo Zlatiçin dhe qëndrimet e shtruara nga ai në emër të KQ të PKJ, kishte deklaruar se:

1. Afrimi dhe bashkëpunimi që të mbërrijmë në vëllazërim e bashkim të popujve tanë dhe me popujt e tjerë, si me popullin bullgar;

2. Duke e parë kështu bashkëpunimin në politikën e brendshme, të tillë do të jemi edhe në politikën e jashtme, do të kemi një politikë të njëjtë, të fortë e të lidhur kundër imperialistëve dhe nxitësve të luftës. Të gjitha qëndrimet me jashtë duhet të karakterizohen nga një politikë e tillë. Në sektorin ushtarak, ne do të jemi bashkë dhe do të mbrojmë Frontin e Jugut të tre vendeve, duke vepruar bashkarisht".<sup>462</sup>

Enver Hoxha, jo vetëm nga bindja e tij, por edhe nën tryshninë dhe kërkesat jugosllave, vinte në pah se bashkëpunimi deri në bashkim në fushën e ekonomive ndër shtetërore ishte çështje e rëndësisë parësore: "Ndihma e Jugosllavisë themi që do të jetë më e madhe, por përpjekjete të dyja palëve do të na çojnë në një bashkim ekonomik. Komiteti Qendror Jugosllav mendon se me luftën e përbashkët për ngritjen e ekonomive tona, lidhjet tona duhet të bëhen të forta e shumë të ngushta ... Pa bashkimin e ekonomive tona, do të ngjal-

---

461 AQSH, F. 14/AP, dos. 3, v. 1947.

462 Po aty.

len të tilla tendenca autarkike".<sup>463</sup> Savo Zlatiç, duke marrë pjesë në diskutim, fillimisht kishte sqaruar: "Sido të bëjmë më vonë, a do të bashkohemi në një shtet të vetëm, kjo do të vijë nga vullneti i popullit, i Partisë dhe i Komitetit Qendror Shqiptar. Por rruga është kjo që do t'i çojë popujt tanë në një bashkim të tillë federativ. Në kuadrot e ulëta të mos merret ndihma jugosllave si presion. Për Bullgarinë mund të thuhet se mund të rrojë edhe vetëm, kurse për Shqipërinë jo. Edhe kjo nuk është presion që i bëhet Shqipërisë, por se kështu është e vërteta, kështu ja në konditat".<sup>464</sup>

Zlatiç, pasi kishte konstatuar se mbi bazat federative duhet të konkretizoheshin marrëdhëniet ekonomike midis dy shteteve fqinje, kishte konkretizuar detyra në drejtim të bashkimit të dy shteteve. Ndër to, ai kishte veçuar unifikimin e monedhës, planifikimin e përbashkët sa më të ngushtë sipas metodës jugosllave, shtimin e marrëdhënieve tregtare, përparimin e bashkëpunimit në fushën e shoqërive të përbashkëta etj. Mirëpo Zlatiç kishte urdhëruar që: "Këshilltarët sovjetikë nuk mund të bëjnë projekte përveç me këtë planifikim, me këtë metodologji dhe këtë emërtim të jugosllavëve. Prandaj sovjetikëve kjo t'u bëhet e qartë".<sup>465</sup> Duke riaktualizuar kredinë prej 21 miliardë dinarësh që Jugosllavia kishte premtuar se do t'ia jepte Shqipërisë, emisari jugosllav kishte shprehur habinë e tij se kushe ka dhënë atë shifër joreale: "... Asnjë prej shokëve në KQ nuk merr përsipër ta ketë thënë një gjë të tillë. Projekt plani ynë kishte parashikuar 12-13 miliardë. Seriozisht nuk di nga kanë dalë këto 21 miliardë".<sup>466</sup> Koçi Xoxe, i cili, falë përkrahjes jugosllavee ndjente se po i forcoheshin pozicionet, edhe në këtë mbledhje si objektiv kryesor parashtronte bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë mbi bazat e federatës së përbashkët, qoftë me Bullgarinë ose edhe

463 Po aty.

464 AQSH, F. 14/AP, dos. 40, v. 1947.

465 Po aty

466 Po aty.

pa të: "Puna në baza federative është ajo punë që shikon të bëhet bashkërisht për ngritjen e ekonomisë së përbashkët. Kështu shpjegohet edhe bashkëpunimi në ushtri, kombinimi i përbashkët dhe mbrojtja e përbashkët që të mund të mbërrimë në një komandë të përbashkët dhe në një shtatmadhori të përbashkët, kur të mbërrimë edhe shtetin e përbashkët".<sup>467</sup> Por Koçi Xoxe ishte prerë ndaj atyre që deri atëherë kishin vonuar procesin e bashkimit ekonomik, ushtarak e kulturor midis dy shteteve, aq më tepër ndaj atyre që e kontestonin qëndrimin paternalist të Jugosllavisë ndaj Shqipërisë dhe impononte modelin jugosllav për të gjitha fushat e zhvillimit në shoqërinë shqiptare. Nga foltorja e Byrosë Politike të KQ të PKSH, Koçi Xoxe paralajmëronte: "Rreziku më i madh vjen nga ata që nuk do të pranojnë bashkëpunimin mbi baza socialiste, internacionale me anë të një bashkimi midis nesh... Vija e re duhet të përcaktohet duke dënuar dhe demaskuar frymën e vjetër në marrëdhëniet mes Jugosllavisë, atë punë që shfaqej në lidhje me këto marrëdhënie".<sup>468</sup> Por ai nuk mjaftohej vetëm me kaq, prandaj duke shtruar detyra të reja para anëtarësisë partiake dhe përgjithësisht banorëve, angazhohej: "Popullarizimi i Jugosllavisë, si një shtet i fortë dhe i Titos, vendosja e flamurit jugosllav bashkë me tonin, si edhe i udhëheqësve, popullarizimi i rëndësisës Jugosllavisë që populli shqiptarta kuptojë këtë rëndësi, që ai të ketë një afrim dhe vëllazërim me gjithë elementin jugosllav, të ketë një afrim familjar me të. Këto ne nuk i kemi bërë deri tashti. Me personelin jugosllav në Shqipëri të bëjmë një jetë intime vëllazërore".<sup>469</sup> Në këtë frymë ishte zhvilluar edhe takimi i fshehtë, më 12 dhjetor 1947, midis Titos dhe delegacionit shqiptar që kryesohej nga Enver Hoxha, gjatë udhëtimit për në Bullgari. Enver Hoxha, duke referuar për këtë takim në

---

467 Po aty.

468 Po aty.

469 Po aty.



mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 23 dhjetor 1947, kishte konfirmuar se gjatë bisedës u prek tema e bashkëpunimit të mëtejshëm midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë: “Marshalli tha se, natyrisht, ekonomia e Shqipërisë duhet të shkojë e koordinuar me ekonominë e Jugosllavisë. Shqipëria nuk mund të shkojë në mënyrë independente për zhvillimin e ekonomisë së saj... Jugosllavia nuk mund të na ndihmojë ashtu si mendonte N. Spiru, nuk mund të jetë e të zhvillohet sipas dëshirës së shqiptarëve... Ne gëzohemi, tha Tito, që KQ i PKSH e ka parë mirë vijën që duhet ndjekur”.<sup>470</sup> Në dhjetor të vitit 1947, me porosi të Titos dhe të Enver Hoxhës, Shtatmadhuria Shqiptare dhe Shtatmadhuria Jugosllave, pas largimit të Mehmet Shehut nga detyra e shefit të Shtatmadhorisë Shqiptare, hartuan një prememorie për bashkimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave. Ndër pikat kryesore që përmbante ky dokument ishin:

1. Të kalojmë sa më parë në unifikimin e Ushtrisë Shqiptare me Ushtrinë Jugosllave:

a) unifikimi i sistemit dhe i formave të organizimit; b) unifikimi i armatimit dhe i furnizimit;

c) unifikimi i sistemit dhe i metodës së stërvitjes së reparteve dhe i përgatitjes së shtabeve;

d) unifikimi i normave të jetesës së ushtrisë;

e) unifikimi i sistemit të evidencave dhe të administratës, si edhe unifikimi i metodës së drejtimit të ushtrisë.

2. Të vendoset kontakti direkt dhe i vazhdueshëm midis shtatmadhorive dhe reparteve të tyre në mënyrë reciproke, në mënyrë të tillë që të bëhet i mundshëm unifikimi i të gjithë sistemit të punës së ushtrisë sonë me ushtrinë e Jugosllavisë...

3. Të përcaktohet organizimi unik i njësisë, reparteve dhe stabilimenteve për kohë lufte...

<sup>470</sup> AQSH, F. 14/AP, dos. 40, v. 1947.

4. Në kohë lufte, Ushtria Shqiptare duhet të veprojë në të njëjtat kondita sikurse çdo armatë tjetër e Ushtrisë Jugosllave, duke u inkuadruar në njërin nga frontet e Ushtrisë Jugosllave dhe duke vepruar me të njëjtin plan operativ;

5. Gjatë vitit 1948, të përpunohet plani operativ i mbrojtjes së Shqipërisë së bashku me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave...

6. Përgatitja e oficerëve nëpër shkollat ushtarake të Jugosllavisë dhe të Bashkimit Sovjetik për oficerët shqiptarë, njësoj sikur bëhet për oficerët jugosllavë. Në Shqipëri nuk do të krijohen shkolla ushtarake, mbasi na intereson që oficerët të përgatiten në Jugosllavi...

7. Buxheti i të dy ushtrivedo të bëhet i përbashkët...".<sup>471</sup>

Padia e dytë jugosllave e paraqitur përmes Savo Zlatiçit, që akuzonte se përbrenda PKSH po kristalizohej "një vijë e dytë antijugosllave", drejtpërdrejt atribuohej Nako Spirus së vetëvrarë. Enver Hoxha, i nxitur edhe nga Koçi Xoxe, kishte caktuar mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH për të diskutuar nga themeli zhvillimet që sollën deri te paraqitja e "vijës antijugosllave" përbrenda radhëve të udhëheqjes së PKSH. Mbledhja e Byrosë Politike me këtë temë kishte filluar më 24 dhjetor dhe me ndërprerje kishte vazhduar deri më 23 janar 1948. Nga përmbajtja e stenogramave të këtyre mbledhjeve maratonike që ishin përcjellë me diskutime të zjarrta dhe akuza nga më të rëndat për Nako Spirun, tanimë të pajetë, del se qëllimi kryesor i ideatorëve të platformës së mbledhjes së ftuar, ishte të hapnin frontin e ri politik për demaskimin e vijës, në fakt të paqenë, në udhëheqjen më të lartë të PKSH. Por, mbledhja njëherit provoi të forconte pozicionin edhe të Enver Hoxhës që shquhej me projugosllavizëm. Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe ishin fitimtarët më të mëdhenj dhe kryesorë në këto përplasje të mëdha politike. Kjo ndodhi kështu, sepse Enver Hoxha, duke anatemuar Nako Spirun

471 Arkivi Qendror i Ushtrisë, F. Shtatmadhuria, dos. 42, v. 1947.

edhe për së vdekuri dhe duke e kualifikuar si armik të interesave të kombitvetëm pse kishte kërkuar qasje racionale, të bazuar në interesat kombëtare, në raport me marrëdhëniet me Jugosllavinë, në fakt po mbronte pozitën e tij të luhatur nga kritika jugosllave dhe e grupit të Koçi Xoxes. Koçi Xoxe, ndonëse nuk ishte lider i PKSH, po ashtu, dilte fitimtar në tërë këtë betejë të rëndë politike për udhëheqjen e PKSH, sepse para jugosllavëve po dëshmohej se, në çastet vendimtare, ai ishte njeriu i cili i zbatonte me saktësi planet jugosllave për bashkimin e dy shteteve. Me këtë, Xoxe imponohej, jo vetëm para faktorit jugosllav, por edhe para udhëheqjes së PKSH, si personi kyç në gjithë zhvillimet politike. Enver Hoxha, i cili që nga fjalja e parë në fjalimin hyrës në mbledhjen Byrosë Politike të KQ të PKSH, po tregohej i pamëshirshëm ndaj Nako Spirus, tërhoqi vërejtjen për krijimin e vijës anti-jugosllave në radhët e partisë, duke identifikuar shkaqet dhe burimet e kësaj vije: "...Është krijuar një front antijugosllav dhe se plani është i real dhe jo i drejtë, plani nuk është bërë në frymën e duhur sipas marrëveshjeve midis të dy KQ të partive. KQJ thekson se qëndrimi i popullit është ndryshe nga qëndrimi i qeverisë ndaj Jugosllavisë. Politika e qeverisë ndryshon ndaj Jugosllavisë. Gjithashtu, marrëdhëniet nuk janë keqësuar vetëm në ekonomi, por edhe në kulturë, etj. Ata theksuan se këtu duhet të jetë gishti i armikut dhe një rol të çuditshëmka lozur Nako Spiru dhe Fadil Paçrami".<sup>472</sup> Ai kishte kritikuar sidomos planin një vjeçar ekonomik të Shqipërisë, të cilin e kishte hartuar Nako Spiru me bashkëpunëtorë: "Ne e kemi studiuar dhe e kemi gjetur se plani ynë është përgatituri ndarë nga Jugosllavia"<sup>473</sup>. Koçi Xoxe, i cili njihej si kundërshtar i rreptë i Nako Spirus, në paraqitjen e tij në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, të datës 1 janar 1948, kishte kritikuar Mehmet Shehun për qëndrimin e

472 AQSH, F. 14/AP, dos. 52, v. 1947.

473 Po aty.

tij oportunist ndaj bashkimit të dy ushtrive, asaj shqiptare me atë jugosllave: “Edhe në këtë sektor është ndjekur nga Mehmeti një vijë shumë e gabuar e ngjashme me atë të Nakos, e cila duket në dy drejtime: 1) Në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë, d.m.th me planin e bashkëpunimit me Jugosllavinë që nuk është parëdrejt, por me qëllim të caktuar, shkëputjen, independencën, kryelartësinë; dhe 2) në lidhje me politikën e brendshme në ushtri. Ashtusi Nakoja në lidhje me Partinë, në tërë sektorët kishte dalë duke sulmuar, duke e goditur Partinë. Ashtu si Nakoja që dilte për të marrë pushtetin, po ashtu edhe Mehmeti atë donte në ushtri”.<sup>474</sup> Mehmet Shehu ishte gjetur në thumb të kritikës për orientim antijugosllav, veçmas në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 8 janar 1948, ku temë qendrore e diskutimit ishte çështja në Ushtrinë Shqiptare. Kristo Themelko, bashkëpunëtor i ngushtë i Koçi Xoxes, e kishte kritikuar Mehmet Shehun se më tepër kishte dëshmuar simpati për modelin sovjetik në Ushtrinë Shqiptare sesa për atë jugosllav: “Është mbërritur të kërkojmë dhe instruktorë politikë në ushtri nga sovjetët. Kjo gjë tregon tendencën e shkëputjes nga Jugosllavia. Një gjë tjetër është te Mehmeti, qëndrimi i ftohtë ndaj jugosllavëve, Mehmeti nuk ka dashur të shkonte në Jugosllavi... Kjo tregon se Mehmeti nuk ka pikëpamjetë drejta mbi bashkëpunimin me Jugosllavinë”<sup>475</sup>. Koçi Xoxe, në kritikatkundër Mehmet Shehut, ishte edhe më i drejtpërdrejtë: “Duke analizuar kështu, Byroja sheh në radhë të parë se Mehmeti nuk i jep garancitë për të qëndruar në ushtri: pikëpamjet e tij në lidhje me bashkëpunimin me Jugosllavinë dhe me gjithë vijën e Partisë nuk janë të drejta; unë e përforcoj se ai nuk i ka të gjitha garancitë të qëndrojnë në ushtri... Në këtë situatë, kur bëhet unifikimi i ushtrisë për një front të vetëm në të gjithë Ballkanin, Mehmeti nuk mund të qëndrojë

474 AQSH, F. 14/AP, dos. 52/1, v. 1948.

475 Po aty.

në ushtri".<sup>476</sup> I gjetur përballë kritikave të rrepta në Byronë Politike, Mehmet Shehu, në mbrojtjen e tij kishte nënvizuar: "Tashti i kuptoj ndryshe marrëdhëniet me Jugosllavinë, që është një bashkim dhe jo një lidhje, si e kemi pasur deri tashti... Që unë të kem pasur frymë antijugosllave, frymë borgjeze, si thotë Koçi, fryma e Nako Spirut, unë këtë nuk e pranoj... Unë mund të pranoj që jam ngatërrestar, egoist, grindavec, por nuk mund të pranoj të jem antijugosllav".<sup>477</sup> Duke parë se nuk ka përkrahje dhe se është i vetmuar në qëndrimin për ruajtjen sadopak të pavarësisë së Ushtrisë Shqiptare, Mehmet Shehu ishte detyruar që të tërhiqej dhe të pranonte: "... Garantoj se nuk jam kundër Jugosllavisë, nuk jam kundër bashkimit të ushtrisë sonë me atë jugosllave. Unë kam punuar dhe punoj për këtë, unë them se nuk kam qenë për përçarje me Jugosllavinë, nuk jam antiparti".<sup>478</sup> Por, megjithatë, nuk kishte pranuar konkluzione për fajësinë e tij: "Unë them se konkluzioni që unë të jem me frymë antijugosllave dhe se unë nuk jami zoti të realizoj vijën e Partisë në ushtri, nuk e pranoj".<sup>479</sup>

Ndërkohë, më 19 janar 1947, Aleksandër Rankoviçi, ministëri Punëve të Brendshme të Jugosllavisë, i njohur për veprimet hakmarrëse ndaj shqiptarëve të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, i kishte dërguar Koçi Xoxes një letër me shifër tepër sekret, në të cilën e njoftonte për përgatitjet e qeverisë greke që të sulmojë Shqipërinë. Në letër konfirmohet: "Në Qeverinë Greke bëhen diskutime për sulmin mbi Shqipërinë. Duke qenë se kohët e fundit bëhet një propagandë e madhe, sidomos kundër jush, nuk përjashtohet që kjo bandë, e ndihmuar nga amerikanët, të mendojë edhe për provokacione të hapta. Në kufi duhen mbikëqyrur lëvizjet

---

476 AQSH, F. 14/AP, d. 53, v. 1948.

477 Po aty.

478 Po aty.

479 Po aty.

e ushtrisë monarko-fashiste në afërsi të kufirit tuaj”.<sup>480</sup> Kjo shkresë, vetëm shtatë ditë më pas, do të shfrytëzohej nga udhëheqja jugosllavesi pretekst që të kërkojnë një bazë ushtarake në Korçë dhe vendosjen aty të një divizioni jugosllav. Byroja Politike e KQ të PKSH, edhe në mbledhjen e datës 22 janar 1947, kishte vazhduar të shqyrtonte marrëdhëniet midis PKSH dhe PKJ, por kësaj radhe po kristalizohej platforma politike, e cila do të shtrohej në Plenumin e 8-të të KQ të PKSH. Koçi Xoxe, tanimë i trimëruar me atmosferën projugosllave në Byronë Politike, e përcaktonte rrjedhën e diskutimeve dhe të konkluzioneve në temën e kritikës së rrugës së deri atëherëshme të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe në përcaktimin e perspektivave në këtë plan. “Në momentin e sotëm, kështu duhet ta përcaktojmë bashkëpunimin. Marrëdhëniet ekonomike, kulturore, ushtarake, etj., do të na çojnë si dy popuj drejt bashkimit, drejt socializmit. Përsa i përket formës, shtet federalose tjetër, kjo është një çështje tjetër. Kjo është çështje e Stalinit, e kampit anti imperialist... nesër në një shtet, në një konfederatë, andej do të shkojmë”.<sup>481</sup> Enver Hoxha, dukshëm nën ndikimin jo vetëm të presioneve dhe diktateve jugosllave, vazhdoi ta përkrahte platformën e tij duke konstatuar: “Unë kam thënë se edhe Partia duhet të shkojë në baza federale, pse e gjithë kjo vijë që shtrojmë atje çon... Ato që thashë e them prapë se të gjithë sektorët të shkojnë në atë rrugë, me baza federale, duke qenë kështu Sekretar i Përgjithshëm, Titoja. Kështu vendi do të shkojë në një federatë”.<sup>482</sup> Del se Enver Hoxha ishte i gatshëm që të dorëzonte detyrën e sekretarit të përgjithshëm të PKSH dhe të pranonte që në federatën eventuale midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë, Tito të ishte udhëheqësi i Partisë dhe i federatës. Më 26 janar 1948, Titoi kishte dërguar letër

480 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1945-1948, (Dokumente), Tiranë, 1996, f. 200.

481 AQSH, F. 14/AP, dos. 53, v. 1948.

482 Po aty.

Enver Hoxhës, ku i kërkonte një bazë ushtarake në Korçë, si dhe vendosjen aty të një divizioni jugosllav. Tito, pasi i bënte të ditur Enver Hoxhës se në bisedën që kishte pasur me Beqir Ballukun, shëf i Shtatmadhorisë të Ushtrisë Shqiptare, kishte diskutuar me hollësi për situatën në kufirin jugor Shqipëri-Greqi, më tej kishte kaluar në propozimin konkret: “Pikërisht për shkaktë një situatetë tillë të paqartë, unë Ju jam lutur që të na jepni bazën në Korçë për një divizion me njësi ndihmëse teknike. Në këtë mënyrë, Juve do tu krijohet mundësia që sektorin në këtë drejtim të detit ta siguronit më mirë dhe në rast provokacionesh, njësitë tona mund të ndërhyjnë shpejt. Të gjitha këto përgatitje, mendoj, duhet të realizohen në mënyrë të qetë dhe pa u kuptuar, që në popull të mos krijohen shqetësime”.<sup>483</sup> Tito, gjithashtu, sugjeronte që të pranohej propozimii tij edhe për faktin se, sipas udhëheqjes së PKJ: “Kjo gjë do të tregojë se aleanca jonë nuk është një çështje formale, porse jemi të vendosur definitivisht t’i mbrojmë së bashku kufijtë tanë”.<sup>484</sup>

Kjo ishte pika kthesë që detyroi edhe BRSS të intervenojë, si te pala jugosllave, ashtu edhe te ajo shqiptare. Qeveria sovjetike kishte informacione të plota rreth zhvillimeve në Shqipëri dhe veprimtarisë së emisarëve jugosllavë. Misioni sovjetik diplomatik dhe ai ushtarak në Tiranë, në fund të vitit 1947 dhe fillim të vitit 1948, po bëhej gjith një e më i madh, duke sjellë nga Moska ekspertë të fushave të ndryshme. Marrëdhëniet midis Jugosllavisë dhe BRSS, në lidhje me Shqipërinë dhe nivelin e ndërhyrjeve të të dyja palëve në të, po bëheshin shkaspër acarim të marrëdhënieve. Megjithatë, “... Duhet thënë se, edhe qeveria jugosllave nuk e kishte konsultuar atë sovjetike për detajet e politikës së vet”.<sup>485</sup> Krahas këtyre ndarjeve ndërmjet qeverisë sovjetike dhe asaj jugosllave,

---

483 AQSH, F. 14/AP, dos. 3, v. 1948.

484 Po aty, f. 402.

485 Milovan Gijlas, vep. e cit., f. 88.

gjithnjë e më e theksuar ishte tendenca e Moskës që të zinte vendin e Jugosllavisë në Shqipëri, gjë që jugosllavëve ju dukej krejtësisht e padrejtë, për arsye se nuk ishte Shqipëria që duhej të bashkohej me BRSS, e as që ishte me të në fqinjësi të drejtpërdrejtë. Në të njëjtën kohë, ishte gjithnjë e më i theksuar orientimi i udhëheqjes shqiptare kah Bashkimi Sovjetik, çështje kjo e cila reflektohej gjithnjë e më dukshëm edhe në propagandën e tyre".<sup>486</sup> Në janar të vitit 1948, në adresë të KQ të PKJ kishte ardhur depesha nga PK e BRSS me kërkesë që, për të harmonizuar çështje të caktuara të politikës ndaj Shqipërisë të dërgohet në BRSS një delegacion jugosllav. Milovan Gjalasi, i cili kishte kryesuar delegacionin jugosllav ishte nisur nga Beogradi për në Moskë, më 8 janar 1948. "Kurrfarë sugjerime dhe udhëzime të veçanta nuk kam marrë në Beograd... që atëherë ishte ndërtuar qëndrimi se përfaqësuesit sovjetikë nuk do të duhej që kursin tanimë të përcaktuar për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë ta pengojnë me ndonjë linjë jotaktike ose tjetërfare...".<sup>487</sup> Gjilasi, duke evokuar kujtime të tij për shkaqet dhe arsyet e vizitës në Moskë të delegacionit të lartë shtetëror dhe partiak të Jugosllavisë, në të cilin bënin pjesë Eduard Kardeli, Vladimir Bakariçi dhe Milovan Gjalasi, shkruante: "Kardeli, atëherë ose menjëherë pas arritjes, (në Moskë-A.Z.) më ka treguar se arsyeja e drejtpërdrejt e konfliktit me Moskën ishte marrëveshja midis qeverisë jugosllave dhe asaj shqiptare për hyrjen e dy divizioneve jugosllave në Shqipëri. Divizionet tanimë ishin të kompletuara, kurse regjimenti i aviacionit ushtarak gjuajtës ishte në Shqipëri, kur Moska u kundërvu vendosmërisht, duke mos i pranuar arsyet se divizionet jugosllave duhej të mbronin Shqipërinë nga sulmi i mundshëm i "monarko-fashistëve" grekë. Në depeshën e tij drejtuar Beogradit, Molotovi kishte kërcënuar me mospajtim

---

486 Po aty.

487 Po aty, f. 89.



publik”.<sup>488</sup> Gjatë takimit me Kardelin në Moskë, në janar 1948, Gjilasi e kishte pyetur: “E çfarë ju është dashur pikërisht tani dërgimi i divizioneve? Dhe pse e gjithë kjo, gjithë këto ndërhyrje nervoze në Shqipëri? Kardeli më tha: Këtë e shtyn Plaku, (Tito)... E die dhe vetë...”.<sup>489</sup> Në bisedën e zhvilluar me Stalinin, në mbrëmje vonë, më 10 janar 1948, ndërtemate bisedimeve të rënda ishte edhe çështja e krijimit të federatës mes Jugosllavisë, Shqipërisë dhe Bullgarisë, por edhe rastii planit jugosllav për dërgimin e dy divizioneve ushtarake në Korçë. Gjatë diskutimit të Eduard Kardelit dhe vlerësimit të tij se, përveç moskonsultimit me palën sovjetike, lidhur me dërgimin e divizioneve ushtarake në Shqipëri, tjetër mosmarrëveshje jugosllavo-sovjetike nuk kishte pasur, Stalini i shqetësuar e kishte ndërprerë me fjalët: “S’është e vërtetë. Ka mosmarrëveshje dhe ato të thella! Çfarë do të doni për Shqipërinë? Aspak nuk na keni konsultuar për futjen e ushtrisë në Shqipëri... Kjo do të mund të sillte deri te komplikimi serioz ndërkombëtar - Shqipëria është shtet i paruar! Çfarë mendoni? U arsyetuat ose jo, ngel fakti se lidhur me dërgimin e dy divizioneve nuk jeni konsultuar me ne”.<sup>490</sup> Biografi i Titos, Vladimir Dedijer, duke shtrembëruar faktet në lidhje me planin jugosllav për dërgimin e dy divizioneve të ushtrisë jugosllave në Shqipëri, shkruante: “Derisa Kardeli dhe Bakariçi po përgatiteshin për të udhëtuar në Moskë, qeveria shqiptare kishte kërkuar nga qeveria jugosllave që të dërgonte divizionet jugosllave në Shqipërinë jugore, sepse Enver Hoxha frikësohej se grekët mund të okupojnë disa pjesë të territorit shqiptar në Epir, për të cilat deklarimin se iu takojnë atyre. Qeveria jugosllave e kishte shqyrtuar kërkesën shqiptare. Në princip, ajo ishte për atë që kjo ndihmë t’i jepej, mirëpo data e shkuarjes së divizioneve nuk ishte

---

488 Po aty, f. 110-111.

489 Milovan Gjilas, Vlast i pobuna, f. 134.

490 Po aty, f. 115.

përcaktuar. Edhe më herët, qeveria shqiptare kishte kërkuar që Jugosllavia t'i dërgonte një regjiment të aviacionit gjuatjës. Kërkesa shqiptare ishte aprovuar dhe regjimenti tanimë gjendej në Shqipëri".<sup>491</sup> Dedijeri, në kujtime te tij lidhur me këtë problem, që shënon thyerjen e madhe në marrëdhëniet jugosllavo-ruse, shënonte: "... Në atë kohë (janar 1948-A.Z.), jugosllavë tende nuk ishin të vetëdijshëm për faktin se Stalini me qëllim po i përdorte marrëdhëniet shqiptaro-jugosllavesi mjet për presion mbi Jugosllavinë. Më vonë, u bë e qartë se Stalini, me plan të përgatitur që më parë, e kishte përdorur Enver Hoxhën, agjentin e tij kryesor në qeverinë shqiptare, që të impononte kërkesën që në Shqipëritë dërgoheshin trupat ushtarake".<sup>492</sup> Më 6 korrik 1952, Eduard Kardeli, në një bisedë me Vladimir Dedijerin, pasi kishte konstatuar se menjëherë pas bisedës me Stalinin (10 janar 1948), delegacioni jugosllav kishte qenë i bindur se kërkesa e Stalinit që t'i nisnin përgatitjet për federatën midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë kishin për qëllim shkatërrimin e unitetit të Jugosllavisë, autobiografit të Titosi kishte sugjeruar për disa çështje, për të cilat ai nuk duhej të shkruante. Konkretisht, Kardeli kishte sugjeruar: "Nën numrin 1. Kardelika thënëse nuk guxohet të shkruhet për dhënien e ndihmës për Markosin. Pastaj, rreth Shqipërisë të mosflitet për divizione te gjithashtu as për këshilla te Stalinit për "gëlltitjen", sepse për këtë ende askund nuk kemi folur".<sup>493</sup> Ky insistim ultimativ i Eduard Kardelit linte të kuptohej se, megjithatë, jugosllavët kishin kërkuar dërgimin e dy divizioneve ushtarake në Shqipëri. Për këtë dëshmon edhe Milovan Gjilas, në vitet e vona të jetës së tij, duke konfirmuar: "Siç dihet Tito, i cili e kishte rolin kryesor dhe vendimtar në Parti, atëkohë vendosi që të dërgonte në Shqipëri divizionet me pretekst se Shqipëria

491 Vladimir Dedijer, *Novi prilozhi za autobiografiju Josipa Broza Tita*, Beograd, 1984, f. 290.

492 Po aty, f. 291-292.

493 Po aty, f. 299.

duhej mbrojtur nga Greqia... Unë edhe sot mendoj se ky veprim ishte një gabimi madh, gabim i cili ka mundur të nxiste dyshimin e shqiptarëve në qëllimet e Jugosllavisë. Madje, mendoj se në instancën e fundit qëllime të tilla edhe kanë ekzistuar, pra që Shqipëria t'i bashkohej Jugosllavisë, por me kushtet të cilat pastaj ne do t'i diktonim. Sovjetët e hetuan qëllimin tonë, kuptohet jo të drejtë dhe plotësisht të gabuar... Megjithatë, Tito vendosi për dërgimin e divizioneve atëherë kur e hetoi se sovjetët po përziheshin rreth Shqipërisë".<sup>494</sup> Gjilasi, i cili, përgjithësisht përzierjen sovjetike në fushën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave e shihte me domethënie negative, megjithatë, pranonte: "Divizioni nuk u nis për Shqipëri për arsye se sovjetët intervenuan, madje me kërcënimin kategorik se, nëse ndodh intervenimi i tillë, këta publikisht do të kundërshtojnë dhe se ata me këtë nuk pajtohen dhe që një hapi tillë s'është tjetër përveç se një hap i politikës jo të drejtë hegjemoniste".<sup>495</sup> Enver Hoxha, në kujtimet nga takimet me Stalinin, shkruante se në bisedat me të ka shtruar edhe çështjen e kërkesës jugosllave për të dërguar në territorin shqiptar dy divizione. Në takimin e parë, të mbajtur në korrik të vitit 1947, sipas Enver Hoxhës, ky i ka thënë Stalinin: "U kemi propozuar jugosllavëve... që të vihemi në lidhje menjëri-tjetrin e të bashkëpunojmë për të parashikuar mbrojtjen e kufijve tanë nga ndonjë sulm eventual grek ose italian, por ata nuk i janë përgjigjur propozimit tonë, duke pretenduar se mund të bisedojnë me ne, pasi ta studioj në çështjen".<sup>496</sup> Ndërkaq, gjithnjë sipas Enver Hoxhës, nga takimet me Stalinin, ky i fundit, në mars-prill 1949, i kishte konfirmuar udhëheqësit shqiptar: "Ne nuk e dinim se jugosllavët, nën pretekstin e "mbrojtjes" së vendit tuaj nga sulmi i fashistëve grekë, donin të sillnin njësitë ushtrisë së tyre në RPSH. Ata për-

---

494 Agim Zogaj, Fuqia e ideve, Prishtinë, 1993, f. 28-29.

495 Po aty.

496 Enver Hoxha, Me Stalinin, Tiranë, 1979, f. 70.

piqeshin ta bënin këtë në mënyrë shumë sekrete. Në të vërtetë qëllimi i tyre në këtë drejtim ishte krejtësisht armiqësor, sepse synonin të përmbysnin situatën në Shqipëri”.<sup>497</sup> Duke iu referuar bisedimeve me gjeneralin jugosllav Kupreshanin, në janar të vitit 1948, Enver Hoxha, në librin “Titistët”, kujton paralajmërimet e gjeneralit jugosllav: “Sulmi parashikohet të fillojë në këtë territor, - tha Kupreshanini dhe zgjati gishtin drejt kufijve të zonës Korçë-Ersekë. Kemi të dhëna se në të njëjtën kohë mund të fillojnë goditjet edhe nga ana e detit... Për shkak të një situatë të tillë të paqartë, unë ju lutem që të na jepni bazën në Korçë për një divizion dhe për njësitë ndihmëse teknike”.<sup>498</sup> Enver Hoxha, i gjetur përballë presionit jugosllav, e kishte lajmëruar Stalinin: “Nëpërmjet ambasadës sovjetike e vura në dijeni Stalinin për çka na kërkonte Titoja dhe në pritje të përgjigjes me shumë mundim arrita që hëpërhë të mos shtrohej në Byro propozimi për ardhjen e divizionit jugosllav”.<sup>499</sup> Çështja e dërgimit të dy divizioneve ushtarake të Jugosllavisë në Shqipëri kishte qenë temë shqyrtimi edhe në mbledhjen e KQ të PKJ, mbajtur më 1 mars 1948. Në fjalën e hyrjes, Tito kishte thënë: “Korçën për bazën tonë ushtarake. Kemi dëshiruar që grekëve t’ua bëjmë me dije se lidhja, aleanca jonë me Shqipërinë është e fortë. Nuk janë të gatshëm për luftë, por për provokime po. Ne kemi filluar ta përgatisim një divizion luftarak. Kam paraparë që para se të nisët divizioni, ta informojmë BRSS (Zhdanovin dhe Stalinin). Erdhi Lavrentijev për të më pyetura kemi për qëllimta dërgojmë një divizion... Divizioni është dashur të jetë i përgatitur deri më 15 shkurt 1948, kurse nisja të bëhet kur çdo gjë të jetë e përgatitur”.<sup>500</sup> Në të njëjtën mbledhje, Tito kishte konstatuar për herë të parë publikisht ftohjen e marrë-

497 Po aty, f. 90.

498 “Titistët”, po aty.

499 Po aty, f. 409.

500 Vladimir Dedijer, Novi prilozi za autobiografiju Josipa Broza Tita, Beograd, 1984, f. 303.

hënieve shqiptaro-jugosllave që nga viti 1947, dhe se përkëtë, sipas tij përgjegjës kryesor ishte Nako Spiru. Kardeli duke iu referuar takimit me Stalinin kishte parafrazuar vlerësimin e tij: "... Nëse Shqipëria sulmohet le t'i drejtohet vendit tuaj për ndihmë. Dërgimi i divizioneve do t'i jepte shkas, pretekst amerikanëve për sulme".<sup>501</sup> Kardeli, po ashtu, kishte pohuar kategorikisht: "Shqipëria duhet mbajtur fort, sepse shumë kemi investuar në të dhe ajo është e rëndësishme për ne. Ta vazhdojmë politikën tonë për të gjitha çështjet politike, si dhe marrëdhëniet ekonomike. Të kërkohet që këshilltarët sovjetikë në Shqipëri të jenë në përbërje të grupit tek ne."<sup>502</sup>

Më 3 mars 1948, pra vetëm dy ditë pas mbledhjes së KQ të PKJ, Byroja e KQ të PKSH shtroi debatin kritik për rrezikun e një sulmi eventual të ushtrisë greke kundër Shqipërisë, sulm të cilin e parashikonin udhëheqësit politikë dhe ata ushtarakë jugosllavë. Enver Hoxha, fillimisht kishte informuar Byronë Politike për bisedimet me gjeneralin jugosllav Kupreshanin dhe vlerësimet e tij lidhur me një sulm të mundshëm të ushtrisë greke kundër Shqipërisë: "Është rrezik i madh të na bëhet një provokacion në stil të gjerë. Kishin informata që në Greqi përgatiten disa divizione që Ushtria Greke ka porositur 30.000 pushkë dhe 5000 topa në Angli dhe në Amerikë. Shtabet angleze dhe amerikane ishin transferuar në Selanik".<sup>503</sup> Enver Hoxha kishte informuar: "Për mbrojtjen e kufijve tanë do të vinte një divizion jugosllav në Korçë. Për këtë na lajmëroi Rankoviçi dhe më vonë Titoja si për divizionin, asht edhe për shpalljen e zonës së Korçës, zonë në gjendje lufte. Marshallit iu përgjigjëm po dhe morëm masat duke postuar divizionin tonë më poshtë në Leskovik, etj. Ishim gati për urdhrin e lëvizjes".<sup>504</sup> Pra, udhëheqja e PKSH, ishte pajtuar pa asnjë kundërvënie që jugosllavët të vendo-

501 Po aty, f. 304.

502 Po aty, f. 305.

503 AQSH, F. 14/AP, dos. 64, v. 1948.

504 AQSH, F. 14/AP, dos. 64, v. 1948.

sin në jug të Shqipërisë divizionin ushtarak. Ata, aq më tepër me vetiniciativë, kërkonin nga udhëheqja shqiptare që zona e Korçës të shpallej zonë lufte. Në këtë kohë, Enver Hoxha pranonte në mbledhjen e Byrosë Politike se në rast agresioni nga pala greke, ushtria shqiptare ka mundësi të mbajë frontin vetëm dhjetë ditë. Lidhur me vendimin e udhëheqjes së PKSH që për kërkesën jugosllave ta njoftojnë në formë konsulte udhëheqjen sovjetike, kishte reaguuar Savo Zlatiç duke i thënë Koçi Xoxes: "... se nuk ishte mirë që qeveria shqiptare ta kërkonte këtë nga Bashkimi Sovjetik, se kjo do të vinte si një nxitje dhe sillte komplikacione. Për gjendjen luftarake ne i kemi marrë masat, ne ua kishim thënë sovjetikëve".<sup>505</sup> Në mbledhje, madje, ishte dhënë ideja që lidhur me situatën të lajmërohej edhe Dimitrovi. Bedri Spahiu madje kishte deklaruar: "Shteti jugosllav duhet të mendojë për ne, ashtu si për kufijtë e tij".<sup>506</sup> Historiografia shqiptare e periudhës së komunizmit, pra, edhe dokumentete PPSH rreth kësaj çështjeje, falsifikojnë dhe i shtrembërojnë të dhënat dhe faktet me qëllime të caktuara politike. Në lidhje me këtë, në botimin e vitit 1968 të librit Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, ndër të tjera konstatohet: "... Por edhe ky plan jugosllav nuk u përmbush. Shoku Enver Hoxha e shtroi këtë çështje në udhëheqjen e Komitetit Qendror. Me propozimine tij u vendos që të mos pranohet sjellja e divizionit jugosllav në Shqipëri...".<sup>507</sup> E vërteta është se me intervenimin politik të udhëheqjes më të lartë të PK të BRSS, pala jugosllave u detyrua që të tërhiqej nga plani i dërgimit të divizionit ushtarak në Shqipëri, çështje kjo të cilën e pranon Milovan Gjlasi.<sup>508</sup>

Zmbrapsja, nga ana e udhëheqjes sovjetike, e planit jugosllav për dërgimin e divizionit të tyre ushtarak në Shqipëri, në mars 1948, shënoi një kthesë në marrëdhëniet jugosllavo-

505 Po aty.

506 Po aty.

507 Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, Tiranë, 1968, f. 250.

508 Vladimir Dedijer, vep. e cit., f. 373.

sovjetike dhe njëherit paralajmëroi thyerjet e mëdha që do të pasonin në të njëjtin vit në relacionet Beograd-Moskë, pra në vijën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Edhe Tito, në mbledhjen e KQ të PKJ, mbajtur më 12 prill 1948, kishte konstatuar krizën e marrëdhënieve jugosllavo-sovjetike, pikërisht, përshkak të çështjes së Shqipërisë: “Konflikti ka ardhur rreth çështjes së Shqipërisë. Me rastin e përgatitjes për dërgimin e divizionit në Korçë. Molotovi ka dërguar protestë. Ne kemi lajmëruar se nuk do ta dërgojmë divizionin, por nuk shohim mënyrë tjetër që të sigurojmë, garantojmë pavarësinë e Shqipërisë e të vendit tonë”.

Udhëheqja e PKSH, në të cilën, në fillim të vitit 1948, gjithnjë e më hapur po pozicionoheshin dy vija politike, njëra për intensifikim të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe tjetra për një proces të kontrolluar dhe më të ngadalësuar të këtij bashkëpunimi dhe të bashkimit eventual në një federatë të përbashkët, në shkurt të vitit 1948, kishte marrëvendim që të thërriste Plenumin 8-të të KQ të PKSH. Temë qendrore e punimeve vetë plenumit, i cili i mbajti punimet prej 2 shkurtit deri më 8 mars 1948, ishte analiza mbi zhvillimet e situatës së brendshme të partisë mbi marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe mbi gabimet në vijën ekonomike të partisë. Plenumi i I i zhvilloi punimet në kohën e intensifikimit të kritikave jugosllave ndaj udhëheqjes së PKSH për ngadalësim dhe bllokim të qëllimshëm të realizimit të marrëveshjeve ndërshtetërore, sidomos të asaj në fushën ekonomike. Në rrethana të tilla, kur mbi Enver Hoxhën po ushtrohej presion i madhe dhe nga Koçi Xoxe dhe grupi i tij projugosllav, KQ i PKSH hapi dhe zhvilloi debat kritik në lidhje me të arritjet dhe pengesat e shumta që dilnin në fushën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Qëllimi themelor i hartuesve të platformës politike të Plenumit të 8-të të KQ të PKSH, i cili në vjeshtën e të njëjtit vit do të kualifikohet si një nga njollat më të zeza të PKSH, ishte

shpejtimi me çdo kusht i bashkimit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe gjithësi largimi i Shqipërisë nga ndikimisovjetik. Në këtë kuptim, Plenumii 8-të duhej të përcaktonte qartë dhe përfundimisht orientimin e patundur të udhëheqjes së PKSH për thellimin dhe zbatimin e marrëveshjeve shqiptaro-jugosllave, nga sfera e ekonomisë e deri te krijimi i federatës së përbashkët. Në propozimet e Byrosë Politike të KQ të PKSH mbi disa çështje, në lidhje me marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe mbi marrëdhëniet në vijën ekonomike të PKSH, vlerësohej lartë roli i PKJ në këtë plan: “Marrëdhëniet tona me Jugosllavinë, marrëdhënie vëllazërore midis popujve tanë, lindën dhe u forcuan gjatë LNÇ, duke ndjekur rrugën e përbashkët. Këto marrëdhënie u konkretizuan me aleancën tonë në Konventën dhe me marrëdhëniet e tjera midis dy vendeve. Pa lidhjet e ngushta, bashkëpunimin dhe ndihmën e vlefshme që popujt e Jugosllavisë kanë dhënë vendit tonë, nuk do të ishin të mundshme fitoret tona, sigurimi dhe zhvillimi i tyre; independenca jonë do të vihej në rrezik nga imperialistët<sup>509</sup>. Plenumi i 8-të i KQ të PKSH, duke pasur në thumb të kritikës Nako Spirun, si kryetar i Komisionit të Planifikimit dhe përgjegjës për zbatimin e marrëveshjeve shqiptaro-jugosllave në fushën e ekonomisë, në tekstin e mëtejshëm të propozimit të Byrosë Politike të KQ të PKSH, akuzonte Spiron: “Në çdo çështje, ai është munduar të krijojë mosmarrëveshje dhe përpjekje, duke ngjallur frymën e mosbesimit, duke mos vënë në zbatim akordet, duke kërkuar gjithmonësa më shumë nga Jugosllavia dhe duke influencuar që ne të shkëputeshim nga Jugosllavia, të bënim marrëveshje me Bashkimin Sovjetik”.<sup>510</sup> Ai, më tej, akuzohej: “... Ka sabotuar me çdo mjet organizimin e shpejtë dhe në rrugë të drejtë vëllazërore të dy popujve tanë, të shoqërive shqiptaro-jugosllave. Ai ka sabotuar vënien në

509 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1945-1948, f. 223.

510 Po aty, f. 226.



zbatim të bashkimit doganor, të këputjes së divizioneve ku-  
fitare. Ndërsa, në Byro, ai i kurdiste punët dhe arrinte të  
bënte mendimet e tij, me njerëz që kishte konfidencë, e nx-  
irrte të gjithë vrerin e tij kundër jugosllavëve”.<sup>511</sup> Pastaj, Nako  
Spiru kritikohej për planine hartuar pesëvjeçar, si dhe  
përgjithësisht për politikën ekonomike dhe “shtrembërimin” e  
vijës saj në PKSH: “Nako Spiru përgatiti një plan pesëvjeçar  
krejt në kundërshtim me koordinimin e planeve me Jugosl-  
lavinë. Ai bëri një projektplan joreal dhe autarkik, në frymën  
e “independencës”, që synonte të merrte sa më shumë nga  
Jugosllavia dhe të mos jepte, po të ishte e mundur, asgjë. Bëri  
një plan të fryrë... dhe që kishte për qëllim të shkaktonte de-  
moralizim dhe mobilizim në masa dhe në Partive të dhe të  
shpinte në shkëputje me Jugosllavinë”.<sup>512</sup> Së bashku me Nako  
Spirun, propozimet e Byrosë së KQ të PKSH, paraqitur para  
fillimit të debatit në Plenumin e 8-të të KQ të PKSH, vunë në  
thumb të kritikës së rreptë partiake fraksioniste edhe bash-  
këpunëtore të tij, Fadil Paçramin në sektorin e Agjitpropit  
dhe të Arsimit dhe Mehmet Shehun nga Shtatmadhuria e  
Ushtrisë Shqiptare. Për Fadil Paçramin konstatohej: “Në të  
gjithë sektorin e Agjitpropit dhe të Arsimit, Fadil Paçrami ka  
bërë të njëjtën luftë kundërvijës së Partisë, kundër forcimit të  
marrëdhënieve kulturore me Jugosllavinë”.<sup>513</sup> Për Mehmet-  
Shehun, që deri atëherë ishte në detyrën e shefit të Shtatmad-  
horisë së Ushtrisë Shqiptare, vlerësohej: “Mehmet Shehu  
ishte njeriu i përshtatshëm që zgjodhi Nako Spiru për të bërë  
punën e tij fraksioniste në ushtri... Gjithë tiparet e punës  
fraksioniste të Nako Spirusi gjen edhe në punën që ka bërë  
Mehmet Shehu në ushtri: luftë kundër vijës së Partisë dhe  
shtrembërim i vijës në lidhje me marrëdhëniet me Jugosl-  
lavinë. Edhe këtu, në të gjithë sektorët, duke e maskuar pu-

---

511 Po aty, f. 227.

512 Po aty, f. 229.

513 Po aty, f. 238.

nën me politikën prosovjetike”.<sup>514</sup> Akuzat për Mehmet Shehun, sikurse edhe ndaj Nako Spirus dhe të tjerëve, ishin të sajara mbi kritikën dhe paditë jugosllave, pra, se kishte sabotuar bashkimin e ushtrisë shqiptare me atë jugosllave, nënkuptonin anatemimin e tij si personalitet ushtarak dhe politik: “Mehmet Shehu ka penguar me çdo mënyrë afrimin tonë me ushtrinë jugosllave... Gjithë instruksionet që erdhën nga Jugosllavia, ai i mbante, nuk i përdorte dhe nuk ua tregonte as shefave të tjerë...Kjo tregon qartazi pikëpamjetë të njëllojta me ato të Nako Spirut, vënien e marrëdhënies me Jugosllavinë në planin e marrëdhënies imperialiste. Këtë vijë, Mehmet Shehu e zbatoi gjer në fund”.<sup>515</sup> Në hapjen e debatit partiak në Plenumin 8-të të KQ të PKSH, në ditën parë të tij, më 26 shkurt, Enver Hoxha pasi kishte konkluduar se Nako Spiru kishte arritur që me: “...punënë të shkatërronte bazën e Partisë, të godiste hapët Partinë tonë, vijën ekonomike e politike të Partisë sonë”,<sup>516</sup> në vijim, i pranonte të gjitha kritikën dhe paditë jugosllave: “Ne u vumë përpara një kritike të drejtë dhe të fortë nga KQ i PKJ për marrëdhëniet tona me Jugosllavinë. Ky hap shpëtimtar bëri që shokët e Byrosë ta marrin këtë çështje me seriozitetin më të madh”.<sup>517</sup> Enver Hoxha vazhdoi të numëronte meritat e mëdha të PKJ për aleancën me PKSH, por duke kritikuar Nako Spirun si përgjegjës për minimin e atyre marrëdhënies të mira: “Aleanca me Jugosllavinë ishte një nga fitoret më të mëdha, Nako Spiru nuk e pranoi këtë. Kjo pati konsekuenca shumë të mëdha për Partinë tonë... Në marrëdhëniet me Jugosllavinë ishin bërë gabime të mëdha, kurse këto merreshin si gabime teknike... Kur erdhi puna e planit pesëvjeçar, ai ka arritur të fshehtë projektin e Jugosllavisë nga ne; ai shkoi edhe më tutje, sa deklaroi në Kuvend që ne mund të bëjmë dhe pa

514 Po aty, f. 240.

515 Po aty, f. 24-241.

516 Po aty, f. 244.

517 Po aty, f. 245.

ndihmën e Jugosllavisë dhe atë kohë ka folur direkt kundër vijës së KQ (mendohet të Jugosllavisë -A.Z.).<sup>518</sup> Mirëpo, Enver Hoxha, gjithsesi nën presionin e kritikave jugosllave, u tregua vetëkritik, duke pranuar: “Kjo na bëri që të gabojmë dhe në lidhjet tona me Jugosllavinë kemi përgjegjësi të madhe, kolektive dhe individuale dhe përgjegjësi më të madhe kam unë, pse unë nuk e shihja Nakon... Këtu ka një gamë përgjegjësie, por nuk mund të krahasojmë përgjegjësinë që kemi ne... I pari Nakoja e rrëmbeu bajrakun e luftës kundër Jugosllavisë... Ne ta ndjejmë veten vëllezër komunistë me jugosllavët. Çështja e vijës me Jugosllavinë është vitale, pse në këtë rrugë na ka udhëzuar Stalini, Molotovi e Titoja. Këto t’i kemi parasysh”.<sup>519</sup> Veprimtarinë e Nako Spirus, karshi çështjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, sekretari organizativ i KQ të PKSH, personi në atë kohë më me ndikim në zhvillimet politike në Shqipëri, Koçi Xoxe, në fjalën e tij në Plenumin e 8-të, e cilësoi si fraksion të madh brenda KQ të PKSH: “Ai ktheu marrëdhëniet me Jugosllavinë, jo si i caktoi KQ si marrëdhënie midis demokracive dhe midis partive tona, por në marrëdhënie imperialiste. Këtu godiste vijën e Partisë”.<sup>520</sup> Naxhie Dume e kritikonte Nako Spirun se ka ndikuar në shkëputjen dhe prishjen e marrëdhënieve midis grave shqiptare dhe atyre jugosllave: “Për koordinimin e planeve, ai nuk ka përfillur projektin dhe mendimet e shokëve jugosllavë”.<sup>521</sup> Rrahman Parllaku në diskutimin e tij kishte veçuar dy qëllime të veprimtarisë antiparti të Nako Spirus në lidhje me marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave: “Dy çështje kryesore ishin: marrja e gjithë punës në dorë dhe shkëputja nga Jugosllavia, këto ishin qëllime të tij dhe kështu reflektohej te ne në komandë vija e Nakos”.<sup>522</sup> Në mbledhjen

518 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, f. 246.

519 Po aty, f. 252, 254-255.

520 Po aty, f. 256.

521 Po aty.

522 Po aty, f. 262.

e datës 27 shkurt 1948 të Plenumit të 8-të KQ të PKSH, Manush Myftiu kishte vërejtur se Nako Spiru pretendonte të merrte udhëheqjen e PKSH, se: “Lufta kundër Jugosllavisë dhe mbulesa me propagandën për Bashkimin Sovjetik tregon se puna e tij ka qenë një punë prej armiku. Ai do të bënte dhe më keq, po të ishte zgjatur akoma kjo situatë dhe, kur e pa që u zbulua, vrau veten... Lufta që ka bërë Nako Spiru dhe shokët e tij kundër Jugosllavisë ka pasur për qëllim të dobësojë pozitat tona. Për punën e tij, Nako Spiru ka përfitur nga gjendja e krijuar në Byro, nga mungesa e unitetit”.<sup>523</sup> Ndër kritikuesit e rreptë dhe të pamëshirshëm të Nako Spirus, në Plenumin e 8-të, ishte edhe Bedri Spahiu për të cilin: “... Nako Spiru nuk ka qenë komunist, por një armik; komunizmi për të ishte një zgjedhje profesioni, ai s’kishte besim në parti, në masat, ishte megaloman, dinak, tallës dhe aq më pak ishte një udhëheqës komunist... Atë nuk e ndante gjë as nga Liria, as nga Ymer Dishnica, as nga Sejfullai... nuk ishte për marrëdhënie të ngushta me Jugosllavinë, veprimtaria e tij është antijugosllave dhe në esencë antisovjetike”.<sup>524</sup> Bedri Spahiu, i cili pas disa vitesh edhe vetë do të akuzohej nga Byroja e KQ të PKSH, e ndërlihte veprimtarinë e Nako Spirus me angazhimin prosovjetik: “Duke punuar gjoja për Bashkimin Sovjetik, ai punonte kundër Bashkimit Sovjetik, se deshte shkëputjen nga Jugosllavia. E tillë ka qenë e gjithë vija dhe veprimtaria e tij në lidhje me kuadrin”.<sup>525</sup> Edhe Gogo Nush i akuzonte Nako Spirun si prishës të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, duke konkluduar: “... Një nga objektivat e tij për të likuiduar Partinë tonë ishte prishja e marrëdhënieve me Jugosllavinë... Me ngatërresat që vetë shkaktonte, krijoi psikozën edhe në Byro deri në anëtarët e Partisë dhe ngjalli dyshime për këto marrëdhënie, duke i interpretuar

---

523 Po aty, f. 267.

524 Po aty, f. 287-288.

525 Po aty.

këto si imperialiste".<sup>526</sup> Tuk Jakova, anëtar i KQ të PKSH, i cilinë vitin 1956 edhe vetë do të pësonte për shkak të luftërave të brendshme politike, në diskutimin e tij në Plenumin e 8-të kishte veçuar devijimet në vijën ekonomike dhe në marrëdhëniet me Jugosllavinë, si dhe çështjen e fraksioneve në PKSH. Ai gjykonte: "Protagonisti i gjithë shkatërrimit të vijës dhe i fraksionit del Nako Spiru... Ai nuk i shikonte mirë këto marrëdhënie (marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave-A.Z.), asnjëherë nuk i ka parë mirë".<sup>527</sup> Mirëpo, Tuk Jakova, përmes kritikës drejtuar Nako Spirit, kishte hapur diskutimin edhe për përgjegjësinë që Enver Hoxha e kishte në lidhje me ato gabime dhe devijime në çështjen e marrëdhënieve me jugosllavët. Prandaj, Jakova kishte sinjalizuar udhëheqjen e KQ të PKSH: "Në këto, gabime ka edhe Byroja. Ai kishte arritur të fitonte autoritet të çuditshëm me ato intrigat e tij të çuditshme. Ajo që i ka dhënë më tepër dorë në këtë punë ka qenë influenca që ai ka ushtruar mbi Komandantin. Nga kjo ka përfituar Nakoja... Asnjëherë Nakoja nuk ka respektuar traktatet e lidhura. E orientonte të gjithë luftën kundër mosrespektimit nga ana e jugosllavëve. Shokët jugosllavë që vinin me dhanë eksperiencë, i lufton. Për të maskuar këtë veprimtari kundër jugosllavëve, ai mbështetejte rusët".<sup>528</sup> Beqir Balluku, i cili sapo e kishte zëvendësuar Mehmet Shehun e larguar nga posti i shefit të Shtatmadhorisë së Ushtrisë Shqiptare, në diskutimin e tij në plenum, ishte ndër më të rreptit në diskualifikimin politik të Nako Spirit. Sipas tij: "Ai ishte kundër aleancës me Jugosllavinë. Kjo është punë agjenti. Klasa nga vjen Nakoja është borgjeze, prandaj Nakon s'e lidh asgjë me rrugën tonë. Nakoja është shovinist borgjez. Ai del me independencën e vendit tonë, pa marrë parasysh se ne nuk mund të shkojmë përpara vetëm".<sup>529</sup> I të njëjtit mendim

526 Po aty, f. 295.

527 Po aty, f. 296.

528 Po aty.

529 Po aty, f. 301.

ishte edhe Petro Papi, i cili mbronte qëndrimin: “Nga puna e Nakos u ashpërsuan marrëdhëniet me Jugosllavinë... Nako-  
jaka punuar në mënyrë armiqësore. Ai deshte të shkëpute  
vendin tonë nga Jugosllavia. Të mendosh sot për shkëputje,  
kjo është vetëvrasje. E donte shkëputjen se ishte shovinist  
borgjez. Ne, si komunistë, jemi për një bashkim të plotë.  
Megjithëse nuk e kemi sot, ne do të punojmë përnjëgjë të  
tillë”.<sup>530</sup> Xhoxhi Blushi, ishte edhe më i drejtpërdrejtë në kri-  
tikat ndaj Nako Spirus dhe në përfaqimin pa kriter të bashkë-  
punimit të Shqipërisë me Jugosllavinë deri në bashkimin e dy  
shteteve, duke e parë Jugosllavinë si “shpëtimtare” të shtetit  
shqiptar: “Mënyra e punës me të cilën ai ka punuar, qën-  
driminë Byro, janë tiparet e një pune armiqësore. Ai lufton  
Jugosllavinë. Shovinist me qëllim që të luftojë rrugën tonë.  
Ai e di mirëse pa Jugosllavinën e bëhemi pre e armikut... Ai  
e ka një preokupim të madh që të ekzagjerojë të gjitha mos-  
marrëveshjet me Jugosllavinë. Ai mundohet t’i paraqes këto  
si punë armiku nga ana e Jugosllavisë”.<sup>531</sup> Lufta e rreptë  
brenda partiake në radhët e Byrosë dhe KQ të PKSH, e insta-  
luar me ndikimin dhe direktivat e emisarëve jugosllavë në  
Shqipëri, u përkufizuanë rezolucionin e Plenumit 8-të të KQ  
të PKSH, aprovuar më 27 mars 1948 në mbledhjen përmbyl-  
lëse të plenumit, ku morën pjesë 25 anëtarët e KQ të PKSH.  
Në rezolucion konstatohet: “...Në lëmin e politikës eko-  
nomike, Nako Spiru shtrembëroi dhe luftoi vijën e Partisë...  
Nako Spiru u përpoqme të gjitha forcat e tij që ekonomia e  
vendit të zhvillohej në mënyrë independente dhe e shkëpu-  
tur nga ekonomia Jugosllavisë. Për këtë gjë ai punoi për të  
dalë me një plan të shtetit të fryrë, ireal dhe në baza  
autarkike”.<sup>532</sup>

Komiteti Qendror i PKSH, duke ngelur në pozitat e va-

---

530 Po aty, f. 303-304.

531 Po aty, f. 307.

532 Po aty, f. 426.

salitetit ndaj Jugosllavisë, ishte i vendosur në qëndrimin se pa bashkëpunimin dhe përkrahjen jugosllave do të rrezikohesh pavarësia dhe integriteti i shtetit shqiptar. Udhëheqja e saj, siç dëshmojnë pikat kryesore të rezolucionit të Plenumit 8-të KQ të PKSH, preokupohej përbashkimin me Jugosllavinë, ndërsa asnjë fjalë nuk ishte thënë për çështjen e Çamërisë, të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare, që ishin nën sundimin jugosllav. Enver Hoxha në librin e tij memoartistik "Titistët" (1982), Plenumin e 8-të të KQ të PKSH e kishte cilësuar "njollë e zezë në historinë e Partisë sonë".<sup>533</sup> Ai pranonte se: "... Udhëheqja e Beogradit synonte që Plenumi i 8-të i KQ të PKSH të krijonte atë gjendje kur Partia jonë, sapa t'i jepej sinjali, të detyrohej të pranonte e të nënshkruante "bashkimin", ose më drejt aneksimin e Shqipërisë nga Jugosllavia".<sup>534</sup> Enver Hoxha shkruante se në atë kohë, pra, edhe në prag dhe gjatë mbajtjes së Plenumit 8-të, në fakt ishte i izoluar politikisht dhe se: "... Plenumi i 8-të i KQ të PKSH ishte një makinacion djallëzor që iu imponua Komitetit Qendror nga jashtë"<sup>535</sup>. Në të njëjtën kohë, grupi i Koçi Xoxes, me sugjerimet e jugosllavëve, propagandonte tërheqjen graduale nga bashkëpunimi me sovjetikët.

Plenumi XI i KQ të PKSH, mbajtur prej 13 deri 24 shtator 1948, në temën e rezolucionit të Plenumit të 8-të kishte konstatuar: "Plenumi i XI i KQ të Partisë dënoi, gjithashtu, punimet dhe vendimet e Plenumit VIII të KQ të Partisë, këtë pikë më të zezë të historisë të Partisë tonë, siç e ka quajtur shoku Enver Hoxha, plenum ky që adoptoi një vijë politike dhe ekonomike krejtësisht të gabuar, antishqiptare dhe antisovjetike..."<sup>536</sup>.

Pas përfundimevetë punimeve të Plenumit 8-të të KQ të PKSH, më 8 mars 1948, Byroja politike kishte përcaktuar

533 Enver Hoxha, "Titistët", f. 410.

534 Po aty, f. 411.

535 Po aty, f. 424.

536 PPSH, Dokumente kryesore, I, Tiranë, 1960, f. 374,

jektivat për shpejtimin e marrëveshjeve ekonomike dhe të tjera midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Dukej se tani ishin eliminuar të gjitha pengesat e mundshme në rrugën e bashkimit të dy shteteve në një federatë, eventualisht edhe me Bullgarinë. Ndërkohë, në sajë të kritikave të rrepta në plenum, por edhe të presioneve nga grupi projugosllav i udhëhequr nga Koçi Xoxe dhe Kristo Temelko, vija politike të cilën e kryesonte Enver Hoxha, që konsiderohej deri atëherë në një kuptim frenuese e bashkimit në federatën e përbashkët, thujse plotësisht ishte disiplinuar në vijën profederatës. Kjo vijë politike, madje, tani ishte gjithnjë e më aktive dhe e zëshme në kërkesën që çështja e bashkimit në federatë duhet të shpejtohej. Në këtë kuptim, mbledhja e Byrosë Politike të KQ të PKSH, mbajtur më 14 mars 1948, ku temë qendrore ishte bashkimi me Jugosllavinë, shënoi edhe një hap kah federata e përbashkët, por edhe kah humbja edhe asaj pak pavarësi e që e kishte shteti shqiptar. Enver Hoxha, në fillim të fjalës së tij, pasi përmendi çështjen e bashkimit të ushtrisë shqiptare dhe të asaj jugosllave dhe çështjen e Kosovës, më tej, u përqendrua te çështja e bashkimit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Kristo Themelko kishte insistuar që çështja e bashkimit të shtrohej sa më parë të jetë e mundur. Enver Hoxha, madje, duke shprehur habinë pse në këtë mbledhje nuk ndodhej edhe Savo Zlatiçi për të dhënë shpjegime në lidhje me bashkimin e dy shteteve, më tej kishte përkujtuar se: "... ne jemi për bashkim, që ta bëjmë sa më parë".<sup>537</sup> Por, Enver Hoxha, megjithatë, edhe pse bëhej sikur ngutej për bashkimin midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në diskutim shtroi pyetjen: "Ata na e kanë hapur dhe na kanë diktuar vijën dhe tashti këtë nuk e bëjnë përprovë".<sup>538</sup> Në të vërtetë, pikërisht në këtë kohë, marsi vitit 1948, Tito, duke analizuar lëvizjet taktike të Stalinit drejt Shqipërisë dhe Jugosllavisë e në lidhje

---

537 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, f. 406.

538 Po aty.



me federatën midis tyre, kishte vlerësuar se mu për këtë nuk duhej ngutur me krijimin e federatës. Enver Hoxha ishte edhe më decidiv në shtruarjen e dilemave politike: “Ka disa kontradiksione të çuditshme në mendimete këtyre jugosllavëve. Këta na thanë që t’i bënim telegram BS dhene i bëmë. Tashtina thonë që çështjen ta vendosim vetë. Këto janë kontradikta. Ata kanë shkuar në Moskë, sigurisht, kanë biseduar për këtë... Kjo nuk shtrohet nëse ne jemi për bashkim. Ne kemi qenë gjithmonë për të. Çështja është ngritur. Ne punojmë në fakt në baza federale dhe çështja e federatës është një gjë formale, që në rastin oportun ne do ta shpallim. Kjo nuk varet nga ne”.<sup>539</sup> Koçi Xoxe, i cilit ngutej për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë, kërkonte që në lidhje me federatën, së pari të pyeten sërish jugosllavët, e pastaj sovjetikët: “Unë them që të pyesim KQ të Jugosllavisë që të na thotë si të veprojmë. Kur të na vijë përgjigje pozitive, ne e marrim në bisedim. Atëherë ne pyesim BS, si kryetari Kampit”.<sup>540</sup> Çështja e federatës midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë ishte shtruar edhe më 10 shkurt 1948, në bisedimet e delegacionit jugosllav me Stalinin. Milovan Gjilas shkruante: “Dikush, mendoj se ishte Kardeli, bëri të ditur se po punohet për federatën jugosllavo-shqiptare. Mirëpo, Stalini theksoi: “Jo, së pari federata ndër-mjet Bullgarisë dhe Jugosllavisë, e pastaj e këtyre dyjave me Shqipërinë”.<sup>541</sup> Çështja e federatës, si detyrë e ngutshme nga ana e PKSH, ishte shtruar edhe në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 15 mars 1948, ku ishte debatuar njëherit edhe për unifikimin e ushtrive dhe komandimin e tyre. Koçi Xoxe kishte dhënë propozime konkrete: “Vija jonë që të shkojmë në federatë është e drejtë, por kjo nuk varet nga ne. Që të jemi Republikë VII ose konfederatë, për këtë, unë them që të pyesim zyrtarisht KQ të

---

539 Po aty, f. 408.

540 Po aty,

541 Milovan Gjilas, vep. e cit., f. 114.

Partisë Jugosllave, si nga ana e Kampit”.<sup>542</sup> Në lidhje me çështjen e ushtrive, Enver Hoxha kishte konfirmuar para të pranishmëve se gjenerali jugosllav Milan Kupreshanin“...na propozoi për një komandë të përbashkët. Ne i thamë se të dy ushtritë do të jenë të përziera.Tani ka dy komanda...Le ta shndërrojë çështjen komanda jugosllave. Ne i thamë se duhet një komandë”.<sup>543</sup> Enver Hoxha kishte dhënë edhe propozime konkrete lidhur me komandën e ushtrisë shqiptare që do t’i bashkohej asaj jugosllave dhe do të komandohej nga një qendër: “Kjo komandë patjetër do të jetë e lidhur me komandën jugosllave dhe komandohet prej andej për çdo gjë... Pengesa që ne gjejmë për ushtrinë kemi biseduar me Kupreshaninin. I kemi thënë atij se ne i gjejmë si pengesa këto marrëdhënie që kemi sot. Ne mendojmë që çdo gjë të zgjidhet me federatën ose konfederatën. Ai më ka pyetur për federatën për Kosovën etj. Unë i kam thënë se këto varen nga ju, pse ju do të kërkoni bashkimin”.<sup>544</sup> Shtruarja e çështjes së Kosovës, në mbledhjen e 15 marsit 1948, nga ana e Kupreshanin dhe Zlatiç ishte bërë për qëllime taktike dhe me sugjerimet e Titos. Kjo, për arsye të nxitjes së interesimit dhe kureshtjes së udhëheqjes së PKSH në temën e federatës jugosllavo-shqiptare. Dihet, ndërkaq, se edhe në bisedimet e Enver Hoxhës me Titon, qershor 1946, kur ishte shtruar çështja e zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, unanimisht ishte arritur marrëveshja parimore që Kosova t’i bashkohej Shqipërisë vetëm kur të realizohej federata e përbashkët midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në mbledhjen e Byrosë së KQ të PKSH, në lidhje me Kosovën, Enver Hoxha kishte informuar Savo Zlatiçin, përmes një radiogrami dhe i kishte deklaruar gatishmërinë e tij që ta shtrojnë për diskutim edhe çështjen e Kosovës: “Mendimi im është që ta ngremë çështjen e Kosovës. Ka ardhur

---

542 Po aty, f. 414.

543 Po aty, f. 411.

544 Po aty, f. 412.

koha që populli shqiptar të grumbullohet".<sup>545</sup> Zhvillimet historike, veçmas ato pas vitit 1948, në planin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, më së miri dëshmojnë përfarsën të cilën, edhe në rastin konkret të apostrofimit të çështjes së Kosovës, e përdorën emisarët ushtarakë dhe politikë jugosllavë që vepronin në Shqipëri. Udhëheqja jugosllave, duke ndjerë rreziqet që vinin nga lidhjet e reja shqiptaro-sovjetike, të realizuara nga takimi i Enver Hoxhës me Stalinin, kishte vendosur që të hiqte dorë nga mbyllja e problemit të Kosovës dhe ta përdorte atë si letër të fundit në synimin për shpejtimin e krijimin e federatës midis dy shteteve fqinje. Në të vërtetë, sipas dokumenteve historike, del se çështja e bashkimit të dy shteteve në një federatë ishte në rrugë të mbarë, pra, edhe pa e shtruar çështjen e Kosovës, çështje kjo të cilën udhëheqja e PKSH, pos në bisedimet Tito-Hoxha, asnjëherë nuk e kishte aktualizuar. Në këtë kuptim, në frymën e diskutimeve intensive brenda KQ të PKSH dhe byrosë së tij, për bashkimin e Shqipërisë dhe Jugosllavisë në një federatë, si dhe për intensifikimin e zbatimit të marrëveshjeve ekonomike, ushtarake e kulturorenë nivelin e marrëdhënieve ndërshtetërore, më 17 mars 1948, Enver Hoxha i dërgoi letër Titos në lidhje me çështjen e bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë në Federatën Ballkanike. Enver Hoxha, pasi e informonte Titon për bisedimet me gjeneralin Milan Kupreshanin në lidhje me vendosjen e forcave jugosllave gjatë kufirit shqiptar, si dhe për çështjen e komandimit të forcave shqiptaro-jugosllave, shprehte pikëpamjen dhe qëndrimin e PKSH për çështjet në fjalë: "... Në parim, duhet të krijohet një komandë unike, pse nuk mundet që në një front ku ndodhen dy ushtri, si tonat, të veprojnë kundër të njëjtit armik nën dy komandatë veçanta... Nga shoku gjeneral Kupreshanini dhe më vonë nga shoku Savo na është sugjeruar në mënyrë jozyrtare se këto vështirësi do të sheshohen më shpejt në rast

<sup>545</sup> Po aty, f. 413.

se bëhet një hap tjetër për parinë lidhje me formën e shteteve tona, domethënë në rast se shkohet sa më shpejt në bashkimin e dy popujve tanë”.<sup>546</sup> Enver Hoxha i konfirmonte Titos: “Në këtë drejtim, na është sugjeruar prej tyre që ne të marrim iniciativën dhe ta kërkojmë këtë gjë, duke e arsytuar nga situata e brendshme, pa marrë parasysh faktorin e jashtëm dhe pavarësisht nga Bullgaria”.<sup>547</sup> Sekretari i përgjithshëm i PKSH, edhe në këtë letër drejtuar Titos, pranonte: “... Pas ardhjes së gjeneral Hamoviçit dhe të shokëve të tjerë të Shtatmadhorisë Jugosllave për të nandihmuar në shpejtimin e unifikimit të ushtrive tona, ne vumë drejtpunën tonë ku ishin vërtetuar gabime të mëdha”.<sup>548</sup> Enver Hoxha, me përkushtim të veçantë, e kishte bindur (miklon) Titon: “Populli ynë është aq i lidhur shpirtërisht dhe ekonomikisht me popujt Jugosllavisë sa as një popull tjetër dhe ky bashkim s’ka asgjë formale, por ndihet thellë në zemrate popullit tonë. Ne duhet të punojmë konkretisht për federatën dhe për këtë gjë në vendin tonë punohet me të gjitha forcat”.<sup>549</sup> Megjithatë, Enver Hoxha, duke mos marrë qëndrim të prerë rreth këshillës së Savo Zlatiçit dhe të gjeneral Milan Kupreshaninit, që pala shqiptare ta paraqiste e para iniciativën për krijimin e federatës së përbashkët shqiptaro-jugosllavo-bullgare, në letërën e 17 marsit 1948 dërguar Titos, kërkonte prej këtij që të jepte mendimin rreth çështjes së federatës dhe bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë. Dhe, duket se interpretimi i Enver Hoxhës ishte më tepër i natyrës taktike, pasi theksonte: “... Ne kemi nevojë të na thuhet nga ju nëse ka ardhur momenti, kur ne duhet të marrim në shqyrtim çështjen e bashkimit dhe të mbërrijmë në konkluzione dhe, nga ana tjetër, do të dëshironim që të na jepeshin disa sqarime më plotësuese që ju i shihni të arsyeshme në lidhje me faktorë të tjerë rreth këtij

546 AQSH, F. 14/AP (M.P.J), dos. 4, v. 1948.

547 Po aty.

548 Po aty.

549 Po aty.

problemi".<sup>550</sup> Siç shihet nga letra e Enver Hoxhës, ai dhe bashkëpunëtorët e tij nuk ishin të disponuar që t'i pranonin propozimet dhe sugjerimet e Savo Zlatiçit dhe të Milan Kupreshaninit për marrjen e iniciativës shqiptare për federatën e dy shteteve fqinje, para se për këtë të deklarohej KQ i PKJ dhe Titos personalisht. Në këtë kuptim, nga distanca historike mund të vlerësohet se veprimi i tillë i Enver Hoxhës ishte domethënës dhe dëshmonte se ai, përkundër zhvillimeve dramatike dhe deklarimeve pro federatës, nuk ngutej për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë. Ai, po ashtu, në letër përmendte edhe faktorët e brendshëm si arsye për bashkimin e dy vendeve. Është për t'u veçuar fakti se letër këmbimi midis Enver Hoxhës dhe Titos ishte zhvilluar pa dijeninë e komiteteve qendrore të dy partive komuniste. Çështja e federatës midis Shqipërisë, Jugosllavisë dhe Bullgarisë ishte diskutuar gjerësisht si pikë e veçantë e rendit të ditës edhe në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 30 mars 1948. Në këtë kohë, Enver Hoxha ende nuk kishte njohuri për letër, të cilën Stalini ia kishte dërguar Titos, më 27 mars 1948, ku paralajmërohej që të bëheshin publike konfliktet dhe mosmarrëveshjet e thella politike e ideologjike midis dy shteteve të kampit socialist. Megjithatë, qysh në fillim të marsit, udhëheqja e PKSH i kishte informacionet e para për mosmarrëveshjet midis Jugosllavisë dhe BRSS dhe kjo kuptohej edhe nga largimi i këshilltarëve ushtarakë dhe specialistëve civilë sovjetikë nga Jugosllavia. Udhëheqja më e lartë e PKSH, në këtë periudhë, kishte filluar të shfaqte rezervat e para për bashkëpunimin me PKJ dhe përgjithësisht Jugosllavinë. Në fakt, edhe për udhëheqjen shtetërore dhe partiake shqiptare, fërkimi i hapur politik dhe ideologjik midis BRSS dhe Jugosllavisë paralajmëronte se edhe për PKSH po afrohej rasti i përcaktimit për njërën nga palët në konflikt politik. Jugosllavët, tanimë për shkaqe taktike, ishin gjithnjë e më

---

550 Po aty.

të rezervuar për realizimin e projektit të federatës së përbashkët me Shqipërinë dhe Bullgarinë, sepse kishin frikë se mos Stalini, me qëllim të shkatërrimit të Jugosllavisë, insistonte në federatën e përbashkët. Prandaj, ishte krejtësisht e qartë pse Enver Hoxha, në fillim të fjalës së tij në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, më 30 mars 1948, kishte thënë: “Savoja (Zlatiçi-A.Z.) erdhi e më dha këtë përgjigje të letrës që i bëra përsa i përket federatës me Bullgarinë. Ai qe vënë në dijeni nga Beogradi se nuk e shihnin të kohës (nuk kishte ardhur momenti) që të bëjmë federatën. Kjo për arsye ekonomike, ushtarake, politike, etj. Shokët (jugosllavët-A.Z.) kanë përshtypjen se e donin federatën me Bullgarinë, pastaj me Shqipërinë”.<sup>551</sup> Zlatiç, siç kishte referuar Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike, megjithatë, kishte paralajmëruar sfidat që do të vinin shumë shpejt në planin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, përgjithësisht dhe jo vetëm në lidhje me projektin e federatës së përbashkët midis dy vendeve fqinje dhe eventualisht edhe me Bullgarinë. Emisari politik jugosllav ishte informuar nga kanalet diplomatike për ecurinë e konfliktit ideologjik dhe politik midis Jugosllavisë dhe BRSS, prandaj i kishte thënë Enver Hoxhës se: “... vija jonë e caktuar nga KQ (mendohet në PKSH -A.Z.) është shumë e drejtë, por do të ketë pengesa”.<sup>552</sup> Koçi Xoxe, që njihet ndër këmbëngulësit e federatës me jugosllavët, edhe përkundër qëndrimit jugosllav se për federatë ende nuk kishte ardhur koha, këmbëngulte në intensifikimin e formave të bashkëpunimit mbi bazat federative, duke kërkuar që: “... Ne duhet të punojmë e të kërkojmë forma bashkë, që në fakt të veprojmë si federatë, pa qenë kjo e publikuar etj.”.<sup>553</sup> Tuk Jakova, në diskutimin e tij, kishte kërkuar që të gjenden format më të përshtatshme për të avancuar projektin e kri-

---

551 AQSH, F. 14/AP, dos. 70, v. 1948.

552 Po aty.

553 Po aty.

jimit të federatës, mirëpo Enver Hoxha, duke e marrë përsëri fjalën, kishte hapur çështjen e njoftimit me çështjen e sovjetëve: “Ne s’u kemi thënë gjë sovjetëve dhe mirë kemi bërë... Për instruktorët sovjetikë, ai (Savo Zlatiç - A.Z.) tha të mos jenë në bazë si këshilltarë, por instruktorë teknikë. Unë i thashë se ne jemi në pozitë të vështirë...”<sup>554</sup> Tuk Jakova, pasi kishte përkujtuar se kjo është fazë tranzitore, më tej, kishte konkluduar: “Për çdo gjë do të bëjmë me Beogradin”. Koçi Xoxe kishte hapur çështjen e informimit, njoftimit të sovjetikëve: “Po sovjetëve, të mos u themi asgjë? T’u themi që s’kemi punë me ta? Nuk është gjë e lehtë. Prandaj unë them se mund të marrim vendim që sonte për këtë, por ta mendojmë”<sup>555</sup> Enver Hoxha, i gjetur para provokimeve të hapura, kishte përkujtuar: “Ne me jugosllavët do të kemi shumë bisedime e propozime. Derisa të mos ketë përfunduar gjë, ne të mos u themi asgjë sovjetikëve, por nga ana tjetër, kjo çështje e federatës nuk është ngritur nga ne, por nga Jugosllavia e Bullgaria. Sa për ne, ne s’lajmërojmë për këtë”. Kristo Themelko, që ishte i një mendimi me Koçi Xoxen, kishte propozuar: “...Mbasi të përfundojmë, t’u themi sovjetikëve, nëse do të bëjmë bashkimin apo jo”<sup>556</sup> Enver Hoxha për herë të parë bëri publik faktin për tërheqjen e këshilltarëve dhe specialistëve sovjetikë nga Jugosllavia, që për të pranishmit ishte element i ri për analizë dhe marrje të vendimeve politike: “Nga Jugosllavia janë tërhequr këshilltarët e specialistët te B.S. Tashti atje i tërheqin, ne i sjellim!”<sup>557</sup> Bërja publike e kësaj të dhëne, për tërheqjen e këshilltarëve ushtarakë dhe specialistëve sovjetikë nga Jugosllavia, e ndërroi mënyrën e qasjes së problemit në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, ndaj Tuk Jakova ishte i pari, i cili ndërroi mendjen dhe tha: “Unë mendoj që t’i vëmë në korrent ata të

554 Po aty.

555 Po aty.

556 Po aty.

557 Po aty.

B.S.”.<sup>558</sup> Më pas, edhe Koçi Xoxe u deklarua: “Këto që do t’u themi sovjetëve, të jenë mendimet tona të përbashkëta. Fjala e Komandantit të jetë fjala e Byrosë. Prandaj, për këto duhet të mendojmë”.<sup>559</sup>

Në javët e para të muajit prill, në aktivet e PKSH ishte lëshuar për diskutim rezolucioni i Plenumit të 8-të të KQ të PKSH, kurse në të njëjtin muaj, Tito i dërgoi Enver Hoxhës dy letra lidhur me zhvillimet më të reja në relacionet e ndërlikuara politike dhe ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Që në fillim të letrës së parë, që mban datën 22 prill 1948, Tito konstatonte keqësimin e përshtetur të marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave: “KQ i PKJ ka arritur në mendimin e njëzëshëm se marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve tona kanë filluar, në kohët e fundit, të keqësohen, ashtu si vitin e kaluar... Cili është shkaku, sipas mendimit tonë? E para, mungesa e besimit të duhur nga ana e juaj në sinqeritetin e mendimeve tona kundrejt Shqipërisë. E dyta, nga ana e Juaj pranohet me fjalë sakrificale materiale që bën vendi ynë me qëllimet më të mira për të ndihmuar aleatën e vet Shqipërinë, kurse në praktikë veprohet në të kundërtën... E treta, ne mendojmë se që në fillim i kemi parë marrëdhëniet tona në mënyrë idealiste dhe jo reale, kurse tani këto kundërshtojnë realitetin”.<sup>560</sup> Tito, duke mos kursyer intonacionin kritik për marrëdhëniet me Shqipërinë dhe udhëheqjen e PKSH, kishte paralajmëruar ndërrim rrënjësor të këtyre marrëdhënieve që mund të shpienin deri në prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave: “... Në qoftë se dëshirojmë me të vërtetë një afrim, të rishqyrtojmë bashkëpunimin tonë të mbarë dhe ta vëmë atë në bazë të atillë që do t’i përgjigjet etapës aktuale dhe rrethanave ndërkombëtare”.<sup>561</sup>

Tito kishte njoftuar për vendimin që nga Shqipëria të

558 Po aty.

559 Po aty.

560 Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1945-1948, f. 467-468.

561 Po aty.



tërhiqej gjenerali Milan Kupreshanin me njerëzit që ishin me të në misionin ushtarak jugosllav dhe të ndërpritej subvencionimi i ushtrisë hqiptare. Mirëpo, Tito njëherit kishte bërë të ditur se Savo Zlatiç e ka informuar edhe për "...disa gjëra të tjera që na bëjnë të shqetësohemi, sepse flasin për diçka që nuk është në rregull dhe që duhet të zgjidhet sa më shpejt e në çdo mënyrë".<sup>562</sup> Në të njëjtën datë, më 22 prill 1948, Tito, dukshëm i shqetësuar nga zhvillimet politike në relacionet Jugosllavi-Shqipëri dhe Jugosllavi-BRSS, i kishte dërguar Enver Hoxhës letrën e dytë ku, në pikën tre, shkruante: "Mbas letrës Suaj të parë, gjeneral Kupreshanini nuk mund të qëndrojë aty për shkak të padive që keni paraqitur në letrën Tuaj kundër tij".<sup>563</sup> Çështja kishte kaluar tek problemi i tërheqjes së instruktorëve ushtarakë jugosllavë, sepse në Shqipëri ishin edhe instruktorët ushtarakë sovjetikë: "... Jam plotësisht i një mendjeje me ju se në gjendjen e sotme tërheqja e instruktorëve ushtarakë sovjetikë do të ishte politikisht e dëmshme".<sup>564</sup> Në fund të letrës, Tito, i cili akuzonte udhëheqjen e PKSH për shfaqje të mosbesimit ndaj udhëheqjes jugosllave, konkludonte: "Pa një besim s'është i mundur një bashkëpunim konstruktiv midis nesh, prandaj duhet ta kapërcejmë këtë mosbesim".<sup>565</sup>

Enver Hoxha tashmë ndjehej më i qetë në raportme akuatdhe paditë e Titos, sepse diku kah 15 prilli kishte marrë letrën, të cilën Stalini ia kishte dërguar, më 27 mars, në emër të KQ të PKBS, Titos dhe KQ të PKJ. Më 25 prill 1948, Enver Hoxha kishte thirrur mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PKSH, në të cilën temë shqyrtimi ishte letërkëmbimi Hoxha-Tito, përkatësisht, zhvillimet më të reja dramatike në relacionet ndërshtetërore dhe partiake midis PKSH dhe PKJ. Në diskutimet anëtarëve të Byrosë të KQ të PKSH u ngrit

562 Po aty.

563 Po aty, f. 470.

564 Po aty.

565 Po aty.

çështja e akuzës jugosllave që buronte nga letrate Titos për mosbesim kinse të palës shqiptarendaj udhëheqjes jugosllave dhe bashkëpunimit me ta. Anëtarët e Byrosë kishin hedhur poshtë si të pabaza akuzate Titos për shfaqjen e mosbesimit të udhëheqjes së PKSHP ndaj asaj jugosllave. Në lidhje me këtë, ishte karakteristikë vlerësimi i Hysni Kapos, ndër bashkëpunëtorët më besnikë të Enver Hoxhës, i cili në diskutimin e tij kishte pohuar: “Në lidhje me mosbesimin që del nga letra se qenkan disa shokë, edhe kjo nuk është e drejtë. Po kështu edhe ajo që thuhet se në teori mendohet ndryshe dhe në praktikë ndryshe. Përgjigja që na jepet se ka mosbesim në disashokë të Byrosë, nuk është e drejtë, meqë vetë shokët sekretarë na i kanë shtruar çështjet ashtu si duhet”.<sup>566</sup> Xhoxhi Blushi kishte deklaruar se: “...Vetëm mosbesimn e kemi krijuar kundrejt Savos dhe Kupreshaninit, në lidhje me propozimet e tyre personale, mbasi na doli ashtu si ajo çështja e divizionit. Edhe për federatën kemi pasur mosbesim te propozimet e tyre personale dhe na dilte çështja që të dallonim mirë, kur ato ishin personale dhe kur ishin të KQJ”.<sup>567</sup> Ndërsa, Koçi Xoxe ishte i drejtpërdrejtë dhe dallonte nga parafolësit e mbledhjes së Byrosë Politike të KQ të PKSHP, mbajtur më 25 prill 1948. Fillimisht, ai kishte formuluar vlerësimin: “Çështja kryesore është mosbesimi, mosbesimi në mendimet e Partisë Komuniste Jugosllave dhe këtu nuk është çështja për një propozim, por për mendimet e një pjese të udhëheqjes... Mosbesimin e lidh me ato që kanë ngjarë në dy-tre muajte fundit. E them në lidhje me divizionin dhe se si u perceptuan çështjet. Ne jetuam propozime jo të drejta edhe për vlerësimin e situatës”.<sup>568</sup> Mirëpo, Enver Hoxha, duke dashur të bënte me dije se në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave po ndodhnin thyerje të mëdha dhe se po ndërronte kursi politik i bashkë-

---

566 AQSH, F.14/AP,dos. 82, v. 1948.

567 Po aty.

568 Po aty.

punimit, gjithsesi, në varësi të konfrontimit ideologjik dhe politik midis BRSS dhe Jugosllavisë, kishte precizuar: “Unë nuk jam dakord me pikëpamjet e Marshallit... Unë mendojse Marshalli këto çështje me kaq rëndësi nuk i ka studiuar realisht dhe nuk ka të drejtë... Mosbesimin nuk e pranoj, pse nuk është”.<sup>569</sup> Enver Hoxha, kësaj radhe kishte shkuar edhe më larg, duke marrë guximin që të pranonte ndërhyrjen jugosllave dhe kërkesat e tyre ultimative: “Nga ana e tyre ka pasur presion”.<sup>570</sup> Ky qëndrimi prerë i Enver Hoxhës, i thënë për herë të parë nga fillimi i mosmarrëveshjeve dhe ballafaqimeve politike me udhëheqjen e PKJ, ishte shenjë e qartë edhe për grupin projugosllavë të Koçi Xoxesë po paralajmëroheshin ngjarje dhe sfida të reja. Me këtë vlerësim të Enver Hoxhës, po ashtu, kuptohej se edhe brenda udhëheqjes më të lartë të Byrosë dhe KQ të PKSH, në lidhje me raportet me Jugosllavinë, priteshin thyerje politike. Megjithatë, letra e Enver Hoxhës dërguar Titos, më 23 maj 1948, së paku deklarativisht, thirrrej në marrëdhëniet e mira ndërshtetërore dhe kundërshtonte dyshimet e PKJ ndaj PKSH në lidhje me “vijën e dytë brenda PKSH” përse u përket marrëdhënieve me Jugosllavinë. Enver Hoxha, në konkluzionin nismëtar të pikës së parëtë letrës, e njoftonte Titon: “Byroja Politikee KQ të PKSH nuk pajtohet me pikëpamjet dhe konkluzionet e arritura nga KQ i PKJ, se marrëdhëniet midis dy vendeve tona kanë filluar kohët e fundit të keqësohen për fajin tonë... Një akuzë e tillë e paargumentuare dhe pabaza nuk pranohet nga ana jonë... se marrëdhëniet vëllazërore, aleanca e pavdekshme me popujt e Jugosllavisë është një konditë e dorës së parë për ruajtjen e independencës dhe sovranitetit të tij, për ruajtjen e fitoreve të mëdhatë luftës dhe për ndërtimin e socializmit në vendintonë”.<sup>571</sup> Në letër, gjithashtu, konstatohej: “Byroja

---

569 Po aty.

570 Po aty.

571 AQSH, F. 14/(MPJ), dos. 4, v. 1948.

Politike e KQ të PKSH nuk mund të pranojë, as thënien, as qëllimin e KQ të PKJ, kur thotë se një nga shkaqet e keqësimit të marrëdhënieve është se njëfarë pabesimi ushqehet karshi mendimeve tuaja nga ana e një pjese të udhëheqësve shqiptarë. Kjo kurrë nuk ka qenë e vërtetë dhe një thënie e tillë jo e drejtë nuk ndihmon”.<sup>572</sup> Përgjigja e Enver Hoxhës drejtuar Titos për dy letrat e 22 prillit 1948, edhe pse mohonte kritikën e KQ të PKJ në adresë të KQ të PKSH, përmbylej megjithatë me kërkesën që me mirëkuptim reciprok të tejkaloheshin keqkuptimet dhe mosmarrëveshjet: “Marrëdhëniet me popujt Jugosllavisë dhe me Partinë motër Jugosllave janë të shenjta për udhëheqjen tonë”.<sup>573</sup> Më 31 maj 1948, KQ i PKJ i dërgoi sërish letër mospajtimi KQ të PKSH dhe me këtë mori fund letër këmbimi midis dy partive, midis Enver Hoxhës dhe Titos. Me këtë akt, marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave morën goditjen përfundimtare për të hapur kështu front të ri të luftës politike dhe ideologjike midis PKSH dhe PKJ që kulmoi me ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike, në fund të vitit 1948.

PKSH ishte ndër partitë e para të Evropës Juglindore, përkatësisht të kampit komunist që e pranuan rezolucionin e Informbyrosë dhe padinë e PK të BRSS kundër PKJ dhe personalisht udhëheqjes jugosllave.

Më 29 qershor 1948, KQ i PKSH publikoi komunikatën me të cilën solidarizohej me rezolutën e Byrosë Informative “Mbi gjendjen në PKJ”, ku dënohej rruga e PKJ dhe e udhëheqjes së saj përbrenda kampit socialist. Në pikën 2 të Komunikatës së KQ të PKSH konstatohej dhe njëkohësisht pranohej: “Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Shqiptare ka qenë vazhdimisht në konflikt me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste Jugosllave, i cili është përpjekur t’i imponojë vendit tonë dhe Partisë sonë metodat dhe politikën

---

<sup>572</sup> Po aty.

<sup>573</sup> Po aty.

e tij tradhtare, armiqësore, trockiste. Komiteti Qendrori Partisë Komuniste Jugosllave, me në krye Titon, kanë shtrembëruar të gjitha marrëdhëniet politike dhe ekonomike me vendin tonë...".<sup>574</sup> Nga përmbajtja e komunikatës në fjalë shihej qartë se udhëheqja e PKSH, me në krye Enver Hoxhën, ishin të vendosur që të braktisnin bashkëpunimin deri në nënshtrim me PKJ dhe të mbanin anën e PK të BRSS, që ishte qendra politike e kampit komunist. Duke akuzuar dhe anatemuar me kualifikime të llojllojta deri në tradhti PKJ dhe udhëheqjene saj, PKSH i thurte lavde Bashkimit Sovjetik dhe Stalinit, që ndryshe paralajmëronte qartazi kursin e ri të politikës së jashtme të Shqipërisë. Enver Hoxha, i cili kishte muaj që heshtazi ishte në konflikt dhe në mosmarrëveshje të thella me jugosllavët, në këto thyerje të mëdha politike dhe ideologjike brenda kampit komunist, e shfrytëzoi situatën për të shpëtuar nga kthetrat e gllabërimit eventual jugosllav. Në Komunikatën e KQ të PKSH vlerësohej: "Në momentin më të rëndë të konfliktit të egër që ekzistonte në mes të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, konflikt i shkaktuar nga udhëheqësit antimarksistë jugosllavë, ndihma e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, e shokëve të shtrenjtë Stalin e Molotov që iu dha Partisë sonë dhe gjithë partive të tjera motra komuniste, ishte shpëtimtare për popullin Partinë tonë Komuniste".<sup>575</sup> Më 1 korrik 1948, qeveria shqiptare i kishte dërguar qeverisë jugosllave notë diplomatike, me të cilën konfirmonte ndërprerjen e të gjitha marrëveshjeve, konventave dhe protokolleve ekonomike që ishin nënshkruar ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në notën e qeverisë shqiptare ishin theksuar një varg çështjesh, të cilat argumentonin se qeveria jugosllave i ka shkelur të gjitha klauzolat e marrëveshjeve ndërshtetërore, duke mos realizuar detyrimet

---

574 PPSH, Dokumente kryesore, I, Tiranë, 1971, f. 475.

575 Po aty, f. 476.

sipas konventave të nënshkruara midis dy vendeve: “Përsa i përket shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave, qeveria jugosllave, në kundërshtim me principet mbi të cilat ato janë realizuar, nuk ka ndërmarrë kurrfarë investime në këto shoqëri, përkundrazi, ka eksploatuar pasuritë e vendit tonë, duke kërkuar që pa të drejtë të imponojë vullnetin e vetë, duke shkelur në këtë mënyrë konventën”.<sup>576</sup> Qeveria shqiptare anulonte të gjitha marrëveshjet, konventat dhe protokollat e nënshkruara pas Konventës për Miqësi dhe Bashkëpunim Reciprok, të datës 9 korrik 1946 në Tiranë, duke i shpallur të pavlefshme dhe joekzistuese. Megjithatë, qeveria shqiptare ofronte mundësi të rishikimit të kushteve dhe rrethanave të reja të bashkëpunimit midis dy shteteve, mirëpo “... këto marrëdhënie duhet të vendosen mbi baza të drejta të barazisë reciproke, që me konsekuencë të respektojnë të drejtat e popujve dhe të mos cenojnë pavarësinë dhe sovranitetin e dy vendeve”.<sup>577</sup>

Edhe qeveria e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, më 1 korrik, i kishte drejtuar një notë proteste qeverisë shqiptare lidhur me ndalimin e shitjes së gazetës jugosllave “Borba” në Shqipëri, mbylljen e librarisë “Libri jugosllav” dhe heqjen e fotografive të Titos nga zyrat e institucioneve të shtetit shqiptar: “Ky veprim brutal dhe ofendim nga ana e pushtetit shqiptar, personalitetit të kryetarit të qeverisë së RFJ, marshallit të Jugosllavisë Josip Broz Tito, është në kundërshtim me marrëveshjet shumta dhe marrëdhëniet miqësore midis popujve dhe vendeve tona...”.<sup>578</sup> Në të njëjtën datë, qeveria jugosllave i dërgoi notën e dytë të protestës qeverisë shqiptare me rastin e prishjes së marrëveshjeve ekzistuese ekonomike: “Qeveria jugosllave thekson konstaton faktet e lartpërmendura paraqesin... akt vandal kundër RFJ, të cilat

---

576 “Libri i Bardhë”, Beograd, 1951, f. 273.

577 Po aty.

578 ASFPJ, PA, 1948, Alb, (F-1), nr. 417822.

janë të papranueshme, aq më tepër kur dihet se dy të tretat e vëllimit të marrëveshjeve ekonomike shqiptaro-jugosllave përbëjnë ndihmën e pastër të RFJ për Shqipërinë”.<sup>579</sup> Në vazhdim, qeveria jugosllave kërkonte që qeveria shqiptare të mos i zbatonte aktet e sipërpërmendura të 29 dhe 30 qershorit të vitit 1948 dhe të dërgonte në Beograd delegacionin me qëllim të rregullimit të çështjeve të bashkëpunimit ekonomik, sipas marrëveshjes së arritur në prill të vitit 1948. Sipas notës së qeverisë jugosllave, përgjegjësia për pasojat, që mund të dilnin nga mosrespektimi i marrëveshjeve të nënshkruara ndërshtetërore, binte mbi qeverinë shqiptare. Qeveria shqiptare vazhdonte të këmbëngulte në vendimin për ndërprerjen e bashkëpunimit me Jugosllavinë, pra njëherit edhe për mosrealizimin e marrëveshjeve ekonomiko-tregtare. Më 2 korrik 1948, qeveria jugosllave, përmes sektorit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, i kishte dërguar notën e tretë qeverisë shqiptare duke e akuzuar për masat e ndërmarra në përzënien e Spiro Serzentiçit, instruktor i drejtorisë kryesore politike të Armatës Jugosllave pranë drejtorisë politike të Armatës Shqiptare. Në notën jugosllave, pasi konfirmohej se më 24 korrik 1948 shefi i Gjeneral shtabit të Ushtrisë Shqiptare, gjeneral-major Beqir Balluku dhe gjeneral-major Kristo Themelko, e kishin ftuar Spiro Serzentiçin dhe i kishin komunikuar se menjëherë duhej ta lëshonte Shqipërinë, më tej konstatohej: “Për shkak të gjithë kësaj, sjellja ndaj gjeneralit të sipërpërmendur flet për sulmin e qëllimtë në autoritetin e armatëssonë dhe përfaqësuesve të saj në Shqipëri, në respektin e vendit tonë dhe të popujve tanë”.<sup>580</sup> Qeveria jugosllave, po ashtu, më 2 korrik 1948, në adresë të qeverisë shqiptare kishte dërguar notën diplomatike, me të cilën protestohej kundër vendimit të qeverisë shqiptare për ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të marrëdhënieve, konventave

579 ASFPJ, PA, 1948, Alb. (F-1), nr. 417823.

580 ASFPJ, PA, 1948, Alb. (F-1), nr. 417824.

dhe marrëveshjeve ekonomike. Në notën jugosllave përkujtohej se asnjëra nga dy shtetet nënshkruese të marrëveshjes së përbashkët, e cila kishte vlerë në afat prej 30 vjetësh, nuk kishte të drejtë që njëanshëm të ndërpriste marrëveshjet në fjalë. Në të konstatohet: “Akti i Republikës Popullore të Shqipërisë paraqet prishjen kundërthënëse të marrëveshjeve ekzistuese, të cilat ajo, jo vetëm që nuk mund t’i anulojë para kalimit të afatit të marrëveshjes, mirëpo nuk mund t’i konsideroj inekzistente dhe të pavlefshme, sepse të gjitha këto marrëveshje janë ratifikuar sipas rregullave kushtetuese të dy vendeve”.<sup>581</sup> Hartuesit e notës jugosllave, duke kundërshtuar si fallse dhe të paargumentuara pohimet e notës së qeverisë shqiptare dërguar asaj jugosllave, në tekstin e notës së 2 korrikut 1948, formulonin qëndrimin: “Për sa i përket tonit të notës së qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe fakteve të shpifura, të cilat theksohen në të, gjoja se qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë është shkaktare e prishjes së marrëveshjeve dhe se ka frenuar zhvillimin Republikës Popullore të Shqipërisë, ka eksploatuar Shqipërinë, etj. - e tërë kjo bie në suaza të propagandës së organizuar, e cilakohëve të fundit zhvillohet kundër Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë”.<sup>582</sup>

Gazeta “Borba”, në artikullin me titull: “Veprimet aventuriere të qeverisë shqiptare kundër interesave jetike të popullit shqiptar”, më 6 korrik 1948, vlerësonte: “Kroatja e mjerë dhe e çmendur për imperializmin e Jugosllavisë së re, për qëllimet gllabëruese, të cilat gjoja kanë pasur për qëllim që Shqipërinë ta bëjnë koloni, dëshmojnë për atë se nuk tregohet kujdes për interesat themelore të zhvillimit dhe forcimit të ekonomisë shqiptare, por atyre u kundërvihen interesa krejtësisht të tjera, të cilat nuk mund të kenë asgjë të përbashkët as me interesa të popullit shqiptar, as me interesate

581 “Libri i bardhë”, Beograd, 1951, f. 73-74.

582 Po aty.



bllokut anti imperialist”.<sup>583</sup> Edhe në notën diplomatike të datës 7 shtator 1948, qeveria jugosllave e kritikon qeverinë shqiptare për përmbajtjen, siç thuhet, ofenduese të notave diplomatike të qeverisë shqiptare drejtuar asaj jugosllave në lidhje me prishjen e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Pas konstatimit se me përmbajtjen dhe tonin e tillë të notave diplomatike të qeverisë shqiptare synohej dobësimi dhe shkëputja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe se për këtë përgje-gjësinë e mban vetëm qeveria shqiptare, në notën diplomatike jugosllave njoftohej: “Qeveria e RDFJ përsëri ia tërheq vërejtjen Republikës Popullore të Shqipërisë se nuk mundet dhe nuk do të pranojë nota të shkruara në praktikën diplomatike me mënyrën ofenduese”.<sup>584</sup>

Në këtë periudhë dhe atmosferë të përshpejtimit të akuzave reciproke midis PKSH dhe PKJ, kur tanimë ishte e qartë se konfrontimi politik dhe ideologjik midis dy partive komuniste, udhëheqjeve të tyre dhe përgjithësisht marrëdhënieve ndërshtetërore po shkonte drejt prishjes përfundimtare, në Tiranë, nga data 13 deri më 24 shtator 1948, i zhvilloi punimet Plenumi XI i KQ të PKSH. Ky plenum paraqet pikën kulmore të thyerjeve në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Enver Hoxha, në referatin e tij kishte konstatuar: “Pas çlirimit të vendit, për shkak të ndërhyrjes brutale të udhëheqjes revizioniste jugosllave në punët e brendshme të partisë dhe të vendit tonë, si dhe të punës armiqësore të grupit të Koçi Xoxes, vija organizative bëhet në përgjithësi jo e drejtë”.<sup>585</sup> Në rezolucionine Plenumit XI të KQ të PKSH, të aprovuar më 24 shtator 1948, konstatohej: “Partia... në punën e saj, gjatë luftës ka hasur në pengesa të ndryshme, siç ka qenë veprimtaria antiparti e fraksionistëve dhe e grupazheve dhe veprimtaria e gabuar e disa udhëheqësve të veçantë. Pas çlir-

---

583 “Borba”, 6.VII.1948, f. 3.

584 “Libri i bardhë”, f. 83-84.

585 Po aty, f. 478.

imit të vendit, pengesa kryesore në rrugën e partisë sonë ka qenë veprimtaria e udhëheqjes jugosllave, e ndërhyrjes së saj në punët e partisë sonë, ka qenë influenza e udhëheqjes jugosllave në udhëheqjen e partisë sonë... qëllimet e udhëheqjes jugosllave kanë qenë keqbërëse karshi vendit tonë dhe marrëdhëniet në mes dy vendeve tona u shtrembëruan prej tyre me rrugë antimarksiste dhe antishqiptare”<sup>586</sup>. Udhëheqja e PKSH e akuzonte PKJ për qëllime koloniale ndaj Shqipërisë: “...Shqipëria të ishte nën mëshirë të Jugosllavisë dhe të furnizohej me bukë dhe me artikuj të fabrikuar nga jashtë aq sa dëshironte Jugosllavia dhe me ato çmime që dëshironte ajo. Që ky sistem shfrytëzues kapitalist dhe kolonial të ishte i plotë, Komiteti Qendrori Partisë Komuniste Jugosllave u përpoq të izolonte vendin tonë politikisht dhe ekonomikisht nga Bashkimi Sovjetik dhe nga demokracitë e tjera popullore”<sup>587</sup>. Plenumi XI, që përcaktoi platformën politike të prishjes së marrëdhënieve me Jugosllavinë, për herë të parë në rezolucionin e tij ndërmori qëndrimin për rehabilitimin politik të Nako Spirus, të akuzuar në Plenumine 8-të për vijë të dytë antijugosllave në radhët e PKSH. Në rezolucion formulohej qëndrimi, sipas të cilit: “Në krye të kësaj lufte parimore kundër tendencave shfrytëzuese koloniale të grupit të Titos ka qenë shoku Enver Hoxha, shoku Nako Spiru dhe mjaft shokë tjerë të Byrosë dhe të Komitetit Qendror... Grupi i Titos kërkonte të eliminonte bashkë me shokun Enver Hoxha dhe shokët Nako Spirun, Mehmet Shehun, etj. që ishin solidarë dhe luftonin për vijën e drejtë politike...”<sup>588</sup>. Në rezolutë konstatohej qëllimi jugosllav për të krijuar në Byronë Politike të KQ të PKSH një psikozë të rëndë lufte dhe kërcënimesh, të cilit i printe Koçi Xoxe. Plenumi konstatonte: “Për këto gabime, në çështjet e kuadrit dhe në vijën organiza-

---

586 Po aty, f. 483-487.

587 Po aty, f. 488.

588 Po aty, f. 489-490.

tive, Koçi Xoxe ka një përgjegjësi të madhe... Gabimi i madh ka qenë fakti që sekretari organizativ i partisë ka qenë njëkohësisht dhe ministër i brendshëm...".<sup>589</sup> Plenumi XI i KQ të PKSH, për shkak të përgjegjësive politike, kishte shkarkuar Koçi Xoxen nga detyra e sekretarit organizativ të PKSH, Pandi Kriston nga Byroja e KQ të PKSH, Xhoxhi Blushin nga kandidati i Byrosë Politike, kurse Kristo Themelkos dhe Pëlumb Dishnicës iu shqiptuan vërejte të rënda me shënim në biografi. Koçi Xoxe, i cili formalisht u caktua në Ministrinë e Industrisë, u përpoq së koti që të shpëtonte, por nuk i ndihmoi as autokritika dhe as betimi i tij për besnikëri ndaj Bashkimit Sovjetik. Më 31 tetor 1948, Koçi Xoxe u përjashtua nga të gjitha funksionet zyrtare partiake e qeveritare, kurse më 22 nëntor, ai u përjashtua nga Partia Komuniste dhe pas kësaj u arrestua së bashku me Pandi Kriston. Më 8 korrik 1949, Koçi Xoxe u dënua me vdekje dhe po atë ditë u ekzekutua.

Qeveria jugosllave, përkatësisht, Ministria e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, duke qenë e bindur se keqësimi i mëturjtëshëm deri në prishje i marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishte i paevitueshëm, më 28 shtator 1948, i dërgoi Legatës së RPSH në Beograd notë verbale, me të cilën i konfirmonte prishjen e marrëveshjes së shkurtit të vitit 1947 për mbrojtjen e interesave shqiptare, të cilën e kryente Jugosllavia në vendet me të cilat Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike (në Belgjikë, Brazil, Egjipt, Angli, Itali, Kanada, Meksikë, Norvegji, Zvicër, Suedi, Turqi, SHBA, Çekoslovakia, Poloni, Rumani dhe Hungari): "Veprime të tilla të qeverisë shqiptare e detyrojnë qeverinë e RDFJ që t'i bëjë të ditur qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisëse më nuk do të ndër marrin kurrfarë përkujdesje rreth repartimit të shqiptarëve të internuar në Gjermani dhe Austri dhe gjithashtu nuk ndjehet më e obliguar që në të ardhmen edhe më tej të mbrojë interesat dhe të drejtat e Republikës Popullore të

<sup>589</sup> Po aty, f. 495.

Shqipërisë dhe të qytetarëve të saj në vendet, në të cilat këtë e ka bërë deri më tani”.<sup>590</sup> Qeveria jugosllave, më 18 tetor 1948, i kishte dërguar qeverisë shqiptare notë të re diplomatike, për arsye të: “...mbajtjes së detyruar të qytetarëve jugosllavë dhe veprimeve të pushtetit shqiptar”.<sup>591</sup>

Udhëheqja e PKSH, në vjeshtëne vitit 1948, kishte bërë përpjekje të reja për të rishikuar në mënyrë kritike marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave. Enver Hoxha, në referatin e tij para aktivitetit të Partisë në Tiranë, duke zbardhur qëllimet jugosllave, vlerësonte: “Kritika (jugosllave -A.Z.) kishte për qëllim kryesor ta bënte vendin tonë një republikë të shtatë të Jugosllavisë, ta nënshtrohte atë nën urdhrat dhe direktivat e Beogradit, vendi ynë të bëhej një koloni e Jugosllavisë se pavarësia e tij të ishte formale, e mbuluar dhe e maskuar me formulat e pseudopavarësi së borgjeze”.<sup>592</sup> Enver Hoxha kishte pranuar për herë të parë se këshilltarët sovjetikë ishin larguar nga Shqipëria, më 1948, me urdhrin e jugosllavëve: “Ne asnjëherë nuk kemi qenë të bindur për ikjen e këshilltarëve sovjetikë, por nën presionin e tyre ne lëshuam në këtë drejtim dhe gabuam... Në këtë kohë, udhëheqja jugosllave kërkoi ardhjen e një divizioni jugosllav në zonën e Korçës... Ardhja e këtij divizioni në atë kohë dhe shpallja e zonës së Korçës, zonë jugosllave, siç kërkuan jugosllavët, ishte një akt pa precedent që mund të krijonte një incident me karakter ndërkombëtar”.<sup>593</sup> Gjithashtu, ai pranon se me sugjerimin e sovjetikëve, qeveria shqiptare kundërshtoi ardhjen e divizionit jugosllav në Korçë dhe se qëllimi i jugosllavëve, në këtë periudhë, ishte që edhe udhëheqjen e PKSH ta vinte në pozita kundërshtuese me Bashkimin Sovjetik. Enver Hoxha, ndërkaq, në raportin e mbajtur në Kongresin

---

590 ASFPJ, PA, 1048, ALB. (F-5), dos. 2.

591 ASFPJ, PA, 1948, ALB. (F-3).

592 Enver Hoxha, Vepra, 5, Tiranë, 1970, f. 64.

593 Po aty.

I të PKSH në kapitullin për marrëdhëniet midis PKSH dhe PKJ, gjatë luftës dhe deri në prishje të tyre, kishte përmendur qëllimet gllabëruese të jugosllavëve, të cilat sidomos kishin kulmuar në Plenumine 8-të të KQ të PKSH, i cili: "... hodhi bazate nënshtrimit të partisë sonë nën grupin trockist... Pas mbarimit të Plenumit të 8-të doli rezolucioni i tij, i cili ishte dokumenti më i hidhur i historisë së Partisë sonë...".<sup>594</sup> Ai, po ashtu, pranonte: "...Partia jonë nuk mund të thotë se nuk i ka shpëtuar influencës së Partisë Komuniste Jugosllave. Partia jonë ka marrë mjaft gjëra nga organizimi i frontit në Jugosllavi, si edhe mjaft formulime të gabuara të jugosllavëve, të cilat i ka adoptuar".<sup>595</sup> Gogo Nushi, anëtar Byrosë Politike të KQ të PKSH, në raportin e mbajtur në Kongresin I të KQ të PKSH, zbërthen elementet kryesore të ndikimit dhe ndërhyrjes jugosllavë në politikën ekonomike në Shqipëri dhe njëherit pasqyron kushtet ekonomike jugosllave që kushtëzuan varësinë ekonomike të shtetit shqiptar nga Jugosllavia. Ai kishte rikonstatuar se me nënshkrimin e konventës ekonomike ishte vendosur koordinimi i planeve ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, parifikimi i monedhës, unioni doganor dhe unifikimi i çmimeve ndërmjet dy shteteve. Në lidhje me parifikimin e monedhës ishte paraparë që: "...të kishte pagesa të barabarta për gjithë punonjësit, duhej që çmimet të ishin unike, por në realitet asgjë nga këto nuk ekzistonte dhe ishte kaq e zorshme, sa edhe e pakuptueshme si do të bëheshin... Ne menduam se kjo reformë monetare do të shkaktonte humbje të mëdha politike, duke krijuar në popullnjë situatë mosbesimi tek monedha jonë dhe nga ana tjetër ky mosbesim të shkaktonte perturbacione të mëdha në jetën ekonomike dhe sidomos në sektorin privat në lidhje me ngritjen e çmimeve".<sup>596</sup> Gogo Nushi kishte

594 Po aty, f. 542-543.

595 Po aty, f. 569.

596 Kongresi I i Partisë Komuniste të Shqipërisë (8-22 nëntor 1948), Tiranë, 1950, f. 464-465.

raportuar se edhe për unifikimin e çmimeve kishte pasur kundërshtime të mëdha midis palës shqiptare dhe asaj jugosllave: "Natyrisht unifikimi i çmimeve ishte i lidhur me parifikimin e monedhës dhe sa u realizua e pamë më lartë, por ishte çështja që konkretisht të vihej në jetë akordi për unifikimin e çmimeve. Doli problemi se si do të kishim ne çmime unike dhe a mund të kishim... Kishte edhe propozime absurde, nga ana e qeverisë jugosllave, që për të arritur realizimin e akordeve duhej që qeveria jonë të subvenciononte nga buxheti gjithë çmimet që ishin më të larta sesa në Jugosllavi dhe si konsekuencë asnjë akumulacion të mos krijohej nga ana e qeverisë sonë, por buxheti të varej kryesisht nga kredianë kartë që do t'i jepte Jugosllavia".<sup>597</sup> Nga kushtëzimet e tilla të palës jugosllave shihej se, Jugosllavia në fushën e ekonomisë synonte që, përmes akordit, të dobësonte pavarësinë edhe ashtu modeste ekonomike të shtetit shqiptar. Prandaj, pala jugosllave me këtë plan angazhohej që politika e çmimeve të mos bëhej nga qeveria shqiptare, por nga ajo jugosllave. Edhe unionin doganor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ekspertët shqiptarë fillimisht e kishin kuptuar si lehtësim për shkëmbimin e mallrave ndërmjet dy vendeve, pa taksë doganore. Mirëpo: "...Tjetër ishte qëllimi i jugosllavëve në lidhje me zbatimin e unionit doganor. Ata mendonin që me vënien në zbatim të unionit doganor të hapeshin kufijtë, dhe, ndërmarrje ose tregtarë të ndryshëm mund të vinin nëpër qytete të Shqipërisë dhe të blinin prodhime, që ishin në treg të lirë dhe t'i çonin në Jugosllavi, këtë punë mund ta bënim edhe ne. Ata mendonin sesi leku dhe dinari të shkëmbeheshin lirisht pa asnjë kufizim në të dy vendet. Ne këtë e kundërshtuam rreptësisht, pse kjo ishte në dëm tonë dhe në të vërtetë kuptuam qëllimet e errëta të tyre, pse ne e dinim mirë edhe gjendjen tonë dhe të atyre vetë".<sup>598</sup> Ndërhyrja eko-

597 Po aty, f. 468-469.

598 Po aty, f. 470-471.

nomike jugosllave, sipas raportit të Gogo Nushit, ishte edhe më e qartë në fushën e koordinimit të planeve ekonomike midis dy shteteve. Marrëdhëniet në këtë aspekt ishin krejtësishtë pabarabarta: “Ne nuk kishim koordinim planesh, por sipas mendimit të udhëheqjes nacionaliste jugosllave, ne duhej të vareshim krejt nga ata dhe plani ynë duhej të ishte një pjesë e pandarë e planit të tyre. Ata duhej të diktonin dhe të vendosnin për zhvillimin e ekonomisë sonë dhe përpërparmin e vendit tonë, ashtu si dominata dhe në interesin e tyre”.<sup>599</sup> Plani ekonomik shqiptar duhej të orientohej dhe të përpilohej sipas planit ekonomik jugosllav dhe jo sipas nevojave të shtetit shqiptar.

Madje jugosllavët, për ta rritur shkallën e varësisë ekonomike të popullit shqiptar, u kishin premtuar edhe sigurinë e bukës: “Ne nuk duhej të siguronim bukën vetë dhe bujqësinë tonë duhej ta orientonim kah pambuku dhe nga bimët tjera industriale, që ishin bazë për industrinë jugosllave, pse bukën do të na e siguroninata”.<sup>600</sup> Qëllimi jugosllav ishte i qartë, ta nënshtrohte ekonomikisht Shqipërinë edhe ashtu të varfër skajshmërisht, në mënyrë që më lehtë të shtrinte ndikimin politik dhe më pas edhe ushtarak mbi udhëheqjen e PKSH dhe përgjithësisht mbi popullin shqiptar. Duke shpjeguar interesat reciproke shtetërore në rastin e krijimit të shoqërive të përbashkëta shqiptaro-jugosllave, Gogo Nushi kishte vërejtur: “Shoqëritë e përbashkët au ngritën gjoja në baza pariteti. Ky paritet, jo vetëm që nuk ka ekzistuar, por i shtruar sipas akordeve vetëm në kapitullin bazë, ishte ormal dhe mashtrues... Qeveria jugosllave po bëhet pjesëtare në shoqëritë me të drejta të barabarta me qeverinë shqiptare, si në drejtimin, ashtue dhe në shfrytëzimin e tyre, pa derdhur asnjë kapital, me përjashtim të kapitalit bazë, që ishte më tepër se minimal e formal... Kështu që shoqëritë e

---

599 Po aty, f. 472-473.

600 Po aty.

përbashkëta dalëngadalë po ktheheshin në ndërmarrje ekonomike jugosllave ose më mirë ndërmarrje federative si u thoshin ata, duke larë duart ne prej tyre".<sup>601</sup>

Rezolucioni i KongresitI të KQ të PKSH kishte përcaktuar platformën e re të PKSH dhe përgjithësisht të qeverisë shqiptare edhe në planin e politikës së jashtme, duke krijuar lidhje dhe bashkëpunim të gjithanshëm me Bashkimin Sovjetik: "Ajo (PKSH -A.Z.) është dhe do të mbetet me partinë bolshevike, Stalinin e madh dhe me Byronë Informative të Partive Komuniste dhe Punëtore motra, kundër udhëheqjes antimarksiste, antisovjetike dhe antishqiptare të Partisë Komuniste Jugosllave me Titon në krye".<sup>602</sup>

Në historiografinë perëndimore, me të drejtë, qëndron vlerësimi se nën patronatin e Titos, regjimi komunist shqiptar në vitet e para të pasluftës arriti të mbijetojë pa vështirësi të mëdha. Pas ndarjes me Titon, në radhë të parë, për shkak të mungesës së mëtejshme të furnizimit jugosllav, standardi ekonomik shqiptar edhe ashtu modest dhe i varfër kishte pësuar rënie të vazhdueshme, duke krijuar tek popullata pakënaqësi dhe tronditje të mëdha ekonomiko-sociale. Acarimi i situatës politike dhe ekonomike në Shqipërinë e vitit 1948-1949, determinohej edhe nga përpjekjet e vazhdueshme të regjimit të Titos që të rrëronte regjimin e Enver Hoxhës. Në rrethanat e tilla të krijuara pas prishjes me jugosllavët, regjimi komunist shqiptar ishte detyruar që të shtrëngonte grushtin e tij mbi popullin, të rreptësonte kontrollin ndaj lëvizjeve politike opozitare, të rriste kontrollin policor ndaj masave qytetare. Stalini, i cili kishte luajtur rolin kryesor në thyerjet midis atij vetë dhe Titos, por pa dyshim edhe midis Titos dhe Enver Hoxhës, ishte aq i fortë sa t'i garantonte këtij të fundit mbajtjen pa problem të postit të titullarit të qeverisë shqiptare dhe të prijësit të PKSH. Stalini i kishte

---

601 Po aty, f. 475-476.

602 Po aty, f. 563.



dhënë leje Enver Hoxhës që të përgatiste procesin politike policor kundër Koçi Xoxes, për të cilin kishte të dhëna të mjaftueshme se ishte me bindje dhe veprime antisovjetike dhe projugosllave. Stalinit, por edhe vetë Enver Hoxhës, i duheshin kuadro të dëshmuara prosovjetike dhe antijugosllave, ndërkaq procesi kundër Koçi Xoxes ishte shenjë se sovjetikët ishin të vendosur që në Shqipëri të instalonin një qeveri krejtësisht prosovjetike, të dëgjueshme dhe politikisht të disiplinuar. Ndër kuadrot që shquheshin për militantizëm në orientimin prosovjetik dhe në qëndrimin e rreptë antijugosllav veçoheshin: Bedri Spahiu, gjeneralmajor i përbetuar sovjetik dhe gjeneral lejtënant Mehmet Shehu, i cili kishte vijuar Akademinë Ushtarake Voroshilov gjatë viteve 1945-1946. Madje, për Mehmet Shehun pohohet se, pikërisht me urdhër të sovjetikëve ishte emëruar ministër i Punëve të Brendshme, pas pushkatimit të Koçi Xoxes. Prania dhe ndikimi sovjetik në Shqipëri kishte zënë fill veçmas në vitin 1948, kur pas abrogimit të marrëveshjes tregtare me Jugosllavinë, Shqipëria lidhi marrëveshje tregtare me BRSS dhe vendet tjera të orbitës: "Marrëveshja shqiptaro-sovjetike, e nënshkruar në shtator të vitit 1948 dhe e ripërtërirë më 1949, është më e madhja për nga vëllimi dhe vlera, e pas tyre për nga rëndësia renditen marrëveshjet tregtare me Çekoslllovakinë, Rumaninë, Poloninë, Hungarinë dhe Bullgarinë. Prodhimet kryesore që Shqipëria do t'i marrë nga BRSS dhe nga satelitët e saj janë drithërat, pajimet transportuese, tekstili, pajime bujqësore, benzina, dhe xeheet. Pjesa më e madhe e këtyre marrëveshjeve janë në bazë të kredive, meqë vlera e eksporteve shqiptare nuk do të mbulonte koston e importit... Pohohet se, në periudhën prej 1 shtatori deri më 15 dhjetor 1948, BRSSi ka dorëzuar gjithsej 38.000 tonë mallra Shqipërisë. Pjesa më e madhe e materialit që ka marrë Shqipëria, s'ka dyshim se ishte destinuar për përdorim nga forcat guerile greke".<sup>603</sup> Në fakt,

603 Dokumente sekrete të CIA-s për Kosovën, Shqipërinë, Jugosllavinë dhe

BRSS, qysh nga qershori i vitit 1948, kishte intens i fikuar në shumë plane një mbikëqyrje më të afërt të shumë çështjeve që më parë i kryente Jugosllavia në Shqipëri. BRSS kishte pasur informacione të mjaftueshme për acarimin e përsheptuar edhe në relacionet Tito-Hoxha, ndaj jo rastësisht, në mars të vitit 1948, në Shqipëri kishte avancuar atasheun e vet ushtarak në Tiranë në gradën e gjeneral majorit dhe njëherit kishte shtuar personelin sovjetik në gjithsej pesëmbëdhjetë oficerë. Nga ana tjetër, në po të njëjtën periudhë, qeveria shqiptare i largoi nga Shqipëria afro 350 “këshilltarë” jugosllavë, të cilët u zëvendësuan me personelin sovjetik.

Në periudhën brenda gjashtë muajve pas prishjes me Titon, i gjithë krahu më ekstrem filo jugosllavë i PKSË u gjend nëpër burgjeose në kampe të përqendrimit. Enver Hoxha, një ndër udhëheqësit më konservativ të epokës së komunizmit, kishte marrë gjithçka nën kontroll. Rruga e bashkëpunimit me Stalinin, për Enver Hoxhën, ishte krejtësisht e hapur. “Këshilltarët sovjetikë, megjithatë, nuk mund të merrnin me mend se në këtë mënyrë i kishin dhënë pushtet absolut variantit të ri të një “titizmi antititist”, i cili u kthye kundër tyre vetëm dhjetë vjet më vonë”.<sup>604</sup> Ndërkohë, politika sovjetike në Shqipëri qartas involvonte:”

1) Ruajtjene qeverisë prosovjetike në pushtet, dhe

2) Përdorimin e Shqipërisë në mbështetje të një presioni periferar kundër Titos.

Regjimi shqiptar, nën mbikëqyrjen për së afërmi nga sovjetikët, e ka forcuar shumë mekanizmin e saj të brendshëm, kanë ndodhur përndjekje të vazhdueshme të elementëve disidentë, si në pushtet, ashtu edhe në Partinë Komuniste, ndërkohë që vetëm prosovjetikët e betuar mbesin në ndonjë post me peshë. Në vend ekziston një opozitë e fshehtë kundër regjimit, por ende kryesisht e pakoordinuar dhe efektiviteti

---

Bashkimin Sovjetik, “Zëri”, 7 korrik 2001.

604 Georges Herman Hodos, “Koha ditore”, 20 tetor 2001.

i saj paraqet një kuantitet të panjohur”.<sup>605</sup> BRSS, sipas dokumentit në fjalë, në fundvitin 1948 dhe fillimin e vitit 1949, kishte krijuar rezervatë konsiderueshme në drithë për popullatën skamnore shqiptare: “BRSS duhet të mbajë barrën ekonomike që i paraqet Shqipëria për shkak të rëndësisë së saj politike e strategjike”<sup>606</sup>.

Dhe, pikërisht, tek rëndësia gjeostrategjike e pozitës së Shqipërisë ishte vënë edhe theksi i analizës së shërbimit sekret amerikan, i cili në lidhje me këtë konstatonte: “Shqipëria, edhe pse vendi vogël dhe i varfër, ka fituar rëndësi të jashtëzakonshme për shkak të lokacionit të vet strategjik në njëra rajon, ku raporti i forcave kalon nga një anë në tjetrën... Bashkimi Sovjetik do të tentojë ta ruajë kontrollin e tij mbi Shqipërinë, meqë me ruajtjen e regjimit të Hoxhës involvon prestigjin sovjetik si kundër edhe dëshirën për të pasur një bazë detare në Adriatik. Shqipëria, po ashtu është e përdorshme edhe si rajon fqinj për mbështetjen e presionit sovjetik kundër Titos. Me Shqipërinë, nën kontrollin e vazhdueshëm sovjetik, Kremli gjithmonë mund t’i kthehet politikës së saj të aktivitetit të intensifikuar kundër Greqisë”<sup>607</sup>.

---

605 Dokumente sekrete të CIA-s për Kosovën, Shqipërinë, Jugosllavinë dhe Bashkimin Sovjetik, “Zëri”, Prishtinë, 5 korrik 2001.

606 Po aty.

607 Po aty.



Kapitulli i pestë

## **SHTYPII KOHËS PËR MARRËDHËNIET**

### **SHQIPTARO- JUGOSLLAVE, 1945-1948**

Shtypi i kohës, i viteve 1945-1948, në Shqipëri dhe në Jugosllavi u kishte kushtuar vëmendje dhe rëndësi të veçantë marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave të kësaj periudhe. Shtypi zyrtar shqiptar dhe jugosllav, që ndryshe ishin zëdhë nëse të partive komuniste dhe qeverive shtetërore, si në Shqipëri, ashtu edhe në Jugosllavi, kishin raportuar, analizuar dhe komentuar marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, bashkëpunimin diplomatik, ekonomik, kulturor etj., në frymën e politikës së bashkëpunimit të ndërsjellë mbi bazat ekskluzivisht të politikës zyrtare të dy shteteve, që ishte krejte zakonshme për regjimet komuniste një partiake dhe regjimet totalitare.

Përsa i përket orientimit për thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror, deri në kërkesën e hapur për bashkimin midis dy shteteve në një federatë të përbashkët, shtypi i Shqipërisë avanconte në parashtrimin e kësaj platforme politike shtetërore për bashkim sa më të shpejtë të Shqipërisë me Jugosllavinë. E veçanta tjetër, në këtë plan, është se shtypi i Shqipërisë ishte dukshëm më aktiv se ai jugosllav në sensibilizimin e platformës së bashkimit të dy shteteve dhe në afirmimin e njëanshëm vetëm të rolit të Jugosllavisë për zhvillimet gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe bashkëpunimin miqësor pas luftës. Lirisht mund të thuhet se, në këtë kup-

tim, shtypi shqiptar i periudhës 1945-1948 është krejtësisht jo kritik ndaj marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave dhe me eufori nënshtruese transmetonte rolin prijës të Jugosllavisë për këto marrëdhënie ndërshtetërore.

Jugosllavia, PKJ dhe në veçanti Tito, madhëroheshin skajshmërisht me idealizëm proletar-ideologjik, kurse populli shqiptar paraqitej në varësi të padiskutueshme nga ndihma dhe përkrahja jugosllave. Kosova, në shtypin shqiptar të kohës, injorohet dhe as që përmendet, po aq sa edhe nga shtypi jugosllav, i cili qëllimisht në këtë periudhë (1945-1948), e hesht problemin e Kosovës sikur ai të mos ekzistonte. Dhe, çuditërisht, shtypi shqiptar dhe ai jugosllav, edhe në këtë pikë aq shumë të diskutueshme për marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, ishin në të njëjta pozicione. Kjo mund të vërehete dhe nga hapësira, të cilën shtypi i Shqipërisë, krahasuar me atë të Jugosllavisë, i kushtonte marrëdhënieve ndërshtetërore për periudhën në fjalë. Mund të thuhet se shtypi jugosllav, megjithatë, për një nuancë, në qëndrimin ndaj këtyre marrëdhënieve ishte më i matur dhe jo euforik. Gjithsesi, analiza kritike e shtypit të kohës, në lidhje me prezantimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, ishte reflektim i raporteve të pabarabarta, madje nënshtruese midis PKSH dhe PKJ. Shtypi shqiptar, herë pas here, në faqet e veta botonte lajme, vështrime dhe analiza të shtypit jugosllav në temën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave. Në këtë frymë, gazeta "Bashkimi", organ qendror i Frontit Nacional-Çlirimtar, në numrin 15, të datës 9 janar 1945, botonte vështrimin e huazuar nga e përditshmja jugosllave "Borba", atëherë organ i PKJ. Në vështrimin redaksional të datës 21 nëntor 1944 të gazetës "Borba" që mbante titullin "Bashkëpunimi i armatosur ndërmjet ushtrisë sonë dhe ushtrisë shqiptare në luftë kundra okupatorëve fashistë", botuar në gazetën "Bashkimi", njoftohej për luftën e përbashkët të ushtrisë shqiptare dhe asaj jugosllave: "...Njësitë tona dhe shqiptare çliruan

me sulm Pejën dhe Prizrendin dhe tue përfitue nga sukse si parë i madh përparojnë në dy drejtime: prej Pejës në drejtim të qytetit të vogël Istog, dhe nga Prizren dinë drejtim të Kukësit<sup>608</sup>. Gazeta jugosllave, mëtej, kishte vlerësuar me entuziazëm: “Prej këndej dhe kështu lindin marrëdhënie te bashkëpunimit dhe ndjenjave vllaznore në mes të popullit tonë dhe të popullit shqiptar, gjithashtu edhe në mes ushtrive tona. Çlirimi i përbashkët i Pejës dhe i Prizrendit,– ky ashtfryti dhe dëshmi e marrëdhënjeve bashkëpunëtoresh në mes të Jugosllavisë së re dhe të Shqipnisë së re, dëshmi e forcës dhe e sinqeritetit të këtyne marrëdhënjeve<sup>609</sup>. Në artikull konstatohet: “Bashkëpunimi çlirimtar i brigadave tona dhe shqiptare në Metohi ka provuar edhe njëherë se ne dhe shqiptarët bajmë luftë të madhe, të drejtë e të qëndrueshme, tue çue drejt këtë luftë dhe tu e edukue drejt luftëtarët<sup>610</sup>. Gazeta “Borba”, në numrin 8, të datës 8 janar 1945, duke iu referuar notës diplomatike të qeverisë shqiptare drejtuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik për njohje të qeverisë së mësipërme, në komentin me titull: “Kërkesë e arsyeshme, e drejtë e popullit shqiptar”, ndër të tjera, shkruante: “Kjo kërkesë thellësisht e drejtë e popullit shqiptar, e dëshmuar aq qartë në notën diplomatike të qeverisë demokratike shqiptare, vjen disa javë pasi që e tërë Shqipëria me forcat e armatës çlirimtare shqiptare, është çliruar nga forcat e okupatorit<sup>611</sup>. Kjo gazetë, duke arsyetuar mbështetjen e qeverisë jugosllave për përkrahjen e kërkesës së qeverisë shqiptare për njohje ndërkombëtare nga tri Fuqitë e Mëdha, nuk e kishte lënë rastin papërmendur sërish luftën e përbashkët të dyshtrive të shteteve fqinje kundër okupatorit fashist: “Se në ç’masë populli shqiptar është i lidhur me fatin e kombeve të bash-

608 “Bashkimi”, nr. 15, 9 janar 1945, Tiranë.

609 Po aty.

610 Po aty.

611 “Borba”, nr. 8, 8 janar 1945, Beograd.

kuara në luftë kundër Gjermanisë hitleriane, tregon edhe vendimi i qeverisë shqiptare që dy divizione shqiptare të vazhdojnë luftën kundër trupave gjermane edhe në territorin e Jugosllavisë. Me këtë, populli shqiptar ka dëshmuar se lufta kundër Hitlerit është e pandarë dhe se nuk ka lirisë për popullin shqiptar derisa flamujt e fitores të mos ngrihen në Berlin<sup>612</sup>. Gazeta "Bashkimi", më 21 janar 1945, në komentimin redaksional me titull "Përtej kufijve të Atdheut", shkruante: "Ushtria jonë vazhdon të japë kontributin në luftën e përbashkët të popujve kundër invazorit gjerman... Më 2, 3, 4 e 5 dhjetor, forcat e Divizionit VI sulmuan kundër pozicioneve dhe përqendrimeve armike në katundet Bozhaj, Nik, Prelaj, Rashovicë e Luharë"<sup>613</sup>. Më 8 shkurt 1945, "Borba" kishte botuar deklaratën për shtyp të shefit të Misionit Ushtarak të Shqipërisë në Jugosllavi, majorit Vasil Konomi, i cili, duke evokuar luftën e përbashkët të ushtrisë shqiptare dhe asaj jugosllave në luftë kundër fashizmit, kishte pranuar: "Mirë na është e ditur vepra heroike e popujve tanë. Ne e dimë se popujt tuaj i kanë dhënë ndihmë të madhe popullit shqiptar në luftën e përbashkët kundër fashizmit... Ata do të mbesin të bashkuar edhe në të ardhmen në mënyrë që vetit t'i sigurojnë paqe dhe që t'i kundërvihen secilit rrezik... Ndjehemi sikur të ishim në vendintonë"<sup>614</sup>.

Në numrin e 28 shkurtit 1945, "Bashkimi", në lidhje me dekoratat që u kishte ndarë Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional çlirimtar të Jugosllavisë heronjve dhe udhëheqësve të Shqipërisë, në komentimin redaksional me titull: "Nder i madh për ne", duke shtruar pyetjen se ç'kuptim të madh kishin ato mirënjohje jugosllave për udhëheqjen, heronjtë dhe popullin shqiptar, konstatoje: "... Ky vëllazërim midis popujve lirishtas dhe trima të Jugosllavisë e popullit tonë u

---

612 Po aty.

613 "Bashkimi", nr. 26, 21 janar 1945, Tiranë.

614 "Borba", 8 shkurt 1945, Beograd.



forcua dhe po çelni kosetsa më tepër, se bazat e tij i ka hedhurme gjaknën flamurin e Frontit Nacional-Çlirimtar. Kup-timi i dekorimit të heronjve dhe udhëheqësve tanë është i madh dhe na nderon”<sup>615</sup>. Bashkëpunimin midis dy shteteve dhe udhëheqje vetë tyre e cilësonte si faktor të rëndësishëm edhe për paqen dhe stabilitetin në Evropën Juglindore: “Si populli ynë, ashtu edhe popujt e Jugosllavisë, të përkrahur nga Aleatët e Mëdhenj Anglo-Sovjeto-Amerikanë e kryen me krenari detyrën e tyre ndaj kauzës së përbashkët. Vëllazërimi i popujve të Jugosllavisë dhe i popullit tonë janë faktorë kryesorë të vëllazërimit, demokracisë dhe paqes në Ballkan”<sup>616</sup>. Gazeta “Politika”, më 11 mars 1945, informonte se në Beograd, me rastin e 8 marsit, kishte arritur delegacioni i grave antifashiste të Shqipërisë, i kryesuar nga Liri Gega, e prezantuar në shtypin jugosllav si anëtare e Këshillit Antifashist të Shqipërisë. Shtypi kishte njoftuar se delegacionin e grave antifashiste të Shqipërisë e kishte pranuar edhe Tito. Më 17 mars 1945, “Politika” kishte marrë një deklaratë nga Liri Gega, e cila kishte konstatuar: “Angazhohemi që të krijojmë Shqipërinë e re demokratike, sepse jemi të bindur që në këtë mënyrë do t’i japim bashkëpunimin më të mirë të gjithë popujve të Jugosllavisë dhe marshallit Tito”<sup>617</sup>. “Borba”, më 18 prill 1945, përmes agjencisë së lajmeve “Tanjug”, njofton tepër punimet e Kongresit të Dytë Antifashist të Rinisë së Shqipërisë, ndërsa në numrin e datës 21 prill botoi edhe deklaratën ekskluzive të gjeneral-kolonel Enver Hoxhës për shtypin jugosllav. Gazeta citonte Enver Hoxhën, i cili në pritjen e rezervuar për përfaqësuesit e mediave jugosllave, kishte nënvizuar faktin: “Në Jugosllavinë, populli shqiptar ka gjetur mikun e tij të sinqertë dhe të fortë. Kjo miqësi është e rëndësishë jetike dhe ne dimëta ruajmë”<sup>618</sup>. I pyetur nga

615 “Bashkimi, nr. 58, 26 shkurt 1945, Tiranë.

616 Po aty.

617 “Politika”, 17 mars 1945, Beograd.

618 “Borba”, 21 prill 1945.

gazetarët jugosllavë për të komentuar nivelin e bashkëpunimit dhe miqësisë shqiptaro-jugosllave, Enver Hoxha ishte shprehur: “Në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ekziston një miqësi e fortë, e cila më parë nuk ishte. Ne tanimë nuk hetojmë, ndjejmë dallime midis jugosllavëve dhe shqiptarëve. Ndaj Jugosllavisë dhe marshallit Tito kultivojmë dashuritë madhe. Nuk ka njeri në fshatrat më të lëna të Shqipërisë, i cili nuk di për emrin e marshallit Tito, ndërsa Jugosllavinë të gjithë e shohin si mike të madhe, e cila gjithmonë do të jetë në anën tonë”. “Borba”, më 20 prill 1945, kishte botuar një vështrim lidhur me problemet ekonomike të Shqipërisë dhe gjithnjë në temën e bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav kishte parashikuar: “Për zgjidhjen e këtyre problemeve, populli i Shqipërisë me në krye qeverinë e tij pret ndihmën dhe bashkëpunimin e Jugosllavisë demokratike federative. Shqipëria llogarit se nga Jugosllavia do të marrë ndihmë në ripërtëritjen e industrisë së saj... Në të njëjtën kohë, Shqipëria do të mund të eksportojnë në Jugosllavi lëndë të parë, siç janë: leshi, sapuni, bakri, petrol, kromietj.”<sup>619</sup>. Më 23 maj 1945, në Shqipëri kishte arritur për vizitë të shkurtër zyrtare gjenera lejtnant Milovan Gjilasi, ministër për Malin e Zi në qeverinë jugosllave. Shtypi shqiptari kishte kushtuar rëndësi kësaj vizite. Konkretisht, gazeta “Bashkimi”, më 25 maj 1945, informonte lexuesite saj për vizitën e Milovan Gjilasit në Shqipëri, kurse më 26 maj kishte botuar intervistën e gjatë me zyrtarin e lartë jugosllav. Gjilasi, duke komentuar faktin pse qeveria e Jugosllavisë e para e kishte njohur qeverinë shqiptare të sapodalë nga lufta, kishte deklaruar: “Jugosllavia e sotme dëshiron që Shqipëria të jetë një shtet i pavarur dhe të vendoset në marrëdhëniet ndërkombëtare sovraniteti i saj shtetëror... Jugosllavia dëshiron që Shqipëria, si fqinja e saj më e afërme dhe si shok besnik i luftës, të konsolidojë sa më parë pozitën e saj ndërkombëtare,

619 “Borba”, 20 prill 1945.

ashtu siç ngjau dhe me të. Jugosllavia e sotme nuk ka kundrejt Shqipërisë asnjë interes tjetër, përveç atij që Shqipëria të jetë një shtet me të vërtetë i pavarur". Gjilas nuk kishte lënë pa përmendur edhe kontributin e dy divizioneve shqiptare në çlirimin e Jugosllavisë nga fashizmi: "Në pikëpamje ushtarake ata, jo vetëm që i kanë zbatuar të gjitha detyrat që u janë ngarkuar, por edhe kanë treguar iniciativë dhe vetmohim në luftë për çlirimin e Jugosllavisë, si të luftonin për çlirimin e vendit të tyre. Njësitë shqiptare në Jugosllavi kanë kontribuar shumë për krijimin e marrëdhënieve më të përzemërta ndërmjet dy ushtrive dhe dy vëndeve"<sup>620</sup>. I pyetur nga intervistuesi, shkrimtari Petro Marko, për personalitetet politike me të cilat ishte takuar në Tiranë, Gjilas kishte vlerësuar lartë udhëheqës të Enver Hoxhës: "Besoj se ky është i vetmi personalitet që mund të bashkojë të tëra përpjekjet nacionale në luftë për përkëmbjen dhe rilindjen e Shqipërisë. Historia më moderne e Shqipërisë nuk ka dhënë figurë më të madhe"<sup>621</sup>. Fragmente nga intervista e Milovan Gjilasit dhënë në gazetën "Bashkimi", më 31 maj 1945, kishte botuar në faqet e saj edhe gazeta "Borba", si dhe gazeta tjetër beogradase "Politika", në numrin e saj të datës 10 qershor. Gazeta "Bashkimi", më 27 maj, njoftonte se, më 26 maj 1945, në Tiranë, kishte arritur ministri i Jugosllavisë Federative në Shqipëri, Velimir Stojnić, i shoqëruar nga kryetari i Misionit Usharak Shqiptar në Beograd, major Vasil Konomi. Gjithnjë sipas gazetës, në aeroport kishin dalë për ta pritur personalitetet të larta shtetërore dhe qeveritare të Shqipërisë, ndërta edhe dr. Omer Nishani, ministër i Punëve të Jashtme, i cili në mirëseardhjen drejtuar përfaqësuesit të ri jugosllav në Shqipëri, kishte deklaruar: "Dërgimi juaj në Tiranë është një garanci akoma më e madhe për zhvillimin e mirë të raporteve miqësore midis dy shteteve, të cilat kanë filluar në luftën an-

---

620 Po aty.

621 Po aty.

tifashiste të çlirimit që bën me aq heroizëm populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë së Marshallit Tito<sup>622</sup>. “Bashkimi” kishte botuar një biografi të shkurtër të Velimir Stojniçit, për të cilin që atëherë dihej se çfarë roli përçarës kishte pasur, veçmas në Plenumin e 2-të të KQ të PKSH. Më 30 maj 1945, “Bashkimi” kishte botuar tekstin integral të deklaratës që Velimir Stojniçi e kishte dhënë për shtypin e Beogradit, parnisjes për në Shqipëri, të cilën paraprakisht, më 27 maj 1945, e kishin botuar gazetat jugosllave, “Borba” dhe “Politika”. Sipas kësaj deklarate, Velimir Stojniç kishte paralajmëruar roline tij të ri në fushën e marrëdhënieve diplomatike midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë me këto fjalë: “Jam i gëzuar se duke marrë këtë detyrë të re kam për të vazhduar të jem interpret i ndjenjave të atdheut tim ndaj Shqipërisë fqinje, me të cilën Jugosllavia Federative Demokratike gëzon besim dhe dashuri dhe në të cilën me entuziazëm dhe respekt përmendet emri i Marshallit Tito<sup>623</sup>. Më 3 qershor 1945, “Bashkimi”, në faqen ballore njoftonte se, më 2 qershor, Velimir Stojniç, në cilësi të ministrit të ri të Jugosllavisë në Shqipëri, i kishte paraqitur letër kredenciale kryetarit të Këshillit Antifashist-Nacional-Çlirimtar të Shqipërisë, dr. Omer Nishanit. Velimir Stojniç ishte zotuar: “...Me detyrën që më është ngarkuar do të bienë marrëveshjetë plotëme ju, me qeverinë tuaj dhe me krejt popullin shqiptar”. Më 19 qershor 1945, “Bashkimi” njoftonte se, më 18 qershor 1945, në legatën jugosllave ishte zhvilluar ceremoni me rastin e dekorimit për merita luftime me “Yllin partizan rendi II” të kolonelëve Haxhi Lleshi, Tahir Kadare dhe Shefqet Peçit. Dekoratat i kishte dorëzuar Velimir Stojniç, i cili kishte mbajtur një fjalë rasti. Më 15 korrik 1945, “Bashkimi”, duke iu referuar korrespondentit të vet nga Beogradi, informonte se, më 11 korrik 1945, me rastin e Ditës së Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, Misioni Ushtarak

---

622 “Bashkimi”, 27 maj 1945.

623 “Bashkimi”, 30 maj 1945.

Shqiptar kishte organizuar pritje në legatën shqiptare në Beograd. Në pritje, ku merrnin pjesë edhe udhëheqës shtetërorë të Jugosllavisë, për bashkëpunimin shqiptaro-jugosllav kishte folur major Vasil Konomi, shef i Misionit Usharak Shqiptar, i cili kishte evokuar: "...Vëllazërimin që ka lindur në mes të popujve të Jugosllavisë së re Federative dhe të popullit shqiptar e në mes të dy ushtrive, vëllazërim i lindur nga lufta kundër armikut të përbashkët"<sup>624</sup>. Në numrin e datës 17 korrik 1945, "Bashkimi" njoftonte se, më 16 korrik, ishte nisur për në Jugosllavi Hysni Kapo, i dërguari i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Beograd. Hysni Kapo, para nisjes për në Beograd, i kishte dhënë intervistë kryeredaktorit të "Bashkimit", në të cilën hiperbolizoi zërin e Jugosllavisë në Luftën e Dytë Botërore: "...Jam i lumtur që më ngarkohet mua kjo barrë të shkoj në Jugosllavinë mike e aleate që ka qenë faktor deciziv për fitoren tonë kundra okupatorit dhe për çlirimin e vendit tonë: unë shkoj në Jugosllavinë e marshallit Tito, që është përkrahësja jonë e sinqertë, që është garanci për paqen e Ballkanit"<sup>625</sup>. Për arrijnë Jugosllavitë Hysni Kapos informonte me një lajm të shkurtër edhe gazeta "Politika"<sup>626</sup>. "Politika", më 19 korrik 1945, duke iu referuar vizitës në Jugosllavi të gjeneral-major-Myslim Pezës dhe ministrit të Punëve të Brendshme të Shqipërisë, Haxhi Lleshit, citonte këtë të fundit: "Populli shqiptar di se pa lirinë e Jugosllavisë nuk ka Shqipëri të lirë... Bashkimi midis popujve të Jugosllavisë dhe popullit shqiptar mendojse është realizuar"<sup>627</sup>. Haxhi Lleshi, duke folur për pozitën e shqiptarë vetë mbetur në ish-Jugosllavi, kishte deklaruar: "Ne shohim se pakica shqiptare te ju është e lirë dhe për këtë dëshmon pjesëmarrja e shqiptarëve në pushtet

624 "Bashkimi", 15 korrik 1945

625 "Bashkimi", 17 korrik 1945.

626 "Politika", 18 korrik 1945.

627 "Politika", 19 korrik 1945.

dhe në ushtri. Ata i kanë edhe shkollate tyre<sup>628</sup>. “Bashkimi”, në numrin e 24 korrikut, njoftonte se më 21 korrik Hysni Kapo, ministër fuqi plotë i Shqipërisë në Jugosllavi, i kishte dorëzuar letrat kredenciale qeveritarëve jugosllavë. Hysni Kapo edhe me këtë rast kishte përkujtuar: “Populli ynë gjeti tek marshalli Tito dhe në luftën e tij kundra armikut të njerëzimit, aleatine tij të fuqishëm. Lufta e popullit jugosllav inspiroi dhe inkurajoi në çastet më të vështira popullin shqiptar<sup>629</sup>”.

Shtypi shqiptar i kishte kushtuar rëndësi afirmimit të aktiviteteve të shoqatave të ndryshme kulturore e sportive për thellimin e bashkëpunimit me Jugosllavinë. Gazeta “Bashkimi”, duke i hedhur një vështrim arritjeve dhe objektivave të Shoqërisë për Bashkëpunimin Kulturor të Shqipërisë me Jugosllavinë, në ditën e mbajtjes së Konferencës Kulturore Shqiptaro-Jugoslave në Tiranë, shkruante: “Na, në konditë sotme nuk kemi mundësi të krijojmë marrëdhënie kulturore me vendet e tjera. Jugosllavia i ka këto marrëdhënie në botën e jashtme. Prandaj, për vendin tonë, bashkëpunimi kulturor me Jugosllavinë hap dritare të reja dhe mundësi të reja komunikimi me botën e jashtme... Shoqënia për Bashkëpunim Kulturor me Jugosllavinë po ç’frytëzon rastin e parë që po i paraqitet vendit tonë për t’u lidhë me botën e jashtme...”<sup>630</sup>. Arti-kullshkruesi injoronte gjithë traditën e sfondit kulturor shqiptar dhe bashkëpuniminë tij me kulturat evro-perëndimore para Luftës së Dytë Botërore. Më 16 tetor 1945, në faqet e “Bashkimit” ishte botuar fjala e rastit mbajtur në konferencën kulturore shqiptaro-jugoslave, ku autori (Selim Shpuza), duke fokusuar objektivatë shoqatës, veçonte: “Shoqnia për bashkimin kulturor të Shqipërisë me Jugosllavinë Federative do të merret me popullarizimin në

---

628 Po aty.

629 “Bashkimi”, 24 korrik 1945.

630 “Bashkimi”, 15 tetor 1945.

Shqipni të letërsisë, të artit e të gjanave të tjera me vleftë që kanë popujt e Jugosllavisë edhe në Jugosllavi do të përhapin e do të popullarizojë çdo gja që asht karakteristike dhe me vlerë nga jeta e popullit shqiptar... Tani sheshi për marrëdhënie kulturore asht i lirë. Populli shqiptar dhe popujt e Jugosllavisë duen që të ç'duken muret që na përçajnë dhe të ndërtohen ura që na bashkojnë"<sup>631</sup>. Shtypi njoftonte se kryetar i Shoqatës Kulturore Shqiptaro-Jugosllave ishte zgjedhur Ramadan Çitaku, nënkryetar Nikollë Ivanaj dhe Selim Shpuza, kurse sekretarë Vasil Llazari, Irfan Majuni dhe prof. Aleks Buda. Gazeta njoftonte se shoqata kishte dërguar një telegram marshallit Tito, në të cilin rikonfirmonte përkushtimin për thellimin e miqësisë dhe bashkëpunimit ndër kulturor midis dy vendeve.<sup>632</sup> Më 27 tetor 1945, "Bashkimi" botonte fragmente nga telegrami i Titos, dërguar në formë përgjigje udhëheqjes së shoqatës në fjalë, me seli në Tiranë, ku veç tjerash vlerësohej: "Perspektivat e mëdha të këtij bashkëpunimi u zbuluan gjithashtu edhe në fushën kulturore. Pikërisht në këto çështje, Shoqata e Marrëdhënieve Kulturore të Shqipërisë me Jugosllavinë mund të përfitojnë nga lidhjet edhe më të gjëra në mes të dy popujve, duke i bërë të njohur pasuri të kulturore dhe historiketë të dy palëve"<sup>633</sup>. Në numrin e 30 tetorit, "Bashkimi" e kishte Velimir Stojnićin, por kësaj radhe përmes njoftimit se ai, pas pesë muaj qëndrimi në Shqipëri, në cilësi të të Dërguarit të Jashtëzakonshëm të Jugosllavisë, po kthehej në vendin e tij. Gazeta nuk kishte lënë pa përmendur: "Gjatë këtij qëndrimi si ministër fuqiplotë, zoti Stojnić, me përpjekje të tij të paprera, sollin një kontribut të vlefshëm në zhvillimin e marrëdhënieve politike dhe ekonomike midis dy vendeve si edhe në formimin e lidhjeve miqësore dhe të sinqerta midis popujve fqinjë të Shqipërisë dhe të Jugosllav-

631 "Bashkimi", 16 tetor 1945.

632 "Bashkimi", 1 tetor 1945.

633 "Bashkimi", 27 tetor 1945.

isë..."<sup>634</sup>. Në të njëjtin numër, gazeta botonte intervistën e gjatë me Velimir Stojnićin, paralargimit të tij nga Tirana. Ai kishte paraqitur rezultatet e arritura në fushën e bashkëpunimit midis dy vendeve: "Ne tashti mund të shohim mirë se ç'rezultate të frytshme na dha ky bashkëpunim, si në lëmën ekonomike, ashtu edhe në lëmën kulturore dhe politike"<sup>635</sup>. Më 13 dhe 14 nëntor 1945, "Bashkimi" kishte informuar për ardhjen në Shqipëri të ministrit të porsa emëruar fuqiplotë të Jugosllavisë në Shqipëri, Josip Gjergjës dhe pritjes që atij i kishte rezervuar dr. Omer Nishani, kryetar i Këshillit Antifashist të Shqipërisë. Shpalljen e Republikës Federative të Jugosllavisë, më 29 nëntor 1945, në mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese jugosllave, shtypi shqiptar e kishte cilësuar si "triumf të demokracisë së Ballkanit, për Ballkanin dita e 29 Nëntorit është një triumfi vërtetë"<sup>636</sup>. Më 7 dhjetor 1945, gazeta kishte botuar telegramin e Enver Hoxhës dërguar Titos me rastin e shpalljes së Republikës Federative Demokratiketë Jugosllavisë<sup>637</sup>. Shtypi shqiptar, më 8 dhjetor 1945, kishte konfirmuar se Jugosllavia kishte dekoruar shtatë oficerë shqiptarë dhe se luftëtarë të Divizionit V merastin e largimit të tyre nga tokat e Jugosllavisë i kishin dërguar një telegram Titos. Gazeta "Bashkimi" shkruante: "...Ata përsëriten marshin Tito, pse në të shikojnë realizonjësia e fitoreve të mëdha të popujve të Jugosllavisë dhe njëkohësisht mikun më të madh dhe më të sinqertë të popullit shqiptar... Ata lënë vëllezërit e Jugosllavisë, njësoj sikur të linin vëllezërit e tyre shqiptarë"<sup>638</sup>. Kjo gazetë, në numrin e datës 14 dhjetor, njoftonte se shkrimtari Dhimitër Shuteriqi kishte mbajtur një ligjëra të para shkrimtarë vetë Jugosllavisë në temën e lit-

---

634 "Bashkimi", 30 tetor 1945.

635 Po aty.

636 "Bashkimi", 1 dhjetor 1945.

637 "Bashkimi", 7 dhjetor 1945.

638 "Bashkimi", 8 dhjetor 1945.



eraturës shqipe.<sup>639</sup> Gazeta "Politika" e datës 14 janar 1946 ia kushtonte komplet faqen e parë aktit të shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë (11 janar 1946 - A.Z.). Gazeta kishte botuar lajmin për shpalljen e Republikës së Popullore të Shqipërisë, duke theksuar se ajo ishte ditë historike për Shqipërinë e re. Në të njëjtën faqe ishte botuar telegrami i urimit të Josip Broz Titos dërguar, me atë rast, Enver Hoxhës dhe komenti redaksional, në të cilin vlerësohej: "E gjithë kjo, si dhe lufta e përbashkët e partizanëve shqiptarë dhe atyre jugosllavë, ka krijuar lidhje te pandara midis popujve tanë dhe u ka mundësuar që të shkoj në krahpërkrah në ndërtimin të ardhmes së lumtur, ashtu si kanë shkuar krahpërkrah në kohën e luftës çlirimtare"<sup>640</sup>. Gazeta "Bashkimi" kishte botuar edhe telegramin falënderues të Enver Hoxhës dërguar Titos, në lidhje me urimin e tij përshpalljen e Republikës Popullore të Shqipërisë. Gazeta e mësipërme kishte botuar deklaratën e Presidiumit të Asamblesë Kushtetuese të Republikës Federative të Jugosllavisë, me të cilën përshëndetej shpallja e Republikës Popullore të Shqipërisë. Në këtë deklaratë shprehej besimi: "Na kemi bindjen e thellë se dy Republikat tona Popullore do të vendosin e do të shtojnë edhe ma tepër marrëdhëniet miqësore e të ngushta që ka krijuar midis dy popujve tonë lufta e përbashkët çlirimtare dhe se do ta vazhdojmë bashkëpunimin e ngushtë e do ta zhvillojmë edhe më tepër..."<sup>641</sup>.

Shtypi jugosllav, gjatë muajit janar 1946, kishte intensifikuar shkrimet rreth çështjes së pranimit, përkatësisht mospranimit të Republikës Popullore të Shqipërisë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Gazeta beogradase "Politika", në faqen ballore, kishte botuar thekse nga ekspozeya e shefit të diplomacisë sovjetike, Andrej Vishinski, i cili para

---

639 "Bashkimi", 14 dhjetor 1945.

640 "Politika", 14 janar 1946, Beograd.

641 "Bashkimi", 19 janar 1946.

foltores së selisë së OKB, kishte deklaruar: “Unë nuk shoh kurrfarë nevoje që çështja e pranimit të Shqipërisë të lidhet me çështjen e pranimit të vendeve të tjera. Mendoj se duhet të shtrohet çështja e pranimit, ashtu si kanë arritur lutjet për pranim”<sup>642</sup>. Kjo gazetë kishte parashtruar pyetjen: “A mundet Italia, aleat i dikurshëm kryesori Gjermanisë, të ndikojë në OKB para Shqipërisë?”<sup>643</sup> Ndërkaq “Politika”, më 31 janar 1946, kishte botuar komentin rreth çështjes së pranimit të Shqipërisë në OKB. Artikull shkruesi, nga prizmi i qëndrimit paternalist të shtetit jugosllav ndaj Shqipërisë, në koment vlerësonte: “Shqipërisë veç i është bërë padrejtësi pse ajo nuk është pranuar në OKB që nga mbarimi i luftës. Konstatimet e disa qarqevese gjoja Shqipëria gjatë luftës ka qenë në anën e armikut të demokracisë, nuk mund të arsyetohet me asgjë, sepse nuk bazohet në fakte të vërteta... Nuk ka pra asnjë argument që ndaj Shqipërisë të ndërmerret një qëndrim tjetërfare”<sup>644</sup>. Prandaj, sipas autorit të komentit: “Për këtë arsye është me plot arsye dhe i argumentuar propozimi i Jugosllavisë, qysh në mbledhjen e tashme të OKB-së në Londër, të pranohet në OKB. Për këtë arsye nuk janë të arsyeshme përpjekjet e atyre që Shqipërinë ta largojnë nga OKB”<sup>645</sup>. Edhe gazeta “Borba”, më 8 shkurt 1946, sillte komentin e transmetuar nga Agjencia Telegrafike Jugosllave “Tanjug”, në lidhje me pretendimet greke dhe italiane ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Agjencia Telegrafike Jugosllave tërhoqte vërejtjen dhe konkludonte: “Ky kujdesim i përbashkët nga ana e monarko-fashistëve grekë dhe e disa qarqeve italiane, nuk janë aspak të rastit. Ato janë përfundimi logjikshëm i qëllimeve dhe i interesave të armiqve të pavarësisë së popullit shqiptar, të cilët kërkojnë copëtimin e Shqipërisë”<sup>646</sup>. Gazeta

642 “Politika”, 30 janar 1946, Beograd.

643 Po aty.

644 “Politika”, 31 janar 1946, Beograd.

645 Po aty.

646 “Borba”, 8 shkurt 1946.

“Bashkimi” konstatontese “Jugosllavia e re është garanci për independencën tonë”<sup>647</sup>. Në vijim, duke i vlerësuar pozitivisht marrëdhëniet ndërshtetërore, ajo sqaronte: “Në marrëdhëniet e Jugosllavisës re me vendet e tjera, marrëdhëniet me Shqipërinë zënë një vend të dukshëm... Populli ynë ruan dashurinë dhe respektin më të madh karshi popujvetë Jugosllavisë dhe udhëheqësit të tyre të madh, pikërisht për luftën dhe fitoren e përbashkët, po edhe sepse Jugosllavia e re e ka treguar dhe e tregon gjithnjë me fakte dashurinë e madhe ndaj nesh”<sup>648</sup>. Gazeta, pasi vinte në dukje angazhimin jugosllav për çështjen shqiptare në Konferencën e San Franciskos, në mbledhjetë KS të OKB, si dhe faktin se qeveria jugosllave e para e njohu qeverinë shqiptare, citonte deklarinë e Enver Hoxhës: “Te Marshalli i Jugosllavisë Tito, ne kemi një nga miqtë tanë më të mirë dhe më të sinqertë. Jugosllavia është i pari shtet që na njohu dhe është një nga shtetet që mbron me mishe me shpirt çështjen tonë”<sup>649</sup>.

Fillimi i vitit 1946 kishte shënuar kthesë të re në thellimin e marrëdhënieve intensive në të gjitha fushat midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në fakt, Jugosllavia përpigëj me të gjitha format legale, por edhe të presioneve të gjithanshme diplomatike, ekonomike, kulturore, ushtarake, të sigurisë e deriteato arsimore, të ishte sa më e pranishme në Shqipëri. E gjithë kjo po realizohej në emër të bashkëpunimit miqësor midis dy shteteve fqinje, midis popullit shqiptar dhe jugosllav. Në këtë plan, qeveria jugosllave kishte bërë depërtime të theksuara edhe në instalimin e aplikimit, futjes së lëndëve mësimore në shkollat në Shqipëri të gjuhës serbo-kroate, që në ato vite emërohej si “jugosllav ishte”. Është për t’u veçuar artikulli i datës 14 shkurt 1946, botuar në gazetën “Bashkimi”: “Qysh dje (13 shkurt 1946-A.Z.) nëpër të tri shkollat e

---

647 “Bashkimi”, 9 shkurt 1946.

648 “Bashkimi”, 9 shkurt 1946.

649 Po aty.

mesme të kryeqytetit filloi mësimi i gjuhës jugosllav ishte. Për këtë qëllim erdhën dhe filluan punën dy profesoresha jugosllave... Nga ana tjetër, nxënësit që në orët e para kanë treguar një interesim të madh për të mësuar jugosllavishten. Të parat fjalë që mësuat nxënësit ishin: “Smrt fashizmu - Slobodanarodu” (Vdekje fashizmit - Liri popullit). Tash për tash për mungesë profesorësh, gjuhën jugosllavishte e mësojnë vetëm nxënësit e klasave të VII e të VIII. Por besohet që për së shpejti të vihet edhe në gjithë shkollat e mesme të Shqipërisë. Pritet të arrijnë edhe gjashtë profesorë të tjerë”<sup>650</sup>. Gazeta me ngazëllim të veçantë apostrofonte: “Jugosllavishtja, jo vetëm për nxënësit tanë, por edhe përgjithë popullin është sa e nevojshme aq edhe e vlefshme... Mësimi i jugosllavishtes do t’u vlejë studentëve shqiptarë për të kryer më së miri studimet e tyre universitare në Jugosllavinë mike e aleate, duke u pajisur me një kulturë të shëndoshë e pozitive”<sup>651</sup>. Artikullshkruesi kishte konfirmuar se: “Kërkesa për t’u futur si lëndë shkollore gjuha jugosllave ishte paraqitur në mbledhjen e III-të të Këshillit të Përgjithshëm të BRASH, me insistimin që të vihej sa më parë mësimi i jugosllavishtes në shkollat tona. Kjo dëshirë e rinisë sonë, sot po plotësohet”<sup>652</sup>. Shtypi jugosllav, më 24 mars 1946, kishte informuar se Enver Hoxha kishte formuar qeverinë e reshqiptare, kurse më 26 mars të të njëjtit vit, duke iu referuar fjalimit solemn të Enver Hoxhës në mbledhjen e parë të qeverisë shqiptare, citonte atë të kishte thënë në lidhje memarrëdhëniet shqiptaro-jugosllave: “Ndër miqtë e tij më të afërt, populli ynë llogarit popujt heroj këtë Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Miqësia midis Jugosllavisë dhe vendit tonë është kalitur në çastet më kritike nëpër të cilat kanë kaluar popujt tanë... Jugosllavia e Marshallit Tito dhe Shqipëria e vogële kanë gjetur

---

650 “Bashkimi”, 14 shkurt 1946.

651 Po aty.

652 Po aty.

rrugën e demokracisë së vërtetë dhe të fuqishme dhe janë shndërruar në faktor të mëdhenj të paqes në Ballkan dhe në Evropë dhe në të njëjtën kohë shtylla të vëllazërimit të popujve të Ballkanit”<sup>653</sup>. Gjithnjë në planin e thellimit të bashkëpunimit të shumanshëm midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, që veçmas në fillim të vitit 1946 kishte marrë hov, gazeta “Bashkimi” njoftonte se, më 16 prill, në Tiranë ishin këmbyer notat mbi rivendosjen e trafikut midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë.<sup>654</sup> Më 18 prill 1946, kjo gazetë njoftonte se rinia shqiptare ishte ftuar të merrte pjesë në Kongresin III të Rinisë së Jugosllavisë. “Politika”, më 10 prill 1946, në faqet qendrore të rubrikës politike, gjithnjë duke iu referuar ATSH, botonte thekset kryesore të Koçi Xoxes, sekretar organizativ i PKSH, i cili pasi kishte ripohuar se “populli shqiptar kultivon ndjenjat vëllazërore dhe të sinqerta ndaj popujve vëllazër të Jugosllavisë dhe ndaj Marshallit Tito”<sup>655</sup>, mëtej, kishte thënë: “Fakti se në kufijtë tonë kemi vendin demokratik dhe të fuqishëm, siç është Republika Federative Popullore e Jugosllavisë, do të thotë se në kufijtë tonë kemi aleatene fuqishme dhe të sinqertë, e cila na do të mirën”<sup>656</sup>.

Thellimin e vazhdueshëm të miqësisë shqiptaro-jugosllave dhe bindjen se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë i kishin bazat e forta në luftën e përbashkët të dy shteteve fqinje kundër nazifashizmit, e kishte theksuar edhe Josip Gjergja, ministër fuqiptotë i Jugosllavisë në Shqipëri, në fjalën e tij me rastin e hapjes në Tiranë të ekspozitës së Luftës Nacionallçirimtare të popujve të Jugosllavisë. Sipas gazetës “Bashkimi”, Gjergja kishte shprehur qëndrimin: “Marrëdhëniet në mes të Republikës Popullore të Jugosllavisë dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë, zhvillimi i këtyre marrëdhënieve gjatë kësaj lufte çlirimtare edhe sot, paraqesin një

653 “Politika”, 27 mars 1946.

654 “Bashkimi”, 17 prill 1946.

655 “Politika”, 10 prill 1946.

656 Po aty.

shembull konkret dhe një argument të gjallë të këtij realiteti historik. Historia e marrëdhënieve si këto, që u vendosën gjatë kësaj lufte të përbashkët për liri në mes të popujve të Jugosllavisë dhe të popullit shqiptar, marrëdhënie që poforcohen dhe po bëhen çdo ditë më të ngushta<sup>657</sup>. Përhapjen e ekspozitës kishte informuar edhe gazeta "Politika", e cila fillimisht kishte cituar nën kolonel Ramiz Alinë, i cili në fjalën e hapjes kishte thënë se: "Kjo ekspozitë na kujton në viktima të përbashkëta, në të cilat ka lindur dhe lulëzuar miqësia e sinqertë dhe vëllazërimi i përhershëmi dy popujve tanë. Kjo ekspozitë do të shërbejë thellimin e kësaj miqësie, e cila është në shërbim të paqes dhe të demokracisë së re"<sup>658</sup>. Gazeta e mësipërme, më datë 27 prill, kishte botuar fragmentet kryesore nga letra e Enver Hoxhës drejtuar Konferencës së Ministrave të Punëve të Jashtme të SHBA, Britanisë së Madhe, Bashkimit Sovjetik dhe Francës, mbajtur në Paris. Në letër kërkohet që Shqipëria të thirrej në konferencën e lartpërmendur për të diskutuar çështjetë marrëveshjes me Italinë dhe Gjermaninë<sup>659</sup>. Gazeta "Politika", në temën e të drejtës së Shqipërisë që në Konferencën e Parisit të ekspozonte kërkesën e saj ndaj Italisë dhe Gjermanisë, në komentine datës 29 prill, kishte veçuar faktin: "Me luftën e vet për demokraci, Shqipëria ka fituar të drejtën që të paraqesë kërkesat e saj ndaj Italisë dhe Gjermanisë... Shqipëria është e sigurt se do të respektohen kërkesat e saj në memorandum, që do të thotë fitoren e re të demokracisë në botë ndaj elementeve të errëta, të cilat përpiqen të rrezikojnë paqen botërore"<sup>660</sup>. Gazeta "Borba", në numrin e saj të rregullt të datës 5 maj 1946, në temën e të drejtës së Shqipërisë që të merrte pjesë në Konferencën e Parisit, shkruante: "Simpatia e opinionit publik të Jugosllavisë është krejt pro kauzës së drejtë të popullit shqiptar. Sot në

657 "Bashkimi", 23 prill 1946.

658 "Politika", 25 prill 1946.

659 "Politika", 25 prill 1946.

660 "Politika", 29 prill 1946.

Jugosllavi asnjëri nuk mund të qëndrojë indiferent kundrejt orvatjeve të kujtdo qoftë që do të kërcënonte pavarësinë e popullit mik shqiptar<sup>661</sup>. Përkushtimi për miqësinë shqiptaro-jugosllave, i krijuar gjatë Luftës Antifashiste shprehej edhe në gazetën “Bashkimi”, e cila duke rikujtuar luftërat e Ushtrisë Shqiptare për çlirimin e Jugosllavisë konkludonte me entuziazëm: “Në tre muaj luftime të përgjakshme, forcat e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare e kishin përmbushur misionin që u ishte ngarkuar nga Komandanti i Përgjithshëm. Ato kishin çliruar krahina të tëra të Malit të Zi, Sanxhakut, Bosnjës dhe Kosovës-Metohisë... Gjaku i derdhur së bashku në këto luftëra e çimentoj edhe më tepër midis popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë vëllazërimit e lindur në Luftën Nacional-Çlirimtare<sup>662</sup>. Po e njëjta gazetë, në artikullin me titull “Vëllazërim gjaku”, botuar më 17 maj 1946, me rastin e tre vjetorit të rënies së gjashtë luftëtarëve maqedonas në burgun e Tiranës, shkruante: “Ata që ishin pranë nesh gjatëluftës, ata edhe sot në periudhën e pasluftës dhe të rindërtimit janë akoma pranë nesh. Populli ynë pa me këtë rast sa e madhe ishte dashuria e popujve të Jugosllavisë ndaj tij. Jugosllavia e Marshallit Tito ka ngritur përherë zërin për të mbrojtur të drejtat legjitime të popullit shqiptar të fituara me gjak, ajo ka kërkuar vazhdimisht pjesëmarrjen tonë në organizatat e mëdha ndërkombëtare. Këtë gjë populli shqiptar nuk e harron<sup>663</sup>. Shoqata për Bashkëpunim Kulturor të Shqipërisë me Jugosllavinë, më 25 maj 1946, me rastin e ditëlindjes së Titos, kishte organizuar në Tiranë një Akademi Solemne në sallën e kinemasë “Kosova”. Ramadan Çitaku, kryetar i shoqatës në fjalë, me eufori të veçantë, kishte thënë: “...Ditëlindja e Marshallit Tito është ditë e madhe edhe për popujtë tjerë, sepse Marshalli Tito ka kontribuar me të gjitha

---

661 “Borba”, 5 maj 1946.

662 “Bashkimi”, 9 maj 1946.

663 “Bashkimi”, 17 maj 1946.

forcat për t'i shtypur kokën agresionit fashist"<sup>664</sup>. Bedri Spahia, i cili kishte folur gjerësisht për biografinë e Titos, duke potencuar rolin e Titos për krijimin e miqësisë shqiptaro-jugosllave, kishte veçuar: "Populli ynë meriton miqësinë dhe dashurinë e tij me luftën e ashpër që bëri kundër okupatorit të përbashkët, me trimërinë e tij, me heroizmin e tij. Populli ynë meritoi kujdesin, ndihmën dhe dashurinë e Titos, të qeverisë së tij dhe të popujve të tij, me vendosjen e tij për mbrojtjen e independencës, të demokracisë dhe të paqes. Populli i tij nuk do të harrojë kurrë ndihmën që na dhanë luftëtonë ky Udhëheqësi Madhme ushtrinë e tij heroike..."<sup>665</sup>.

Në këtë atmosferë të betimeve reciproke të qeverisë shqiptare dhe asaj jugosllave, më 23 qershor 1946, Enver Hoxha me bashkëpunëtorë u nis për vizitën e parë zyrtare në Jugosllavi. Gazeta "Bashkimi", datë 23 qershor 1946, në kryetitullin e madh konfirmonte: "Kryeministri dhe Komandanti Suprem i Forcave të Armatosura, gjeneral kolonel Enver Hoxha, i shoqëruar nga personalitete të tjera, u nis sot për në Beograd për një vizitë miqësore"<sup>666</sup>. Në të njëjtën faqe, gazeta, në një nga titujt qendror, shkruante: "Populli i kryeqytetit nderoi me madhësi eshtrat e 350 bijve të Shqipërisë që ranë në tokat e Jugosllavisë në luftën kundër fashizmit"<sup>667</sup>. Në të njëjtën datë, 23 qershor 1946, edhe gazeta beogradase "Politika" njoftonte për vizitën e Enver Hoxhësnë Jugosllavi: "Sot, më 23 qershor 1946, paradite, arrin në Beograd kryetari i qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, ministri i Mbrojtjes Popullore dhe ministri i Punëve të Jashtme, gjeneralkolonel Enver Hoxha."<sup>668</sup> Gazeta e mësipërme, poashtu, njoftonte për ditën e parë të vizitës së Enver Hoxhës me bashkëpunëtorë në Beograd, si dhe pritjen që Tito i kishte

664 "Bashkimi", 26 maj 1946.

665 "Bashkimi", 26 maj 1946.

666 "Bashkimi", 23 qershor 1946.

667 Po aty.

668 "Politika", 23 qershor 1946.



bërë në aeroportin e Zemunit. Gazeta, duke cituar Enver Hoxhën, veçonte: “Gjeneral kolonel Enver Hoxha, me të arritur në Beograd, ka deklaruar se nga gjaku i derdhur i bijve më të mirë të Jugosllavisë dhe Shqipërisë, në luftën kundër armikut të përbashkët, lindi dhe u çelikos vëllazërimi dhe miqësia, e cila do të mbetet e përhershme”<sup>669</sup>. Gazeta nënvizonte se Beogradi me përzemërsi i ka pritur mysafirët, derisa ata parakalonin rrugëve dhe shesheve të kryeqytetit jugosllav. Gazeta “Bashkimi”, e cila në anterfile të faqes ballore me shkronja të mëdha shkruante: “Të rrojë sa malet miqësia dhe vëllazërimi në mes popullit shqiptar dhe popujvetë Jugosllavisë Popullore”<sup>670</sup>, në kryetitull njoftonte: “Gjen.kol.Enver Hoxha pritet nga Marshalli Tito dhe brohoritet nga populli i Beogradit, se Beogradi merr pamjen e festës për të pritur gjen.kol. Enver Hoxhën”<sup>671</sup>. Gazeta, duke iu referuar ATSH, konfirmonte: “Gjatë gjithë rrugës populli brohoriste me entuziazëm Enver-Tito. Në të gjithë rrugën që kish një gjatësi prej 6 km., populli nuk reshte së brohorituri për vëllazërimin dhe miqësinë fortë të Jugosllavisë dhe Shqipërisë”. Shtypi jugosllav i kishte kushtuar rëndësi të veçantë vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi. Gazeta “Borba”, më 24 qershor 1946, duke komentuar vizitën e Enver Hoxhës, shkruante: “Populli shqiptar është shumë afër zemrës sonë, se ne kemi qenë dëshmitarë direkt të luftës së tij heroike kundër tiranisë fashiste... Popujt tanë dinë ta çmojnë shumë mirë gjakun që ka derdhur ushtria e lavdishme e Shqipërisë së re në tokën tonë. Ky gjak u përzie me gjakun e luftëtarëve tonë për liri dhe për një vëllazërimtë ri dhe të lumtur të Ballkanit demokratik”<sup>672</sup>. Gazeta “Politika”, datë 26 qershor 1946, në kryetitull të faqes së parë citonte Enver Hoxhën të kishte thënë gjatë fjalës së tij në takimin me ministrin e Punëve të Jashtme të Jugosllav-

669 “Politika”, 24 qershor 1946.

670 “Bashkimi”, 25 qershor 1946.

671 Po aty.

672 “Borba”, 24 qershor 1946.

isë, Stanoje Simiç: “Populli shqiptar sheh në Jugosllavinë, jo vetëm popullin vëlla, aleatin dhe mikun, por edhe popullin cili i ka ofruar përkrahjen e madhe si në luftë ashtu edhe tani në paqe”<sup>673</sup>. Kjo gazetë njoftonte për aktivitetet diplomatiketë Enver Hoxhës në Beograd, ku kishte takuar kryetarin e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Jugosllavisë, dr. Ivan Ribarin, kishte vënë lule në varrin e heroit të panjohur, kishte vizituar fabrikën e motorëve dhe Akademinë e Lartë Ushtarake. Gazeta njoftonte se komandanti i armatës jugosllave, Koça Popoviç, kishte shtruar drekë për nder të Enver Hoxhës, ku ishin ngritur dolli rasti me zotimet e të dy palëve se marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave do të shënojnë përparime të reja. Të njëjtën ditë, Enver Hoxha kishte pritur në takim udhëheqësit e Shoqërisë për Bashkëpunim Kulturor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Edhe gazeta “Bashkimi” njoftonte për takimet e sipërpërmendura, si dhe njoftonte se 100 të rinj shqiptarë ishin nisur vullnetarë në aksionin punues në hekurudhën “Brçko-Banoviç”, ndërkohë që me ftesë të BRASH, më 23 qershor 1946, në Tiranë kishin arritur për vizitë një muajshe 39 pionierë jugosllavë. Shtypi jugosllav i kishte kushtuar më shumë hapësirë vizitës së Enver Hoxhës me bashkëpunëtorë në Zagreb, sesa ai shqiptar. Kështu, “Politika”, më datë 30 qershor, krahas lajmit përvizitën e Enver Hoxhës në Kroaci, botonte edhe thekse nga fjala përshëndetëse e Vladimir Nazorit, Vladimir Bakariçit dhe e Enver Hoxhës, i cili edhe me këtë rast kishte theksuar: “Populli shqiptar me të drejtë e ka pa se në popujt e Jugosllavisë ka miqtë sinqertë, të besueshëm, të cilët e kanë ndihmuar me tërë forcat e veta... Unë ju bindse në Shqipërinë keni, po ashtu, mikun e vërtetë, i cili si i tillë, gjithmonë do të mbetet i lidhur me shtetin e juaj dhe për popujt Jugosllavisë”<sup>674</sup>. Ndërkaq, asnjë fjalë, as në shtypin shqiptar e as në atë jugosllav, nuk ishte

673 “Politika”, 26 qershor 1946.

674 “Politika”, 30 qershor 1946.

shkruar për atë se si ndodhi që asnjë udhëheqës i atëhershëm shqiptar i Kosovës të mos ishte takuar me Enver Hoxhën. Nuk ishte përmendur as fakti pse Enver Hoxha nuk e vizitoi Kosovën. Nga kjo distancë historike mund të konsiderojmë se, injorimi që iu bë Kosovës dhe popullit të saj martir nga Enver Hoxha, ishte rrjedhojë edhe e veprimeve taktike të udhëheqjes jugosllave për ta lënë në harresë, nën hije çështjen e pazgjidhur të Kosovës.

Vizita e Enver Hoxhës me bashkëpunëtorë në Jugosllavi, prej 23 qershorit deri më 2 korrik 1946, dhe betimet reciproke të udhëheqësve shtetërorë shqiptarë e atyre jugosllavëse do të intensifikojnë bashkëpunimin dhe miqësinë të gjitha fushat, kishte rezultuar menjëherë me nënshkrimin e marrëveshjes, përkatësisht, të Paktit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Gazeta "Bashkimi", më datë 3 korrik 1946, kishte gdhirë me kryetitullin e madh hapës: "Në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë u vendos të konkludohet një pakt miqësie dhe ndihme reciproke. U arrit, gjithashtu, në një akord të plotë përsa i përket bashkëpunimit ekonomik në mes të dy vendeve"<sup>675</sup>. Gazeta shkruante: "Rroftë marrëveshja midis popullit shqiptarë popujve të Jugosllavisë së Re, garanci për paqen në Ballkan dhe Evropë"<sup>676</sup>. Gazeta "Bashkimi" përshkruante në detaje pritjen që populli i Tiranës i kishte bërë Enver Hoxhës dhe delegacionit shqiptar me të arritur nga vizita në Jugosllavi, më 2 korrik 1946. Reporterët specialë të "Bashkimit" përshkruanin entuziazmin e popullit tiranas me këto fjalë: "Populli po këndonte, duartrokiste, brohoriste për Enverin e për Titon, përforcimin e miqësisë dhe vëllazërimit me popujt heroikë të Jugosllavisë etj... Dhe ja. Komandanti në ballkon. Entuziazmi arriti kulmin. Buçasin edhe më fortë emrat "Enver-Tito". Thirrje "Rrofshin popujt e Jugosllavisë", "Rroftë

675 "Bashkimi", 3 korrik 1946.

676 Po aty.

miqësia jonë”, “Tiranë-Beograd”, dëgjohen vazhdimisht<sup>677</sup>. Gazeta kishte botuar fjalën e rastit të Enver Hoxhës para turmës së tubuar në sheshin “Skënderbeu” në Tiranë, në të cilën kishte përkujtuar: “Dita e pjekjes sonë me Marshallin Tito, udhëheqësin e madh të popujve heroikë të Jugosllavisë dhe njëkohësisht miku i jonë shumë i madh dhe besnik, do të mbetet e paharruar dhe njëkohësisht një ditë e shënuar në historinë e popullit tonë. Pjekja jonë është simboli vëllazërimit të madh dhe i miqësisë sonë të ngushtë dhe të sinqertë, është realizimi i ëndrrave të djelmëve tanë që derdhen gjakun për lirinë e Atdheut tonë dhe për të krijuar një vëllazërim dhe një miqësi sa më të ngushtë me popujt vëllezër të Jugosllavisë<sup>678</sup>. Enver Hoxha, dukshëm i entuziazmuar nga pritja në Jugosllavi, duke iu drejtuar masës së tubuar në Tiranë, kishte bërë thirrje për ruajtjen dhe thellimin e miqësisë midis dy shteteve dhe dy popujve: “Në popujt vëllezër të Jugosllavisë, ne kemi miqtë më të mëdhenj dhe më të sinqertë, dhe, ne këtë miqësi duhet ta ruajmë si sytë e ballit, ta forcojmë dita ditës, pse ajo është garancia shumë e madhe e mbrojtjes së independencës dhe sovranitetit të vëndit tonë... Ne e shohim sot të ardhmen tonë me siguri, se kemi miqtë fortë e të sinqertë, të cilët na duan me gjithë shpirt dhe me të cilët do të jem solidarë deri në vdekje<sup>679</sup>. “Politika”, duke njoftuar lexuesit e saj për nënshkrimin e Paktit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis dy vendeve, shkruante: “Kjo lloj marrëveshjeje vetëm sa do të vërtetojë vëllazërimin e përgjakur e të pamposhtur, i cili është krijuar në Luftën Nacionalçlirimtare kundër armikut të përbashkët, dhe se do të vërtetojë vendosmërinë e popujve të dy vendeve miqësore që edhe në të ardhmen së bashku të mbrojnë lirinë dhe pavarësinë e vet<sup>680</sup>. Me këtë rast, gazeta beogradase kishte vendosur lajmin për nënsh-

677 “Bashkimi”, 3 korrik 1946.

678 Po aty.

679 Po aty.

680 “Politika”, 3 korrik 1946.

krimin e Paktit të Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, si dhe kishte botuar lajmin për largimin e delegacionit shtetëror shqiptar nga Jugosllavia. Kjo tregonte se çfarë rëndësie dhe domethënie kishte për Jugosllavinë marrja e vendimit për nënshkrimin e një konvente të tillë, me ç'rast qeveria jugosllave po i krijonte favoret dhe rrethanat për thellimin e ndërhyrjeve në Shqipëri. Shtypi shqiptar, i ndikuar dhe i diktuar nga politika shtetërore, vazhdonte të botonte analiza e komente, në të cilat ngrihej e madhërohej roli i Jugosllavisë. Gazeta "Bashkimi" shkruante: "Popujt e Jugosllavisë duke luftuar për vete luftuan edhe për ne, për gjithë Ballkanin dhe për gjithë popujt liridashës... Këtë miqësi dhe këtë aleancë të sigurtë e të fortë që ekziston midis popullit tonë dhe popujve të Jugosllavisë, nuk ka fuqi në botë që t'i përmbysë, sepse janë të gatuar me gjakun e bijve më të mirë të dy vendeve, sepse sot, Jugosllavia nuk është për Shqipërinë Jugosllavia e Kralëve të Beogradit..."<sup>681</sup>.

Nënshkrimi i Traktatit të Miqësisë dhe i Ndhmës Reciproke në Tiranë, më 9 korrik 1946, nga Enver Hoxha dhe Stanoje Simiç, ministër i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, ishte në plan të parë të shkrimeve të gazetës "Bashkimi" të datës 10 korrik 1946. Gazeta, përveç tekstit integral të traktatit të nënshkruar, kishte botuar edhe tekstet integrale të fjalëve përshëndetëse të Enver Hoxhës dhe Stanoje Simiçit, me rastin e ceremonisë së nënshkrimit të dokumentit ndërshtetëror. Enver Hoxha kishte ripohuar: "Ne shohim te popujt Jugosllavisë dhe te Kryetari i juaj, Marshalli Josif Broz Tito, miqtë e ngushtë dhe të sigurtë, që kanë ndihmuar pa kursyer popullin tonë në arritjen e fitores së sotme dhe që po e vazhdojnë me një ritëm më të madh këtë ndihmë përmbrojtjen e lirisë, të independencës dhe të sovranitetit të vendit tonë"<sup>682</sup>. Udhëheqja shqiptare nuk mund ta paramendonte në këtë kohë

681 "Bashkimi", 4 korrik 1946.

682 "Bashkimi", 10 korrik 1946.

të euforisë së miqësisë dhe bashkëpunimit me Jugosllavinë, se edhe ky trakt favorizonte qëllimet gllabëruese jugosllave ndaj Shqipërisë. Ministri i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Stanoje Simiç, kishte apostrofuar se traktati në një kuptim kishte për qëllim institucionalizimin, sipas akteve të diplomacisë ndërkombëtare, mbrojtjen e integritetit të Shqipërisë nga ana e Jugosllavisë në rastreziku apo agresioni eventual. Prandaj, diplomati jugosllav ishte munduar t'i bindte të pranishmit: "Kjo marrëveshje, që është lidhur brenda frymës së Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe nuk është e drejtuar kundër askujt, do të shërbejë si garanci që në këtë sektor të mos përsëritet më asnjë sulm zaptontjës e aq më pak të robërohen popujt e lirë e paqedashës demokratë"<sup>683</sup>. Të njëjtën frymë paternaliste ndaj Shqipërisë, lexuesi mund ta gjejë edhe në komentin redaksional të gazetës "Politika", e cila shkruante: "Marrëveshja shqiptaro-jugosllave përfaqëson pasojën logjike të katër vjet lufte të popujve shqiptarë dhe jugosllavë kundër të njëjtit armik, agresorëve fashistë... Republika Federative Popullore e Jugosllavisë dëshiron të ndihmojë Shqipërinë demokratike fqinje për ruajtjen e sigurisë së saj dhe në përpjekjet që ajo po bën në rimëkëmbjen ekonomike e kulturore... Kundër kësaj marrëveshjeje do të jenë sigurisht vetëm ata, të cilët do të dëshironin të vazhdonin dikur lojën tradicionaletë fatit të popujve ballkanas, ata të cilët do të dëshironin që shtetet ballkanike të jenë edhe mëtej vetëm figura në tabelën e shahut"<sup>684</sup>. Gazeta serbe "Glas", organ i Frontit Popullor të Serbisë, më 11 korrik 1946, duke komentuar nënshkrimin e Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, veç të tjerash, në kryeartikullin e numrit konkludonte: "Traktati midis Jugosllavisë e Shqipërisë përfaqëson frytin e aspiratave tradicionale të të dy popujve, të ndërgjegjshëm se miqë-

---

683 Po aty.

684 "Politika", 11 korrik 1946.

sia e singertë reciproke dhe ndihma e përbashkët përfaqësojnë rrugën e vetme drejt sigurimit dhe ringjalljes paqësore të popujve ballkanikë”<sup>685</sup>. Edhe gazeta “Borba” vlerësohte: “Marrëveshja midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë përfaqëson një kontribut shumë të madh për ruajtjen e integritetit dhe të pavarësisë së Shqipërisë...

Nuk është nevoja të theksojmë në mënyrë të posaçme se kjo marrëveshje që u përfundua në Tiranë është një paralajmërim serioz për të gjithë ata që me kombinacionet e tyre përgatisin plane kundër Jugosllavisë dhe Shqipërisë”<sup>686</sup>.

Më 14 korrik, “Bashkimi” sillte reagimet e diplomacisë sovjetike në lidhje me nënshkrimin e Traktatit Shqiptaro-Jugosllav. Lidhur me këtë, gazeta botonte thekse nga komenti i redaksisë shqipe të Radio Moskës ku vlerësohej: “Ky traktat është një kontribut i ri për çështjen e sigurimit dhe të paqes në Ballkan dhe në gjithë botën”<sup>687</sup>. Më 23 korrik, “Bashkimi”, duke iu referuar Agjencisë jugosllave të lajmeve “Tanjug”, njoftonte se Asambleja Kombëtare e Jugosllavisë, më 20 korrik, kishte ratifikuar Traktatin e Miqësisë dhe Ndhmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Me këtë rast, gazeta citonte ministrine Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Stanoje Simiç, të kishte deklaruar para parlamentarëve jugosllavë: “U treguadëshira që kjo marrëveshje të zbatohet, jo vetëm me një mbrojtje të mundshme të pavarësisë dhe integritetit tokësor të të dy popujve tanë, por edhe në të gjithë bashkëpunimet e ardhshme ekonomike dhe kulturore midis dy popujve tanë”<sup>688</sup>. Shtypi shqiptar i kishte kushtuar publicitet paraqitjes së diplomacisë jugosllave në Konferencën e Paqes në Paris, në verë të vitit 1946, lidhur me çështjen e të drejtës së përfaqësimit të Shqipërisë në atë konferencë. Kështu, “Bashkimi” në kryetitull të komentit redaksional,

685 “Glas”, 11 korrik 1946.

686 “Borba”, 13 korrik 1946.

687 “Bashkimi”, 14 korrik 1946.

688 “Bashkimi”, 23 korrik 1946.

të datës 2 gusht 1946, vintënë pah: "Jugosllaviae marshallit Tito mbron të drejtat tona"<sup>689</sup>. "Në seancën e Komisionit të procedurës së Konferencës së Paqes, delegati i Jugosllavisë, Mosha Pijade, mbrojti të drejtën e popullit shqiptar për të marrë pjesë në këtë konferencë... Nuk është e para herë që Jugosllavia e marshallit Tito mbron të drejtat e vendit tonë... Jugosllavia e re e marshallit Tito është mike besnike e Shqipërisë. Ajo e njohu e para qeverinë tonë demokratike. Mbrojtja e vendosur që ajo u bën të drejtave tona më legjitime është sprovë më e mirë e dashurisë që popujtë saj kanë ndaj popullit tonë"<sup>690</sup>. Gazeta "Politika", duke reaguar ndaj paraqitjes hegjemoniste të udhëheqësi të delegacionit grek në Konferencën e Paqes në Paris, Caldiris, në lidhje me pretendimet greke ndaj territorit të shtetit shqiptar, drejtpërdrejt aktualizonte çështjen e Çamërisë, duke shkruar: "Në rast se mund të flitet mbi disa pretendime tokësore, atëherë mund të përmendeshin me plot gojë të drejtat e Shqipërisë mbi një pjesë të tokës që gjendet sot nën pushtimin e Greqisë dhe që banohet me shumicë më të madhe nga shqiptarë... Prapa këtyre kërkesave të Greqisë, fshihet dora e etur dhe e pangopurë reaksionit ndërkombehtar që shqetësohet tepër nga paqja e Ballkanit"<sup>691</sup>. Gazeta serbe "Glas", lidhur me të njëjtën temë, shkruante: "Caldiris nuk mundi ta njollojë Shqipërinë, por përkundrazi vuri në dukje poshtërsinë e vjetër imperialiste që karakterizon edhe sot regjimin antipopullor të Greqisë... Bisedimi rreth Shqipërisë, i hapur nga delegacioni jugosllav i detyroi mbrojtësit e "kombeve të vogla" që të heqin maskën dhe të tregojnë fytyrën e vërtetë, e cila nuk është asdemokratike as mbrojtëse e interesave të kombeve të vogla"<sup>692</sup>. "Bashkimi", duke analizuar reflektimet e reagimeve jugosllave në lidhje me mbrojtjen e çështjes shqiptare në Konferencën

689 "Bashkimi", 2 gusht 1946.

690 "Bashkimi", 2 gusht 1946.

691 "Politika", 1 gusht 1946.

692 "Glas", 11 gusht 1946.



e Paqes në Paris, konstatonte: “Zëri i përfaqësorjve të Jugosllavisë mike, pranë Konferencës së Paqes për fitimin e Shqipërisë në këtë konferencë, prodhoi kënaqësinë masat e gjëra të popullit shqiptar”<sup>693</sup>. Edhe gazeta tjetër jugosllave “Politika”, duke kritikuar qëndrimet e delegacionit grek në Konferencën e Paqes në Paris, shkruante: “Caldirisu mundua ta komprometojë edhe Jugosllavinë në këtë lojë, duke i ofruar asaj një pazar të poshtër për ndarjen e Shqipërisë në dysh”<sup>694</sup>. Gazeta “Borba”, në artikullin me titull: “Rivendikimet e poshtra të imperialistëve grekë kundrejt Shqipërisë aleate”, theksonte: “Popujt e Ballkanit dhe në radhë të parë popujt e Jugosllavisë janë të interesuar thellësisht për integritetin e Shqipërisë dhe... Delegacioni jugosllav deklaroi se nuk mundet dhenuk do të qëndrojë indiferent përpara përpjekjeve kërcënuese kundër pavarësisë së Shqipërisë. Çështja e integritetit dhe e pavarësisë së Shqipërisë aleate është e lidhur në mënyrë të pandashme me sigurinë e Jugosllavisë dhe të vendeve të tjera liridashëse të Ballkanit”<sup>695</sup>. Me të njëjtat intonacione të përbetimeve për miqësinë shqiptaro-jugosllave, madje duke e apostrofuar sërish rolin e Jugosllavisë për sigurinë dhe mbrojtjen e integritetit territorial të Shqipërisë, sigurisht nën atmosferën e presioneve greke të kohës, gazeta “Bashkimi” në komentimin redaksional me titull: “Kemi aleate Jugosllavinë e Marshallit Tito”, shkruante: “Jugosllavia ka mbrojtur gjithnjë dhe vazhdimisht interesat dhe të drejtat e popullit tonë... Kjo tregon se Jugosllavia e re e Marshallit Tito është aleati më besnik dhe mbrojtësi më i sinqertë dhe më i vendosur i të drejtave të populli tonë. Kjo tregon se Jugosllavia e re është një garanci e sigurtë për independencën dhe integritetin tonë tokësor... Populli ynë e di që miqësia dhe aleanca me Jugosllavinë është siguri indip-

---

693 “Bashkimi”, 10 gusht 1946.

694 “Politika”, 14 gusht 1946.

695 “Borba”, 1 shtator 1946.

endence dhe demokracie, sepse Jugosllavia e re e Marshallit Tito është shtyllë e paqes në Ballkan”<sup>696</sup>. Nuk habit ky lloj i ngazëllimit të shtypit shqiptar karshi këtyre qëllimeve të shtypit jugosllav. Në thelb, prapa asaj përkrahjeje deklarative mediale të jugosllavëve fshihej politika gllabëruese e pushtetit jugosllav.

Më 11 shtator 1946, “Bashkimi” njoftonte se, më 10 shtator, në Tiranë ishte nënshkruar Marrëveshja Detare në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe se të njëjtën ditë për në Beograd ishte nisur për një vizitë zyrtare, Haxhi Lleshi, Ministër pa Portofol. Për qëndrimin e tyre ndaj çështjes shqiptare në Konferencën e Paqes në Paris, edhe Koçi Xoxe, në telegramin falënderues drejtuar Titos, i kishte dhënë mirënjohje publike qeverisë jugosllave. Në këtë telegram, siç shkruante “Bashkimi”, ai kishte ritheksuar: “Populli ynë u është mirënjohës miqve të shquar Edvard Kardelidhe Mosha Pijade, të cilët duke thënë fjalën tuaj dhe të gjithë shokëve udhëheqës të Jugosllavisë së re, mbrojtën me mishe me shpirt para botës mbarë të drejtën legjitime të Republikës sonë Popullore”<sup>697</sup>. Kjo gazetë njoftonte se, më 12 shtator 1946, “Në Beligrad u ç’këmbyen instrumentet e ratifikimit të Traktatit të Miqësisë dhe të Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë”<sup>698</sup>. Në të, me gërma të mëdha shkruhej: “Rroftë aleanca dhe vëllazërimi i popullit shqiptar me popujt Jugosllavisë”, ndërsanë komentin redaksional me titull: “Populli shqiptar do ta ruajë si gjënë më të shtrenjtë dhe do ta forcojë gjithnjë më tepër aleancën me Jugosllavinë”<sup>699</sup>, theksohej: “Aleanca me Jugosllavinë është garanci e sigurt për zhvillimin e vendit tonë, për independencën dhe integritetin tonë tokësor. Lufta e jonë e përbashkët, pushtetet tona popullore dhe udhëheqja e Enverit dhe e Titos janë garanci e sigurt

696 “Bashkimi”, 7 shtator 1946.

697 “Bashkimi”, 12 shtator 1946.

698 “Bashkimi”, 14 shtator 1946.

699 Po aty.

se këtë traktat s'ka fuqi që ta përmbysë"<sup>700</sup>. Gazeta, duke iu referuar burimeve të Agjencisë Telegrafike Jugosllave "Tanjug", njoftonte se dokumentin për ratifikimin e Traktatit shqiptar-jugosllav e kishin nënshkruar në emër të qeverisë shqiptare, Haxhi Lleshi, kurse në emër të asaj jugosllave, inxhinieri Nikola Petroviç, ministëri Tregtisë së Jashtme Jugosllave.

Më 23 tetor 1946, nga përmbajtja e gazetës "Bashkimi" veçohej lajmi se qeveria jugosllave kishte ndarë 484 bursa për specializime për të rinjtë shqiptarë.<sup>701</sup> Çështjen e kujdesit të qeverisë jugosllave për të ndihmuar financiarisht shkollimin e rinisë dhe studentëve shqiptarë në Jugosllavi, e kishte vlerësuar në intervistën dhënë gazetës "Bashkimi" edhe kryetarja e rinisë shqiptare, Liri Belishova, duke thënë: "Kujdesi i qeverisë jugosllave për studentët tanë tregon se në çdo rast populli shqiptar ka ndihmat e popujve vëllezër të Jugosllavisë, të cilët duan që vendi ynë të përparojë, të bëhet i fortë dhe të shkojë përpara. Kjo tregon se miqësia jonë, në formë traktati, është rrënjosur thellë në shpirtin e popujve tanë".<sup>702</sup> Nga vështrimet dhe komentet e gazetës "Bashkimi", gjatë muajit dhjetor 1946, gjithnjë në temën e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave, veçohet vështrimi botuar në formë të kryeartikullit, në prag të Kongresit Sllav, të mbajtur më 8 dhjetor 1946, në Beograd. Ky koment, sigurisht, është ndër paraqitjet më të pashembullta të shkallës ekstreme të indoktrinimit të udhëheqjes së atëhershme shqiptare me jugosllavizmin si "shpëtimtare" të popujve të Ballkanit dhe jo vetëm të atij shqiptar: "Nuk është çështje propagande ose filopropagande të flasësh për kontributin që kanë dhënë sllavët në botë për paqen dhe demokracinë dhe për kontributin që ata po japin sot për konsolidimine paqes dhe të demokracisë... Popujt sllavë janë sot avangardë të paqes dhe demokra-

---

700 Po aty.

701 "Bashkimi", 23 tetor 1946.

702 Po aty.

cisë, por po bëhen një faktor me rëndësi edhe për kulturën. Kultura sllave është sot në gjendje të mësojë Perëndimin... Kultura sllavesot po bëhet simbol i kulturës paqësore dhe liridashëse<sup>703</sup>. Autori i komentit shkante edhe më tutje në "përparësitë" e kulturës sllave ndaj asaj perëndimore: "Roli i kulturës sllave është sot roli i popujve sllavë...Popujt sllavë duan lirinë dhe paqen dhe luftojnë për to. Kjo është arsyeja e propagandës antisllave e të ashtuquajturit pansllavizëm<sup>704</sup>. Në këtë kuptim, autori vazhdonte komentin: "Populli shqiptar shikon përgjithësisht në popujt sllavë dhe veçanërisht në Republikën Federative Popullore të Jugosllavisë, d.m.th. në popujt vëllezër serbë, kroatë, sllovenë, malazeze maqedonas, garancinë për independencën dhe zhvillimin e tij.Rruga e jonë është në rrugën e Jugosllavisë, e ardhmja jonë është e lidhur ngushtësisht me avenirin e popujve të Jugosllavisë. Ne jemi një vend i vogël, por kemi armiq të mëdhenj. Ne kemi nevojë për vëllazërimin me popujt sllavë"<sup>705</sup>. Në këtë-frymë, shtypi, zëdhënësi besnik i politikës, jepte porosinë: "Kjo është rruga e avenirit tonë: Populli shqiptar duhet dhe do të drejtohet nga kultura e popujve sllavë..."<sup>706</sup> I njëjti autor, me të njëjtin intonacion, duke i hedhur një vështrim marrëveshjes ekonomike të 27 shtatorit 1946 midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, në gazetën "Bashkimi", pasi pohonte se: "Shqipëria me ndihmën e Jugosllavisë hyn në fazën e realizimeve të mëdha ekonomike për një avenir më të mirë e të sigurtë"<sup>707</sup>, në vijim, shkruante: "Ja pse në këto momente na bëjmë edhe një hap të madh drejt sigurimit gjithnjë më të madh të independencës së vendit tonë. Ja si Jugosllavia e marshallit Tito na jep edhe një dorë vëllëzërishe miqsh për ruajtjen e fitorevetona...Vëllazërimi, aleanca dhe bashkëpun-

703 "Bashkimi", 6 dhjetor 1946.

704 Po aty.

705 Po aty.

706 Po aty.

707 "Bashkimi", 12 dhjetor 1946.

imi ekonomik sa më i thellë me popujt e Jugosllavisë është rruga që të çon drejt sigurimit të independencës sonë...<sup>708</sup>. Gazeta "Borba", më 17 dhjetor 1946, duke informuar lexuesit e vet për nënshkrimin e Marrëveshjes Ekonomike të 27 nëntorit mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, shkruante: "Jugosllavia tregon se është mbrojtëse e patundur e të gjitha fitoreve dhe institucioneve demokratike që populli shqiptar ka korrur gjatë luftës çlirimtare"<sup>709</sup>. "Bashkimi", ndërkaq, në numrin e rregullt të datës 17 dhjetor, njoftonte për manifestimin që ishte organizuar në Tiranë në shenjë të nënshkrimit të Marrëveshjes për Konvencionin Ekonomikmidis Shqipërisë dhe Jugosllavisë: "Mëse 40.000 veta nga populli i kryeqytetit, në një manifestim nga më të mëdhenjtë që është parë gjër më sot, shfaqin gëzimin e tyre për konvencionin ekonomik në mes R.P. të Shqipërisë dhe R.F.P. të Jugosllavisë, mirënjohjen e madhe për popujt e Jugosllavisë dhe vendosmërinë për t'i realizuar me sukses të gjitha vendimet e konvencionit, me në krye udhëheqësit e dashur Enver-Tito"<sup>710</sup>. Shtypi, gjithashtu, informonte për entuziazmine qytetarëve në mbarë Shqipërinë, lidhur me nënshkrimin e marrëveshjes në fjalë: "Marrëveshja ekonomikenë mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë prodhoi kënaqësi në gjithë Shqipërinë"<sup>711</sup>. Gazeta "Bashkimi", organ qendror i Frontit Demokratik, edhe në numrin 626 të datës 27 dhjetor, kishte konstatuar: "Populli shqiptar sheh në popujt e Jugosllavisë garancinë për lumturinë dhe begatinë e vendit të tij. Asnjëherë populli shqiptar s'ka pasur një ndihmë kaq të madhe, sepse asnjëherë gjatë historisë së tij nuk ka pasur miq kaq të sinqertë dhe të fortë, si popujt e Jugosllavisë së re të Marshallit Tito"<sup>712</sup>. Gazeta, gjithashtu, in-

708 Po aty.

709 "Borba", 16 dhjetor 1946.

710 "Bashkimi", 17 dhjetor 1946.

711 Po aty.

712 "Bashkimi", 27 dhjetor 1946.

formonte se Kuvendit Popullor i paraqitej për ratifikim konvencioni ekonomik me Jugosllavinë: "...mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë"<sup>713</sup>. Të nesërmen, më 28 dhjetor, gazeta "Bashkimi" kishte botuar tekstin integral të traktatit "Mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe barazimin e monedhave midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Federative të Jugosllavisë"<sup>714</sup>. Edhe gazeta "Politika" kishte njoftuar se, më 27 dhjetor 1946, "Presidiumi i Kuvendit Popullor, dje, ka ratifikuar Marrëveshjen për harmonizimin e planeve ekonomike, për bashkimin doganor dhe barazimin e monedhës midis Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë"<sup>715</sup>.

Gazeta "Bashkimi", e cila në disa numra rresht kishte informuar lexuesit për ndihmat që Jugosllavia i kishte mbledhur për të dëmtuarit në Shqipëri nga vërshimet e vjeshtës 1946, në numrin e 31 dhjetorit, pasi kishte konfirmuar se: "Komiteti i ndihmave për të dëmtuarit e Shqipërisë u dorëzoi përfaqësuesve të legatës shqiptare në Beograd 51.468.941 dinarë të mbledhur në Jugosllavi për popullin tonë"<sup>716</sup>, në komentin redaksional me titull metaforik: "Popuj vëllezër", duke spikatur ndihmën jugosllave, ndër të tjera, shkruante: "Populli shqiptar pret ndihmën e popujve të Jugosllavisëmemirënjohjen dhe dashurinë më të thellë. Ai nuk do ta harroj kurrë këtë. Ai sheh në këtë ndihmë një provë tjetër të karakterit të ri të marrëdhënieve që ekzistojnë midis popujve tanë..."<sup>717</sup>.

Edhe në numrin e datës 3 janar 1947, gazeta "Bashkimi" kishte njoftuar lexuesite saj se: "në Beligrad shkëmbehen

713 Po aty.

714 "Bashkimi", 28 dhjetor 1946.

715 "Politika", 28 dhjetor 1946.

716 "Bashkimi", 31 dhjetor 1946.

717 Po aty.

instrumente të ratifikimit mbi koordinimin e planeve ekonomike, bashkimin doganor dhe parifikimin e monedhës midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë<sup>718</sup>. Gazeta, po ashtu, duke veçuar euforinë e qarqeve qeveritare shqiptare dhe të popullit shqiptar për ratifikimin e marrëveshjes në fjalë, vinte në pah: "Populli e priti me gëzim të madh ratifikimin e traktatit dhe marrëveshjes ekonomike me Jugosllavinë"<sup>719</sup>. "Politika" e datës 3 janar 1947, duke iu referuar telegramit të Enver Hoxhës dërguar Titos me rastin e Vitit të Ri, bontonte tekstin integral të telegramit, ku thuhej: "Marrëveshjet tona me Jugosllavinë i sigurojnë Shqipërisë ndihmë të madhe, e njëkohësisht e ruajnë dhe e mbrojnë pavarësinë, integritetin dhe suverinitetin e Shqipërisë... I mbarë populli ynë, të vjetër dhe të rinj, me falënderime të thella mendojnë sot në popujt vëllezër të Jugosllavisë dhe në Titon dhe nga zemra ju deklarojnë: Vëllezër jugosllavë, dje na kanë bashkuar vuajtjet, mjerimi dhe qëllimet e përbashkëta, kurse sot na bashkon jeta..."<sup>720</sup>. E përditshmja jugosllave, "Politika", edhe në komentin redaksional të datës 11 janar 1946, me rastin e përvjetorit të parë të shpalljes së Republikës Popullore të Shqipërisë, ndër të tjera, në lidhje me Traktatin e Miqësisë dhe të Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, shkruante: "Ky traktat do të ndihmojë RP të Shqipërisë që të rimëkëmbet dhe të rindërtohet"<sup>721</sup>. "Bashkimi", duke iu referuar Agjencisë Telegrafike Jugosllave "Tanjug", njoftonte se: "Në Beligrad kremtohet përvjetori i Republikës Popullore të Shqipërisë, se studentët e universitetit celebruan mbrëmë në fakultetin e shkencave përvjetorine parë të proklamimit të Republikës Popullore të Shqipërisë"<sup>722</sup>. "Bashkimi" lajmëronte se, më 15 shkurt 1947, në Tiranë, ishte regjistruar

718 "Bashkimi", 3 janar 1947.

719 Po aty.

720 "Politika", 3 janar 1947.

721 "Politika", 11 janar 1947.

722 "Bashkimi", 14 janar 1947.

Shoqëria Shqiptaro-Jugosllave për Import-Export: “Qendra e shoqërisë do të jetë në Tiranë, ajo do të ketë filialin e saj kryesor meqendër në Beograd... Kjo shoqëri ka statutin e shoqërive aksioniste shqiptare dhe vepron sipas ligjeve të Republikës Popullore të Shqipërisë”<sup>723</sup>.

Në numrat vijues, të botuar gjatë muajit mars, gazeta “Bashkimi” i kishte kushtuar publicitet të madh koncerteve të ansamblit artistik nga Jugosllavia, kurse në edicionin e datës 4 prill 1947, shkruante: “Komandanti (E. Hoxha -A.Z.) asiston në një mbrëmje organizuar nga Shoqëria për Lidhje Kulturore të Shqipërisë me Jugosllavinë, ku u projektuan<sup>3</sup> filma mbi Jugosllavinë”<sup>724</sup>. Në vazhden e informacioneve për bashkëpunimin kulturor midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, “Bashkimi” lajmërontese, më 30 prill 1947, në Tiranë ishte inauguruar “Libri jugosllav”, përkatësisht libraria jugosllave. Me këtë rast, gazeta citonte Hysni Kapon të kishte pohuar në fjalën e tij përshëndetëse, në emër të qeverisë shqiptare, se: “çelja e librarisë sot është një provë tjetër që tregon dëshirën dhe interesimin e udhëheqësve të Jugosllavisë për forcimin e marrëdhënieve kulturore dhe edukative midis dy vendeve”<sup>725</sup>. Gazeta, gjithashtu, citonte thekse nga fjala e Drago Kosmerlj, i ngarkuar me punë në Legatën Jugosllave në Tiranë, i cili kishte vlerësuar: “Me popullin shqiptar janë krijuar shumë kondita që na garantojnë se libri jugosllav do të mund ta kryejë plotësisht misionin e tij...Libri jugosllav do të ndihmojë përafrimin kulturor të popujve tanë dhe me këtë do të ndihmojë për krijimin e një aveniri më të lumtur dhe më të bukur të popujve tanë vëllezër”<sup>726</sup>. Më 1 maj 1947, me rastine dy vjetorit të njohjes së qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, “Bashkimi” në kryeartikullin e numrit me titull: “Aleanca me popujt e

723 “Bashkimi”, 16 shkurt 1947.

724 “Bashkimi”, 4 prill 1947.

725 “Bashkimi”, 30 prill 1947.

726 Po aty.



Jugosllavisë garanci për mbrojtjen e independencës sovranitetit dhe për zhvillimin gjithanshëm të vendit tonë”, veç të tjerash, shkruante: “Pa luftën e popujve të Jugosllavisë, ka thënë Komandanti, as që mund të mendohet një rezistencë e efektshme e popullit shqiptar”<sup>727</sup>. Shtypi i Tiranës, më 25 maj 1947, e kishte shënuar gjerësisht ditëlindjen e 55 të Titos. Shtypi shkruante se udhëheqësit e lartë shtetërorë, përfshirë edhe Enver Hoxhën, i kishin dërguar me këtë rast urime Titos. Gazeta “Bashkimi” njoftonte se me rastin e 55 vjetorit të ditëlindjes së Titos, kryetari i Shoqërisë për Bashkimin Kulturor ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, Ramadan Çitaku kishte mbajtur konferencë shtypi, ku kishte spikatur: “Për popullin tonë Marshalli Tito asht simboli ma i çmueshëm i miqësisë. Me ëmbëlsi dhe me entuziazëm flasin për prijësin e Jugosllavisë së re, të rinjtë e të rejtat, gratë e pleqtë dhe mbarë populli shqiptar... Ne e dimë dhe e kemi parë se me çfarë dashurie e ka mbrojtur kauzën e vendit tonë Jugosllavia e Marshallit Tito”<sup>728</sup>. Gjatë muajit maj, gazeta i kishte dhënë mjaft publicitet edhe mbajtjes së mbledhjes të Aktivit të Shoqërisë për Lidhje Kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Në raportet ditore të gazetës kësaj veçohet konkluzioni që dilte për “...nevojën e përkthimeve sa më të shumta nga Jugosllavia, si dhe ishte ngritur çështja e shtimit të anëtarëve dhe e mësimin të gjuhës serbo-kroate”<sup>729</sup>.

Në shënimin e përvjetorit të parë të Traktatit të Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, gazeta “Bashkimi” kishte botuar telegramin përsëritës të Enver Hoxhës dërguar Titos, ku vlerësohej lartë miqësia shqiptaro-jugosllave: “...Ky Traktat Miqësie dhe Ndihme Reciproke është një kontribut shumë i madh që popujt tonë japin përforcimin e një paqeje të shëndoshë dhe të një sigurie

---

727 “Bashkimi”, 1 maj 1947.

728 “Bashkimi”, 27 maj 1947.

729 “Bashkimi”, 31 maj 1947.

efektive në Ballkan dhe në botë”<sup>730</sup>. Në të njëjtin numër ishte botuar komenti me titullin simbolik: “Tiranë-Beograd”, ku artikullshkruesi komentonte: “Nuk është e rastit që Traktatiu plotësua në Shqipëri me marrëveshjen ekonomike dhe se po krijohen dhe forcohen gjithnjë e më tepër marrëdhëniet tona kulturore me popujt e Jugosllavisë”<sup>731</sup>. Pasi konstatonte se: “Me popujt Jugosllavisë gjithçka na bashkon dhe asgjë s’na ndan, se aleanca me Jugosllavinë nuk është një aleancë formale”<sup>732</sup>, artikullshkruesi, duke polemizuar me kritikët e bashkëpunimit mbi bazat unitariste dhe kosmopoliste të Shqipërisë me Jugosllavinë, shkruante: “Ka disa që u tingëllojnë kulturë e popujve të Jugosllavisë dhe përgjithësisht-kultura sllave. Këta janë ata që nuk kanë kurajën ta thonë se nuk u pëlqen kultura progresiste... Dy popujt tanë, Tirana dhe Belgradi, dy udhëheqësi tanë Enver dhe Tito, janë dhe do të jenë fytyrat e një monedhe të vetme”<sup>733</sup>. Duke pasurparasysh indoktrinimin e thellë me ideologji bolshevike komuniste të udhëheqësve shqiptarë, duhet t’i kuptojmë me realizëm retorikën dhe patetikën politike edhe të shtypitshqiptar të kohës. Siç shihet, ky shtyp reflektonte qëndrimet e përcaktimet politike të udhëheqjes së PKSH, për orientimin që me çdo kusht ta fuqizonte vartësinë e shumëfishtë nga Jugosllavia. Në fakt, Shqipëria po binte nën varësinë e plotë të udhëheqjes jugosllave.

Pikërisht, më 10 korrik 1947, gazetat “Politika” dhe “Borba” lajmëronin, në kuadër të thellimit të bashkëpunimit shqiptaro-jugosllav, më 9 korrik 1947, në Tiranë u nënshkrua Konventa për Bashkëpunimin Kulturor ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Shtypi jugosllav, duke iu referuar burimeve të korrespondentit të “Tanjugut” nga Tirana, citonte deklaratën e Manol Konomit, ministër i Drejtësisë, dhënë

730 “Bashkimi”, 9 korrik 1947.

731 Po aty.

732 Po aty.

733 Po aty.

pas ceremonisë së nënshkrimit të konventës: “Me njohjen e traditave kulturore të dy popujve tonë, edhe më tepër do të thellojmë dhe forcojmë lidhjet tona vëllazërore”<sup>734</sup>. Edhe përfaqësuesi i qeverisë jugosllave ishte cituar se kishte rikonfirmuar qëndrimin e vendosur jugosllav për thellimin e miqësisë dhe bashkëpunimit midis dy vendeve edhe në fushën e kulturës: “Konventa për Bashkëpunimin Kulturor dëshmon sërish gatishmërinë e popujve tanë të nisen me vendosmëri atyre rrugëve, të cilat sigurojnë paqe midis popujve, lidhje vëllazërore dhe të përhershme”<sup>735</sup>. Gazeta “Bashkimi”, në komentin redaksional të datës 12 korrik 1947, komentonte: “Me konventën, marrëdhëniet tona kulturore hyjnë në një fazë të re të zhvillimit. Ato tashti përcaktohen dhe konkretizohen mirësi pas nevojave dhe perspektivave të zhvillimit tonë arsimor e kulturor. Edhe në fushën kulturore ne kemi nevojë ndihmës dhe bashkëpunimit të popujve vëllezër të Jugosllavisë, ashtu si në fushën politike dhe ekonomike. Ashtu si nuk mund të kuptohet independenca dhe zhvillimi ekonomik i Shqipërisë pa ndihmën dhe bashkëpunimin e Jugosllavisë së re, ashtu nuk mund të kuptohet edhe zhvillimi lulëzimi kulturor në vendin tonë”<sup>736</sup>. Gazeta, gjithnjë në frymën e qëndrimeve të politikës së qeverisë shqiptare, propagandonte: “Kjo kulturë është për lirinë dhe independencën e Shqipërisë. Për një kulturë të tillë ka nevojë populli ynë dhe drejt një kulture të tillë do të ecim”<sup>737</sup>.

Gazeta “Politika” njoftonte se Enver Hoxha është pritur solemnisht në Moskë. Gazeta, duke iu referuar Agjencisë Telegrafike të lajmeve të Bashkimit Sovjetik, shkruante se: “Në Moskë, më 14 korrik, arritën kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore të Shqipërisë, gjeneral-kolonel Enver Hoxha, zëvendëskryetari i Këshillit të mi-

734 “Politika”, 10 korrik 1947.

735 Po aty.

736 “Bashkimi”, 12 korrik 1947.

737 Po aty.

nistrave dhe ministri i Punëve të Brendshme, Koçi Xoxe, ministri i Drejtësisë, Manol Konomi, dhe zyrtarë të tjerë. Në aerodromin qendror i pritën zëvendësi i Këshillit të Ministrave dhe ministër i Punëve të Jashtme të BRSS, Molotovi, zëvendësministri i Punëve të Jashtme të BRSS, Vishinski, si dhe personalitetetjera<sup>738</sup>. Dy ditë më vonë, me një lajm krejtësisht të shkurtër, duke iu referuar Agjencisë sovjetike “Tass”, e përditshmja serbe, “Politika” informonte lexuesit se Stalini ka pranuar në takim Enver Hoxhën. Në informatën e shkurtër thuhej se në bisedime kanë marrë pjesë edhe Molotovi, Koçi Xoxe dhe përfaqësuesi diplomatik i BRSS në Shqipëri, Dimitrij Çuvahin.<sup>739</sup>

“Bashkimi”, edhe gjatë muajve gusht-shtator 1947, kishte vazhduar t’i kushtonte hapësirë afirmimit të arritjeve ndërshtetërore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, por ajo që është për t’u veçuar është se, asnjëherë dhe me asnjë fjali, në asnjë koment redaksional dhe vështrime e analiza politike nuk e kishte përmendur problemin e Kosovë se as të shqiptarëve të mbetur në trojet e tyre në Jugosllavi. Kështu, gazeta “Bashkimi” kishte botuar lajmin për nënshkrimin në Tiranë të Marrëveshjes mbi suprimimin e vizave ndërmjet Shqipërisë dhe Jugosllavisë, më 25 shtator 1947.<sup>740</sup>

Nga përmbajtja e shkrimeve me temën e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, botuar te gazeta “Politika” gjatë muajit tetor 1947, është i veçantë artikulli i korrespondentit të saj nga Tirana, botuar më 5 tetor 1947. Artikullshkruesi, duke transmetuar thekse nga fjalimi i Enver Hoxhës, mbajtur më 3 tetor 1947 në Gjirokastrë, qytetin e tij të lindjes, e cilësonte fjalimin e tij si: “Fjalimi i madh i Enver Hoxhës, kryetar i qeverisë shqiptare në Gjirokastrë”<sup>741</sup>. Ai kishte veçuar pohimin e Enver Hoxhës: “Populli shqip-

738 “Politika”, 16 korrik 1947.

739 “Politika”, 19 korrik 1947.

740 “Bashkimi”, 27 shtator 1947.

741 “Politika”, 5 tetor 1947.

tar kurrë nuk ka pasur miq aq të shtrenjtë siç janë: Bashkimi i madh Sovjetik dhe Jugosllavia”<sup>742</sup>. Enver Hoxha kishte deklaruar për Bashkimin Sovjetik, se “... e mbron Shqipërinë nga rrezikimi i reaksionit ndërkombëtar”<sup>743</sup>, si dhe kishte ripohuar: “bashkimin dhe vëllazërimin e ngushtë ndërmjet popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë”<sup>744</sup>. Nga këto thekse, por edhe nga përmbytja e fjalimit të botuar me shkurtime në gazetën “Politika”, vërehej se Enver Hoxha, i ndikuar nga bisedimet dhe marrëveshjet me Stalinin, për herë të parë i vinte në plan të parë të bashkëpunimit në suazat e kampit komunist, marrëdhëniet me BRSS. Apostrofimi në fjalimin mbajtur në Gjirokastër, për rolin e veçantë të BRSS në ruajtjen e integritetit territorial dhe të pavarësisë të Shqipërisë, ishte një mesazh shumë i qartë për diplomacinë jugosllave. Në mos tjetër, me këtë fjalim, Enver Hoxha i bëri me dije Titos se në të ardhmen nuk do të pranonte që rregullat e lojës politike midis dy shteteve t’i përcaktonte vetëm Titoja. Në këtë kontekst, duhet analizuar edhe vizita e Enver Hoxhës, më 12 dhjetor 1947, në Bullgari dhe bisedimet e tij me kryetarin bullgar Georgi Dimitrov, vizitë për të cilën informonin, si shtypi shqiptar, ashtu edhe gazetat serbe “Politika” dhe “Borba”. Konkretisht, gazeta “Borba”, në korrespondencën e të dërguarit të saj nga Sofja, më 20 dhjetor 1947, citonte Enver Hoxhën, i cili gjatë takimit me gazetarë në Sofje kishte deklaruar: “Populli shqiptar dhe ai bullgar, në të ardhmen do të shkojnë krahpërkrah, duke ndërtuar të ardhmen më fatlume”<sup>745</sup>. Enver Hoxha me patetikë diplomatike zotohej për miqësinë shqiptaro-jugosllave. Kështu, në telegramin dërguar Titos, me rastin e ditës së Ushtrisë Kombëtare të Jugosllavisë, ndër të tjera, shkruante: “Ne luftuam dhe fituam së bashku. Gjaku i derdhur së bashku në luftën e

742 Po aty.

743 Po aty.

744 Po aty.

745 “Borba”, 20 dhjetor 1947.

përgjakshme që bënë popujt tanë kundër të njëjtit armik far këto i vëllazërimin dhe bashkimin e pathyeshëm të popujve tanë”<sup>746</sup>. Me këto përcaktime politike, Enver Hoxha dhe udhëheqja e Shqipërisë po hynin në vitin vijues, duke mosbesuar as vetë se viti 1948 do të ishte viti i thyerje vetë mëdha politike në relacionet me Jugosllavinë dh eudhëheqjen e saj, që do të kulmonin deri në prishje.

Numrin e parë të vitit 1948, datë 3 janar, gazeta “Bashkimi” e kishte hapur me botimin e urimit përshëndetës të Titos dërguar Enver Hoxhës, ku e falënderonte këtë të fundit për urimet e tij dërguar Titos, me rastin e nënshkrimit të Konventës Ekonomike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe me rastin e 22 Dhjetorit, ditës së Ushtrisë Jugosllave. Titoja, në urimet drejtuar Enver Hoxhës, ripohonte vendosmërinë e Jugosllavisë për thellimin dhe përparimin e miqësisë dhe bashkëpunimit me Shqipërinë<sup>747</sup>.

Gazeta në të njëjtën faqe, madje në vend më dallues se telegrame te Titos, kishte botuar edhe telegramin falënderues të Stalinit drejtuar Enver Hoxhës përpërshëndetjet miqësore dhe urimet e udhëheqësit shqiptar me rastin e ditëlindjes së Stalinit.<sup>748</sup> Përkushtimi deklarativ i Enver Hoxhës dhe i udhëheqjes shqiptare për thellimin e bashkëpunimit me Jugosllavinë reflektohej shumë qartë edhe në letër falenderimin e Enver Hoxhës dërguar Titos, e cila ishte botuar në gazetën “Bashkimi”, më 16 janar 1948: “...Populli shqiptar është i vendosur me të gjitha forcat e tij të ecë i bashkuar dhe krahpërkrah me popujt vëllezër të Jugosllavisë në rrugën e përbashkët për ndërtimin dhe garantimin e jetës së tyre të lumtur”<sup>749</sup>. Në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, në fillim të vitit 1948, ende nuk ndjehej ndonjë çarje. Për këtë dëshmonte edhe vendimi i qeverisë së Republikës Popullore të

746 “Bashkimi”, 23 dhjetor 1947.

747 “Bashkimi”, 3 janar 1948.

748 Po aty.

749 “Bashkimi”, 16 janar 1948.

Shqipërisë që qeveria jugosllave të interesohej për mbrojtjen e interesave shqiptare në vendet, ku RP e Shqipërisë ende nuk kishte marrëdhënie diplomatike. Lidhurme këtë, gazeta "Bashkimi", e datës 20 shkurt 1948, shkruante: "Me kërkesën e Republikës Popullore të Shqipërisë, qeveria e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë ka pranuar që të marrë përsipër mbrojtjen e interesave shqiptare në disa shtete, me të cilat Shqipëria nuk ka akoma lidhje diplomatike. Qeveria jugosllave është interesuar dhe ka bërë përçapje te duhura në këtë drejtim. Këto ditë, ajo njoftoi qeverinë shqiptare se tani së fundi edhe qeveritë e Egjiptit dhe të Brazilit kanë pranuar që përfaqësitë jugosllave në këto vendetë mbrojnë edhe interesat shqiptare"<sup>750</sup>. Edhe politika zyrtare jugosllave deklarohet pro forcimit të marrëdhënieve me Shqipërinë, duke ngritur zërin, madje edhe kundër provokimeve të grupeve monarko-fashiste greke ndaj Shqipërisë. Gazeta "Borba", më 4 mars 1948, informonte lexuesit e saj: "Nëse monarko-fashistët grekë mendojnë se kufijtë e Republikës Popullore të Shqipërisë janë të përshtatshme për veprime provokative, atëherë është e nevojshme t'u tërhiqet vërejtja se mashtrohen keq... Republika Popullore e Shqipërisë nuk është e lëshuar në mëshirën e vetvetes, nuk është pa miq dhe pa aleatë. Republika Popullore e Shqipërisë ka marrëveshje për ndihmë reciproke dhe bashkëpunim me Jugosllavinë dhe Bullgarinë"<sup>751</sup>.

Më 21 mars 1948, gazeta "Bashkimi" shkruante: "Në hekurudhën Shkodër-Titograd vazhdojnë punimet përgatitore"<sup>752</sup>. Në këtë gazetë ishte botuar intervista e inxhinierit Hujbnre, drejtor i Shoqërisë Shqiptaro-Jugosllave për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hekurudhave, i cili kishte bërë të ditur: "Në fund të këtij viti, Shqipëria do të ketë linjën hekurudhore

---

750 "Bashkimi", 20 shkurt 1948.

751 "Borba", 4 mars 1948.

752 "Borba", 21 mars 1948.

Shkodër-Titograd, e cila lidhet me Nikshiqin, Sarajevën e Beogradin, prej ku ka lidhje edhe me shtetet e tjera<sup>753</sup>. Më 24 mars, gazeta e mësipërme botonte raportin nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë për Lidhje Kulturore në mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë, mbajtur më 23 mars 1948 në Tiranë. Gazeta botonte fjalimin e Bedri Spahiut, i cili roline shoqatësnë fjalë e kishte projektuar edhe në funksion: "...që të njihet më mirë Jugosllavia e Titos, që u bë për popullin tonë mburoja e sigurt dhe besnike, ndihmëtarja efektive e ndërtimit paqësor të vendit, e ngritjes së jetës së re të popullit tonë, e sigurimit të independencës tonë"<sup>754</sup>. Ndërkohë, shtypi jugosllav lajmëronte se, më 6 prill 1946, në Beograd ishte themeluar kuvendi i Shoqërisë Kulturore Shqipëri-Serbi. Por, si rezultat i mosmarrëveshjeve dhe antagonizmave të thella politike midis BRSS dhe Jugosllavisë, idilës së marrëdhënieve midis PKSH dhe PKJ po u vinte fundi. Zhvillimet diplomatike në relacionet BRSS-Jugosllavi dhe reflektimet në prishjen e marrëdhënieve midis Tiranës zyrtare dhe Beogradit zyrtar dëshmuuan sesa iluzione dhe mashtrime kishte pasur në marrëdhëniet e brishta, false e të pabarabarta midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë komuniste. Miqësia e dikurshme midis dy shteteve komuniste, për një çast, pra, në vitin 1948, u shndërrua në armiqësi dhe madje edhe në prishje të marrëdhënieve diplomatike midis dy shteteve. Ajo prishje e "miqësisë" dëshmoise sa të dëmshme kishin qe në iluzionet politike të udhëheqjes së PKSH dhe të vetë Enver Hoxhës për "përkrahjen" dhe "ndihmën vëllazërore" të popujve dhe të udhëheqjes jugosllave. Sidoqoftë, udhëheqja shqiptare do të ishte dashur të ishte më vigjilente, më e përgjegjshme në pranimin e hapur para popullit të vet për politikën e dështimeve në raport me marrëdhëniet me Jugosllavi në dhe udhëheqjen e PKJ. Udhëheqja e PKSH i fshihte gabimet e saj,

---

753 Po aty.

754 "Bashkimi", 24 mars 1948.



e fshihte të vërtetën për marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe me një vonesë historike, pra, edhe vetë Enver Hoxhës i pranoi gabimet e veta për politikën pro bashkëpunimit me çdo kusht me Jugosllavinë.

Më 1 korrik 1948, gazeta "Bashkimi" botonte tekstin integral të komunikatës së KQ të PKSH, në lidhje me rezolucionin e Byrosë Informative të Partive Komuniste dhe Punëtorë mbi gjendjen në Partinë Komuniste të Jugosllavisë. Në komunikatë, pasi konstatohej se: "Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Shqipërisë unanimisht solidarizohet me rezolucionin e Byrosë Informative të Partive Komuniste mbi gjendjen në Partinë Komuniste të Jugosllavisë..."<sup>755</sup>, në vijim, vlerësonte: "Komiteti Qendrori i Partisë Komuniste të Shqipërisë vazhdimisht ka qenë në konflikt me Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Jugosllavisë, i cili është përpjekur t'i imponojë vendit tonë dhe partisë sonë metoda dhe politikën e tij tradhtarë, armiqësore, trockiste"<sup>756</sup>. Në komunikatë apostrofohej përkushtimi i udhëheqjes së PKSH për thellimin e marrëdhënieve me PK të BRSS, që sipas formulimit të qëndrimit ndaj BRSS dhe personalisht Stalinit, linte të kuptohej se PKSH po paralajmëronte kursin e ri të politikës ndërkombëtare të shtetit shqiptar: "Në momentet më të rënda të konfliktit të egër që ekzistonte në mes të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Shqiptare dhe udhëheqësve të Partisë Komuniste Jugosllave, ndihma e Partisë Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, e shokëve të shtrenjtë Stalin dhe Molotov, që iu dha partisë sonë dhe gjithë partive të tjera motra komuniste ishte shpëtim madhi popullit tonë, i Partisë sonë Komuniste"<sup>757</sup>. Ndërkaq, gazeta "Politika" kishte botuar tre nota të qeverisë jugosllave drejtuar qeverisë shqiptare, në lidhje me fillimin e fushatës ndërshtetëror edhe konfliktin e hapur midis dy

---

755 "Bashkimi", 1 korrik 1948.

756 Po aty.

757 Po aty.

partive komuniste. Në notën e parë të qeverisë jugosllave, pasi konstatoheshin një varg incidentesh të shkaktuara në Shqipëri ndajshitetasve jugosllavë, thuhej: “Një veprimi këtil-lë brutal dhe ofendim nga ana e pushtetit shqiptar ndaj personalitetit të kryetarit të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë është në kundërshtim flagrant me marrëveshjet dhe marrëdhëniet midis popujve dhe vendeve tona... Në lidhje me këtë, qeveria jugosllave proteston në mënyrën më të rreptë te qeveria shqiptare dhe kërkon që bartësit e këtyre ofendimeve të thirren në përgjegjësi, që kundër tyre të ngrihen hetimet dhe se për rezultatet përkatëse të njoftohet qeveria e RFP të Jugosllavisë”<sup>758</sup>. Më 4 korrik 1948, “Politika” botoonte përgjigjene qeverisë jugosllave ndaj notave të qeverisë shqiptare, nga ku mund të kuptohej se konflikti midis PKSH dhe PKJ kishte marrë përmasa serioze dhe paralajmëronte shkallëzime të reja deri në prishjen e plotë të marrëdhënieve midis dy partive dhe dy vendeve fqinjë, të cilat aq shumë kishin propaganduar bashkëpunimin fqinjësor. Në notën e qeverisë jugosllave thuhej: “Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë i kakomunikuar qeverisë së Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë se i anulon të gjitha marrëveshjet ekonomike, kontratat dhe protokollet dhe se i konsideron si të pavlefshme dhe joekzistuese”<sup>759</sup>.

Lidhur me komunikatat jugosllave, “Bashkimi”, më 7 korrik, botoonte komunikatën ATSH, ku hidheshin poshtë: “...si shpifje dhe një trillim të thjeshtë, pa baza, lajmin e dhënë nga Legata e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë në Tiranë...se gjoja policia shqiptare kabllokuar në Shkodër dhe në Durrës ushqime te destinuar përrestorantin jugosllav dhe gjoja paska ndaluar ushqimet e shtetasve jugosllavë... Ky lajm konsiderohet si një shpifje e bërë me të vetmin qëllim armiqësor për të krijuar zemërimin e popujve vëllezër

758 “Politika”, 3 korrik 1948.

759 “Politika”, 4 korrik 1948.

të Jugosllavisë ndaj vendit e popullit tonë<sup>760</sup>. Ndërsa, më 9 korrik, gazeta "Bashkimi" botonte tekstin e plotë të notës së Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë dërguar Legatës së Jugosllavisë në Tiranë, ku protestohet për akuzat e bëra në lidhje me largimin e personelit jugosllav nga Shqipëria. Në notën diplomatike të Ministrisë së Jashtme Shqiptare konkludohej: "Ministria e Jashtme e Republikës Popullore të Shqipërisë konsideron se akuzat, në të cilat ishte mbështetur protesta e asaj legate, janë krejtësisht në kundërshtim me realitetin, të dalë nga një informacion i gabuar i asaj legate"<sup>761</sup>. Përgjigja e qeverisë shqiptare ndaj akuzave të qeverisë jugosllave dhe denoncimeve që vinin nga Legata jugosllave në Tiranë, përqëndrim jokorrekt të punëtorëve të sigurimit të rendit shqiptar ndaj shtetasve jugosllavë që ndodheshin në Shqipëri, ishte edhe më e rreptë në notën diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë drejtuar Legatës jugosllave në Tiranë, në lidhje me rastin e kolonelit jugosllav. Në notë, ndër të tjera, thuhej: "Notat jugosllave nuk përmbajnë veçse një varg gënjeshtresh të imagjinuara dhe të kurdisura me një mendjelehtësi të çuditshme dhe me paturpësitë regjur. Përralla e "pengesave" të shtetasve jugosllavë për t'u larguar nga Shqipëria, e "prerjes" së ushqimeve fëmijëve jugosllavë dhe nga ana tjetër shpifjet e Radio-Beogradit dhe të agjencisë së lajmeve jugosllave që po bëhen kundra vendit tonë dhe popullit tonë... e kanë burimin e tyre në deklaratat e disanjerëzve të papërgjegjshëm dhe me një të kaluar shumë të dyshimtë, që autoritetet jugosllave nuk përtojnë ta përhapin, duke shpifur paskrupuj kundra vendit tonë"<sup>762</sup>. Intonacioni i kundërpërgjigjes diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Shqipërisë ndaj akuzave jugosllave, ishte i nivelit të tillë, që shprehte papajtueshmëri absolute mes qëndrimeve të dy qe-

---

760 "Bashkimi", 7 korrik 1948.

761 "Bashkimi", 9 korrik 1948.

762 Po aty.

verive të shteteve fqinje, dhe, në esencë, duke përdorur edhe kualifikimin “me qëllime armiqësore”<sup>763</sup>, paralajmëronte shkallëzime në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave: “Por këto nota përmbajnë, nga ana tjetër, edhe gënjeshtër të kurdisura me qëllime të errëta provokacioni dhe shpifjeje, me qëllime armiqësore si rasti i imagjinuar fund e krye dhe i shpifur i grisjes së një flamuri jugosllav, si rasti i shtrembëruar fund e krye i kolonel Spiro Srezentiç etj”<sup>764</sup>. Në të njëjtin numër të gazetës “Bashkimi” bie në sy lajmi për arritjen në Tiranë të një delegacioni ushtarak sovjetik. Gazeta botonte fjalën përshëndetëse të zëvendësministrit të Mbrojtjes Kombëtare Shqiptare, gjeneral-major Kristo Themelko, i cili, para delegacionit ushtarak sovjetik, kishte thënë: “Neve shqiptarët, Ushtria e jonë është koshiente se pa Bashkimin Sovjetik, pa Ushtrinë Sovjetik edhe luftën e saj, nuk do të kishim fituar lirinë dhe independencën dhe këtë ja dimë për nder dhe nuk do t’ua harrojmë kurrë, deri në vdekje, popujve të Bashkimit Sovjetik, Partisë Bolshevike dhe Stalinit të Madh”<sup>765</sup>. Po aty botohej edhe fjala e gjeneral kolonel Grishin Ivan Mihonoviç, i cili, duke iu drejtuar popullit të Tiranës, kishte paralajmëruar: “S’ka e s’do të ketë një fuqi të këtillë që të mund ta thyejë frontin e vetëm të popujve të lirë me Bashkimin Sovjetik në krye. Kush do ta ngrejë shpatën kundra këtij, do të gjejë vdekjen prej kësaj shpate”. Gazeta, po ashtu, nënvizonte: “Më se 15.000 veta nga populli i kryeqytetit ishin radhitur në të dyja anët e rrugës, që nga aeroporti deri te pallati i komitetit ekzekutiv të qytetit të Tiranës që priste me gëzim për të përshëndetur delegacionin ushtarak të Bashkimit të lavdishëm Sovjetik... Nga turma dëgjoheshin thirrjet: “Rroftë Bashkimi Sovjetik, Rroftë Partia Bolshevike, Të rrojë Stalini i Madh, Tiranë-Moskë...”<sup>766</sup>. Pra, ende pa u shpallur prishja defini-

763 Po aty.

764 Po aty.

765 Po aty.

766 Po aty.

tive dhe ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavinë, në vend të parullës "Tiranë-Beograd", aq shpeshtë brohoritur shesheve të Tiranës, tani po në të njëjtatsheshe po trumbetonte parulla "Tiranë-Moskë".

Ndërkohë, qeveria jugosllave, në planin e luftës diplomatikeme Shqipërinë, në fund të korrikut të vitit1948, kishte dërguar telegrame përkrahjeje dhe mbështetjeje për udhëheqjen e saj, në lidhje me mospajtimet dhe kundërshtimet reciproke të Jugosllavisë ndaj akuzave dhe notave denoncuese diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Madje, qeveria jugosllave, në luftën propaganduese, përdorte edhe shtetasit shqiptarë, të cilët gjendeshin në Kosovë me angazhime konkrete në fushën e arsimit. Gazeta "Politika", më 20 korrik, lajmëronte: "Mësuesit shtetas shqiptarë, të cilët jetojnë në Kosmet, kanë mbajtur këshillim, në të cilën kanë shqyrtuar rezolucionin e Informbyrosë për gjendjen në Partinë tonë dhe qëndrimin e KQ të PKSH ndaj PKJ. Me atë rast i kanë dërguar telegram KQ të PKJ dhe qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë"<sup>767</sup>. Gazeta nënvizonte se, mësuesit shtetas shqiptarë nga Kosova e dënojnë qëndrimin e KQ të PKSH ndaj PKJ: "Na habit deklarata dhe akuza e KQ të PKSH ndaj PKJ dhe Komitetit të saj Qendror, se KQ i PKSH ka mundur të dijë dhe di se akuza e saj është e pasaktë dhe e paramenduar..."<sup>768</sup>. Por edhe PKSH organizonte tubim edhe mitingje partiake në shenjë përkrahjeje të qëndrimeve të dala nga rezolucioni i Byrosë Informative dhe komunikatave të KQ të PKSH, në lidhje me vlerësimet për gjendjen në PKJ. Gazeta "Bashkimi", më 15 shkurt 1948, njoftonte se: "Aktivete organizatës së Partisë të rrethit të Lezhës dhe Krujës aprovojnë plotësisht rezolucionin e Byrosë Informative dhe Komunikatën e KQ të P.K. Shqiptare"<sup>769</sup>. Më 17 korrik, "Bash-

---

767 "Politika", 22 korrik 1948.

768 Po aty.

769 "Bashkimi", 15 korrik 1948.

kimi" njoftonte: "Partia Komuniste Shqiptare nuk pranon të dërgojë delegacion në Kongresin e Partisë Komuniste të Jugosllavisë"<sup>770</sup>. Gazeta botonte tekstin integral të përgjigjes së KQ të PKSH, lidhur e ftesën e KQ të PKJ që të dërgonte një delegacion në Kongresin e Pestë të KQ të PKJ. Në pikën dy të letër përgjigjes së KQ të PKSH, nënshkruar nga Koçi Xoxe, thuhej: "Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Jugosllave ka bërë karshi Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe karshi Komitetit Qendror të saj një politikë armiqësore anti-marksiste, duke rrezikuar ekzistencën e Partisë Komuniste Shqiptare dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë"<sup>771</sup>. Kjo përgjigje e KQ të PKSH, në fakt, sqaronte drejt për drejt pozicionin e vendosur të KQ të PKSH për të shkuar deri në fund në konfliktin me KQ të PKJ, pra, edhe deri në shkëputje të bashkëpunimit dhe të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe jo vetëm midis dy partive komuniste. Fryma e tillë e konfrontimit midis KQ të PKSH dhe KQ të PKJ bartej edhe në për organizatat e PKSH dhe institucionet e tjera në jetën shoqërore, intelektuale, ekonomike, arsimore, e kulturore në Shqipëri. "Bashkimi", më datë 29 korrik, duke njoftuar për solidaritetin e qytetarëve dhe të masave punonjëse e punëtores të mbarë viseve të Shqipërisë me qëndrimet e dala nga Komunikata e KQ të PKSH, në lidhje me konfrontimin me KQ të PKSH, njoftonte: "Nga mbledhjet për punimin e rezolucionit të Byrosë Informative dhe Komunikatës së K.Q. të P.K. të Shqipërisë, punëtorët dhe populli përshëndesin Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë"<sup>772</sup>. Gazeta, ndërkaq, në numrin e 31 korrikut, njoftonte: "Nga mbledhjet për punimin e rezolucionit të Byrosë Informative dhe Komunikatës së K.Q. të P.K. të Shqipërisë, populli i fshatrave dhe qyteteve për shëndet Komitetin Qendror të Partisë Komu-

---

770 "Bashkimi", 17 korrik 1948.

771 Po aty.

772 "Bashkimi", 29 korrik 1948.

niste të Shqipërisë<sup>773</sup>. Qëndrimet dhe konstatimet e dala nga Komunikata e KQ të PKHi përshëndesnin edhe komunistët shqiptarë që në atë kohë jetonin në Beograd, e në radhë të parë punonjësit e legatës shqiptare në Jugosllavi. Në këtë kontekst, “Bashkimi”, më 1 gusht 1948, botontete legramin e komunistëve shqiptarë që jetonin e vepronin në Beograd: “Ne komunistët shqiptarë në Beograd jemi dëshmitarë të politikës armiqësore që vazhdojnë të bëjnë udhëheqësit e Partisë Komuniste Jugosllave dhe të shtetit jugosllav karshi Byrosë Informative dhe partive tjera si motra, karshi Partisë Bolshevike dhe Bashkimit Sovjetik, karshi partisë dhe popullit tonë në fushatat e tyre demagogjike...”<sup>774</sup>. Në shtator 1948, gazeta “Bashkimi” botonte deklaratën e KQ të PKSH mbi shpifjet e KQ të PK të Maqedonisë. Në deklaratë, pasi konstatohej se: “Deklarata e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Maqedonisë është një dokument antishqiptar dhe antimarksisist i bërë me qëllime të caktuara nga klikanacionaliste trockiste e Titos me shokë<sup>775</sup>, për herë të parë, polemizohej me KQ të PKJ për temën e Kosovës, përkatësisht për pozitën e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të ngulura nën Jugosllavi, duke e kualifikuar politikën e udhëheqjes jugosllave ndaj popullit shqiptar në Jugosllavi, politikë jo të drejtë dhe nacionaliste të KQ të PKJ. Deklarata e KQ të PKSH konstatonte: “...Shqipëria mbahej krejtësisht e izoluar për zhvillimin e situatës në Kosovë. Marrëdhëniet në mes të popullit shqiptar dhe popujve të Jugosllavisë po forcoheshin dhe kjo sillte patjetër me vete që marrëdhëniet e Shqipërisë me popullatë nshqiptare të Kosovës duheshin të forcoheshin dhe të afroheshin. Nga politika jo e drejtë dhe nacionaliste e Komitetit Qendror të Jugosllavisë kjo nuk ngjau<sup>776</sup>. Në vijim të Komunikatës së KQ tëPKSH sqarohej edhe më drejt-

773 “Bashkimi”, 31 korrik 1948.

774 “Bashkimi”, 1 gusht 1948.

775 “Bashkimi”, 4 shtator 1948.

776 “Bashkimi”, 4 shtator 1948.

përdrejt pozicionimi i ri i qeverisë shqiptare ndaj çështjes së Kosovës dhe përgjithësisht çështjes shqiptare në Jugosllavi, e cila, deri në shtator të vitit 1948, ishte injoruar në tërësi. Mund të thuhet se kjo frymë e qëndrimeve të PKSHP ndaj çështjes së Kosovës, e promovuar në vjeshtë të vitit 1948, paralajmëronte se problemi i Kosovës dhe i shqiptarëve në Jugosllavi do të ngrihej në nivelet më të larta të politikës së brendshme dhe asaj të jashtme të shtetit shqiptar. Për këtë dëshmon fragmenti vijues nga komunikata në fjalë: “As populli shqiptar nuk di gjë si zhvillohet jeta në shqiptarët e Kosovës e Metohisë, por as shqiptarët e Kosovës e Metohisë nuk dinë dhe s’janë të qartë se si zhvillohet jeta në Shqipërinë e re. Shumë herë kanë shkuar grupe folkloristike nga Shqipëria në Jugosllavi, kanë vizituar gjithë Jugosllavinë, janë pritur me dashuri dhe entuziazëm nga gjithë popujt e Jugosllavisë, por Komiteti Qendror i Jugosllavisë kurrë nuk ka menduar dhe lejuar që këta të shkojnë në Kosovë dhe Metohi”<sup>777</sup>. Në komunikatë, për herë të parë, publikisht, pranohej edhe faktise KQ i PKJ nuk kishte lejuar që udhëheqësit politikë të KQ të PKSHP, që kishin vizituarsa e sa herë Jugosllavinë, të vizitonin Kosovën dhe viset tjera të banuara me shqiptarë. Konkretisht, në komunikatë shkruhej: “... Por kurrë Komiteti Qendror i Jugosllavisë nuk ka menduar dhe lejuar që këta shokë, udhëheqës kryesorë të Partisë sonë, të shkojnë në Kosovë e Metohi, të marrin kontakt me popullatën shqiptare të Kosovës... Me urdhërja në hequr shumë kohë më parë nga shkollat shqipe të Kosovës e Metohisë librat në gjuhën shqipe që ishin shtypur në Shqipëri”<sup>778</sup>. Megjithatë, udhëheqja e PKSHP, e influencuar vetëm nga elementi ideologjik i rezolutës së Informbyrosë, në komunikatë sugjeronte popullin shqiptar në Jugosllavi: “E vetmja rrugë e drejtë për shqiptarët e Kosmetit dhe të Maqedonisë është bashkimi i shëndoshë me popujt vëllezër të Jugosllavisë dheme elementin e shëndoshë

<sup>777</sup> “Bashkimi”, 4 shtator 1948.

<sup>778</sup> Po aty.



të Partisë Komuniste Jugosllave për të luftuar kundër klikës tradhtarë të Titos, që po përpiqet t'ia bëjë varrin Jugosllavisë së re dhe që po përpiqet ta transformojë këtë në një koloni të imperializmit<sup>779</sup>.

Tema e konfrontimit të hapur politik midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë kishte vazhduar të zinte faqet e para të shtypit shqiptar dhe të atij jugosllav edhe gjatë muajve nëntor e dhjetor 1948, pra deri në prishjen dhe ndërprerjen definitive të marrëdhënieve diplomatike ndërshtetërore midis dy vendeve. Siç del nga komunikatat zyrtare të forumeve partiake dhe atyre shtetërore të dy shteteve, edhe udhëheqja shqiptare, edhe ajo jugosllave e akuzonin njëra-tjetrën për prishjen e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Por, në fakt, prishja e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave erdhi kryesisht si rrjedhojë e konfrontimit të hapur midis PK të BRSS dhe PKJ. Pas prishjes së marrëdhënieve diplomatike me Jugosllavinë, Shqipëria u orientua në thellimin dhe zgjerimin e marrëdhënieve diplomatike, ushtarake, ekonomike, kulturore e të tjera me BRSS. Orientimi i Shqipërisë nga bashkëpunimi, në radhë të parë, me BRSS e përcaktoi edhe më qartë drejtimin e politikës së brendshme dhe asaj të jashtme shqiptare kah totalitarizmi lindor. Me këtë, Shqipëria, për pesëdhjetë vjet me radhë, i mbylli dyert e kooperimit me civilizimet euro-atlantike, duke u shndërruar në një nga emblemat më ortodokse të mbrojtjes së komunizmit si ideologji dhe projekt pa ardhmëri. Ndërkohë, shteti shqiptar përjetoi zhvillime të rënda, kurse përgjithësisht, çështja shqiptare deri në shembjen e komunizmit dhe fitoren e demokracisë edhe në Shqipëri, mbeti e izoluar nga zhvillimet ndërkombëtare. Pasojat e këtij rreshtimi ndërkombëtar të Shqipërisë u reflektuan edhe në pozitën diskriminuese të popullit shqiptar të mbetur në kufijtë e Jugosllavisë së dytë avnojiane, veçmas të popullit të Kosovës, të cilit, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore nuk iu pranua, nuk iu njohë e drejta për vetvendosje.

---

779 Po aty.

## PËRMBYLLJE

Marrëdhëniet shqiptaro-jugoslave, gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe ato të viteve 1945-1948, janë ndër segmentet më të veçanta në historikun e marrëdhënieve të Shqipërisë me shtetet fqinje në historinë e re të Evropës Juglindore. Këto marrëdhënie në vete ngërthejnë përpjekjet intensive për bashkëpunim të dy shteteve mbi bazat e kooperimit dhe të bashkëpunimit midis dy partive komuniste. Lirisht mund të themi se marrëdhëniet shqiptaro-jugoslave, të periudhës 1941-1948, janë si rrjedhojë, jo aq të zhvillimeve historike dhe politike në Evropën Juglindore, sesa ato reflektojnë burimisht raportet e ndërsjella të determinuara nga interesat dhe synimet programore të PKSH dhe të PKJ. Kjo do të thotë se marrëdhëniet shqiptaro-jugoslave, pas vitit 1945, pra, pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, nuk kanë qenë të domosdoshme që të vazhdonin drejt thellimit dhe ndihmëse bashkëpunimit reciprok ndërshtetëror, sikur të mos kishte qëlluar rastësia që fituese të Luftës Antifashiste në të dy vendet dolën pikërisht dhe në mënyrë absolute të dy partitë komuniste fqinje, pra PKSH në Shqipëri dhe PKJ në Jugosllavi. Ç'është e vërteta, historiku i marrëdhënieve shqiptaro-jugoslave, në periudhën 1945-1948, e kishte kontinuitetin e vet në bashkëpunimin midis PKSH dhe PKJ qysh nga themelimi i PKSH, 8 nëntor 1941. Historiografia jugosllave vazhdon të këmbëngulë në rolin vendimtar të përfaqësuesve komunistë jugosllavë me rastin e themelimit të PKSH, por në fakt kjonuk mund të pranohet si fakt absolut

historik, sepse, veprimet e celulave komuniste në Shqipëri kishin nisur edhe para takimeve të para midis komunistëve shqiptarë dhe përfaqësuesve të PKJ, lidhur me bashkimin e grupeve komuniste shqiptare. Megjithatë, përfaqësuesit e PKJ, gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore, zhvilluan aktivitete intensive dhe konkrete deri në ndërhyrje në zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri dhe në radhë të parë, në shumë raste, patën ndikim vendimtar në vendimmarrjen e përcaktimeve programore të PKSH. Ndërhyrja e tyre ishte vendimtare në prishjen e Marrëveshjes së Mukjes dhe në këtë kuptim, pretendimi i Enver Hoxhës që meritat për këtë t'ia linte vetes, nuk qëndrojnë. Kjo për faktin se, në këtë periudhë, ai ishte nën ndikimin dhe presionet e emisarëve ushtarakë e politikë jugosllavë. Ndërhyrja më qartë dhe më e kobshme e emisarëve jugosllavë në zhvillimet politike në Shqipëri ndodhinë Plenumin e 2-të të KQ të PKSH, i njohur në histori si Plenumi i Beratit. Me vendimet e Plenumit të 2-të të KQ të PKSH, u hapën portat e ndërhyrjes së pakontrolluar të KQ të PKJ në zhvillimet politike në Shqipëri dhe në radhë të parë përbrenda PKSH. Ç'është e vërteta, në vitin 1945, në sajë të kundërshtimeve të vijës antijugosllave, në Byronë Politike të KQ të PKSH, me në krye Sejfulla Malëshovën, trendet e bashkëpunimit dhe bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë, në një masë kishin stagnuar dhe po e ngadalësonin atë proces. Mirëpo, KQ i PKJ, duke e hetuar këtë tendencë, menjëherë, përmes emisarëve të vet në Shqipëri, kishte reaguar dhe kështu fillimi i vitit 1946 shënon kthesë të re në thellimin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave që shpinin kah bashkimi i dy shteteve në një federatë. Plenumi i 5-të i jashtëzakonshëm i KQ të PKSH, mbajturnë shkurt 1946, kishte dënuar dhe eliminuar politikisht vijën partiake të Sejfulla Malëshovës për kundërshtim të platformës së PKSH, për bashkëpunim me PKJ dhe njëkohësisht kishte përcaktuar drejtimit e reja politike të atij bashkëpunimi. Presioni jugo-

sllav, sidomos i përfaqësuesit të PKJ në PKS, Savo Zlatiç, ishte i vazhdueshëm dhe këmbëngulës. Megjithatë, nuk vanoi dhe përbrenda udhëheqjes së Byrosë Politike të KQ të PKS ishte paraqitur edhe një vijë tjetër politike, e cila nuk pajtohej me orientimin e PKS për bashkim me Jugosllavinë. Eksponenti kryesor i kësaj vije politike ishte Nako Spiru, i cili, edhe pse kishte koordinuar sa e sa traktate miqësie dhe bashkëpunimi ekonomik me jugosllavët, dhe, madje kishte nënshkruar dokumente shtetërore në emër të qeverisë së Tiranës, megjithatë ishte kritikuar për sektarizëm, vijë të dytë politike në lidhje me bashkëpunimin me Jugosllavinë. Mbi këto akuza të rënda, se ishte kundër bashkëpunimit dhe aq më tepër bashkimit me Jugosllavinë, Nako Spiru kritikohet rreptë dhe detyrohet në vetëvrasje.

Edhe pse gjatë vitit 1946, midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ishin nënshkruar me dhjetëra marrëveshje ndërshtetërore të nivelit më të lartë zyrtar, deri edhe te Traktati për Bashkëpunim dhe Ndihmë Reciproke midis dy shteteve, pala jugosllave nuk ishte e kënaqur me shkallën e realizimit të marrëveshjeve. Kjo pakënaqësi jugosllave, që u paraqit edhe pas vizitës së Enver Hoxhës në Jugosllavi, në fillim të vitit 1947, kulmoi me padinë ndaj KQ të PKS për gjoja krijimin e një vije të dytë antijugosllave. Ky veprim dinak e detyroi KQ të PKS që të vinte në rend dite të Plenumit të 8-të të KQ të PKS akuzën jugosllave. Synimi ishte i qartë, që të bëhej presioni shtuar në udhëheqjen e KQ të PKS për të përshpejtuar bashkimin me Jugosllavinë. Udhëheqja e PKS e gjetur e pafuqishme përballë këtyre presioneve, edhe për faktin se pozitat ndërkombëtare të Shqipërisë në atë kohë ishin shumë të pavolitshme, ishte detyruar që t'i pranonte këto akuza. Udhëheqja e PKS nuk kishte informacione se, ndërkohë, ishin shfaqur shenjat e para të mosmarrëveshjeve, jo vetëm ideologjike midis BRSS dhe Jugosllavisë. Në janar të vitit 1947, Tito, i trimëruar nga forcimi i vijës projugosllave

në PKSH, i kishte kërkuar Enver Hoxhës lejen për një bazë ushtarake në Korçë, ku do të vendosej një divizion i ushtrisë jugosllave. Beogradi e prapësoi urdhrin vetëm pas intervenimit të rreptë diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të BRSS, e cila paraprakisht ishte informuar nga Enver Hoxha. Udhëheqja shqiptare me në krye E. Hoxhën ishte krejtësisht e pafuqishmë e që të kundërshtonte qëllimet gllabëruese të Jugosllavisë. Ndërkohë, pala jugosllave, përmes Savo Zlatiçit, e kishte ngritur qëllimisht çështjen e Kosovës para udhëheqjes së PKSH. Qëllimi i jugosllavëve ishte ta vinte në lajthitje tërë udhëheqjen e PKSH.

Ngamesi i prillit 1948, udhëheqja e PKSH, përmes letrës së PK të BRSS, u njoftua me konfliktin Stalin-Tito. Nuk kishin kaluar as dy javë të plota që kur ishte shpallur rezolucioni i Plenumit të 8-të të KQ të PKSH ku ishte përcaktuar platforma e shpejtimit të bashkimit me Jugosllavinë Udhëheqja e PKSH, e gjetur midis Titos dhe Stalinit, ishte vendosur për këtë të dytin. Tito, duke parë rrezikun e madh që po e humbte Shqipërinë si zonë interesi, në pranverë dhe verë të vitit 1948, i kishte shpeshtuar presionet mbi Enver Hoxhën, por ky, duke e vlerësuar qartë momentin historik për t'i shpëtuar ndikimit të ndërhyrjeve të Titos, përfundimisht në qershor 1948, merr plotësisht anën e Stalinit. Ky riorientim kombëtar, diplomatik e ndërkombëtar i Enver Hoxhës kah miqësia me sovjetikët, aspak nuk ia lehtësonte sfidat, me të cilat shumë shpejt ishte ballafaquar.

## **BURIMETDHELITERATURA**

### **1. Burimet e pabotuara**

Arkivi Qendrori Shqipërisë (AQSH); Arkivi i KQ të PPSH;

Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë;  
Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë; Arki-  
vii KQ të PKJ(LKJ), Beograd;

Arkivi i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme të Ju-  
gosllavisë, Beograd; Arkivi i Kosovës, Prishtinë;

Arkivi i Institutit të Historisë, Prishtinë;

Biblioteka Kombëtare, Tiranë;

Biblioteka Kombëtare, Prishtinë.

### **2. Burimet arkivore të botuara**

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1945-1948, (Doku-  
mente), Tiranë, 1996;

Politika antikombëtare e Enver Hoxhës, Tiranë, 1996;

Bela knjiga, dokumente, Beograd, 1951; Bela knjiga, doku-  
mente, Beograd, 1961;

Dokumenti ospolnoj politici SFRJ, dokumente, 1946, II,  
Beograd, 1985, 1947, I, Beograd, 1985, 1947, II, Beograd, 1986;  
1948, Beograd, 1989, 1946, I, Beograd, 1985;

Izvoriza istoriju SKJ, Dokument i Central nih Organa  
KPJNOR i Revolucija 1941-1945, Beograd, 1987;

Kongresi i Frontit Demokratik, 5 gusht 1945, dokumente,  
Tiranë, 1945;

Politika antikombëtare e Enver Hoxhës, Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, dokumente, Tiranë, 1996;

PPSH, dokumente kryesore I, (1960,1975); III (1970) Tiranë.

### 3. Literatura

Agani, Fehmi [1994], Demokracia, kombi, vetvendosja, Pejë; Bakalli, Arifi Emine [1997], Marrëdhëniet ekonomike shqiptaro-jugosllave 1929-1939;

Bare, Themis [1966], Provokacione dhe komplete kundër Republikës Popullore të Shqipërisë në vitet 1945-1945, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Prishtinë;

Barker, Elisabeth [1978], Britanska politika na Balkanu u II svjetskomratu, Zagreb;

Bartl Peter, Albanien Vom Mittelalter bis zur Gegenwart, Regensburg, 1995;

Bartl Peter, Shqipëria nga mesjeta deri më sot, Prizren, 1999;

Basha-Sabile Keçmezi, Lëvizja ilegale patriotike shqiptare në Kosovë (1945-1947), Rilindja, 1998;

Beqaj Rakip, Veprimtaria armiqësore e klerit katolik shqiptar 1945-1971;

Bethel Nikolas, Tradhtia e madhe, Tiranë, 1993;

Biagini Antonello, Historia e Shqipërisë, Tiranë, 1998;

Bislimi Daut, Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945, Prishtinë, 1997;

Butka Uran, Ringjallja, Tiranë, 1995;

Castellan Georges, Historia e Ballkanit, Tiranë, 1996; Champseix, Elisabeth & Champseix, Jean Paul [2000], Shqipëria ose logjika e dëshpërimit, Tiranë;

Conte Artur, Jalta dhe ndarja e Botës, Tiranë, 1994;

Çabej Eqrem, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes, Tiranë, 1994;

Dedijer, Vladimir [1980], Noviprilozi za autobiografiju Josipa Broza Tita, Tom 1-3, Rijeka;

Dedijer Vladimir [1980], Noviprilozi za autobiografiju Josipa Broza Tita, Tom 1- 3, Mladost, Zagreb;

Dedijer, Vladimir [1947], Pariška Konferencija, Beograd;

Dedjer, Vladimir [1949], Albansko-Jugoslovenski odnosi (1939-1948), Beograd;

Dedjer, Vladimir [1949], Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave (1939-1948), Beograd;

Demi, Leonard [2000], Shqipëria dhe diplomacia amerikane, Tiranë;

Dizdarević, Nijaz [1998], Albanski dnevnik, Lubjanë; Djaković, Spasoje [1984], Sukobina Kosovu, Beograd;

Djilas, Milovan [1990], Razgovorisa Staljinom, Beograd;

Djilas, Milovan [1991], Vlasti pobuna, Beograd;

Djordjević, Borozan, Velika Albanija, Beograd, 1995;

Durham Edith, Brenga e Ballkanasve, Tiranë, 1998;

Ermenji Abaz, Albania, Romë, 1968;

Gard, Paul [1996], Zivoti smrt Jugoslavije, Ceres, Zagreb; Fevziu, Blendi [2011], Enver Hoxha, Tiranë;

Fischer J. Bernd, Shqipëria gjatë Luftës 1939-1945, Tiranë, 1999;

Gjeçovi, Xhelal [1999], Lufta Nacionalçlirimtare në Shqipëri, Tiranë;

Gjeçovi, Xhelal [1998], Shteti shqiptar dhe çështja e Kosovës, Tiranë;

Hibbert, Reginald [1993], Fitorja e hidhur Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, Tiranë;

Hisari, Bashkim, Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave, 1945-1948, (temë magjistrature - dorëshkrim), Biblioteka e Fakultetit Filozofik në Prishtinë;

Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar (1939-1944), Tiranë, 1975;

Historia e Partisë së Punës, Tiranë, 1968;



Historia e Shqipërisë, IV, Tiranë, 1975; Hadri, Ali [1976], Gjakova në LNC, Prishtinë;

Hadri, Ali [1973], Kritikë historiografike, Nova Make-donija, Shkup;

Hoti, Izber [1997], Çështja e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore, Prishtinë; Hoti, Izber [1999], Të dhëna të panjohura për Luftën e Dytë Botërore në Kosovë (1941-1945), Prishtinë;

Hoxha, Enver [1979], Me Stalinin (kujtime), Tiranë;

Hoxha, Enver [1982], Rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë, (kujtime), Tiranë;

Hoxha, Enver [1982], Titoistët (kujtime), Tiranë;

Hoxha, Nexhmije [1998], Jeta ime me Enverin (kujtime), Tiranë; Hoxha, Enver [1969,1970], Vepra, Vëllimi 3, 4, 5;

Hrabak, Bogumilj [2005], Arbanaške studije, knj.I-V, Beograd;

Jelavich, Barbara [1999], Historia e Ballkanit, Tiranë;

Kasoruh, Amik [1996], Një ankth gjysmë shekullor, Tiranë;

Kissinger, Henry [1999], Diplomacia, Tiranë;

Kodra, Lam[1945]Artikuj dhe ligjërata 1939-1945, Tiranë;

Kodra, Masar [1997], Çështja shqiptare në analet diplomatike amerikane (1918-1945), Shkup;

Lalaj, Ana [2000], Kosova, rruga e gjatë drejt vetvendosjes, Tiranë; Lamaj, Idriz [2000], Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë, Nju Jork;

Lleshi, Haxhi[1996], Vite, njerëz, ngjarje, Tiranë;

Macolm, Noel [1998], Kosova - një histori e shkurtër, Prishtinë;

Marmullaku, Rmadan [1975], Albania and the Albanians, London;

Marović, Miodrag [1995], Balkanski džoker, Tivar;

Martin, Nicolas [1979], La Forteres se albanaise, Paris;

Miljković, Mita [1978], Kosmet moje mladosti, 1937-1978, Beograd;

Mjeku, Muhamet [1991], Lufta e Drenicës dhe Shaban Poluzha, Prishtinë;

Musta, Agim [1992], Mandelë te Shqipërisë, Tiranë;

Nako, Spiru [1945], Artikuj dhe fjalime, Tiranë;

Nasi, Lefter [1994], Ripushtimi i Kosovës, Tiranë;

Nikolić, Miodrag [1989], Inform biro, Zagreb;

Nishani, Omer [1945], Artikuj dhe ligjërata, Tiranë;

Pano, Nicholas [1968], The People's Republic of Albania, Baltimore;

Perović, Marko [1961], Ekonomski odnosi i zmedju Jugoslavije i Albanije, Beograd;

Petković, Ranko [1982], Jugoslavija i susednezemlje, Sarajevo;

Petranović, Branko [1995], Zapisnicisa sednica Politbiroa Centralnog Komiteta KPJ (11. Jun 1945 - 7. Jul 1948), Beograd;

Petranović, Branko [1991], Balkanska federacija 1943-1948, Beograd;

Petranović, Branko [1980], Istorija Jugoslavije, 1918-1978, Beograd;

Plaku, Panajot [1985], Dhunan daj revolucionit në Shqipëri, Rilindja;

Plasari, Ndreçi [1964], Partia Komuniste e Shqipërisë organizatore e fitores historike të popullit shqiptar në luftën nacional-çlirimtare kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve, Tiranë;

Plasari, Ndreçi - Ballvora Shyqri [1975], Historia e Luftës Antifashiste Nacional çlirimtare të popullit shqiptar 1939-1944, Tiranë;

Pollo, Stefanaq [1990], Në gjurmë të historisë shqiptare I, Tiranë;

Pribičević, Branko [1990], Balkanska federacija, Beograd;

Pribičević, Branko [1970], Sukobizmedju komunističke partije Jugoslavije i Kominforma, Beograd;

Rajović, Radošin [1987], *Autonomiae Kosovës, Prishtinë*;  
 Sadiku, Riza [2000], *Ajet Rushiti, aderues i ideve të Ballit Kombëtar dhe Lidhjes Kosovare, Prishtinë*;  
 Shatri, Muhamet [1997], *Kosova në Luftën e Dytë Botërore, Prishtinë*;  
 Shtylla, Behar [1997], *Fan Noli, si çë kam njohur, Tiranë*;  
 Staravecka, Xhelal [1996], *Paragjyqit të historisë, Bruxells*;  
 Tempo, S. Vukmanović [1981], *Borbaza Balkan, Lubjanë*;  
 Tempo, S. Vukmanović [1971], *Revolucija koja teče, Beograd*;  
 Tempo, V. Svetozar [1985], *Memoari, Beograd*;  
 Tonnes, Bernhard, *Sonderfall Albanien, Minhen, 1980*;  
 Ukaj-Sulltane, Kojçini [1997], *Kuadri arsimornë Kosovë në shënjestrën e sigurimit shtetëror (1945 - 1952), Prishtinë*;  
 Vereš, Vladimir [1988], *Osnovni momenti društveno-ekonomskogi političko grazvoja Albanije u posleratnim godinama, Beograd*;  
 Xhonson, Pol [2000], *Kohët moderne (I-II), Tiranë*;  
 Zavalani, Tajar [1968], *Historia e Shqipnisë, Londër*; Zogaj, Agim [1993], *Fuqia e ideve, Prishtinë*;  
 Zogaj, Agim [2007], *Kosova mbi të gjitha, "Zëri", Prishtinë*;  
 Zogaj, Agim [2008], *Kritikë historiografike bashkëkohore, "Zëri", Prishtinë*;  
 Zogaj, Agim [2010], *Paqja e Ftohtë, Rozafa, Prishtinë*;

#### **4. Revistat dhe gazetat**

- “Bashkimi”, Tiranë;  
“Borba”, Beograd;  
“Casopis za Suvremenu Povijest”, Zagreb;  
“Duga”, Beograd;  
“Glas”, Beograd;  
“Gjurmime Albanologjike”. Prishtinë;  
“Istraživanja”, Novi Sad;  
“Istorija 20. veka”, Beograd;  
“Istorijski časopis”, Beograd;  
Javorja politike “Zëri”, Prishtinë;  
“Koha ditore”, Prishtinë;  
“Marksisti čkamisao”, Beograd;  
“Politika”, Beograd;  
“Rilindja”, Prishtinë;  
Shejzat, nr, 7-8, Romë, 1962;  
“Studime historike”, Tiranë;  
“Zëri i Popullit”, Tiranë;  
“Zëri i rinisë”, Prishtinë; “Zëri”, Prishtinë.

### **Nga i njëjtiautor:**

1. Dosja P. /Procesi i Prizrenit '56/ (1992 & 1997);
2. Fuqia e ideve /1993/;
3. Shpirtrate lënduar /1995,1997/;
4. Dëshmi për Kosovën /1995, Prishtinë & Shkup & Dyseldorf/;
5. Dëshmi për rrugën e lirisë /2002/;
6. Ndërhyrja jugosllave në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore /2003/;
7. Kosova mbi të gjitha /2007/;
8. Kritikë historiografike bashkëkohore /2008/;
9. Yugoslav Interventionin Albania during World War Two /2014, Editor: Lambert Academy Publishing/;
10. Paqja e Ftohtë /2010/;
11. Marrëdhëniet shqiptaro– jugosllave dhe çështja e Kosovës 1945 - 1948 /2015/;
12. Lufta e Kosovës /Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës 1998-1999/ Në dorëshkrim/;
13. Kosova: të vërtetat e fshehura /Në dorëshkrim/.

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51).09(093.2) 327(496.51:497.1)“1945/1948”

Zogaj, Agim

Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe çështja e Kosovës  
1945-1948 / Agim Zogaj. – Prishtinë : Kosova PEN Center,  
2015. – 256 f. ; 21 cm.

Burimet dhe literatura : f. 251-255

**ISBN 978-9951-457-40-8**